

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR VETËQEVERISJEN VENDORE

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare



Tiranë, 2018

ISBN: 978-9928-01-088-9

Adresa:

Rruga "Nikolla Jorga"

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al, Web: www.botimezyrtare.gov.al

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I ORGANIZIMI DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Ligj nr.139/2015, datë 17.12.2015	Për vetëqeverisjen vendore	7
Ligj nr.115/2014, datë 31.07.2014	Për ndarjen administrative (vetëm ligjin pa tabelat), ndryshuar me: <i>- ligjin nr.180/2014, datë 18.12.2014</i>	40
Ligj nr.8669, datë 26.10.2000	Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave, ndryshuar me: <i>- ligjin nr. 10 176, datë 29.10.2009;</i> <i>- ligjin nr.10 084, datë 23.2.2009;</i> <i>-ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011.</i>	41
Ligj nr.10129, datë 11.05.2009	Per gjendjen civile, ndryshuar me: <i>- ligjin nr.6/2012, datë 2.2.2012;</i> <i>- ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013;</i> <i>- ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016.</i>	48
Ligj nr.9270, datë 29.07.2004	Per sistemin e adresave, ndryshuar me: <i>- ligjin nr.9951, datë 10.7.2008;</i> <i>- ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016.</i>	76
Ligj nr.8744, datë 22.02.2001	Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, ndryshuar me: <i>- ligjin nr.9561, datë 12.6.2006;</i> <i>- ligjin nr.9797, datë 23.7.2007.</i>	83
Ligj nr.9220, datë 15.04.2004	Për shërbimin publik të varrimit, ndryshuar me: <i>- ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014.</i>	89
Ligj nr.152/2015, datë 21.12.2015	Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	105
Ligj nr.10463, datë 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ndryshuar me: <i>- ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013.</i>	125
Ligj nr. 8308, datë 18.3.1998	Për transportet rrugore, ndryshuar me: <i>- ligjin nr. 8908, datë 6.6.2002;</i> <i>- ligjin nr.9096, datë 3.7.2003;</i> <i>- ligjin nr. 9373, datë 14.4.2005;</i> <i>- ligjin nr.9760, datë 21.6.2007;</i> <i>- ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009;</i> <i>- ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010;</i> <i>- ligjin nr. 118, datë 13.12</i> <i>.2012;</i> <i>- ligjin nr. 21, datë 14.2.2013;</i> <i>- ligjin nr. 37, datë 10.4.2014;</i> <i>- ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016.</i>	160
Ligj nr. 107/2014, datë 31.7.2014	Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, ndryshuar me: <i>- ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015;</i> <i>- ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017.</i>	180

KAPITULLI II ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

Ligj nr.9632, datë 30.10.2006	Për sistemin e taksave vendore, ndryshuar me: - <i>ligjin nr.9745, datë 28.5.2007;</i> - <i>ligjin nr.9764, datë 9.7.2007;</i> - <i>ligjin nr.9931, datë 9.6.2008;</i> - <i>ligjin nr.10 073, datë 9.2.2009;</i> - <i>ligjin nr.10 117, datë 23.4.2009;</i> - <i>ligjin nr.10 146, datë 28.9.2009;</i> - <i>ligjin nr. 10 354, datë 18.11.2010;</i> - <i>ligjin nr.10 457, datë 21.7.2011;</i> - <i>ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013;</i> - <i>ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013;</i> - <i>ligjin nr. 85/2014, datë 17.7.2014;</i> - <i>ligjin nr.142/2015, datë 17.12.2015;</i> - <i>me vendimin e gjykatës kushtetuese nr. 16, datë 1.3.2017;</i> - <i>ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017;</i> - <i>ligjin nr. 106, datë 30.11.2017.</i>	210
----------------------------------	---	-----

Ligj nr.68/2017, datë 27.04.2017	Për financat e vetëqeverisjes vendore	244
-------------------------------------	---------------------------------------	-----

KAPITULLI III SHËRBIMET DHE PËRKUJDESJA SHOQËRORE

Ligj nr.9374, datë 21.04.2005	Për ndihmën shtetërore, ndryshuar me: - <i>ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009;</i> - <i>me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016.</i>	268
----------------------------------	---	-----

Ligj nr.9355, datë 10.03.2005	Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, ndryshuar me: - <i>ligjet: nr.9602, datë 28.7.2006;</i> - <i>ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009;</i> - <i>ligjin nr.10 252, datë 11.3.2010;</i> - <i>ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011;</i> - <i>ligjin nr. 25/2013, datë 14.2.2013;</i> - <i>ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014;</i> - <i>ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016;</i> - <i>ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016.</i>	279
----------------------------------	---	-----

Ligj nr.22/2018, datë 3.5.2018	Për strehimin social	293
-----------------------------------	----------------------	-----

KAPITULLI IV ARSIMI, SPORTI DHE SHËRBIMET ARGËTUESE

Ligj nr.69/2012, datë 21.6.2012	Për arsimin parauniversitar, ndryshuar me: - <i>ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015.</i>	325
------------------------------------	---	-----

Ligj nr. 79/2017 datë 27.04.2017	Për sportin	348
-------------------------------------	-------------	-----

Ligj nr.112/2013, datë 04.04.2013	Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me: - <i>ligjin nr.10/2015, datë 19.2.2015.</i>	367
--------------------------------------	--	-----

Ligj nr.10 253, datë 11.03.2010	Për gjuetinë, ndryshuar me: <i>-ligjin nr.43/2013, datë 14.02.2013.</i>	375
------------------------------------	--	-----

KAPITULLI V

MJEDISI DHE BURIMET NATYRORE

Ligj nr.9693, datë 19.03.2007	Për fondin kullosor, ndryshuar me: <i>- ligjin nr.9996, datë 22.9.2008;</i> <i>- ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009;</i> <i>- ligjin nr. 14/2012, datë 16.2.2012;</i> <i>- ligjin nr. 38/2013, datë 14.2.2013;</i> <i>- ligjin nr. 49/2016, datë 5.5.2016 .</i>	395
Ligj nr.111/2012 datë 15.11.2012	Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ndryshuar me: <i>- ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018.</i>	407
Ligj nr.24/2017, datë 9.3.2017	Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit	447
Ligj nr.10 431, datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e mjedisit, ndryshuar me: <i>- ligjin nr.31/2013, date 14.2.2013.</i>	462
Ligj nr.9385, datë 4.5.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor, ndryshuar me: <i>- ligjin nr.9533, datë 15.5.2006;</i> <i>-ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007;</i> <i>- ligjin nr.9989, datë 15.9.2008;</i> <i>- ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009;</i> <i>- ligjin nr.15/2012, datë 16.2.2012;</i> <i>- ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013;</i> <i>- ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016.</i>	448
Ligj nr.10 440, datë 7.7.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis	514
Ligj nr. 81/2017, datë 4.5.2017	Për zonat e mbrojtura	529
Ligj nr.93/2015, datë 27.7.2015	Për turizmin, ndryshuar me: <i>- ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017.</i>	563

KAPITULLI VI

SIGURIA PUBLIKE

Ligj nr.9780, datë 16.07.2007	Për inspektimin e ndërtimit, ndryshuar me: <i>- ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010;</i> <i>- ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010;</i> <i>- ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013;</i> <i>-ligjin nr.183/2014, datë 24.12.2014.</i>	591
Ligj nr.8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile, ndryshuar me: <i>-ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009</i>	600

KAPITULLI I
ORGANIZIMI DHE SHËRBIMET PUBLIKE

LIGJ
Nr. 139/2015

PËR VETËQEVERISJEN VENDORE¹

Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrimi” është e drejta për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e një funksioni.
2. “Autonomi vendore” është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.
3. “Funksion” është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.
4. “Funksione të deleguara” janë ato funksione të qeverisë qendrore, ushtrimi i të cilave u delegohet njësive të vetëqeverisjes vendore.
5. “Kompetencë” është autoriteti i dhënë me ligj një organi të njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e një funksioni apo një pjese të tij.
6. “Konsultimi” është proces institucional këshillimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin e shkëmbimin e opinionëve për politikën, legjislacionin e normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.
7. “Ndërmarrje për shërbime publike” është çdo ndërmarrje e krijuar për të ofruar shërbim /shërbime publik/e që janë kompetencë e bashkisë, për të cilën kapitali, vota ose e drejta për të emëruar organet drejtuese dhe financimi kontrollohen nga bashkia.

¹ Ligj nr. 139/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 249, datë 14 janar 2016.

8. “Qeverisje qendrore” është Këshilli i Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të shtetit.

9. “Rregullimi” është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin.

10. “Riorganizim administrativo-territorial” është ndryshimi në ndarjen administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. “Subjekt i kompetencave të përbashkëta” është një komitet, ent, institucion, ndërmarrje ose bord, shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përmbushjen e një detyrimi të përbashkët.

12. “Subsidiaritet” është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomisë.

13. “Shërbime publike” janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Neni 3

Misioni i vetëqeverisjes vendore

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Neni 4

Parimet themelore të vetëqeverisjes vendore

1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore.
2. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë persona juridikë publikë.
4. Çdo bashki dhe qark është njësi vetë-qeverisëse me vazhdimësi.

KREU II

NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE DHE ORGANET

Neni 5

Njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.

2. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore.
3. Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh. Bashkitë, shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj përcaktohen me ligj.
4. Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore.
5. Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj.

Neni 6 Nënndarjet e bashkisë

1. Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj.
2. Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj. Shpallja e qyteteve të reja bëhet me ligj.
3. Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Një lagje, si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë. Ndarja e qyteteve në lagje dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

Neni 7 Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Në çdo bashki dhe qark krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv.
2. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë.
3. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Funkcionet ekzekutive në qark kryhen nga kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut.
4. Organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë zgjidhen në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
5. Organi përfaqësues i qarkut krijohet me përfaqësues nga organet e zgjedhura të bashkive që e përbëjnë atë, sipas mënyrës së përcaktuar në Kushtetutë dhe në kreun XIII të këtij ligji. Kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshilli i qarkut, sipas mënyrës së përcaktuar në kreun XIII, të këtij ligji.

KREU III TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 8 Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor

1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.
2. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhërësave dhe urdhrave.

Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës:

a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;

b) bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra;

c) krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi;

c) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre.

d) krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

1.2. Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

b) e drejta e fitimit të pronës, nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

c) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

1.4. Të drejtën dhe përgjegjësinë e kryerjes së veprimtarive ekonomike, sipas së cilës:

a) për përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqësojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ushtrojnë veprimtari ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit;

b) të ardhurat, që përfitohen nga veprimtaria ekonomike, përdoren në pjesën më të madhe për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve publike;

c) veprimtaria ekonomike e njërive të vetëqeverisjes vendore rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.5. Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës:

a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësi të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë;

b) bashkëpunojnë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;

c) kanë të drejtë të organizohen në shoqata, në përputhje me legjislacionin përkatës.

1.6. Të drejtën e personit juridik:

Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë:

a) të drejtën e lidhjes së kontratës;

b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;
c) të drejtën e ngritjes së padisë civile;
ç) të drejtën e mbajtjes së llogarive;
d) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore.

1.7. Të drejta të tjera, sipas të cilave:

a) japin tituj nderi dhe stimuj;
b) vendosin emërtimet e territoreve, objekteve dhe institucioneve nën juridiksionin e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj;
c) njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë vulën dhe simbolet e tyre.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e sipër-përmendura ushtrohen nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi.

KREU IV

MARRËDHËNIET MIDIS QEVERISJES QENDRORE DHE NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 10

Marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore

Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Neni 11

Komunikimi dhe informimi

Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, për fushën e tyre të përgjegjësisë, informojnë me shkrim organet e qeverisjes qendrore për çdo çështje që u kërkohet informacion. Organet e qeverisjes qendrore, kur kërkohet nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, japin informacion, sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 12

Konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësive.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.

3. Struktura, procedura, forma, mënyra e organizimit dhe funksionimit dhe natyra e çështjeve për konsultim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare, të përcaktuara në legjislacionin përkatës, ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë, monitorojnë veprimtarinë e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për funksionet e deleguara kanë të drejtë t'i mbikëqyrin ato.

2. Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe inspektimit financiar për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen kontrollit të jashtëm financiar nga organet e qeverisjes qendrore për përdorimin e fondeve të kushtëzuara dhe/ose të deleguara që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe/ose fondet e ndihmës së huaj, të alokuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga qeverisja qendrore.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V BASHKËPUNIMI MES NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 14

Bashkëpunimi mes dy apo më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve specifike në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësi të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë.

2. Në çdo marrëveshje të bashkëpunimit ndërvendor përcaktohen:

- a) qëllimi i marrëveshjes;
- b) funksionet që do të ushtrohen nga secila bashki apo në mënyrë të përbashkët;
- c) mënyra me anë të së cilës do të plotësohet qëllimi;
- d) shkalla dhe kohëzgjatja e delegimit të kompetencave;
- e) mënyra dhe masa e kontributit financiar përkatës dhe e ndarjes së të ardhurave e të përfitimeve të tjera.

3. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërvendor miratohet nga këshillat përkatës të secilës prej njësive të vetëqeverisjes vendore që janë palë në marrëveshje. Detyrimi financiar për secilën prej njësive të vetëqeverisjes vendore, palë të marrëveshjes, miratohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin vendor.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor me njësi të vetëqeverisjes vendore të shteteve huaja. Përpara lidhjes së këtyre marrëveshjeve, njësitë marrin mendimin e Ministrisë Punëve të Jashtme.

5. Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

6. Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, subjekti i kompetencave të përbashkëta njofton zyrtarisht prefektin.

7. Në njoftimin zyrtar përcaktohen:

- a) emërtimi i njësive të vetëqeverisjes vendore, palë në marrëveshje;
- b) data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- c) qëllimi i marrëveshjes dhe funksioni që do të ushtrohet;
- d) vendimet e bashkive të përfshira në marrëveshje në lidhje me të;
- e) kontributi i palëve në këtë marrëveshje.

8. Marrëveshja bëhet e zbatueshme pas shprehjes së ligjshmërisë nga prefekti brenda afateve të përcaktuara me ligj.

KREU VI

TRANSPARENCA, KONSULTIMI DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Neni 15

Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.
3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 16

Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.
2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 17

Mbledhjet e këshillit të bashkisë

1. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

Neni 18

Seancat e këshillimeve me bashkësinë

1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji.
2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.
3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Neni 19

E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore.

2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 20

E drejta e iniciativës qytetare

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.

2. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

KREU VII

FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 21

Llojet e funksioneve

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara.

2. Funksionet u njihen njërive të vetëqeverisjes vendore me këtë ligj. Funksione apo kompetenca të tjera mund t'u njihen një, disa apo të gjitha njërive të vetëqeverisjes vendore vetëm në bazë të ligjit.

3. Funksionet e deleguara u transferohen njërive të vetëqeverisjes vendore me ligj ose me marrëveshje. Në çdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferi i mjafueshme të qeverisjes qendrore për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve.

Neni 22

Parimet për ushtrimin e funksioneve

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde e norma specifike të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave kombëtarë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.

3. Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjafueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore administrojnë ushtrimin e funksioneve të deleguara, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e deleguara, qeverisja qendrore siguron mjete dhe burime financiare të mjaftueshme për të ushtruar këto funksione në mënyrën dhe në atë nivel ose standard, i cili është përcaktuar me ligj.

Neni 23

Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
5. Ndriçimin e mjediseve publike.
6. Transportin publik vendor.
7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
8. Shërbimin e dekorit publik.
9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 24

Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 25

Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

3. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.

4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Neni 26

Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Neni 27

Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.
5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.
2. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.
3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.
4. Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.
5. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.
6. Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Neni 29

Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike

Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësisë të vetë-qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Neni 30

Funksionet dhe kompetencat e deleguara

1. Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme.

2. Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë ato të përcaktuara me ligj.

3. Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë bashkinë ose qarkun të kryejnë funksione të caktuara, duke përcaktuar, kur është e nevojshme, procedurat e kryerjes e të kontrollit për zbatimin e tyre.

4. Institucionet qendrore mund të autorizojnë bashkinë dhe/ose qarkun të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar.

5. Bashkisë ose qarkut mund t'u delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për këtë funksion ose kompetencë.

6. Në çdo rast qeverisja qendrore u garanton njësisë të vetëqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

7. Bashkia ose qarku, me nismën e tyre, mund të përdorin burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të deleguara, me synim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të bashkësisë.

Neni 31

Funksionet e qarkut

1. Funksionet e qarkut janë ndërtimi e zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj.

2. Qarku ushtron të gjitha funksionet që i delegohen nga një ose më shumë bashki, brenda territorit të qarkut, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve.

3. Qarku kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror, sipas parimeve të parashikuara në nenin 22 të këtij ligji.

Neni 32

Administrimi i shërbimeve publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike, në përputhje me funksionet e caktuara me ligj, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë.

2. Mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimeve publike, kur nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 33

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

a) njësive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;
b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;
c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;
ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;

d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, njësia vendore do të jetë përgjegjëse për:

a) hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare;

b) hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës;

c) krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor.

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.

KREU VIII FINANCAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 34

Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.

2. Funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kudoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.

4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohej me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

5. Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera.

6. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Neni 35

Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore

1. Bashkitë krijojnë të ardhura nga:

a) taksat vendore mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;

b) taksat vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;

c) taksat vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;

c) taksat vendore mbi të ardhurat vetjake, të krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;

d) të ardhura nga donacionet dhe dhuratat;

dh) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;

e) taksa të tjera të përcaktuara me ligj.

2. Bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin përkatës.

3. Bashkitë kanë të drejtë të përjashtojnë nga pagimi i taksës kategori të caktuara apo grupe në nevojë, në përputhje me ligjin përkatës.

4. Baza e taksave vendore, si dhe kufijtë maksimalë dhe/ose minimalë të tyre vendosen me ligj të veçantë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të zbatojnë ose jo një taksë vendore. Kur këto njësi zbatojnë taksën vendore, ato ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të tyre, mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të tyre, sipas kriterëve dhe kufijve të përcaktuar në legjislacionin përkatës.

5. Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për:

a) shërbimet publike që ato ofrojnë;

b) të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;

c) dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;

c) çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara me ligj.

Neni 36

Të ardhurat nga burime të tjera të bashkive

1. Të ardhurat nga burime të tjera të bashkive janë:

a) të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë;

b) të ardhurat nga investimet mbi kapitalet;

c) të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia;

ç) të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi;

d) të ardhurat nga partneritetet privat-publik.

2. Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjrobat, ndihmat ose donacionet.

3. Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Neni 37

Të ardhurat që rrjedhin nga burimet kombëtare

1. Bashkitë krijojnë të ardhurat nga burimet kombëtare:

a) Taksat dhe tatimet e ndara, në të cilat përfshihen një pjesë e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin dhe taksave të tjera mbi pasuritë kombëtare. Të ardhurat nga këto taksa e tatime u jepen bashkive rregullisht në jo më pak se katër transferta në vit. Pjesa e taksës dhe tatimit që shkon në favor të tyre, si dhe mbledhja e administrimit përcaktohen me ligj për çdo taksë ose tatim të ndarë.

b) Transferta e pakushtëzuar nga qeverisja qendrore të njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e funksioneve të veta, si dhe për arritjen e barazisë së shpërndarjes së burimeve financiare mes njësitë të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar caktohet si përqindje fikse kundrejt të ardhurave të qëndrueshme publike, sipas përcaktimit në ligjin që rregullon financat vendore, si dhe shpërndahet sipas formulës së përcaktuar me ligj.

c) Transfertat e kushtëzuara nga qeverisja qendrore do të bazohen në kriterë objektive dhe renditjen prioritarë të nevojave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, kushtet ekonomike, kërkesat e infrastrukturës, si dhe në strategjitë e zhvillimit në nivel kombëtar e rajonal.

2. Qeverisja qendrore, në periudhën e hartimit të projektbuxhetit të shtetit, është e detyruar të konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet instrumenteve të përcaktuara të konsultimit, duke analizuar mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 38

Burimet e financimit të qarkut

1. Qarku krijon të ardhura nga burimet e veta vendore dhe të ardhura që rrjedhin nga burime kombëtare.

2. Të ardhurat nga burimet e veta vendore dhe kombëtare përbëhen nga:

- a) transfertat e pakushtëzuara nga Buxheti i Shtetit;
- b) transfertat e kushtëzuara për kryerjen e funksioneve e të kompetencave të deleguara përkatëse nga bashkitë përbërëse;
- c) taksa të vendosura në nivel qarku, të përcaktuara në përputhje me ligjin;
- ç) tarifat për shërbimet publike të kryera nga qarku.

3. Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak.

4. Kriteret dhe normat për krijimin dhe administrimin e të ardhurave nga burimet e veta vendore janë të ngjashme me ato të përcaktuara për të ardhurat nga burimet vendore të bashkive.

5. Të ardhurat e qarkut nga ndarja e të ardhurave kombëtare krijohen dhe administrohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj dhe në ligje të tjera në fuqi.

Neni 39

Huamarrja vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin hua, në përputhje me legjislacionin që rregullon menaxhimin e sistemit buxhetor, huamarrjen vendore dhe financat vendore.

2. Në kufirin vjetor të huamarrjes, miratuar me ligjin vjetor të buxhetit, një përqindje e caktuar i rezervohet njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me politikën dhe disiplinën fiskale të ndjekur nga qeverisja qendrore. Aksesit në tregun e borxhit të jashtëm rregullohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe entitete të tjera, të përcaktuara me ligj.

3. Çdo rregullim apo kufizim i vendosur nga qeverisja qendrore në huamarrjen e vetëqeverisjes vendore, që kufizon mundësinë e njësive të vetëqeverisjes vendore për të marrë hua, duhet të jenë të përkohshëm dhe të mos shtrihen përtej vitit fiskal në të cilin janë vendosur, përveç rasteve kur këto masa miratohen nga Kuvendi.

Neni 40

Shpenzimet

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare. Të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, që nuk janë shpenzuar brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal.

2. Në kushtet e mungesës së buxhetit të miratuar nga këshilli, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr përkohësisht kompetencat e këshillit dhe autorizon kryerjen e shpenzimeve mujore deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës.

3. Kryetari i bashkisë ose personat e autorizuar prej tij nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve, të përcaktuar në zërin përkatës në buxhetin vjetor. Nuk lejohen shpenzime të fondeve nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla.

4. Pas miratimit zyrtar të buxhetit, kryetari i bashkisë mund të autorizojë ose të kërkojë autorizimin e këshillit për rishpërndarjen e fondeve nga një zë shpenzimesh në një tjetër, brenda dhe midis programeve të ndryshme buxhetore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë menaxhimin e sistemit buxhetor dhe financat vendore.

5. Pavarësisht nga dispozitat e këtij ligji, asnjë transfertë e kushtëzuar, e dhënë nga qeverisja qendrore, nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në grantin apo transfertën përkatëse.

6. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Neni 41

Buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore.

2. Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:

a) parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh, përfshirë shlyerjen e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) të gjitha transfertat e kushtëzuara, të parashikuara për t'u marrë nga qeverisja qendrore dhe të cilat hyjnë në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe që përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë, në përputhje me rregullat e caktuara nga qeverisja qendrore për përdorimin e tyre;

c) të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për t'u siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë bashkisë nga çfarëdolloj burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore, tarifat, vlerësimet, gjokat, grantet nga burime të niveleve të tjera të qeverisjes;

ç) parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse; parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja me informacionin e mëposhtëm:

i) qëllimin e investimit;

ii) planin e financimit, përfshirë mënyrat dhe burimet e financimit;

iii) shpenzimet vjetore që duhen për shlyerjen e kredisë, nëse përdoret, si dhe një preventiv të shpenzimeve operative që lindin si pasojë e kryerjes së investimit;

d) objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Neni 42

Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare

1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjëse për arkivimin, ruajtjen e administrimin e dokumenteve financiare dhe për dëmtimin ose humbjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat.

Neni 43

Kontrolli i jashtëm dhe auditimi

1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohet kontrollit të jashtëm nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është subjekt i auditimit të brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo raport i kontrollit të jashtëm apo auditimit të brendshëm mbi funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të vihet në dispozicion të publikut, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Me vendim të veçantë të këshillit bashkiak ose të këshillit të qarkut, organet ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore mund t'i nënshtrohen auditimit të kryer nga shoqëri të specializuara në fushën e auditimit.

Neni 44

Raporti vjetor

Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

KREU IX

**PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT
E KËSHILLIT BASHKIAK**

Neni 45

Mënyra e zgjedhjes

Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 46

Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak

1. Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:

- Bashkitë deri në 20 000 banorë	15 anëtarë;
- Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë	21 anëtarë;
- Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë	31 anëtarë;
- Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë	41 anëtarë;
- Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë	51 anëtarë;
- Bashkitë mbi 400 000 banorë	61 anëtarë.
2. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet vendore.

Neni 47

Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit

1. Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:
 - a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë;
 - b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;

- c) funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
- c) funksionin e deputetit;
- d) funksionin e ministrit.
- 2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak.
- 3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin.

Neni 48

Mbledhja e parë e këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga data e shpalljes së rezultatit nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor.
2. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti.
3. Në rast se asnjë nga subjektet e sipër-përmendura nuk e ushtron këtë të drejtë, brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë këshilli mbledhet vetë brenda 10 ditëve.
4. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, të shpallur nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Nëse nuk mbledhen më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të këshillit, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret çdo tri ditë, por jo më shumë se tri herë. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrjeje nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, këshilli konsiderohet i shpërndarë.
5. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë.
6. Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak:
 - a) zgjidhet komisioni i mandateve;
 - b) miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
 - c) këshilltarët bëjnë betimin;
 - c) zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit;
 - d) zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen me mandatin e përfaqësimit.
7. Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 49

Mandati i këshilltarit

1. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak.
2. Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.
3. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.
4. Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:
 - a) ndryshon vendbanimin jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji;
 - c) mandati, nga ana e tij, është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
 - d) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykatë;
 - dh) vdes;
 - e) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;
 - ë) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykatë të formës së prerë;
 - f) këshilli shpërndahet nga organi kompetent.
5. Mbarimi i mandatit para kohe deklarohet me vendim të këshillit bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve.

Neni 50
Betimi

1. Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, këshilltarët bëjnë këtë betim para këshillit: “Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë (*emri i bashkisë përkatëse*) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

2. Këshilltari që mungon me arsye në bërjen e betimit betohet në mbledhjen më të parë që merr pjesë. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorë-heqjen dhe atij nuk i jepet mandati.

Neni 51
Të drejtat e këshilltarit

1. Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të bashkisë përkatëse.

2. Punëdhënësi detyrohet të lejojë anëtarin e këshillit bashkiak të shkëputet nga puna për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, komisioneve të tij apo aktivitete të organizuara prej këshillit bashkiak.

3. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga kryetari i bashkisë përkatëse, çdo dokumentacion i lidhur me bashkinë.

4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

Neni 52
Kushtet e pengesës ligjore, vetëdeklarimi dhe përjashtimi

1. Anëtar i këshillit bashkiak nuk përfshihet në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse në rastet kur:

- a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;
- b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendim-marrjen në shqyrtim;
- c) ai ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;
- d) ai ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;
- e) personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim;
- dh) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në çështjen në shqyrtim;
- e) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës së shqyrtimit;
- ë) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen, sipas rrethanave konkrete, se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën në shqyrtim;
- f) në çdo rast parashikohet nga legjislacioni në fuqi;
- g) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, janë përfshirë në çdo lloj mënyre në negocime të mundshme për punësim në të ardhmen të tij apo të personave të përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, gjatë ushtrimit të funksionit apo në negocime për çdo lloj forme tjetër

marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Nëse anëtari i këshillit bashkiak vëren një nga pengesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ai njofton menjëherë me shkrim kryetarin e këshillit bashkiak.

3. Persona të tretë mund të kërkojnë përjashtimin e pjesëmarrjes së një anëtari të këshillit bashkiak nga një procedurë, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga shqyrtimi dhe vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet kryetarit të këshillit bashkiak dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

4. Kryetari i këshillit bashkiak, i njoftuar sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, i propozon këshillit bashkiak përjashtimin ose konfirmimin e anëtarit të këshillit bashkiak nga/në procedura vendimmarrëse.

Neni 53

Funksionimi i këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, sipas nenit 48, të këtij ligji, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

2. Mbledhjet e radhës së këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.

3. Këshilli mbledhet në çdo rast:

a) me kërkesën e kryetarit të bashkisë;

b) me kërkesën me shkrim të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij;

c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

4. Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.

5. Rendi i ditës miratohet nga këshilli.

6. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm bashkiak ushtron kompetenca të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.

7. Mbledhja e këshillit bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 55 të këtij ligji.

8. Mbledhjet e këshillit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;

b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;

c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;

d) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;

f) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;

g) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

- e) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;
- l) vendos për simbolet e bashkisë;
- ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
- m) jep tituj nderi dhe stimuj;
- n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim të bashkia.

Neni 55

Votimi

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.
3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji.
4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.
6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 56

Kryetari i këshillit bashkiak

1. Kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit bashkiak zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit.
2. Kryetari i këshillit kryen këto detyra:
 - a) thërret mbledhjen e këshillit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji;
 - b) drejton mbledhjet e këshillit, në përputhje me rregulloren e tij;
 - c) nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;
 - ç) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloren e këshillit.
3. Në mungesë të kryetarit të këshillit, detyrat e tij i kryen zëvendëskryetari, sipas përcaktimit në rregulloren e brendshme të këshillit.

Neni 57

Sekretari i këshillit bashkiak

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.

2. Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës për:

- a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
- b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës;
- c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
- d) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak;
- e) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
- dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.

3. Sekretari i këshillit bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

Neni 58

Shpërndarja e parakohshme e këshillit bashkiak

1. Kur këshilli bashkiak nuk mbledhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore nga mbledhja e fundit e tij, prefekti thërret mbledhjen e tij, jo më vonë se 20 ditë nga ky afat. Nëse edhe pas thirrjes së prefektit këshilli bashkiak nuk mbledhet, atëherë ai shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli bashkiak shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave edhe kur:

a) nuk miratohet buxheti brenda afatit të përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Në këtë rast prefekti i kërkon kryetarit të bashkisë të thërrasë mbledhjen e këshillit bashkiak, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 10 ditë nga data e mbarimit të këtij afati. Në rast se edhe në këtë rast këshilli bashkiak nuk arrin të miratojë buxhetin, vendoset shpërndarja e tij para kohe;

b) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.

3. Këshilli bashkiak shpërndahet edhe kur bëhet riorganizim me ndryshim kufijsh, sipas nenit 93 të këtij ligji.

4. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të shpërndarjes nga organi kompetent, në bashkinë përkatëse organizohen zgjedhjet për këshillin, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

5. Deri në konstituimin e këshillit të ri, funksionet dhe kompetencat e këshillit, për aq sa është e mundur, kryhen nga kryetari i bashkisë.

KREU X

KRYETARI I BASHKISË

Neni 59

Kryetari i bashkisë

1. Çdo bashki ka kryetarin e saj, të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.

2. Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkisë, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Kryetari i bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga kryetari i bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga kryetari i bashkisë.

4. Zëvendëskryetari i bashkisë nuk mund të jetë anëtar i këshillit bashkiak.

Neni 60

Mandati i kryetarit të bashkisë

1. Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.

2. Deklarimi i pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit bëhet kur vërehet se nuk plotësohen kushtet, sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

3. Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të këshillit bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin, sipas formulës së përcaktuar në nenin 50, të këtij ligji, dhe e nënshkruan atë.

4. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës.

5. Në rast se këshilli bashkiak nuk mblidhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prefekti organizon ceremoninë e betimit të kryetarit të bashkisë në mjedisin e bashkisë dhe në praninë e banorëve të njësisë përkatëse.

Neni 61

Përfundimi para kohe i mandatit të kryetarit të bashkisë

1. Mandati i kryetarit të bashkisë përfundon përpara afatit në rastet kur kryetari:

- a) nuk pranon të bëjë betimin;
- b) jep dorëheqjen;
- c) nuk është më banor i përhershëm i bashkisë ku është zgjedhur;
- c) shkarkohet, sipas nenit 62 të këtij ligji;
- d) kandidon për deputet;
- dh) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
- e) vdes.

2. Kryetari i bashkisë në rastet e dorëheqjes e depoziton atë pranë këshillit bashkiak përkatës. Sekretari i këshillit, për ndjekjen e procedurave të nevojshme, njofton prefektin për dorëheqjen e kryetarit.

3. Për rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit përpara afatit, këshilli bashkiak njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit.

4. Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, organizohen zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e bashkisë, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

5. Me përfundimin para kohe të mandatit të kryetarit të bashkisë, sipas këtij neni, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksionet e tij i kryen zëvendëskryetari i bashkisë. Në rastet kur ka më shumë se një zëvendëskryetar bashkie, këshilli përkatës, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, cakton një nga zëvendëskryetarët të kryejë funksionet e kryetarit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

6. Në rastin kur vendi i kryetarit të bashkisë mbetet vakant gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të tij, këshilli përkatës zgjedh nga radhët e veta një kryetar të ri me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, i cili ushtron funksionet deri në përfundim të mandatit.

Neni 62

Shkarkimi i kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur:

- a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve;
- b) dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë, nga gjykata;

c) propozohet për shkarkim nga këshilli bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë.

Neni 63

Simboli i kryetarit të bashkisë

1. Simboli dallues i kryetarit të bashkisë është një shirit me ngjyrat e flamurit kombëtar, me gjerësi 111 mm, i ndarë në tre sektorë me gjerësi të njëjtë, i kuq - i zi - i kuq.

2. Simboli dallues vendoset krahaqafë, nga supi i djathtë në ijën e majtë.

3. Kryetari e mban detyrimisht këtë shirit në mbledhjet solemne, pritjet zyrtare, ceremonitë publike dhe në ceremonitë e lidhjes së martesave.

Neni 64

Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;

b) zbaton aktet e këshillit;

c) merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;

ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;

d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;

dh) është anëtar i këshillit të qarkut;

e) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;

ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative /lagjeve dhe i shkarkon ata;

f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;

g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;

gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;

h) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;

i) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve;

j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;

l) kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.

KREU XI

DREJTIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË

Neni 65

Administrata e njësisë administrative

1. Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori.
2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës. Administratori duhet të ketë vendbanimin në njësinë administrative përkatëse.
3. Struktura dhe organika e administratës së njësisë administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Neni 66

Detyrat e administratës së njësisë administrative

Administrata e njësisë administrative kryen këto detyra:

- a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- c) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;
- d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;
- e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;
- ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;
- f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;
- g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;
- g)) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;
- h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë.

Neni 67

Administrimi i lagjes

1. Në rastin e krijimit të lagjeve, sipas pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji, në secilën lagje krijohet dhe funksionon administrata e lagjes, që drejtohet nga administratori i lagjes. Administratori i lagjes emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij.
2. Administrata e lagjes kryen të gjitha detyrat administrative, të ngarkuara nga kryetari i bashkisë, si dhe kujdeset për zhvillimin ekonomik vendor, për përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në lagjen përkatëse. Detyrat më të hollësishme përcaktohen në aktet e nxjerra nga kryetari i bashkisë.

KREU XII FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE KOMUNITARE NË BASHKI

Neni 68

Struktura komunitare në qytet

1. Në qytete, në bazë të iniciativës qytetare, ngrihen dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe organizohen mbi baza vullnetare.
2. Këshillat bashkiakë përcaktojnë rregullat e përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve dhe marrëdhëniet që ato kanë me bashkinë dhe strukturat e saj.
3. Nga radhët e anëtarëve të këshillave komunitarë zgjidhen ndërlidhësit komunitarë që drejtojnë dhe organizojnë punën e këshillave.
4. Si rregull, në çdo lagje krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve.

Neni 69

Detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar

1. Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të mbështesin funksionet qeverisëse të bashkisë në lagjen e tyre dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit.
2. Këshillat komunitarë, në bazë të vendimeve të këshillave bashkiakë, kanë të drejtë të kryejnë funksione dhe kompetenca të caktuara që mund t'u delegohen nga këshilli. Në këtë rast, këshilli bashkiak vendos edhe për masën e financimit apo bashkëfinancimit për kryerjen e funksionit apo kompetencës së deleguar, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e këshillit komunitar.
3. Ndërlidhësi komunitar mund të shpërblehet për punën që kryen, sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak.

Neni 70

Struktura komunitare në fshat

1. Fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. Kryesia është organ këshillimor i kryetarit. Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhje të fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote. Përbërja e kryesisë së fshatit duhet të respektojë ligjin për barazinë gjinore. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga këshilli bashkiak përkatës.
2. Numri i anëtarëve të kryesisë së fshatit përcaktohet nga këshilli bashkiak në bazë të numrit të banorëve të fshatit dhe lagjeve përbërëse të tij.
3. Kryetari i fshatit zgjidhet nga kryesia e fshatit nga radhët e anëtarëve të kryesisë së fshatit.
4. Zgjedhjet e kryesisë së fshatit bëhen një herë në katër vjet, pas zgjedhjeve për këshillin bashkiak dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, kryetari i bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit. Në rastet e krijimit të vendit vakant për anëtar të kryesisë zhvillohen procedurat e sipërpërmendura të zgjedhjes për vendin vakant. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të afatit katërvjeçar.
5. Procesi i zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikëqyren nga këshilli bashkiak përkatës.

Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit

1. Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.

2. Bazuar në vendimin e kryetarit të bashkisë, kryetari ose kryesia e fshatit mund të kryejë edhe detyrat si më poshtë:

a) kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit;

b) kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdollos tërësi të rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike në fshat;

c) administrimin e varrezave të fshatit;

ç) kujdesjen për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave, si dhe të burimeve natyrore.

3. Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak.

4. Kryetari pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin.

5. Urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e organeve të zgjedhura të bashkisë përkatëse janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.

6. Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, sipas kritereve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kryetari i fshatit mund të thirret në mbledhjet e këshillit bashkiak ose merr pjesë në to me nismën e tij pa të drejtë vote. Ai ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në mbledhje për çështje që janë të lidhura me fshatin përkatës.

KREU XIII

PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT TË QARKUT

Përbërja e këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut përbëhet nga përfaqësues të bashkive që bëjnë pjesë në qark.

2. Kryetarët e bashkive që bëjnë pjesë në qark janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut.

3. Numri i anëtarëve të këshillit të qarkut përcaktohet sipas nenit 73 të këtij ligji.

4. Funksioni i anëtarit të këshillit të qarkut është i papajtueshëm me çdo funksion në administratën e qarkut.

5. Anëtarët e këshillit të qarkut e kryejnë funksionin pa shpërblim, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur anëtarë të kryesisë së këshillit të qarkut.

Përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillit të qarkut

1. Numri i përfaqësuesve të bashkive në këshillin e qarkut caktohet në përpjesëtim me numrin e popullsisë, si më poshtë:

- Bashkitë me popullsi deri në 20 000 banorë, 2 përfaqësues.

- Bashkitë me popullsi 20 001 deri në 50 000 banorë, 4 përfaqësues.

- Bashkitë me popullsi 50 001 deri në 100 000 banorë, 5 përfaqësues.

- Bashkitë me popullsi mbi 100 000 banorë, 5 + nga një përfaqësues shtesë për çdo 1 deri në 50 000 banorë mbi 100 000 banorë.

2. Brenda numrit të përfaqësuesve për çdo bashki, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshihet kryetari i bashkisë, si dhe përfaqësuesit e tjerë që zgjidhen nga këshilli i bashkisë.

3. Prefekti përcakton numrin e përfaqësuesve të çdo bashkie, që përfshihen në territorin e qarkut, duke u bazuar në të dhënat e numrit të popullsisë, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit të zgjedhjeve vendore.

4. Vendimet e këshillave bashkiakë për përfaqësuesit e tyre në këshillin e qarkut i dërgohen prefektit brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tyre.

Neni 74

Mbledhja e parë e këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 50 ditë nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore.

2. Mbledhja e parë thirret nga kryetari i bashkisë, qendër e qarkut, ose nga një e treta e anëtarëve të këshillit të qarkut. Njoftimi për mbledhjen e këshillit të qarkut i dërgohet me shkrim të gjithë anëtarëve të këshillit të qarkut jo më vonë se 10 ditë para datës së mbledhjes.

3. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij.

4. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të këshillit të qarkut, drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

5. Në mbledhjen e tij të parë këshilli i qarkut:

- a) zgjedh komisionin e mandateve, i cili verifikon mandatet e anëtarëve të këshillit;
- b) vërteton mandatet e anëtarëve të këshillit;
- c) zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kryesinë e këshillit të qarkut, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

6. Këshilli i qarkut konstituohet pas vërtetimit të mandateve të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

7. Nëse nuk sigurohet pjesëmarrja e gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit të qarkut, mbledhja anulohet dhe thirret çdo dhjetë ditë, derisa të sigurohet shumica e nevojshme.

8. Në rast se këshilli i qarkut nuk konstituohet deri në 90 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore, prefekti ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e këtij këshilli deri në çastin e konstituimit.

Neni 75

Mandati i këshilltarit të qarkut

1. Mandatin e këshilltarit të qarkut e fitojnë të gjithë kryetarët e bashkive përbërëse të tij menjëherë me marrjen e mandatit përkatës.

2. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit të qarkut përfaqësues nga radhët e këshillit bashkiak, në përputhje me nenin 48, të këtij ligji, bëhet me votimin e listës shumëmemërore të kandidatëve dhe shpallet fitues kandidati ose kandidatët që kanë marrë më shumë vota.

3. Anëtarit të këshillit të qarkut i mbaron mandati kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) vdes;
- c) humbet mandatin si kryetar apo këshilltar i bashkisë;
- d) vërtetohet se mandati është fituar në mënyrë të paligjshme.

4. Në rastin e krijimit të vendit vakant, që lidhet me humbjen e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një anëtar i këshillit të një bashkie, ai zëvendësohet nga këshilli bashkiak përkatës, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

5. Në rast se vendi vakant krijohet nga humbja e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një kryetar bashkie në 6 muajt e fundit të mandatit, vendin e tij e zë kryetari i zgjedhur nga këshilli bashkiak përkatës.

Neni 76

Funksionimi i këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut ushtron kompetencat nga çasti i konstituimit të tij deri në konstituimin e këshillit pasardhës.
2. Mbledhja e radhës e këshillit të qarkut bëhet jo më pak se një herë në tre muaj.
3. Mbledhjet zhvillohen sipas programit të punës që bën këshilli.
4. Këshilli i qarkut mbledhet jashtë radhe me kërkesë:
 - a) të kryetarit të tij;
 - b) të kryesisë së këshillit;
 - c) të një të tretës së anëtarëve të këshillit;
 - ç) të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
5. Thirrja e mbledhjes së këshillit bëhet nga kryetari.
6. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet, si rregull, jo më pak se 10 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.
7. Mbledhja e këshillit të qarkut quhet e vlefshme, kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 77

Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut

Këshilli i qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh nga anëtarët e këshillit kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e kryesisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit të qarkut;
- ç) miraton strukturën, organikën dhe kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njësive e të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkë-themelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm;
- f) vendos për taksat e tarifat në kompetencë të qarkut, si dhe për nivelin e tyre;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e një personi juridik me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta, sipas nenit 14 të këtij ligji;
- h) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndër-marrjeve dhe të institucioneve në varësi të tij;
- i) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- j) vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut, sipas nenit 75 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin e disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik në nivel qarku;
- l) vendos për simbolet e qarkut;

- ll) jep tituj nderi dhe stimuj;
- m) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark;
- n) miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së këshillit të qarkut.

Neni 78

Votimi

1. Vendimet e këshillit të qarkut merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “ë”, “f”, “g”, “gj” e “ll”, të nenit 77, të këtij ligji, që kërkojnë votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 77, të këtij ligji.

2. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rast se edhe pas këtij votimi kandidatët kanë numër të barabartë votash, fituesi caktohet me short.

3. Vendimet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 79

Mbledhjet e hapura, seancat e këshillimeve dhe e drejta e publikut për t'u informuar

Këshilli i qarkut zhvillon mbledhje të hapura për publikun, zhvillon seanca këshillimi me organet përfaqësuese e ekzekutive të bashkive dhe me bashkësitë përkatëse, si dhe respekton të drejtën e publikut për t'u informuar, sipas përcaktimeve në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji.

Neni 80

Pengesa ligjore për anëtarët e këshillit të qarkut

Anëtari i këshillit të qarkut është në kushtet e pengesës ligjore, në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 52, të këtij ligji, dhe për të zbatohet nga kryetari i këshillit të qarkut kompetenca dhe procedura e parashikuar në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 52, të këtij ligji.

Neni 81

Kryesia e këshillit të qarkut

1. Kryesia e këshillit të qarkut përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe nga 3 deri në 5 anëtarë të tjerë.

2. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen e shkarkohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur nuk arrihet shumica e kërkuar, kalohet në rivotim ndërmjet dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave në raundin e parë.

3. Anëtarët e tjerë të kryesisë së këshillit të qarkut zgjidhen dhe shkarkohen me votim, me listë shumemërore kandidatësh, dhe shpallen fitues kandidatët që kanë marrë më shumë vota.

4. Kryesia e këshillit të qarkut thirret në mbledhje nga kryetari, jo më pak se një herë në muaj.

5. Mbledhjet e kryesisë janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

6. Funksionet e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të këshillit të qarkut janë të papajtueshme me funksionin e kryetarit të bashkisë.

Kompetencat e kryesisë së këshillit të qarkut

1. Kryesia e këshillit të qarkut ka këto kompetenca dhe detyra:

- a) ushtron të gjitha kompetencat, me përjashtim të atyre që i janë dhënë shprehimisht këshillit të qarkut;
- b) miraton projektaktet dhe materialet e tjera për mbledhjen e këshillit të qarkut, në përputhje me rendin e ditës, të përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme të kërkuara nga ajo vetë;
- c) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kërkohet nga këshilli;
- ç) raporton në këshill sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e qarkut;
- d) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar qarkut si person juridik.

2. Në ushtrimin e kompetencave të saj, kryesia e këshillit të qarkut nxjerr vendime, të cilat miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm. Vendimet marrin fuqi detyruese për t'u zbatuar nga të gjitha organet dhe personat e ngarkuar, pasi shpallen publikisht ose u bëhen të njohura subjekteve të interesuara.

3. Vendimet e kryesisë duhet të miratohen në mbledhjen më të afërt të këshillit të qarkut, në të kundërt e humbasin fuqinë e tyre që nga fillimi.

Kryetari i këshillit të qarkut

1. Kryetari i këshillit të qarkut përfaqëson këshillin e qarkut në marrëdhënie me organe shtetërore, me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, me persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, si dhe ushtron këto kompetenca:

- a) kryeson mbledhjet e këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;
- b) nënshkruan të gjitha aktet dhe procesverbalet e mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së këshillit;
- c) siguron zbatimin e vendimeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;
- ç) në përputhje me tematikën e mbledhjeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë, përgatit raportet, projektvendimet dhe materialet e tjera të nevojshme;
- d) drejton administratën e këshillit të qarkut dhe përgjigjet para këshillit për funksionimin e saj;
- dh) emëron dhe shkarkon personelin e administratës së këshillit të qarkut, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;
- e) garanton kryerjen e funksioneve që i janë dhënë me ligj këshillit të qarkut;
- ë) merr masa dhe siguron funksionim normal të të gjitha strukturave të këshillit, të mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së tij;
- f) ushtron kompetenca të tjera, që i ngarkohen me ligj, nga këshilli i qarkut ose nga kryesia e tij.

2. Në ushtrimin e kompetencave të tij, kryetari i këshillit të qarkut nxjerr urdhra me karakter individual.

3. Në mungesë të kryetarit, funksionet e tij kryhen nga zëvendëskryetari.

Sekretari i këshillit të qarkut

Sekretari i këshillit të qarkut kryen detyrat e tij njëloj me ato të sekretarit të këshillit bashkiak, të përcaktuara në nenin 57 të këtij ligji.

Neni 85

Kufizimi i autoritetit të qarkut

Vendimet e organeve të qarkut nuk mund të cenojnë autonominë e bashkive përbërëse.

KREU XIV

**RIORGANIZIMI I ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL I VETËQEVERISJES
VENDORE**

Neni 86

Riorganizimi administrativo-territorial

Ndarja administrativo-territoriale në fuqi mund të riorganizohet me ose pa ndryshim të kufijve ekzistues të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me interesat ekonomike e sociale, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë.

Neni 87

Riorganizimi me ndryshim kufijsh

Riorganizimi me ndryshim të kufijve bëhet kur:

- a) një njësi e vetëqeverisjes vendore ndahet në mënyrë të plotë në dy a më shumë njësi më vete të vetëqeverisjes vendore;
- b) dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore shkrihen për të formuar së bashku në territorin tyre një njësi të vetme të vetëqeverisjes vendore;
- c) një pjesë e territorit të një njësie të vetë-qeverisjes vendore kalon në territorin dhe administrimin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore;
- ç) kërkohet një kombinim i rasteve të sipër-përmendura.

Neni 88

Riorganizimi pa ndryshim kufijsh

Riorganizimi pa ndryshim kufijsh bëhet në rastet e ndryshimit të emërimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës të saj.

Neni 89

Mbështetja ligjore dhe propozuesi i riorganizimit

Riorganizimi i ndarjes administrativo-territoriale me ose pa ndryshim kufijsh bëhet me ligj të veçantë. Propozimi për riorganizimin e një ose më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me këto fakte dhe argumente:

- a) arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demo-grafike, administrative për nevojën dhe avantazhet e riorganizimit;
- b) mendimin e popullatës që banon në njësitë e vetëqeverisjes vendore që do të riorganizohet;
- c) hartat administrativo-territoriale, në të cilat pasqyrohen edhe ndryshimet që rrjedhin nga riorganizimi;
- ç) mënyrat e rregullimit të çështjeve financiare, të detyrimeve ndaj të tretëve ose ndaj njëra-tjetrës të njësive të qeverisjes vendore, të përfshira në riorganizim.

Neni 90

Detyrimi për të shprehur mendimin

1. Këshillat bashkiakë dhe të qarqeve, që janë të përfshirë drejtpërdrejt në riorganizim, si dhe kryetarët e tyre japin mendimin e tyre zyrtar dhe, nëse ka, edhe mendimin “kundër” të një pjese të këshilltarëve të këshillit përkatës.

2. Këshilli i Ministrave, kur ky i fundit nuk është propozues, dhe institucione të tjera shtetërore qendrore, që nuk varen nga Këshilli i Ministrave, të interesuara për riorganizimin përkatës, japin mendimin e tyre të argumentuar “pro” ose “kundër” ndaj këtij riorganizimi.

3. Organet e sipërpërmendura japin mendimin brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shprehje mendimi nga ana e propozuesit.

Neni 91

Rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve të njësive të riorganizuara

1. Në çdo rast, kur riorganizimi prek çështje të të drejtave financiare, pasurore, të detyrimeve ndaj të tretëve dhe të drejta të tjera civile të njësive të vetëqeverisjes vendore, ato rregullohen sipas legjislacionit në fuqi si të drejta dhe detyrime të personave juridikë, si rregull, nëpërmjet marrëveshjes mes palëve.

2. Në rast mosmarrëveshjes për problemet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, konfliktet zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 92

Garantimi i vazhimit të funksioneve bazë qeverisëse

1. Në rastin e riorganizimit me ndryshim kufijsh, që krijon njësi të reja të vetëqeverisjes vendore, ose kur ky riorganizim shkakton papajtueshmëri të mandatit të shumicës së anëtarëve të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, së cilës i largohet një pjesë e territorit, në këto njësi kryhen zgjedhje vendore të pjesshme, sipas mënyrave dhe afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

2. Organet e reja të vetëqeverisjes vendore, si dhe organet e tjera shtetërore qendrore e vendore kompetente marrin menjëherë masat e nevojshme që njësitë e vetëqeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi, të funksionojnë normalisht, sipas këtij ligji, duke garantuar kryerjen e shërbimeve bazë publike për popullatën përkatëse për periudhën transitore.

3. Procedurat dhe masat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër shtetëror në njësitë e vetë-qeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 93

Përditësimi i kufijve administrativo-territorialë

1. Këshilli i Ministrave, bazuar në ligjin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale, miraton me vendim hartën e përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetë-qeverisjes vendore, sipas standardeve të përcaktuara gjeohapësinore. Kjo hartë përditësohet çdo 10 vjet.

2. Këshillat bashkiakë, bazuar në ligjin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale, miratojnë me vendim hartën e përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorialë të njësive administrative dhe fshatrave në përbërje të tyre, sipas standardeve të përcaktuara gjeohapësinore.

KREU XV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 94

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 12, pika 3, dhe 93, pika 1, të këtij ligji.

Neni 95

Dispozitë kalimtare

1. Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësive administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësive administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efekt-shmërisë administrative.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në nenin 54, shkronja “i”, të këtij ligji, përbërja ekzistuese e këshillave të qarqeve qëndron në fuqi deri në formimin e këshillave të qarqeve pas zgjedhjeve vendore në vitin 2019. Në rast të krijimit të vendeve vakante, deri në plotësimin e kërkesës së shkronjës “i”, të nenit 54, të këtij ligji, ato plotësohen me kandidatë të gjinisë më pak të përfaqësuar.

3. Funksionet e reja, që u transferohen bashkive me këtë ligj, për një periudhë deri në tre vjet, do të financohen nga buxheti i shtetit me transfertat specifike, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit.

Neni 96

Shfuqizime

Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, si dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 97

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.12.2015

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 115/2014

PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË²

(Ndryshuar me ligjin nr.180/2014, datë 18.12.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja f, 83, pika 1, dhe 108, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë:
 - a) bashki - 61
 - b) qarqe - 12
2. Ndarjet administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen nga ky ligj.

Neni 2

Emërtimi, shtrirja territoriale, kufijtë, qendra, njësitë administrative përbërëse të çdo njësie të qeverisjes vendore dhe nëndarjet e tyre janë të përcaktuara në hartat dhe në tabelat bashkëlidhur këtij ligji dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 3

1. Organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.
2. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 do të organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.
3. Organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, do të organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4

1. Ligji nr. 8653, datë 31.7.2000, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

² Për t'u njohur me ndarjen administrative sipas materialit bashkëlidhur ligjit nr.115/2014, mund të konsultoni Fletoren Zyrtare nr.137, datë 1 shtator 2014.

Ligji nr.180/2014, datë 18.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare 211, datë 14 janar 2015.

2. Ligji nr. 8654, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", shfuqizohet me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të Bashkisë së Tiranës pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 31.7.2014

LIGJ
Nr. 8669, datë 26.10.2000

PËR CENSUSIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE TË BANESAVE³
(Ndryshuar me ligjin nr.10 084, datë 23.2.2009; aktin normativ nr. 6, datë 30.9.2009; ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i censusit

(shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

1. Censusi synon t'u ofrojë Kuvendit, Qeverisë, njërive të qeverisjes vendore, organizatave ekonomike, shkencore dhe kulturore, si dhe gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analizat private dhe publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes dhe të të kuptuarit nga shtetasi të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

2. Censusi ofron të dhëna për:

- a) numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë rezidente (banuese);
- b) strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore të popullsisë;
- c) numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e banesave dhe të ndërtesave, që përdoren për qëllime banimi;

³ Ligji nr. 8669, datë 26.10.2000 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 36, datë 15 nëntor 2000.

Ligji nr.10 084, datë 23.2.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 25 mars 2009.

Akti normativ nr. 6, datë 30.9.2009 miraturar me ligjin nr. 10 176, datë 29.10.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 8 tetor 2009.

Ligji nr.10 442, datë 7.7.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 1 gusht 2011.

- ç) kushtet e strehimit të popullsisë.
3. Shfuqizuar.

Neni 2 **Objekti i ligjit**

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e censusit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 **Përkufizime** *(shtuar shkronjat "c", "ç" dhe "d" me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)*

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtme do të kuptohen kështu:

a) Me "popullsi rezidente" kuptohet popullsia e përbërë nga grupi i individëve, të cilët ditën e censusit ndodhen në territorin e Republikës, si dhe ata që janë larguar për një periudhë prej më pak se një vit.

b) Me "banesë" kuptohen një ose më shumë mjedise, të caktuara për përdorim banimi, që kanë një hyrje të pavarur në rrugë, në kat, në oborr, në tarracë dhe që në çastin e censusit është ose janë të banuara ose të përcaktuara për t'u banuar nga një person ose nga një grup personash.

Termat e tjera, që do të përdoren në procesin e censuit, do të përcaktohen në librin e udhëzimeve.

c) "Census" është mbledhja e informacionit me anë të pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave të tilla, në mënyrë që të sigurojë një numërim të plotë të të gjithë individëve, familjeve e banesave dhe të ndërtesave të shfrytëzuara për qëllime banimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në një moment të vetëm në kohë, si dhe prodhimi i statistikave në lidhje me karakteristikat demografike, ekonomike dhe sociale të popullsisë së Shqipërisë.

ç) "Dita e censusit" është dita e parë e fillimit të punës në terren.

d) "Momenti i censusit" është ora 00:00 e mesnatës, që paraprin ditën e censusit.

Neni 4 **Detyrimi për t'u përgjigjur** *(ndryshuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)*

Të gjithë personat me shtetësi shqiptare apo të huaj, si dhe personat pa shtetësi, me përjashtim të personelit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët në momentin e censusit ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të japin informacionin e kërkuar në pyetësorët e censusit të popullsisë dhe të banesave, të miratuar nga Komisioni Qendror i Censusit, në përputhje me shkronjën "e" të nenit 12 të këtij ligji:

- a) në mënyrë të plotë;
b) në mënyrë të saktë dhe të besueshme.

Neni 5 **Institucioni i censusit**

Censusi organizohet dhe zbatohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT) nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Censusit dhe me mbështetjen e komisioneve të censusit, në qarqe dhe të zyrave të censusit në komuna dhe në bashki.

Përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e këtyre organeve përcaktohen në këtë ligj.

Neni 6

Data e censusit dhe periudha e mbledhjes së të dhënave

(shfuqizuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Neni 7

Shtrirja e censusit

1. Censusi mbulon të gjitha zonat, urbane dhe rurale, pra kryhet në çdo qytet dhe fshat të territorit të Republikës.

2. Ai përfshin popullsinë banuese, si dhe të gjitha objektet brenda territorit të Republikës, që përdoren për banim, pavarësisht nëse ato janë pronë e luajtshme ose e paluajtshme.

Neni 8

Kategoritë e të dhënave dhe përdorimi i tyre

(ndryshuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

1. Të dhënat e mbledhura nga censusi kategorizohen në:

a) identifikuese dhe personale të individëve;

b) identifikuese dhe strukturore të ndërtesave, banesave, banesave të jetesës kolektive.

2. Të dhënat e mbledhura nga censusi do të përdoren vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, dhe me standardet e rekomandimet ndërkombëtare.

3. Të dhënat e mbledhura nga censusi nuk do të përdoren për asnjë listë elektorale ose për përditësimin e asnjë regjistri të gjendjes civile dhe të asnjë regjistri tjetër administrativ.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti

(ndryshuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

1. Konfidencialiteti i të dhënave të grumbulluara nga censusi është i mbrojtur nga dispozitat e këtij ligji dhe nga legjislacioni në fuqi.

2. Çdo person ose autoritet publik, që, përmes përfshirjes në proceset e censusit, ka dijeni mbi të dhëna personale, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit mbi to, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

3. Konsiderohen shkelje e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni, edhe rastet kur personi, pas përfundimit të marrëdhënieve të punësimit, që, për qëllime të censusit apo të çdo marrëdhënieje tjetër me censusin, nuk ruan konfidencialitetin mbi të dhënat personale për të cilat ka dijeni.

4. INSTAT-i merr të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurisë, për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në instalimet, ku të dhënat personale të censusit mbahen, përpunohen ose ruhen dhe për t'i mbrojtur ato nga shkatërrimet e paligjshme, aksidentale, humbjet aksidentale, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

5. INSTAT-i, pasi të ketë marrë masat e duhura për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, i bën ato anonime, pas fshirjes nga dosjet elektronike të çdo elementi identifikues, të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji.

6. Të dhënat anonime mund t'i vihen në përdorim një pale të tretë të autorizuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, vetëm për veprimtari, në përputhje me nenin 1 të ligjit.

7. Të gjitha të dhënat identifikuese dhe personale, të mbledhura nga censusi, mbahen nga INSTAT-i për një periudhë që është e nevojshme për përpunimin e tyre dhe ruhen, sipas afateve kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

Neni 10

Rezultatet e censusit

(ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Rezultatet statistikore të censusit janë një pasuri e përbashkët e të gjithë shoqërisë shqiptare. Ato jepen në kushtet e mëposhtme:

a) INSTAT-i paraqet dhe boton rezultatet e përkohshme dhe ato përfundimtare të censusit mbi baza shkencore dhe profesionale.

b) Rezultatet statistikore, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij neni, publikohen në nivel kombëtar dhe në nivel vendor, duke siguruar që ato të jenë të paraqitura në një formë, që përjashton identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të individit.

KREU II

PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË DHE MARRËDHËNIET E ORGANEVE TË NGARKUARA PËR TË BËRË CENSUSIN

Neni 11

Komisioni Qendror i Censusit

(shfuqizuar fjalia e parë me aktin normativ nr.6, datë 30.9.2009, ndryshuar me ligjin nr.10 084, datë 23.2.2009 dhe shfuqizuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Neni 12

Përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Censusit

(ndryshuar shkronja "ç" dhe shtuar shkronjat "d", "dh" e "e" me ligjin nr.10 084, datë 23.2.2009; ndryshuar shkronja "e" dhe shtuar shkronja "ë" me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Komisioni Qendror i Censusit ka këto përgjegjësi:

- a) Harton dhe miraton rregulloren e Komisionit Qendror të Censusit.
- b) Mbikëqyr përgatitjen dhe zbatimin e censusit dhe udhëzon INSTAT-in për të dhënat statistikore, që priten nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile.
- c) Garanton bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve qendrore për censusin dhe mbështetjen e organizatave shkencore.
- ç) I propozon Këshillit të Ministrave përbërjen e komisioneve të censusit në qarqe dhe të zyrave të censusit në bashki dhe komuna, si dhe përcakton detyrat e tyre.
- d) I rekomandon Këshillit të Ministrave aktet ligjore dhe nënligjore për kryerjen e censusit;
- dh) Ndan detyrat për institucionet e përfshira në procesin e censusit;
- e) Cakton datën e censusit, miraton kalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censusit dhe përmbajtjen e pyetësorit të censusit, të propozuar nga INSTAT-i.
- ë) Përbërja, funksionimi, organizimi dhe detyrat, që do të kryejë Komisioni Qendror i Censusit, në përputhje me kompetencat e parashikuara në këtë nen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Instituti i Statistikave

(ndryshuar shkronja "d" me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Instituti i Statistikave (INSTAT) ka këto përgjegjësi:

- a) Harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësorin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen dhe zbatimin e censusit në baza profesionale dhe shkencore të pavarura.

b) Menaxhon burimet njerëzore dhe financiare të ofruara për censusin dhe u raporton Komisionit Qendror të Censusit dhe donatorëve ndërkombëtarë përdorimin e këtyre burimeve.

c) Njofton autoritetet dhe organet qeveritare përkatëse për hapat që duhen marrë për censusin, zhvillon fushatën e njoftimit publik dhe raporton në Komisionin Qendror për zhvillimin e veprimeve të censusit.

ç) Harton termet e referencës dhe udhëzimet e trajnimit që duhen zbatuar nga komisionet e censusit në qarqe dhe zyrat e censusit, në bashki dhe komuna për përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit të censusit. Drejton punën në terren për realizimin e qëllimeve të këtij ligji dhe merr të gjitha masat e nevojshme për kryerjen, në kohë dhe me korrektësi, të censusit, në bashkëpunim me organet e censusit në njësitë e qeverisjes vendore.

d) Përpunon të dhënat e mbledhura nga censusi dhe paraqet dhe boton rezultatet paraprake dhe përfundimtare të censusit.

Neni 14

Komisioni i censusit në qarqe

(ndryshuar shkronja "a" me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Komisionit Qendror të Censusit, cakton përbërjen e komisioneve të censusit që ngrihen në çdo qark. Ky komision ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Monitoron procesin e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe të trajnimit të kontrollorëve dhe miraton listën e kontrollorëve të paraqitur nga komisioni ad hoc i vlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji.

b) U jep asistencë teknike zyrave të censusit, në bashkitë dhe komunat, brenda territorit të qarkut dhe bën kontrolle periodike në këto zyra për zhvillimin e procesit të censusit.

c) Raporton çdo javë në INSTAT për zhvillimin e veprimeve të censusit në qark, ndërsa gjatë muajit të censusit raporton çdo ditë.

ç) Në bashkëpunim me INSTAT-in dhe me zyrat e censusit, në bashki dhe komunë, organizon punën për marrjen dhe dërgimin e pyetësorëve të censusit dhe të materialeve shoqëruese në komisionet dhe zyrat e censusit në bashki dhe komunë.

Neni 15

Zyrat e censusit në bashki dhe komuna

(ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Komisionit Qendror të Censusit, cakton përbërjen e një zyre censusi, në çdo komunë dhe bashki. Kjo zyrë ka detyrat e mëposhtme:

a) Në zbatim të udhëzimeve dhe të orientimeve të INSTAT-it merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zhvillimin normal të veprimeve të censusit brenda territorit të bashkisë dhe komunës dhe u jep të dhëna dhe asistencë personelit të censusit në qytete dhe fshatra.

b) Monitoron procesin e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe të trajnimit të anketuesve dhe miraton listën e anketuesve të paraqitur nga komisioni ad hoc i vlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji.

c) Raporton çdo javë pranë komisionit të censusit në qark për zhvillimin e procesit të censusit brenda territorit të bashkisë ose komunës, ndërsa gjatë muajit të censusit raporton çdo ditë.

ç) Merr masat e duhura për të siguruar pranimin në gjendje të mirë të materialeve të censusit në bashki ose komunë, depozitimin e sigurt të këtyre materialeve dhe dorëzimin në kohë të tyre në komisionin e censusit të qarkut.

KREU III PROCEDURAT E CENSUSIT

Neni 16

Informimi

(ndryshuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

1. Qëllimet dhe procedurat e censusit, si dhe detyrimet juridike lidhur me të bëhen publike nëpërmjet mediave dhe një fushate të gjerë informimi, të drejtuar nga INSTAT-i.

2. Fushata informuese fillon 8 javë para ditës së censusit dhe përfundon me nxjerrjen e rezultateve paraprake të censusit.

Neni 17

Zyra Qendrore e Censusit të Pasurive të Paluajtshme

(shfuqizuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Neni 18

Personeli i censusit

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Personeli i censusit përbëhet nga:

- a) anketuesit, të cilët të pajisur me një shenjë dalluese zyrtare, shkojnë në çdo vendbanim për të intervistuar banorët dhe për të plotësuar me saktësi pyetësonin;
- b) kontrollorët, të cilët mbështesin dhe kontrollojnë punën e disa anketuesve;
- c) mbikëqyrësit, të cilët mbështesin dhe kontrollojnë punën e disa kontrollorëve;
- ç) operatorët, të cilët fusin të dhënat e pyetësorëve në sistemet e kompjuterizuara;
- d) personeli drejtues, që organizon dhe drejton përgatitjen, njoftimin, logistikën dhe administrimin e censusit;
- dh) statisticienët, demografët dhe personeli tjetër, të cilët përpunojnë të dhënat, analizojnë përmbledhëset dhe nxjerrin rezultatet statistikore të censusit.

2. INSTAT-i përcakton kriteret dhe ngre një komision ad hoc vlerësimi për çdo qark, bashki dhe komunë për përzgjedhjen, rekrutimin e personelit të censusit, të cilët emërohen si më poshtë:

- a) Emërimi i anketuesve bëhet nga INSTAT-i, në bazë të listës së miratuar nga zyrat e censusit në bashki dhe komuna;
- b) Emërimi i kontrollorëve bëhet nga INSTAT-i, në bazë të listës së miratuar nga komisioni i censusit në qark;
- c) Emërimi i mbikëqyrësve, i operatorëve, i personelit drejtues, i ekspertëve shkencorë, si dhe i personelit tjetër që angazhohet në procesin e censusit bëhet nga INSTAT-i.

Neni 19

Ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme

1. Gjatë një periudhe kohore prej 6 javësh para kryerjes së censusit dhe gjatë muajit të mbledhjes së të dhënave të censusit është e ndaluar, për të gjithë individët dhe organizatat, të mbledhin të dhëna brenda territorit të Republikës.

2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, të gjitha subjektet, të cilët gjatë periudhës së përmendur më lart kanë ndërmend të grumbullojnë të dhëna për individë dhe banesa ose për veprimtari tregtare e private, duhet të kërkojnë një autorizim të veçantë pranë Komisionit Qendror të Censusit.

KREU IV KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 20

Kundërvajtjet

(ndryshuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen, përkatësisht, me gjobë shkeljet e mëposhtme:

1. Refuzimi për të bërë deklaram ose deklarimi i rremë dënohet me gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh.
2. Mosrespektimi i rregullave të konfidencialitetit, të përcaktuara në nenin 9 të ligjit, nga personi/personat përgjegjës dënohet me një gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
3. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji nga personi/personat përgjegjës dënohet me gjobë nga 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.
4. Për hetimin administrativ të kundërvajtjeve, INSTAT-i ka të drejtë të konsultojë bazat e të dhënave shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20/1

Vlerësimi i kundërvajtjeve administrative

(shtuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

1. INSTAT-i është përgjegjës për shqyrtimin e çdo dokumenti që vërteton kundërvajtjen administrative, në përputhje me nenet 4 e 20 të këtij ligji, dhe për vendosjen e ekzekutimin e gjobave zbaton procedurat e ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.
2. INSTAT-i është përgjegjës për konstatimin e kundërvajtjes administrative, në përputhje me nenin 9 të ligjit, dhe e referon rastin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 21

Ankimi ndaj sanksionit për kundërvajtjen administrative

(ndryshuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

1. Ankimi ndaj një vendimi të INSTAT-it për vendosjen e një gjobe, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 3 të nenit 20 të këtij ligji, paraqitet në Komisionin Qendror të Censurit brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.
2. Kundër vendimit që ka marrë Komisioni Qendror i Censurit, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të paraqitet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.
3. Ankimi ndaj vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vendosjen e gjobës, në përputhje me pikën 2 të nenit 20 të këtij ligji, kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 40 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me parimet e përgjithshme të parashikuara në nenet 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 të këtij ligji.

Neni 23
(shfuqizuar me ligjin nr.10 442, datë 7.7.2011)

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2780, datë 7.11.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 10 129, datë 11.5.2009

PËR GJENDJEN CIVILE⁴

(Ndryshuar me ligjet nr.6/2012, datë 2.2.2012, nr.130/2013, datë 25.4.2013, nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

(Ndryshuar pika 7 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013, shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Gjendja civile” është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre.

⁴ Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 85, datë 12 qershor 2009.
Ligji nr.6/2012, datë 2.2.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, datë 21 shkurt 2012.
Ligji nr.130/2013, datë 25.4.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.78, datë 13 maj 2013.
Ligji nr. 134/2016, datë 22.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 265, datë 12 janar 2017.

2. “Regjistri Kombëtar” i vitit 2010 (në vijim Regjistri Kombëtar) është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj dhe çdo personi pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

3. “Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile” është libri me fletë të hapur për çdo familje, ku pasqyrohen, për secilin person, të gjithë përbërësit e gjendjes civile. Ky libër ruhet në arkivin e zyrës së arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.

4. “Përbërës të gjendjes civile” janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj apo çdo personi pa shtetësi me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

5. “Përbërës të prezumuar” janë përbërësit e gjendjes civile, të cilët vlerësohen të mirëqenë deri në çastin, që vërtetohet ndryshe.

6. “Dokumente të arkivuara” është i gjithë dokumentacioni, që mbahet dhe përdoret nga zyra e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.

7. “Emra/mbiemra të papërshtatshëm” janë emrat me karakter fyes, imoral ose racist, qesharakë, të vështirë për t’u thirrur, apo që të çojnë në konfuzion, të përcaktuar si të tillë në udhëzim të ministrit, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

8. “Ministri”/“Ministria” është ministri/ministria që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Neni 3

Karakter i personal i të dhënave

(Shtuar pika 2/1, ndryshuar pika 3 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal. Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shprehëse për gjendjen civile i jepen vetëm personit, që i përket këto të dhëna, anëtarit të familjes, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose, me prokurë dhe pas vdekjes, atyre, që kanë legjitimitetin e kërkimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

2. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Këto subjekte, që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.

2/1. Çdo institucion, organ, person juridik apo fizik, privat apo shtetëror, që nuk përfshihet në pikën 2 të këtij neni, mund të kërkojë dhe të marrë të dhënat e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse merr pëlqimin me shkrim nga ana e personit, subjekt i të dhënave. Në këtë rast, të dhënat e gjendjes civile përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë dhe për të cilin ka dhënë pëlqimin me shkrim personi, subjekt i të dhënave.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej subjekteve të treta, sipas pikave 2 dhe 2/1 të këtij neni, sipas procedurës të parashikuar me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon gjendjen civile dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë udhëzim përcaktohen lloji, mënyra e dhënies dhe sasia e informacionit, që mund t’u jepet subjekteve kërkuuese, në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre apo pëlqimin me shkrim të dhënë nga personi, subjekt i të dhënave, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 4

Vlera juridike e të dhënave

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm nëse lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile, në mënyrën dhe formën e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

2. Për çdo akt dhe dokument, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuar me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon, në mënyrë të plotë, emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.

Neni 5

Papajtueshmëria e veprimeve

Nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të kryejë veprime të gjendjes civile aty ku është emëruar, kur këto i përkasin atij vetë, bashkëshortit e fëmijëve të tij, prindërve, gjyshit, gjyshes, vëllezërve, motrave, vjehrrit ose vjehrrës. Në këtë rast veprimet kryhen nga një nëpunës tjetër i shërbimit të gjendjes civile.

KREU II GJENDJA CIVILE

Neni 6

Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

(Shfuqizuar termi kombësi me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.

2. Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.

3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen.

Neni 7

Numri personal

1. Numri personal është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj, si dhe çdo personi pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm, me lidhje të caktuara ekonomike nga shërbimi gjendjes civile.

2. Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me ligj të veçantë.

Neni 8

Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile

(Shfuqizuar termi kombësi me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhën, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Neni 9

Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore

Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht, si fakte juridike, nga personat dhe organet, të cilëve u njihet ky tagër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit

Fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja.

Neni 11

Përbërës të rrjedhur nga aktet e organeve të tjera

(shtuar fjalë me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Birësimi, shtetësia, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, si përbërës kryesorë të gjendjes civile, burojnë dhe pasqyrohen vetëm në mbështetje e në përputhje me aktin e organit përgjegjës shtetëror, sipas ligjit. Prej tyre përcaktohen edhe përbërësit e tjerë kryesorë të gjendjes civile, kur ndryshohen sipas ligjit.

Neni 12

Përbërës që vërtetohen nga burime të tjera

Përbërësit e tjerë vërtetohen sipas ligjit nga organet dhe institucionet shtetërore, subjektet juridike, shtetërore e private, ose drejtpërdrejt nga ligji i veçantë dhe marrin cilësinë e përbërësit, kur pasqyrohen në dokumentet e gjendjes civile.

Neni 13

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Gjendja civile e një personi mund të jetë:

- a) “beqar/e”, shtetasi, i cili nuk ka lidhur akt martese;
- b) “i/e martuar”, shtetasi, i cili është lidhur me akt martese;
- c) “i/e ve”, shtetasi, të cilit i ka vdekur bashkëshorti/ja, me të cilin ishte i/e lidhur me akt martese;
- ç) “i/e divorcuar”, shtetasi, martesa e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë

KREU III

DEKLARIMI DHE REGJISTRIMI I VENDBANIMIT

Neni 14

Deklarimi i vendbanimit

(shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Shtetasit kanë të drejtë të kenë një apo më shumë banesa për përdorim vetjak apo familjar në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese për përdorim, sipas kësaj pike.

2. Shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin lirisht në cilën banesë të jetojnë zakonisht ose të shumtën e kohës. Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij.

Neni 15

Regjistrimi dhe ndryshimi i vendbanimit

1. Regjistrimi fillestar i vendbanimit/adresës së banesës, sipas nenit 14 të këtij ligji, si dhe ndryshimi i vendbanimit/adresës së banesës, si rregull, bëhet në zyrën e gjendjes civile bashki/komunë që ka në juridiksion territorial vendbanimin apo banesën e deklaruar.

2. Nëse një shtetas ka më shumë se një banesë për përdorim, sipas pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, ai duhet të deklarojë banesën, në të cilën ka vendbanimin e tij. Shtetasit nuk mund të deklarojnë njëherazi më shumë se një vendbanim.

3. Në rast ndryshimi të vendbanimit, apo kur një banesë nuk përdoret më për përdorim vetjak apo të familjes, ky ndryshim deklarohet në zyrën e gjendjes civile. Regjistrimi fillestar i vendbanimit apo ndryshimi i tij bëhet jo më vonë se 30 ditë nga ardhja në këtë vendbanim. I njëjti afat zbatohet edhe për deklarimin e banesave që nuk kanë statusin e vendbanimit.

4. Rregullat e veprimeve për pasqyrimin e regjistrimit dhe ndryshimit të vendbanimit të shtetasve, përcaktohen nga ministri që mbulon gjendjen civile.

Neni 16

E drejta për deklarimin e vendbanimit

1. Deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes.

2. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtareve të tjerë të familjes, bën deklarim individual të vendbanimit. Shtetasi mund të deklarojë, gjithashtu, në mënyrë individuale një banesë për përdorim vetjak.

3. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij. Kur një i mitur apo një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, banon në një vendbanim të ndryshëm nga prindërit e tij, deklarimi për të, bëhet sipas rastit, nga kryefamiljari, njëri nga prindërit, apo personi që zotëron kujdestarinë. Në këtë rast zyra e gjendjes civile administron edhe dokumentacionin që provon kujdestarinë mbi të miturin dhe vendbanimin e kujdestarit.

Neni 17

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Një person apo një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një personi apo të një familjeje tjetër kur nuk kanë lidhje familjare, kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit për frymë, si dhe kur zotërojnë një kontratë ose kur kryefamiljari i familjes pritëse apo shtetasi që zotëron titull të ligjshëm pronësie ose përdorimi të banesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat e ndryshimit të vendbanimit.

Në këtë rast, kryefamiljari i familjes pritëse dhe personi apo kryefamiljari që kërkon të banojë në vendbanimin e tij shprehin vullnetin e tyre për këtë qëllim para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse.

2. Në rast të lidhjeve familjare të vërtetuara, pranimi i personit apo i familjes në vendbanimin e ri bëhet në bazë të deklarimit të tyre para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse.

3. Strukturat komunitare të bashkisë/njësisë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet vendbanimi i ri, kryejnë verifikimet përkatëse, në lidhje me plotësimin e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë. Pas kryerjes së verifikimit, strukturat komunitare përgatisin një raport, i cili është pjesë e praktikës që administron nëpunësi i zyrës së gjendjes civile për këtë qëllim.

Neni 18

Regjistrimi i vendbanimit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë

1. Për shtetasit që:

a) kryejnë shërbimin ushtarak apo kryejnë detyra në Forcat e Armatosura dhe banojnë brenda territorit të njësisë së Forcave të Armatosura;

b) kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor;

c) qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore, me qëllim kurimin afatgjatë;

dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës.

2. Institucioni përgjegjës njofton zyrën kompetente të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucion i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, me marrjen e njoftimit nga institucioni.

3. Kur përfundon qëndrimi i shtetasve në një nga institucionet e përcaktuara në këtë nen, institucioni përkatës njofton zyrën e gjendjes civile brenda juridiksionit të tij territorial, në lidhje me këtë fakt, brenda 5 ditëve. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet në Regjistrin Kombëtar, sipas rregullave të përcaktuara nga ministri që mbulon gjendjen civile.

4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e njoftimit nga ana e institucioneve për kategoritë e shtetasve të përcaktuar në këtë nen.

Neni 19

Afati i deklarimit të ndryshimit të vendbanimit për arsye pune ose arsimimi

1. Shtetasit që për arsye të kryerjes së detyrave shtetërore apo për shkak punësimi janë të detyruar të jetojnë zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje apo për më shumë se gjashtë muaj, gjatë një viti kalendarik, në një vendbanim të ndryshëm me atë të regjistruar në zyrën e gjendjes civile, janë të detyruar të deklarojnë vendbanimin e ri brenda 30 ditëve nga ardhja në atë vendbanim, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial vendbanimin e ri.

2. Rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për arsye arsimimi, kur ata ndjekin programe shkollore apo universitare në sistemin me shkëputje nga puna dhe kur programi i plotë akademik është më i gjatë se 1 vit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull shtetasit që banojnë apo regjistrojnë vendbanimin e tyre brenda territorit të qarkut apo në rrethet fqinje me atë, në të cilin ndodhet adresa e institucionit arsimor, pavarësisht se nuk janë në të njëjtin qark.

Neni 20

Deklarimi i vendbanimit pranë punëdhënësit apo institucionit arsimor

1. Shtetasit që për arsye pune/arsimimi ndryshojnë vendbanimin, janë të detyruar të paraqesin pranë institucionit shtetëror apo punëdhënësit, në çastin e fillimit të marrëdhënies së punës, ose pranë institucionit arsimor, në çastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik, një nga dokumentet që vërteton vendbanimin, në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Në çdo rast, ky dokument duhet të paraqitet jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i detyrës, marrëdhënies së punës ose paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik të studimeve. Në rast se regjistrimi në vitin akademik bëhet automatikisht dhe pa kërkesë, institucioni verifikon kushtet e parashikuara në këtë nen dhe, kur identifikon mangësi në dokumentacionin provues të vendbanimit, njofton brenda 5 ditëve shtetasin që ka detyrimin për deklaram, si dhe zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin arsimor.

2. Institucionet shtetërore dhe arsimore, si dhe punëdhënësit e përcaktuar në këtë nen, janë të detyruar të informojnë brenda 5 ditëve zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe që nuk kanë paraqitur ende dokumentin që vërteton vendbanimin.

3. Zyra e gjendjes civile, brenda 5 ditëve, në bashkëpunim me institucionin përkatës që ka bërë informimin, njofton me shkrim shtetasit, të cilët, për arsye pune apo arsimimi, janë vendosur me vendbanim në bashkinë/komunën në juridiksion të zyrës përkatëse të gjendjes civile, për

detyrimin për regjistrim të vendbanimit dhe për sanksionet në rast mosregjistrimi. Kur edhe pas kalimit të afatit për regjistrim, shtetasi nuk ka deklaruar vendbanimin e tij, zyra e gjendjes civile njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC).

4. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e komunikimit midis institucioneve apo punëdhënësve, subjekte të këtij neni, si dhe të njoftimit të shtetasve nga zyrat e gjendjes civile, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

Neni 21

Regjistrimi i vendbanimit të shtetasve të huaj dhe i personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë në zyrën e gjendjes civile vendbanimin e tyre, brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së lejes së qëndrimit nga organi kompetent.

Zyra që mbulon shtetësinë dhe refugjatët njofton brenda 5 ditëve DPGJC-në për çdo akt të ri për këtë kategori shtetasish.

2. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim në Republikën e Shqipërisë, kur ndryshojnë vendbanim, janë të detyruar të njoftojnë zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të tyre brenda 30 ditëve nga ardhja në vendbanimin e ri.

Neni 21/1

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

(shtuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 22

Dokumentacioni për vërtetimin e vendbanimit dhe ndryshimit të tij

1. Zyra e Gjendjes Civile e regjistron deklarin e vendbanimit ose banesës për përdorim vetjak apo familjar të shtetasit kur ai paraqet dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose një kontratë apo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës.

2. Këshilli i Ministrave përcakton dokumentacionin e nevojshëm që vërteton vendbanimin apo banesën për përdorim vetjak ose familjar të shtetasit, si dhe mënyrën e administrimit të këtij dokumentacioni nga zyra e gjendjes civile.

Neni 23

Veprimet për fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcjell në zyrën e gjendjes civile, ku do të regjistrohet shtetasi, dekretin e Presidentit të Republikës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Në këtë rast, zyra e gjendjes civile, në momentin e paraqitjes së shtetasit, cakton datën dhe orën e kryerjes së betimit.

2. Në rastin e dekretit të Presidentit të Republikës për lënien e shtetësisë shqiptare, zyra e gjendjes civile, ku shtetasi rezulton i regjistruar, kryen veprimet për çregjistrimin e tij nga Regjistri Kombëtar brenda 30 ditëve, nga marrja e dekretit. Kopje e këtij dekreti i përcillet Ministrisë së Punëve të Jashtme nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3. Rregullat, procedurat për kryerjen e betimit dhe teksti i betimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Neni 24

E drejta e DPGJC-së të mbledhë të dhëna nga institucione të treta

1. DPGJC-ja ka të drejtë të ketë akses ose të kërkojë informacion, në mënyrë periodike apo rast pas rasti, nga institucione ose ente shtetërore e private të tjera që mbledhin dhe administrojnë baza të dhënash të shtetasve që përmbajnë të dhëna lidhur me adresën e personit apo të vendbanimit të tij.

2. Institucionet dhe entet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë të detyruara që t'i sigurojnë akses të menjëhershëm e të papenguar DPGJC-së në bazat përkatëse të të dhënave, ose t'i dërgojnë asaj informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës.

3. DPGJC-ja i përdor të dhënat e siguruar në zbatim të këtij neni, për atë që është e nevojshme për të verifikuar dhe siguruar saktësinë e të dhënave të Regjistrat Kombëtar. Të dhënat e siguruar nga baza alternative të dhënash nuk përbëjnë burim të drejtpërdrejtë dhe të vetëm të dhënash, në lidhje me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve. DPGJC-ja i përdor të dhënat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve.

4. Këshilli i Ministrave përcakton llojin, sasinë, organizimin e informacionit dhe rregullat për marrjen dhe përpunimin e informacionit, sipas këtij neni.

KREU IV

NATYRA DHE DOKUMENTIMI I PËRBËRËSVE TË GJENDJES CIVILE

Neni 25

Llojet dhe veçoritë e përgjithshme të dokumenteve

(Shfuqizuar shkronja "b" e pikës 3 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, të shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, vërtetohen e dokumentohen në dokumentet bazë të gjendjes civile.

Këto dokumente hartohen nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga nëpunësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë, të ardhura nga të tretët, sipas ligjit.

2. Dokumentet bazë, që mban shërbimi i gjendjes civile, janë:

- a) akti i lindjes;
- b) akti i martesës;
- c) akti i vdekjes;
- ç) regjistrat themeltarë;
- d) Regjistri Kombëtar;
- dh) procesverbali/procesverbalet për ndryshim emri, mbiemri;
- e) procesverbali/procesverbalet për bashkim dhe veçim familjar.

3. Dokumentet bazë, që lëshon zyra e gjendjes civile, janë:

- a) letërnjoftimi;
- b) shfuqizuar;
- c) certifikata e lindjes;
- ç) certifikata martesore;
- d) certifikata e familjare;
- dh) certifikata e vdekjes.

4. Forma, elementet përbërëse, mënyra e mbajtjes, afati i përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 26
Letërnjoftimi

1. Dokumenti bazë i përhershëm për identifikimin e shtetasve është letërnjoftimi.
2. Personat, të cilët, për efekt moshe, sipas ligjit, nuk përfitojnë letërnjoftim, pajisen nga zyra e gjendjes civile me certifikatën e lindjes me fotografi, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 27
Aktet për lindjet, martesat e vdekjet
(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.
2. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.
3. Aktet e martesës, të mbajtura në postet konsullore, si dhe deklaratimet e lindjes e të vdekjes, të mbajtura në shërbimin e gjendjes civile të vendeve të huaja, për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcillen, periodikisht, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila ia dërgon për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.

Neni 28
Nënshkrimi i akteve

1. Nëpunësi i gjendjes civile, i interesuari, si dhe të pranishmit, kur parashikohet nga ky ligj, nënshkruajnë me të njëjtin mjet, si dhe shënojnë emrin e mbiemrin. Nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile, në çdo rast, shoqërohet me vulën e zyrës së gjendjes civile, në të kundërt veprimi është i pavlefshëm.
2. Kur personi nuk di ose nuk është në gjendje fizike të nënshkruajë, në akt shënohen shkaqet, të vërtetuara me nënshkrim të veçantë të përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, të nëpunësit dhe të pjesëmarrësve të tjerë, të pranishëm në veprim.

Neni 29
Dokumentet e tjera bazë
(Shtuar pika 3 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Dokumente të tjera janë aktet zyrtare, shtetërore ose joshtetërore, të cilat, sipas ligjit, vërtetojnë ose ndryshojnë faktet juridike, të vërtetuara me aktet e gjendjes civile. Përmbajtja e tyre, kur pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar, shndërrohet në përbërës të gjendjes civile të shtetasit.
2. Dokumentet e tjera bazë, si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër, me karakter administrativ, plotësohen e administrohen, në përputhje me kriteret ligjore përkatëse, sipas llojit të dokumentit.
3. Përmbajtja e fletës familjare të regjistrit themeltar është e pavlefshme kur përbërësi i përket periudhës para krijimit të regjistrit dhe nuk ka dorëshkrimin e plotësuesit të parë të asaj flete ose, pavarësisht nga periudha që i përket, nuk mbështetet në një libër aktesh apo dokumentesh bazë, të pasqyruar si burim edhe në faqen përkatëse të fletës familjare.

Neni 30

Korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara
(*Shfuqizuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013*)

Neni 31

Detyrimet e organeve të tjera

Të gjitha organet, të cilat, në mbështetje të këtij ligji apo sipas një ligji të veçantë, janë përgjegjëse për caktimin, vërtetimin ose ndryshimin e një përbërësi të gjendjes civile, detyrohen të dërgojnë, zyrtarisht e drejtpërdrejt, një kopje të aktit, vendimit, në zyrën e gjendjes civile, ku personi figuron i regjistruar, brenda 15 ditëve nga data e lëshimit të aktit ose nga marrja e formës së prerë të vendimit.

Neni 32

Administrimi i dokumentacionit

(*shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016*)

1. Aktet mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përgjegjësi i gjendjes civile në degën e qarkut/përgjegjësi i gjendjes civile të Bashkisë së Tiranës rishikon saktësinë e veprimeve të kryera në aktet e lindjeve, të martesave e të vdekjeve dhe, në bashkëpunim me nëpunësin përkatës të zyrës së gjendjes civile, bën mbylljen e tyre. Pas verifikimit, aktet dorëzohen në arkivin e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, jo më vonë se data 20 janar e vitit pasardhës dhe ruhen përgjithmonë.

2. Dokumentet, mbi të cilat bazohet formulimi i akteve të gjendjes civile, vendosen në arkivin e zyrës së gjendjes civile, në njësinë e qeverisjes vendore, në muajin e parë të vitit pasardhës dhe ruhen për një periudhë 10-vjeçare.

3 Me krijimin e Regjistrat Kombëtar, regjistrat themeltarë të shtetasve në bashki/njësi administrative dorëzohen në arkivin e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, sipas procedurave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3/1. Për kryerjen e veprimeve, zyrat e gjendjes civile pranojnë vetëm akte ose dokumente origjinale.

4. Për administrimin e të gjithë dokumentacionit, shërbimi i gjendjes civile zbaton rregullat e përgjithshme për arkivat, për sa nuk parashikohet dhe nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

KREU V

REGJISTRI KOMBËTAR

Neni 33

Regjistri Kombëtar

(*Ndryshuar pika 4 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.201, ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016*)

1. Regjistri Kombëtar është dokumenti unik shtetëror ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas shqiptar, shtetas të huaj, person pa shtetësi si dhe për personat, të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese, për faktet juridike, të cilat kanë ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1/1. Në Regjistrin Kombëtar transkriptohen të dhënat për shtetasit shqiptarë sipas akteve të zyrave të gjendjes civile të vendeve të huaja. Pasqyrimi i këtyre akteve bëhet kronologjikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile janë kryer verifikimet e nevojshme për përputhshmërinë e të dhënave në dokumentacionin e administruar me ato të shërbimit të gjendjes civile.

2. Administrimi i Regjistrit Kombëtar bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Përditësimi i të dhënave të regjistrit bëhet nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative.

3. Veprimet në Regjistrin Kombëtar dhe në aktet e gjendjes civile bëhen me anë të teknikave informatike.

4. Shkëmbimi i të dhënave bëhet nëpërmjet kornizës kombëtare të ndërveprimit, sipas specifikimeve teknike të ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore, e cila koordinohet zhvillohet dhe administrohet nga Autoriteti Rregullator Koordinues i Bazave të të Dhënave Shtetërore, në përputhje me ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Neni 34

Veprimet në Regjistrin Kombëtar

Veprimet në Regjistrin Kombëtar kryhen vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe nga nëpunësi në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 35

Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar

Përbërësit e gjendjes civile pasqyrohen në faqen individuale të Regjistrit Kombëtar për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe për shtetasit e huaj, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

Neni 36

Plotësimet në Regjistrin Kombëtar

Kur në Regjistrin Kombëtar vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin, kur:

- a) përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak;
- b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;
- c) vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykatë.

Neni 37

Mungesa e së dhënës

1. Kur e dhëna, që kërkohet për aktin e lindjes dhe të vdekjes, është e pamjaftueshme ose nuk vërtetohet nga deklaruesi, verifikohet pjesa përkatëse pranë organit, që ka dijeni për faktin juridik, përveç rasteve të shënimeve të përkohshme, sipas këtij ligji.

2. Me vërtetimin e së dhënës apo caktimin përfundimtar, bëhet plotësimi vetëm në Regjistrin Kombëtar.

KREU VI

REGJISTRIMI I AKTIT TË LINDJES

Neni 38

Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga

personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.

2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.

3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

Neni 39

Dokumentet bazë të personave të gjetur

1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.

2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit publik dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.

3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të bashkisë/ njësisë administrative, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërisht imagjinarë, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjërish të prindërve.

4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paafte mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t'i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.

5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, fëmija i gjetur regjistrohet në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.

6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paafte mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi.

Neni 40

Deklarimi i lindjes

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.

2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.

Neni 41

Regjistrimi i lindjes

(shfuqizuar pika 3 dhe ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.

2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.

3. Shfuqizuar.

4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Fondi për shpërblimin për regjistrimin e lindjes brenda afatit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4, të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit. Procedurat për përfitimin e shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

6. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që çdo ditë të hënë, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.

7. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të këtij ligji, në zonën që mbulojnë.

Neni 42

Akti i lindjes

(Shfuqizuar termi kombësi në shkronjën “e” me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

1. Akti i lindjes vërtetohet ligjërisht lindjen e shtetasit.
2. Akti i lindjes është procesverbal, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe deklaruesi.

Ai përmban:

- a) numrin rendor, datën e mbajtjes dhe zyrën e gjendjes civile;
- b) datën e plotë dhe orën e lindjes;
- c) vendin e lindjes;
- ç) emrin e mbiemrin, të caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- d) numrin personal të fëmijës;
- dh) gjininë;
- e) Shfuqizuar.
- ë) shtetësinë;
- f) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez;
- g) numrin personal dhe identitetin e nënës;
- gj) numrin personal dhe identitetin e babait, kur njihet, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- h) identitetin, numrin personal dhe cilësinë e deklaruesit;
- i) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e përkthyesit.

Neni 43

Vlefshmëria dhe kundërshtimi i aktit të lindjes

1. Akti i lindjes është absolutisht i pavlefshëm, kur nuk është mbajtur nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, ose kur nuk është nënshkruar qoftë edhe nga njëri prej personave të parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të këtij ligji. Në raste të tjera, akti i lindjes është i relativisht i pavlefshëm.

2. Nuk mund të konfirmohet përmbajtje tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria absolute ose relative, pasaktësia ose falsiteti i pretenduar për aktin përkatës.

3. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrijnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile.

4. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Neni 44

Ndryshimi i të dhënës së aktit të lindjes
(Ndryshuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar, mund të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Neni 45

Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

1. Në Regjistrin Kombëtar pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme.

2. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm, mund të bëhet shënimi, në çdo kohë, kundrejt deklaratimit të nënshkrimit të përbashkët të prindërve ose me vendim gjykate. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

3. Plotësimi i të dhënave në Regjistrin Kombëtar, kur në aktin e lindjes ka rubrika të paplotësuara, bëhet, sipas rastit, me vendim gjykate.

4. Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me nënën, e cila ka vdekur më pas, ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës.

KREU VII

REGJISTRIMI I AKTIT TË MARTESËS

Neni 46

Forma e aktit të martesës

1. Akti i martesës është procesverbali i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

2. Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese apo parregullsi në dokumentet e identitetit të palëve, ndërpriten veprimet. Kur është e mundur, bëhet verifikimi i menjëhershëm dhe veprimet vazhdojnë vetëm kur rrëzohen shkaqet që sollën ndërprerjen.

Neni 47

Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar

1. Akti i martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkaku i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt.

2. Martesa lidhet kur nëpunësi i gjendjes civile vërteton, pasi ka përfunduar procedura e shpalljes së martesës, sipas Kodit të Familjes, identitetin e secilit prej bashkëshortëve.

3. Martesa e shtetasit të huaj ose e personit pa shtetësi, që banon jashtë shtetit ose është banues i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, me shtetas shqiptar lidhet sipas dokumenteve të shtetit, shtetas i të cilit është ose ku ka banimin e përhershëm, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga data që kërkohet të lidhet martesa, përveç rasteve kur ka mënyra dhe një afat tjetër, të përcaktuar në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe.

4. Për të huajt, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë ose janë refugjatë, akti i martesës bazohet në dokumentet personale, të vërtetuara brenda 15 ditëve nga organi përkatës shqiptar ose drejtpërdrejt nga të dhënat e këtij organi.

5. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, mund të lidhin martesë ndërmjet tyre në një zyrë të gjendjes civile, me dëshirën e vet. Gjithashtu, martesa mund të lidhet kur njëri ose të dy janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të nxjerrë rregullat për veprimet, që do të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për dokumentacionin dhe procedurën që do të ndiqet.

Neni 48

Përmbajtja e aktit të martesës

Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit e mëposhtëm:

- a) zyra e gjendjes civile, ku kryhet akti i martesës;
- b) numri dhe data e mbajtjes së aktit të martesës;
- c) numri dhe data e shpalljes së martesës;
- ç) numri dhe data e vendimit të gjykatës;
- d) vendi i lidhjes së martesës dhe ora;
- dh) identiteti, numri personal të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm;
- e) vendbanimi /vendqëndrimi para martesës;
- ë) vendbanimi pas martesës;
- f) mbiemri që do të mbajë pas lidhjes së martesës secili nga bashkëshortët;
- g) njohja e atësisë ose amësisë së fëmijëve të bashkëshortëve, të lindur para martesës;
- gj) regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve;
- h) numri personal emri, mbiemri dhe vendbanimi i dëshmitarëve;
- i) numri personal, emri, mbiemri i përkthyesit;
- j) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile.

Neni 49

Vërtetimi i martesës

Fakti juridik i martesës lind dhe vërtetohet me dokumentin që hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi e që pasqyron vullnetin e personave, në prani të nëpunësit të gjendjes civile dhe të dy dëshmitarëve.

Neni 50

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet për mbajtjen e aktit të martesës në Regjistrin Kombëtar dhe përditëson të dhënat, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

2. Transkriptimi i të dhënave referuese të aktit të martesës, që shtetasit shqiptarë kanë lidhur në zyrat e gjendjes civile në vende të huaja, në Regjistrin Kombëtar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shtetasi, që pretendon se i është cenuar një e drejtë nga pasaktësi në aktin e martesës, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

KREU VIII REGJISTRIMI I AKTIT TË VDEKJES

Neni 51

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Akti i vdekjes është dokumenti që vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit dhe mbahet për çdo të vdekur. Ky akt nënshkruhet nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi, pasi të jetë administruar dokumenti “skedë vdekjeje”, i lëshuar nga institucionet e autorizuar shëndetësore, që kanë të drejtë të vërtetojnë këtë fakt.

2. Akti i vdekjes përmban:

- a) zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku mbahet akti i vdekjes;
- b) numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes;
- c) vendin dhe orën e vdekjes;
- ç) shkakun e vdekjes, të përcaktuar sipas dokumentit shëndetësor;
- d) identitetin dhe numrin personal të të vdekurit ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura, që nuk mund të identifikohen;
- dh) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e mjekut ose të ekspertit mjeko-ligjor, që ka plotësuar skedën e vdekjes;
- e) të dhënat referuese të njoftimit përkatës të institucionit të prokurorisë, që autorizon kryerjen e veprimeve për raste të përcaktuara në këtë ligj;
- ë) emrin, mbiemrin e nëpunësit të zyrës së gjendjes civile.

Neni 52

Deklarimi i vdekjes

(ndryshuar pika 1, 3 dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga:

- a) çdo pjesëtar madhor i familjes;
- b) nga persona të afërt të familjes;
- c) për personat e vetmuar, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë/njesisë administrative, në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi që ka ndërruar jetë ka pasur vendbanimin/vendqëndrimin e tij të fundit, ose në zyrën e gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është gjetur kufoma apo ka ndodhur fakti juridik i vdekjes.

2. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor.

3. Afati për deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë, nga data e vdekjes ose gjetja e kufomës, për vdekjet brenda vendit, dhe 90 ditë, nga data e vdekjes, për vdekjet jashtë vendit.

3/1. Për vdekjen aksidentale, afati i deklarimit në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë nga lëshimi i lejes nga prokurori, e cila paraqitet në zyrën e gjendjes civile nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Drejtuesit e spitaleve, të reparteve ushtarake, të burgjeve, të reparteve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda 5 ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre.

5. Kur vdekja ndodh ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit të varrimit kërkon dokumentet, që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bën deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile, në ditën e parë të punës.

6. Me deklarimin e vdekjes, zyra e gjendjes civile jep edhe lejen e varrimit.

7. Në fshatra, në juridiksionin e komunave, që nuk kanë zyrë të gjendjes civile, lejen për varrimin e jep kryeplaku i fshatit. Në këtë rast, kryeplaku, pasi ka administruar dokumentet, që vërtetojnë vdekjen, është i detyruar që, brenda pesë ditëve, të njoftojë zyrën e gjendjes civile, ku janë të dhënat e shtetasit, për regjistrimin e aktit të vdekjes.

8. Zyra e gjendjes civile, kur merr njoftimin për vdekje, sipas pikës 4 të këtij neni dhe për ato raste kur nuk paraqiten të afërm të viktimës për të bërë deklarinimin, kërkon të bëhet verifikimi nga përfaqësuesit e pushtetit vendor. Në rast se konfirmohet vdekja, atëherë mban aktin e vdekjes, për të cilin duhet të firmosin, sipas rastit, përfaqësues të pushtetit vendor, kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes, ose përfaqësuesi i shërbimit të varrimit, si palë e interesuar.

9. Shërbimi i gjendjes civile, kur ka të dhëna se persona të vdekur vazhdojnë të qëndrojnë të regjistruar në regjistrin themeltar dhe në Regjistrin Kombëtar, mund të ngrëjë padi në gjykatë për të vërtetuar vdekjen, pasi të ketë shfrytëzuar të gjithë procedurën administrative.

10. DPGJC-ja është detyruar që për çdo muaj të gjenerojë nga Regjistri Kombëtar listën e shtetasve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe për çdo datë 5 të muajit pasardhës shpërndan listën, sipas zyrës së gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile, në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor, bën verifikimin rast pas rasti, sipas procedurës së miratuar nga ministri që mbulon gjendjen civile.

Neni 53

Vërtetimi i faktit juridik të vdekjes

1. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij.

Shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar bëjnë vërtetimin faktik, në rrugë gjyqësore, sipas Kodit Civil.

2. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit.

3. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale.

4. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar e/ regjistrin themeltar (arkivi), pa u mbajtur akti i vdekjes.

5. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e përfaqësive diplomatike, në avion apo në anije shqiptare, në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

Neni 54

Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjekë, qendër shëndetësore, spital, urgjencë etj.). Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe është nënshkruar edhe nga prokurori.

Neni 55

Pavlefshmëria e aktit të vdekjes

1. Akti i vdekjes është absolutisht i pavlefshëm kur personi, në fakt, nuk ka vdekur, gjë që vërtetohet me paraqitjen e tij fizike ose ekzistencën pas datës së aktit të vdekjes, në çdo rast me mungesë kufome apo kufomë të një personi tjetër.

2. Akti i vdekjes është i pavlefshëm kur ka vdekur një person tjetër nga ai që përmban akti dhe, në këtë rast, është i detyrueshëm të mbahet akt i veçantë për të vdekurin në fakt.

3. Akti i vdekjes shpallet relativisht i pavlefshëm kur nuk i përgjigjet realitetit, për sa i përket kohës, shkakut e vendit të vdekjes.

4. Pavlefshmëria, sipas pikës 1 të këtij neni, konstatohet nga gjykata, pas kërkesës së paraqitur, në çdo kohë, nga personi, për të cilin është mbajtur akti i vdekjes. Kur personi është i mitur, i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar ose nuk është në gjendje mendore apo fizike, këtë të drejtë e kanë përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët e tij dhe, kur nuk ka të tillë apo kur kjo e drejtë nuk ushtrohet prej tyre, të drejtën e ka edhe prokurori.

5. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, përveç personit, që rezulton i gjallë, pavlefshmëria kërkohet edhe nga personat, të cilët kanë pasoja juridike nga mungesa e aktit të vdekurit në fakt. Kur këta janë të mitur, u është hequr zotësia për të vepruar ose nuk janë në gjendje mendore apo fizike dhe nuk paraqitet kërkesë nga përfaqësuesi ligjor apo kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat rëndojnë mbi shtetin, kërkesa paraqitet nga prokurori.

6. Prokurori paraqet kërkesë edhe kur personi, që rezulton i gjallë, ndonëse i ka mundësitë, nuk bën kërkesë ose shmanget qëllimisht.

7. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, kur nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të vdekur realisht, çështja shqyrtohet më vete, duke bërë identifikimin ose jo, por, në çdo rast, duke mbajtur një akt tjetër vdekjeje.

8. Pavlefshmëria, sipas pikës 3 të këtij neni, kërkohet nga të interesuarit, që kanë zotësi juridike ose nga prokurori, kur pasojat rëndojnë mbi të miturit, personat madhorë, që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur:

- a) kjo nuk ushtrohet nga përfaqësuesit ligjorë ose kujdestari;
- b) nuk ka të tillë;
- c) pasojat lidhen me shtetin.

9. Me shpalljen e pavlefshmërisë së aktit të vdekjes me vendim gjyqësor, shënimet në fletën familjare të regjistrit themeltar ose në Regjistrin Kombëtar anulohen ose ndryshohen dhe ky veprim pasqyrohet në rubrikën e vërejtjeve dhe në vetë aktin e vdekjes.

KREU IX EMRI, MBIEMRI DHE NDRYSHIMI I TYRE

Neni 56

Emri e mbiemri

(Shfuqizuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013 (ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës ka ndodhur lindja, pasi administron deklaratën e shkruar të personave të përcaktuar në nenin 40, të këtij ligji, lidhur me:

a) emrin që do t'i vendosin fëmijës së lindur, përveç emrave të klasifikuar të papërshtatshëm, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) mbiemrin që do të mbajë fëmija, në përputhje me Kodin e Familjes, i pasqyron këta përbërës të gjendjes civile në aktin e lindjes.

2. Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore.

3. Kur prindërit nuk bien dakord, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër, me shënimin në kllapa “i përkohshëm”, deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata.

4. Shfuqizuar.

5. Shfuqizuar.

6. Mbiemri i fëmijës përcaktohet në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Familjes.

7. Kur prindërit kanë vdekur apo nuk janë në gjendje fizike a mendore ose nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë dhe, në mungesë të tyre, nga nëpunësi i gjendjes civile.

Neni 57

Rastet e ndryshimit të mbiemrit dhe të emrit

(Ndryshuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Mbiemri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:
 - a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes;
 - b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji.
2. Emri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:
 - a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes, në rastin e birësimit;
 - b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji, brenda 1 viti nga mbushja e moshës madhore, dhe vetëm një herë, si dhe sipas nenit 45 të këtij ligji.

Neni 57/1

Procedura për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit me kërkesë të personit të interesuar

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Me përjashtim të rastit të korrigjimit të emrit/mbiemrit, çdo shtetas mund të kërkojë ndryshimin e emrit ose të mbiemrit pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të përmbajë arsyen/shkakun e ndryshimit të emrit/mbiemrit dhe emrin/mbiemrin e ri që kërkohet të merret. Kërkesa paraqitet personalisht nga kërkuesi në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

2. Kërkesa për ndryshimin e emrit të përkohshëm, të vendosur nga prindërit, mund të bëhet nga vetë personi brenda një viti nga data e mbushjes së moshës madhore. Në këtë rast kërkesa përmban datën dhe nënshkrimin e kërkuesit, i cili duhet të përcaktojë qartë emrin e përhershëm që kërkon të marrë.

3. Kërkesa për ndryshimin e emrit ose mbiemrit duhet të bëhet vetëm një herë dhe vetëm për shkaqe papërshtatshmërie. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin e aplikimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të përkohshëm, sipas pikës 2 të këtij neni.

Në asnjë rast nuk mund të kërkohet marrja e mbiemrave që u përkasin personave me rëndësi historike, apo të tillë që mund të çojnë në lajthim, lidhur me përkatësinë e familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, të përcaktuara si të tilla sipas procedurës së përmendur në pikën 4 të këtij neni.

4. Ministri përgjegjës për gjendjen civile parashikon me udhëzim rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave që konsiderohen të papërshtatshëm, si dhe listën me emra dhe mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, së bashku me një listë, pasi merr paraprakisht mendimin e institucioneve të specializuara. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga zyrat e gjendjes civile, si dhe çdo organ tjetër shtetëror.

Neni 57/2

Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

- Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:
- a) vërtetimin e gjendjes gjyqësore/formularin e plotësuar të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
 - b) vërtetimin nga prokuroria se nuk është në ndjekje penale;
 - c) vërtetimin nga gjykata se nuk është në proces gjyqësor;

ç) kopjen e letërnjoftimit;
d) certifikatën e lindjes dhe certifikatën e përbërjes familjare;
dh) vërtetimin se nuk është marrë ndaj tij ndonjë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër;

e) vendimin gjyqësor, i njohur sipas legjislacionit shqiptar, në rast të ndryshimit të emrit apo mbiemrit në një vend tjetër, jashtë rasteve të parashikuara nga Kodi i Familjes.

Neni 57/3

Rastet kur ndalohet ndryshimi i emrit dhe mbiemrit

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Emri dhe mbiemri nuk ndryshohen në rastet kur:

- a) shtetasi është në proces gjyqësor ose nuk ka mbaruar ndjekja penale;
- b) vërtetohet se ndaj shtetasit është marrë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër.

Neni 57/4

Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Kërkesa për ndryshimin e emrit/mbiemrit i paraqitet përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Tarifat për paraqitjen e kërkesës përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapaguhet nga kërkuesi me depozitimin e kërkesës.

2. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile formon fashikullin e kërkesës me dokumentet përkatëse dhe, pasi ka verifikuar nëse ka shënime të mëparshme në regjistrin e gjendjes civile, brenda 60 ditëve, e përcjell fashikullin pranë prefektit të qarkut, nën juridiksionin e të cilit ndodhet zyra e gjendjes civile, së bashku me mendimin e tij lidhur me plotësimin e dokumentacionit dhe verifikimin paraprak të arsyeve të kërkesës së paraqitur.

3. Prefekti, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kërkesës, kryen këto verifikime:

- a) pasjen ose mospasjen e juridiksionit;
- b) hetimin për praninë e shkaqeve që legjitimojnë kërkesën dhe legjitimimin e kërkuetit, sipas nenit 57 të këtij ligji;
- c) respektimin e procedurave dhe të afateve kohore, brenda të cilave duhej të ishte paraqitur kërkesa;
- ç) vlerësimin e arsyeve të kërkesës;
- d) marrjen e dokumenteve zyrtare, provave të nevojshme apo informacionit të nevojshëm për trajtimin e kërkesës.

Prefekti, kur çmon se janë përmbushur kushtet dhe procedurat, sipas këtij ligji, urdhëron afishimin e shpalljes të kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa, pranë vendbanimit të kërkuetit, si dhe në dy prej gazetave për një periudhë prej 15 ditësh, si dhe/ose në Fletoren Zyrtare. Shpallja duhet t'u njoftohet personave të interesuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të kërkuetit apo të atyre personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuetit. Forma dhe përmbajtja e shpalljes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile. Tarifat për afishimin e shpalljes përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapaguhet nga kërkueti përpara se të bëhet afishimi i shpalljes.

4. Prefekti, kur çmon se kërkesa nuk plotëson dokumentacionin shoqërues apo elementet formale të saj, cakton një afat jo më të shkurtër se 30 ditë për plotësimin e kërkesës, duke njoftuar kërkuetin dhe zyrën e gjendjes civile, ku ai ka vendbanimin. Nëse brenda këtij afati kërkueti nuk plotëson të metat e kërkesës, prefekti vendos për deklarimin e braktisjes së procedurës dhe arkivimin e kërkesës. Në këtë rast kërkesa nuk evidentohet në shënimet e gjendjes civile.

Neni 57/5

Kundërshtimi i të tretëve

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

2. Kundërshtimi bëhet me kërkesë me shkrim dhe duhet të depozitohet pranë prefektit ose në zyrën e gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Në këtë rast, kërkesa i përcillet pa vonesë prefektit të qarkut ku bën pjesë zyra e gjendjes civile.

Neni 57/6

Vendimi për kërkesën

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Me kalimin e afatit të parashikuar për kundërshtimin e të tretëve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së parashikuar, si dhe vlerësimit të kundërshtimeve që mund të jenë paraqitur, prefekti nxjerr mendim të arsyetuar për themelin e kërkesës për ndryshimin, sipas rastit, të emrit apo mbiemrit, duke i propozuar Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesës për ndryshimin e emrave apo të mbiemrave pranimin apo refuzimin e ndryshimit.

Mendimi i prefektit për kërkesën për ndryshimin e emrit apo mbiemrit, së bashku me fashikullin e kërkesës, i përcillet për shqyrtim dhe miratim Komisionit Kombëtar pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, i cili vendos për kërkesën, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ky ligj dhe në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Nëse prefekti vlerëson se ndryshimi i kërkuar ka të bëjë me mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara apo të mirënjohura në juridiksionin e tij, që nuk janë në listën e miratuar me udhëzim, përpara përcjelljes së kërkesës pranë Komisionit Kombëtar, ai ka të drejtë t'i kërkojë mendim këshillit komunal ose atij bashkiak apo institucioneve të tjera publike të specializuara të fushës për marrjen e emrave apo mbiemrave që kërkohen të merren nga kërkuesi. Mendimi i këshillit komunal/bashkiak, apo i institucionit të specializuar, përfshihet në fashikullin që shoqëron kërkesën. Nëse këshilli komunal/bashkiak apo institucioni i specializuar nuk shpreh brenda afatit 90 ditor, ky fakt konsiderohet si mos kundërshtim i heshtur i kërkesës dhe evidentohet në procesverbal nga ana e prefektit.

3. Me qëllim vlerësimit përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave/mbiemrave, pranë ministrisë që mbulon punët e brendshme, krijohet Komisioni Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave. Përbërja dhe rregullat për funksionimin e Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, si dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit miratohen me urdhër të ministrit që mbulon punët e brendshme.

4. Pas përcjelljes së kërkesës dhe fashikullit shoqërues në Komisionin Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, ky i fundit, në përfundim të procedurës administrative për marrjen e të dhënave të nevojshme, shprehet me vendim përfundimtar për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit.

5. Vendimi i komisionit, i arsyetuar, i njoftohet kërkuesit dhe personave të interesuar, prefektit, si dhe zyrës së gjendjes civile përkatëse për veprim, sipas rastit, si dhe për mbajtjen e shënimeve përkatëse në regjistër.

Neni 57/7

Kërkesa për korrigjimin e emrit dhe mbiemrit

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Çdo person, që ka interes për të korrigjuar emrin/mbiemrin e vet, për shkak të një gabimi të provuar material, të bërë gjatë transkriptimit të akteve të gjendjes civile, mund të paraqesë kërkesë pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin.

Neni 57/8

Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës për korrigjim material

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) kopje të aktit të lindjes;
- b) çdo dokument tjetër që provon gabimin.

Neni 57/9

Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Në rastin e gabimeve materiale të provuara në një akt të gjendjes civile, personi i interesuar apo pjesëtarët e familjarët që preken nga ai akt, mund të kërkojnë ndreqjen e gabimit të ndodhur, kur provojnë gabimin material gjatë kryerjes së veprimeve në Regjistrin Kombëtar. Nëpunësi i gjendjes civile, pas pranimi të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, ia përcjell atë për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, së bashku me një mendim mbi themelin e saj. Vendimi i drejtorit i komunikohet prefektit të qarkut përkatës dhe ky i fundit ka të drejtë t'ia njoftojë atë Komisionit Kombëtar.

2. Rregullat për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për korrigjim miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 57/10

Efektet e ndryshimit të emrit dhe mbiemrit të ri

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Pas miratimit të kërkesës së shtetasit, ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar. Në procesverbalin, që mbahet në këtë rast, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri i ndryshuar.

Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga nëpunësi i gjendjes civile dhe përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Emri e mbiemri i ndryshuar, si dhe numri e data e procesverbalit pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

Rregullat dhe procedurat për pasqyrimin e ndryshimit të emrit/mbiemrit në Regjistrin Kombëtar përcaktohen nga ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

KREU X
GJENDJA CIVILE E SHTETASVE TË HUAJ DHE
E PERSONAVE PA SHTETËSI”
(Ndryshuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Neni 58

Kombësia

(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

Neni 59

Gjendja civile e shtetasve të huaj dhe e personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe shtetasit e huaj, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të gjitha të drejtat, sipas këtij ligji, me përjashtim të të drejtave, që lidhen ngushtë me shtetësinë shqiptare dhe të veçorive në mënyrën e dokumentimit.

2. Gjendja civile e shtetasit të huaj me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në dokumentet e shtetit përkatës, ndërsa ajo e personit pa shtetësi, në dokumentet e shtetit ku ka lindur ose prej nga ka ardhur. Gjendja civile e shtetasit të huaj, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë vërtetohet nga të dhënat, që ka organi përkatës administrativ për refugjatët.

3. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm, vizitorë ose që janë tranzit në Shqipëri, kanë të drejtë që, nëpërmjet shërbimit të gjendjes civile, të evidentojnë dhe të vërtetojnë faktet juridike të tyre, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, sikurse çdo shtetas shqiptar, përveçse kur ka pengesë ose një procedurë të veçantë, të përcaktuar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare.

KREU XI
SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 60

Natyra dhe funksioni

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrin Kombëtar, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shërbimi i gjendjes civile, krahas detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i jep informacion subjekteve të përcaktuar nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, mbi bazën e dokumentacionit që administron, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, kundrejt tarifës që përcaktohet, sipas parashikimit të nenit 73 të këtij ligji.

Neni 61

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile organizohet, si më poshtë vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) zyrat e arkivit së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut;
- c) zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative;
- ç) shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare.

Shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike e konsullore shqiptare funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Veprimet e nëpunësve të autorizuar e të trajnuar në Regjistrin Kombëtar, në postet konsullore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Shërbimi i gjendjes civile mund të ofrohet, në mënyrë të kufizuar, edhe nga institucione të tjera shtetërore, të përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

3. Shërbimi i gjendjes civile mund të ofrohet edhe në forma ose mënyra të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ofrimin e shërbimeve publike në sportel.

4. Rregullat, llojet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara në pikat 2 e 3, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 62

Struktura dhe organika

Struktura, organika dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63

Buxheti

1. Të ardhurat që sigurohen nga shërbimi i gjendjes civile duhet të përdoren në përputhje me aktet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë përdorimin dhe administrimin e të ardhurave që krijohen nga institucionet buxhetore.

2. Buxheti i shërbimit të gjendjes civile është program më vete, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Brendshme.

3. Bashkitë, njësitë administrative, në përputhje me objektivin e tyre, mund të parashikojnë dhe kryejnë shpenzime, operative ose kapitale, shtesë, për përmirësimin e shërbimit të zyrës së gjendjes civile.

Neni 64

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile dhe nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 65

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen këto detyra:

- a) I propozon ministrit projektaktet në zbatim të ligjit.
- b) Harton dhe i propozon për miratim ministrit treguesit e cilësisë së shërbimit, metodikat dhe rregulloret për funksionimin e zyrave të shërbimit të gjendjes civile.
- c) Administron Regjistrin Kombëtar dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave.
- ç) Harton programe dhe merr masa për zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit të gjendjes civile.
- d) Bën drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut, bashki, njësi administrative, si dhe në përfaqësitë diplomatike e konsullore.

dh) Bashkëpunon me institucione dhe donatorë të interesuar për problemet e shërbimit të gjendjes civile dhe i paraqet ministrit për miratim projekt marrëveshje, në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim.

e) Merr masa, harton dhe zbaton programe për kualifikimin dhe rekrutimin e nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile.

ë) Propozon modelet e dokumenteve që mbahen dhe lëshohen nga zyrat e shërbimit të gjendjes civile, si dhe programet kompjuterike që përdor ky shërbim.

f) Vendos kriteret profesionale që duhen plotësuar nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për pranimin e tyre në këtë shërbim.

g) Kur vëren shkelje, i propozon kryetarit të bashkisë/njesisë administrative dhe prefektit të qarkut masa administrative për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Masat e propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile janë të detyrueshme për zbatim nga kryetarët dhe prefekti i qarkut.

gj) Zgjidh konfliktet për veprimet apo mosveprimet e zyrave të gjendjes civile, në ushtrim të funksioneve të tyre.

Neni 66

Emërimi dhe lirimi i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Emërimi dhe lirimi nga detyra i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, bëhet nga prefekti i qarkut, me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, sipas kriterëve të përcaktuara me urdhër të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Neni 67

Detyrat e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut

(ndryshuar pika "b" me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut kanë këto detyra:

- a) zbatojnë metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) administrojnë arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile, nivel qendër qarku;
- c) lëshojnë certifikata të shërbimit të gjendjes civile, për dokumentet që administron vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrës së gjendjes civile në bashki /komunë;
- ç) u japin të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d) pranojnë dhe shpërndajnë në zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna njoftimet, që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
- dh) kontrollojnë veprimtarinë e zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna dhe u propozojnë organeve përkatëse marrjen e masave të nevojshme;
- e) raportojnë para prefektit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e degës së qarkut dhe të zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna.

Neni 68

Zyrat e gjendjes civile në bashki, njësi administrative

1. Shërbimi i gjendjes civile ushtron funksionet në bashki/njësi administrative.
2. Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë/njesisë administrative, sipas kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
3. Lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë/ njësi administrative, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Neni 69

Detyrat e zyrave të gjendjes civile në bashki, njësi administrative

Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative kanë këto detyra:

- a) përditësojnë Regjistrin Kombëtar;
- b) mbajnë aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve;
- c) lëshojnë dokumentin e identitetit, certifikatat e lindjes, ato familjare, të martesës dhe të vdekjes, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- ç) kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi;
- d) plotësojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të institucioneve të tjera shtetërore dhe të subjekteve të interesuara;
- dh) vënë në dijeni këshillin dhe kryetarin e bashkisë/njësisë administrative, si dhe zyrën e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, për veprimtarinë e zyrës së gjendjes civile, sipas kërkesës ose periodikisht, në përputhje me udhëzimet përkatëse;
- e) plotësojnë të gjitha detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 69/1

(shtuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Dokumenti “certifikatë”, që sipas dispozitave të këtij ligji lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, nga zyra e gjendjes civile në njësi administrative, mund të lëshohet edhe nga zyra e gjendjes civile në bashki, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësia.

2. Në rastin e ofrimit të shërbimit, sipas parashikimit të bërë në pikat 2 dhe 3, të nenit 61, të këtij ligji, dokumenti “certifikatë” lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, me nënshkrimin dhe/ose vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 70

Detyrat e zyrës së gjendjes civile në Bashkinë e Tiranës

Zyra e gjendjes civile në Bashkinë e Tiranës ka këto detyra:

- a) zbaton metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) administron arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile të njësive administrative të Tiranës;
- c) lëshon certifikata të shërbimit të gjendjes civile për dokumentet që administron vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrave të gjendjes civile në bashki /komunë;
- ç) u jep të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d) pranon dhe shpërndan, në zyrat e gjendjes civile të njësive bashkiake të Tiranës, njoftimet që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
- dh) kontrollon veprimtarinë, që kryejnë zyrat e gjendjes civile në njësitë bashkiake dhe u propozon organeve përgjegjëse marrjen e masave të nevojshme;
- e) raporton para kryetarit të bashkisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e zyrës në bashki dhe të zyrave të gjendjes civile në njësitë bashkiake.

Neni 71

Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Veprimet, të cilat kryhen nga nëpunësit e shërbimit konsullor, që mbulojnë çështjet e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare, duhet të

përmbushin kriteret e përcaktuara nga ligji në fuqi. Këta nëpunës, përpara fillimit të punës, duhet të trajnohen si nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Ata administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar për shtetasit shqiptarë, që janë me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.

Neni 72

Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile

Të drejtat dhe përgjegjësitë për kryerjen e veprimeve në regjistrat e gjendjes civile, sipas këtij ligji, i kanë vetëm nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, ndërsa për përfaqësitë diplomatike e konsullore, vetëm nëpunësit e trajnuar për këtë qëllim.

Neni 73

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Informacionet që jepen nga shërbimi i gjendjes civile për subjektet private, të përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kryhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Financave.

2. Të ardhurat e siguruara nga tarifat, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

Neni 74

Kundërvajtjet administrative

(Ndryshuar shkronjat "a", "b", "c", me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013, ndryshuar shkronja "a" dhe shtuar shkronja "ç" me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 19 pikat 1 dhe 2, në nenin 20 pika 1, në nenin 21 pikat 1 dhe 2, si dhe në nenin 52 pikat 3, 5 dhe 7 dënohet me gjobë në masën 3 000 lekë.

b) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 18 pikat 2 dhe 3, në nenin 20 pika 2, në nenin 41 pika 6 në nenin 52 pika 4 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë.

c) shkelja ose moszbatimi i dispozitës së parashikuar në nenin 65 shkronja "g", në nenin 66 pikat 2 dhe 3 dhe në nenin 68 pika 2 dhe 3 dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë;

ç) shkelja ose mosrespektimi i dispozitës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 15, dënohet me gjobë, në masën 10 000 lekë, dhe me pezullim të shërbimit deri në vjeljen e gjobës, të cilën e vendos dhe e vjel nëpunësi i gjendjes civile.

2. Gjocat e parashikuara në shkronjat "b" dhe "c" të këtij neni vendosen nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, sipas njoftimit të ardhur nga zyrat e gjendjes civile. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në institucionin e ministrit që mbulon gjendjen civile, i cili brenda 10 ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër vendimit të ministrit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

3. Masat administrative të gjobës, të cilat nuk ankimohen brenda afatit, si dhe ato të cilat lihen në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat përmbartimore për ekzekutimin e tyre.

KREU XII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 76
Nxjerrja e akteve nënligjore
(Ndryshuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për gjendjen civile që të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 15 pika 4, 18 pikat 3 dhe 4, 20 pika 4, 22 pika 2, 24 pika 4, 25, 52 pika 10, 62 dhe 63 të këtij ligji.

Dispozita kalimtare
(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Procedura për ndryshimin e emrit/mbiemrit, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojë të rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në datën e paraqitjes së kërkesës.

Neni 24
Dispozitë kalimtare
(parashikuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Gjoha e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në nenin 22, të këtij ligji, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 77
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6180, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

LIGJ⁵
Nr.9270, datë 29.7.2004

PËR SISTEMIN E ADRESAVE

(Ndryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008, nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 112 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(Ndryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008, nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e krijimit e të administrimit të sistemit kombëtar të adresave, si dhe kriteret për vendosjen e adresës së saktë e unike për çdo ndërtesë, apartament dhe truall të lirë brenda së njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 1/1

(Shtuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008, ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3 me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Adresa” përbëhet nga fjalë, numra dhe shenja ortografike, të renditura sipas një rregulli të caktuar, të cilat tregojnë vendndodhjen e saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti ose të një trualli të lirë. Ajo formohet nga shkronja të alfabetit shqip dhe numra arabë.

2. “Bulevardi”, “rruga”, “rrugica”, “sheshi” dhe “parku” janë pjesë të territorit publik, që shërbejnë si referencë për përshkrimin e vendndodhjes së saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti dhe të një trualli të lirë brenda së njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. “Regjistri vendor i adresave” është dokumenti shtetëror ku hidhen, ruhen dhe pasqyrohen, në mënyrë të vazhdueshme, elementet përbërëse të adresës së ndërtesave, apartamenteve dhe të truallit të lirë për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. “Regjistri Kombëtar i Adresave” është dokumenti unik shtetëror, që krijohet nga tërësia e të dhënave të regjistrave vendorë të adresave.

⁵ Ligji nr.9270, datë 29.7.2004 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.56/2004.

Ligji nr.9951, datë 10.7.2008, është botuar në Fletoren Zyrtare nr.122/2008.

Ligji nr. 89/2016, datë 15.9.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.185/2016.

Neni 2

(Ndryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008 me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

1. Adresa shërben për të identifikuar në mënyrë të saktë e unike vendndodhjen e çdo ndërtese, apartamenti apo trualli të lirë, në shkallë vendi, dhe përbëhet nga këto elemente:

- a) emri i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në të cilën ndodhet ndërtesa;
- b) emri i njësisë administrative, në të cilën ndodhet ndërtesa;
- c) emri i qytetit ose fshatit ku ndodhet ndërtesa;
- ç) emri i bulevardit/rrugës/rrugicës/sheshit ose parkut ku ka daljen ndërtesa dhe përcaktohet vetëm me njërin nga elementet e mësipërme. Emri formohet nga shkronja të alfabetit shqip dhe numra arabë, por jo vetëm me numra;
- d) numri rendor i ndërtesës, bulevardit / rrugës/rrugicës/parkut ose sheshit. Ky numër rendor mund të jetë:
 - i) një numër natyror;
 - ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);
- dh) numri i hyrjes, që shërben për identifikimin e hyrjes në të njëjtën ndërtesë. Ky numër rendor mund të jetë:
 - i) një numër natyror;
 - ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);
- e) numri i apartamentit, që shërben për identifikimin e një banese/biznesi në një hyrje të ndërtesës. Ky numër rendor mund të jetë:
 - i) një numër natyror;
 - ii) dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit (/);
- ë) kodi postar, i miratuar.

2. Radha e vendosjes së elementeve të adresës përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008 dhe ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Emërtimi i bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen, ndërsa numërtimi i ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve bëhet nga seksionet/zyrat e urbanistikës në bashkitë/njësitë administrative, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen.

Neni 4

Sistemi i adresave zbatohet për çdo lloj ndërtese, pavarësisht nga destinacioni i saj, për banim ose jo (hotel, zyrë, qendër tregtare ose komunikacioni, ndërtesë industriale, arsim, muzeum, spital etj.), si dhe pavarësisht nga vendndodhja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4/1

(Shtuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008)

1. Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon, përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Adresave.

3. Mënyra e krijimit, administrimit të regjistrave vendorë dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave, si dhe rregullat e shfrytëzimit të sistemit e të rrjetit informatik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU II KRITERET PËR EMËRTIMIN E ADRESËS

Neni 5

1. Çdo bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park ka vetëm një emër të caktuar.
2. Nuk lejohet që në të njëjtin qytet ose fshat të ketë më shumë se një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park me të njëjtin emër. Bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet ose parqet mbajnë emrin e caktuar në të gjithë gjatësinë e tyre.

Neni 6

1. Në rrugën me një dalje vendoset emër i veçantë, kur në të ka mbi 10 banesa ose kur në planin rregullues parashikohet dalje në një rrugë tjetër. Kërkesa, sipas kësaj pike, zbatohet edhe në fshatra.
2. Për rrugicat me një dalje ose me më pak se 10 banesa përdoret emri i rrugës ku ato kanë dalje.

Neni 7

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Standardet dhe rregullat për emërtimin e bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve e parqeve, nga autoritetet përgjegjëse, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III RREGULLAT PËR NUMËRTIMIN E ADRESËS

Neni 8

Ndërtesat e çdo bulevardi, rruge, rrugice, sheshi ose parku, që kanë një emër të caktuar, duhet të kenë një numër rendor të veçantë.

Neni 9

1. Për të bërë numërtimin e ndërtesave të një bulevardi, rruge, rrugice, sheshi ose parku më parë caktohen vendndodhja dhe kufijtë e tyre.
2. Për bulevardet ose rrugët kryesore, që takohen në qendrën e qytetit, si pikë e nisjes merret pikërisht qendra e qytetit.

Neni 10

Numërtimi i ndërtesave bëhet si më poshtë:

- a) për rrugët kryesore, që nuk përfshihen në nenin e mësipërm, dhe për të gjitha rrugët dytësore, merret si pikë nisjeje, ekstremi lindor ose jugor i rrugës, në mënyrë që numrat të vazhdojnë nga Lindja në Perëndim, nga Jugu në Veri, nga Verilindja në Jugperëndim dhe nga Juglindja në Veriperëndim, por jo edhe në drejtim të kundërt;
- b) në qytetet ose fshatrat, që përshkohen nga një lumë ose që ndodhen në buzë të detit a liqenit, mund të merret si pikë nisjeje lumi, deti ose liqeni;
- c) duke u nisur nga pika e nisjes së bulevardit, rrugës, rrugicës, sheshit ose parkut, ndërtesave, në krahun e majtë të drejtimit të tyre, u vihen numra tek 1, 3, 5, 7, 9 etj., ndërsa atyre në krahun e djathtë numra çift 2, 4, 6, 8 e kështu me radhë;

ç) ndërtesave, që ndodhen në rrugica me një dalje dhe që vlerësohen si vazhdim i një rruge, u vihen numra rendorë që i përkasin krahut të majtë ose të djathtë të kësaj rruge, nga e cila fillon rrugica e verbër. Kur rrugica pa dalje ka një emër më vete, ndërtesat që ndodhen në të dyja anët e kësaj rrugice marrin numër rendor të veçantë.

Neni 11

Adresim numerik i jashtëm i një ndërtese është numri, që merr ajo kur ka vetëm një dalje në rrugë, pavarësisht se mund të jetë banesë e vetme ose kolektive.

Neni 12

Ndërtesat shumëkatëshe, me apartamente, zyra, hapësira dyqanesh duhet të kenë edhe adresim të brendshëm, pavarësisht nga numri i vendosur në hyrjen e përbashkët.

Neni 13

Çdo ndërtese, që ka një portë të vetme si dalje në rrugë ose në oborrin rrethues, i vihet një numër rendor i vetëm.

Neni 14

(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008 dhe nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

1. Në qoftë se një ndërtesë ka dy ose më shumë hyrje që dalin në një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, të cilat përdoren për hyrje dhe dalje, secilës hyrje i vihet një numër natyror ose dy numra natyrorë, të ndarë me shenjën e fraksionit.

2. Hyrje e parë, quhet hyrja që ndodhet në krah të majtë nëse qëndrojmë me fytyrë nga ndërtesa në drejtim të hyrjes në ndërtesë.

Neni 15

Kur një ose më shumë ndërtesa janë brenda një muri rrethues dhe kanë një dalje të përbashkët në bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, secilës prej ndërtesave u vihet një numër rendor i veçantë.

Neni 16

Ndërtesës, që ka dalje në dy ose më shumë bulevarde, rrugë, rrugica, sheshe ose parqe të ndryshme, i vihet në çdo portë (hyrje) numri rendor i ndërtesës korresponduese të bulevardit, rrugës, rrugicës, sheshit ose parkut, në anë të së cilës gjendet fasada e ndërtesës.

Neni 17

1. Kur ndërsat kanë dyqane, punishte ose lokale të ndryshme, të cilat kanë hyrje të veçanta, që dalin në bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, çdo dyqani, lokali ose punishteje i vihet një numër i veçantë. Në rast se këto dyqane, punishte apo lokale kanë më tepër se një portë (hyrje), këtyre portave (hyrjeve), që janë të të njëjtit dyqan, lokal ose punishte dhe po në atë rrugë, u vihet secilës i njëjti numër.

2. Po në mënyrën e mësipërme u vihet nga një numër edhe të gjitha ndërtimeve të përkohshme (barrakave), qosheve, që gjenden gjatë drejtimit të një rruge, rrugice, sheshi ose parku, e kur këto janë të grumbulluara, në çdo 16 metra gjatësi rruge, marrin një numër të vetëm, por me fraksion.

Neni 18

Trojet, që ndodhen ndërmjet dy ndërtesave në rrugët e qytetit dhe që kanë fasadën në një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, u rezervohet nga një numër rendor për 16 metra hapësirë të lirë ndërmjet dy ndërtesave. Në rrugët ku trojet janë të ndara në parcela, për çdo parcelë rezervohet nga një numër i veçantë.

Neni 19

Ndërtesave të mëdha, që janë të ndara brenda në formë apartamenti për daljet në bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park, u vihet numër, njësoj si të gjitha ndërtesave të tjera.

Neni 20

1. Ndërtesës, që shërben si pjesë ndihmëse e ndërtesave (për banim ose jo) nuk u vihet numër i veçantë.

2. Objekteve industriale që janë të vendosura ngjitur me ndërtesat e banimit ose me zyrat dhe që kanë formën e ndërtesave më vete, u vihen numra.

Neni 21

(Ndryshuar pika 3, me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008)

1. Në ato fshatra ku nuk ka mundësi të bëhet emërtimi i rrugëve, numërtimi i ndërtesave bëhet sipas lagjeve, nëse këto janë larg njëra-tjetrës.

2. Kur fshati është i grumbulluar, numërtimi i banesave fillon dhe mbaron me një numër rendor të vetëm për të gjitha ndërtesat, që gjenden në atë fshat, duke filluar nga numri 1 dhe duke vazhduar deri në fund pa ndërprerje.

3. Ngarkohet Ministri i Brendshëm të nxjerrë aktet nënligjore për të përcaktuar rregulla të hollësishme për emërtimin dhe numërtimin e ndërtesave dhe të rrugëve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 22

Ndërtesat që ndodhen brenda kufijve të një qyteti, por jashtë pikave të shtrirjes së planit rregullues në fuqi dhe kur nuk ka një sistem rrugësh të rregullta, numërtohen duke filluar nga numri 1 dhe me radhë, deri në ndërtesën e fundit, në mënyrë të njëjtë, sipas sistemit të caktuar për fshatrat.

Nëse vende të tilla nuk kanë emra të caktuar, u vihet nga një emër, sipas mënyrës së treguar në këtë ligj.

Neni 23

1. Ndërtesave, që ngrihen pas përfundimit të numërtimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, u vihen numrat që u janë lënë rezervë trojeve, ku janë ngritur ndërtesat.

2. Ndërtesave, të cilat janë ngritur në trojet tek të cilat nuk janë parashikuar numra rezervë ose numrat rezervë janë të pamjaftueshëm, u vihen numrat e ndërtesave më të afërta me fraksione si, për shembull, 5/1, 5/2, 5/3 e me radhë.

Neni 24

Nëse dy ose më shumë ndërtesa, që kanë pasur numra të veçantë, transformohen në një ndërtesë të vetme, kësaj ndërtese i vihen të gjithë numrat që kishin ndërtesat e para si, për shembull, 120-126 ose 15-19.

Neni 25

(Ndryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008)

Tabelat për emërtimin e bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve dhe numërtimin e ndërtesave, të hyrjeve dhe apartamenteve janë standarde brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 26

1. Tabelat me emërtimin që kanë marrë bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet ose parqet vendosen së paku në një largësi prej 2 metrash e gjysmë në qoshet e ndërtesave që ndodhen në fillim ose në mbarim të tyre.

2. Kur bulevardi ose rruga ndërpritet nga një bulevard ose rrugë tjetër kryesore, shesh apo park, ose kur bulevardi apo rrugët janë të gjata, tabelat mund të vendosen edhe në pika të tjera të dukshme përgjatë vazhdimit të bulevardit ose rrugës.

Neni 27

Lloji i materialit të tabelave, përmasat e tyre, si dhe formati i shkrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Shpenzimet për tabelat me emërtimet e bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve e parqeve dhe ndërtesave, përballohen nga buxheti i njërive vendore përkatëse.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 29

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

1. Këshillat e njërive të vetëqeverisjes vendore duhet të bëjnë emërtimet e bulevardeve, të rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve ekzistuese të paemërtuara, brenda datës 31 dhjetor 2016.

2. Seksionet/zyrat e urbanistikës në njësitë e vetëqeverisjes vendore/njësitë administrative duhet të bëjnë adresimin numerik të brendshëm e të jashtëm të objekteve ekzistuese, brenda datës 31 dhjetor 2016.

3. Nëse njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk përmbushin detyrimet ligjore të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, ato përmbushen nga prefekti i qarkut, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Vënia në shfrytëzim e bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve, që ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqërohet, detyrimisht, me emërtimin përkatës, të bërë nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, me propozimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 31

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Seksionet/zyrat e urbanistikës së njësive të vetëqeverisjes vendore/njesisë administrative përkatëse detyrohen të përcaktojnë adresë të plotë për objektin që në momentin e dhënies së lejes së ndërtimit.

Neni 32

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Shkelja ose mosrespektimi i detyrimit ligjor, nga personat përgjegjës në seksionet dhe zyrat e urbanistikës të njësive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuar në:

a) pikën 2, të nenit 29, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) nenin 31, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Neni 33

(Ndryshuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

Gjobat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 32, vendosen nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ankimohen në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislationit në fuqi.

Neni 33/1

Nxjerrja e akteve nënligjore

(Shtuar me ligjin nr. 89/2016, datë 15.9.2016)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendim, në zbatim të neneve 5 dhe 7 të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike të nxjerrë udhëzim, në zbatim të pikës 2, të nenit 3, të këtij ligji.

Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4295, datë 2.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.8744, datë 22.2.2001

PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE TË
SHTETIT NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE⁶

(Ndryshuar me ligjin nr.9561, datë 12.6.2006; nr.9797, datë 23.7.2007)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 41, 78 dhe 83 pika 1, 111, 112 dhe 113 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj rregullon porcesin e transferimit të pronave të paluajtshme publike të shtetit dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore.

Në këtë ligj përcaktohen llojet që do t'u transferohen njësive të qeverisjes vendore, natyra e të drejtave të njësive të qeverisjes vendore mbi to dhe procesi, sipas të cilit do të bëhet transferimi i pronave.

Neni 2
Përcaktimet e termave të përdorura në këtë ligj

a) “Prona” do të quajmë të gjitha pronat e paluajtshme publike të shtetit, si dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore.

b) “Transferim” do të quajmë kalimin e të drejtës së pronësisë dhe/ose të drejtën e përdorimit të pronave të paluajtshme publike të shtetit nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

c) “Pushtet qendror” do të quajmë Këshillin e Ministrave, ministrinë, si dhe institucionet e tjera që kanë të drejtë të administrojnë pronën e paluajtshme publike të shtetit në përputhje me këtë ligj.

ç) “Kushtet e përdorimit” nënkuptojnë kriteret dhe kufizimet mbi të drejtat e përdorimit të pronave që u transferohen njësive të qeverisjes vendore sipas këtij ligji.

⁶ Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.9, mars 2001.

Ligji nr.9561, datë 12.6.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.69, datë 6 korrik 2006.

Ligji nr.9797, datë 23.7.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.104, datë 6 gusht 2007.

KREU II

LLOJET E PRONAVE QË U TRANSFEROHEN NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Neni 3

Prona që u transferohen njësive të qeverisjes vendore

U transferohen njësive të qeverisjes vendore pronat që përdoren për realizimin e funksioneve dhe/ose shërbimeve për bashkësinë të njohura me ligj, të tilla si:

- a) Pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve të tyre administrative.
- b) Pronat që përdoren për realizimin e programeve arsimore.
- c) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.
- ç) Pronat që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike.
- d) Pronat që përdoren për kryerjen e veprimtarive social-kulturore e sportive.
- dh) Pronat që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit.
- e) Pronat që përdoren për grumbullimin, depozitimin, pastrimin dhe shpërndarjen e ujit, si dhe për grumbullimin, depozitimin, pastrimin dhe shfrytëzimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza.
- ë) Pronat që përdoren për sistemin e transportit publik.
- f) Pronat që përdoren si lehtësira të transportit vendor (urbane, rurale dhe ndërkomunare), përfshirë rrugët, rrugicat, urat, aeroportet dhe portet vendore.
- g) Prona të tilla si trotuare, sheshe, rrjeti i ndriçimit publik, si dhe pajisjet e tjera zbukuruese brendapërbrenda bashkive dhe komunave.
- gj) Prona të tilla si mjete për funeral, varrezat brendapërbrenda bashkive dhe komunave.
- h) Prona të tilla si monumetet historike e kulturore dhe bustet me interes vendor.
- i) Prona të tilla si pyje, kullota, parqe dhe kopshte publike, që kanë për qëllim të përdoren për interes vendor.
- j) Prona të tilla si struktura dhe njësi rezidenciale me interes vendor.
- k) Prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve të tjera sipas ligjeve në fuqi.

Neni 4

Transferimi i tipeve të tjera të pronës

Kur pronat e paluajtshme shtetërore u transferohen njësive të qeverisjes vendore, çdo pronë e luajtshme, që ka të bëjë me këtë të fundit, duke përfshirë dhe rezervat ligjore, do t'i transferohen, gjithashtu, njësive të qeverisjes vendore.

Së bashku me pronën që transferohet, njësive të qeverisjes vendore, i jepet i gjithë dokumentacioni për këtë pronë.

Në ato raste kur pronat e transferuara njësive të qeverisjes vendore janë në formën e aksioneve në një shoqëri tregtare dhe/ose ndërmarrje shtetërore, pushteti qendror mund të transferojë një pjesë ose të tërë titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin që ka në këto shoqëri.

KREU III

TË DREJTAT E PRONËSISË, TË PËRDORIMIT DHE KUFIZIMET E TYRE

Neni 5

E drejta e pronësisë dhe e drejta e përdorimit

Transferimi i pronës nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore, sipas këtij ligji bëhet në njërën nga format e mëposhtme:

- në pronësi ose
- në përdorim

Neni 6

Pushteti qendror për pronat që u transferohen njërive të qeverisjes vendore:

- a) në rastin e kalimit të pronës në pronësi njërive të qeverisjes vendore, mbikëqyr respektimin e kushteve dhe/ose të kufizimeve të përcaktuara në aktin e transferimit;
- b) në rastin e kalimit të pronës në përdorim njërive të qeverisjes vendore, ndërhyr me cilësinë e pronarit, kur vëren mosrespektim të kushteve dhe/ose të kufizimeve të përcaktuara në aktin e transferimit.

Neni 7

Kufizimet mbi të drejtat e pronësisë

Në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë, pushteti qendror mund të vendosë kushte dhe kufizime mbi këtë të drejtë. Këto kushte dhe kufizime duhet të jenë vetëm për të siguruar maksimumin e përfitimeve publike ose mbrojtjen e një karakteristike të veçantë të pronës.

Neni 8

Kufizime mbi të drejtën e pronësisë janë:

- a) Mosndryshim i destinacionit. Ndalimi i ndryshimit të destinacionit dhe/ose qëllimit të përcaktuar në aktin e transferimit pa miratimin e pushtetit qendror.
- b) Kushte të veçanta përdorimi. Përdorimi i pronës në mënyrë që të garantojë ruajtjen e karakteristikave unike të saj.
- c) Kufizimet mbi të drejtën e tjetërsimit dhe të dhënies në përdorim. Për disa prona mund të ndalohej e drejta e tjetërsimit ose e dhënies në përdorim të të tretëve pa miratimin e pushtetit qendror. Ndalohej tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të pronave publike, për të legalizuar ndërtime pa leje.

Neni 8/a

Revokimi i transferimit të pronësisë

(Shtuar me ligjin nr.9797, date 23.7.2007)

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon pushtetin vendor, revokon transferimin e së drejtës së pronësisë kur:

- a) prona nuk i shërben më realizimit të funksioneve ose shërbimeve, të njohura me ligj nga njësitë e qeverisjes vendore;
- b) prona, që ka kaluar në pronësi të qeverisjes vendore, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave.

Neni 9

Tjetërsimi ose dhënia në përdorim e pronës së fituar nga transferimi

Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund të tjetërsojnë pronën e përfituar (marrë) në pronësi sipas këtij ligji në të gjitha mënyrat e njohura nga legjislati në fuqi, ndaj një personi fizik a juridik privat, në njërin nga këto raste:

- a) Ka një kusht ose kufizim që i ndalon atij tjetërsimin ose dhënien në përdorim.
- b) Prona është e domosdoshme për kryerjen e një funksioni të qeverisjes vendore.

Neni 10

Përdorimi i të ardhurave nga tjetërsimi ose dhënia në përdorim e pronës

Të ardhura nga tjetërsimi ose dhënia në përdorim e pronës duhet të përdoren vetëm për realizimin e funksioneve të njësive të qeverisjes vendore.

Neni 11

Heqja e kushteve ose kufizimeve për pronën

1. Njësitë e qeverisjes vendore mund t'i kërkojnë Këshillit të Ministrave heqjen e një kushti ose të një kufizimi të vendosur sipas këtij ligji për çdo pronë, që ato e kanë në pronësi, vetëm 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave, brenda 90 ditëve pas marrjes së kërkesës, shprehet për pranimin ose mospranimin e saj. Në rast se brenda këtij afati Këshilli i Ministrave nuk shprehet, kërkesa vlerësohet e pranuar.

2. Në rastin e mospranimit të kërkesës nga Këshilli i Ministrave, njësia e qeverisjes vendore ka të drejtë t'ia kthejë pronën në pronësi pushtetit qendror, i cili është i detyruar ta pranojë. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve pas njoftimit nga njësia e qeverisjes vendore, e kundërshtojnë atë për çdo përmirësim që mund t'i ketë bërë pronës me burimet e saj pas transferimit. Në rast të mosshlyerjes së detyrimit brenda afatit nga Këshilli i Ministrave, kushti ose kufizimi hiqet automatikisht.

Neni 12

Kushtet dhe/ose kufizimet e vendosura sipas këtij ligji mbi pronën e transferuar do të kenë fuqi derisa ato të hiqen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

E drejta e njësive të qeverisjes vendore mbi pronat e dhëna në përdorim

1. Kur një njësi e qeverisjes vendore i jepet e drejta e përdorimit për një pronë, Këshilli i Ministrave, në aktin e transferimit, përcakton kushtet e përdorimit të saj.

2. Kushtet e përdorimit të çdo prone respektojnë pavarësinë e njësive të qeverisjes vendore për përmbushjen e funksioneve me të cilat lidhet kjo pronë.

Neni 14

Shfuqizimi i së drejtës së përdorimit të pronës

Këshilli i Ministrave vendos për shfuqizimin e së drejtës së përdorimit të një prone nga njësitë e qeverisjes vendore në këto raste:

- a) Kur funksioni i deleguar, për të cilin prona është transferuar, përfundon ose ndërpritet.
- b) Në çastin kur Këshilli i Ministrave vëren se prona nuk po përdoret nga njësia e qeverisjes vendore sipas kushteve dhe/ose kufizimeve të përdorimit të pronës në fjalë.

Neni 15

Procedurat e dhënies në përdorim të pronës

Këshilli i Ministrave do të ndjekë procedurën e mëposhtme për përfundimin e dhënies në përdorim sipas neneve 14(a) ose 14 (b):

- a) Në rastin kur vendimi, që i heq të drejtën e përdorimit të pronës njësive të qeverisjes, merret sipas nenit 14(a), atëherë vendimi do të ekzekutohet vetëm kur përmbushen dy kushtet e mëposhtme:

- të kenë kaluar 90 ditë nga njoftimi i këtij vendimi njësisë të qeverisjes vendore dhe
- vetëm pas shlyerjes së detyrimeve që Këshilli i Ministrave u ka njësisë të qeverisjes vendore për përmirësimet e bëra pronës me fondet e veta.

Shlyerja e detyrimit bëhet jo më vonë se 6 muaj nga dita e njoftimit. Nëse pushteti qendror nuk shlyen detyrimet, njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë ta përdorin pronën deri në shlyerjen e detyrimit për një periudhë trevjeçare.

b) Në rastin kur vendimi, që i heq të drejtën e përdorimit të pronës njësisë të qeverisjes vendore, merret sipas nenit 14(b), Këshilli i Ministrave ekzekuton vendimin e tij brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit njësisë të qeverisjes vendore, pavarësisht nga shlyerja ose jo e përmirësimeve të bëra pronës nga njësitë e qeverisjes vendore me fondet e veta.

Këshilli i Ministrave do të shlyejë detyrimin për përmirësimet e bëra pronës nga njësitë e qeverisjes vendore jo më vonë se 6 muaj nga data e ekzekutimit të vendimit. Pas 6 muajsh, pushteti qendror paguan një kamatë 1 për qind në ditë të shumës së përgjithshme që u detyrohet njësisë të qeverisjes vendore.

Neni 16

Përgjegjësia financiare mbi pronat që transferohen

1. Në rast se Këshilli i Ministrave do të vendosë një kusht, që i shkakton njësisë të qeverisjes vendore kosto për mirëmbajtjen ose për përmirësimin e pronës, ai do t'u sigurojë njësisë të qeverisjes vendore fonde financiare për përballimin e këtyre shpenzimeve.

2. Sa herë që Këshilli i Ministrave u jep të drejta përdorimi mbi një pronë njësisë të qeverisjes vendore, ai do t'u sigurojë atyre mjete të nevojshme për shfrytëzim dhe mirëmbajtjen e kësaj prone.

3. Kushtet e përdorimit shoqërohen me detyrimet përkatëse financiare të njësisë të qeverisjes vendore dhe asaj qendrore për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e pronës.

KREU IV

PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Neni 17

Afatet dhe procedurat e transferimit

(Ndryshuar paragrafi i parë, ndryshuar shkronja "a", "b" dhe "ç" e paragrafit të dytë me ligjin nr.9561, datë 12.6.2006)

Transferimi i pronave përfundon sipas procedurave të këtij ligji. Transferime të tjera kryhen sa herë që do të ketë shtesa të funksioneve të njësisë të qeverisjes vendore.

Kryerja e transferimit do të bëhet si vijon:

a) Nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, njësitë e qeverisjes vendore paraqesin në Këshillin e Ministrave listën e pronave, që kërkojnë t'u transferohen, në përputhje me krerët II dhe III të këtij ligji.

b) Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton kërkesat e paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas shkronjës "a" të këtij neni, merr vendimin paraprak për listën e pronave, që do t'ia transferojë çdo njësi të qeverisjes vendore. Lista e pronave, që transferohen së bashku me kushtet dhe kufizimet që përcakton Këshilli i Ministrave, sipas këtij ligji, i njoftohet njësisë së qeverisjes vendore, e cila, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit, e shpall atë publikisht.

c) Jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së listës së pronave, çdo njësi e qeverisjes vendore mund t'i parashtrijë Këshillit të Ministrave kundërshtime për përmirësimin e listës, sipas shkaqeve të caktuara në nenin 19 të këtij ligji.

ç) Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së kundërshtimeve, vendos përfundimisht për transferimin e pronës, për të cilën ka kundërshtim nga njësi e qeverisjes

vendore përkatëse, së bashku me ndonjë kusht ose kufizim që duhet zbatuar për këto pronë.

d) Njësitet e qeverisjes vendore, të cilat fillimisht paraqesin listën e pronës sipas nenit 17(a), mund ta kundërshtojnë vendimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave para gjykatës së rrethit gjyqësor (seksioni administrativ), sipas nenit 19 të këtij ligji.

dh) Njësitet e qeverisjes vendore, të cilat nuk e parashtrojnë listën e pronave sipas nenit 17(a), nuk kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave për transferimin e pronave.

Neni 18

Dokumentacioni i transferimit

Të gjitha pronat, të cilat u kalohen në pronësi njësive të qeverisjes vendore sipas këtij ligji, do të regjistrohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Po kështu do të regjistrohen në kartelën e pasurisë së paluajtshme edhe kushtet dhe kufizimet e vendosura sipas këtij ligji.

KREU V

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 19

1. Çdo njësi e qeverisjes vendore ka të drejtë të kundërshtojë listën e pronës së përgatitur nga Këshilli i Ministrave sipas nenit 17(c) të këtij ligji, për shkaqet e mëposhtme:

- a) Njësive të qeverisjes vendore u mungon aftësia financiare për mirëmbajtjen e pronave.
- b) Njësitet e qeverisjes vendore mendojnë se pronë nuk është e nevojshme për kryerjen e një funksioni të tyre.
- c) Njësitet e qeverisjes vendore mendojnë se një pronë duhet t'i shtohet listës për përmbushjen e funksioneve të tyre në përputhje me nenin 3 dhe kreun III të këtij ligji.
- ç) Njësitet e qeverisjes vendore besojnë se një kusht ose kufizim, që rekomandohet për t'u vendosur mbi një pronë, nuk është në përputhje me parimet e caktuara në nenet 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.

2. Nëse bisedimet për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe njësisë së qeverisjes vendore përkatëse nuk e zgjidhin atë brenda kohës së përcaktuar në nenin 17(ç), atëherë brenda 6 muajve palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor (seksioni administrativ).

3. Për mosmarrëveshjet që lidhen me përmbushjen e detyrimeve financiare, të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, si dhe në dokumentacionet e transferimit, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor (seksioni administrativ).

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërtesat administrative të bashkive dhe komunave dhe të gjitha mjediset në të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre administratat vendore, që janë nën administrimin e njësive të qeverisjes vendore dhe kur nuk përbëjnë konflikt pronësie me të tretë, kalojnë në pronësi të komunave ose bashkive.

Komunat dhe bashkitë, me miratimin e këshillave komunale, marrin masa dhe mbulojnë koston për regjistrimin e këtyre pronave sipas procedurave të përcaktuara me ligjin përkatës.

Neni 21

Organi përgjegjës për zbatimin e ligjit

Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij dhe ngarkon strukturat përkatëse për zbatimin e tij.

Aktet nënligjore do të përfshijnë edhe formularët standard të propozimit dhe të transferimit të pronës.

Nen 22

Dispozitat ligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2917, datë 9.3.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIGJ

Nr.9220, datë 15.4.2004

PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË VARRIMIT⁷

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

(Hequr fjala "publik" me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave e afateve për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

⁷ Ligji nr.9220, datë 15.4.2004 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 27 maj 2004.

Ligji nr. 80/2014, datë 17.7.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 11 gusht 2014.

Neni 2

Përkufizime

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Vdekje” është pushimi në mënyrë të parikthyeshme i aktivitetit të të gjitha sistemeve jetësore të organizmit të njeriut.
2. “Kufomë” është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore.
3. “Varr” është vendi i vendosjes së kufomës dhe/ose mbetjeve mortore.
4. “Varrezë” është një parcelë e përcaktuar territori, ku varrosen të vdekurit.
5. “Varrim” është procesi i vendosjes në varr të kufomës dhe/ose mbetjeve mortore, që i bëhet të vdekurit.
6. “Varrezë publike” është vendi ku ndodhen varrezat e një rajoni, të cilat janë pronë e njësisë bazë të qeverisjes vendore.
7. “Varrezë monumentale” është varreza ku prehen personalitete historike, fetare, kulturore, dëshmorë të kombit a njerëz të shquar dhe që mbahet për qëllime historike, përkujtimore, nderimi a vetëdijësimi kombëtar.
8. “Varrezë historike” është varreza ku prehen njerëz, të cilët kanë humbur jetën në kontekstin e ngjarjeve të caktuara historike, e cila mbahet për qëllime historike dhe përkujtimore.
9. “Varrezë fetare” është varreza që ngrihet nga komuniteti fetar dhe shërben për varrimin, si rregull, të besimtarëve të vet.
10. “Varrezë private” është varreza që ngrihet dhe administrohet nga subjekte private të licencuara, sipas kushteve dhe kritereve të këtij ligji.
11. “Mineralizim natyror i kufomës” është dekompozimi i indeve të buta të kufomës.
12. “Mineralizim artificial i kufomës” është transformimi në hi i indeve të buta dhe të forta të kufomës përmes kremimit.
13. “Kremim” është procesi i transformimit të kufomës nëpërmjet trajtimit industrial me nxehtësi të lartë.
14. “Mbetje mortore” janë mbetjet pas mineralizimit natyror të kufomës (eshtrat) dhe/ose pas mineralizimit artificial të kufomës (hiri).
15. “Shërbim i varrimit” është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës.
16. “Morg” është mjedisi ku kryhen autopsitë anatomo-patologjike dhe mjeko-ligjore të kufomave, si dhe të konservimit të përkohshëm frigoriferik të tyre.
17. “Morg civil” është ambienti ku trajtohen kufomat përpara se të kryhet ceremonia e varrimit.
18. “Zhvarrim” është nxjerrja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore nga varri.
19. “Zhvarrim i zakonshëm” është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes.
20. “Zhvarrim i jashtëzakonshëm” është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik.
21. “Periudhë e observimit” është koha e mbikëqyrjes së kufomës para varrimit.
22. “Shenjë funebre” është çdo lloj simboli ose mbishkrimi i vendosur mbi varr nga familjarët.
23. “E drejtë për përdorimin e varrit” është e drejta që buron nga marrëdhënia kontraktore, me të cilën lidhet disponimi mbi varrin konkret.
24. “Kohë e prehjes” është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.
25. “Zonë e rezervuar” është zona që nga banesa e fundit e periferisë së qytetit ose fshatit deri te fillimi i varrezave.

KREU II PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË VARRIMIT

Neni 3

Varrezat publike të njësive bazë të qeverisjes vendore

(Ndryshuar titulli, neni 1, dhe shtuar pika 4/1, me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Çdo njësi bazë e qeverisjes vendore duhet të ketë të paktën një varrezë. Toka e caktuar për ndërtimin e varrezave është pronë publike. Njësitë bazë të qeverisjes vendore garantojnë shërbimin publik të varrimit në njësitë e tyre administrative, duke ndërtuar dhe administruar varreza publike të mjaftueshme.

2. Njësitë bazë të qeverisjes vendore, që përfshijnë disa fshatra, në të cilat transporti i kufomave deri në qendër të njësisë bazë të qeverisjes vendore nuk është i lehtë, për shkak të vështirësive të komunikacionit, duhet të kenë varreza të veçanta për këto fshatra.

3. Njësitë bazë të qeverisjes vendore mund të kenë një varrezë të përbashkët vetëm në qoftë se janë fqinje me njëra – tjetrën. Në këtë rast, me marrëveshje të përbashkët, shpenzimet për shërbimin dhe mirëmbajtjen e varrezave shpërndahen ndërmjet njësive bazë të qeverisjes vendore, në bazë të të dhënave të popullsisë së tyre.

4. Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit vendor”, njësitë bazë të qeverisjes vendore sigurojnë mirëmbajtjen, rregullin dhe ruajtjen e varrezave dhe kur varreza është e përbashkët këtë detyrë e kryen njësia bazë të qeverisjes vendore ku ndodhet varreza. Këto veprime kryhen nga shërbimi i varrezave publike vendore ose nga një shoqëri private e licencuar, sipas kriterëve të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

4/1. Varrimi në varrezat e njësive bazë të qeverisjes vendore bëhet pavarësisht nga besimi fetar i të vdekurit, duke garantuar kushtet për kryerjen e riteve fetare, sa herë kjo kërkohet.

5. Zyrat përgjegjëse të njësisë bazë të qeverisjes vendore duhet të jenë të pajisura me një planimetri me shkallë 1 : 5000 të varrezave ekzistuese, e shtrirë në zonën rrethuese të tyre. Planimetria duhet të azhurnohet çdo vit, duke pasqyruar në të të gjitha ndryshimet e kryera.

6. Njësitë bazë të qeverisjes vendore, për administrimin e varrezave, bashkëpunon edhe me komunitetet fetare.

Neni 3/a

Varrezat fetare

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat fetare ngrihen nga bashkësitë fetare mbi troje në pronësi të tyre, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

2. Ngritja e varrezave fetare bëhet me miratimin e këshillit të njësisë bazë të qeverisjes vendore.

3. Administrimi i varrezave fetare bëhet nga bashkësia përkatëse fetare ose nga subjekte private, me të cilat organet drejtuese të komunitetit fetar lidhin kontratë për administrimin e varrezës.

4. Varrimi i personave që nuk i përkasin të njëjtit besim në varrezat fetare është në tagrin e bashkësisë fetare që administron varrezën.

Neni 3/b

Varrezat private

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat private ngrihen nga subjekte private mbi troje në pronësi të tyre ose në troje në pronësi shtetërore a të njësisë bazë të qeverisjes vendore, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

2. Ngritja e varrezave private bëhet me miratim të Këshillit të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe/ose të Këshillit të Ministrave. Për njësitë bazë të qeverisjes vendore mund të ngrihet vetëm një varrezë private për 100 mijë banorë dhe me sipërfaqe jo më pak se 10 ha.

3. Subjekti privat ushtron veprimtarinë e tij në bazë të marrëveshjes së lidhur, sipas rastit, me kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore ose ministrin përgjegjës për çështjet e planifikimit urban, në përputhje me rregullat për funksionimin dhe administrimin e varrezave, që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave. Marrëveshja nuk u nënshtrohet rregullave të legjislacionit në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

4. Kriteret dhe procedurat për ngritjen e varrezave private përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Varrimi në varrezat private bëhet pavarësisht nga besimi fetar i të vdekurit, duke garantuar kryerjen e riteve fetare, sa herë kjo kërkohet.

Neni 3/c

Varrezat monumentale

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Statusin e varrezave monumentale e mbajnë Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, vendvarrimet e veçanta mbisipërfaqësore, sipas nenit 11, të ligjit, si dhe vendvarrimet e personaliteteve të shquara kombëtare historike, kulturore a fetare.

2. Varrezat monumentale ngrihen me vendim të Këshillit të Ministrave, në shenjë nderimi, përkujtimi dhe mirënjohjeje kolektive për personalitetet që prehen në to, me elemente funksionale dhe organizative të dallueshme qartë dhe të përshtatura sipas nevojave të ceremonialit zyrtar dhe pelegrinazhit kolektiv.

3. Rregullat për statusin “Varrezë monumentale”, për personat ose rrethin e personaliteteve që gëzojnë të drejtën e prehjes në to, për administrimin, financimin, kujdesin dhe mirëmbajtjen e tyre, përcaktohen në aktet me të cilin krijohen varrezat monumentale.

4. Administrimi, financimi, ruajtja, përdorimi dhe mirëmbajtja e varrezave monumentale, që kanë statusin monument kulture, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

5. Me përjashtim të Varrezave të Dëshmorëve të Atdheut, varrezat monumentale nuk shërbejnë për varrime të reja.

Neni 3/ç

Varrezat historike

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat historike ngrihen me vendim të Këshillit të Ministrave, në shenjë përkujtimi për ngjarje të veçanta historike, me elemente funksionale dhe organizative të dallueshme qartë dhe të përshtatura sipas nevojave të ceremonialit zyrtar dhe pelegrinazhit kolektiv.

2. Në varrezat historike prehen persona që kanë humbur jetën gjatë/dhe për shkak të ngjarjeve që përkujtohen. Varrezat historike nuk shërbejnë për varrime të reja.

3. Rregullat për administrimin, financimin, kujdesin dhe mirëmbajtjen e tyre përcaktohen në aktet me të cilin krijohen varrezat historike.

Neni 3/d

Rregullat teknike, të administrimit dhe mbikëqyrja

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Rregullat teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave përcaktohen me rregullore të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Rregullat për administrimin dhe funksionimin e varrezave publike, fetare dhe private, përcaktohen me rregullore të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Përveç sa përcaktohet në këtë rregullore, njësitë e qeverisjes vendore mund të përcaktojnë rregulla plotësuese në zbatim të saj.

3. Për varrezat fetare, rregullat e ritualit fetar që aplikohen, miratohen nga organet e bashkësisë fetare. Publiku duhet të ketë akses mbi këto rregulla.

4. Kontrolli për mënyrën e administrimit dhe funksionimit të varrezave publike, fetare dhe private, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore.

Neni 3/dh

Tarifat

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat publike, fetare dhe private ofrojnë shërbimet e tyre në bazë të tarifave të shërbimit. Tarifat e shërbimit publikohen. Administrata e varrezës është e detyruar të garantojë aksesin e plotë dhe në çdo kohë të publikut mbi informacionin përkatës.

2. Tarifat e shërbimit për varrezat publike miratohen nga këshilli i njësisë bazë përkatëse të qeverisjes vendore.

Neni 4

Zona e rezervuar

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrezat duhet të jenë të izoluara nga zonat e banimit nëpërmjet zonës së rezervuar. Ndalohej të bëhen ndërtime brenda zonës së rezervuar.

2. Në qendrat e banuara me popullsi mbi 10 000 banorë, gjerësia e zonës së rezervuar duhet të jetë më e madhe se 100 m nga vija kufizuese e qendrës së banuar dhe për ato me popullsi më të vogël se 10 000 banorë, duhet të jetë më e madhe se 50 m.

3. Këshilli i njësisë bazë të qeverisjes vendore ka të drejtë të zvogëlojë gjerësinë e zonës së rezervuar. Kjo bëhet vetëm me vendim të motivuar të organeve të mësipërme, duke marrë mendimin e inspektoratit sanitar.

Neni 5

Ndalimi i varrimit në një vend të ndryshëm nga varrezat

(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2, me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrosja e kufomave bëhet vetëm në varreza. Me kërkesë të komuniteteve fetare lejohet varrosja në mjediset brenda selive fetare.

2. Shfuqizuar.

Neni 6

Pranimi i kufomave në varreza

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Në varrezat pranohen:

a) kufomat dhe/ose mbetjet mortore të personave të vdekur në territorin e njësive bazë të qeverisjes vendore, pavarësisht nga vendi i banimit kur ishin gjallë;

b) kufomat dhe/ose mbetjet mortore të personave të vdekur jashtë territorit të njësive bazë të qeverisjes vendore, por që, kur ishin gjallë, ishin banues të tyre;

c) kufomat dhe/ose mbetjet mortore të personave që nuk banonin në këtë njësi bazë të qeverisjes vendore kur ishin gjallë dhe që kanë vdekur jashtë territorit të kësaj njësie bazë të qeverisjes vendore;

ç) kufomat dhe/ose mbetjet mortore dhe/ose mbetjet mortore të shtetasve të huaj me banim ose jo në Shqipëri, që dëshirojnë të varrosen në këto territore pasi të jenë pajisur me autorizim nga prefekti;

d) Shfuqizuar.

dh) të lindurit të vdekur.

Neni 6/a

Detyrimi për varrim

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Për çdo kufomë lind detyrimi për varrim. Këtu bëjnë pjesë dhe të sapolindurit e vdekur dhe fetuset e vdekura në lindje me peshë mbi 500 gramë.

2. Foshnjat e lindura të vdekura dhe fetuset e vdekura gjatë lindjes, me peshë nën 500 gramë, varrosen me shpenzimet e prindërve, kur këtë e kërkon së paku njëri nga prindërit. Kur ngjarja ndodh në institucione mjekësore, atëherë institucioni është i detyruar të informojë prindërit për këtë klauzolë. Në rast se prindi nuk bën kërkesë, atëherë institucioni bën trajtimin e mëtejshëm me shpenzimet e veta dhe në përputhje me procedurat e brendshme spitalore. Këto procedura duhet të garantojnë trajtimin në mënyrë dinjitoze të tyre.

3. Foshnjat dhe fetuset e lindura të vdekura, sipas pikës 2, të këtij neni, që nuk kërkohet të varrosen, lejohet të përdoren vetëm për qëllime shkencore. Për përdorimin për nevoja mësimore-shkencore kërkohet pëlqimi i të dy prindërve. Institucioni shkencor përgjigjet për varrimin e tyre sapo ato të mos jenë më të nevojshëm për veprimtarinë mësimore-shkencore. Nga ky moment institucioni mbart të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për prindin.

4. Pjesët e trupit të amputuara trajtohen në përputhje me procedurat e brendshme spitalore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6/b

Detyrimi për përkujdesje për varrimin

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Detyrimi për t'u përkujdesur për varrimin i takon familjarëve të të vdekurit, sipas radhës dhe rastit:

- a) bashkëshortit a bashkëshortes ose bashkëjetuesit a bashkëjetueses;
- b) fëmijëve në moshë madhore;
- c) prindërve;
- ç) prindërve të prindërve;
- d) vëllezërve e motrave madhore dhe fëmijëve të tyre.

2. Nëse detyrimi, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk plotësohet, administrata vendore duhet të urdhërojë kryerjen e varrimin nga shërbimi i varrimit dhe kalimin e shpenzimeve në ngarkim të familjarëve që kanë detyrimin sipas pikës 1, të këtij neni, në rast se kufoma nuk u përcillet shërbimit anatomo-patologjik. Kur detyrimi sipas pikës 1, të këtij neni, është i pamundur, shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku ai është i regjistruar.

3. Pika 2, e këtij neni, zbatohet edhe për personat që jetojnë në kushtet e varfërisë, të braktisjes, të mungesës së interesit mes anëtarëve të familjes, ose për të cilët është e pamundur të identifikohen familjarë që bartin detyrimin, sipas pikës 1, të këtij neni. Kur këta persona nuk janë banorë të njësisë së qeverisjes vendore, shërbimi i varrimit kryhet nga njësia bazë e qeverisjes vendore, ku personi ka ndërruar jetë, duke marrë pagesën nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku ai është i regjistruar.

Neni 6/c

Llojet dhe mënyrat e varrimit

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Varrimi mund të jetë nëntokësor, mbitokësor ose me kremim dhe bëhet sipas ritualit fetar ose laik. Lloji dhe mënyra e varrimit përcaktohen sipas vullnetit të të vdekurit. Nëse i vdekuri nuk ka lënë vullnet të shprehur për llojin dhe mënyrën e varrimit, atëherë ato përcaktohen nga familjarët, sipas pikës 1, të nenit 6/b, të këtij ligji.

Neni 6/ç

Llojet e varreve

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrimi, si rregull, bëhet në varre individuale, ku mund të varrosen persona të tjerë vetëm pas kalimit të kohës së prehjes, sipas nenit 7/ç të këtij ligji, dhe vetëm me kërkesën me shkrim të familjarëve të personit të vdekur, për të cilin është lëshuar e drejta e përdorimit. Në këtë rast lidhet kontratë e re përdorimi, e cila nuk anulon kushtet e kontratës së parë të përdorimit.

2. Varrimi mund të bëhet në varre familjare nëntokësore, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 7

Shërbimi i varrimit

(Ndryshuar pika 1 dhe 2, me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Pranë çdo varreze publike, fetare ose private, funksionon shërbimi i varrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe rregullores së administrimit dhe funksionimit të varrezës. Shërbimi i varrimit mund të kontraktojë të tretë për kryerjen e shërbimeve dhe për mallra të caktuara.

2. Shfuqizuar.

3. Çdo shërbim varrimi regjistrohet në dy regjistra të njëjtë, numri i faqeve të të cilave vërtetohet nga kryetari ose sekretari i njësisë bazë të qeverisjes vendore. Në regjistrë shënohen:

a) varrimet që janë kryer, duke saktësuar emrin, mbiemrin, moshën, vendin dhe datën e lindjes (siç rezulton nga leja e varrimit), vitin, ditën dhe orën e varrimit, numrin e gurit të varrit dhe numrin rendor të faturës së varrimit;

b) çdo ndryshim që ka ndodhur si pasojë e zhvarrosjeve.

Regjistri nënshkruhet në çdo fletë nga përgjegjësi i shërbimit. Modeli i tij përcaktohet në udhëzimin e ministrit që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike.

4. Njëra prej kopjeve të regjistrit dorëzohet çdo fund viti në arkivin e njësisë bazë të qeverisjes vendore, ndërsa kopja tjetër mbetet në ruajtje pranë shërbimit të varrimit.

5. Rakordimi i regjistrave me zyrat e gjendjes civile bëhet çdo tremujor.

6. Regjistrat e përmendur në pikën 3 të këtij neni paraqiten pranë organeve të kontrollit të njësisë vendore pas çdo kërkesë të tyre.

Neni 7/a

Kushtet për lejimin e varrimit

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Kufomat lejohet të varrosen vetëm pasi është lëshuar leja e varrimit nga zyra e gjendjes civile e njësisë bazë përkatese të qeverisjes vendore. Shërbimi i varrimit merr në dorëzim dhe ruan për çdo varrim lejen e varrimit.

2. Kur vdekja ndodh në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit kërkon dokumentet që vërtetojnë vdekjen, në

përputhje me nenin 54, të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, dhe me këto dokumente bën deklarin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile në ditën e parë të punës.

3. Për kufomat, që transportohen nga një shtet tjetër, shërbimi i varrimit merr në dorëzim dhe ruan bashkë me certifikatën e vdekjes, të lëshuar sipas formës dhe modaliteteve në fuqi në shtetin tjetër, edhe lejen për transportimin e kufomës (pasaportën e kufomës), të lëshuar nga autoritetet konsullore shqiptare. Kur certifikata e vdekjes, si më sipër, mungon, atëherë certifikata e vdekjes u kërkohet autoriteteve shqiptare, sipas procedurave në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

4. Rregullat e detajuara për aktin e vdekjes, deklarin e vdekjes, lëshimin e lejes së varrimit, vërtetimin e vdekjes, si dhe për organet e personat përgjegjës përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për gjendjen civile.

Neni 7/b

Kushte të veçanta për varrimin me kremim

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Kufomat lejohet të varrosen me kremim vetëm nëse:
 - a) njihet identiteti i personit të vdekur;
 - b) është lëshuar leja e varrimit, sipas nenit 7/a, të këtij ligji;
 - c) dokumenti që vërteton vdekjen konfirmon se vdekja ka ardhur për shkaqe natyrore dhe se shkaku i vdekjes është konstatuar jashtë çdo lloj dyshimi;
 - ç) ekziston vullneti i shprehur i personit të vdekur.
2. Nëse rrethanat, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk plotësohen, atëherë varrimi me kremim mund të zhvillohet vetëm nëse organi i prokurorisë autorizon me shkrim kryerjen e tij.

Neni 7/c

E drejta për përdorimin e varrit

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. E drejta për përdorimin e varrit fitohet me anën e kontratës së përdorimit, të lidhur me shërbimin e varrezës. Kontrata e përdorimit të varrit nuk sjell pronësinë mbi të.
2. Kontrata e përdorimit lidhet nga vetë personi përpara vdekjes (prenotim varri) ose nga familjarët para ose pas vdekjes së personit.
3. Kontrata lidhet sipas kushteve, kriterëve dhe tarifave të përcaktuara në rregulloren e administrimit dhe funksionimit të varrezës. Në kontratë përcaktohen identiteti i personit ose i personave që lejohet të varrosen në varrin, objekt kontrate, mënyra e veshjes dhe dekorimit të varrit, shenjat funebre që do përdoren, rregullat për kujdesin dhe mirëmbajtjen, lloji dhe mënyra e varrimit, kohëzgjatja e së drejtës së përdorimit, shërbimet që do të prenotohen, çmimet përkatëse dhe mënyra e pagesës.

Neni 7/ç

Koha e prehjes dhe afati për përdorimin e varrit

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Koha e prehjes për të gjitha varrezat publike, fetare ose private, është e barabartë me 15 vjet. E drejta e përdorimit të varrit gjatë kohës së prehjes është pa shpërblim. Këtu nuk përfshihen shërbimet që ofron varreza, për të cilat ka tarifa të miratuara.
2. Afati për kohëzgjatjen e së drejtës së përdorimit të varrit është, në minimumin e tij, sa afati, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe, në maksimumin e tij, i përhershëm. Për çdo varr, afati i përdorimit përcaktohet në kontratën e përdorimit, sipas nenit 7/c, të këtij ligji. Për periudhën përtej afatit minimal kontrata mund të parashikojë shpërblim, nëse për këtë qëllim ka tarifa të miratuara.

Neni 7/d

Shërbimi anatomo-patologjik

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Shërbimi anatomo-patologjik pranon kufoma në kuadër të veprimtarisë mësimore-shkencore, për të cilat është lëshuar leja e varrimit, sipas nenit 7/a të këtij ligji.

2. Shërbimi anatomo-patologjik ka për detyrë të sigurojë që kufomat e administruara prej tij të mos bëhen burim për përhapjen e sëmundjeve.

3. Shërbimi anatomo-patologjik përgjigjet për varrimin e kufomës sapo ajo të mos jetë më e nevojshme për veprimtarinë mësimore-shkencore. Nga ky moment ai mbart të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për familjarin.

Neni 7/dh

Përpunimi i të dhënave personale

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Gjatë ushtrimit të funksioneve të veta shërbimi i varrimit ka të drejtë të përpunojë të dhëna personale. E drejta për përpunimin e të dhënave personale lidhet sidomos me mbajtjen e regjistrit të personave të varrosur, të klientëve dhe kontratave apo të të punësuarve.

2. Mbajtja, kontrolli, përpunimi dhe fshirja e të dhënave personale bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.

KREU III

NORMAT TEKNIKE PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE

Neni 8

Projektimi i varrezave

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Çdo projekt për zgjerimin e varrezave ekzistuese dhe ndërtimin e varrezave të reja bëhet në bazë të një studimi të plotë të zonës, të miratuar nga këshilli i njësisë bazë të qeverisjes vendore, veçanërisht, për sa i përket vendndodhjes, shtrirjes së tokës e natyrës fiziko-kimike të saj, thellësisë dhe drejtimit të shtresës hidrike, kushteve teknike të ndërtimit të varrezave.

1/1. Zgjerimi i varrezave ekzistuese dhe ngritja e varrezave të reja është pjesë përbërëse e planit të përgjithshëm vendor. Plani për zhvillimin e varrezave hartohet mbështetur në kapacitetet ekzistuese, nevojat e planifikuara, sipas rritjes së popullsisë, në prirjet e zhvillimit territorial, si dhe sipërfaqet e lira dhe përshtatshmërinë funksionale të tyre. Plani konsultohet me komunitetet fetare dhe subjektet e interesuara.

1/2. Në planin për zhvillimin e varrezave duhet të përcaktohen edhe parashikimet për mbylljen apo prishjen e varrezave ekzistuese dhe destinacioni i tyre. Si rregull, destinacioni i varrezave të prishura duhet të jetë sipërfaqe e gjelbër. Përdorimi për qëllime të tjera mund të justifikohet vetëm për motive të interesit publik.

2. Ndërtimi, zgjerimi, mbyllja apo prishja e varrezave apo parcelave të varrezave bëhen në pajtim me planin për zhvillimin e varrezave, planin e përgjithshëm vendor dhe vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedis. Në projektet e ndërtimit të varrezave të reja mund të parashikohen edhe parcela të ndara sipas komuniteteve fetare, në funksion të përbërjes fetare të popullsisë së rajonit.

2/1. Në projektimin e varrezave mbahen parasysh rregullat në fuqi për rendin dhe sigurinë publike, si dhe ato për shëndetin publik.

2/2. Natyra fiziko-kimike e tokës dhe thellësia dhe drejtimi i shtresave hidrike duhet të dokumentohen shkencërisht.

3. Shfuqizuar.

Neni 9

Vendmbajtja e përbashkët e eshtrave

Çdo varrezë ka vendmbajtjen e eshtrave, që përbëhet nga një ndërtesë e destinuar për mbledhjen e eshtrave, që vijnë nga zhvarrimet dhe që nuk janë kërkuar nga familjarët për destinacion tjetër në varreza. Vendmbajtja e eshtrave duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që eshtrat të mos shihen nga publiku. Vendmbajtja e eshtrave lejohet edhe brenda selive të komuniteteve fetare, pas marrjes së lejes nga njësi bazë e qeverisjes vendore.

Neni 10

Mjediset për ceremonitë e varrimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Në varreza ngrihen, në hyrje ose në afërsi të territorit të tyre, mjedise të mjaftueshme pritjeje ose për zhvillimin e ceremonive në nderim të personave të vdekur apo për zhvillimin e ritualeve fetare. Mjediset shërbejnë për ceremoni varrimi dhe përkujtime.

2. Këto mjedise dhe shërbimet e lidhura me to vihen në dispozicion kundrejt pagesës. Çmimi për njësi kohe, sipas kësaj pike, bëhet publik. Administrata e varrezës është e detyruar të garantojë aksesin e plotë dhe në çdo kohë të publikut mbi informacionin përkatës. Për varrezat private ky çmim është i liberalizuar.

3. Për kryerjen e riteve fetare mjediset duhet të organizohen dhe të pajisen, sipas kërkesave të komuniteteve fetare, në bazë të parimit të barazisë për të gjithë.

Neni 10/a

Implantet e kremimit

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

Implantet e kremimit ngrihen brenda ose në afërsi të varrezave pas miratimit nga këshilli i njësisë bazë të qeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

VARRIMET JASHTË VARREZAVE

Neni 11

Varrime të veçanta mbisipërfaqësore

Varrimi i veçantë mbisipërfaqësor i kufomave ose mbetjeve mortale në vende të ndryshme nga varrezat autorizohet me dekret të Presidentit të Republikës, duke respektuar normat e përcaktuara në këtë ligj. Autorizimi për këtë lloj varrimi bëhet kur ekzistojnë motive të justifikueshme për nderime të veçanta.

KREU V

PRISHJA E VARREZAVE

Neni 12

Mbyllja dhe prishja e varrezave

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varreza ose pjesë të caktuara të saj mund të mbyllen për varrime të reja, në rast se kjo nevojë lind për një shkak ose interes publik. Kjo dispozitë zbatohet edhe për lloje të veçanta varrimi apo varresh.

2. Për të drejtat e përdorimit, të cilat nuk janë ushtruar deri në momentin e mbylljes, me mirëkuptimin e palës, bëhet zëvendësimi me të drejta të reja përdorimi në pjesë të tjera të varrezës apo, sipas rastit, në varreza të tjera, ose bëhet kthimi i pagesave, në rastet kur është bërë prenotimi i varrit.

3. Vendimi për mbylljen e varrezës merret nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe bëhet publik.

4. Kur mbyllja e varrezës bëhet për shkak të nevojës për ndërtime me destinacion tjetër, atëherë varreza i nënshtrohet procedurës së prishjes. Prishja kryhet në përfundim të afatit sipas nenit 13 të ligjit. Prishja e varrezës vendoset nga një komision i posaçëm, i ngritur nga këshilli i njësisë bazë të qeverisjes vendore, i cili harton dokumentin përkatës për verifikimin e gjendjes së plotë të varrezës, pasi është marrë mendimi i strukturës rajonale të shëndetit publik.

5. Vendimi për prishjen e varrezës merret nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe bëhet publik.

6. Për të drejtat e përdorimit, të cilat janë në fuqi deri në momentin e prishjes, bëhet zëvendësimi me të drejta të reja përdorimi në pjesë të tjera të varrezës apo, sipas rastit, në varreza të tjera. Në këtë rast, të vdekurit zhvendosen në varre të reja. Shpenzimet për zhvendosjen, rivarrimin dhe veshjen e dekorimin e ri të varreve nuk u ngarkohen familjarëve.

Neni 13

Përdorimi i varrezës së prishur

1. Toka e një varreze, për të cilën është vendosur prishja, nuk destinohet për përdorim tjetër pa kaluar 15 vjet nga varrimi i fundit që bëhet në të. Gjatë kësaj periudhe, kjo varrezë mbetet nën mbikëqyrjen e njësisë bazë të qeverisjes vendore, e cila organizon mirëmbajtjen e saj.

2. Përpara se të përdoret për qëllim tjetër, nga toka e varrezës duhet të hiqen me kujdes eshtrat në një thellësi jo më të madhe se 2 m dhe ato vendosen në ndërtesën e përbashkët të vendosjes së eshtrave ose në varrezën e re.

Neni 14

Materialet dhe shenjat funebre të varrezës së prishur

(Shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Materialet mbitokësore të varrezave, monumentet dhe shenjat funebre, të vendosura mbi varret që do të prishen, mbeten në pronësi të familjarëve, të cilët mund t'i transportojnë ato në varrezën e re.

2. Në rastet kur familjarët refuzojnë ta bëjnë këtë, këto materiale kalojnë në pronësi të njësisë bazë të qeverisjes vendore.

3. Shfuqizuar.

KREU VI

MËNYRA E VARRIMIT

Neni 15

Varrimi nëntokësor

(Ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrimi nëntokësor bëhet në gropa të gërmuara dhe më pas të mbuluara me dhe. Kufomat duhet të vendosen në arkivole të mbyllura druri ose materiali tjetër të ngjashëm, që të dekompozohen me lehtësi, me përjashtim të rasteve kur kufoma transportohet nga jashtë njësisë bazë të qeverisjes vendore për në vendvarrim me arkivol metalik. Çdo varr dallohet nga bordura anësore, pllaka e varrit, sipas një numri progresiv dhe identifikimi i kufomës.

2. Fushat e destinuar për këtë lloj varrimi shtrihen në toka të përshtatshme nga pikëpamja e strukturës gjeologjike dhe mineralogjike për vetitë mekanike dhe fizike, si dhe për nivelin e shtresës hidrike sipas rregullave teknike për ndërtimin dhe projektimin e varrezave.

3. Shfuqizuar.

Neni 16

Varrimi mbitokësor

(Shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrimi mbitokësor ka të bëjë me vendosjen e kufomës në një dhomë të mbyllur hermetikisht me mur ose me pllaka guri. Në këtë mënyrë mund të vendosen edhe kufomat e balsamosura.

2. Kufomat e destinuar për varrim mbitokësor duhet të vendosen në arkivole me mure të dyfishta, njëri prej druri dhe tjetri prej metali.

3. Në arkivolin e jashtëm vendoset pllaka metalike, ku shënohen emri, mbiemri, data e lindjes dhe e vdekjes së kufomës.

4. Shfuqizuar.

Neni 16/a

Varrimi me kremim

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Varrimi me kremim bëhet në varreza, sipas parashikimeve të rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave.

2. Zhvarrimi i urnës mund të bëhet vetëm pas kalimit të afatit të përdorimit. Pas zhvarrimit, urna administrohet sipas rregullores së administrimit dhe funksionimit të varrezës.

3. Nuk lejohet marrja e urnës nga familjarët. Nuk lejohet administrimi i saj jashtë procedurave të parashikuara nga ky ligj.

Neni 16/b

Konservimi dhe balsamimi i kufomave

(Shtuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Kufomat që i nënshtrohen varrimit nëntokësor lejohet të konservohen ose të balsamosen vetëm nëse varrezës i është lejuar varrimi i kufomave të tilla. Kjo mënyrë nuk zbatohet kur kufomat transportohen jashtë shtetit.

2. Nuk lejohet konservimi ose balsamimi i kufomave pa u lëshuar certifikata e vdekjes.

KREU VII

MËNYRAT E ZHVARRIMIT

Neni 17

Zhvarrime të zakonshme nga nëntoka

(Ndryshuar afati në pikat 1 dhe 2, me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Zhvarrimet e zakonshme nga nëntoka kryhen pas një periudhe 15-vjeçare nga viti i varrimit. Varret e liruara nga mbeturinat e arkivolit përdoren për varrime të reja.

2. Në rastet kur vërtetohet se pas periudhës 15-vjeçare nuk sigurohet mineralizimi i plotë i kufomave, bëhet zgjatja e kësaj periudhe me miratim të mjekut ligjor dhe, në mungesë të tij, të mjekut anatomo-patolog. Në rast se edhe pas kësaj periudhe nuk realizohet mineralizimi i plotë i kufomave, Ministria e Shëndetësisë vendos për transferimin ose jo të varrezave.

3. Kur vërtetohet se në një varrezë, për shkak të kushteve të veçanta të përbërjes apo strukturës së tokës, mineralizimi i kufomave kryhet për një periudhë më të shkurtër, mjeku ligjor dhe, në mungesë të tij, mjeku anatomo-patolog autorizon shkurtimin e kësaj periudhe jo më pak se 5 vjet.

4. Kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore lëshon lejet për zhvarrimet e zakonshme nga nëntoka, të cilat kryhen nga shërbimi i varrezave që administron varrezat.

Neni 18

Zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka

1. Kufomat mund të zhvarrosen përpara periudhës së caktuar, me urdhër të gjyqtarit ose prokurorit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale ose me autorizimin paraprak të kryetarit të njësisë bazë të qeverisjes vendore, për t'i transportuar në varr tjetër.

2. Për zhvarrimet e jashtëzakonshme nga nëntoka, të urdhëruara nga gjyqtari ose prokurori, kufomat duhet të transportohen në sallat e autopsisë, duke respektuar kërkesat e bëra nga këto organe.

3. Të tilla zhvarrime duhet të kryhen në prani të grupit të mjekëve ligjorë, përfaqësues të organeve që e kanë kërkuar zhvarrimin dhe të të ngarkuarit me shërbimin e varrezave.

Neni 19

Rastet kur nuk mund të kryhen zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka

Përveç rasteve të urdhëruara nga gjyqtari ose prokurori, nuk kryhen zhvarrime të jashtëzakonshme nga nëntoka:

a) në muajt maj, qershor, korrik, gusht dhe shtator, duke përjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me varreza malore, ku lejohen procedurat e zhvarrimeve edhe në muajt e mësipërm;

b) në rastet e kufomave të personave të vdekur nga sëmundje infektive, përveç rasteve kur ka kaluar 2 vjet nga data e varrimit dhe kur zhvarrimi kryhet në përputhje me masat për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

Neni 20

Depozitimi i eshtrave të zhvarrosura nga nëntoka

1. Eshtrat, që mblidhen si rezultat i zhvarrimeve të zakonshme, duhet të grumbullohen në vendin e tyre të përbashkët, me përjashtim të rasteve kur varrosen në një parcelë të veçantë.

2. Eshtrat, si rezultat i zhvarrimeve të zakonshme, mund të groposen në të njëjtin varr me një kufomë tjetër, sipas kërkesës së familjarëve.

3. Të gjitha mbeturinat e varrezave konsiderohen si mbeturina të veçanta dhe duhet të asgjësohen.

Neni 21

Zhvarrime të zakonshme mbitokësore

1. Zhvarrimet mbitokësore kryhen në mbarim të periudhës së lejes, që varion nga 5 deri në 20 vjet dhe bëhen me autorizim të kryetarit të njësisë bazë të qeverisjes vendore.

2. Arkivolet e zhvarrosura varrosen nën tokë, pasi arkivolit t'i hapen disa të çara të përshtatshme, për të lejuar fillimin e procesit të mineralizimit të kufomës.

3. Kur kufomat e zhvarrosura gjenden në kushtet e një mineralizimi të plotë, me miratimin e mjekut anatomo-patolog, nga ndërmarja që administron varrezat mund të merren masa për mbledhjen e eshtrave në kasën e tyre.

Neni 22

Ndalimi i zvogëlimit të përmasave të kufomave

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Ndalohet çdo veprim që ka të bëjë me zvogëlimin e përmasave të kufomës së varrosur mbi tokë, për ta futur në një arkivol me përmasa më të vogla se ato fillestare të arkivolit, me të cilin është varrosur.

2. Për rastet e parashikuara si vepër penale nga neni 118 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, shërbimi i varrimit të varrezave bën kallëzim për ndjekje penale dhe ndërkohë vë në dijeni kryetarin e njësisë bazë të qeverisjes vendore.

Neni 23

Zhvarrimet e jashtëzakonshme mbitokësore

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore autorizon zhvarrimin mbitokësor të arkivoleve të destinuara për t'u transportuar në një vend tjetër pas çdo periudhe kohe dhe në çdo muaj të vitit, me kusht që, pas hapjes së varrit mbitokësor, autoriteti sanitar vendor të verifikojë gjendjen e rregullt të arkivolit dhe të deklarojë se transferimi i tij nuk përbën asnjë rrezik për shëndetin publik.

2. Kur autoriteti sanitar i sipërpërmendur vëren se arkivoli nuk është në gjendje të rregullt, mund të lejojë transferimin e tij, vetëm pasi të sistemohet në mënyrë të përshtatshme, sipas normave të përcaktuara në zbatim të këtij ligji dhe rregullores së administrimit dhe funksionimit të varrezave.

KREU VIII

TRANSPORTIMI I KUFOMËS

Neni 24

Transportimi i kufomës në varrezë

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Transportimi i kufomës nga vendi i vdekjes deri në morg ose në varrezë bëhet me automjete të mbyllura dhe nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e policisë bashkiake ose komunale.

2. Ndalohet të kryhet transportimi i kufomave përpara periudhës së observimit, të këshilluar nga grupi mjekësor, gjatë së cilës mund të shfaqen raste eventuale të kthimit në jetë.

3. Automjetet e varrimit duhet të plotësojnë kushte të veçanta, të cilat përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 25

Leja për transportimin e kufomave

1. Transportimi i kufomave nga një njësi bazë e qeverisjes vendore në një tjetër autorizohet nga kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore, ku ka ndodhur vdekja.

Kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore pritëse duhet të lajmërohet për ardhjen e kufomës. Autorizimi i dorëzohet përgjegjësit të shërbimit të varrezave.

2. Për rastet kur kërkohet vendosja e kufomës në njësinë bazë të qeverisjes vendore të tjera ndërmjetëse, për kryerjen e nderimeve të veçanta, autorizimi i lëshuar nga kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore u njoftohet edhe kryetarëve të njësisë vendore ndërmjetëse.

3. I ngarkuari për transportimin e kufomës jashtë njësisë bazë të qeverisjes vendore pajiset me autorizimin e kryetarit të njësisë bazë të qeverisjes vendore, ku ka ndodhur vdekja.

4. Nëse transportimi kryhet me hekurudhë, anije ose avion, autorizimi i mësipërm duhet t'i dorëzohet transportuesit gjatë kryerjes së transportit.

Neni 26

Transportimi i mbetjeve mortore

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Transportimi i mbetjeve mortore, përveç autorizimit të përmendur në nenin 25, të ligjit, shoqërohet edhe me autorizimin e strukturës rajonale të shëndetit publik.

2. Mbetjet mortore futen në çdo rast në kaseta zinku, me trashësi jo më të vogël se 0,6 mm, dhe mbyllen me saldim. Mbi kasetë shënohen emri dhe mbiemri i kufomës.

3. Në rast se mbetjet mortore janë të gjetura dhe nuk është i mundur identifikimi i tyre, në kasetë shënohen vendi dhe data e gjetjes.

Neni 27

Transportimi i kufomave dhe/ose mbetjet mortore për dhe nga jashtë shtetit

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Kufomat dhe/ose mbetjet mortore, që transportohen për dhe nga jashtë shtetit, duhet të jenë të shoqëruara nga një dokument i veçantë. Ky dokument lëshohet nga prefekti, për kufomat që nxirren nga territori shtetëror dhe nga autoriteti përgjegjës i shtetit nga sillet kufoma, për kufomat që hyjnë në territorin shtetëror.

2. Për futjen në vend të kufomave dhe/ose mbetjeve mortore, që vijnë nga shtetet e tjera, i interesuari për transportimin e kufomës duhet të paraqesë, nëpërmjet autoriteteve përkatëse ose personalisht, në autoritetin konsullor shqiptar, në shtetin ku ka ndodhur vdekja:

- a) kërkesën për lejen e transportimit të kufomës dhe/ose mbetjet mortore për në Shqipëri;
- b) certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse;
- c) certifikatën e organeve përgjegjëse, që vërteton se janë respektuar të gjitha kushtet sanitare për transportimin e kufomës dhe/ose mbetjet mortore.

Dokumentacioni i mësipërm paraqitet nga i interesuari me rrugë postare ose me faks.

Për shtetet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi diplomatike, kërkesa e mësipërme dërgohet në përfaqësinë, nga e cila mbulohet ai shtet.

3. Autoriteti konsullor shqiptar, pasi kontrollon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur dhe pasi bën verifikimin në autoritetet përkatëse që kanë lëshuar dokumentet e mësipërme, lëshon lejen për futjen e kufomës në Republikën e Shqipërisë. Leja i lëshohet drejtpërdrejt të interesuarit dhe autoritetit përkatës me postë ose me faks. Autoriteti konsullor shqiptar njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, ministrinë që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike dhe prefektin e qarkut ose kryetarin e njësisë vendore ku do të çohet kufoma dhe/ose mbetjet mortore.

4. Për ekstradimin nga vendi të kufomave dhe/ose mbetjet mortore për në një shtet tjetër, i interesuari duhet t'i drejtojë një kërkesë prefektit të qarkut, ku ndodhet kufoma dhe/ose mbetjet mortore, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

a) miratimin për futjen e kufomës dhe/ose mbetjet mortore nga autoriteti konsullor i shtetit, në të cilin do të çohet kufoma;

b) certifikatën e organeve shëndetësore përgjegjëse, ku vërtetohet se janë respektuar të gjitha kushtet sanitare për transportimin e kufomës **dhe/ose mbetjet mortore**.

5. Prefekti, pasi merr kërkesën, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, lëshon autorizimin, duke njoftuar prefektin e qarkut të pikës kufitare nga do të kalojë kufoma dhe/ose mbetjet mortore.

6. Masa e shpenzimeve, procedura që do të ndiqet, institucioni që do të ngarkohet për përballimin e shpenzimeve të varrimit, për shtetasit shqiptarë që vdesin jashtë vendit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Kushtet e veçanta për transportimin e kufomave

1. Kufomat e destinuar për ekstradim jashtë territorit të vendit ose që duhet të transportohen në njësitë bazë të qeverisjes vendore dhe me mjetin e zgjedhur të transportit mund të arrijnë vetëm pas 24 orëve, ose kur transportimi kryhet pasi kanë kaluar 48 orë nga çasti i vdekjes, duhet t'i nënshtrohen trajtimit antiprishje, duke injektuar në trupin e kufomës të paktën 500 cc formalinë, pasi të ketë kaluar periudha e observimit.

2. Kufomat që janë balsamosur nuk u nënshtrohen këtyre kushteve.

Neni 29

Transportimi i të vdekurve me sëmundje infektive

Kur vdekja ka ardhur si pasojë e një sëmundjeje infektive, ngjitëse, që bën pjesë në listën e veçantë të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë, transportimi i kufomës u nënshtrohet rregullave të veçanta, të përcaktuara me udhëzim të ministrit që mbulon këtë veprimtari.

KREU IX

SANKSIONET NDAJ SHKELËSVE

Neni 30

(Ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 dhe pika 2 me ligjin nr. 80/2014, datë 17.7.2014)

1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) për shkelje të nenit 5 të këtij ligji, gjoba është në vlerën 30 000 lekë;

b) për shkelje të neneve 4 pikat 1 dhe 2, 7/a, 16 pikat 1 dhe 2, 17, 18 pika 3, 19 shkronjat "a" dhe "b", gjoba është në vlerën 20 000 lekë;

c) për shkelje të nenit 24 pikat 1 dhe 3, 25 pika 1, 28 pika 1, gjoba është në vlerën 25 000 lekë.

2. Policia bashkiake dhe policia komunale janë organet që vendosin gjobën dhe bëjnë ekzekutimin e saj, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Në rast përsëritjeje të shkeljeve, policia bashkiake ose komunale bën pezullimin ose ndërprerjen e veprimtarisë për subjektet shkaktare.

4. Kur këto shkelje përbëjnë vepër penale, policia bashkiake ose komunale bën kallëzim për ndjekje penale.

Neni 31

Ankimi

1. Ankimi kundër vendimit të policisë bashkiake ose policisë komunale bëhet te kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore duhet t'i përgjigjet ankimit brenda afatit kohor prej 30 ditësh.

2. Ankimi kundër vendimit të kryetarit të njësisë bazë të qeverisjes vendore apo kur ky i fundit nuk kthen përgjigje brenda afatit kohor të përcaktuar më sipër, bëhet brenda 30 ditëve nga marrja ose jo e njoftimit në gjykatën e rrethit.

Neni 32

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 27 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 3, 8, 15 pika 3 dhe 16 pika 4.

3. Ngarkohen ministri që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike, ministri që mbulon veprimtarinë e transportit dhe Ministri i Shëndetësisë të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të nenit 24 të këtij ligji.

4. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 të këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4225, datë 14.5.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ **Nr. 152/2015**

PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN⁸

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Objekti**

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat, statusin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon veprimtarinë, marrëdhëniet e punës, garantimin e karrierës dhe vazhdimësinë në detyrë të punonjësve të këtij shërbimi.

Neni 2 **Misioni**

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në vijim shërbimi i MZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

⁸ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 240, datë 7 janar 2016.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akti i ekspertimit të zjarrit” është akti administrativ, i përpiluar për çdo zjarr të rënë dhe i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, me kërkesë të institucioneve të prokurorisë dhe gjykatës, të shtetasve, personave fizikë e juridikë.
2. “Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri” është akti administrativ, i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.
3. “Evakuim” është lëvizja e organizuar e personave në një vend më të sigurt, në rast të një zjarri apo rreziqeve e fatkeqësive të tjera.
4. “Fatkeqësi natyrore” janë tërmetet, përmytjet, thatësirat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet tektonike, ortelet, erërat e forta, zjarret masive në pyje, të cilat rrezikojnë jetën e njeriut, gjësë së gjallë dhe pronën, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore, të cilat kërkojnë ndërhyrjen e shërbimit zjarrfikës dhe të forcave të tjera operuese.
5. “Fatkeqësi të tjera” janë aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, zjarret e përmasave të mëdha, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale, dhe çdo lloj tjetër aksidenti i shkaktuar nga veprimi njerëzor, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, mjedisin, si dhe format e tjera të dhunës masive, të cilat kërkojnë ndërhyrjen e shërbimit zjarrfikës dhe të forcave të tjera operuese.
6. “Hidrantë zjarrfikës” janë pjesë të sistemit hidrik, të cilat shërbejnë për marrjen e ujit nga tubacionet e rrjetit ujësjellës apo burime të tjera uji për shuarjen e zjarrit.
7. “Inspektim për mbrojtjen nga zjarri” është kontrolli që kryhet nga strukturat e shërbimit të MZSH-së për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, për mbrojtjen nga zjarri.
8. “Inspektor për mbrojtjen nga zjarri” është punonjësi i strukturave të shërbimit të MZSH-së, i autorizuar për inspektimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
9. “Masat parandaluese të rënies së zjarrit” është tërësia e masave të marra për zbatimin e normave dhe standardeve, që nga projektimi i objektit, ndërtimi, kompletimi, instruktimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e masave dhe mjeteve të sinjalizimit dhe shuarjes së zjarrit.
10. “Ministri” është ministri përgjegjës për hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
11. “Ministria përgjegjëse” është ministria që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e përgjegjësisë shtetërore për punët e çështjet e brendshme, për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të pronës nga rreziku i zjarrit dhe i fatkeqësive të tjera, në përputhje me legjislacionin përkatës.
12. “Ndërhyrje operuese zjarrfikëse” është puna e përditshme e shërbimit zjarrfikës, për realizimin dhe kryerjen e misionit të saj, të gjitha ndërhyrjet e menjëhershme të strukturave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, vetëm apo në bashkëpunim me shërbimet të tjera, Policinë e Shtetit, shërbimin e urgjencës mjekësore, Forcat e Armatosura etj., për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut dhe pronës në raste zjarri, aksidentesh, incidentesh dhe emergjencash të ndryshme.
13. “Norma teknike” janë rregulla që përfshijnë sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, të miratuara me ligje apo akte nënligjore të veçanta.
14. “Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtim” është tërësia e masave tekniko-organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.
15. “Pajisje të tjera zjarrfikëse dhe të shpëtimit” janë të gjitha ato pajisje që shërbejnë për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin e jetës, pronës e mjedisit nga rreziku i zjarrit dhe fatkeqësive të tjera natyrore.

16. “Projekt për mbrojtjen nga zjarri” është paraqitja grafike, shoqëruar me relacionin teknik përkatës të mbrojtjes pasive dhe aktive, e tërësisë së masave për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, për planet zhvillimore, strukturat, konstruksionet, ndërtimet, pyjet, kullotat dhe objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas funksionit të tyre.

17. “Punonjës administrativ” është punonjësi që kryen veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtjeje, shërbimi, ruajtjeje dhe nuk ushtron një funksion publik.

18. “Qendra të monitorimit të sistemeve të diktim-sinjalizimit” janë qendrat, të cilat kryejnë monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të diktim-sinjalizimit të zjarrit në objekte të ndryshme.

19. “Rrezik zjarri” është situata e krijuar nga akumulimi i faktorëve që nxitin mundësinë e nisjes së zjarrit dhe zhvillimit të tij.

20. “Sisteme të diktim-sinjalizimit” janë pajisje që diktojnë, sinjalizojnë shfaqjen e tymit, gazrave dhe zjarrit.

21. “Stacion zjarrfikës” është pjesë e infrastrukturës operuese të shërbimit të MZSH-së, që vepron në një territor të caktuar, kompletuar me personel zjarrfikës, automjete dhe pajisje zjarrfikëse, për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin.

22. “Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri” është organizimi i strukturës vullnetare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, nga organet e njësitë e qeverisjes vendore, nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari të tyre në Republikën e Shqipërisë, nga institucione dhe agjenci shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarri.

23. “Shpëtimi” është tërësia e veprimeve operuese në rast aksidentesh, situatash e fatkeqësish të ndryshme, për mbrojtjen e jetës dhe pronës.

24. “Zjarr” është dukuria e djegies, e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese.

25. “Zjarr normal” është zjarri që shkakton dëm, për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të bashkisë.

26. “Zjarr masiv” është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

27. “Zjarr me përmasa të mëdha” është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

28. “Zjarrfikës” është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe të pronës.

29. “Ekspert zjarrfikës privat” është personi fizik dhe juridik, i certifikuar, i cili harton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kryen aktin e ekspertizës për zjarrin e rënë, kryen trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas dispozitave të këtij ligji.

KREU II

STATUSI, SIMBOLET, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Neni 4

Statusi i shërbimit të MZSH-së

1. Shërbimi i MZSH-së është institucion i administratës publike, me status të veçantë.

2. Statusi i punonjësit të shërbimit të MZSH-së rregullohet:

a) sipas këtij ligji për punonjësit e shërbimit të MZSH-së me grada;

b) sipas Kodit të Punës për punonjësit administrativë.

3. Statusi i shërbimit nuk ndryshon edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.

Neni 5 **Simbolet**

Shërbimi i MZSH-së ka uniformën, me shenjat dalluese përkatëse, gradat, flamurin dhe stemën e vet, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6 **Punonjësit e shërbimit**

1. Punonjësit e shërbimit të MZSH-së ndahen në dy kategori:
 - a) punonjës operacional, inspektues, drejtues, i cili mban gradë;
 - b) punonjës pa grada, në funksione admini-strative.
2. Rregullat dhe procedurat për kërkesat e përgjithshme të pranimit, marrëdhëniet e punës, të trajnimit, ecurisë në karrierë dhe ndërprerjes së saj, për klasifikimin e niveleve, sipas funksioneve organike, përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grup, si dhe emërtesat e pozicioneve përcaktohen në rregulloren e shërbimit të MZSH-së, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7 **Organizimi i strukturës së shërbimit**

1. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin organizohet në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin përfaqëson nivelin qendror; strukturat e shërbimit të MZSH-së në bashki përfaqësojnë nivelin vendor dhe organizohen në drejtori ose sektorë.
2. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, në varësi të ministrit, përfaqëson autoritetin më të lartë teknik, mbikëqyrës dhe drejtues të shërbimit të MZSH-së. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së organizohet në drejtori me funksione inspektimi, koordinimi, trajnimi dhe logjistike.
3. Drejtoria ose sektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor është në varësi të kryetarit të bashkisë. Ajo përfaqëson strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion.
4. Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse.
5. Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë.
6. Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se 14 zjarrfikës, personel profesionist.

Neni 8 **Ministri**

1. Ministri:
 - a) përcakton objektivat për zbatimin e politikave të përgjithshme dhe të programit të qeverisë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;
 - b) orienton zbatimin e politikave të veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së, me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga zjarri dhe shpëtimin shkallë vendi.
2. Ministri nxjerr udhëzime, në zbatim të ligjit, për të unifikuar veprimtarinë e shërbimit të MZSH-së, të cilat janë të detyrueshme për çdo bashki, institucion, subjekt privat apo shtetëror.

Neni 9

Kryetari i bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto përgjegjësi:

- a) merr masa për ngritjen dhe kompletimin me mjete e pajisje të stacioneve për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, të shërbimit të MZSH-së në territorin e bashkisë, sipas standardeve e normave në fuqi;
- b) planifikon fondet e shërbimit të MZSH-së, nga buxheti i bashkisë, për çdo vit;
- c) siguron gatishmërinë e përhershme të stacioneve të shërbimit zjarrfikës me automjete, pajisje speciale, personel zjarrfikës dhe i vë ato në dispozicion për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin jetës, pronës, në çdo rast aksidenti, incidenti apo fatkeqësie dhe emergjencash të ndryshme në territorin e bashkisë;
- ç) kërkon dhe detyrohet të japë ndihmë me personel, automjete e pajisje nga stacionet zjarrfikëse të tij, nga/për bashkitë fqinje ose më gjerë, në raste zjarresh masive, emergjencash dhe fatkeqësish të tjera;
- d) bashkërendon veprimet e shërbimit zjarrfikës me forcat e tjera operuese që gjenden e veprojnë në territorin e bashkisë;
- dh) merr masa për mbajtjen në gjendje funksionimi të rrugëve të kalimit, për automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse;
- e) kërkon nga institucionet përgjegjëse kompletimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në objektet e çdo lloji, pyjet, kullotat etj., që gjenden në territorin e bashkisë;
- ë) kërkon instalimin dhe kompletimin me sisteme hidrike funksionale për shërbimin e MZSH-së, konform normave dhe standardeve në fuqi, në gjithë territorin e bashkisë;
- f) kërkon për çdo objekt, për miratimin e lejeve zhvillimore/ndërtimore, projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
- g) jep leje zhvillimi/ndërtimi dhe akte shfrytëzimi të strukturave ndërtimore vetëm pas plotësimit të rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të përcaktuara në këtë ligj;
- gj) planifikon fonde për trajnimin, kualifikimin periodik dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit zjarrfikës që ka në juridiksion;
- h) siguron, nëpërmjet mjeteve të informimit publik që ka në dispozicion, informimin për edukimin e komunitetit me njohuritë dhe masat e mbrojtjes kundër zjarrit;
- i) vendos lidhje dhe bashkëpunon me partnerë ose dhurues të shteteve të tjera, për të siguruar asistencë teknike, kualifikime e specializime për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe për furnizimin materialo-teknik të stacioneve zjarrfikëse;
- j) merr masa organizative e teknike dhe planifikon fonde financiare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin edhe në projektet e veprave që hartohen dhe miratohen nga ana e tyre.

Neni 10

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së

Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së ka këto detyra:

- a) harton rregullore për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) harton dhe unifikon metodologjinë për masat e parandalimit, ndërhyrjes dhe inspektimit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
- c) bashkëpunon me kryetarin e bashkisë për zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore;
- ç) bashkërendon dhe koordinon veprimtarinë e stacioneve të MZSH-ve të bashkive dhe urdhëron ndërhyrjen me forca, automjete e pajisje zjarrfikëse të tyre në rastet e zjarreve masive apo situatave të tjera, për operacione komplekse shpëtimi, që kërkojnë ndërhyrjen e njësisë të shërbimit nga disa bashki;

d) bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e shërbimit të MZSH-së me strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, të Mbrojtjes Civile, Shërbimit të Urgjencës Mjekësore dhe të institucioneve të tjera qendrore, për rritjen e sigurisë publike;

dh) mban e përpunon statistika për aktivitetin e veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikat;

e) bashkëpunon me institucionet, organizmat të tjera ndërkombëtare, shërbimet homologe, subjektet jopublike dhe organizatat joqeveritare;

ë) organizon kualifikimin, trajnimin e personelit të shërbimit vendor të MZSH-së, të personelit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin të objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike dhe të shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në Akademinë e Sigurisë dhe qendrat e tjera të sigurisë e të inspektimit;

f) raporton te ministri për përmbushjen e detyrave të mësipërme;

g) kryen detyra të tjera, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Detyrat e drejtorisë/ sektorit të shërbimit vendor

Drejtoria/ sektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor ka këto detyra:

a) marrjen e masave të inspektimit, parandalimit dhe ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin në territorin e bashkisë;

b) drejtimin e shërbimit të MZSH-së për gatishmërinë e personelit, të automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse;

c) zbatimin e ligjshmërisë, zbatimin e masave inspektuese dhe parandaluese për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në të gjitha objektet në territorin e bashkisë;

ç) bashkëpunimin, koordinimin e veprimeve të strukturave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin me strukturat e tjera operuese dhe inspektuese që veprojnë në territorin e bashkisë;

d) mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të shërbimit të MZSH-së, si dhe përpilimin e statistikave për aktivitetin dhe veprimtarinë e shërbimit në nivel vendor, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike dhe të shërbimit vullnetar;

e) drejton dhe përgjigjet për rritjen e aftësive profesionale të personelit të MZSH-së, të shërbimit vullnetar, për zbatimin e programit të përgatitjes së tyre profesionale, dhe zhvillon mësim tregues për dhënien e njohurive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 12

Shërbimi i MZSH-së në objektet me rëndësi ekonomike, strategjike

1. Në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike në shkallë vendi, në porte, aeroporte, tunele, në zonat e mbrojtura natyrore, linja magjistrale të transportit të gazit e të karburanteve ngrihen stacione të shërbimit të MZSH-së. Lista e këtyre objekteve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Subjektet që i kanë në pronësi apo përgjegjësi administrimi objektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, zbatojnë legjislacionin në fuqi, normat teknike dhe standardet ndërkombëtare në fushën e MZSH-së, si dhe kompletojnë stacionet me automjete dhe pajisje speciale zjarrfikëse.

3. Punonjësit e stacioneve të shërbimit të MZSH-së janë në përbërje e limit organik të institucioneve, subjekteve që i administrojnë ose që i kanë ato në pronësi. Kriteret e punësimit të punonjësve janë ato të përcaktuara në këtë ligj.

4. Punonjësit e stacioneve të shërbimit të MZSH-së në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike emërohen nga subjekti që i ka ato në pronësi apo administrim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 13
Shërbimi vullnetar i MZSH-së

1. Në bashki krijohet shërbimi vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me këtë ligj, dhe ai bëhet pjesë e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor.

2. Struktura, uniforma dhe shenjat dalluese të veçanta, të punonjësit të shërbimit vullnetar të MZSH-së, miratohen me vendim të këshillit bashkiak.

KREU III
EMËRIMI DHE LIRIMI NGA SHËRBIMI I MZSH-SË

Neni 14
Kriteret e pranimit për nivelet në shërbimin e MZSH-së

Punonjësit e shërbimit të MZSH-së ndahen në punonjës të nivelit bazë, të mesëm, të lartë dhe madhor.

1. Kriteret e pranimit për nivelin bazë të këtij shërbimi janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) të jetë i/e moshës nën 30 vjeç;
- ë) të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës.

2. Kriteret e pranimit për nivelin e mesëm janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë përfunduar arsimin e lartë policor, ushtarak, juridik ose inxhinieri, niveli minimal i diplomës “*Bachelor*”;
- c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike;
- d) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje.

3. Kriteret e pranimit për nivelin e lartë janë:

- a) në këtë nivel konkurrojnë dhe pranohen ata persona që plotësojnë kërkesat e pikës 2 të këtij neni;
- b) të ketë punuar në nivelin e mesëm në strukturat e shërbimit MZSH-së jo më pak se 10 vjet dhe të mbajë gradën maksimale të nivelit të mesëm.

4. Për nivelin madhor konkurrojnë ata persona që plotësojnë kërkesat e pikës 3, të këtij neni, që kanë punuar në nivelin e lartë të shërbimit të MZSH-së jo më pak se 10 vjet, dhe që mbajnë gradën maksimale për nivelin e lartë.

Neni 15

Emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i personelit të shërbimit të MZSH-së

1. Emërimi, lirimi dhe përjashtimi i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së bëhet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës.

2. Emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së bëhet nga ministri përgjegjës, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së.

3. Emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i punonjësve të nivelit të lartë dhe të mesëm të shërbimit vendor të MZSH-së bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së, me propozim të kryetarit të bashkisë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

4. Emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i punonjësve të nivelit bazë të shërbimit vendor të MZSH-së bëhet nga drejtori ose shefi i sektorit të shërbimit të MZSH-së, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

5. Ndarja e funksioneve, nivelet, detyrat, rolet, procedurat e konkurrimit e të përzgjedhjes së kandidaturave për emërim, si edhe procedurat për lirim, pezullimin e përjashtimin, përcaktohen në rregulloren e shërbimit të MZSH-së.

Neni 16

Pranimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës në funksione administrative të shërbimit të MZSH-së

Pranimi dhe largimi i punonjësve në/nga funksionet administrative bëhet me urdhër të titullarit të strukturës qendrore ose vendore të MZSH-së, sipas Kodit të Punës.

Neni 17

Lirimi, pezullimi, përjashtimi dhe rikthimi i punonjësit të MZSH-së

Punonjësi i shërbimit të MZSH-së ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet nga ky shërbim.

1. Punonjësi i MZSH-së lirohet nga shërbimi në rastet kur:

- a) deklarohet i paaftë për punë, nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;
- b) mbush moshën për pension pleqërie;
- c) kërkon të lirohet me dëshirën e tij;
- d) konstatohet pavlefshmëria e aktit administrativ të pranimit;
- e) vdes, apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së tij;
- dh) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- e) i shkurohet funksioni organik.

2. Rregullat dhe procedurat për pezullimin disiplinor të punonjësit të shërbimit të MZSH-së përcaktohen në rregulloren e MZSH-së.

Në rastet e nisjes së procedimit penal ndaj punonjësit të shërbimit të MZSH-së, pezullimi fillon në momentin kur punonjësi merret në cilësinë e të pandehurit nga organi i ngarkuar me ligj.

3. Një person mund të rikthehet në shërbimin e MZSH-së vetëm nëse ai ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me strukturat e tij brenda 5 viteve të fundit.

4. Punonjësi i MZSH-së përjashtohet nga shërbimi në rastet kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
- b) ndaj tij merret masa disiplinore e përjashtimit nga shërbimi i MZSH-së.

5. Rregullat dhe procedurat e vlerësimit, të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, të ankimit, rikthimit në shërbim, përcaktohen në rregulloren e MZSH-së.

Neni 18
Mbrojtja e veçantë

1. Çdo veprim a mosveprim tjetër i paligjshëm ndaj punonjësit të MZSH-së, për shkak ose gjatë kryerjes së detyrës, dënohet sipas dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal.

2. Kur atij, për shkak të shërbimit, i rrezikohet jeta, familja ose i dëmtohet prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19
Kufizimi i të drejtave politike dhe i të drejtës së grevës

Punonjësi me grada i shërbimit të MZSH-së:

- a) nuk ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo të shprehë publikisht bindjet dhe preferencat e tij politike;
- b) nuk mund të jetë anëtar i një partie apo organizate politike dhe me veprimtarinë e tij nuk duhet të cenojë natyrën e depolitizuar të institucionit;
- c) nuk ka të drejtën e grevës.

Neni 20
Marrëdhëniet me sindikatat

1. Në shërbimin e MZSH-së lejohet krijimi dhe zhvillimi i veprimtarive sindikaliste, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e interesave të punonjësve.

2. Çdo punonjës, me përjashtim të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, ka të drejtë të jetë anëtar sindikate.

3. Punonjësit të shërbimit të MZSH-së, gjatë veprimtarive sindikaliste, i ndalohej të mbajë uniformën apo të përdorë mjetet e shërbimit.

KREU IV
GRADAT

Neni 21
Sistemi i gradave

Sistemi i gradave përcakton hierarkinë dhe nivelin e funksionimit e menaxhimit të shërbimit të MZSH-së. Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese.

Neni 22
Gradat

1. Gradat, për punonjësit operacionalë, inspektues e drejtues në shërbimin e MZSH-së, sipas rendit hierarkik rritës, emërtohen, si më poshtë:

Niveli bazë:

- a) “Asistent zjarrfikës”;
- b) “Zjarrfikës”;
- c) “Kryezjarrfikës”.

Niveli mesëm:

- a) “Inspektor zjarrfikës”;
- b) “Kryeinspektor zjarrfikës”;
- c) “Komisar zjarrfikës”.

Niveli lartë:

- a) “Drejtues zjarrfikës”;
- b) “Drejtues i parë zjarrfikës”.

Niveli madhor: “Drejtues i lartë zjarrfikës”.

2. Kriteret e ecures dhe fitimit të gradave, tabela e njësimit të funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të gradave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Hierarkia e gradave

Hierarkia e punonjësve të shërbimit të MZSH-së përcaktohet nga grada, nga funksioni, për punonjësit me të njëjtën gradë, dhe nga vjetërsia në gradë, për punonjësit me gradë e funksion të njëjtë.

Neni 24

Dhënia e gradës

1. Gradat e nivelit të lartë dhe madhor jepen nga ministri përgjegjës, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradave.

2. Gradat e nivelit të mesëm dhe bazë jepen nga Drejtori i Përgjithshëm i shërbimit të MZSH-së, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradave.

3. Përbërja dhe funksionimi i komisioneve të vlerësimit të gradave përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 25

Kriteret për fitimin e gradës

1. Për fitimin e gradës, punonjësi i MZSH-së duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të përmbushë kriteret për pozicionin e punës;
- b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj;
- c) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më të ulët se 70 % të vlerësimit të përgjithshëm;
- ç) të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm për gradë;
- d) të mos ketë filluar ndaj tij procedim penal;
- dh) të mos ketë filluar ndaj tij procedim disiplinor për shkelje të rëndë;
- e) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:
 - i) nga “Asistent zjarrfikës” në “Zjarrfikës” 5 vite;
 - ii) nga “Zjarrfikës” në “Kryezjarrfikës” 5 vite;
 - iii) nga “Inspektor zjarrfikës” në “Krye-inspektor zjarrfikës” 5 vite;
 - iv) nga “Kryeinspektor zjarrfikës” në “Komisar zjarrfikës” 5 vite;
 - v) nga “Komisar zjarrfikës” në “Drejtues zjarrfikës” 5 vite;
 - vi) nga “Drejtues zjarrfikës” në “Drejtues i parë zjarrfikës” 5 vite;
 - vii) nga “Drejtues i parë zjarrfikës” në “Drejtues i lartë zjarrfikës” pa afat.

2. Në vetërsinë për efekt konkurrimi, për fitimin e gradës, llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të:

- a) paaftësisë shëndetësore deri në 6 muaj, brenda afatit 12-mujor;
- b) vjetërsisë së shërbimit, të njohur me vendim gjyqësor;
- c) lejes së lindjes.

3. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë pagese.

Neni 26

Arsimimi dhe trajnimi për fitimin e gradës

1. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së i nënshtrohet testeve dhe kurseve pranë Akademisë së Sigurisë ose qendrave për rritjen dhe marrjen e gradës pasardhëse.

2. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së, për të ndjekur programin e arsimimit/trajnimit, zgjidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, bazuar në listën emërore të së drejtës për gradë.

3. Pas përfundimit të programit të arsimimit /trajnimit, dhënia e gradës bëhet sipas listës emërore të së drejtës për gradë, duke filluar nga punonjësi që ka vlerësimin më të lartë.

KREU V DISIPLINA

Neni 27

Sjellja dhe etika

1. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave.

2. Normat, rregullat e sjelljes e të etikës përcaktohen në rregulloren e MZSH-së.

Neni 28

Shkeljet e disiplinës

1. Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të shërbimit të MZSH-së që është në kundërshtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren e MZSH-së.

2. Shkeljet disiplinore kategorizohen në të lehta dhe të rënda.

3. Masa e lehtë disiplinore jepet nga eprori i punonjësit të MZSH-së. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së, ndaj të cilit merret masë e lehtë disiplinore, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit që ka dhënë masën, brenda 5 ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim, për dhënien e masës disiplinore.

Masa e rëndë disiplinore për punonjësit e MZSH-së jepet nga komisioni i disiplinës, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të MZSH-së, në nivel qendror, dhe me propozim të kryetarit të bashkisë, në nivel vendor.

Komisioni i disiplinës ngrihet dhe funksionon sipas rregullores së shërbimit të MZSH-së, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

4. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të shërbimit të MZSH-së duhet t'i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.

5. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 29

Masat disiplinore

1. Ndaj punonjësit të shërbimit të MZSH-së, që kryen shkelje disiplinore, merren këto masa:

a) Për shkelje të lehta disiplinore:

i) vërejtje;

ii) vërejtje me paralajmërim.

b) Për shkelje të rënda disiplinore:

i) shtyrje e afatit të gradimit deri në 1 vit;

ii) ulje me një gradë, për një periudhë deri në 6 muaj;

iii) përjashtimi nga shërbimi i MZSH-së.

2. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:

- a) gjashtë muaj, nga njoftimi i masës “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim”;
- b) një vit, nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore “shtyrje e afatit të gradimit deri në 1 vit” ose “ulje me një gradë”.

3. Llojet e shkeljeve disiplinore, procedura dhe kompetencat e dhënies së masave, shqyrtimit, ndëshkimit, ankimit për masën e dhënë, si dhe shuarja apo parashkrimi i shkeljeve e masave disiplinore për punonjës, përcaktohen në rregulloren e shërbimit të MZSH-së.

4. Efektet e masës disiplinore për punonjës të shërbimit të MZSH-së fillojnë pas përfundimit të procesit disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të ankimit administrativ.

5. Punonjësit administrativ, për shkelje disiplinore, i jepet masë disiplinore, sipas përcaktimeve në kontratën individuale ose kolektive të punës.

KREU VI MARRËDHËNIA E PUNËS DHE TRAJTIMI I PERSONELIT

Neni 30

Koha e punës dhe e pushimit

1. Koha e punës dhe e pushimeve, për punonjësit e shërbimit, njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës shtetërore, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Pushimi vjetor, për punonjës të funksioneve administrative, njësohet me atë të administratës shtetërore, ndërsa për punonjës të shërbimit me gradë është 28 deri në 40 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar, sipas vjetërsisë dhe gradave.

3. Periudha e pushimeve pa të drejtë pagese nuk llogaritet në vjetërsi pune të shërbimit dhe as për efekt të ecurisë në karrierë.

4. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së trajtohet me pushim ose pagë shtesë për mbikohën normale të punës.

5. Kriteret, masat e përfitimeve dhe llojet e pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Trajtimi financiar gjatë qëndrimit në punë

1. Punonjësi me gradë të shërbimit të MZSH-së, për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, gëzon trajtim të veçantë, të përcaktuar në këtë ligj, në të cilin përfshihen:

- a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune;
- b) ndihma financiare në rastet e fatkeqësive në familje, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- c) ndihma e menjëhershme financiare, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit.

2. Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të shërbimit të MZSH-së, sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 32

Sigurimi i jetës

Punonjësi i shërbimit të MZSH-së përfiton sigurim jete, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33

Përfitimet suplementare pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës

1. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së, që ndërpret marrëdhëniet e punës me shërbimin, përfiton:
 - a) pagesë kalimtare;
 - b) pension të parakohshëm suplementar;
 - c) pension suplementar pleqërie.
2. Përfitimet suplementare, për rastet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen me ligj të veçantë.

KREU VII
BURIMET FINANCIARE

Neni 34

Buxheti i shërbimit të MZSH-së

Buxheti i shërbimit të MZSH-së ka si burim financimi Buxhetin e Shtetit, i cili përbëhet nga buxheti për pushtetin vendor dhe buxheti i ministrisë përgjegjëse, si dhe të ardhurat nga shërbimi ndaj të tretëve dhe forma të tjera financimi, të njohura me ligj.

Neni 35

Marrëdhëniet me shoqëritë e sigurimeve

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si autoriteti përgjegjës për aktivitetin e shoqërive të licencuara në fushën e sigurimeve, bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së në fushën e sigurisë nga zjarri. Ky institucion, në fund të vitit kalendarik, informon, zyrtarisht, Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së për listën e objekteve që janë siguruar nga zjarri.
2. Shoqëritë e sigurimit i paguajnë shërbimit vendor të MZSH-së shpenzimet e ndërhyrjes së tij për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri.
3. Mënyra dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes, administrimi dhe përdorimi i këtyre të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor të MZSH-së, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Shërbimi i MZSH-së në nivel vendor, pas kërkesës së shoqërisë së sigurimit, vë në dispozicion të saj dokumentacionin teknik që zotëron, në raste zjarri.

Neni 36

Lidhja e kontratës dhe tarifat

1. Personat juridikë e fizikë lidhin kontratë me shërbimin e MZSH-së, për dhënie të asistencës teknike e trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri, vënien në dispozicion të personelit, mjeteve, pajisjeve dhe teknikës së shuarjes së zjarreve dhe anasjelltas.
2. Tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i MZSH-së përcaktohen me vendim të Këshillit Ministrave.

KREU VIII
PËRGJEGJËSITË E AUTORITETEVE QENDRORE DHE PERSONAVE FIZIKË E
JURIDIKË

Neni 37

Ministritë dhe institucionet qendrore

- 1.Ministritë dhe institucionet qendrore, në objektet në përgjegjësi administrimi, kanë këto detyra:
- a) marrin masa për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;
 - b) caktojnë personel teknik në organikën dhe strukturën e tyre, të specializuar me detyra në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - c) bashkëpunojnë me shërbimin e MZSH-së;
 - ç) planifikojnë fonde financiare për përmirësimin e infrastrukturës së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - d) nxjerrin rregullore të ndryshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, sipas fushave që mbulojnë;
 - dh) koordinojnë me shërbimin vendor të MZSH-së për marrjen e masave parandaluese e të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - e) institucionet përkatëse, që kanë në përgjegjësi administrimi zona të mbrojtura, marrin të gjitha masat e duhura, duke ngritur struktura për ruajtjen e pyjeve nga zjarret dhe stacione zjarrfikëse, me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse, në këto zona.
- 2.Ministria përgjegjëse për arsimin vendos në kurrikulat e arsimit 9-vjeçar programe për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 38

Detyrimet e personave fizikë e juridikë

1. Personat fizikë e juridikë detyrohen të:
- a) zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe aktet e tjera nënligjore për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin;
 - b) marrin masa për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre;
 - c) kontrollojnë, të paktën një herë në vit, gjendjen e masave, mjeteve dhe pajisjeve për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, në objektet dhe aktivitetet ku ushtrojnë veprimtarinë;
 - ç) planifikojnë fonde financiare për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin;
 - d) planifikojnë fonde financiare për ngritjen e grupeve zjarrfikëse dhe trajnimin periodik të tyre;
 - dh) pajisin strukturat e tyre me sisteme sinjalizimi, ndërldhjeje, sisteme stacionare automatike, me hidrantë zjarrfikës për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në përputhje me normat teknike, si dhe t'i mbajnë ato në gatishmëri;
 - e) hartojnë rregullat e brendshme për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me rrezikshmërinë e proceseve teknologjike;
 - ë) shoqërojnë me certifikatë prodhimet e kimikateve e të lëndëve me burim rreziku të shtuar zjarri e shpërthimi, ku të përshkruhen karakteristikat fiziko-kimike, mënyrat e ruajtjes, transportimit e përdorimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transportin tokësor dhe hekurudhor të mallrave të rrezikshme;
 - f) pranojnë dhe të krijojnë lehtësi inspektimit nga strukturat e ngarkuara të shërbimit shtetëror të MZSH-së për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe të zbatojnë në kohë detyrat e lëna nga këto struktura.

2. Personat juridikë e fizikë ngrenë, në objektet e tyre, qendra të monitorimit të sistemeve të diktimit-sinjalizimit. Mënyra e funksionimit, projektimit, instalimit dhe veprimtaria e këtyre qendrave duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Në rastet e forcave madhore, personat fizikë e juridikë, që posedojnë toka, ndërtime, instalime teknologjike apo mjete transporti, kanë detyrimin të:

a) lejojnë, pa kushte, përdorimin e burimeve të ujit, materialeve dhe mjeteve personale për operacionet e shpëtimit, të shuarjes dhe kufizimit të efekteve të zjarrit mbi pronën e tyre ose të tjerëve;

b) pranojnë masat e vendosura nga drejtuesi i shuarjes së zjarrit për shembjen e ndonjë ndërtimi, ose një pjese të tij, prerjen\zbërthimin e mjeteve të transportit, ndërprerjen e përkohshme të aktiviteteve apo evakuimin nga zona e rrezikut, dhe të japë mbështetje me forcat dhe mjetet personale, për realizimin e këtyre masave.

KREU IX

MASAT PËR SIGURINË NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, NË PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E VEPRAVE, INSPEKTIMI

Neni 39

Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin

1. Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është pjesë përbërëse e dokumentacionit që kërkohet për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit.

2. Objektet e çdo lloji, sipas shkallës së qëndrueshmërisë ndaj zjarrit dhe rrezikshmërisë ndaj tij, ndahen në kategori, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit.

3. Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve dhe administrimin e zonave të mbrojtura etj., përfshijnë edhe projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 40

Detyrimet e hartuesit të projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin

1. Në objektet dhe ndërtesat e çdo lloji, ndërtime të reja apo rikonstruksione, që konsistojnë në ndryshime në impiantistikë, individët apo subjektet e licencuara, sipas dispozitave në fuqi në fushën e projektimit, detyrohen të:

a) përgatitin projektin teknik të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për kategori ndërtimesh e instalimesh, në bazë të standardeve dhe normave në fuqi;

b) parashikojnë, në dokumentacionin teknik të projektimit, sipas kategorizimit të objekteve, kompletimin e tyre me sisteme hidrike, sinjalizimi, sisteme për shuarjen e zjarreve, mjete të tjera teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe mënyrat e evakuimit të njerëzve;

c) parashikojnë dhe përfshijnë, në dokumentacionin që shoqëron projektin, masat specifike të sigurisë nga zjarri, natyrën e rrezikut që mbart objekti apo ndërtesa që projektohet.

2. Hartuesi i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin mban përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, për respektimin e dispozitave të këtij neni dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 41

Shqyrtimi i dokumentacionit tekniko-ligjor

1. Shërbimi vendor i MZSH-së miraton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që shoqëron dokumentacionin tekniko-ligjor të lejeve zhvillimore, lejeve të ndërtimit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Shërbimi qendror i MZSH-së miraton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që shoqëron dokumentacionin tekniko-ligjor të lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit të objekteve me rëndësi ekonomiko-strategjike kombëtare, dhe të objekteve me rrezikshmëri të theksuar për zjarr e shpërthim, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

3. Klasifikimi i objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e miratimit, koha dhe mënyra e shqyrtimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, që shoqërojnë dokumentacionin tekniko-ligjor, lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit, si dhe e lëshimit të certifikatës të mbrojtjes nga zjarri, miratohen me udhëzim të ministrit.

4. Personi i ngarkuar nga shërbimi i MZSH-së për miratimin e dokumentacionit teknik që shoqëron lejet zhvillimore/ndërtimore, si dhe për dokumentacionin për lëshimin e certifikatës së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, mban përgjegjësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 42

Moszbatimi i projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin

1. Moszbatimi i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në konstruksionet, objektet e ndërtimit, në ndërtesa të çdo lloji apo aktivitete që ushtrohen në to, ngarkon me përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, personat fizikë e juridikë që i kanë ato në pronësi ose në administrim.

2. Punonjësit e shërbimit të MZSH-së mbajnë përgjegjësi për lëshimin e certifikatës së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin kur nuk janë zbatuar detyrat e parashikuara në projekt.

Neni 43

Ndryshimi i destinacionit

Për çdo ndryshim destinacioni të përdorimit të objekteve apo aktiviteteve të ushtruara në to, merret miratimi nga strukturat e shërbimit MZSH-së.

Neni 44

Sistemet, pajisjet, mjetet dhe instalimet e shuarjes së zjarrit

1. Tregtimi, prodhimi i pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen dhe mbrojtjen nga zjarri, si dhe instalimet e tyre, bëhen në zbatim të rregullave dhe standardeve të sigurisë nga zjarri.

2. Sistemet, pajisjet, mjetet dhe instalimet për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin shoqërohen me certifikatën e origjinës.

3. Mirëmbajtja e sistemeve për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare për sigurinë nga zjarri.

4. Inspektorët e shërbimit të MZSH-së kryejnë kontroll për zbatimin e standardeve dhe rregullave për tregtimin, nga subjektet fizike e juridike, të pajisjeve, sistemeve manuale e automatike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin. Inspektorët e shërbimit të MZSH-së, kur konstatojnë shkelje të këtij neni, marrin masa administrative, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 45

Kontrolli teknik pas përfundimit të punimeve

1. Inspektorët e shërbimit të MZSH-së, në përfundim të punimeve të objektit, kontrollojnë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të detyrave të lëna në projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe

shpëtimin. Nëse janë respektuar kërkesat e projektit, drejtori/shefi i sektorit të shërbimit të MZSH-së jep certifikatën e sigurisë nga zjarri.

2. Në rast të shkeljes së rregullave ose moszbatim të detyrave të lëna në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, punonjësit e inspektimit të shërbimit të MZSH-së marrin masa administrative, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 46

Inspektimi për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

1. Inspektimi mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të tjera të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në Republikën e Shqipërisë, kryhet nga inspektorët e MZSH-së, sipas dispozitave ligjore për inspektimin në fuqi.

2. Punonjësit e inspektimit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin janë punonjës të nivelit të mesëm. Përveç plotësimit të kriterëve, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 13, këta punonjës duhet të kenë jo më pak se 5 vjet vjetërsi në strukturat e shërbimit të MZSH-së.

Neni 47

Të drejtat dhe detyrat e inspektorëve

Punonjësit e inspektimit vendor të MZSH-së, në bashki, gjatë kryerjes së inspektimit, përveç të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në ligjin “Për inspektimin”, kanë edhe këto të drejta e detyra:

a) të kontrollojnë masat dhe mjetet e mbrojtjes nga zjarri në çdo objekt ku prodhimi ose aktiviteti që kryhet lidhet me substanca të rrezikshme;

b) të inspektojnë çdo lloj objekti, instalime të ndryshme, magazinime dhe mbajtje të mallrave, materialeve dhe dokumentacioni përkatës, që ka të bëjë me sigurinë nga zjarri, apo detyrimin e të punësuarve për zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, duke zbatuar programin e miratuar të ushtrimit të kontrollit;

c) të bashkëpunojnë me shërbimet e Policisë së Shtetit, për përcaktimin e shkaqeve të zjarreve;

ç) të specifikojnë afatin për eliminimin e mangësive apo parregullsive në zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

d) të mbajnë, për çdo objekt të kontrolluar, dokumentacionin përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

KREU X

TË DREJTAT DHE DETYRAT E SHËRBIMIT TË MZSH-SË

Neni 48

Detyrat

Shërbimi i MZSH-së ka këto detyra kryesore:

a) ndërhyjnë me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, gjësë së gjallë e pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme;

b) harton raportin e ndërhyrjes, me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri;

c) organizon, inspekton dhe jep asistencë teknike për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregullave për sigurinë e jetës së njerëzve, të pronës, nga rreziku i zjarrit;

ç) organizon punën për rritjen e gatishmërinë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme;

d) organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri;

dh) ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike;

e) bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera;

ë) përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;

f) kryen studime në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore e projektuese;

g) njofton, rregullisht, publikun për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit.

Neni 49

Të drejtat

1. Shërbimi i MZSH-së ka këto të drejta:

a) bllokon, deri në plotësimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, veprimtarinë, në të gjitha kategoritë e proceseve teknologjike të veprave, strukturave dhe institucioneve në mjediset publike, pajisjet, materialet, lëndët e rrezikshme, që sjellin pasoja për jetën e njerëzve ose pronën, si lëndët plasëse, municionet, helmet e forta, lëndët lehtësisht të ndezshme e të djegshme, lëndët radioaktive etj., kur ato paraqesin rrezik për jetën e njerëzve ose pronën dhe kur në to nuk janë zbatuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj;

b) bllokon të gjitha mjediset ku ka rënë zjarr, për të ruajtur të paprekur vendin e ngjarjes;

c) urdhëron largimin e menjëhershëm, nga mjediset, të pajisjeve dhe materialeve e lëndëve të rrezikshme, që sjellin pasoja për jetën e njerëzve dhe të pronës;

c) merr masa administrative ndaj kundërvajtësve, sipas dispozitave të veçanta të këtij ligji dhe në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

2. Drejtori i Përgjithshëm i shërbimit të MZSH-së jep certifikatë të karrierës, për punonjësit me karrierë të gjatë në kryerjen e detyrës.

3. Kryetari i bashkisë jep certifikatë për shërbime të dalluara për punonjësit e dalluar në kryerjen e detyrave.

4. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit.

KREU XI

SANKSIONET ADMINISTRATIVE, ANKIMI DHE EKZEKUTIMI

Neni 50

Sanksionet administrative

1. Personat fizikë dhe juridikë, që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur veprimet apo mosveprimet e tyre përkatëse nuk përbëjnë vepër penale, janë përgjegjës për kundërvajtje administrative.

2. Në përfundim të inspektimit, inspektorët vendorë të shërbimit të MZSH-së, për shkeljet e detyrimeve të parashikuara në nenet e këtij ligji, vendosin këto masa administrative:

a) për shkelje të nenit 38, dënim me gjobë, në masën 5 000 deri në 50 000 lekë;

b) për shkelje të nenit 39, dënim me gjobë, në masën nga 10 000 deri në 30 000 lekë;

c) për shkelje të nenit 40, dënim me gjobë, në masën nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

c) për shkelje të neneve 42 e 43, dënim me gjobë, në masën nga 20 000 deri në 100 000 lekë;

- d) për shkelje të nenit 44, dënim me gjobë në masën nga 100 000 deri në 200 000 lekë.
3. Inspektorët vendorë të shërbimit të MZSH-së vendosin gjobë, në masën nga 10 000 deri në 200 000 lekë, në rastet kur:
- a) nuk janë zbatuar detyrat e lëna në aktkontroll;
 - b) ka rënë zjarr për shkak të shkeljes së rregullave teknike të mbrojtjes nga zjarri e të shpëtimit;
 - c) janë bllokuar rrugët e kalimit, si rezultat i kryerjes së punimeve të ndërtimit.
4. Inspektorët vendorë të shërbimit të MZSH-së bllokojnë çdo kategori e strukturë zhvillimore/ndërtimore kur ajo paraqet rrezik të shtuar për rënie zjarri e shpërthimi dhe kur nuk janë zbatuar detyrat e lëna, që përbëjnë shkelje, sipas dispozitave të këtij ligji.
5. Inspektorët në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së vendosin gjobë, në masën nga 200 000 deri në 500 000 lekë, në rastet kur nuk janë zbatuar detyrimet e përcaktuara në nenet 9 e 40 të këtij ligji.
6. Shërbimi i MZSH-së bën kallëzim penal për shkelje të dispozitave të këtij ligji, kur ka elemente të veprës penale, pavarësisht nga procedimi dhe dënimi administrativ.
7. Përveç dënimeve kryesore, sipas këtij ligji, jepen edhe dënimet plotësuese “pezullim” ose “ndërprerje e veprimtarisë”.
8. Mënyra e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe procesverbali i konstatimit të shkeljes miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 51

Ankimi

1. Kundër vendimit të inspektorit të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor bëhet ankimi, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit për inspektimin, te kryetari i bashkisë.
2. Kundër vendimit të inspektorit të shërbimit të MZSH-së në nivel qendror bëhet ankimi, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit për inspektimin, te Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së.
3. Kundër vendimit të kryetarit të bashkisë apo Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 52

Ekzekutimi

Ekzekutimi i gjobave dhe masave të tjera administrative, në zbatim të këtij ligji, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU XII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 53

Dispozita kalimtare

1. Stacionet e shërbimit të MZSH-së, përfshirë të gjitha asetet, prona të paluajtshme, pajisje e automjete, kalojnë nga institucioni i prefektit të qarkut, në pronësi të bashkive respektive, me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Bashkitë, që kanë stacione të shërbimit zjarrfikës të MZSH-së, janë të detyruara të mbulojnë dhe të ndërhyjnë, në çdo rast, me punonjësit dhe mjetet e tyre, në territoret e bashkive të cilat nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së, deri në plotësimin dhe kompletimin e tyre përfundimtar me mjete dhe personel zjarrfikës.

3. Bashkitë, të cilat nuk kanë stacione zjarrfikëse, ngrenë dhe plotësojnë me personel, automjete e pajisje shërbimin e MZSH-së, deri në dhjetor të vitit 2018.

4. Lista e bashkive, të cilat ngrenë shërbimin e MZSH-së brenda afatit 3-vjeçar, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Në bashkitë ku mungon shërbimi i MZSH-së, efektet financiare të kryerjes së këtij shërbimi nga bashkitë fqinje mbulohen nga Buxheti i Shtetit, sipas tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Arritja e standardit minimal, të përcaktuar në pikën 6, të nenit 7, të këtij ligji, financohet në mënyrë progresive, çdo vit, nga Buxheti i Shtetit, për të gjitha bashkitë që nuk e plotësojnë këtë standard, deri në 3 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

7. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së do të ruajë të njëjtën gradë që ka edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të kreut IV, të këtij ligji.

8. Për Drejtorin e Përgjithshëm të MZSH-së ndryshohet emërtimi i funksionit të tij dhe ai vazhdon të qëndrojë në detyrë vetëm nëse plotëson kriteret e parashikuara në këtë ligj.

9. Sektorët aktualë të MZSH-së, në institucionin e prefektit të qarkut, kalojnë në varësi të kryetarit të bashkisë dhe emërtohen drejtori të MZSH-së, ndërsa stacionet ekzistuese dhe ato që do të ngrihen në bashkitë, në zbatim të këtij ligji, për efekt strukture, emërtohen sektorë.

Neni 54

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

1. Rregullorja e shërbimit të MZSH-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 5; 6, pika 2, 10, shkronja “a”; 12, pika 1; 18, pika 2; 22, pika 2; 30, pika 5; 31, pika 2; 32; 35, pika 3; 36, pika 2; 53, pikat 1, 4 e 5, dhe 54, pika 1.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pika 3; 34, shkronja “b”; 39, pika 2; 41, pika 3; 49, pika 4, dhe 50, pika 8.

Neni 55

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8766, datë 5.4.2001, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, të ndryshuar, zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj dhe shfuqizohen me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 56

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9384, datë 6.1.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

LIGJ
Nr.10 463, datë 22.9.2011

PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE*⁹

(Ndryshuar me ligjin nr. 32/2013, datë 14.02.2013; nr. 156/2013, datë 10.10.2013)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet:

- a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve;
- b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre;
- c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

Neni 2

Objekti

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ky ligj përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efikasitetit të këtij përdorimi.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “ADR” është Marrëveshja Europiane për Transportimin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme, në rrugë automobilistike, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë që më 26 janar 2005.

2. “Agjent” është sipërmarrësi që rregullon marrëdhëniet ndërmjet palëve përgjegjëse për rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve, pavarësisht nga fakti nëse i merr mbetjet fizikisht në zotërim apo jo.

^{*} Ky ligj është përafshuar plotësisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: **32008L0098**, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3 - 30.

⁹ Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.148, datë 8 nëntor 2011.

Ligji nr. 32/2013, datë 14.02.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 12 mars 2013.

Ligji nr. 156/2013, datë 10.10.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 29 nëntor 2013.

3. “Asgjësım”  sht   do operacion q  nuk  sht  rikuperim edhe kur operacioni ka si pasoj  dyt sore rikuperimin e substancave ose t  energjis . Lista e operacioneve t  asgj simit p rcaktohet n  shtojc n 1 bashk lidhur k tij ligji.

4. “Ambalazh” jan  t  gjitha produktet e prodhuara nga  do lloj materiali i  do natyre, q  p rdoret p r mbajtjen, mbrojtjen, dor zimin, shp rndarjen dhe prezantimin e mallrave, duke filluar q  nga l nd t e para e deri te produktet e p rpunuara, nga prodhuesi te p rdoruesi apo konsumatori. “Elementet e pakthyeshme”, q  p rdoren p r t  n j tat q llime, konsiderohen gjithashtu si ambalazhe.

5. “Bateri apo akumulator automjeti”  sht  bateria apo akumulatori i p rdorur p r nisjen, ndri imin apo fuqin  e injektimit t  automjeteve.

6. “Bateri apo akumulator”  sht  burimi i energjis  elektrike q  gjenerohet nga konvertimi i drejtp rdrejt  i energjis  kimike dhe q  konsiston n  n j  apo m  shum  qeliza baterish (t  pakarikueshme), apo q  konsistojn  n  n j  apo m  shum  qeliza baterish dyt sore (t  karikueshme).

7. “Bateri apo akumulator industrial”  sht  bateria apo akumulatori i projektuar vet m p r p rdorime industriale apo profesionale ose p r p rdorim n   do lloj automjeti elektrik.

8. “Dokument dor zimi”  sht  dokumenti q  shoq ron  do transfert  t  mbetjeve t  rrezikshme, sipas nenit 25 t  k tij ligji.

9. “Dokument transferimi”  sht  dokumenti q  shoq ron  do transfert  t  mbetjeve t  parrezikshme, sipas nenit 20 t  k tij ligji.

10. “Grumbullim i diferencuar”  sht  grumbullimi, sipas t  cilit n j  rrym  mbetjesh ndahet, n  p rputhje me llojin dhe natyr n, p r t  b r  t  mundur n j  trajtim specifik.

11. “Grumbullim”  sht  mbledhja, p rfshir  ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak t  mbetjeve p r transportimin e tyre n  impiantet e p rpunimit t  mbetjeve.

12. “Krijues i mbetjeve”  sht   do person, veprimtarit  e t  cilit krijojn  mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose  do person, q  kryen p rpunimin paraprak, p rzierjen ose operacione t  tjera q   ojn  n  ndryshimin e natyr s ose t  p rb rjes s  asaj mbetjeje.

13. “Impiant bashkincinerimi”  sht   do impiant i pal vizsh m ose i l vizsh m, q llimi kryesor i t  cilit  sht  krijimi i energjis  ose prodhimi i produkteve materiale dhe:

a) q  i p rdor mbetjet si l nd  djeg se, baz  ose shtes ;

b) n  t  cilin mbetjet i n nshtrohen trajtimit termik, me q llim asgj simit e tyre.

N  rast se bashkincinerimi kryhet n  at  m nyr  q  q llimi kryesor i impiantit nuk  sht  krijimi i energjis  apo prodhimi i produkteve materiale, por trajtimi termik i mbetjeve, impianti do t  konsiderohet si n j  impiant incinerimi. Ky p rkufizim mbulon vendndodhjen e impiantit dhe t  gjith  impiantin, p rfshir  t  gjitha linjat e bashkincinerimit, vendin e pranimit t  mbetjeve, t  magazinimit, impiantet e paratrajtimit n  vend, sistemet e furnizimit me l nde djeg se dhe aj r, bojler t, impiantet p r trajtimin e gazrave t  shkarkimit, impiantet p r trajtimin ose magazinimin n  vend t  tepricave t  mbetjeve dhe uj rave t  p rdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit t  operacioneve t  incinerimit, t  regjistrimit dhe t  monitorimit t  kushteve t  incinerimit.

14. “Impiant incinerimi”  sht   do pajisje dhe n j si teknike, e pal vizshme ose e l vizshme, q  p rdoret p r trajtimin termik t  mbetjeve, q  e rikuperon ose jo nxeht sin  q  krijohet nga djegia. K tu p rfshihet incinerimi i mbetjeve me oksidim, si dhe procese t  tjera t  trajtimit termik, si piroliza, gazifikimi ose proceset e plazm s, pas t  cilave substancat, q  p rftohen nga trajtimi, incinerohen. Ky p rkufizim mbulon vendndodhjen dhe t  gjith  impiantin e incinerimit, p rfshir  t  gjitha linjat e incinerimit, vendin e pranimit t  mbetjeve, t  magazinimit, impiantet e paratrajtimit n  vend, sistemet e furnizimit me mbetje, l nd  djeg se dhe aj r, bojler t, impiantet p r trajtimin e gazrave t  shkarkimit, impiantet p r trajtimin ose magazinimin n  vend t  tepricave t  mbetjeve dhe uj rave t  p rdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit t  operacioneve t  incinerimit, t  regjistrimit dhe t  monitorimit t  kushteve t  incinerimit.

15. “K rkues”  sht   do person q  k rkon n j  leje mjedisi n  baz  t  k tij ligji.

16. “Lendfill” është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose në tokë, përfshirë:
- a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lendfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;
 - b) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të:
 - i) impianteve ku mbetjet shkarkohen për t’u përgatitur për t’u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër;
 - ii) vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikupërohen ose të trajtohen;
 - iii) vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.
17. “Ligji për mbrojtjen e mjedisit” është ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
18. “Lëng kullues” është çdo lëng që rrjedh prej mbetjeve të depozituara dhe që shkarkohet ose mbetet në lendfill.
19. “Leje e mjedisit” ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në ligjin përkatës që rregullon lejet e mjedisit.
20. “Mbetje e ngurtë” është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t’i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.
21. “Mbetje bio” janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringut dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.
22. “Mbetje të rrezikshme” janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, të listuara në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij ligji.
23. “Mbetje shtëpiake” janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.
24. “Mbetje inerte” janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.
25. “Mbetje e lëngshme” është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat.
26. “Ministër” është ministri përgjegjës për mjedisin.
27. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.
28. “Mbetje jo të rrezikshme” janë mbetjet që nuk mbulohen nga përkufizimi i “mbetjeve të rrezikshme”.
29. “Mbetje të ambalazheve” janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbulohen nga përkufizimi i mbetjes në këtë ligj, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre.
30. “Mbetjet nga gomat e përdorura” janë mbetjet që krijohen kur gomat e vjetëruara, të dëmtuara janë zëvendësuar dhe kur automjetet arrijnë në fundin e jetës së tyre.
31. “Mbetje” është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.
32. “Menaxhim i integruar i mbetjeve” është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

33. “Operator” është personi që:
- a) është përgjegjës për vendin e asgjësimit ose të rikuperimit të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Personi përgjegjës në fazën e përgatitjes mund të jetë i ndryshëm nga personi përgjegjës në fazën e kujdesit të mëtejshëm pas mbylljes së lëndës;
 - b) kontrollon impiantin e incinerimit të mbetjeve.
34. “PCB/PCT” janë bifenilet e poliklorinuara, trifenilet e poliklorinuara, monometil-tetraklorodifenil metani, mono-metil-dikloro-difenil metani, monometil-dibromo-difenil metani dhe çdo përzierje që përmban cilëndo nga substancat e përmendura më lart në masë mbi 0,005 për qind të peshës së saj.
35. “Person” është çdo person fizik ose juridik.
36. “Përgatitje për ripërdorim” është kontrolli, operacionet e rikuperimit, përmes pastrimit ose riparimit, me anë të të cilave produktet ose përbërësit, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t’u ripërdorur pa iu nënshtruar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak.
37. “Parandalim” janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:
- a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;
 - b) ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;
 - c) përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.
38. “Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
39. “Rikuperim” është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:
- a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoren në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar;
 - b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë. Në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij ligji, jepet një listë joshtruese e operacioneve të rikuperimit.
40. “Riciklim” është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.
41. “Rigjenerim i vajrave të përdorura” është çdo operacion riciklimi, me anë të të cilit vajrat bazë mund të prodhohen nga rafinimi i vajrave të përdorura, në mënyrë të veçantë duke hequr ndotësit, produktet oksiduese dhe shtuesit e tjerë, që gjenden në këto vajra.
42. “Rajon” është një ose disa njësi të ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë.
43. “Ripërdorim” është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.
44. “Ruajtje e përkohshme” është mbajtja në një vend, me qëllim ruajtjen e mbetjeve për një periudhë kohe jo më shumë se një vit, pa kryer operacione që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së mbetjeve.
45. “Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve” është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomikisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin.
46. “Teknika më të mira të disponueshme (TMD)” ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.
47. “Tregtar” është sipërmarrësi që vepron si palë kryesore në blerjen dhe shitjen më pas të mbetjeve, pavarësisht nga fakti nëse i merr mbetjet fizikisht në zotërim apo jo.
48. “Transportim” është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.

49. “Trajtim” janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

50. “Vajra të përdorura” janë të gjitha vajrat minerale, lubrifikantë sintetikë apo industrialë që janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin, për të cilin ishin prodhuar fillimisht. Vajrat e përdorura përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në vajrat e përdorura të motorëve me djegie të brendshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike.

51. “Vendndodhja e mbetjeve” është vendi ku ndodhet lendfilli apo incineratori apo çdo vend tjetër ku, sipas këtij ligji, lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve.

52. “Zotërues i mbetjeve” është krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje.

Neni 4

Përfshirje

Përfshihen nga objekti i këtij ligji fushat e mëposhtme, të cilat rregullohen me legjislacion të veçantë:

- a) shkarkimet e gazta në atmosferë;
- b) tokat in situ, që përfshijnë tokat e ndotura të pagërmuara dhe ndërtesat që janë të lidhura në mënyrë të përhershme me tokën (ndërtesat e përhershme, jo ato provizore);
- c) tokat që nuk janë të ndotura dhe materialet e tjera natyrore, të gërmuara si pasojë e veprimtarive të ndërtimit, në rastet kur është e sigurt që materiali do të përdoret për qëllime ndërtimi në gjendjen e tij natyrore në territorin nga ku është gërmuar;
- ç) mbetjet radioaktive;
- d) lëndët shpërthyese të zbërthyer/të demontuara;
- dh) lëndët fekale, në rast se nuk përmenden në shkronjën “b” të këtij neni, kashta dhe materiale të tjera natyrore, bujqësore ose pyjore jo të rrezikshme, që përdoren në bujqësi, pylltari ose për prodhimin e energjisë nga biomasa, përmes procesesh ose metodash që nuk dëmtojnë mjedisin dhe nuk vënë në rrezik shëndetin e njeriut;
- e) ujërat, nënproduktet e mbetjet, në rastet kur trajtohen nga ligje të tjera si:
 - i) ujërat e përdorura;
 - ii) nënproduktet shtazore dhe produktet e përpunuara, përveç atyre që destinohen për incinerim, për në lendfill ose për përdorim në një impiant kompostimi ose biogazi;
 - iii) skeletet e kafshëve të ngordhura, përfshirë rastet kur janë thërrur në thertore apo janë vrarë për të eliminuar sëmundjet epizotike;
 - iv) mbetjet që dalin nga kërkimi, nxjerrja, trajtimi dhe magazinimi i burimeve minerale dhe punimet në gurore;
- ë) sedimentet që rikthehen në ujërat sipërfaqësore për qëllime të menaxhimit të ujërave dhe rrugëkalimeve ujore, për parandalimin ose zbutjen e efekteve të përmbytjeve dhe thatësirave ose për bonifikimin e tokave, nëse provohet që këto sedimente janë të parrezikshme.

Neni 5

Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit

Mbetjet menaxhohen duke mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos:

- a) duke mos vënë në rrezik ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët;
- b) duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë;
- c) duke mos shkaktuar shqetësime përmes zhurmave ose erërave, në përputhje me përcaktimet e akteve të tjera ligjore apo nënligjore.

Neni 6

Përparësitë e menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Përcaktimi i përparësive në ligje, strategji, plane dhe programe të menaxhimit të integruar të mbetjeve të trashëguara apo të atyre që krijohen bëhet duke pasur parasysh hierarkinë e mëposhtme:

- a) parandalimin e mbetjeve;
- b) përgatitjen për ripërdorim;
- c) riciklimin;
- ç) rikuperime të tjera;
- d) asgjësimin.

2. Për përcaktimin e kësaj hierarkie mbahen parasysh parimet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në nenet 6-14 të ligjit ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe kërkesat e tjera të këtij ligji.

3. Në rastet e zbatimit të hierarkisë së menaxhimit të integruar të mbetjeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ministria dhe të gjitha autoritetet përkatëse marrin masa për të nxitur opsionet me rezultatet e përgjithshme më të mirat në mjedis.

4. Aktet nënligjore të veçanta për rryma të veçanta mbetjesh bazohen në hierarkinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kur një gjë e tillë justifikohet nga analiza e ciklit të kohëzgjatjes së ndikimeve të përgjithshme, që vijnë nga krijimi dhe menaxhimi i këtyre mbetjeve, në mënyrë që të përftohet rezultati i përgjithshëm më i mirë për mjedisin.

Neni 7

Nënproduktet

1. Një substancë ose objekt, që përftohet gjatë një procesi prodhimi, qëllimi parësor i të cilit nuk është prodhimi i kësaj substance apo i këtij objekti, për qëllime të këtij ligji, mund të konsiderohet sikur nuk është mbetje, por nënprodukt, vetëm në qoftë se plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) përdorimi i mëtejshëm i kësaj substance ose objekti është siguruar;
- b) substanca ose objekti mund të përdoret drejtpërdrejt pa iu nënshtruar ndonjë përpunimi të mëtejshëm përtej praktikave industriale normale;
- c) substanca ose objekti prodhohet si pjesë përbërëse e procesit të prodhimit;
- ç) përdorimi i mëtejshëm i kësaj substance ose objekti i plotëson standardet teknike përkatëse të produktit për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut, lidhur me atë përdorim dhe nuk sjell ndikime të përgjithshme negative për mjedisin ose për shëndetin e njeriut në përgjithësi;
- d) përdorimi i mëtejshëm i kësaj substance ose këtij objekti është i ligjshëm.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton kriteret që duhet të plotësojnë substancat ose objektet për t’u klasifikuar si nënprodukte dhe jo si mbetje. Masa të tilla përcaktohen në bazë të kushteve të parashtruara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 8

Fundi i statusit mbetje

1. Për qëllim të këtij ligji, një mbetje e caktuar pushon së qeni mbetje kur ka pësuar një operacion rikuperimi, përfshirë riciklimin, dhe vetëm në qoftë se plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) substanca ose objekti përdoret gjerësisht për qëllime të caktuara;
- b) ekziston tregu apo kërkesa për një substancë ose objekt të tillë;
- c) substanca ose objekti plotëson kërkesat teknike për këto qëllime specifike;
- ç) substanca ose objekti plotëson të gjitha standardet teknike përkatëse për produktet;
- d) përdorimi i substancës ose objektit plotëson të gjitha kërkesat përkatëse për mbrojtjen e

mjedisit e të shëndetit për atë përdorim të caktuar dhe nuk sjell ndikime negative në mjedis ose në shëndet në përgjithësi.

2. Fundi i statusit të mbetjeve për çdo tip mbetjeje përcaktohet në bazë të kriterëve specifike, të cilat:

- a) përcaktohen në bazë të kushteve të dhëna në pikën 1 të këtij neni;
- b) sipas rastit, përfshijnë vlerat kufi për ndotësit;
- c) marrin në konsideratë çdo ndikim të mundshëm negativ të substancës ose objektit në mjedis.

Këto kriterë miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit.

3. Në rastet kur mbetjet pushojnë së qeni mbetje, në përputhje me këtë nen, ato pushojnë së qeni të tilla edhe për çdo qëllim tjetër rikuperimi dhe riciklimi, sipas këtij ligji.

Neni 9

Katalogu i mbetjeve

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton katalogun e mbetjeve.

2. Në katalogun e mbetjeve jepet lista e mbetjeve, sipas origjinës dhe përbërjes së tyre dhe, aty ku është e nevojshme, edhe sipas vlerave kufi të përqendrimit të substancave të rrezikshme. Në këtë katalog përfshihen edhe mbetjet e rrezikshme.

3. Katalogu i mbetjeve është detyrues për përcaktimin e mbetjeve që duhen konsideruar si të rrezikshme.

4. Ndalohet hollimi apo përzierja e mbetjeve të rrezikshme me mbetje të tjera, me qëllim uljen e përqendrimeve fillestare të substancave të rrezikshme në një nivel më të ulët se vlera kufi, që i përkufizon mbetjet si të rrezikshme, me qëllim riklasifikimin e tyre si mbetje jo të rrezikshme.

5. Pavarësisht se një substancë ose objekt gjendet në katalogun e mbetjeve, ajo konsiderohet si e tillë vetëm në rastet kur përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 31 të nenit 3 të këtij ligji.

KREU II

PLANET E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

Neni 10

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

1. Ministria harton Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit, të përcaktuara në ligjin ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, dhe në përputhje me kërkesat e tjera të këtij ligji.

2. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve duhet të përmbajë:

- a) të paktën informacionin e përcaktuar në shtojcën 4, pjesa A, si dhe mund të përmbajë edhe informacionin e përcaktuar në shtojcën 4, pjesa B, bashkëlidhur këtij ligji;
- b) masat specifike që do të merren për të arritur objektivat e përcaktuar, në përputhje me këtë ligj;
- c) masat specifike për menaxhimin e ambalazheve dhe të mbetjeve të tyre;
- ç) masat specifike për menaxhimin e mbetjeve të biodegradueshme, në veçanti masat për pakësimin e mbetjeve të tilla që shkojnë në lëndëfill.

3. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve duhet të sigurojë që objektivat e tij të arrihen brenda afateve të përcaktuara.

4. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve duhet të përmbajë një kapitull të veçantë për menaxhimin e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre, duke përcaktuar saktë e qartë masat që duhen marrë për të parandaluar krijimin e mbetjeve të ambalazheve dhe masat për sistemet e ripërdorimit të ambalazheve.

5. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve duhet të përmbajë, në një kapitull të veçantë për menaxhimin e PCB-ve/PCT-ve, planet për grumbullimin dhe/ose çndotjen dhe/apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT, si dhe të vetë PCB-ve/PCT-ve.

6. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve duhet të përfshijë një kapitull të veçantë për menaxhimin e integruar të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve. Ky plan duhet të sigurojë që objektivat e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni të arrihen brenda afateve të përcaktuara. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve rishikohet dhe, në rast se është e nevojshme, përditësohet çdo gjashtë vjet.

Neni 11

Procedurat për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

1. Ministria publikon projektin për Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në faqen e vet zyrtare të internetit dhe e vë atë në dispozicion të publikut, i cili jep mendim për të.

2. Projekti i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve i nënshtrohet vlerësimit strategjik mjedisor, sipas nenit 24 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

3. Projekti i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve u dërgohet ministrive të linjës për mendim.

4. Ministria përgatit projektin përfundimtar të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, pasi merr në konsideratë rezultatet e vlerësimit strategjik mjedisor, mendimet e ministrive të linjës, të Komitetit të Administrimit të Mbetjeve dhe mendimet e publikut dhe ia dërgon atë për miratim Këshillit të Ministrave.

5. Këshilli i Ministrave miraton Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, i cili më pas botohet, shpallet në faqen zyrtare të ministrisë dhe vihet në dispozicion të publikut.

6. Ministri raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në formatin e përcaktuar nga ministri.

7. Dispozitat e këtij neni zbatohen për çdo plan të përditësuar, të përgatitur në përputhje me kërkesat e pikës 6 të nenit 10 të këtij ligji.

8. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.

Neni 12

Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Çdo qark harton planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

2. Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

3. Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisht të qeverisjes vendore përcakton rregulloren për kontrollin e menaxhimit të rrymave specifike të mbetjeve, që gjenerohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, ose masën e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive. Këto rregulla mund të jenë më strikte sesa qëllimet dhe kërkesat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Këto rregullore miratohen nga këshilli i qarkut.

4. Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve rishikohen dhe, në rast se është e nevojshme, përditësohen të paktën çdo gjashtë vjet.

5. Çdo njësi e qeverisjes vendore raporton çdo vit në këshillin e qarkut përkatës për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve në formatin e përcaktuar nga ministri.

6. Çdo qark i raporton çdo vit ministrisë për zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe të planeve rajonale apo vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin nën juridiksionin e vet, në formatin e përcaktuar nga ministri.

Neni 13

Procedurat për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Çdo këshill qarku dhe çdo njësi e qeverisjes vendore publikojnë projektplanet përkatëse në faqet zyrtare të internetit dhe i vënë ato në dispozicion të publikut.

2. Projektplanin rajonal i menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe projektplanin vendor përkatës i nënshtrohen vlerësimit strategjik mjedisor, në përputhje me nenin 24, të ligjit ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

3. Projektplanet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve u dërgohen autoriteteve ose institucioneve përkatëse për mendim.

4. Publiku jep mendimet e veta për projektplanet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

5. Këshilli i qarkut apo këshilli i çdo njësie të qeverisjes vendore miraton planet përkatëse rajonale apo vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Këshilli i qarkut apo i njësisë së qeverisjes vendore, kur miraton planin përkatës, merr në shqyrtim rezultatet e vlerësimit strategjik mjedisor, mendimet e autoriteteve ose të institucioneve përkatëse dhe mendimet e publikut.

6. Këshilli i qarkut dërgon për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

7. Planin rajonal i menaxhimit të integruar të mbetjeve hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga Këshilli i Ministrave. Planin vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga këshilli i qarkut.

8. Planet rajonale apo vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të miratuara botohen dhe i vihen në dispozicion publikut.

9. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve, të përditësuara e të përgatitura në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 12 të këtij ligji.

10. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masa të hollësishme për zbatimin e këtij neni.

Neni 14

Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve

1. Ministria harton programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit, të përcaktuara në ligjin ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me kërkesat e këtij ligji dhe, në mënyrë të veçantë, me hierarkinë e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

2. Afati për hartimin e programeve të para për parandalimin e krijimit të mbetjeve është jo më vonë se data 1 janar 2017.

3. Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve janë pjesë përbërëse e dallueshme e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

4. Planet rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve hartohen në përputhje me të gjitha programet përkatëse për parandalimin e mbetjeve.

5. Programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve hartohen në përputhje me shtojcën 5 bashkëlidhur këtij ligji.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat për programet e parandalimit të mbetjeve, përfshirë objektivat sasiorë e cilësorë për masat për parandalimin e mbetjeve.

Neni 15

Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

1. Për të bashkërenduar detyrat e ministrive për menaxhim të integruar mjedisor të mbetjeve, krijohet Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, si organizëm ndërmintor, në nivel zëvendësministrash. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të tij.

2. Çdo fund viti, komiteti paraqet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave raportin vjetor të gjendjes dhe të menaxhimit të integruar të mbetjeve në shkallë vendi.

KREU III

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat e nevojshme që çdo person juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhuesi i produktit) mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

2. Masat e referuara në pikën 1 të këtij neni, synojnë të rrisin ripërdorimin, parandalimin, riciklimin dhe rikuperime të tjera të mbetjeve.

3. Masat e referuara në pikën 1 përfshijnë, sipas rastit, edhe pranimin e produkteve të kthyer dhe të mbetjeve që teprojnë pas përdorimit të tyre, si dhe menaxhimin e ardhshëm të mbetjeve dhe përgjegjësitë financiare për veprimtari të tilla. Në masa të tilla përfshihet edhe detyrimi për të ofruar publikisht informacionin e disponueshëm për masën, në të cilën produkti është i ripërdorshëm dhe i riciklueshëm.

4. Në masat e referuara në pikën 1 të këtij neni përfshihen edhe masa, që nxisin projektimin e produkteve, në mënyrë që të pakësohen ndikimet e tyre në mjedisin e krijimi i mbetjeve gjatë prodhimit dhe përdorimit të produkteve, dhe që sigurojnë kryerjen e rikuperimit dhe të asgjësimit të produkteve të shndërruara në mbetje, në përputhje me këtë ligj.

5. Masat e referuara në pikën 4 të këtij neni nxisin zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e mallrave që janë të përshtatshme për shumë përdorime, që kanë jetë të gjatë dhe për të cilat, kur shndërrohen në mbetje, rikuperimi dhe asgjësimi kryhen në mënyrë të sigurt dhe pa ndikim në mjedis.

6. Gjatë planifikimit të masave të referuara në pikën 1 të këtij neni merren plotësisht në konsideratë bëshmëria teknike, leverdia ekonomike dhe ndikimet e përgjithshme mbi shoqërinë, mjedisin dhe shëndetin e njeriut, duke respektuar legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve, kërkesat thelbësore për produktet joushqimore dhe vlerësimin e konformitetit.

7. Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit nuk cenon përgjegjësinë për menaxhimin e integruar të mbetjeve, sipas nenit 21 të këtij ligji, apo legjislacionit referuar në këtë ligj, përfshirë legjislacionin për rrymat specifike të mbetjeve dhe legjislacionin për produktet.

Neni 17

Rikuperimi i mbetjeve

1. Mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar për të lehtësuar ose për të përmirësuar rikuperimin e tyre, në rastet kur një gjë e tillë është praktikisht e mundur nga ana teknike, mjedisore dhe ekonomike.

2. Për të plotësuar kërkesën e referuar në pikën 1 të këtij neni, mbetjet nuk përzihen me mbetje ose me materiale të tjera, që kanë veti të ndryshme nga të tyret.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët publike, miraton masa për zbatimin e këtij neni.

Neni 18

Ripërdorimi dhe riciklimi i mbetjeve

1. Ministria dhe autoritetet përkatëse nxisin ripërdorimin e produkteve dhe përgatitjen e veprimtarive të ripërdorimit, në veçanti, duke nxitur ngritjen dhe mbështetjen e rrjeteve të ripërdorimit e të riparimit, përdorimin e instrumenteve ekonomike, zbatimin e kriterëve të prokurimit, arritjen e objektivave sasiore ose marrjen e masave të tjera.

2. Mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, për të lehtësuar ose për të përmirësuar cilësinë e riciklimit në të gjitha rastet, kur një gjë e tillë është praktikisht e mundshme nga ana teknike, mjedisore dhe ekonomike dhe kur kjo ndihmon që të plotësohen standardet e cilësisë për sektorët përkatës të riciklimit.

3. Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, sipas nenit 16 të këtij ligji, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastik dhe qelq.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton afate të ndërmjetme për zbatimin e pikës 3 të këtij neni nga njësitë e qeverisjes vendore.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masa për zbatimin e këtij neni, ku përfshihen edhe objektivat e afatit për riciklimin e rrymave specifike të mbetjeve dhe kërkesat për metodat e llogaritjes e të raportimit, me qëllim përmbushjen e këtyre objektivave.

6. Në masat e referuara në pikën 5 të këtij neni, sipas rastit, përfshihen edhe kërkesat për grumbullimin e diferencuar të rrymave të tjera të mbetjeve, veç atyre të referuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.

Neni 19

Asgjësimi i mbetjeve

Mbetjet, që nuk rikuperohen sipas kërkesës së nenit 17 të këtij ligji, u nënshtrohen operacioneve të sigurta të asgjësimit, në përputhje me këtë ligj.

Neni 20

Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, në përputhje me parimin “Ndotësi paguan”, të përcaktuar në nenin 12 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, mbulohen nga krijuesi fillestar i mbetjeve ose nga zotëruesi aktual apo i mëparshëm i tyre.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat, miraton masa për zbatimin e këtij neni.

3. Këshilli i Ministrave, në përputhje me masat e referuara në pikën 2 të këtij neni, vendos që kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve të mbulohen, plotësisht ose pjesërisht, nga krijuesi i produktit, si pasojë e të cilit kanë dalë mbetjet dhe, sipas rastit, shpërndarësit e produktit të mbulojnë një pjesë të këtyre kostove.

Kur Këshilli i Ministrave miraton masat, në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të këtij neni, miraton edhe masa të veçanta për rryma specifike të mbetjeve dhe/ose për metodat e rikuperimit apo të asgjësimit, të cilat mund të përfshijnë skemat e rimbursimit të depozitave apo tarifat e përdoruesit.

KREU IV
MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE

Neni 21

Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve

1. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a personi tjetër që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 448 ,datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

2. Krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve, që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton kushtet e përgjegjësisë dhe specifikon se në cilat raste krijuesi fillestar mban përgjegjësi për të gjithë zinxhirin e trajtimit dhe në cilat raste përgjegjësia ndahet mes tij dhe zotëruesit të mbetjeve apo u delegohet aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të trajtimit.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton rrethanat në të cilat përgjegjësia për organizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve mbartet, plotësisht apo pjesërisht, nga prodhuesi i produktit që krijon mbetjet dhe rrethanat kur këto përgjegjësi mund të ndahen me shpërndarësit e këtij produkti.

5. Personat fizikë a juridikë, të licencuar, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje, dorëzojnë mbetjet e grumbulluara ose të transportuara në impiante trajtimi të përshtatshme që plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

6. Të gjitha llojet e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen në baza profesionale nga një person te një tjetër, shoqërohen me një dokument transferimi. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm edhe në formë elektronike.

7. Dokumenti i transferimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin e dokumentit të dorëzimit;
- b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transferuesit;
- c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të personit, tek i cili transferohet mbetja (pritësi);
- ç) informacion për sasinë dhe tipin e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen dhe tipin e konteinerëve në të cilët ndodhet;
- d) vendin, kohën dhe datën e transferimit;
- dh) përshkrimin e mbetjeve jo të rrezikshme bashkë me listën e kodeve respektive;
- e) hollësi për trajtimet apo procese të tjera që mbetjet jo të rrezikshme kanë pësuar deri në këtë çast.

8. I njëjti dokument transferimi lejohet të mbulojë më shumë se një transfertë mbetjesh jo të rrezikshme nga transferuesi tek i njëjti pritës vetëm nëse mbetjet që transferohen janë të ngjashme. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm për një periudhë kohe jo më të gjatë se 1 vit.

9. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i ruajnë dokumentet e transferimit për një periudhë kohe prej të paktën 2 vjetësh, të cilat ua vënë në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit për Mjedisin, pas paraqitjes së kërkesës së tyre me shkrim. Dokumentet përmbajnë minimalisht përshkrimin me shkrim të mbetjeve dhe kopjet e dokumenteve të transferimit.

10. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një herë në vit, informacion për mbetjet jo të rrezikshme.

11. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe kërkesa të tjera për informacionin që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

12. Kryetarët e njërive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 22

Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve (Hegur fjalë në pikën 3, me ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013)

1. Rrjeti i integruar i impianteve për rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve të përziera bashkiake nga sektori urban, si dhe të mbetjeve të ngjashme, që grumbullohen nga prodhues të tjerë, krijohet mbi bazën e teknikave më të mira të disponueshme.

2. Rrjeti i referuar në pikën 1 të këtij neni mundëson që, për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit të njeriut, mbetjet të rikuperohen apo të asgjësohen në një nga impiantet e përshtatshme më të afërta, me teknologjitë dhe metodat më të përshtatshme.

3. Këshilli i Ministrave ndalon importin e mbetjeve, që destinohet për incinerim, kur ky operacion klasifikohet si rikuperim dhe vlerësohet se:

- a) një gjë e tillë është e nevojshme për të mbrojtur rrjetin e impianteve të trajtimit të mbetjeve;
- b) importe të tilla mundësojnë trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve të vendit me mënyra që nuk përputhen me planet përkatëse të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat e nevojshme për zbatimin e këtij neni.

KREU V

MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE TË RREZIKSHME

Neni 23

Kontrolli i mbetjeve të rrezikshme

1. Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në përputhje me këtë ligj. Këto kushte përfshijnë masat që sigurojnë gjurmueshmërinë e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre, si dhe kontrollin e mbetjeve të rrezikshme, me qëllim plotësimin e kërkesave të këtij ligji.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për mbetjet e përziera, të krijuara nga vetë sektori familjar.

3. Leja e mjedisit për personat fizikë a juridikë, që krijojnë, grumbullojnë, transportojnë, magazinojnë apo trajtojnë mbetje të rrezikshme, përcakton kushtet që duhen përmbushur për të siguruar zbatimin e pikës 1 të këtij neni dhe përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Transporti i mbetjeve të rrezikshme bëhet vetëm me mjete që:

- a) janë të përshtatshme për tipin dhe sasinë e mbetjeve të rrezikshme që transportohen;
- b) janë në përputhje me standardet rrugore;
- c) plotësojnë të gjitha kërkesat përkatëse të ADR-së;
- ç) janë regjistruar paraprakisht për këtë qëllim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

5. Transporti i mbetjeve të rrezikshme bëhet në përputhje të plotë me çdo akt tjetër në fuqi për transportin e produkteve të rrezikshme.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masa për zbatimin e këtij neni, përfshirë sigurimin e gjurmueshmërisë nga krijimi i mbetjeve deri në destinacionin përfundimtar të tyre.

Neni 24

Përzierja e mbetjeve të rrezikshme

1. Mbetjet e rrezikshme, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, nuk përzihen as me lloje të tjera mbetjesh të rrezikshme, as me mbetje, substanca apo materiale të tjera. Për qëllime të kësaj pike, përzierja nënkupton edhe hollimin e substancave të rrezikshme.

2. Dispozita e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohet për mbetjet e përziera, të krijuara nga vetë sektori familjar.

3. Leja e mjedisit, që lejon përzierjen e mbetjeve të rrezikshme, jepet vetëm në rastet kur:

a) përmbushen kërkesat e këtij ligji dhe veçanërisht të nenit 5;
b) menaxhimi i integruar i mbetjeve nuk rrit ndikimin negativ në shëndetin e njeriut dhe në mjedis;

c) operacionet e përzierjes kryhen në përputhje me teknikat më të mira të disponueshme.

4. Lejet e mjedisit për veprimtaritë e përcaktuara në këtë ligj miratohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe përfshihen në kategorinë III.1 të shtojcës së tij.

5. Mbetjet e rrezikshme që, për arsye teknike dhe ekonomike dhe në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, janë përzier me mbetje, substanca apo materiale të tjera, për të plotësuar kërkesat e nenit 5, nëse një gjë e tillë është e mundur dhe e nevojshme, duhet të ndahen prej tyre.

Neni 25

Etiketimi i mbetjeve të rrezikshme

1. Mbetjet e rrezikshme grumbullohen, transportohen dhe magazinohen në mënyrë të përkohshme vetëm kur ato janë ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me këtë ligj.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për mbetjet e përziera, të krijuara nga vetë sektori familjar.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për ambalazhimin dhe etiketimin e mbetjeve të rrezikshme në procesin e grumbullimit, të transportit dhe të magazinimit të përkohshëm.

Neni 26

Dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme

1. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik te një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike.

2. Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e dokumentit të dorëzimit;
b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;
c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;
ç) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);
d) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;
dh) përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasitë respektive;

e) hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimet e tyre.

3. Marrësi në dorëzim, brenda 30 ditëve, i dërgon dorëzuesit një konfirmim me shkrim për marrjen e mbetjeve të rrezikshme.

4. Marrësi në dorëzim, kur refuzon një transfertë mbetjesh të rrezikshme, i tregon transferuesit arsyet e refuzimit.

5. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme, ruan dokumentacionin e transferimit për një kohë prej të paktën 3 vjetësh nga data kur fillon dorëzimi dhe ua vë ato në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Inspektoratit për Mjedisin, pas paraqitjes së kërkesës së tyre me shkrim. Dokumentacioni përmban të paktën kopje të dokumentit të dorëzimit, kopje të dokumentit të konfirmimit dhe informacion për dorëzimet e refuzuara.

6. Çdo dorëzues, transportues dhe marrës në dorëzim i dërgon çdo 3 muaj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit informacion për dorëzimin e mbetjeve.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

Neni 27
Vajrat e përdorura

1. Vajrat e përdorura grumbullohen në mënyrë të diferencuar, kur një gjë e tillë është teknikisht e mundur.

2. Leja e mjedisit për personat fizikë a juridikë, që trajtojnë vajra të përdorura, përfshin kushte që sigurojnë trajtimin e tyre, në përputhje me këtë nen dhe me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji.

3. Vajrat e përdorura të llojeve të ndryshme, që kanë karakteristika të ndryshme, nuk përzihen, kur një gjë e tillë është teknikisht e mundur dhe ekonomikisht e leverdishme. Vajrat e përdorura nuk përzihen as me lloje të tjera mbetjesh apo substancash, nëse kjo përzierje pengon trajtimin e tyre.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura. Në këto rregulla përfshihen masa të tilla si kërkesat teknike, përgjegjësitë e prodhuesit, instrumentet ekonomike dhe marrëveshjet vullnetare.

KREU VI
RRYMAT SPECIFIKE TË MBETJEVE

Neni 28
Mbetjet bio

1. Në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji, ministria, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe njësitë e qeverisjes vendore, brenda kompetencave të tyre, nxisin:

- a) grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për qëllime kompostimi dhe digjestimi;
- b) trajtimin e mbetjeve bio në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit;
- c) përdorimin e materialeve të prodhuara nga mbetjet bio që janë të sigurta për mjedisin.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton:

- a) masat e nevojshme për zbatimin e pikës 1 të këtij neni;
- b) kriteret dhe rregullat për pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill dhe afatet për arritjen e tyre.

Neni 29
Ambalazhet dhe mbetjet e tyre

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton:

- a) kërkesat minimale për ambalazhet;
- b) masat e nevojshme për parandalimin e krijimit të mbetjeve të ambalazheve dhe për ngritjen e sistemeve për ripërdorimin apo rikuperimin e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre;
- c) masat që synojnë rritjen e sasisë së mbetjeve nga ambalazhet që rikuperohen apo riciklohen dhe afatet për arritjen e tyre.

2. Ambalazhet hidhen në treg vetëm nëse plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 1 shkronja “a” të këtij neni.

Neni 30
Ndotësit organikë të qëndrueshëm

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat që ndalojnë prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm (NOQ), si dhe administrimin e mbetjeve të këtyre ndotësve.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve/PCT-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve/PCT-ve të përdorura.

3. Kërkesat e referuara në pikën 1 të këtij neni sigurojnë që PCB-të/PCT-të e përdorura të asgjësohen dhe PCB-të/PCT-të dhe pajisjet që përmbajnë PCB/PCT të çndoten apo të asgjësohen sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 31

Bateritë dhe akumulatorët

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton:

- a) kërkesat për standardet teknike për hedhjen në treg të baterive dhe akumulatorëve;
- b) kërkesat për grumbullimin, trajtimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve;
- c) kuotat dhe afatet respektive të grumbullimit të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve.

Neni 32

Automjetet në fund të jetës

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton kërkesa për parandalimin e mbetjeve të automjeteve dhe për ripërdorimin, riciklimin dhe forma të tjera rikuperimi të automjeteve në fund të jetës dhe të pjesëve përbërëse të tyre, me qëllim pakësimin e mbetjeve të destinuara për t'u asgjësuar.

Neni 33

Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike

1. Këshilli i Ministrave nxit projektimin dhe prodhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike në mënyra që marrin parasysh dhe lehtësojnë çmontimin dhe rikuperimin, në mënyrë të veçantë, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve, pjesëve përbërëse e të materialeve të tyre.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kërkesa të tilla, në bazë të të cilave nuk u lejohej prodhuesve t'i japin projektit apo prodhimit tipare apo procese të tilla, që pengojnë ripërdorimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike, nëse këto tipare specifike nuk sigurojnë avantazhe të rëndësishme, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe/ose kërkesat për sigurinë.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për ekonominë, miraton kërkesa për parandalimin e mbetjeve elektrike dhe elektronike, ripërdorimin, riciklimin dhe forma të tjera rikuperimi të këtyre lloj mbetjesh, me qëllim që të pakësojë mbetjet e destinuara për t'u asgjësuar.

Neni 34

Llumrat e ujërave të zeza

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për bujqësinë, miraton kërkesat për përdorimin e llumrave të ujërave të zeza në bujqësi, me qëllim parandalimin e efekteve të dëmshme mbi tokën, bimët, kafshët dhe njerëzit.

Neni 35

Mbetjet spitalore

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, miraton kërkesat për menaxhimin e mbetjeve spitalore.

Neni 36
Nënproduktet shtazore

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për bujqësinë, miraton kërkesat për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu.

Neni 37
Mbetjet inerte

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kërkesat për menaxhimin e mbetjeve inerte.

Neni 38
Mbetjet e industrisë nxjerrëse

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për industrinë, miraton kërkesat për menaxhimin e mbetjeve nga kërkimet, nxjerrja, trajtimi dhe depozitimi i burimeve minerare, si dhe të mbetjeve nga punimet në gurorë.

2. Në kërkesat që referohen në pikën 1 të këtij neni përfshihen edhe masa që parandalojnë ose pakësojnë sa më shumë të jetë e mundur efektet e dëmshme në mjedis, në veçanti, në ujë, ajër, tokë, faunë, florë dhe peizazh, dhe çdo rrezik të mundshëm për shëndetin e njeriut, që shkaktohet nga menaxhimi i mbetjeve të industrisë nxjerrëse.

Neni 39
Mbetjet e industrisë së dioksidit të titanit

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare, miraton kërkesat për menaxhimin e mbetjeve të industrisë së dioksidit të titanit dhe të mbetjeve të tjera industriale që nuk trajtohen me legjislacion të veçantë.

Neni 40
Mbetjet nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton kërkesat për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat në det.

Neni 41
Mbetjet nga gomat e përdorura

1. Gomat e përdorura përfshijnë gomat që mund të ritregtohen, me qëllim përdorimin origjinal të tyre, edhe nëse do të jetë e nevojshme t'i nënshtrohen trajtimit të tyre.

2. Gomat e patregtueshme riciklohen nëpërmjet grirjes së tyre dhe përdorimit të granulave si lëndë e parë për industrinë e prodhimit të gomave, ose të përdoren si lëndë djegëse shtesë për veprimtari të caktuara industriale.

3. Nuk lejohet në asnjë rast djegia e mbetjeve të gomave në mjedise të hapura.

4. Rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 42
Rryma të tjera mbetjesh

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kërkesa për menaxhimin edhe të rrymave të tjera të mbetjeve të ndryshme, nga sa përmenden më lart.

KREU VII
LENDFILLET E MBETJEVE

Neni 43
Kategoritë e lëndfilleve

1. Lëndfillet klasifikohen në tri kategori:
 - a) lëndfille për mbetjet e rrezikshme;
 - b) lëndfille për mbetjet jo të rrezikshme;
 - c) lëndfille për mbetjet inerte.
2. Mbjetet çohen në lëndfill vetëm nëse i janë nënshtruar trajtimit.
3. Lëndfillet e mbetjeve të rrezikshme përdoren për ato mbetje të rrezikshme që plotësojnë kriteret e pranimit në lëndfillet e mbetjeve të rrezikshme, të përcaktuara në pikën 6 të këtij neni.
4. Lëndfillet për mbetjet jo të rrezikshme përdoren vetëm për:
 - a) mbetjet bashkiake;
 - b) mbetjet jo të rrezikshme të çdo origjine tjetër, të cilat plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit, të përcaktuara në pikën 6 të këtij neni;
 - c) mbetjet e rrezikshme joreaktive, të qëndrueshme, me veti lëngëzuese, ekuivalente me mbetjet jo të rrezikshme, të referuara në shkronjën “b” të kësaj pike, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit, të përcaktuara sipas pikës 6 të këtij neni. Këto mbetje të rrezikshme nuk depozitohen në parcelat e destinuar për mbetjet jo të rrezikshme të biodegradueshme.
5. Lëndfillet për mbetjet inerte përdoren vetëm për mbetjet inerte.
6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kërkesat për llojet e mbetjeve që pranohen në kategoritë e ndryshme të lëndfilleve.
7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kushtet për ndërtimin e kategorive të lëndfilleve.

Neni 44
Mbetjet e përjashtuara nga lëndfillet

1. Nuk pranohen në lëndfill:
 - a) mbetjet e lëngshme;
 - b) mbetjet që, në kushtet e lëndfillit, janë shpërthyes, gërryese, oksiduese, të djegshme ose shumë të djegshme, siç përcaktohen në shtojcën 3 bashkëlidhur këtij ligji;
 - c) mbetjet spitalore dhe mbetjet e tjera të klinikave që krijohen nga qendrat mjekësore ose veterinarë, që janë infektuese, siç përcaktohen në shtojcën 3 bashkëlidhur këtij ligji;
 - ç) mbetjet e rrezikshme farmaceutike, të cilat janë të ndezshme, gërryese, toksike dhe reaktive;
 - d) mbetjet e substancave kimike që krijohen nga veprimtaritë e kërkim-zhvillimit apo mësimdhënies në shkolla që nuk janë të identifikuar dhe/ose janë të reja dhe efektet e tyre mbi njeriun dhe/ose mjedisin janë të panjohura (p.sh. mbetjet nga laboratorët etj.);
 - dh) të gjitha gomat e përdorura, me përjashtim të gomave të përdorura si material inxhinierik, të gomave të biçikletave dhe të gomave me diametër të jashtëm mbi 1 400 mm, duke filluar nga 1 janari 2013;

e) gomat e përdorura të grira, me përjashtim të gomave të biçikletave dhe të gomave me diametër të jashtëm mbi 1 400 mm, duke filluar nga 1 janari 2016;

ë) bateritë dhe akumulatorët industrialë dhe automotivë;

f) çdo lloj tjetër mbetjesh që nuk plotëson kriteret e pranimi, të përcaktuara në përputhje me pikën 6 të nenit 43 të këtij ligji.

2. Ndalohet hollimi ose përzjerja e mbetjeve, me qëllim plotësimin e kriterëve të pranimi të tyre në lëndfill.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, sipas rastit, përjashton nga pranimi në lëndfill edhe tipat e tjerë të mbetjeve.

Neni 45

Operacionet e lëndfilleve

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kriteret e studimit e projektzbatimit për ndërtimin e lëndfilleve dhe për mbylljen e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kërkesat për operacionet që kryhen në lëndfille, përfshirë:

a) procedurat e pranimi të mbetjeve;

b) procedurat e kontrollit e të monitorimit;

c) procedurat e mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm;

ç) kërkesat e tjera që duhen plotësuar kur kërkohet leje mjedisi;

d) kushtet e tjera që duhen përfshirë në një leje mjedisi.

3. Ndërtimi i lëndfilleve, si rregull, bëhet në nivel rajonal.

Neni 46

Garancitë financiare

1. Çdo person, që operon ose ka për qëllim të operojë një lëndfill, në përputhje lejen e mjedisit, duhet të disponojë dhe të sigurojë të gjitha mjetet financiare të nevojshme për të mbuluar kostot e ndërtimit, të operimit, të mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm të lëndfillit pas mbylljes së tij, përfshirë pagesën e garancisë për kostot e mbylljes së tij, ndërhyrjet e mëpasme dhe rehabilitimin e mjedisit.

2. Periudha e nevojshme për kujdesin e mëtejshëm për lëndfillin është të paktën 30 vjet.

3. Kur operatori i sheshit të lëndfillit është njëkohësisht edhe personi garantues, informon me shkrim Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për shumën e garancisë financiare.

4. Operatori i sheshit të lëndfillit, kur garantuesi është një palë e tretë, informon me shkrim Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si për ekzistencën e garancisë, ashtu dhe nëse kjo garanci do të pezullohet apo do të pushojë së ekzistuari. Garancia nuk pezullohet apo pushon së ekzistuari më parë se 60 ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

5. Garancia financiare ose ekuivalenti i saj mbahen për aq kohë sa janë të nevojshme operacionet e mirëmbajtjes dhe të kujdesit të mëtejshëm të lëndfillit.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat, miraton rregullat për garancitë që duhet të ofrohen në lidhje me lejet e mjedisit për lëndfillet. Në këto rregulla:

a) përcaktohen objekti dhe kohëzgjatja e këtyre garancive;

b) deklarohet që prona, në të cilën vendoset sheshi i lëndfillit, pas mbylljes, i kalon në pronësi njësisë së qeverisjes vendore;

c) përfshihet çështja e kompensimit për sheshin e lëndfillit, që i kalon njësisë së qeverisjes vendore sipas shkronjës “b” të kësaj pike.

KREU VIII INCINERIMI I MBETJEVE

Neni 47 **Incinerimi i mbetjeve**

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për incinerimin e mbetjeve, përfshirë:

- a) specifikimin e kërkesave për incineratorët dhe bashkincineratorët e mbetjeve;
- b) procedurat e pranimit të mbetjeve në incineratorë dhe bashkincineratorë;
- c) kushtet operationale të tyre;
- ç) procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre;
- d) procedurat e mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm;
- dh) kërkesa të tjera që duhen plotësuar kur kërkohet leje mjedisi;
- e) kushte të tjera që duhen përfshirë në një leje mjedisi.

KREU IX IMPORTI DHE EKSPORTI I MBETJEVE

Neni 48 **Ndalimi i importeve dhe kalimeve transit të mbetjeve** *(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 3, me ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013)*

1. Ndalohet në të gjitha rastet importimi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë.
2. Ndalohet në të gjitha rastet kalimi transit ndërkufitar i mbetjeve të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë.
3. Shfuqizuar.

Neni 49 **Importi i mbetjeve jo të rrezikshme** *(Shfuqizuar me ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013)*

Neni 50 **Kalimi transit i mbetjeve jo të rrezikshme**

1. Vetëm mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte mund të kalojnë transit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Kalimi transit i mbetjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, lejohet vetëm me autorizim të ministrit.
3. Autorizimi për kalimin transit të mbetjeve lëshohet vetëm në përputhje të plotë me këtë ligj dhe akte të tjera në fuqi. Autorizimi i kalimit transit të mbetjeve është i vlefshëm për një periudhë kohe deri një vit dhe u nënshtrohet kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në rregullat e referuara në pikën 5 të këtij neni, si dhe çdo kushti specifik që lidhet me rastin konkret.
4. Në autorizimin për kalimin transit të mbetjeve përcaktohen:
 - a) numri i dokumentit të dorëzimit;
 - b) lloji dhe sasia e mbetjes për të cilën lëshohet;
 - c) standardet që lidhen me ambalazhimin e etiketimin e mbetjeve dhe dokumentet shoqëruese gjatë transportit të tyre;
 - ç) kërkesat për monitorimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve.
5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

Neni 51
Eksporti i mbetjeve

1. Eksporti i mbetjeve nga Republika e Shqipërisë lejohet vetëm me autorizim të lëshuar nga ministri.
2. Autorizimi për eksportin e mbetjeve lëshohet vetëm në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera në fuqi, që rregullojnë fushën e veprimtarisë.
3. Ministri i jep autorizimin për eksportin e mbetjeve të çdo lloji personit që ka paraqitur kërkesën, vetëm pasi të ketë marrë leje nga vendi i importit dhe vendet e kalimit transit e pasi t'i ketë njoftuar ato paraprakisht.
4. Autorizimi i eksportit të mbetjeve është i vlefshëm për një periudhë kohe deri në një vit dhe u nënshtrohet kushteve të përgjithshme, të përshkruara në rregulloret e referuara në pikën 6 të këtij neni, si dhe kushteve specifike që lidhen me rastin konkret.
5. Në autorizimin e eksportit të mbetjeve përcaktohen:
 - a) numri i dokumentit të dorëzimit;
 - b) lloji dhe sasia e mbetjes për të cilën lëshohet;
 - c) standardet që lidhen me ambalazhimin e etiketimin e mbetjeve dhe dokumentet shoqëruese gjatë transportit të tyre;
 - ç) kërkesat për monitorimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve.
6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

KREU X
ORMAT TEKNIKE

Neni 52
Normat teknike minimale

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulloret që përcaktojnë normat teknike minimale për operacionet e trajtimit të mbetjeve.
2. Normat teknike minimale, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni:
 - a) jepen për ndikimet kryesore në mjedis të shkaktuara nga impiantet e trajtimit të mbetjeve;
 - b) sigurojnë që mbetjet të trajtohen në përputhje me këtë ligj dhe në veçanti me nenin 5 të tij;
 - c) marrin në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme;
 - ç) në rast se është e përshtatshme, përfshijnë elemente që lidhen me cilësinë e trajtimit dhe kërkesat e procesit.

KREU XI
KUSHTE TË TJERA PËR LEJEN E MJEDISIT

Neni 53
Kërkesa për leje mjedisi

Personat fizikë a juridikë, që synojnë të kryejnë operacione për trajtimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisi në përputhje me ligjin ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

Neni 54
Kushtet e tjera që duhen përfshirë në lejen e mjedisit

1. Pavarësisht nga kërkesat e ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe nga kërkesat e akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, leja e mjedisit e referuar në nenin 53 të këtij ligji, përmban, gjithashtu, kushte të tjera që duhen plotësuar, ku përcaktohen:

- a) llojet dhe sasi të mbetjeve që trajtohen;
 - b) operacionet që përfshihen në leje, kërkesat teknike dhe kërkesat që lidhen me territorin në fjalë;
 - c) masat e sigurisë dhe masat parandaluese që duhen marrë;
 - ç) metoda që duhet përdorur për secilin operacion;
 - d) operacionet e monitorimit dhe të kontrollit që nevojiten;
 - dh) dispozitat për mbylljen dhe kujdesin e mëtejshëm, sipas nevojës.
2. Leja e mjedisit për incinerimin ose bashkincinerimin e mbetjeve, që shoqërohet me rikuperim energjie, përmban kushtin që rikuperimi i energjisë të kryhet me efikasitet të lartë të energjisë.
3. Aktet, që hartohen në zbatim të këtij ligji, përfshijnë edhe kushte të tjera në lejen e mjedisit, lidhur me rrymat specifike të mbetjeve apo metodat specifike të trajtimit të tyre.

Neni 55

Kërkesa për mbajtjen e të dhënave

1. Kërkesa për mbajtjen dhe përditësimin e të dhënave për mbetjet përcaktohet në:
- a) lejen e mjedisit për personin fizik apo juridik, që krijon mbetje;
 - b) licencën e transportit për personin fizik apo juridik, që grumbullon ose transporton mbetje;
 - c) licencën e tregtarit dhe/apo të agentit;
 - ç) lejen e mjedisit për personin fizik apo juridik, që kryen çdo lloj operacioni për trajtimin e mbetjeve.
2. Të dhënat e referuara në pikën 1 të këtij neni përfshijnë:
- a) të dhëna kronologjike për sasinë, natyrën dhe origjinën e mbetjeve;
 - b) sipas rastit, destinacionin, shpeshhtësinë e grumbullimit, mënyrën e transportit dhe metodën e trajtimit të parashikuar sipas llojit të mbetjeve.
3. Personat e referuar në këtë nen i mbajnë të dhënat për mbetjet e rrezikshme për të paktën 3 vjet.
4. Personat e referuar në këtë nen i mbajnë të dhënat për mbetjet jo të rrezikshme për të paktën 1 vit.
5. Personat fizikë dhe juridikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, i vënë të dhënat e referuara në pikën 2 të këtij neni në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Inspektoriatit për Mjedisin, në bazë të kërkesës së tyre me shkrim.
6. Personat fizikë dhe juridikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoratit për Mjedisin ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjes, në bazë të kërkesës së tyre me shkrim, evidenca të dokumentuara që tregojnë se operacionet e menaxhimit janë kryer.

Neni 56

Inspektimi

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 32, datë 14.2.2013)

1. Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit inspekton instalimet, mbi të cilat zbatohet ky ligj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
2. Inspektimet për çdo operacion grumbullimi dhe transporti përfshijnë origjinën, natyrën, sasinë e mbetjeve të grumbulluara e të transportuara deri në destinacionin përfundimtar.

KREU XII

LICENCIMI I VEPRIMTARIVE PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE

Neni 57

Transportuesit e mbetjeve

1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve.

2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

Neni 58

Tregtarët dhe agjentët e mbetjeve

1. Tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhet nga persona që disponojnë licencën për veprimtaritë e tjera profesionale, lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B.

2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit(QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

Neni 59

Licencimi i veprimtarive

Licencat për veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

KREU XIII

STATISTIKAT E MBETJEVE

Neni 60

Statistikat e mbetjeve

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson statistikat për krijimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

2. Ministria përgatit dhe publikon çdo 3 vjet një raport për statistikat e mbetjeve në Shqipëri.

3. Raporti, që referohet në pikën 2 të këtij neni, publikohet në mënyrë elektronike edhe në faqen zyrtare të internetit të ministrisë dhe i vihet në dispozicion publikut.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

KREU XIV
NDALIMET, SANKSIONET DHE NDËSHKIMET

Neni 61
Ndalimet

Ndalohen:

- a) hedhja apo gruposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike;
- b) hedhja apo gruposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në parcelat bujqësore të mbjella ose jo, në anë të kanaleve kulluese e ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bima dhe kafsha;
- c) hedhja apo gruposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore;
- ç) djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve në kundërshtim me këtë ligj;
- d) braktisja, depozitimi apo asgjësimi i pakontrolluar i mbetjeve.

Neni 62
Kundërvajtjet dhe sanksionet

(Shtuar pika 63 me ligjin nr. 32, datë 14.2.2013; dryshuar pika 48 dhe shfuqizuar pika 51, me ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013;)

Shkeljet e mëposhtme, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

1. Çdo person, që përzier mbetje në kundërshtim me nenet 17 pika 2 dhe 24 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
2. Çdo person, që asgjëson mbetje jo në përputhje me nenin 19 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
3. Çdo krijues apo mbajtës mbetjesh, që trajton vetë mbetjet e veta jo në përputhje me këtë ligj dhe në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.
4. Çdo krijues apo mbajtës mbetjesh, që transferon mbetje te një person tjetër që nuk është i autorizuar të marrë atë mbetje, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.
5. Çdo person, që grumbullon apo transporton mbetje dhe nuk e dërgon atë në një instalim trajtimi të përshtatshëm, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
6. Çdo person, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme pa një dokument transferimi mbetjesh, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
7. Çdo person, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme, që nuk është në përputhje me dokumentin e transferimit të mbetjes, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
8. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentet, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 (treqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
9. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ua vë dokumentet në dispozicion autoriteteve përkatëse, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 (treqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
10. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 (treqind mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

11. Mungesa e kushteve dhe standardeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve që krijohen brenda territorit të njërive të qeverisjes vendore jo në përputhje me kërkesat e nenit 21 pika 12 të këtij ligji, ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e këtyre njërive, të cilët dënohen me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

12. Çdo person, që importon mbetje që destinohen për incinerim jo në përputhje me nenin 22 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

13. Çdo person, që prodhon, grumbullon, transporton, magazinon apo trajton mbetje të rrezikshme jo në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

14. Çdo person, që transporton mbetje të rrezikshme me automjete, që nuk janë në përputhje me nenin 23 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

15. Çdo person, që grumbullon, transporton apo magazinon mbetje të rrezikshme që nuk është ambalazhuar apo etiketuar, në përputhje me nenin 25 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

16. Çdo person, që transferon mbetje të rrezikshme apo që merr në dorëzim mbetje të rrezikshme pa një dokument dorëzimi, në kundërshtim me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

17. Çdo person, që transferon mbetje të rrezikshme apo që merr në dorëzim mbetje të rrezikshme, që nuk është në përputhje me dokumentin e dorëzimit, në kundërshtim me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

18. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentet, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

19. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk ia vë dokumentet në dispozicion autoriteteve përkatëse, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

20. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

21. Çdo person, që trajton vavra të përdorura pa leje mjedisi, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

22. Çdo person, që trajton vavra të përdorura jo në përputhje me lejen e mjedisit, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

23. Çdo person, që përzier vavra të përdorura jo në përputhje me lejen e mjedisit, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

24. Çdo person, që hedh në treg ambalazhe jo në përputhje me nenin 30, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

25. Çdo person, që angazhohet në menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

26. Çdo person, që asgjëson ose menaxhon NOQ jo në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

27. Çdo person, që hedh në treg bateri apo akumulatorë jo në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

28. Çdo person, që grumbullon, trajton, riciklon apo asgjëson mbetje baterish dhe akumulatorësh jo në përputhje me nenin 31 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

29. Çdo person, që angazhohet me automjetet në fund të jetës jo në përputhje me nenin 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

30. Çdo person, që hedh në treg pajisje elektrike dhe elektronike jo në përputhje me nenin 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

31. Çdo person, që angazhohet me mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike jo në përputhje me nenin 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

32. Çdo person, që përdor llumrat e ujërave të zeza në bujqësi jo në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

33. Çdo person, që angazhohet me mbetjet spitalore jo në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

34. Çdo person, që angazhohet me nënproduktet e kafshëve jo në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

35. Çdo person, që angazhohet me mbetjet inerte jo në përputhje me nenin 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

36. Çdo person, që angazhohet me mbetjet nga industria nxjerrëse jo në përputhje me nenin 38 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

37. Çdo person, që angazhohet me mbetjet nga industria e dioksidit të titanit jo në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

38. Çdo person, që angazhohet me mbetjet e gjeneruara nga anijet dhe ngarkesat jo në përputhje me nenin 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

39. Çdo person që angazhohet me mbetjet nga gomat e përdorura jo në përputhje me nenin 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

40. Çdo person, që vepron në kundërshtim me kërkesat e nenit 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

41. Çdo person, që asgjëson mbetje në një lëndfill, që nuk është klasifikuar për atë mbetje, në kundërshtim me nenin 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

42. Çdo person, që asgjëson në lëndfill mbetje që nuk është trajtuar, në kundërshtim me nenin 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

43. Çdo person, që pranon mbetje në një lëndfill që nuk plotëson kriteret e pranimi në lëndfill, në kundërshtim me nenin 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

44. Çdo person, që pranon mbetje të përjashtuara apo që asgjëson në lëndfill mbetje të përjashtuara, në kundërshtim me nenin 44 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

45. Çdo person, që operon një lëndfill jo në përputhje me lejen e mjedisit apo jo në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

46. Çdo person, që operon një lëndfill pa një garanci financiare, në kundërshtim me nenin 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

47. Çdo person, që incineron mbetje jo në përputhje me lejen e mjedisit apo jo në përputhje me nenin 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

48. Çdo person që importon mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

49. Çdo person, që transiton mbetje të rrezikshme përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

50. Çdo person, që importon mbetje jo të rrezikshme për ruajtje apo asgjësim, sipas nenit 48 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

51. Shfuqizuar.

52. Çdo person, që transiton mbetje jo të rrezikshme përmes territorit të Republikës së Shqipërisë pa autorizim apo në kundërshtim me autorizimin, jo në përputhje me nenin 50 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

53. Çdo person, që eksporton mbetje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa autorizim apo në kundërshtim me autorizimin, jo në përputhje me nenin 51 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

54. Çdo person, që kryen veprimtari për trajtimin e mbetjeve pa leje mjedisi në kundërshtim me nenin 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

55. Çdo person, që kryen veprimtari për trajtimin e mbetjeve jo në përputhje me lejen e mjedisit, në kundërshtim me nenin 53 apo 54 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

56. Çdo person, që nuk ruan dokumentet apo nuk ia vë ato në dispozicion autoriteteve përkatëse, në kundërshtim me nenin 55 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

57. Çdo person, që transporton mbetje pa licencë apo jo në përputhje me licencën, në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

58. Çdo person, që vepron si agent apo tregtar mbetjesh pa licencë apo jo në përputhje me licencën, në kundërshtim me nenin 58 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

59. Çdo person, që hedh apo gropos mbetje në një vend publik, në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

60. Çdo person, që djeg mbetje, në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

61. Çdo person, që braktis, shkarkon apo asgjëson mbetje në mënyrë të pakontrolluar në kundërshtim me nenin 61 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

62. Çdo operator i një venddepozitimi/lendfilli ekzistues, që nuk plotëson kërkesat e nenit 64 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

63. Gjoba, në zbatim të këtij neni, vendoset nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me ligjin për inspektimin dhe është dënim kryesor.

Neni 63

Masat në rastet e shkeljes së lejes së mjedisit

(Ndryshuar me ligjin nr. 32, datë 14.2.2013)

1. Autoritetet, në rastet e shkeljes së lejes së mjedisit, marrin masat e parashikuara në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

2. Kur shkelja e këtij ligji ka të bëjë me përdorimin e një automjeti, ky i fundit konfiskohet nga autoritetet përkatëse, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Licenca e transportit të mbetjeve, e tregtarit dhe agentit të mbetjeve revokohet nga ministri, me propozimin e inspektorit, kur shkelen kushtet dhe rregullat e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit për ushtrimin e veprimtarisë dhe, për këtë, ministri njofton Qendrën Kombëtare të Licencimit.

4. Inspektori, sipas nevojave të rastit, merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin. interesat.

Neni 63/1

Ankimi dhe ekzekutimi

(Shtuar me ligjin nr. 32, datë 14.2.2013)

1. Ndaj vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim sipas ligjit për inspektimin.

2. Ndaj vendimeve të organeve të tjera, të marra në zbatim të këtij ligji, bëhet ankim sipas dispozitave në fuqi.

3. Kundërvajtësi paguan gjobën administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, me përjashtim të rastit kur vendimi për gjobën është pezulluar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Kur gjoba administrative nuk është paguar brenda datës së caktuar në pikën 3 të këtij neni, autoriteti përkatës ka të drejtë të pezullojë apo të revokojë lejen e mjedisit, licencën apo autorizimin derisa gjoba të paguhet.

5. Të ardhurat e grumbulluara nga gjobat dhe interesat derdhen në Buxhetin e Shtetit

KREU XV

DISPOZITA RREGULLUESE

Neni 64

Venddepozitimet/lendfillet ekzistuese

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat që parashikojnë dispozitat kalimtare për venddepozitimet/lendfillet ekzistuese, që janë në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi.

Neni 65

Nxiti e investimeve private dhe e partneritetit publik privat

1. Këshilli i Ministrave nxit angazhimin e sektorit privat dhe partneritetin publik privat në veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

2. Projektet që, në gjykimin e ministrisë, synojnë të realizojnë masat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, jepen me koncesion, në përputhje me ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

Neni 66

Raportimet

1. Ministria përgatit çdo tre vjet një raport për zbatimin e këtij ligji.

2. Raporti përfshin informacion për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe për progresin e bërë, lidhur me zbatimin e programeve të parandalimit të mbetjeve dhe, sipas rastit, edhe për masat e marra lidhur me përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati për Mjedisin dhe institucione të tjera ia sigurojnë këto informacione ministrisë për përgatitjen e raportit të referuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Raportet e referuara në pikën 1 të këtij neni publikohen në faqen zyrtare të ministrisë dhe i vihen në dispozicion publikut.

5. Ministri, me urdhër, përcakton kërkesat për përgatitjen e raporteve të referuara në pikën 1 të këtij neni, bashkë me informacionin që duhet të përmbajnë këto raporte.

KREU XVI

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 67

Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave, brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore, në zbatim të neneve 7 pika 2, 8 pika 2, 9 pika 1, 11 pikat 5 dhe 8, 13 pikat 7 dhe 10, 14 pika 6, 15 pika 1, 16 pika 1, 17 pika 3, 18 pikat 4 dhe 5, 20 pika 2, 21 pikat 3, 4 e 11, 22 pika 4, 23 pika 6, 25 pika 3, 26 pika 7, 27 pika 4, 28 pika 2 shkronjat “a” dhe “b”, 29 pika 1 shkronjat “a”, “b” e “c”, 30 pikat 1 e 2, 31, 32 pika 1, 33 pikat 1, 2 e 3, 34, 35, 36, 37, 38 pika 1, 39, 40; 41 pika 4, 42, 43 pikat 6 dhe 7, 44 pika 3, 45 pikat 1 dhe 2, 46 pika 6, 47, 49 pika 8, 50 pika 5, 51 pika 6, 52 pika 1, 57 pika 3, 58 pika 3, 60 pika 4 dhe 64 të tij.

2. Ministri brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 12 pika 5 dhe 66 pika 4 të tij.

Neni 68

Vazhdimi i efekteve të disa akteve nënligjore

Aktet nënligjore të mëposhtme mbeten në fuqi deri në shfuqizimin e tyre me akt të veçantë:

a) vendimi nr. 99, datë 18.2.2005 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”;

b) rregullorja nr. 1, datë 30.3.2007 e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet, që nga krijimi dhe transporti i tyre për asgjësim”;

c) vendimi nr. 798, datë 29.9.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””;

ç) udhëzimi nr. 6, datë 27.11.2007 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”;

d) vendimi nr. 806, datë 4.12.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave e procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi e riciklimi”;

dh) rregullorja nr. 4, datë 15.10.2003 e Ministrit të Mjedisit “Për kërkimin, shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të eksportimit dhe të transitimit të mbetjeve”.

Neni 69 **Shfuqizimet**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta”, ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

DISPOZITË KALIMTARE E LIGJIT NR.32, DATË 14.2.2013.

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

DISPOZITË KALIMTARE E LIGJIT NR 156/2013, DATË 10.10.2013

1. Subjektet, të cilat, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë pajisur me autorizim për importimin e mbetjeve jo të rrezikshme, janë të detyruara që, për sasinë e mbetjeve që kanë importuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të përfundojnë procesin e riciklimit brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

2. Çdo dispozitë ligjore dhe akt nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 70 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA 1 **OPERACIONET E ASGJËSIMIT**

D1 Depozitimi nën dhe ose mbi dhe (p.sh. në lëndfill etj.).

D2 Trajtimi në tokë (p.sh. biodegradimi i shkarkimeve të lëngshme ose llumrave në tokë etj.).

D3 Injektimi në thellësi (p.sh. injektimi i shkarkimeve me pompim në puse, kripore apo në vende që nga vetë natyra e tyre janë të përshtatshme për depozitim mbetjesh etj.).

D4 Mbulimi sipërfaqësor, përfshirë vendosjen e mbetjeve të lëngshme ose llumrave në gropa, pellgje ujore apo laguna etj.

D5 Lëndfillet me projekte inxhinierike të posaçme (p.sh. vendosja në qeliza të veçanta, të renditura njëra pas tjetrës, të cilat mbulohen dhe izoloohen nga njëra- tjetra dhe nga mjedisi etj.).

D6 Shkarkimi në një trup ujqor, me përjashtim të deteve/oqeanëve.

D7 Shkarkimi në dete/oqeanë, përfshirë futjen/depozitimin në shtratin e detit.

D8 Trajtimi biologjik që nuk specifikohet në ndonjë pjesë tjetër të kësaj Shtojce, që rezulton me përbërje ose përzierje përfundimtare, të cilat shkarkohen me anë të cilitdo nga operacionet e renditura nga D 1 deri në D 12.

D9 Trajtimi fizio-kimik që nuk specifikohet në ndonjë pjesë tjetër të kësaj Shtojce, që rezulton me përbërje ose përzierje përfundimtare, të cilat shkarkohen me anë të cilitdo nga operacionet e renditura nga D 1 deri në D 12 (p.sh.avullimi, tharja, kalcifikimi etj.).

D10 Incinerimi mbi tokë.

D11 Incinerimi në det.

D12 Ruajtja/magazinimi i përhershëm (p.sh. vendosja e konteinerëve në një minierë etj.).

D13 Përzierja ose bashkimi para se t'i nënshtrohen cilitdo prej operacioneve të renditura nga D1 deri në D 12.

D14 Riambalazhimi para se t'i nënshtrohet cilitdo prej operacioneve të renditura nga D 1 deri në D 13.

D15 Ruajtja/magazinimi në pritje të cilitdo prej operacioneve të renditura nga D 1 deri në D 14 (me përjashtim të ruajtjes paraprake në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetet janë krijuar).

SHTOJCA 2 OPERACIONET E RIKUPERIMIT

R 1 Përdorimi kryesisht si lëndë djegëse ose mënyra të tjera për prodhimin e energjisë. Kjo përfshin impiantet e incinerimit, që përdoren për përpunimin e mbetjeve të ngurta bashkiake vetëm kur efienca e energjisë është e barabartë me ose më e madhe se:

- 0,60 për instalimet që janë operative dhe kanë marrë një leje mjedisi, në përputhje me legjislacionin përkatës përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;

- 0,65 për instalimet që kanë marrë një leje mjedisi, në përputhje me legjislacionin përkatës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Duke përdorur formulën e mëposhtme: Efienca e energjisë = $(E_p - (E_f + E_i)) / (0,97 \times (E_e + E_f))$

Ku:

E_p - është energjia vjetore e prodhuar si nxehtësi ose elektricitet. Është llogaritur me energji në trajtë elektriciteti shumëzuar me 2,6 dhe nxehtësi e prodhuar për përdorim tregtar e shumëzuar me 1,1 (GJ/vit).

E_f - është inputi vjetor i energjisë në sistem nga lëndët djegëse që kontribuojnë në prodhimin e avullit (GJ/vit).

E_e - është energjia vjetore që përmbahet në mbetjet e trajtuara të llogaritura, duke përdorur vlerën kalorifike neto të mbetjeve (GJ/vit).

E_i - është energjia vjetore e importuar duke përjashtuar E_e dhe E_f (GJ/vit).

0,97 - është një faktor që merr parasysh humbjet e energjisë për shkak të hirave fundorë dhe rrezatimit.

R 2 Rikuperimi/rikrijimi i solventëve/tretësve.

R 3 Riciklimi/përtëritja e substancave organike që nuk janë përdorur si solventë/tretës (përfshirë përzierje plehrash dhe të tjera procese të transformimit biologjik). Ky përfshin gazifikimin dhe pirolizën, që i përdorin këto përbërës si kimikate.

R 4 Riciklimi/ripërtëritja e metaleve dhe komponimeve të tyre.

R 5 Riciklimi/ripërtëritja e materialeve të tjera inorganike. Ky përfshin pastrimin e tokës, që rezulton me rikuperimin e dheut dhe riciklimin e materialeve inorganikë të ndërtimit.

R 6 Ripërtëritja e acideve ose bazave.

R 7 Rikuperimi i përbërësve të përdorur për luftimin e ndotjes.

R 8 Rikuperimi i komponentëve të katalizatorëve

R 9 Rirafinimi i naftës ose ripërdorime të tjera të saj.

R 10 Trajtimi i tokës që rezulton në të mirë të bujqësisë ose të përmirësimit ekologjik.

R11 Përdorimi i mbetjeve të përfuara nga cilido nga operacionet e renditura nga R 1 deri në R 10.

R 12 Shkëmbimi i mbetjeve për t'iu nënshtruar cilitdo nga operacionet e renditura nga R 1 deri tek R 11. Në qoftë se nuk ka një kod tjetër të përshtatshëm R, ky mund të përfshijë operacionet paraprake para rikuperimit përfshirë para-përpunimin siç është, inter alia, çmontimi, grumbullimi i diferencuar, thyerja/copëtimi, ngjeshja, peletizimi, tharja, grirja, zbutja, riambalazhimi, ndarja, bluarja apo përzjerja para dorëzimit në cilindo nga operacionet e numëruara R1 deri R11.

R 13 Ruajtja e mbetjeve në pritje të cilitdo nga operacionet e renditura nga R1 deri në R 12 (me përjashtim të ruajtjes paraprake, në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

SHTOJCA 3

VETITË E MBETJEVE QË I KLASIFIKOJNË ATO SI TË RREZIKSHME

H 1 “Shpërthyesë”

Substanca dhe preparate që mund të shpërthejnë nën efektin e flakës ose që janë më të ndjeshme ndaj goditjes ose fërkimit sesa dinitrobenzeni.

H 2 “Oksiduese”

Substanca dhe preparate që shfaqin reaksione eksotermike të larta kur hyjnë në kontakt me substanca të tjera, në mënyrë të veçantë substanca të djegshme.

H 3-A “Shumë të djegshme”

- Substancat e lëngshme dhe preparatet që e kanë pikën e ndezjes nën 21 °C (përfshirë lëngje me djegshmëri shumë të lartë), ose

- Substancat dhe preparatet që mund të nxehen dhe në fund të marrin flakë në kontakt me ajrin në temperaturë mjedisi pa përdorimin e energjisë, ose

- Substancat dhe preparatet e ngurta që mund të marrin flakë me lehtësi pas një kontakti të shkurtër me një burim flake dhe që vazhdojnë të digjen ose të konsumohen pas largimit të burimit të flakës, ose

- Substancat dhe preparatet e gazta që digjen në ajër në presion normal, ose

- Substancat dhe preparatet që, në kontakt me ujin ose ajrin e lagësht, çlirojnë gaze me djegshmëri të lartë në sasi të rrezikshme.

H 3-B “Te djegshme”

Substancat dhe preparatet e lëngshme që e kanë pikën e ndezjes të barabartë ose më të madhe se 21° C dhe më të vogël ose të barabartë me 55 ° C.

H 4 “Irrituese”

Substancat dhe preparatet jokorrozive që, përmes kontaktit të menjëhershëm, të zgjatur ose kontaktit të përsëritur me lëkurën ose membranat e mukozës, mund të shkaktojnë inflamacion.

H 5 “Dëmtuese”

Substancat dhe preparatet që, në qoftë se thithen përmes rrugëve të frymëmarrjes ose gëlltiten, ose në qoftë se depërtojnë në lëkurë, mund të përfshijnë rreziqe të limituara për shëndetin.

H 6 “Toksike”

Substancat dhe preparatet (përfshirë substancat dhe preparatet shumë toksike) që, në qoftë se thithen përmes rrugëve të frymëmarrjes, gëlltiten apo depërtojnë në lëkurë, mund të shkaktojnë rrezik shëndetësor serioz, akut ose kronik ose edhe vdekje.

H 7 “Kancerogjene”

Substancat ose preparatet që, në qoftë se thithen përmes rrugëve të frymëmarrjes, gëlltiten apo depërtojnë në lëkurë, mund të shkaktojnë kancer ose të rrisin mundësinë për shfaqjen e tij.

H 8 “Gërryese”

Substancat ose preparatet që mund të shkatërrojnë indet e gjalla përmes kontaktit me to.

H 9 “Infektuese”

Substancat ose preparatet që përmbajnë mikroorganizma të mundshëm ose toksina të tyre, që njihen ose besohet se shkaktojnë sëmundje për njeriun apo organizma të tjerë të gjallë.

H 10 “Toksike për riprodhimin”

Substancat ose preparatet që, në qoftë se thithen përmes rrugëve të frymëmarrjes, gëlltiten apo depërtojnë në lëkurë, mund të shkaktojnë keqformime jo të trashëgueshme në lindje ose të rrisin mundësinë e shfaqjes së tyre.

H 11 “Mutagjenike”

Substancat ose preparatet që, në qoftë se thithen përmes rrugëve të frymëmarrjes, gëlltiten apo depërtojnë në lëkurë, mund të shkaktojnë defekte gjenetike të trashëgueshme ose të rrisin mundësinë për shfaqjen e tyre.

H 12 Mbetjet që çlirojnë gaze toksike ose shumë toksike kur hyjnë në kontakt me ujin, ajrin ose me një acid.

H 13 “Rritëse të ndjeshmërisë”

Substancat dhe preparatet që, në qoftë se thithen përmes rrugëve të frymëmarrjes, gëlltiten apo depërtojnë në lëkurë, janë të afta të shkaktojnë një reaksion hiperndjeshmërie të tillë, që ndaj ekspozimeve të mëtejshme ndaj substancës shkakton efekte negative karakteristike.

H 14 “Ekotoksike”

Mbetjet që shfaqin ose mund të shfaqin rreziqe të menjëhershme ose të vonuara për një ose më shumë sektorë të mjedisit.

H 15 Mbetjet që në çdo rast, pas asgjësimit, kanë aftësinë të prodhojnë një substancë tjetër, p.sh. një substancë kulluese, e cila zotëron ndonjë nga karakteristikat e përmendura më sipër.

Shënime

1. Atributimi i karakteristikave të rrezikshme “toksike” (dhe “shumë toksike”), “të dëmshme”, “gërryese”, “irrituese”, “kancerogjene”, “toksike për riprodhimin”, “mutagjenike” dhe “ekotoksike” është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara në akte të tjera ligjore e nënligjore.

2. Sipas rastit, do të zbatohen vlerat limit që lidhen me klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e preparateve të rrezikshme, të përcaktuara në akte të tjera.

3. Metodat që duhet të përdoren janë përshkruar në ligjin nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 11.12.2003 “Për klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e sigurt të substancave dhe preparateve kimike”.

SHTOJCA 4

PLANI KOMBËTAR I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

Pjesa A

Plani Kombëtar i Menaxhimit të IntegrUAR të Mbetjeve përmban:

- Analizën e situatës aktuale të menaxhimit të integrUAR të mbetjeve në Shqipëri;
- Analizën e masave që duhen marrë për të përmirësuar përgatitjen për ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve pa ndikuar mbi mjedisin; dhe
- Vlerësimin mbi mënyrën se si plani do të mbështesë zbatimin e objektivave dhe të kërkesave të këtij ligji.

2. Plani Kombëtar i Menaxhimit të IntegrUAR të Mbetjeve përmban, gjithashtu, sipas rastit, aty ku është e përshtatshme të paktën edhe:

a) llojin, sasinë dhe burimin e mbetjeve të krijuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, mbetjet që mund të importohen ose eksportohen dhe një vlerësim për zhvillimin e rrymave të mbetjeve në të ardhmen;

b) skemën ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve dhe instalimet e mëdha të asgjësimit dhe rikuperimit, përfshirë tërësinë e organizimeve të veçanta për vajrat e përdorura, mbetjet e rrezikshme ose rrymat e tjera të mbetjeve, siç përcaktohen në aktet nënligjore përkatëse;

c) vlerësimin e nevojës për skemat e reja të grumbullimit, mbylljen e instalimeve ekzistuese të mbetjeve, infrastrukturën e instalimeve shtesë për mbetjet, në përputhje me nenin 21 parimet e vetësuficiencës dhe afërsisë, dhe, në qoftë se nevojitet, edhe investimet përkatëse;

ç) informacion të mjaftueshëm mbi kriteret e vendndodhjes për identifikimin e territorit/sheshit dhe kapacitetin e instalimeve të ardhshme të asgjësimit ose instalimeve të mëdha të rikuperimit, në qoftë se është e nevojshme;

d) politikat e përgjithshme të menaxhimit të integruar të mbetjeve, përfshirë teknologjinë dhe metodat e menaxhimit të planifikuar të mbetjeve ose

dh) politikat e mbetjeve që shkaktojnë probleme specifike për menaxhimin.

Pjesa B

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve mund të përmbajë:

a) aspektet organizative të lidhura me menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë përshkrimin e përcaktimit të përgjegjësisë midis aktorëve të sektorit publik dhe atij privat që merren me menaxhimin e mbetjeve;

b) vlerësimin e dobishmërisë dhe përshtatshmërisë së përdorimit të instrumenteve ekonomike dhe instrumenteve të tjera në përballjen me problemet e ndryshme të mbetjeve;

c) përdorimin e fushatave ndërgjegjëse dhe ofrimin e informacionit për mbarë publikun ose konsumatorët specifikë;

ç) sheshet/territoret historike të ndotura/të kontaminuara të asgjësimit të mbetjeve dhe masat për rehabilitimin e tyre.

SHTOJCA 5

PROGRAMET E PARANDALIMIT TË MBETJEVE

Programet e parandalimit të mbetjeve:

1. Përcaktojnë objektivat e parandalimit të mbetjeve dhe masat që duhen marrë për të realizuar këta objektiva. Këto masa dhe objektiva kanë për qëllim të prishin lidhjen që aktualisht ekziston midis rritjes ekonomike dhe ndikimeve në mjedis që shkaktohen nga krijimi i mbetjeve.

2. Përshkruajnë dhe vlerësojnë efektivitetin e masave parandaluese ekzistuese.

3. Vlerësojnë progresin dhe efektivitetin e masave parandaluese, krahasuar me tërësinë e pikave të referimit ose indikatorëve cilësorë apo sasiorë që janë adoptuar.

4. Vlerësojnë dobishmërinë e masave parandaluese apo masave të tjera të përshtatshme, përfshirë:

a) Masa që mund të prekin kushtet bazë që lidhen me krijimin e mbetjeve.

i) Përdorimi i masave të planifikimit ose instrumenteve të tjerë ekonomikë që nxisin përdorimin eficient të burimeve.

ii) Nxitja e kërkimit dhe zhvillimit në fushën e teknologjive dhe produkteve më të pastra dhe produkteve dhe teknologjive që krijojnë me më pak mbetje dhe përhapja e përdorimi i rezultateve të këtij kërkimi e zhvillimi.

iii) Zhvillimi i indikatorëve kuptimplotë dhe efektivë të trysnive mbi mjedisin që lidhen me krijimin e mbetjeve dhe që synojnë të kontribuojnë në parandalimin e krijimit të mbetjeve në të gjitha nivelet, duke filluar nga krahasimet midis produkteve tek veprimet e ndërmarra nga autoritetet e pushtetit vendor e deri te masat në nivel kombëtar.

b) Masa që prekin fazën e projektimit, prodhimit dhe shpërndarjes.

i) Nxitja e ekoprojektimit (integrimi sistematik i aspekteve mjedisore në projektimin e produktit, me qëllim që të përmirësojë performancën e produktit në mjedis gjatë gjithë ciklit të jetës së tij).

ii) Ofrimi i informacionit mbi teknikat për parandalimin e mbetjeve, që synon lehtësimin e zbatimit të teknikave më të mira të disponueshme për çdo industri.

iii) Organizimi, për autoritetet përkatëse, i trajnimeve që instruktojnë se si të përfshihen

kërkesat për parandalimin e mbetjeve në Lejet e Mjedisit të tipit A në bazë të ligjit për lejet e mjedisit.

iv) Përfshirja e masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve në instalimet që kërkojnë Leje Mjedisit të tipit B ose C në bazë të ligjit për lejet e mjedisit. Aty ku është e përshtatshme, masa të tilla mund të përfshijnë plane ose vlerësime për parandalimin e mbetjeve.

v) Përdorimi i fushatave ndërgjegjësuere apo dhënia e mbështetjes financiare, në vendimmarrje apo mbështetje të tjera për bizneset. Këto masa mund të jenë veçanërisht efektive kur ato kanë në fokus dhe përshtaten për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe funksionojnë përmes rrjeteve të ngritura/ekzistuese të biznesit.

vi) Përdorimi i marrëveshjeve vullnetare, grupimeve/komiteteve të konsumatorëve dhe prodhuesve ose negociatave sektoriale me qëllim që bizneset apo sektorët industrialë përkatës të hartojnë planet ose objektivat e veta të parandalimit të mbetjeve ose të korrigjojnë produktet apo ambalazhet që krijojnë shumë mbetje.

vii) Nxitja e sistemeve të menaxhimit të mjedisit të besueshme, përfshirë EMAS dhe ISO 14001.

c) Masa që mund të prekin fazën e konsumit dhe të përdorimit.

i) Instrumentet ekonomike, si nxitëse për blerje të pastra ose vendosja e një pagese të detyrueshme për tu paguar nga konsumatorët për një produkt apo element të caktuar të ambalazhit, që në rast të kundërt do të jepej falas.

ii) Përdorimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe ofrimi i informacionit për mbarë publikun ose konsumatorë të veçantë.

iii) Nxitja e ekoetiketave të besueshme.

iv) Marrëveshjet me industrinë, si përdorimi i grupimeve/komiteteve për produktet siç janë ato që mund të jenë ngritur në kuadër të Politikave të Integruara për Produktet ose me shitësit me pakicë mbi disponueshmërinë e informacionit për parandalimin e mbetjeve dhe produkteve me ndikim më të ulët në mjedis.

v) Në kontekstin e prokurimeve publike apo të korporatave, integrimi i kriterëve mjedisore dhe atyre të parandalimit të mbetjeve në tekstet e thirrjeve për tender dhe të kontratave.

vi) Nxitja e ripërdorimit dhe/ose riparimit të produkteve të përshtatshme që janë hedhur apo pjesëve të tyre përbërëse, veçanërisht përmes përdorimit të masave edukuese, ekonomike, logjistike apo masave të tjera, si mbështetja apo ngritja e rrjeteve dhe qendrave të akredituara për riparimin dhe ripërdorimin, sidomos në rajonet me densitet të lartë të popullsisë.

LIGJ
Nr.8308, datë 18.3.1998

PËR TRANSPORTET RRUGORE¹⁰

(Ndryshuar me ligjet nr. 8908, datë 6.6.2002, nr. 9096, datë 3.7.2003, nr. 9373, datë 14.4.2005, nr. 9760, datë 21.6.2007, nr. 10137, datë 11.5.2009, nr. 10 302, datë 15.7.2010, nr. 118, datë 13.12.2012, nr. 21, datë 14.2.2013, nr. 37, datë 10.4.2014, nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

a) Ky ligj do të zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

b) Ky ligj do të zbatohet, gjithashtu, për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të mallrave për të tretë, me qira ose për nevojat e veta brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

c) Transporti rrugor i mallrave për të tretë dhe me qira ose për nevojat e veta përshin ngarkimin, shkarkimin dhe lëvizjen bosh dhe plot të mjetit.

Neni 2

a) Transporti brenda territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë është i ndaluar për transportuesit e huaj që nuk e kanë selinë në Shqipëri, me përjashtim të rasteve kur ata janë regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe punojnë me mjete të regjistruara në Shqipëri.

b) Në përputhje me rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë, rregulli i mësipërm mund të mos zbatohet.

¹⁰ Ligji nr.8308, datë 18.3.1998 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.8 1998.
Ligji nr. 8908, datë 6.6.2002 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, qershor 2002.
Ligji nr.9096, datë 3.7.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64, gusht 2003.
Ligji nr. 9373, datë 14.4.2005 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 11 maj 2003.
Ligji nr.9760, datë 21.6.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 81, datë 6 korrik 2007.
Ligji nr. 10137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 12 qershor 2009.
Ligji nr. 10 302, datë 15.7.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 11 gusht 2010.
Ligji nr. 118, datë 13.12.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, dhjetor 2012.
Ligji nr. 21, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 29, datë 11 mars 2013.
Ligji nr. 37, datë 10.4.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 63, datë 7 maj 2014.
Ligji nr. 10/2016, datë 11.2.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.35, datë 7 mars 2016.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, shtuar pikat me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007, shtuar dhe ndryshuar pika 3.21 me ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010, ndryshuar pika 3.25 me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Në këtë ligj termat e përdorur kanë këtë kuptim:

3.1. Transportues: person fizik ose juridik, i cili shfrytëzon mjete të transportit rrugor në pronësi në bashkëpronësi ose me qira.

3.2. Ministri: ministria përgjegjëse për veprimtarinë e transporteve.

3.3. Ministër: personi i ngarkuar me detyrën e ministrit përgjegjës për veprimtarinë e transporteve.

3.4. Mjet motorik (mjet): të gjitha mjetet e transportit që shfrytëzojnë pjesërisht a tërësisht fuqinë mekanike motorike si tërheqës ose përfshirë në të, përveç atyre hekurudhore.

3.5. Autobus: mjet motorik i prodhuar vetëm për transportin e udhëtarëve me më shumë e 8 vende të ulura, përveç atij të drejtuesit të automjetit.

3.6. Taksi: mjet motorik i prodhuar vetëm për transportin e udhëtarëve me vende të ulura jo më pak se 4 dhe jo më shumë se 8, përveç atij të drejtuesit të automjetit, që ka jo më pak se katër dyer për autoveturat dhe jo më pak se tre dyer funksionale për mikrobuse dhe është i pajisur me taksimetër.

3.7. Kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve, të caktuar për përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

3.8. Tërheqës: mjet i destinuar për tërheqjen vetëm të rimorkiove ose të gjysëmrimorkiove.

3.9. Drejtues i mjetit motorik: çdo shtetas që ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e një mjeti motorik.

3.10. Transport i rregullt udhëtarësh është shërbim i rregullt transporti në itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportuesi dhe të përcaktuara më parë në rregulloren e udhëtimit. Ky shërbim mund të jetë qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar dhe shërbim i rregullt, i specializuar.

3.11. Transport i rastit i udhëtarëve nënkupton shërbimet që nuk përfshihen në shërbimet e rregullta brenda vendit ose ato ndërkombëtare, të përkufizuara në pikën 3.10 të nenit 3, të cilat kryhen në itinerarin, me çmimin, shkallën e shërbimit dhe kushtet e tjera, që përcaktohen në marrëveshjen ndërmjet transportuesit dhe përdoruesit.

3.12. Shërbim taksi: shërbimi publik që siguron një transport të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë të udhëtarëve dhe bagazheve të tyre.

3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

3.15. Transport ndërkombëtar: transporti i mallrave për të tretë me qira ose për llogari të vet (pjesërisht) jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë.

3.16. Organe transporti janë organet dhe zyrat që merren me transportin në ministri e organet në varësi të saj, si dhe zyrat në qark, bashki.

3.17. Licencë: e drejta për të kryer veprimtari transporti të rregullt udhëtarësh dhe veprimtari transporti mallrash për të tretë e me qira brenda dhe jashtë vendit në përputhje me këtë ligj.

3.18. Certifikatë:

a) dokument që provon mbajtjen e licencës dhe është i vlefshëm për të drejtën e operimit të një mjeti;

b) dokument që i jep të drejtë një mjeti vetëm për transportin e mallrave për vete brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me pikën 3.13 të këtij ligji.

c) dokument që i jep të drejtën një mjeti për transportin e udhëtarëve, për llogari të vet, brenda dhe jashtë vendit.

3.19. Leje: dokument që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtën e kryerjes së transportit ndërkombëtar për udhëtarë ose për mallra.

3.20. Leje operimi: specifikim i të drejtës për operatorët e huaj të transportit të udhëtarëve për të kryer transport ndërkombëtar brenda territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë siç përmendet në këtë ligj.

3.21. Veprimtaria e operatorit të transportit rrugor të mallrave nënkupton veprimtarinë e çdo ndërmarrjeje, që transporton mallra për të tretë dhe me qira, me anë të mjeteve motorike ose kombinimeve të mjeteve.

3.22. Veprimtaria e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve nënkupton veprimtarinë e çdo ndërmarrjeje, që operon me anë të mjeteve motorike, të konstruara dhe të pajisura në mënyrë të tillë, që të jenë të përshtatshme për të transportuar më shumë se nëntë persona, përfshirë drejtuesin e mjetit dhe të destinuara për këtë qëllim, që kryen shërbime transporti udhëtarësh për kategoritë publike ose të veçanta të përdoruesve, kundrejt pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori i transportit.

3.23. Ndërmarrje nënkupton çdo person fizik ose juridik për qëllime fitimi apo jo, çdo shoqatë ose grup individësh, pa personalitet juridik, me qëllim fitimi ose jo, apo çdo organ zyrtar, që ka personalitetin e vet ligjor ose varet nga një organ, që e ka këtë personalitet.

3.24. Taksimetër nënkupton një instrument matës, i cili, në përputhje me karakteristikat e mjetit ku vendoset dhe tarifat për të cilat fiksohet, llogarit, në mënyrë automatike dhe të vazhdueshme, shumën që do të paguhet nga përdoruesi i mjetit publik, i quajtur taksi, në bazë të distancës së përshkuar dhe/ose kohës, për të cilën mjeti është përdorur.

3.25. “Kabotazhi” nënkupton transportin rrugor të brendshëm për të tretë ose kundrejt pagesës, i kryer përkohësisht nga një transportues jorezident, i vendosur në një shtet tjetër, anëtar ose jo i BE-së.

3.26. “Regjistri Elektronik Kombëtar” nënkupton regjistrin, i cili përmban të dhënat e ndërmarrjeve të transportit rrugor në Shqipëri.

3.27. “Sistemet Inteligjente në Transport” ose “SIT” nënkupton sistemet, në të cilat teknologjitë e informacionit dhe komunikimit zbatohen në fushën e transportit rrugor, që përfshin infra-strukturën, mjetet dhe përdoruesit, dhe në menaxhimin e trafikut dhe të lëvizshmërisë, si dhe për lidhjen me metodat e tjera të transportit.

Neni 3/1

(Shtuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, për të tretë a me qira, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen, respektivisht, në kategoritë VII.1 e VII.2, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje. Veprimtaritë e tjera të transportit, të përcaktuara në këtë ligj, licencohen ose autorizohen sipas dispozitave vijuese në të.

Neni 4

Transportuesit që kryejnë veprimtari transporti në, nga dhe nëpër territorin tokësor të Republikës së Shqipërisë janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe:

- a) Të përdorin mjete transporti që kanë kaluar kontrollin e nevojshëm teknik.
- b) Të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrime e dokumente për çdo mjet dhe për veprimtarinë e vet transportuese, si dhe t'i ruajnë ato për 5 vjet nga data e transportimit.
- c) Të plotësojnë evidenca statistikore sipas formateve të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Përmbajtja, mënyra e regjistrimit, mënyra e raportimit dhe afatet përcaktohen në rregullore të posaçme të ministrit.

ç) Në mjet, gjatë qarkullimit, duhet të jenë dokumentet përkatëse sipas këtij ligji.

Neni 5

(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës. Miratimi i saj në emër të transportuesit bëhet nga ministri ose nga organet e caktuara prej tij.

Licenca është e patjetërsueshme dhe e patransferueshme.

Veprimtaria e transportit të mallrave dhe udhëtarëve për vetë kryhet mbi bazën e certifikatës.

Kriteret, rregullat, afatet dhe dokumentacioni për dhënien e licencës, certifikatës dhe lejes përcaktohen me udhëzim të ministrisë.

Licencat, certifikatat dhe lejet jepen kundrejt pagesës. Tarifat përcaktohen nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

Neni 6

(Ndryshuar me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Këshilli i Ministrave me vendim përcakton rregulla të hollësishme, për:

a) pranimin e ndërmarrjeve në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor për të tretë ose me qira, për mallra ose udhëtarë, mbështetur mbi këto kërkesa:

i) reputacionin e mirë;

ii) qëndrueshmërinë e duhur financiare;

iii) kompetencën profesionale;

iv) vendosjen efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri;

b) njohjen e dokumenteve të lëshuara ose të njohura nga shtetet anëtare të BE-së për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor.

Neni 7

Licenca për veprimtarinë e transportit humbet vlerën kur:

a) vdes ose humb zotësinë për të vepruar mbajtësi i saj;

b) mbaron personi juridik, mbajtësi i licencës;

c) mbaron afati i dhënies së saj.

Neni 8

(Ndryshuar dhe shtuar paragrafi me ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Licenca për veprimtarinë e transportit pezullohet ose hiqet, kur:

a) kërkohet nga mbajtësi i saj;

b) veprimtaria nuk fillon në kohën e përcaktuar në të;

c) mbajtësi i licencës nuk plotëson një ose më shumë nga kërkesat e nenit 6;

ç) mbajtësi i licencës shkel detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Procedurat për pezullimin dhe heqjen e licencës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 9

Shteti, nëpërmjet organeve të veta, organizon transportin e udhëtarëve, kur ai kryhet me mjete motorike, përveç atyre të përdorimit vetjak.

Transporti i udhëtarëve lejohet vetëm me mjete origjinale të prodhuara për këtë lloj transporti.

Kushtet që duhet të plotësojnë këto mjete përcaktohen me udhëzim të Ministrisë.

Neni 10

(Shtuar germa "ç" me ligjin nr. 37, datë 10.4.2014, shtuar shkronja "ç" me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

a) Mbajtësi i licencës, pas pagesës së çdo udhëtari që përdor këtë shërbim, është i detyruar të pajisë atë me biletë ose faturë si provë e qenies së një kontrate mes tyre.

Të drejtat dhe detyrimet specifike të palëve janë përcaktuar në dispozitat e Kodit Civil.

b) Tarifat e transportit të udhëtarëve zbatohen mbi bazën e dispozitave të ligjit "Për çmimet dhe tarifat".

Tarifat e transportit të udhëtarëve me subvencion nga shteti miratohen nga Këshilli i Ministrave.

c) tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.

ç) Tarifat e biletave të transportit rrethqytetës të udhëtarëve miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 11

Ndalohet vendosja në mjetet e transportit të udhëtarëve e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter pornografik.

KREU II.1 TRANSPORTI I UDHËTARËVE BRENDË VENDIT *(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)*

Neni 12

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Transporti i udhëtarëve brenda vendit kryhet nëpërmjet:

- a) shërbimeve në linja të rregullta, transporti qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës;
- b) shërbimeve të rregullta, të specializuara;
- c) transporteve për llogari të vet;
- ç) transporteve të rastit.

Neni 13

Transporti qytetës është një shërbim i veçantë që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, duke kryer shërbim të rregullt me autobusë brenda vijave kufizuese të tij ose duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit.

Neni 14

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, shtuar paragraf me ligjin nr. 37, datë 10.4.2014, shtuar një paragraf pas paragrafit të parë, me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetës, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet.

Përfashtim nga përcaktimet e nenit 13 dhe shkronjës “a”, të paragrafit të parë, të nenit 15, bën vetëm Bashkia e Tiranës, e cila, me vendim të këshillit bashkiak, mund të shtrijë rrjetin e linjave qytetëse në çdo njësi administrative përbërëse, në kufi me njësitë administrative të qytetit të Tiranës, nëse këto njësi përfaqësojnë qendra të zhvilluara e të rëndësishme urbane dhe/ose industriale.

Tarifa e llojit të biletës në transportin qytetas të udhëtarëve me autobus miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me nivelin e standardit të kërkuar për këtë shërbim.

Transporti qytetës kryhet me autobus vetëm nga shoqëritë, të cilat kanë të shprehur në aktet e themelimit, si objekt të veprimtarisë, veprimtarinë e transportit të udhëtarëve.

Licenca për transportin qytetës jepet nga kryetari i bashkisë.

Neni 15

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, shtuar germa “e” me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

1. Transporti i udhëtarëve në linja rrethqytetëse është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:

- a) njësisë administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin;
- b) njësisë administrative përbërëse të së njëjtës bashki;
- c) fshatrave me njëri-tjetrin ose fshatrave në drejtim të qendrës së njësisë administrative së cilës i përkasin dhe/ose një njësie administrative tjetër të së njëjtës bashki;
- ç) fshatrave dhe njësisë administrative përbërëse, të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën.

2. Ky lloj transporti kryhet nga persona juridikë ose fizikë, të pajisur me licencë. Licenca për transportin rrethqytetës jepet nga kryetari i bashkisë ku ka selinë subjekti transportues.

Neni 16

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, ndryshuar germa “a” me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Transporti ndërqytetës i udhëtarëve me autobus, si transport i rregullt, kryhet në linjat kryesore dhe linjat ushqyese, të parashikuara në rrjetin e linjave të miratuara nga ministri.

Linjat kryesore shërbejnë për të plotësuar nevojat e lëvizjes së popullsisë që lidhin bashkitë, si më poshtë:

- a) bashkitë qendër të qarqeve të ndryshme;
- b) një bashki qendër qarku me bashkitë jo qendër qarku të një qarku tjetër ose dy bashki jo qendër qarku të qarqeve të ndryshme.

Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime ose me ndalime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës.

Linjat ushqyese lidhin dy bashki brenda një qarku, me qëndrime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës, të përcaktuara në rrjetin e linjave.

Transporti ndërqytetës kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë.

Neni 17

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9373, datë 14.4.2005, shfuqizuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Transporti ndërqytetës, rrethqytetës dhe ai qytetës i udhëtarëve, si shërbim i rregullt, kryhet nga shoqëritë ose nga personat fizikë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, brenda afatit të përcaktuar në licencë.

Për të fituar të drejtën si shoqëri e vetme në një ose disa linja të rregullta, subjekti transportues duhet të ketë numrin e autobusëve, në përputhje me nevojat e linjës.

Shfuqizuar.

Kushtet dhe rregullat për marrjen e licencës dhe të së drejtës si e vetme shoqëri transporti në një ose disa linja të rregullta përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

Neni 18

(Shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Autobusët ndërqytetës me kohëzgjatje të lëvizjes në linjë më tepër se 8 orë, detyrimisht duhet të jenë me dy drejtues.

Autobusët, që përdoren në shërbimet e rregullta të transportit të udhëtarëve, janë të pajisur me pajisje regjistrimi (tahograf), në përputhje me aktet në fuqi.

Koha e punës dhe e pushimit të drejtuesve të mjetit rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtuesit e autobusëve dhe drejtuesit e autoveturave me 8+1 vende, kur e parashikojnë dispozitat e këtij ligji, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit.

Neni 19

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9373, datë 14.4.2005, ndryshuar me nr. 9760, datë 21.6.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Rrjeti i linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve për secilën linjë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin çdo tre vjet.

Rrjeti i linjave rrethqytetëse, stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 15, miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ndërsa për shkronjën “ç” miratohen nga këshilli i qarkut.

Rrjeti i linjave rrethqytetëse miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cenojë rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose i qarkut, respektivisht, miraton linjat në rrjetin e linjave rrethqytetëse, në të cilat lejohet përdorimi i autoveturave me 8+1 vende.

Hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse dhe ndërqytetëse bazohet mbi të dhënat demografike e gjeografike, gjendjen social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjendjen e infrastrukturës rrugore.

Hartimi i rrjetit të linjave ndërqytetëse mbështetet në nevojat e lëvizjes së udhëtarëve për në ose nga bashkitë qendër qarku, bashkitë e tjera dhe destinacionet dimërore apo verore dhe qendrat historike.

Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore me qendrat e njësive administrative përbërëse dhe qendrat e njësive administrative përbërëse me fshatrat dhe fshatrat ndërmjet tyre.

Neni 20

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, shfuqizuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Neni 21

Shërbimi i transportit të udhëtarëve dhe bagazheve kryhet nëpërmjet agjencive të transportit, rregullat kryesore të veprimtarisë së të cilave përcaktohen me akte të Këshillit të Ministrave.

Neni 21/1

(Shtuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Terminali i autobusëve është infrastruktura e transportit që plotëson kushtet e nevojshme për mbërritjen dhe nisjen e autobusëve, hipjen ose zbritjen e udhëtarëve e të bagazheve të tyre dhe për shërbime të tjera, që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit rrugor. Vendndodhja e terminalit të autobusëve caktohet me vendim të këshillit bashkiak.

Kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, kategorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Operatorët e terminaleve të autobusëve mund të jenë subjekte publike ose private, të pajisura me autorizim nga kryetari i bashkisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Terminali i autobusëve u ofron shërbime në kushte të barabarta të gjithë operatorëve të transportit, që janë të pajisur me licencë për transport udhëtarësh, bazuar në kategorinë e terminalit të autobusëve, sipas tarifave të përcaktuara me udhëzim nga ministria, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat.

Neni 21/2

(Shtuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Çdo udhëtar pajiset me biletë për udhëtimin e përshkruar. Biletat blihen në terminalin e autobusëve, në autobus, në agjenci ose në çdo vend tjetër, të cilit operatori i transportit i ka dhënë të drejtën për shitje.

Udhëtari në autobus paraqet biletën e udhëtimit, me kërkesë të personit të autorizuar nga operatori i transportit ose të organeve të kontrollit në rrugë.

Modeli i biletave të udhëtimit përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin. Biletat mund të jenë me faturë ose elektronike, por, në çdo rast, përmbajnë të paktën:

- a) gjatësinë e udhëtimit në km;
- b) çmimin për km;
- c) numrin e serisë;
- ç) emrin e operatorit të transportit;
- d) datën dhe kohën e nisjes;
- dh) pjesën e biletës (dëshminë/etiketën) për bagazhin e udhëtarit.

Me propozim të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për prodhimin dhe shpërndarjen e biletave.

Neni 22

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Vendet e nisjes e të mbërritjes së autobusëve dhe të agjencive të transportit të udhëtarëve përcaktohen nga këshilli i bashkisë.

Nuk mund të organizohet transporti me autobusë, si pikënisje nga një qendër e banuar, bashki ose qendër e njësisë administrative përbërëse, në qoftë se aty nuk është organizuar njëkohësisht shërbimi i rregullt me agjenci.

Neni 23

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Në raste fatkeqësish natyrore ose në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, për plotësimin e nevojave të transportit, ministria dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, me urdhër, lejojnë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë së transportit jashtë linjave të miratuara më parë.

Neni 23/1

(Shtuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Janë, gjithashtu, shërbime të rregullta ato shërbime, që sigurojnë një transportim për kategori të caktuara udhëtarësh, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë, përderisa shërbime të tilla kryhen në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 3.10 të nenit 3.

Shërbimet e rregullta të specializuara janë shërbime, të cilat përfshijnë:

- a) transportin shtëpi-punë të punonjësve;
- b) transportin shtëpi-institucion shkollor të nxënësve dhe studenteve;
- c) transportet qytetëse kufitare, kur lejohen me marrëveshje ndërkombëtare.

Shërbimet e rregullta të specializuara kryhen me autobus.

Për shërbimet sipas shkronjave "a" dhe "b", dokumentacioni shoqëruar i automjetit përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Për shërbimet sipas shkronjës "c" jepet licencë nga ministri, i cili përcakton, me udhëzim, kushtet dhe rregullat për marrjen e kësaj licence.

Neni 23/2

(Shtuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Transporte për llogari të vet quhen transportet e kryera nga një ndërmarrje për punonjësit ose nga një shoqatë, pa qëllim fitimi, për anëtarët e vet, në kuadër të veprimtarisë shoqërore, me kusht që:

- a) transporti të përbëjë vetëm një veprimtari ndihmëse për ndërmarrjen ose shoqatën;
- b) mjetet e përdorura të jenë pronë e ndërmarrjes ose e shoqatës, të jenë blerë me këste nga këto të fundit ose të jenë objekt i një kontrate qiraje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës i ndërmarrjes ose anëtar i shoqatës.

Dokumentacioni, që shoqëron automjetin, për transportin për llogari të vet, përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 24

Transportuesi që ngarkohet të kryejë transportin me autobusë duhet të plotësojë kushtet dhe të zbatojë rregullat e përcaktuara me akte të veçanta të Këshillit të Ministrave.

KREU II.2 TRANSPORTET E RASTIT ME AUTOBUSE

Neni 25

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Transportet e rastit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.11 të nenit 3, janë objekt i këtij ligji.

Neni 26

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Transportet e rastit janë shërbime që kryhen me autobus dhe përfshijnë:

a) udhëtimet me dyer të mbyllura, domethënë shërbimet e kryera me të njëjtin mjet që transporton një ose më shumë grupe udhëtarësh të formuar më parë, duke e kthyer çdo grup në vendin e nisjes;

b) shërbimet:

i) e kryera për grupe udhëtarësh të formuara më parë, pa kthimin e udhëtarëve në vendin e nisjes gjatë të njëjtit udhëtim dhe kthimin bosh të mjetit në vendin e nisjes;

ii) e kryera me mjet bosh në vajtje në vendin e destinacionit, për grupe udhëtarësh të formuara më parë, me kthimin e mjetit me udhëtarë në vendin e nisjes;

c) shërbimet e organizuara me rastin e ngjarjeve të veçanta, si konferenca, seminare ose manifestime kulturore-sportive, që nuk u përgjigjen përkufizimeve të shkronjave "a" dhe "b".

Grup i formuar më parë do të quajmë një grup:

a) për të cilin një organizëm ose një person përgjegjës është ngarkuar të marrë masa për nënshkrimin e kontratës ose për pagesën kolektive të shërbimit apo për marrjen e të gjitha prenotimeve dhe të pagesave përpara nisjes;

b) që është formuar nga një numër personash:

i) jo më pak se 12 veta;

ii) jo më pak se 40 për qind e kapacitetit të mjetit, pa llogaritur shoferin.

Neni 27

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Transporti turistik, i cili bën pjesë në transportet e rastit, është, gjithashtu, objekt i këtij ligji.

Agjencitë turistike, për kryerjen e veprimtarisë së tyre, kanë të drejtë të marrin autobusë me qira, sipas kontratës me persona fizike a juridike.

Neni 28

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Dokumentacioni, me të cilin duhet të jetë i pajisur autobusi në transportet e rastit, caktohet me udhëzim të ministrit.

KREU II.3 TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR ME AUTOBUS

Neni 29

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtareve me autobus kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

Transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve kryhet nëpërmjet:

1. shërbimeve të rregullta;
2. shërbimeve të rregullta, të specializuara;
3. shërbimeve vajtje-ardhje.

Me "shërbime vajtje-ardhje" kuptohen shërbimet, që organizohen për të transportuar grupe udhëtarësh të formuara më parë nga e njëjta zonë nisjeje dhe me të njëjtën zonë mbërritjeje, me udhëtime të përsëritura vajtje dhe ardhje. Të tilla grupe, të përbëra nga udhëtarë që kanë kryer udhëtimin e vajtjes, rikthehen në zonën e nisjes me anën e një udhëtimi pasues, ku:

- a) asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të zbritet gjatë udhëtimit;
- b) udhëtimi i parë në ardhje dhe i fundit në vajtje në një sërë udhëtimesh vajtje-ardhje bëhet bosh;

4. shërbimeve të rastit.

Përveç shërbimeve vajtje-ardhje, përkufizimet e shërbimeve të transportit rrugor ndërkombëtar përkrijnë respektivisht me nenin 3 pikat 3.10 dhe 3.11 të këtij ligji.

Në rast se nuk janë përfunduar marrëveshje me Shtete të veçanta, transporti rrugor ndërkombëtar me autobus kryhet në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e përcaktuara në aktet përkatëse të organizmave ndërkombëtare, në të cilët Republika e Shqipërisë ka aderuar.

Neni 30

(Shfuqizuar e shtuar fjalët me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

Transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve me autobus kryhet nga persona juridikë ose persona fizikë tregtarë të organizuar në shoqëri transporti dhe i nënshtrohet sistemit të licencimit.

Sistemi i certifikimit (neni 3, pika 3.18 a, b) dhe të lejeve (pika 3.19) i nënshtrohet edhe transporti vajtje-ardhje i disa grupeve të formuara më parë, ku detyrimisht udhëtimi i parë në kthim dhe udhëtimi i fundit në vajtje kryhet bosh, si dhe lëvizja e autobusit bosh për të marrë një grup udhëtarësh.

Transporti ndërkombëtar transit me autobus kryhet në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31

Transportuesit që nuk e kanë selinë në Republikën e Shqipërisë, kryejnë transport për/dhe nga territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare e të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

Transporti brenda territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues që nuk e kanë selinë në Republikën e Shqipërisë, është i ndaluar. Përjashtimi bëhen vetëm me leje të lëshuar nga ministri.

Mënyra e dhënies ose e shkëmbimit të lejeve dhe lejeve të operimit, rregullat dhe organet që ndjekin zbatimin e tyre, për secilin lloj transporti ndërkombëtar me autobusë, si dhe lejimi i kalimit pa leje përcaktohen në marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

Neni 32

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

Neni 33

Çmimet e biletave të linjave ndërkombëtare të transportit me autobus dhe të bagazheve miratohen nga Ministria në bashkëpunim me organin kompetent të shtetit tjetër, në çastin e lidhjes së marrëveshjes ose të dhënies së licencës.

Neni 34

Organet doganore të pikave kufitare ku bëhet kalimi i autobusëve që kryejnë transportin ndërkombëtar, detyrohen të bëjnë kontrollin e dokumentacionit përkatës në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

KREU II.4 TRANSPORTI I UDHËTARËVE ME TAKSI (Ndryshuar titulli me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Neni 35

(Ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 6.6.2002, ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9373, datë 14.4.2005, ndryshuar me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007; ndryshuar paragrafi i parë dhe i tretë dhe shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet.

Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Licenca për shërbimin taksi jepet me afat 5 vjet, me të drejtë rinovimi automatikisht, kur subjekti ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 36

(Ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 6.6.2002, ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9373, datë 14.4.2005, ndryshuar me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Rregullat dhe kushtet për kërkesa të veçanta për taksitë, si dhe për zbatimin e tarifave dhe të çmimeve, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Këshilli bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave.

Niveli dysheme i tarifave të shërbimit taksi, për të gjitha llojet e taksive, nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus (për shërbimet në linja të rregullta, qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse).

Neni 36/1

(Shtuar me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007)

Taksimetrat duhet të jenë në përputhje me rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore (OIML), për sa u përket specifikimeve të përgjithshme e të veçanta dhe/ose në përputhje me kushtet e vendosura në standardet e BE-së për tipin e miratuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, si autoriteti përgjegjës, në përputhje me paragrafin e mësipërm, për tipin e miratuar kryen verifikimin fillestar të taksimetrit.

Taksimetri duhet të jetë i kalibruar dhe i vulosur nga autoriteti përkatës, si dhe duhet të jetë në gjendje të rregullt pune dhe i vendosur në vend të dukshëm.

Neni 37

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007)

Transporti i udhëtarëve me taksi në linjë të rregullt është i ndaluar.

Në rastin kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë territorit të rrethit ku është e regjistruar, ajo lejohet të marrë në kthim:

- a) udhëtarë vetëm në rrethin e regjistrimit të saj;
- b) të njëjtët udhëtarë, të cilët e kanë pronotuar dhe/ose rezervuar më parë në vajtje dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të saj.

Nuk lejohet krijimi i stacioneve të taksive në stacionet qytetëse dhe ndërqytetëse të autobusëve, për të kryer transport të udhëtarëve në linja të rregullta.

Neni 38

Shërbimi me taksi pa licencë dhe me mjete të tjera jashtë atyre të përcaktuara në nenin 3, pika 3.6, është i ndaluar.

Kushtet dhe rregullat e përgjithshme për kryerjen e këtij lloj shërbimi përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU III TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 39

Transporti i mallrave brenda vendit dhe ai ndërkombëtar është transporti që kryhet nga shoqëri transporti, persona fizikë ose filiale të shoqërive tregtare, shoqëruar me dokumentet përkatëse dhe ato suplementare që përcaktohen me dispozita të veçanta të Këshillit të Ministrave.

Neni 39/1

(Shtuar me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

Drejtuesit e mjeteve me peshë të përgjithshme të lejuar me ngarkesë mbi 6 tonë ose kur ngarkesa e lejuar, përfshirë rimorkion ose gjysmërimorkion, i kalon 3,5 tonë në transportin e mallrave, pajisen me certifikatën e aftësisë profesionale, në përputhje me udhëzimin e ministrit.

Neni 40

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009)

KREU III.1 TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PËR TË TRETË

Neni 41

Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Neni 42

Kur transporti i mallrave për të tretë dhe me qira kryhet me pagesë, ky çmim të mbështetet në dispozitat e ligjit "Për çmimet dhe tarifat".

Neni 43

(Ndryshuar me ligjin nr. 9760, datë 21.6.2007)

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm për ndërmarrjet që kryejnë transport mallrash për të tretë dhe me qira, brenda vendit, me anë të mjeteve motorike ose të kombinimeve të mjeteve.

Kapaciteti maksimal i lejuar i transportimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Llojet e transportit të mallrave me qira dhe për të tretë, të cilat mund të kryhen pa licencë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.

KREU III.2 TRANSPORTI I MALLRAVE PËR VETË

Neni 45

Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë.

Neni 46 (Ndryshuar ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010)

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.

Neni 47

Llojet e mallrave për transport brenda vendit për nevojat e veta që nuk kanë nevojë për certifikatë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.

KREU III.3 TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR I MALLRAVE

Neni 48

a) Ky ligj do të zbatohet edhe për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave, për aq sa nuk shprehet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

b) Transporti ndërkombëtar i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencë.

c) Transporti ndërkombëtar i mallrave për nevojat e veta është i ndaluar të kryhet pa certifikatë.

Neni 49

Transporti ndërkombëtar i mallrave me qira, për të tretë dhe për nevojat e veta, kryhet me mjete, kapaciteti i të cilave përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 50

a) Mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar të mallrave, duhet të jenë të pajisur me dokumente të përcaktuara nga ministri dhe dokumente të kërkuara nga marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këto marrëveshje.

b) Format i dokumenteve të përcaktuara si më sipër miratohet dhe jepet nga ministri ose organet e autorizuar prej tij.

c) Ministri ose organe të tjera kompetente do të sigurojnë informacionin e nevojshëm.

KREU IV
TRANSPORTI I MALLRAVE NGA TRANSPORTUES QË NUK KANË SELINË
NË SHQIPËRI

Neni 51

Transporti i mallrave nga, për në dhe përmes Republikës së Shqipërisë nga transportues që nuk e kanë selinë në të, është i ndaluar.

Kjo pengesë hiqet vetëm në zbatim dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

Neni 52

Një transportues që nuk e ka selinë në Republikën e Shqipërisë, ndalohet të kryejë transport ndërkombëtar në territorin tokësor të Republikës së Shqipërisë.

Kjo pengesë mund të hiqet vetëm me leje të lëshuar nga Ministria.

Neni 52/1

(Shtuar me ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010, ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 10/2016, datë 11.2.2016)

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 të këtij ligji, ministri lejon kryerjen e transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga një transportues i huaj (kabotazh), që nuk e ka selinë në Shqipëri, edhe kur nuk parashikohet në marrëveshjen ndërkombëtare me shtetin, ku transportuesi i huaj ka selinë, vetëm për arsye të emergjencës civile dhe zgjat për sa kohë zgjatet gjendja e emergjencës.

2. Rregullat dhe kushtet për kryerjen e operacioneve të kabotazhit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe, të cilat e parashikojnë atë.

Neni 53

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet përkatëse në lidhje me:

1. kushtet, me të cilat jepet ose hiqet leja;
2. mundësinë e përjashtimit nga leja;
3. mundësinë e refuzimit të hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU V
TRANSPORTI I MALLRAVE TË RREZIKSHME
(Shfuqizuar me ligjin nr. 118, datë 13.12.2012)

KREU VI
KONTROLLI SHTETËROR DHE MBIKËQYRJA E KUALIFIKUAR NË
TRANSPORTIN RRUGOR

Neni 64

(Shtuar me ligjin nr. 21, datë 14.2.2013)

Kontrollin shtetëror dhe mbikëqyrjen e kualifikuar në transportin rrugor e kryejnë organet e specializuara të kontrollit të transportit, sipas nenit 3, pika 3.16.

Gjatë kësaj veprimtarie këto organe verifikojnë nëse transportuesit përmbushin detyrat e përcaktuara në këtë ligj dhe e ushtrojnë atë sipas licencave, lejeve dhe certifikatave.

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

Neni 65

(Ndryshuar me ligjin nr. 21, datë 14.2.2013)

Personat e ngarkuar me detyrën e kontrollit/inspektimit shtetëror janë të autorizuar nga organi i specializuar i kontrollit dhe pajisen me dokumentin përkatës të identitetit si kontrollor/inspektor. Ata e ushtrojnë veprimtarinë sipas këtij ligji, duke verifikuar të gjithë dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor.

Neni 66

Transportuesi është i detyruar t'i paraqesë kontrollorit gjithë dokumentet e kërkuara dhe t'i krijojë atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas këtij ligji.

Neni 67

Mbikëqyrjen superiore shtetërore në të gjitha problemet e transportit rrugor e kryen Ministria. Mbikëqyrësi superior shtetëror kontrollon punën e mbikëqyrësit të kualifikuar shtetëror të përcaktuar në udhëzimin e ministrit.

Në detyrat e mbikëqyrësit superior shtetëror përfshihen edhe ato të përcaktuara në nenin 65.

Neni 68

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, ndryshuar me ligjin nr. 10 302, datë 15.7.2010, ndryshuar shkronja "ç" dhe shtuar shkronja "d", me ligjin nr. 10, datë 11.2.2016)

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbejnë vepër penale, përbejnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë e me masa plotësuese të pezullimit licencës (ose të certifikatës) dhe të lejes së qarkullimit.

Për shkelje të dispozitave të parashikuara në nenet:

a) 5, II, 23/1 shkronjat "a" dhe "b", 23/2, 30, 31 dhe 38 dënohen me gjobë nga 5 000 deri në 100 000 lekë dhe me masën plotësuese të pezullimit të lejes së qarkullimit nga 1 deri në 3 muaj;

b) 10 shkronja "b", 21, 23/1 shkronja "c", 25, 26, 27, 28, 36 paragrafi i tretë dhe 37 dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 leke, si dhe me masën plotësuese të pezullimit licencës ose të certifikatës nga 3 deri në 6 muaj.

c) 54 shkronja "c", 56, 57, 60 dhe 61 dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë, si dhe me masën plotësuese të pezullimit licencës ose të certifikatës nga 3 deri në 6 muaj.

ç) 52/1, shkelja e rregullave të kabotazhit në transportin e mallrave dënohet sipas rastit:

i) me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë;

ii) me heqjen e lejes përkatëse, kur operacionet e kabotazhit parashikohen të kryhen me leje;

iii) me refuzimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

d) 18, me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë.

Neni 69

(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Gjashtëdhjetë për qind e të ardhurave nga të gjitha gjobat, për shkeljet e parashikuara nga ky ligj, i kalojnë organit që konstaton shkeljen, i cili i përdor për përmirësimin e shërbimit në zbatim të këtij ligji, kurse dyzet për qind e të ardhurave i kalojnë Buxhetit të Shtetit.

Neni 70
(Ndryshuar me ligjin nr. 21, datë 14.2.2013)

Kundërvajtjet administrative konstatohen, shqyrtohen dhe ndëshkohen nga personat e ngarkuar me detyrën e kontrollit/inspektimit shtetëror të transportit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

Ndaj vendimit që konstaton kundërvajtjen administrative mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 71
(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003, shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 21, datë 14.2.2013)

Për shkeljet, të cilat nuk janë parashikuar në nenin 68 të këtij ligji, organet e kontrollit në Rrugë kanë të drejtë të gjobisin në vend kundërvajtësit me gjobë nga 250 deri në 5 000 lekë.

Shfuqizuar.

Neni 72
(Shfuqizuar me ligjin nr. 21, datë 14.2.2013)

Neni 73

Një person fizik ose juridik, interesat e të cilit janë të lidhura me një vendim të marrë sipas këtij ligji ose akteve në zbatim të tij, me përjashtim të dënimeve për kundërvajtjet administrative, mund të ankohet kundër këtij vendimi brenda tridhjetë ditëve nga koha që ai vendim i është bërë i njohur atij tek ministri përkatës.

Kundër vendimit të ministrit, subjekti mund të ankohet në gjykatë.

Neni 74
(Ndryshuar me ligjin nr. 9096, datë 3.7.2003)

Kur organet e policisë rrugore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, konstatojnë shkelje të këtij ligji, bashkëpunojnë me organet e specializuara për kontrollin dhe mbikëqyrjen e transportit dhe marrin masat përkatëse, sipas kompetencave që ka ky organ.

Neni 75

Organet e doganës në kufirin shtetëror kontrollojnë nëse drejtuesi i mjetit që kalon kufirin ka dokumentet e parashikuara për kryerjen e transportit ndërkombëtar.

Për mjetet e huaja që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë verifikohet pajisja me dokumentet dhe me lejet përkatëse të kërkuara nga ky ligj dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 76

Organet e doganës kontrollojnë në kufirin shtetëror nëse drejtuesi i mjetit që transporton mallra të rrezikshme, është i pajisur me dokumentet e nevojshme sipas dispozitave të këtij ligji dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Në rast të kundërt organet e doganës ndalojnë qarkullimin e mjetit në hyrje ose dalje të kufirit shtetëror.

Gjuha e dokumenteve përcaktohet në marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

Neni 77

Ministria u bën të njohura organeve të kontrollit të kalimit kufitar modelet e dokumenteve me të cilat duhet të jenë të pajisura mjetet e transporteve ndërkombëtare dhe përparësitë e kalimit të tyre.

Neni 77/1¹¹

(Shtuar me ligjin nr. 10, datë 11.2.2016)

Të gjitha ndërmarrjet e transportit rrugor të vendosura në Shqipëri janë të detyruara të regjistrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor, që mbahet nga organi i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Të dhënat përkatëse, të përfshira në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor, do të jenë të aksesueshme për të gjitha autoritetet kompetente, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

Pas licencimit të subjektit transportues, organi që e ka licencuar atë dërgon informacion te mbajtësi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor për ndërmarrjen e transportit dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Për mbledhjen, përpunimin, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor zbatohen dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rregulla të hollësishme për kategoritë e të dhënave që mbahen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor, si dhe mënyra e mbajtjes së tij përcaktohen me udhëzim të ministrit, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

Neni 77/2¹²

(Shtuar me ligjin nr. 10, datë 11.2.2016)

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, pjesë përbërëse e sistemeve inteligjente në transport, zbatohen në fushën e transportit rrugor, duke përfshirë infrastrukturën, mjetet e përdoruesit dhe menaxhimin e trafikut dhe të lëvizshmërisë.

Aplikimet dhe shërbimet e sistemeve inteligjente në transport (SIT) në fushën e transportit rrugor, si dhe lidhjet me metodat e tjera të transportit zbatohen pa cenuar çështjet që lidhen me sigurinë kombëtare dhe interesat e mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

Rregullat për zbatimin e sistemeve inteligjente në fushën e transportit rrugor dhe lidhjet me mënyrat e tjera të transportit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Ky nen zbatohet në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 78

Ministria është organi më i lartë shtetëror që përfaqëson Republikën e Shqipërisë në marrëveshjet a konventat dypalëshe dhe shumëpalëshe për transportet rrugore.

Kur si pasojë e zbatimit të marrëveshjeve ose konventave lëshohen leje të llojeve të ndryshme për transportet rrugore, ato administrohen nga Ministria, e cila ka të drejtë ta delegojë administrimin.

Çmimi i lejeve caktohet nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

¹¹ Neni 77 hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.

¹² Neni 78 hyn në fuqi në datën 1 janar 2017.

Neni 79

Transportuesit që organizohen në shoqata, pa qëllim fitimi, për shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të tyre, sipas dispozitave të Kodit Civil, krijojnë marrëdhënie me ministrinë në zbatim të këtij ligji.

Ministri, sipas karakterit të objektit të shoqatës transportuese, mund t'i delegojë asaj funksione të kufizuara dhe të kontrolluara prej tij.

Neni 80

Shteti nuk mban përgjegjësi për dëmet që u shkaktohen subjekteve gjatë veprimtarisë së transportit rrugor, të cilat vijnë si pasojë e mosnjohjes dhe e mosrespektimit të këtij ligji, si dhe të akteve në zbatim të tij.

Transportuesit janë të detyruar t'ua bëjnë të ditur ato gjithë punonjësve të tyre.

Neni 81

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve të lindura në zbatim të këtij ligji dhe në interes të tyre, zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 82

Kur nga shkelja e dispozitave të këtij ligji dhe akteve në zbatim të tij rrjedhin vepra penale, personat përgjegjës mbajnë përgjegjësi penale, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 83

Në zbatim të nenit 3, pika 3.10 të këtij ligji, transportuesi është i detyruar të hartojë rregulloren e udhëtimit, e cila duhet të ndodhet në mjet dhe pjesë të rëndësishme të saj, duhet të afishohen në vende të dukshme të mjetit. Kriteret bazë për hartimin e rregullores përcaktohen me udhëzim të Ministrisë.

Neni 84

Transportuesit janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë gjithë kuadrin ligjor, me të cilin lidhen problemet e transportit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, si Kodin Rrugor, Kodin e Punës, Kodin Doganor, ligjin "Për çmimet dhe tarifatat", marrëveshjet qeveritare me shtetin a shtetet, për të cilat ai është i interesuar të operojë etj.

Neni 85

(Shtuar paragrafi fundit me ligjin nr. 37, datë 10.4.2014)

Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta.

Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Neni 86

1. Në Ministri krijohet komisioni i transportit rrugor.
2. Përbërja e komisionit vendoset me akt të veçantë të Këshillit të Ministrave. Qëllimi, detyrat dhe çdo hollësi tjetër përkatëse që lidhet me funksionimin e këtij komisioni, caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kryetar i komisionit caktohet zëvendësministri përkatës.
4. Anëtarë të komisionit caktohen edhe përfaqësues të shoqatave të transportuesve shqiptarë rrugorë.
5. Ministri cakton një sekretari që siguron mbarëvajtjen e punës së komisionit.

Neni 87

1. Licencat e lëshuara para daljes së këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në to. Ato mund të rinovohen vetëm kur mbajtësi i licencës plotëson kushtet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe aktet në zbatim të tij.
2. Nëse vlefshmëria e licencës zgjat për një periudhë më pak se dymbëdhjetë muaj nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, ministri mund të lejojë një periudhë kalimtare vlefshmërie për licencën, në mënyrë që mbajtësi i licencës të përshtatet me detyrimet e këtij ligji.
3. Periudha kalimtare nuk mund të jetë më shumë se dymbëdhjetë muaj.

Neni 88

Këshilli i Ministrave dhe ministritë e ngarkuara për zbatimin e këtij ligji të marrin masa për nxjerrjen e vendimeve e të udhëzimeve përkatëse brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

DISPOZITË E PARASHIKUAR ME LIGJIN NR. 118/2012, DATË 13.13.2012, (neni 60)

5. Subjektet e angazhuara në transportin e mallrave të rrezikshme, në bazë të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar do të vazhdojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

DISPOZITË E PARASHIKUAR ME LIGJIN NR. 21/2013, DATË 14.2.2013 (neni 5)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

DIZPOZITA TË PRARASHIKUARA ME LIGJIN NR. 10/2016, DATË 11.2.2016 (neni 18)

1. Ministri përgjegjës për transportin miraton rrjetin e ri të linjave ndërqytetëse, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Licencat për transportin ndërqytetës, të lëshuara nga bashkitë, dhe licencat e transportit rrethqytetës, të lëshuara nga bashkitë ose komunat, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në ditën e lëshimit të licencave, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por jo më vonë se data 1 janar 2017.
3. Këshilli i Ministrave dhe ministritë e ngarkuara për zbatimin e këtij ligji të marrin masat për nxjerrjen e vendimeve e të udhëzimeve përkatëse brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2034, datë 3.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

LIGJ
Nr. 107/2014

PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E TERRITORIT¹³
(Ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015, nr. 28/2017, datë 23.3.2017)
(I përdistësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private, duke bashkërenduar punën për:
 - i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;
 - ii) krijimin e garantimin e territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike, sociale e kulturore, lehtësimi të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura;
 - iii) nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;
 - iv) garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor;
 - v) garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;
 - vi) nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;

¹³ Ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 1 shtator 2014.
Ligji nr. 73/2015, datë 9.7.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 21 korrik 2015.
Ligji nr. 28/2017, datë 23.3.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 75, datë 12 prill 2017.

c) të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

ç) të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;

d) të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;

dh) të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;

e) të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;

Neni 2

Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësi dhe rregullave për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime

(ndryshuar pika 1, 33, 38 dhe shtuar pikat 39/1, 44/1 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)” është institucion me përgjegjësi planifikimi në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit të territorit.

2. “Autoritetet e planifikimit” janë organet dhe institucionet publike, që kanë përgjegjësi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

3. “Autoritetet e inspektimit të ndërtimit” janë organet e përcaktuara në legjislacionin për inspektimin e ndërtimit.

4. “Bashkim për qëllim zhvillimi” është bashkimi i dy apo më shumë parcelave në një të vetme, për qëllime zhvillimi, në përputhje me përcaktimet e parashikuara në këtë ligj, në aktet nënligjore në zbatim të tij dhe në dokumentet e planifikimit.

5. “Baza e të dhënave shtetërore GIS” është përmbledhja e të gjitha dokumenteve të planifikimit të territorit, sipas përcaktimit të legjislacionit për të dhënat gjeohapësinore, në përputhje me parimet e GIS dhe në shtresa individuale të hartave të përgatitura me mjete digjitale.

6. “Certifikata e përdorimit” është dokument zyrtar i lëshuar nga autoriteti përgjegjës në miratim të kërkesës, i cili vërteton se ndërtimi është në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit dhe se punimet e kryera dhe ndërtimi janë të përshtatshme për përdorim.

7. “Çështje, zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit” janë ato çështje, zona dhe objekte që njësohen ose lidhen me interesa shtetërore ose kombëtarë.

8. “Deklaratë paraprake për kryerje punimesh” është deklarata e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

9. “Dokumente të planifikimit” janë dokumente zyrtare të planifikimit që hartohen dhe zbatohen në territor, në nivel qendror dhe vendor, në përputhje me nenin 16 të këtij ligji.

10. “E drejta për zhvillim” është e drejta ligjore për të zhvilluar një parcelë dhe/ose një zonë, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit. E drejta për zhvillim është e dallueshme nga e drejta e pronësisë dhe jepet nga autoriteti vendor i planifikimit, që ka kompetencën për të rregulluar përdorimin e tokës në juridiksionin e tij, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Të drejtat për zhvillim mund të mbahen nga pronari i tokës, të shkëmbehen ose të shiten.

11. “Infrastrukturë publike” është tërësia e rrjeteve, instalimeve dhe e ndërtimeve ekzistuese ose të parashikuara në territor, si dhe e hapësirave publike, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, arsimit, shëndetësisë, administrimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, administrimit të burimeve natyrore e kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile e kundër zjarrit si dhe të tjera fusha të ngjashme në shërbim të publikut. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe realizohet me investime publike ose private.

12. “Kërkesë për zhvillim” është kërkesa e paraqitur pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për lejimin e punimeve dhe ndërtimit, e cila përmban dokumentacionin e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

13. “Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT)” është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri.

14. “Kontroll i zhvillimit” është procesi, në bazë të të cilit autoriteti përgjegjës i planifikimit vlerëson dhe vendos nëse një kërkesë për zhvillim, kërkesë për ndërtim, kryerja e punimit ose ndërtimit përputhet me dokumentet e planifikimit, zhvillimit dhe të kontrollit të zhvillimit, të miratuara, kodin e ndërtimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

15. “Kushte zhvillimore” janë kushtet e përcaktuara nga plani i detajuar vendor ose, në mungesë, nga plani i përgjithshëm vendor dhe, në mungesë të të dyjave, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit të domosdoshëm për pajisjen me leje ndërtimi.

16. “Leje ndërtimi” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse.

17. “Leje zhvillimi” është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.

18. “Miratim në heshtje” është akti i përfitimit të së drejtës për zhvillim, kryerje të punimeve apo përdorim të ndërtimit pa marrjen e miratimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit, nëse miratimi ose refuzimi i kërkesës nuk është dhënë brenda afatit të parashikuar nga dispozitat përkatëse të këtij ligji.

19. “Mjete tradicionale të informimit” janë:

- a) regjistri elektronik;
- b) posta elektronike;
- c) lajmërimi publik, i cili afishohet në mjediset e autoritetit të planifikimit dhe në hapësira të tjera që kanë aksesueshmëri të gjerë nga publiku;
- c) lajmërimi në mediat elektronike kombëtare ose lokale;
- d) botimi në gazeta të pushtetit vendor ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.

20. “Ndërtim” është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë.

21. “Ndërtim/punim pa leje” janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar.

22. “Ndërtim në shkelje të lejes” janë punime dhe/ose ndërtime të kryera në shkelje të kushteve dhe kriterëve teknike dhe/ose ligjore të lejes, pavarësisht krijimit të shtesave dhe volumeve në ndërtim.

23. “Nënndarja për qëllim zhvillimi” është ndarja e një parcele në dy ose më shumë parcele, për qëllime zhvillimi, në përputhje me mënyrën e përcaktuar në këtë ligj, në aktet nënligjore në zbatim të tij dhe në dokumentet e planifikimit.

24. “Njësi strukturore të territorit” janë zonat më të vogla, në të cilat ndahet territori administrativ i një njësie vendore të nivelit të parë për qëllime zhvillimi. Njësitë strukturore krijohen në procesin e planifikimit vendor dhe kanë kushte zhvillimore të njëtrajtshme, të cilët zbërthehen në nivel parcele, sipas përcaktimeve të planit të përgjithshëm vendor dhe /ose dokumenteve të zhvillimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

25. “Njoftim publik” është njoftimi paraprak i palëve të interesuara dhe /ose publikut, i kryer

në kohë të mjaftueshme, nëpërmjet një ose disa prej mjeteve tradicionale të informimit, me qëllim informimin e palëve të interesuara për kohën, vendin dhe qëllimin e takimit publik, sipas këtij ligji.

26. “Palë e interesuar” është çdo person fizik, juridik, ose autoritet shtetëror apo organ i tij, të drejtat ose interesat e ligjshëm të të cilit, qofshin këta individualë ose të përbashkët, kanë të ngjarë të preken nga një dokument planifikimi, zhvillimi ose kontrolli të zhvillimit.

27. “Parcela” është sipërfaqja e tokës e identifikuar me numër të parcelës kadastrale dhe e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

28. “Përdorim i tokës” është përdorimi i tokës dhe strukturave, sikurse parashikohet në dokumentet e planifikimit.

29. “Plan i detajuar vendor” është dokumenti që detajon përcaktimet e planit të përgjithshëm vendor në nivelin e një ose disa njësive strukturore dhe përcakton kushtet për zhvillimin e një zone përmes lejeve të ndërtimit.

30. “Procedura e thjeshtuar” është procedura, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

31. “Projektakt” janë projektvendimet e autoriteteve të planifikimit dhe projektet e dokumenteve të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit përpara se të jenë miratuar nga autoriteti përkatës.

32. “Punime apo punime ndërtimore” është çdo veprim ose proces për krijimin e ndërtimeve.

33. “Regjistër Kombëtar i Planifikimit të Territorit”, në vijim regjistri, është baza e të dhënave shtetërore, sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës, në të cilin regjistrohen dhe administrohen nga autoritetet kombëtare dhe vendore, në mënyrë të pavarur, të dhënat për territorin, dokumentet e planifikimit, në proces miratimi apo të miratuara, së bashku me të drejtat apo kufizimet ligjore, që rrjedhin prej tyre, si dhe studime apo materiale të tjera në funksion të planifikimit e me interes për publikun, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

34. “Riparim” janë punime që kanë për qëllim kthimin e një objekti në kushte të pranueshme duke bërë ripërtëritjen, zëvendësimin, apo rregullimin e pjesëve të dëmtuara ose të degraduara.

35. “Rregullore e planifikimit” është rregullore e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton rregulla të unifikuara për përmbajtjen dhe strukturën e dokumenteve të planifikimit, sipas kreut II të këtij ligji.

36. “Rregullore e zhvillimit” është rregullore e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave që përcakton kushtet dhe procedurat e detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe për përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit, sipas kreut III të këtij ligji.

37. “Rregullore ndërtimi” është rregullorja e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që përcakton normat dhe kushtet teknike bazë të detyrueshme për garantimin e qëndrueshmërisë së strukturave, hapësirave të emergjencës, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës, në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve, si dhe për përshtatjen e hapësirave për përdorimin nga persona me aftësi të kufizuara. Rregullorja bazohet në standardet ndërkombëtare dhe përfshin norma teknike të përshtatura për Shqipërinë.

38. “Rregullore e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit” është rregullorja e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen rregullat për administrimin e mirëmbajtjen e të dhënave, si dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe të personave të tjerë, fizikë e juridikë, për sa i përket mirëmbajtjes e dorëzimit të dokumenteve dhe të dhënave në regjistër.

39. “Sistemi i informacionit geografik (GIS)” është sistemi i përcaktuar dhe rregulluar nga legjislacioni për informacionin gjeohapësinor.

39/1. “Sistemi elektronik i lejeve” është sistemi i integruar i programeve dhe pajisjeve elektronike, i përdorur për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin digjital) e të dhënave dhe dokumenteve, që transmetohen në rrugë elektronike, për kryerjen e procedurave të aplikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për leje në fushën e ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi.

40. “Takim publik” është takimi i hapur, i organizuar, në vend të përshtatshëm dhe me afat lajmërimi të arsyeshëm nga autoriteti i planifikimit, i cili përmes njoftimit publik fton qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara të parashtrijnë vërejtjet, komentet apo propozimet e tyre mbi projektaktin e dokumentit të planifikimit, zhvillimit ose kontrollit të zhvillimit përpara finalizimit të dokumentit të planifikimit, zhvillimit apo kontrollit të zhvillimit, të parashikuar nga ky ligj, nga autoriteti përkatës.

41. “Territor kombëtar” është hapësira gjeografike tokësore, nëntokësore, ujore e ajrore, që përkon me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

42. “Territor vendor” është hapësira gjeografike tokësore, nëntokësore, ujore e ajrore, që përputhet me ndarjet administrative - territoriale të njësisë të qeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

43. “Vërejtje” është mendimi kundërshtues për zgjidhjet e propozuara në projektaktin e dokumentit të planifikimit, zhvillimit apo kontrollit të zhvillimit ose një pretendim për mosrespektim të dispozitave ligjore apo nënligjore në procesin e planifikimit.

44. “Zona” është një pjesë e territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese a të planifikuara të tokës e ndërtimeve në të, sipas rregulloreve të përdorimit të tokës. Zona mund të përputhet ose jo me një apo më shumë njësi strukturore të territorit.

44/1. “Zonë e zhvillimit” është territori në funksion të procesit të zhvillimit, pjesë e një njësie strukturore, sipas përcaktimeve të planit të detajuar vendor.

45. “Zhvillim” është procesi i ndryshimit të territorit përmes ndërtimeve të reja ose ndryshimit të ndërtimeve ekzistuese.

Neni 4

Parimet

Planifikimi i territorit bazohet në këto parime:

- a) zhvillimi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe të garantojë nevojat e brezave për barazi sociale, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit;
- b) zhvillimi i territorit është çështje e rëndësisë kombëtare; ai duhet të jetë i drejtë dhe vlera e krijuar të përftohet dhe të përvetësohet nga shoqëria që e krijon atë;
- c) planifikimi duhet të harmonizojë interesat publikë e privatë, kombëtarë e vendorë;
- c) zhvillimi duhet të udhëhiqet nga planifikimi, i cili është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet e planifikimit sipas këtij ligji;
- d) parimet dhe vlerat e dokumenteve të planifikimit duhet të kenë vazhdimësi dhe pas ndryshimit të tyre;
- dh) transparenca duhet të shoqërojë proceset e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit;
- e) shërbimi me një ndalesë;
- ë) heshtja është miratim;
- f) planifikimi duhet të marrë në konsideratë karakteristikat e kontekstit të territorit në zhvillim;
- g) decentralizimi dhe subsidiariteti;
- gj) harmonizimi me qasjen e Bashkimit Europian në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, si edhe lidhur me kriteret mjedisore, ruajtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura;
- h) zhvillimi duhet të bazohet në planifikimin dhe projektimin e gjithanshëm, që garanton kushte të barabarta dhe të drejta për të gjithë qeniet, pavarësisht nga nevojat dhe karakteristikat e secilit;
- i) planifikimi e zhvillimi duhet të garantojnë eliminimin e barrierave, për një përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuara ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta;
- j) hierarkia e planeve;
- k) shpërndarja e të drejtave të zhvillimit duhet të jetë e drejtë dhe në bazë të parimit të proporcionalitetit;
- l) sigurimi i detyrueshëm i objekteve, i përgjegjësive civile dhe profesionale në ndërtim;

- ll) garantimi i aksesit dhe pjesëmarrjes së publikut në hartimin e dokumenteve të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit;
- m) sistemi i integruar i planifikimit.

Neni 4/1

Hapësira publike

(shtuar me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015)

1. Hapësira publike është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit".

2. Autoritetet publike, kryesisht ose në partneritet me sektorin privat, krijojnë hapësirë publike përmes ndërtimit të infrastrukturave publike, të përcaktuara në nenin 3, të ligjit nr. 107/2014, për gjelbërimin, transportin, aktivitetet sociale, edukativo-sportive, çlodhëse dhe/ose krijuese, sipas rregullave, kushteve dhe standardeve të posaçme.

3. Autoritetet vendore të planifikimit kanë detyrimin të sigurojnë mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e hapësirave publike, me shpenzimet e veta, përfshirë në pronë private, pa cenuar të drejtën e pronarëve për zhvillimin e tyre deri në momentin e kryerjes së zhvillimit.

4. Në hapësirat publike lejohen të kryhen vetëm aktivitete që janë në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre.

5. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, rregullat, kushtet dhe procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.

KREU II

PLANIFIKIMI

SEKSIONI I

AUTORITETET E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

Neni 5

Autoritetet përgjegjëse

Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit janë:

1.1. Në nivel qendror:

- a) Këshilli i Ministrave;
- b) Këshilli Kombëtar i Territorit;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

1.2. Në nivel qarku:

- a) këshilli i qarkut.

1.3. Në nivel bashkie:

- a) këshilli bashkiak;
- b) kryetari i bashkisë.

Neni 6

Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave

(ndryshuar shkronja "b" e pikës 6, me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015)

1. Këshilli i Ministrave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për alokimin e mjeteve financiare për:

- a) hartimin e Planit të Përgjithshëm të Territorit;
 - b) hartimin e planeve sektoriale dhe planeve të detajuara për zonat me rëndësi kombëtare;
 - c) detajimin e planit të Përgjithshëm të Territorit përmes hartimit të planeve të përgjithshme vendore;
 - ç) zbatimin e synimeve, objektivave dhe masave të veprimit, siç janë përcaktuar në planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare;
 - d) mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të planifikimit të integruar – Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit.
2. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për:
- a) miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit (PPKT);
 - b) miratimin e rregullores së planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, rregullores së Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit si dhe të dokumenteve tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - c) nxitjen e hartimit të dokumenteve kombëtare e vendore të planifikimit nga autoritetet përkatëse të planifikimit;
 - ç) mbështetjen e zhvillimit të burimeve të nevojshme njerëzore e profesionale, në nivel qendror dhe vendor, për planifikimin e territorit, kontrollin e zhvillimit dhe administrimin e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit;
 - d) miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara sipas këtij ligji.
3. Këshilli i Ministrave në bazë vjetore njihet me Raportin Monitorues të Zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit, planet kombëtare sektoriale dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare, merr masa sipas rastit.
4. Këshilli i Ministrave rregullisht koordinon dhe harmonizon politikat dhe strategjitë sektoriale të ministrive përkatëse.
5. Këshilli i Ministrave bashkërendon mbledhjen e raporteve për zhvillimin strategjik të secilit sektor, sipas fushës së përgjegjësisë së secilës ministri. Këto raporte ia dorëzon ministritë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit brenda 6 muajve që nga fillimi i procesit të hartimit apo rishikimit të Planit të Përgjithshëm të Territorit.
6. Këshilli i Ministrave, me akt nënligjor, përcakton:
- a) përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve tij;
 - b) rregullat për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, numrin e punonjësve, nivelet e pagave e të shpërblimit dhe të punonjësve të kësaj agjencie, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Territorit

(shtuar paragrafi i dytë, me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015)

1. Këshilli Kombëtar i Territorit ka këto kompetenca:
- a) vendos miratimin, miratimin me ndryshime ose shtyrjen për shqyrtim të mëvonshëm të dokumenteve të planifikimit, kërkuar për miratim nga autoritetet e planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - b) vendos për miratimin e dokumenteve të planifikimit sektorial, të përcaktuara me legjislacion të posaçëm, dhe që kanë efekte në territor;
 - c) përcakton rëndësinë kombëtare të një çështjeje, zone ose objekti në planifikimin e territorit, dhe miraton planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, kur parashikohen të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT).
2. Pranë Këshillit Kombëtar të Territorit funksionon sekretariati teknik i këtij këshilli, i cili ka përgjegjësi:
- a) për të organizuar mbledhjet e KKT-së;

- b) për të përgatitur dokumentacionin që shqyrtohet në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit;
- c) për të administruar dokumentacionin e sipërpërmendur.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e strukturës që do të veprojnë si sekretariat teknik, numrin e punonjësve, nivelet e pagave e të shpërblimit dhe marrëdhëniet e tyre të punës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 8

Përgjegjësitë e ministrisë së linjës për planifikimin dhe zhvillimin

1. Ministria, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjëse për:
 - a) përgatitjen e politikave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
 - b) hartimin e kuadrit ligjor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
 - c) marrjen e nismës dhe koordinimin e punës për hartimin e Planit të Përgjithshëm të Territorit, si dhe për rishikimin e tij;
 - ç) marrjen e nismës, sipas rastit, dhe koordinimin e punës për hartimin e planeve të detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe për rishikimin e tyre;
 - d) bashkërendimin e objektivave të autoriteteve qendrore të planifikimit në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare;
 - dh) kryerjen e studimeve dhe vlerësimeve në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në përfundim, i parashtron Këshillit të Ministrave për shqyrtim dhe miratim masat për përmirësimin e kuadrit ligjor përkatës dhe përmirësimin e ecurisë së detajimit të Planit të Përgjithshëm të Territorit;
 - e) hartimin e rregullores së ndërtimit bazuar në propozimet e dhëna nga ministritë e tjera për rregulloret e ndërtimit të sektorëve përkatës;
 - ë) mbështetjen e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e planifikimit të territorit;
 - f) nxitjen dhe mbështetjen e nismave dhe programeve për përmirësimin e cilësive profesionale e teknike të autoriteteve të planifikimit.
2. Të gjitha institucionet publike në nivel qendror dhe lokal janë të detyruara të asistojnë ministrinë me dokumentet mbështetëse të sektorëve të ndryshëm, të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e Planit të Përgjithshëm të Territorit dhe planeve të detajuara për zonat me rëndësi kombëtare.
3. Për hartimin e dokumenteve të planifikimit të territorit, ministria mund të sigurojë donacione nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, krahas burimeve financiare të akorduara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

(shfuqizuar pika 4, me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015, ndryshuar shkronja "dh" e pikës 1, me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjëse:
 - a) për të bashkërenduar, në përgjithësi, procese të hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, të cilat ndërmerren nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror e vendor;
 - b) për të mbështetur bashkërendimin horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare të planifikimit gjatë proceseve të planifikimit sektorial apo gjatë proceseve të hartimit të planeve të detajuara për zona me rëndësi kombëtare, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme kombëtare, të fushave e sektorëve të ndryshëm;
 - c) për të mbështetur bashkërendimin vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit gjatë proceseve të planifikimit në nivel vendor, me synim harmonizimin e trajtimit të

çështjeve të rëndësishë kombëtare e vendore në fushën e planifikimit të territorit;

ç) për të propozuar në Këshillin e Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për çështjet e planifikimit të territorit, rishikimin e akteve apo hartimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji;

d) organizimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së integruar të të dhënave të planifikimit të territorit – Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit – me të gjitha dokumentet e planifikimit të nivelit qendror dhe vendor, të cilat kanë hyrë në proces miratimi apo janë miratuar nga autoritetet përkatëse, si dhe të dhëna të tjera shtesë, të cilat ndërlidhen me planifikimin e territorit;

dh) për kontrollin e përputhshmërisë së akteve të botuara në regjistrë me ligjet, dokumentet e planifikimit në fuqi;

e) për zhvillimin e trajnimeve për sektorin publik dhe privat që ushtrojnë veprimtari profesionale në fushën e planifikimit të territorit, për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore që lidhen me të;

ë) për të mbështetur bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e planifikimit të territorit;

f) për të informuar publikun për proceset e planifikimit të territorit;

g) për të inkurajuar dhe siguruar që pjesëmarrja e publikut është garantuar gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

2. AKPT-ja siguron që hartimi i dokumenteve të planifikimit të territorit dhe kontrolli i zhvillimit, në nivel qendror dhe vendor, është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, përmes ofrimit të ndihmës teknike për autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit, duke:

a) ofruar të dhënat elektronike bazë dhe normat teknike të planifikimit të territorit që duhet të shfrytëzohen gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit në nivel kombëtar dhe vendor;

b) zhvilluar trajnime për përdorimin e të dhënave elektronike bazë dhe normave teknike të planifikimit të territorit para se të fillojë hartimi i dokumenteve të planifikimit;

c) bashkërenduar vlerësimin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit në shqyrtim me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe planet e tjera kombëtare, mbi bazën e parimit të hierarkisë së dokumenteve të planifikimit, si dhe kontrollin e tyre me të dhënat elektronike bazë dhe normat teknike të planifikimit. Në vijim, me anë të komunikimit zyrtar njofton autoritetin përgjegjës për:

i) përputhshmërinë e dokumentit të planifikimit dhe kalimin e tij për miratim në KKT;

ii) kërkesën për ndryshime dhe plotësime të dokumentit të planifikimit;

iii) përputhshmërinë e dokumentit të planifikimit të ndryshuar e plotësuar dhe kalimin e tij për miratim në KKT;

ç) përgatitur e botuar manuale metodologjike për planifikimin e territorit;

d) hartuar dhe shpërndarë standarde teknike të administrimit të Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit sipas përcaktimeve të këtij ligji;

dh) mbështetur drejtpërdrejt autoritetet e planifikimit për mënyrën e regjistrimit dhe të administrimit në mënyrë të pavarur të të dhënave në regjistrë;

e) zhvilluar trajnime për përmirësimin e cilësive profesionale e teknike të tyre nëpërmjet trajnimit dhe ndihmës së drejtpërdrejtë.

3. AKPT-ja është përgjegjëse për të përgatitur:

a) studime për Sistemin e Integruar të Planifikimit në Republikën e Shqipërisë, dhe të propozojë për KKT-në dhe Këshillin e Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për çështjet e planifikimit të territorit, masat e nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit;

b) Raportin Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektive të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare, në bazë vjetore;

c) propozimet për ministrin përgjegjës për çështjet e planifikimit të territorit, për ndërmarrjen e proceseve planifikuese apo masa të tjera të nevojshme;

ç) propozimet për Këshillin Kombëtar të Territorit, për përcaktimin si të rëndësishë kombëtare të një çështjeje, zone apo objekti.

4. Shfuqizuar.

5. AKPT-ja, ushtron përgjegjësi të tjera, të para-shikuara shprehimisht në këtë ligj, në ligje të tjera e në aktet nënligjore.

Neni 10

Përgjegjësitë e ministrive të tjera

1. Ministrinë janë përgjegjëse për të:
 - a) hartuar dokumente kombëtare planifikimi për sektorët e përgjegjësisë në të cilët ato veprojnë;
 - b) propozuar rregullore ndërtimi, apo kapituj të tyre, lidhur me fushën e përgjegjësisë, për të garantuar sigurinë e cilësinë e jetës dhe të shëndetit publik;
 - c) marrë masa për zbatimin e dokumenteve kombëtare të planifikimit dhe zhvillimit;
 - c) mbështetur hartimin e dokumenteve vendore të planifikimit nga autoritetet përkatëse dhe për të ndihmuar që ato të përmbushin standardet e përcaktuara në këtë ligj dhe ligje të tjera, duke udhëzuar për çështje që lidhen me fushën e përgjegjësisë së ministrive;
 - d) inspektuar zhvillimet në territor që lidhen me fushën e përgjegjësisë së tyre, dhe marrin masa parandaluese e ndëshkuese;
 - dh) regjistruar dhe administruar, në mënyrë të pavarur në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, aktet dhe projektaktet për të cilat janë përgjegjëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - e) bashkëpunuar me autoritetet e planifikimit të çdo niveli, sipas përcaktimeve të këtij ligji, dhe raportojnë rregullisht sipas hierarkisë;
 - ë) informuar publikun për të gjithë procesin planifikues e zhvillimet në territor, të cilat lidhen me fushën e përgjegjësisë, dhe për të siguruar transparencë nëpërmjet regjistrit dhe formave e burimeve të tjera tradicionale;
 - f) hartuar raportet për zhvillim strategjik të secilit sektor, sipas fushës së përgjegjësisë së secilës ministri, të cilat i dorëzohen ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit të territorit, nëpërmjet Këshillit të Ministrave, brenda gjashtë 6 muajve që nga fillimi i procesit të hartimit apo rishikimit të Planit të Përgjithshëm të Territorit.
 - g) përgatitur në bazë vjetore, Raportin Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektivave të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare, për fushën e përgjegjësisë, dhe për ta dorëzuar atë pranë AKPT-së;
2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, ministrinë dhe organet e tjera publike qendrore sigurojnë dhe zhvillojnë burimet e nevojshme, njerëzore e profesionale, për planifikimin e territorit, kontrollin e zhvillimit, menaxhimin e tokës e të mjedisit dhe administrimin e regjistrit.

Neni 11

Përgjegjësitë e këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut është përgjegjës për koordinimin e proceseve të planifikimit në nivel qarku.
2. Këshilli i qarkut miraton, sipas rastit, nismën dhe dokumentet e planifikimit sektorial të qarkut.

Neni 12

Përgjegjësitë e këshillit bashkiak

(ndryshuar shkronjat "a", "b" dhe shfuqizuar shkronja "d", me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Këshilli Bashkiak, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për miratimin e mjeteve financiare të akorduara nga bashkia për zbatimin e këtij ligji.
2. Këshilli bashkiak është përgjegjës për të:
 - a) miratuar nismën për hartimin apo rishikimin e planit të përgjithshëm vendor;
 - b) miratuar planin e përgjithshëm vendor;
 - c) monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e planit të përgjithshëm vendor dhe planeve sektoriale në nivel vendor;

- c) monitoruar respektimin e kuadrit ligjor për pjesëmarrjen dhe shqyrtimin publik të dokumenteve vendorë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, gjatë procesit të hartimit të tyre;
- d) Shfuqizuar.
- dh) shqyrtuar në bazë vjetore Raportin Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektivave të deklaruara në dokumentet e planifikimit në nivel vendor.

Neni 13

Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë

(ndryshuar shkronja "d" me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Kryetari i bashkisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për:
 - a) zhvillimin e territorit vendor, përmes hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit të territorit;
 - b) ndërmarrjen e nismës për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve vendore të planifikimit;
 - c) hartimin apo rishikimin e dokumenteve të planifikimit të territorit në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe, sipas rastit, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe duke iu përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit;
 - ç) koordinimin mes institucioneve publike dhe alokimin e burimeve njerëzore të nevojshme për hartimin e dokumenteve të planifikimit në nivel vendor;
 - d) dorëzimin dhe prezantimin e planit të përgjithshëm vendor pranë AKPT-së, për të verifikuar përputhshmërinë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe normat teknike të planifikimit;
 - dh) miratimin e planeve të detajuara vendore.
2. Të gjitha institucionet publike në nivel qendror dhe lokal janë të detyruara të ndihmojnë autoritetin vendor përgjegjës për planifikimin dhe administrimin e territorit të bashkisë, me dokumentacionin mbështetës të sektorëve të ndryshëm, të nevojshëm për përgatitjen e dokumenteve vendore të planifikimit.

Neni 14

Kontributet profesionale në planifikim

1. Çdo njësi e qeverisjes vendore cakton organe përgjegjëse për ushtrimin e veprimtarive të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit të territorit, sipas legjislacionit në fuqi dhe dispozitave të këtij ligji.
2. Autoritetet e qeverisjes vendore sigurojnë që për kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj të kenë profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë pune në fushat përkatëse. Numri minimal i profesionistëve që duhet të sigurojë çdo njësi e qeverisjes vendore përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të numrit të popullsisë së njësisë së qeverisjes vendore, dhe është në çdo rast jo më i vogël se 6 profesionistë.
3. Formimi akademik i profesionistëve për secilën nga katër fushat e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përcaktohet si më poshtë:
 - a) për planifikimin e territorit: planifikim dhe menaxhim urban, hapësinor dhe territori, urbanistikë ose projektim urban dhe fusha të tjera ekuivalente studimi, sipas legjislacionit të arsimit;
 - b) për kontrollin e zhvillimit: fushat sipas shkronjës "a", të kësaj pike, juridik, arkitekturë, inxhinieritë e ndërtimit, topogjeodezi;
 - c) për mbrojtjen e mjedisit: menaxhim mjedisi urban, inxhinieritë e mjedisit dhe të agromjedisit, studime mjedisore, arkitekturë dhe projektim peizazhi, gjeologji, inxhinieri pyjesh;
 - ç) për administrimin e regjistrit: "GIS" dhe topogjeodezi ose, në mungesë, planifikim urban, territori, urbanistikë, projektim urban, inxhinieritë e ndërtimit ose arkitekturë me përgatitje dhe eksperiencë në GIS ose topogjeodezi.

4. Në rast se nuk arrijnë të përmbushin kërkesat, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit nëpërmjet delegimit në përputhje me legjislacionin për pushtetin vendor.

5. Autoritetet vendore të planifikimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në të gjithë territorin e tyre administrativ.

Neni 14/1

Delegimi i përgjegjësiave

(shtuar neni me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015)

1. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit mund t'u delegojnë organeve në varësi përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit.

2. Autoritetet kombëtare dhe vendore mund t'i delegojnë, me marrëveshje, njëra-tjetrës përgjegjësi dhe funksione të caktuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

3. Autoritetet kombëtare dhe vendore mund të kontraktojnë kryerjen e shërbimeve të ndryshme për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ose mund t'i kryejnë ato bashkërisht në marrëveshje mes tyre.

SEKSIONI II

DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT

Neni 15

Dokumentet e planifikimit sipas niveleve të qeverisjes

1. Në Republikën e Shqipërisë janë dy nivele të planifikimit të territorit:

1.1 Planifikimi i nivelit qendror, që kryhet përmes dokumenteve të planifikimit si vijon:

1.1.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT), për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.1.2 Planet kombëtare sektoriale, për të gjithë ose një pjesë të territorit

1.1.3 Planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare.

1.2 Planifikimi i nivelit vendor, që kryhet përmes dokumenteve të planifikimit si vijon:

1.2.1 Planet sektoriale në nivel qarku.

1.2.2 Plani i përgjithshëm vendor.

1.2.3 Planet e detajuara vendore.

2. Qëllimi final i dokumenteve të planifikimit është integrimi i gjithë dokumenteve të planifikimit, të çdo lloji niveli, për gjithë territorin kombëtar, në funksion të ngritjes së një sistemi të integruar të planifikimit të territorit, me qëllim lidhjen, integrimin, rakordimin dhe harmonizimin e tyre.

3. Këshilli i Ministrave me akt nënligjor përcakton përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e hartimit, zbatimit/detajimit dhe monitorimin e zbatimit të planeve.

Neni 16

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT)

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT) përcakton kuadrin referues të detyrueshëm për të gjitha planet që hartohen në Republikën e Shqipërisë.

2. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit janë:

a) përcaktimi i parimeve dhe i drejtimeve për një zhvillim të qëndrueshëm e të balancuar të territorit;

b) krijimi i kushteve territoriale për zhvillimin rajonal;

- c) drejtimi i krijimit dhe zhvillimit të infra-strukturës publike kombëtare;
- ç) krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversiteteve, burimeve natyrore mbi e nën tokë dhe të pasurisë natyrore e kulturore, balancimi i efekteve të sistemeve të banimit e veprimtarive ekonomike dhe mbrojtja e zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra e sipërfaqeve të tjera të kultivueshme;
- d) orientimi i objektivave për planifikimin rajonal, ndërvendor e vendor;
- dh) bashkërendimi i punës, harmonizimi dhe orientimi i objektivave sektoriale të zhvillimit me efekt në territor;
- e) përputhja me orientimet dhe udhëzimet e dokumentit të perspektivës europiane për zhvillimin hapësinor.

3. AKPT-ja, kryesisht ose me kërkesë të një ministrie apo të një organi tjetër qendror ose vendor, ndërmerr nismën dhe i propozon për miratim KKT-së përcaktimin e një çështjeje, zone ose objekti si të rëndësisë kombëtare në planifikim. Procedurat e detajuara për këtë nismë përcaktohen në rregulloren e planifikimit.

Neni 17

Planet kombëtare sektoriale

Planet kombëtare sektoriale hartohen nga ministritë, me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve të ndryshëm, sipas fushave të kompetencës si siguria kombëtare, energjia, industria, transporti, infrastruktura, turizmi, zonat ekonomike, arsimi, sporti, trashëgimia kulturore dhe natyrore, shëndetësia, bujqësia dhe ujërat.

Neni 18

Planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare

1. Planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare hartohen në përputhje me dokumentet kombëtare të planifikimit, për menaxhimin, me qëllim mbrojtjen, prezervimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

2. Nisma për hartimin e planit të detajuar për një zonë të rëndësisë kombëtare merret nga ministri përgjegjës për çështjen përkatëse të rëndësisë kombëtare mbi bazën e vendimit përkatës të KKT-së, sipas nenit 16, pika 3, të këtij ligji.

3. Plani i detajuar për zonën e rëndësisë kombëtare hartohet nga ministri përgjegjës për çështjen e rëndësisë kombëtare dhe miratohet nga KKT-ja.

4. KKT-ja merr vendim në lidhje me miratimin e planit të detajuar brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë.

5. Struktura dhe forma, si dhe procesi për nismën, hartimin dhe miratimin e planit të detajuar për një zonë të rëndësisë kombëtare përcaktohen në rregulloren e zhvillimit.

6. Leja e zhvillimit për punimet në zonën e rëndësisë kombëtare, për të cilën është hartuar plani i detajuar, jepet nga KKT-ja mbi bazën e këtij plani.

Neni 19

Planet sektoriale në nivel qarku

Planet sektoriale në nivel qarku përcaktojnë zhvillimin strategjik të sektorëve të ndryshëm brenda territorit administrativ të qarkut. Planet kanë objekt:

- a) bashkërendimin e punës, në nivelin e territorit përkatës, për programet dhe përcaktimet e dokumenteve kombëtare të planifikimit me ato bashkiake;
- b) balancimin e nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në nivelin e qarkut;
- c) krijimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji;
- ç) përcaktimin e një platforme dhe të drejtimeve strategjike të detyrueshme të zhvillimit në territor

për njësinë përkatëse të qeverisjes dhe për planet e përgjithshme vendore të autoriteteve të nivelit bazë të qeverisjes vendore;

d) përcaktimin strategjik për rregullimin e përdorimeve të tokës sipas sistemeve natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;

dh) planifikimin e programeve dhe masave për të garantuar mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;

e) rregullimin e vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitutet publike, sipas legjislacionit në fuqi;

ë) rregullimin e ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Plani i Përgjithshëm Vendor

1. Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) janë:

a) balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;

b) krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji;

c) drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;

ç) rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;

d) planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;

dh) rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitutet publike, sipas këtij ligji;

e) rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

2. Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

Neni 21

Planet sektoriale në nivel bashkie

Planet sektoriale në nivel bashkie hartohen në zbatim të planit të përgjithshëm vendor dhe përcaktojnë zhvillimin strategjik të sektorëve të ndryshëm brenda territorit administrativ të bashkisë.

Neni 22

Plani i detajuar vendor

(ndryshuar pikat 5, 6, 12, 13, 14 dhe shfuqizuar pikat 10, 11, me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Autoriteti i planifikimit vendor përcakton në planin e përgjithshëm të territorit zonat, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të planeve të detajuara vendore, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në rregulloren e planifikimit.

2. Planet e detajuara vendore hartohen me nismë publike ose private në zona të cilat janë:

a) një njësi strukturore;

b) disa njësi strukturore bashkë;

c) çdo zonë me prioritet për zhvillim, e përcaktuar si e tillë në planin e përgjithshëm vendor të territorit.

3. Planet e detajuara vendore kanë për qëllim:

- a) zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e një zone;
- b) rigjenerimin/ripërtëritjen e një zone kryesisht urbane;
- c) ndërtimin e infrastrukturave publike.

4. Planet e detajuara vendore kanë për objekt nëndarjen dhe/ose bashkimin për qëllim zhvillimi.

5. Nisma private duhet të mbështetet nga pronarët që kanë në pronësi, jo më pak se 51 për qind të sipërfaqes së zonës së zhvillimit, për të cilën propozohet plani i detajuar vendor.

6. Kryetari i bashkisë merr vendimin mbi miratimin e planit të detajuar vendor brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar, pasi ka informuar palët e interesuara përmes një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe kryen takime publike me ta, në rast se kërkohet.

7. Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detajuar vendor, bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor, vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse të zhvillimit.

8. Në rast se ka kundërshtime si më sipër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore organizon takime publike me palët e interesuara, shqyrton vërejtjet ose propozimet përkatëse dhe vlerëson reflektimin e tyre në planin e detajuar vendor.

9. Në përfundim të procesit, kryetari vendos në lidhje me miratimin e planit duke u shprehur edhe në lidhje me pranimin ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të depozituara.

10. Shfuqizuar.

11. Shfuqizuar.

12. Plan i detajuar vendor regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën. Parcelat e reja që krijohen nga nëndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese janë objekt transaksioni vetëm pasi të jenë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, me kërkesë të zhvilluesit.

13. Struktura, forma, pjesët përbërëse të përmbajtjes, procesi për nismën, informimin dhe takimet publike të detyrueshme, hartimin dhe miratimin e planit të detajuar vendor, kriteret për përcaktimin e kufijve të zonës që trajtohet me plan të detajuar vendor dhe kushte të tjera, përcaktohen në rregulloren e planifikimit.

14. Dokumenti i planit të detajuar vendor shoqërohet nga një dokument teknik i shpërndarjes së balancuar të të drejtave të zhvillimit, ku përcaktohen edhe raportet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

15. Përfitimet e autoritetit të planifikimit nga të drejtat për zhvillim dhe vlera e rritur e tokës përdoren për ndërtimin ose financimin e infrastrukturave publike, kryesisht në zonën ku janë përfutur.

16. Metoda për përcaktimin e vlerës së të drejtave për zhvillim dhe vlerës së rritur të tokës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

SEKSIONI III

BASHKËRENDIMI, KËSHILLIMI DHE SHQYRTIMI PUBLIK I DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT NË NIVEL QENDROR DHE PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

Neni 23

Bashkërendimi

1. Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit siguron një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi horizontal e vertikal, me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara, përpara fillimit dhe gjatë hartimit të dokumentit vendor të planifikimit.

2. Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit këshillohet rregullisht me AKPT-në dhe palët e interesuara dhe i informon ato çdo muaj mbi ecurinë e procesit.

3. AKPT-ja shqyrton përputhshmërinë e projektaktit të dokumentit të planifikimit me dispozitat ligjore e nënligjore të zbatueshme në fushën e planifikimit të territorit, si dhe me dokumentet e planifikimit në fuqi. Në përfundim të shqyrtimit, AKPT-ja i përcjell autoritetit përgjegjës përfundimet dhe propozimet përkatëse për trajtimin e mangësive.

4. Këshilli i Ministrave me akt nënligjor përcakton procedurën dhe afatet për kryerjen e bashkërendimit.

Neni 24

Këshillimi dhe takimi publik

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit organizon një ose më shumë seanca takimi publik dhe këshillimi, përpara çdo vendimmarrjeje që ka lidhje me dokumentet e planifikimit në nivel qendror dhe me planin e përgjithshëm vendor dhe i përsërit ato, sipas nevojës, me qëllim informimin e plotë të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e konflikteve.

2. Autoriteti përgjegjës i planifikimit i njofton publikut dhe palëve të interesuara vendin, datën dhe orën e çdo takimi publik dhe vë në dispozicion të tyre projektin e dokumentit të planifikimit, të paktën 30 ditë përpara takimit. Njoftimi kryhet përmes botimit të informacionit në regjistër dhe në dy gazeta me qarkullim më të madh ose në organe të tjera të medias.

3. Palët e interesuara kanë të drejtë që, gjatë periudhës nga data e njoftimit, sipas pikës 2 të këtij neni, deri në datën e përcaktuar të takimit publik, të kenë akses në materialet e informacionet që lidhen me dokumentin e planifikimit, përfshirë përmbledhjen e procesit të bashkërendimit, të kryer sipas nenit 23, të këtij ligji, dhe në vërejtjet, propozimet e përfundimet e arritura gjatë këtij procesi. Aksesit i tyre sigurohet, paraprakisht, në kohë të mjaftueshme e në mënyrë efektive nëpërmjet regjistrit dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.

4. Përmbledhja e vërejtjeve apo propozimeve gjatë takimit publik i bashkëlidhen projektit të dokumentit të planifikimit, të paraqitur për miratim, dhe njoftohet së bashku me të nëpërmjet botimit në regjistër dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.

5. Në mbështetje të vërejtjeve apo propozimeve të marra, autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit ndryshon projektaktin ose jep arsyet e argumentuara të moskryerjes së një ndryshimi të tillë. Projektakti, së bashku me ndryshimet ose argumentimin e moskryerjes së ndryshimit, përcillet për miratim tek autoriteti/organi përkatës brenda 30 ditëve nga data e organizimit të takimit publik.

6. Në rastet kur projekti i dokumentit të planifikimit rishikohet nga autoriteti përgjegjës, në bazë të vërejtjeve e propozimeve të bëra gjatë takimit publik, për çështje thelbësore të përmbajtjes së tij, autoriteti përgjegjës i planifikimit organizon një takim publik shtesë, sipas përcaktimeve të sipërpërmendura të këtij neni.

7. Personat fizikë apo juridikë, që ndodhen në zonën e planifikimit ose që kanë informacion apo të dhëna për të duhet, kur u kërkohet dhe për aq sa kanë mundësi të bëjnë një gjë të tillë, t'i japin autoritetit përkatës të planifikimit ose çdo personi të autorizuar, pa kundërshtpërblim, informacionin që disponojnë, i cili mund të nevojitet gjatë procesit të hartimit të dokumentit kombëtar të planifikimit. Autoriteti i planifikimit, ose personi i autorizuar sigurojnë ruajtjen e administrimit e informacionit të marrë gjatë procesit të hartimit të dokumentit kombëtar të planifikimit dhe e bëjnë këtë informacion të disponueshëm për publikun.

Neni 25

Miratimi i dokumenteve të planifikimit

1. Autoriteti përgjegjës për miratimin e dokumentit të planifikimit, në çdo nivel, miraton projektaktin përkatës ose ia rikthen atë për rishqyrtim autoritetit propozues, së bashku me arsyet e mosmiratimit në rastet kur vlerëson se:

a) nuk janë kryer bashkërendimi, këshillimi dhe takimi publik ose nuk janë respektuar procedurat e tjera të detyrueshme të planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji; dhe/ose

b) projektakti ka mospërputhje me dokumentet e planifikimit ose me legjislacionin në fuqi.

2. Në këto raste, autoriteti propozues, në bashkëpunim me AKPT-në, kryen procesin e duhur të rishqyrtimit të projektaktit.

3. Në përfundim të rishqyrtimit, projektakti i dokumentit të planifikimit i dërgohet për miratim autoritetit përkatës miratues.

4. Autoriteti përgjegjës për miratimin përfu-ndimtar, jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të tij, boton në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit dhe u dërgon Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit dhe autoritetit të planifikimit një kopje të dokumentit të planifikimit, të miratuar së bashku me vendimin e miratimit të tij.

5. Ndryshimi ose shfuqizimi i dokumentit të planifikimit bëhen sipas së njëjtës procedurë të përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për hartimin e tij.

Neni 26

Rishikimi i planeve

(ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Planet e përgjithshme janë objekt ndryshimi, kur është e nevojshme, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë çdo 15 vjet. Procesi për shqyrtimin e plotë të tyre fillon 2 vjet para përfundimit të afatit të sipërpërmendur, sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për miratimin e tyre. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit do të jetë subjekt vlerësimi, në përshtatje me faktorët e rinj, socialë, ekonomikë dhe mjedisorë, të paktën në fund të çdo 5-vjeçari, në përputhje me kornizën kohore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

2. Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafërimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

3. Rregullat dhe procedura e ndryshimit të planeve apo rishqyrtimit të plotë të tyre, sipas këtij neni, do të përcaktohen në rregulloren e planifikimit.

KREU III

ZHVILLIMI

SEKSIONI I

AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E TERRITORIT

Neni 27

Autoritetet përgjegjëse

Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit.

2. kryetari i bashkisë.

Neni 28

Përgjegjësitë e KKT-së

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. KKT-ja është autoriteti përgjegjës për vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi për llojet e zhvillimit komplekse, të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit dhe ato që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësisë kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit.

2. Lëshimi i certifikatës së përdorimit për lejet e ndërtimit, të miratuara sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet në përfundim të një procesi të bashkërenduar të kontrollit të përputhshmërisë së ndërtimit mes autoriteteve qendrore të përfshira, sipas fushës së kompetencës, dhe autoritetit vendor përgjegjës për kontrollin e punimeve të ndërtimit në territorin administrativ ku kryhet zhvillimi.

3. Procedurat e detajuara për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe/ose ndërtimi, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit përkatëse përcaktohen në rregulloren e zhvillimit.

Neni 29

Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë është përgjegjës për:

- a) vendimarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë;
- b) vlerësimin e respektimit të kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh;
- c) dhënien e certifikatës së përdorimit, sipas nenit 42 të këtij ligji, për lejet e ndërtimit të miratuara prej tij.

SEKSIONI II

INSTRUMENTET PËR DREJTIMIN E ZHVILLIMIT

Neni 30

Intensiteti i ndërtimit me kushte

1. Intensiteti i ndërtimit me kushte është instrumenti i zhvillimit të territorit që synon të sigurojë kontribut për financimin e investimeve kapitale në infrastruktura dhe shërbime publike, përfshirë programet sociale të strehimit, në zona të parashikuara nga plani i përgjithshëm vendor. Ky kontribut jepet nga kërkuuesi i lejes së ndërtimit në këmbim të shtimit të intensitetit të ndërtimit, në marrëveshje me autoritetin vendor.

2. Intensiteti i ndërtimit me kushte zbatohet nga autoritetet vendore të planifikimit, përmes programeve përkatëse, në përputhje me përcaktimet e planeve të përgjithshme vendore.

3. Rregullorja e zhvillimit përcakton kriteret për programin e intensitetit me kushte të ndërtimit dhe metodën e llogaritjes së vlerës së intensitetit.

Neni 31

Transferimi i së drejtës për zhvillim

(ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Transferimi i së drejtës për zhvillim midis njësive strukturore realizohet, sipas rastit, nga autoriteti vendor i planifikimit, me qëllim ruajtjen e monumenteve të kulturës dhe zonave historike, tokës bujqësore dhe asaj natyrore, si dhe hapësirave publike.

2. Ky transferim ndodh përmes një programi të hartuar nga autoriteti vendor i planifikimit, në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe me marrëveshje midis autoritetit vendor dhe pronarëve të tokave, të cilët përfshihen në program.

3. Kushtet dhe procedurat për përcaktimin e vlerës monetare të të drejtave për zhvillim dhe transferimin e tyre rregullohen në rregulloren e zhvillimit.

Neni 32

Zhvillimi i detyrueshëm i tokës

1. Në rastet kur si rezultat i procesit të hartimit të planit të detajuar vendor një ose disa pronarë nuk bien dakord me përmbajtjen e tij, autoriteti vendor i planifikimit negocion me ta për arritjen e një marrëveshjeje.

2. Në rast se marrëveshja, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk arrihet, atëherë autoriteti vendor i planifikimit vepron sipas rasteve të mëposhtme:

a) rishpërndan të drejtën e zhvillimit të përcaktuar nga plani i përgjithshëm vendor në parcelat e këtyre pronarëve të parcelat fqinje dhe/ose njësi strukturore të tjera;

b) nuk rishpërndan të drejtën e zhvillimit, por vendos një taksë të moszhvillimit, e cila zbatohet deri në momentin që këta pronarë hyjnë në një marrëveshje zhvillimi, sipas përcaktimeve të planit të përgjithshëm vendor;

c) shpronëson këta pronarë, nëse plani i detajuar vendor është nismë publike dhe/ose refuzimi i pronarëve për të arritur një marrëveshje cenon interesin publik.

ç) për planet e detajuara vendore me nismë private, përcaktimet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, zbatohen nëse pronarët që nuk bien dakord me planin kanë në pronësi deri në 1/3 e sipërfaqes së zonës që është objekt i planit të detajuar vendor.

3. Metodologjia e përcaktimit të vlerës së taksës së moszhvillimit dhe e rishpërndarjes së të drejtave të zhvillimit rregullohet në rregulloren e zhvillimit.

Neni 33

Pezullimi i zhvillimit

1. Në rastet kur është marrë nisma për hartimin e një dokumenti planifikimi, autoriteti përgjegjës i planifikimit mund të vendosë pezullimin e zhvillimit, me qëllim ruajtjen e planifikimit për zonën objekt planifikimi.

2. Pezullimi i zhvillimit ka për efekt ndalimin e përkohshëm të zhvillimit ose shtyrjen e shqyrtimit të kërkesave për zhvillim e ndërtim në të gjithë territorin ose në një pjesë të tij për një, disa ose çdo tip zhvillimi.

3. Pezullimi i zhvillimit përdoret, në proporcion me rrethanat që e diktojnë atë, vetëm kur rezulton se instrumente të tjera në fuqi nuk do të jepnin një zgjidhje të përshtatshme. Pezullimi i zhvillimit nuk zbatohet për:

a) zhvillime për të cilat leja e ndërtimit është miratuar, formalisht ose me miratim në heshtje, përpara vendimit për pezullimin e zhvillimit;

b) punimet e mirëmbajtjes;

c) zhvillime publike, shtetërore me interes vendor ose kombëtar.

4. Vendimi për pezullimin e zhvillimit përcakton arsyet e përdorimit të këtij instrumenti, territorin e përfshirë ose pjesë të caktuara të tij, llojet e lejeve apo të çështjeve të lidhura me to, dhënia e të cilave pezullohet, ndërtimet që nuk mund të prishen, afatin dhe shkallën apo nivelin e pezullimit, sipas tipit të zhvillimit. Në rastin e zhvillimeve që kryhen me deklaratë për kryerje punimesh, vendimi për pezullimin e zhvillimit përcakton kufizimin ose ndalimin e ndryshimeve madhore apo themelore, me rezultat rritjen e vlerës së ndërtimeve ekzistuese.

5. Pezullimi i zhvillimit mund të vendoset për një periudhë kohore deri në 12 muaj dhe mund të zgjatet edhe për 6 muaj të tjerë, për shkaqe të arsyeshme. Vendimi për pezullimin e zhvillimit shfuqizohet automatikisht me përfundimin e kësaj periudhe.

6. Pezullimi i zhvillimit mbaron para afatit të përcaktuar për të gjithë territorin e përfshirë ose pjesë të caktuara të tij, kur kushtet e kërkuara për miratimin e tij pushojnë së ekzistuari. Në çdo rast, ai mbaron në datën kur dokumenti i planifikimit hyj në fuqi.

7. Autoriteti i planifikimit mund të vendosë ndryshimin e vendimit për pezullimin e zhvillimit, sipas përcaktimeve të sipërpërmendura të këtij neni.

Neni 34

Servituti publik

1. Servituti publik është barra që i ngarkohet një prone në dobi të një prone tjetër për interes publik. Ai nuk përjashton përdorimin e pasurisë së paluajtshme ose të një pjese të saj që nuk cenon realizimin e servitutit publik.

2. Servituti publik mund të përcaktohet nga dokumenti vendor apo kombëtar i planifikimit ose të diktohet nga një kërkesë për ndërtim. Kur servituti bazohet në një dokument planifikimi në fuqi ai zbatohet ndaj një kërkesë ndërtimi.

3. Çdo servitut publik, i vendosur mbi parcela të caktuara, transferohet në parcelat e reja të krijuara në të njëjtën vendndodhje fizike, si pasojë e një procesi nënndarjeje dhe/ose bashkimi të parcelave për qëllim zhvillimi. Servituti publik qëndron në fuqi pa afat në rast se akti që e krijon atë nuk përcakton një afat përfundimi.

4. Të drejtat dhe detyrimet mbi servitutin publik janë ato të përcaktuara në Kodin Civil e legjislacionin në fuqi për servitutet.

Neni 35

E drejta e transferimit

1. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë transferimin e pasurisë së paluajtshme publike, pronë e njësive të qeverisjes vendore, në favor të shtetit, për realizimin e investimeve publike ose private në infrastrukturën publike kombëtare, në përputhje me dokumentet në fuqi të planifikimit.

2. Akti i kalimit të pronësisë nga njësia e qeverisjes vendore në favor të shtetit kryhet përkundrejt pagimit të vlerës reale të tokës dhe/ose ndërtimeve në të, sipas kushteve të tregut në çastin e transferimit të pronësisë.

3. Njësia e qeverisjes vendore njoftohet nga ministri përgjegjës i linjës, të paktën 60 ditë para propozimit të marrjes së vendimit, sipas pikës 1, të këtij neni.

4. Përcaktimi i vlerës apo mënyrave të kompensimit konsultohet ndërmjet autoriteteve kombëtare e vendore të përfshira në proces dhe, në rast mosmarrëveshjeje, vlera e kompensimit caktohet nga gjykata. Padia dhe shqyrtimi gjyqësor nuk përbëjnë shkak për ndërprerjen ose pezullimin e transferimit të pronësisë në favor të shtetit.

5. Vlera e kompensimit të pronës së transferuar paguhet brenda 6 muajve nga data e marrjes së vendimit. Ndryshimet në regjistrin e pasurive të paluajtshme kryhen vetëm pas pagimit të vlerës së kompensimit.

Neni 36

E drejta e preferimit

1. E drejta e preferimit është e drejta në dobi të një autoriteti të planifikimit, në kuptim të këtij ligji, për t'u preferuar në radhë para çdo personi privat në blerjen, në të njëjtat kushte, të një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, që është objekt shitjeje dhe ndodhet në një zonë vendimtare për realizimin ose mbrojtjen e një interesi publik.

2. E drejta e preferimit ushtrohet nga autoriteti i planifikimit për realizimin e interesit publik, për pasuri të paluajtshme, në pronësi private ose pjesë të tyre, sipas zonave të përcaktuara për këtë qëllim në dokumentin e planifikimit në fuqi. Kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet:

- a) për blerje të pasurisë së paluajtshme, që rregullohet sipas kuadrit ligjor për bashkëpronësinë;
- b) kur pronari ia shet pasurinë e paluajtshme bashkëshortit, fëmijëve, fëmijëve të fëmijëve, ose prindërve;
- c) kur pasuria e paluajtshme është në proces blerjeje nga një institucion publik ose për llogari të tij;
- ç) për pasuritë e paluajtshme, për të cilat janë pranuar kërkesa për leje ndërtimi, që janë në proces shqyrtimi deri në datën e miratimit të zonës së ushtrimit të së drejtës së preferimit.

3. Pasuria e blerë nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së preferimit përdoret vetëm për interesin publik konkret, për të cilin është zgjedhur. Nëse autoriteti përgjegjës i planifikimit vendos ta shesë pasurinë e blerë me preferim brenda pesë viteve nga data e blerjes, ai është i detyruar të njoftojë ish-pronarin e saj ose trashëgimtarët e tij, nëse kanë interes ta riblenë atë pasuri.

4. Procedura e detajuar përmes së cilës mund të ushtrohet e drejta e preferimit do të përcaktohen në rregulloren e zhvillimit.

SEKSIONI III

KUSHTET PËR ZHVILLIM DHE DOKUMENTET PËR KONTROLLIN E ZHVILLIMIT

Neni 37

Kushtet për zhvillim

Zhvillimi lejohet vetëm në kushtet e përcaktuara nga dokumentet e planifikimit ose, në mungesë të tyre, të aprovuara nga organi kompetent, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit që shoqëron kërkesën për leje ndërtimi.

Neni 38

Leja e zhvillimit

1. Leja e zhvillimit është dokumenti i lëshuar nga autoriteti përgjegjës që përcakton kushtet zhvillimore për një pronë të caktuar.

2. Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e planit të detajuar vendor. Në rastin e parcelave, për të cilat nuk parashikohet hartimi i një plani të detajuar vendor, leja e zhvillimit jepet me miratimin e planit të përgjithshëm vendor.

Neni 39

Leja e ndërtimit

1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

2. Dokumenti i lejes së ndërtimit përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit dhe normave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Përfutuesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.

4. Lejet e ndërtimit të miratuara në kundërshtim me ligjin dhe dokumentet e planifikimit në fuqi janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 40

Afati i lejes së ndërtimit

(ndryshuar pika 3 dhe shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Afati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më i gjatë se 1 vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit.

2. Afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga autoriteti i planifikimit.

3. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, mbi bazën e një kërkesë të arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi. Kërkesa shoqërohet nga kalendari i ri i punimeve dhe vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit, sipas nenit 52 të këtij ligji.

4. Kërkesa për shtyrjen e afatit të punimeve konsiderohet e miratuar në heshtje nëse autoriteti i planifikimit nuk i njofton vendimin përkatës subjektit kërkuar brenda afatit 45-ditor nga dita e depozitimit të kërkesës.

5. Shfuqizuar.

6. Për punimet e filluara prej më shumë se dhjetë vjetësh dhe ende të papërfunduara, sipas projektit të miratuar, autoriteti përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit përcakton mënyrën e ndërtimit të detyruar ose vendos prishjen apo konfiskimin e ndërtimit.

Neni 41

Deklarata paraprake për kryerjen e punimeve

1. Rregullorja e zhvillimit përcakton listën e ndërtimeve, instalimeve dhe punimeve që, për shkak të ndërhyrjeve jothelbësore në objekt, natyrës së përkohshme të instalimeve ose rregullimit të kontrollit të zhvillimit nga një leje apo autorizim tjetër apo nga legjislacioni i posaçëm sektorial, nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi dhe janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh.

2. Në rastet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni, deklarata me shkrim e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të kontrollit të zhvillimit, bashkërisht me projektin e punimeve, të hartuar dhe nënshkruar nën përgjegjësinë e profesionistëve të licencuar, është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për fillimin e punimeve të ndërtimit.

3. Autoriteti përgjegjës mund të kundërshtojë deklaratën paraprake për kryerjen e punimeve, me vendim të arsyetuar, në rast se konstaton mosrespektim të kushteve dhe kërkesave ligjore që rregullojnë deklaratën paraprake të punimeve.

Neni 42

Certifikata e përdorimit

(ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Në fund të procesit të zhvillimit, autoriteti përgjegjës i planifikimit lëshon certifikatën e përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit, si dhe zbatimin e kriterëve të dokumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit.

2. Në të gjitha rastet, subjekti që kryen punimet lëshon deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi.

3. Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit.

4. Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.

5. Certifikata e përdorimit shqyrtohet dhe jepet sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin për disiplinimin e punimeve të ndërtimit. Në rastet kur nuk është marrë vendim brenda afateve të përcaktuara dhe subjekti që kryen punimet ka plotësuar pa shkelje të gjitha aktet administrative, të parashikuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, certifikata e përdorimit konsiderohet e miratuar në heshtje.

6. Miratimi në heshtje i certifikatës së përdorimit nuk zbatohet në rastet kur:

a) aktet e kontrollit të punimeve të mbajtura nga autoritetet përkatëse kanë evidentuar shkelje të kushteve të lejes së miratuar;

b) certifikata e përdorimit kërkohet për punime me rrezikshmëri të lartë.

7. Punimet e kryera në zbatim të këtij ligji regjistrohen, sipas ligjit, në regjistrat e pasurive të paluajtshme, në bazë të certifikatës së përdorimit, të lëshuar sipas përcaktimeve të këtij ligji ose të miratuar në heshtje. Në rastin e miratimit në heshtje, punimet e kryera regjistrohen mbi bazën e kërkesës së subjektit për certifikatë përdorimi, kopjes së dytë të aktit të kolaudimit dhe akteve administrative të parashikuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit.

8. Në rastet e lejeve që mbulojnë një grup ndërtimesh, certifikata e përdorimit mund të jepet e veçantë për çdo ndërtim, sipas fazave të përfundimit të punimeve të përcaktuara në lejen e ndërtimit. Certifikata e përdorimit për ndërtimin e fundit jepet vetëm pasi të ketë përfunduar realizimi i të gjitha infrastrukturave që kërkohen nga leja përkatëse e ndërtimit.

9. Njëkohësisht me lidhjen e kontratës për kalimin e pronësisë së punimeve, ndërtuesi duhet t'i dorëzojë blerësit një policë sigurimi me afat dhjetëvjeçar me përfitues blerësin/blerësit dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve, që mbulon dëmet e ndërtesës, përfshirë dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin kur, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, ndërtimi shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda, që shfaqen pas lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë.

SEKSIONI IV PROCESI I KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT

Neni 43

Aplikimi për leje ndërtimi

(ndryshuar pika 1 dhe shtuar një fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Aplikimi për leje ndërtimi duhet të kryhet përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit.

2. Aplikimi për leje ndërtimi përmban një përshkrim të hollësishëm të punimeve që do të kryhen dhe shoqërohet nga dokumentacioni i plotë ndërtimor, përfshirë projektet e detajuara, të hartuara dhe nënshkruara nën përgjegjësinë e ekspertëve të licencuar.

3. Rregullorja e zhvillimit do të detajojë përmbajtjen e formularit të aplikimit dhe listën e plotë të dokumentacionit që duhet të shoqërojë kërkesën. Autoriteti përgjegjës i zhvillimit nuk mund të përcaktojë procedura apo kërkesa të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë ligj dhe në rregulloren e zhvillimit për pajisjen me leje në fushën e ndërtimit.

Neni 44

Shqyrtimi i kërkesës për leje ndërtimi

1. Autoriteti përgjegjës, sipas nenit 27 të këtij ligji, shqyrton aplikimin për leje ndërtimi sipas parimit me një ndalesë, duke bashkërenduar punën me të gjitha autoritetet publike të specializuara që duhet të shprehen në lidhje me aplikimin.

2. Autoriteti përgjegjës vendos për lejen e ndërtimit brenda 60 ditëve nga dorëzimi i aplikimit për leje ndërtimi. Rregullorja e zhvillimit mund të përcaktojë afate më të shkurtra apo procedura të diferencuara për pajisjen me leje ndërtimi, për punime me impakt të ulët në territor apo për investime strategjike për vendin.

3. Në rast se autoriteti përgjegjës nuk merr vendim brenda afatit të mësipërm dhe struktura përgjegjëse e planifikimit pranë autoritetit vendor nuk ka dhënë mendim negativ lidhur me kërkesën, leja e ndërtimit konsiderohet e dhënë në heshtje. Miratimi në heshtje nuk zbatohet për lejet e ndërtimit që janë në kompetencë të KKT-së, si dhe për punime të tjera, përfshirë ato me rrezikshmëri të lartë, që përcaktohen nga rregullorja e zhvillimit apo rregullohen në mënyrë të veçantë nga legjislacioni në fuqi.

4. Në rast refuzimi të kërkesës për leje ndërtimi ose kundërshtimi të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 45

Kushti për infrastrukturën

1. Përpara se të jepet leja e ndërtimit është e detyrueshme që në zonën ku propozohet zhvillimi të ekzistojë infrastruktura kryesore dhe dytësore.

2. Infrastruktura dytësore mund të financohet dhe realizohet edhe nga subjekti që kërkon të pajiset me leje ndërtimi pasi të ketë lidhur një marrëveshje me autoritetin përgjegjës, ku specifikohen afatet dhe kushtet e financimit dhe realizimit.

Neni 45/1

Kushti për përshtatshmërinë e mjedisit

(shtuar me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015)

1. Të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas dispozitave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

2. Përshtatshmëria e ndërtimeve të reja apo në proces rikonstruksioni, si më sipër, është kusht për marrjen e lejes së ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit.

3. Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun janë të detyruara të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.

Neni 46

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore.

2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.

3. Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike.

Neni 47

Dorëzimi i lejes së ndërtimit

1. Dokumenti i lejes së ndërtimit i dorëzohet kërkuarit të saj nga autoriteti përgjegjës, jo më vonë se:

- a) 15 ditë nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit nga kryetari i bashkisë;
- b) 30 ditë nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

2. Dorëzimi i lejes së ndërtimit paraprihet nga kryerja dhe dorëzimi i sigurimit të detyrueshëm për mbulimin e përgjegjësiave civile dhe profesionale që rrjedhin nga mosrespektimi i legjislacionit dhe dokumenteve të planifikimit në fuqi. Përgjegjësitë që janë objekt sigurimi të detyrueshëm në fushën e ndërtimit detajohen në rregulloren e zhvillimit.

Neni 48

Rishikimi i kushteve të lejes

1. Kushtet e tjera të lejes së ndërtimit dhe projekti i zbatimit mund të rishikohen në rast se gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit hasen situata të paparashikuara ekonomike dhe teknike që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit të miratuar me lejen e ndërtimit.

2. Rishikimi kryhet nga autoriteti që ka miratuar lejen, mbi kërkesën e arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, të shoqëruar me relacionin përkatës, të firmosur nga projektuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

3. Kushtet e tjera të lejes dhe procedura e rishikimit të tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni, kryhet sipas rregullores së zhvillimit.

Neni 49

Stimuj zhvillimi

Në varësi të llojit dhe volumit të investimeve, prioriteteve të zhvillimit vendor apo kombëtar apo zbatimit të lejeve të mëparshme të ndërtimit në mënyrën dhe afatet e caktuara, autoritetet vendore mund të parashikojnë procedura të përsheptuara apo incentiva zhvillimi për investitorë apo aplikime të caktuara.

KREU IV

VËZHGIMI, INSPEKTIMI, KUNDËRVAJTJET E DËNIMET

Neni 50

Vëzhgimi i zhvillimeve në territor

1. Çdo autoritet i planifikimit, në përputhje me sferën e tij të juridiksionit dhe të përgjegjësi, kryen vëzhgime për zhvillimet në territor, me qëllim studimin dhe vlerësimin e këtyre zhvillimeve, parashikimin e rreziqeve apo të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme apo për ndërmarrjen e politikave, miratimin e dokumenteve apo të kryerjes së veprimeve të përshtatshme për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit.

2. Autoritetet e planifikimit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet ndërmjet tyre dhe bashkëveprojnë e shkëmbejnë informacione e të dhëna.

3. Çdo autoritet i planifikimit përgatit dhe boton në regjistër dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit, brenda fundit të muajit mars të çdo viti, raportin vjetor për zhvillimet në territorin e tij administrativ gjatë vitit të mëparshëm.

4. AKPT-ja, bazuar në raportet e autoriteteve të tjera, si dhe në vëzhgimet e kryera prej saj, përgatit dhe boton në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit, brenda fundit të muajit qershor të çdo viti, raportin kombëtar për zhvillimet në territor gjatë vitit të mëparshëm.

5. Këshilli i Ministrave përcakton strukturën e unifikuar të raporteve të përmendura në pikat e mësipërme të këtij neni.

Neni 51

Inspektimi

1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësi, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.

4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.

Neni 52

Kundërvajtjet administrative

(shtuar shëronja "b" në pikën 1 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) moskryerja e takimit publik dhe këshillimit, sipas neni 24 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë;

b) shkelja e afateve të botimit në regjistër të akteve dhe projektakteve, për të cilat botimi është i detyrueshëm sipas këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë;

c) miratimi i lejes së ndërtimit dhe lëshimi i certifikatës së përdorimit, në kundërshtim me këtë ligj ose me dokumentet e planifikimit në fuqi, dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 3 000 000 lekë. Mosveprimet e pambështetura në ligj, me pasojë miratimin në heshtje në kundërshtim me ligjin, dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë;

ç) mosrespektimi i afatit të dorëzimit të dokumentit të lejes, sipas nenit 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

d) mosdeklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas nenit 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 150 000 lekë;

dh) shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve, sipas nenit 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë;

e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera;

ë) kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes:

i) pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 300 000 lekë, pezullim të punimeve dhe me masën e përcaktuar në përfundim të procedurës, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni;

ii) me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera pa leje.

f) përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

g) vazhdimi i punimeve me gjithë vendimin administrativ për pezullimin ose ndërprerjen e tyre dënohet me prishje dhe me gjobë nga 10 000 lekë deri në 20 000 lekë;

gj) hartimi i projektit të ndërtimit, kryerja e oponencës, mbikëqyrjes, zbatimit të punimeve dhe kolaudimit të objektit në kundërshtim me ligjin, dokumentet e planifikimit ose me lejen e ndërtimit, pavarësisht nëse përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 3 000 000 lekë.

h) refuzimi i lejes së ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

2. Vlera e punimeve të kryera pa leje, sipas pikës 1, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij neni, llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

3. Në rastin e konstatimit të ndryshimeve në projekt apo shkeljeve të kushteve të lejes, pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dhe volume shtesë, autoriteti i inspektimit, krahas dënimit sipas nënndarjes “I”, të shkronjës “e”, të këtij neni, pezullon punimet dhe i cakton një afat deri në 45 ditë subjektit për të aplikuar për pajisjen me leje të punimeve të kryera në ndryshim të projektit dhe lejes së miratuar pranë autoritetit vendor dhe njofton autoritetin e planifikimit. Aplikimi për pajisjen me leje shoqërohet nga dokumentacioni tekniko-ligjor, argumentimi teknik për ndryshimet në projekt apo për mosrespektimin e kushteve të lejes dhe vërtetimi i pagesës së gjobës. Në rast se subjekti nuk aplikon brenda afatit, autoriteti i planifikimit merr vendim, sipas pikës 4 të këtij neni, në lidhje me ndërtimin.

4. Autoriteti i planifikimit shqyrton kërkesën e paraqitur, sipas pikës 3, të këtij neni, dhe mund të miratojë lejen për ndryshimet në projekt apo punimet jashtë kushteve të lejes, vetëm në rast se ndërtimi nuk është në kundërshtim me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, dhe nuk cenon të drejtat pronësore të personave të tjerë, si dhe qëndrueshmërinë e sigurinë e objektit. Në rastet kur ndërtimi është në përputhje me kërkesat e mësipërme, autoriteti i planifikimit merr vendim për miratimin e kërkesës dhe pajisjen me leje. Në rast të kundërt, autoriteti përgjegjës vendos prishjen e ndryshimeve apo punimeve jashtë kushteve të lejes. Kur prishja nuk mund të kryhet pa cenuar pjesën e ndërtimit në konformitet me projektin dhe lejen e miratuar, autoriteti i planifikimit vendos një gjobë të barabartë me dyfishin e vlerës së punimeve të kryera në shkelje të lejes, por në çdo rast jo më pak se 1 000 000 lekë. Pas pagesës së gjobës, autoriteti përgjegjës miraton lejen e ndërtimit për punimet përkatëse.

5. Për shkeljet e kryera nga subjekti ndërtues, projektuesi, mbikëqyrësi dhe kolaudatori, strukturat e kontrollit paraqesin menjëherë kërkesën për heqjen e licencës. Autoritetet përkatëse janë të detyruar të marrin vendim për heqjen e licencës brenda pesë ditëve. Subjekti, të cilit i është hequr licenca, nuk mund të pajiset më me të njëjtën licencë për 5 vitet në vijim.

6. Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit.

7. Për shkeljet që përbëjnë vepër penale, autoritetet e inspektimit, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, sipas këtij neni, bëjnë menjëherë kallëzim për ndjekje penale.

8. Dispozitat e parashikuara në këtë nen për ndërtimet pa leje zbatohen edhe në rastin e shfuqizimit të lejes së ndërtimit me vendim të gjykatës ose autoritetit kompetent.

Neni 53

Ekzekutimi i dënimeve

1. Gjambat e përcaktuara, sipas nenit 52, të këtij ligji, vendosen nga autoriteti përgjegjës i inspektimit.

2. Autoriteti kombëtar i inspektimit vendos, sipas nenit 52, të këtij ligji, për shkeljet e konstatuara në nivel kombëtar, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Autoriteti kombëtar i inspektimit kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga autoriteti vendor i inspektimit dhe ushtron detyrat e tij për çështje të rëndësisë kombëtare në planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe kur ato nuk janë ushtruar nga autoriteti vendor i inspektimit.

4. Autoriteti kombëtar i inspektimit, kur konstaton se cenohet parimi i interesit kombëtar për zhvillimin e territorit nga ndërtimet pa leje, vepron në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për çështjet dhe zonat e rëndësisë kombëtare.

5. Masa e gjobës përcaktohet, në çdo rast, në përpjesëtim të drejtë me natyrën e kundërvajtjes së konstatuar, me përgjegjësinë dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje të zyrtarit ose të kundërvajtësit dhe me faktin nëse kundërvajtësi është përsëritës apo jo.

6. Në rast përsëritjeje të kundërvajtjes, kundërvajtësi dënohet me dyfishin e vlerës së gjobës.
7. Procedurat e konstatimit të kundërvajtjes, të njoftimit të kundërvajtësit, vendimit, ankimit dhe masave të tjera administrative, kundrejt shkeljeve të këtij ligji, si dhe ekzekutimi i dënimit rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi që rregullojnë inspektimin e ndërtimit.

KREU V

REGJISTRI KOMBËTAR I PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Neni 54

Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit (ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Funksionet themelore të regjistrit janë:
- a) regjistrimi i informacionit ligjor e fizik të të drejtave apo kufizimeve publike e private mbi tokën dhe transformimet që ajo pëson për shkak të zhvillimit;
 - b) njoftimi, në formë e format të përshtatshëm, i projektakteve dhe akteve të lidhura me planifikimin e territorit;
 - c) çdo funksion tjetër që mund t'i jepet me ligj.
2. Funksionimi dhe përdorimi i regjistrit nuk shmangin detyrimin për botim, sipas mjeteve të tjera tradicionale të informimit, në rast se parashikohet me ligj.

Neni 55

Organizimi dhe funksionimi i regjistrit

1. Informacioni në regjistër organizohet sipas një rrjeti të integruar e shumëqëllimësh të bazave të të dhënave shtetërore për tokën dhe zhvillimet në të, të pavarura e ndërvepruese ndërmjet tyre. Autoritetet përgjegjëse ndërtojnë, administrojnë e mirëmbajnë bazën e tyre të të dhënave, pjesë përbërëse të regjistrit, sipas një platforme teknike, strukture dhe standardeve të përbashkëta gjeodezike e GIS-it për të siguruar përputhshmërinë e ndërveprimit ndërmjet tyre dhe shkëmbimin e përdorimit të informacionit të regjistruar në to.
2. Të dhënat e botuara në regjistër aksesohen lirisht nga publiku nëpërmjet komunikimit elektronik me internet, përveç atyre që mbrohen me ligj. Si rregull, aksesimi në regjistër është falas dhe përmbajtja e akteve të përfshira në të është publike. Për shërbime të caktuara mund të zbatohet një tarifë, për të cilën publiku informohet paraprakisht.
3. Bazat e të dhënave shtetërore GIS administrohen nga autoritetet e planifikimit dhe institucionet e tjera publike, në nivel kombëtar e vendor, sipas përgjegjësisë të përcaktuara në këtë ligj dhe legjislacionit në fuqi. Çdo autoritet i planifikimit regjistron të dhënat sektoriale në regjistër dhe i boton ato.
4. Autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucionet e tjera publike kontribuojnë proporcionalisht në ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit.

Neni 56

Botimi në regjistër (ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Të gjitha projektaktet ose aktet e miratuara, që lidhen me planifikimin, përfshirë dokumentacionin shoqërues dhe vërejtjet apo propozimet gjatë bashkërendimit të planifikimit, janë të detyrueshme për botim, përveç atyre llojeve, të cilat:
- a) përjashtohen me ligj;
 - b) janë akte të brendshme të një autoriteti kombëtar ose vendor;
 - c) janë akte ose dokumentacion shoqërues, botimi i të cilave ndalohet nga legjislacioni në fuqi.

2. Botimi në regjistër, kur nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, është kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për hyrjen në fuqi të aktit.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, mund të botohet në regjistër, me nismën e autoritetit përgjegjës të planifikimit, çdo akt tjetër që nuk është i detyrueshëm për botim, literaturë, metodologji, studime dhe çdo njoftim me interes për publikun.

4. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, projektaktet dhe aktet që janë të detyrueshme për botim në regjistër botohen në regjistër brenda 10 ditëve nga data e vendimit përkatës.

Neni 57

Rregullat për regjistrin

(shfuqizuar shkronja "ç" me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

Në zbatim të dispozitave të mësipërme të këtij kreu, Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore për miratimin e:

a) rregullave për mbështetjen me burime financiare të autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucioneve të tjera publike në lidhje me mirëmbajtjen dhe funksionimin e regjistrin;

b) strukturës dhe standardeve të përbashkëta gjeo-dezike dhe të GIS-it;

c) rregullave për krijimin, administrimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave e për strukturën dhe formatet e regjistrimit;

ç) Shfuqizuar.

d) rregullave të lidhjes në rrjet dhe të transferimit të ndërsjellë të të dhënave ndërmjet autoriteteve të planifikimit dhe institucioneve të tjera shtetërore;

dh) detyrimeve dhe të drejtave të autoriteteve kombëtare, rajonale e vendore, të planifikimit për regjistrin;

e) shërbimeve dhe tarifave përkatëse për to.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 58

Hartimi i dokumenteve të planifikimit

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë Planin e Përgjithshëm Kombëtar jo më vonë se 20 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Dokumentet e planifikimit, të cilat janë në proces hartimi në momentin e hyrjes në fuqi të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, i nënshtrohen procesit të rishikimit në përputhje me të.

3. Ngarkohen autoritetet vendore të planifikimit të miratojnë dokumentet vendore të planifikimit jo më vonë se 2 vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Për dokumentet e planifikimit, të cilat janë në proces hartimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen dispozitat e këtij ligji.

5. Në funksion të ngritjes së një sistemi të integruar të planifikimit në rang kombëtar, ngarkohet AKPT-ja të kryejë analizën e dokumenteve ekzistuese, vlerësimin e dokumenteve të planifikimit që janë të nevojshme për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe përlllogaritjen e kostove dhe afateve të nevojshme për hartimin e tyre.

Neni 59

Dokumentet e kontrollit të zhvillimit

1. Kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi në proces shqyrtimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji të vlerësohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Lejet e zhvillimit/ndërtimit të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen në përputhje me kushtet e lejes përkatëse.

3. Dorëzimi i dokumentit të lejes së ndërtimit për lejet e miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të përfundojë brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Zgjatja e afatit të lejes dhe ndryshimi i subjektit zbatues për lejet e ndërtimit të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji kryhen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 60

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve përkatëse të këtij ligji.

Neni 61

Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 10 119, datë 23.4.2009, “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij shfuqizohen.

2. Ligji nr. 96/2013, datë 4.3.2013, shfuqizohet.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

(e shtuar me ligjin nr. 73/2015, datë 9.7.2015)

Deri në krijimin dhe nisjen e funksionimit të strukturës së sekretariatit teknik të KKT-së, funksionet e këtij sekretariati do të ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Dispozita kalimtare

(shtuar me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017)

1. Për lejet e ndërtimit, të cilave u ka përfunduar afati i zbatimit të punimeve, përcaktuar në formularin e lejes përkatëse, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, shtyrja e afatit mund të kryhet nga autoriteti përgjegjës, me kërkesë të zhvilluesit, me kushtin që të mos kenë kaluar më shumë se 10 vjet nga data e miratimit të lejes së ndërtimit dhe subjekti të ketë paguar paraprakisht penalitetet e parashikuara nga neni 52, i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

2. Në rast se punimet e ndërtimit për këto leje nuk kanë filluar, në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, deri në datën e hyrjes në fuqi të dokumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit, shtyrja e afatit të lejes përkatëse bëhet pas përputhshmërisë me planin e përgjithshëm vendor.

Neni 62

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2014.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 31.7.2014

KAPITULLI II ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

LIGJ Nr.9632, datë 30.10.2006

PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE¹⁴

(Ndryshuar me ligjet: nr.9745, datë 28.5.2007, nr.9764, datë 9.7.2007, nr.9931, datë 9.6.2008, nr.10 073, datë 9.2.2009, nr.10 117, datë 23.4.2009, nr.10 146, datë 28.9.2009, nr. 10 354, datë 18.11.2010, nr.10 457, datë 21.7.2011, nr. 106/2013, datë 28.3.2013, nr. 181/2013, datë 28.12.2013, nr. 85/2014, 17.7.2014, nr. 142/2015¹⁵, datë 17.12.2015, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 1.3.2017, ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 dhe ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji janë taksat e bashkive.

Neni 2 Qëllimi i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

¹⁴ Ligji nr.9745, datë 28.5.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, datë 19 qershor 2007.

Ligji nr.9764, datë 9.7.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 21 korrik 2007.

Ligji nr.9931, datë 9.6.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 102, datë 1 korrik 2008.

Ligji nr.10 073, datë 9.2.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 4 mars 2009.

Ligji nr.10 117, datë 23.4.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 62, datë 14 maj 2009.

Ligji nr.10 146, datë 28.9.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 144, datë 12 tetor 2009.

Ligji nr. 10 354, datë 18.11.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, datë 15 dhjetor 2010.

Ligji nr.10 457, datë 21.7.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 102, datë 2 gusht 2011.

Ligji nr. 106/2013, datë 28.3.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 15 prill 2013.

Ligji nr. 181/2013, datë 28.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 30 dhjetor 2013.

Ligji nr. 85/2014, datë 17.7.2014, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 11 gusht 2014.

Ligji nr. 142/2015, datë 17.12.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 252, datë 22 janar 2016.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 1.3.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 49, datë 15 mars 2017.

¹⁵ Neni 18 i ligjit 142/2015, datë 17.12.2015 është shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 1.3.2017.

Ligji nr. 68/2017, datë 27.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 22 maj 2017.

Ligji nr. 106, datë 30.11.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19 janar 2017 dhe hyn në fuqi më 1 prill 2018, me përjashtim të nenit 7, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Neni 3

Përkufizime

(Shtuar pika 7, me ligji nr. 142/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar pika 2, shtuar pika 2/1 dhe shfuqizuar pika 7 me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

Në zbatim të këtij ligji:

1. Termat e përdorur do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 2 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”.
2. “Pasuri e paluajtshme” janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
- 2.1. “Kadastra Fiskale” është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
3. “Zyrë e taksave” është njësi organizative që, me vendim të këshillit të bashkisë, ngarkohet për administrimin e taksave vendore.
4. “Organe tatimore të pushtetit qendror” janë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e tatim-taksave në rrethe.
5. “Nivel tregues i taksës” është niveli i taksës mbi biznesin e vogël, i parashikuar në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.
6. “Arka regjistruese” janë kasat regjistruese elektronike, të detyrueshme për lëshimin e kuponave tatimorë nga biznesi, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe me udhëzimin e Ministrit të Financave.
7. Shfuqizuar.

Neni 4

Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë

(Ndryshuar pika 6, me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015, shtuar pika 9 me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

1. Bashkitë dhe organet tatimore të pushtetit qendror i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, në përputhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e çdo akt tjetër detyrues për sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë, për aq sa këto të fundit nuk bien në kundërshtim me këtë ligj dhe me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”.
2. Zyra e taksave të bashkisë vendos e zbaton sanksione për shkelje të procedurave e të detyrimeve fiskale vendore, të përcaktuara në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Policia bashkiake mbështet inspektorët e taksave të bashkisë në veprimtarinë e tyre, kur gjykohet e nevojshme dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara nga këshilli i bashkisë, sipas nenit 5 të këtij ligji.
4. Organet tatimore të pushtetit qendror, për administrimin në tërësi të sistemit tatimor, ndërmarrin edhe veprime vlerësimi dhe kontrolli për çështje që lidhen ose ndikojnë në administrimin e tatimeve ose të taksave kombëtare. Zyrat e taksave të bashkive njoftojnë dhe mbështesin organet tatimore të pushtetit qendror, kur u kërkohet prej këtyre të fundit.
5. Organet tatimore të pushtetit qendror, me kërkesë të bashkisë, mbështesin veprimtarinë e tyre për administrimin e taksave vendore. Palët mund të bashkëpunojnë mbi bazën e mirëkuptimit ose bazuar në një marrëveshje tip të miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave.
6. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet bashkive dhe organeve tatimore të pushtetit qendror, për çështje që kanë të bëjnë me kompetencën e juridiksionit mbi taksën vendore, bëhet me mirëkuptim. Në të kundërt, palët i drejtohen gjykatës.
7. Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm nxjerrin udhëzime, në zbatim të këtij neni, për sigurimin e uniformitetit minimal e të domosdoshëm të standardeve procedurale e të raportimit të sistemit të taksave vendore.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat. Struktura dhe organika miratohen me urdhër të Kryeministrit.

Këshilli i Ministrave miraton rregullat për organizimin dhe funksionimin e saj.

Neni 5

Rregulla të përbashkëta për taksat vendore

Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë:

a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;

b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;

c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;

ç) përcakton:

i) detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së taksave;

ii) mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella;

iii) rastet e ndërhyrjes së policisë bashkiake, në mbështetje të administrimit të taksave vendore;

iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore;

v) kriteret dhe procedurat e marrëdhënieve me taksapaguesit, përfshirë të drejtën e tyre të ankimit;

vi) mënyrat e zbatimit të sanksioneve për kundërvajtje administrative.

Neni 6

Përjashtimi nga taksat

Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë ligj apo në ligje të tjera të veçanta. Për përjashtimet nga taksat vendore, të cilat aplikohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushteti vendor do të kompensohet për efektet financiare nga Buxheti i Shtetit.

Neni 7

Ankimi

(ndryshuar me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimt të zyrës së taksave, bëhet te struktura vendore e apelimit tatimor, sipas kriterëve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimit tatimor në bashki.

Neni 8

Të drejtat e tatimpaguesit

Tatimpaguesi kërkon të drejtat në përputhje me procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe me këtë ligj.

KREU II TAKSAT VENDORE

Neni 9

Llojet e taksave vendore

(Shfuqizuar pika 6, me ligjin nr. 10 457, datë 21.7.2011, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, ndryshuar pika 2 dhe shfuqizuar pika 7, me ligjin nr. nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

Në taksat vendore përfshihen:

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Shfuqizohet.
7. Shfuqizohet.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

KREU III

TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

(ndryshuar krejt kapitulli me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

Neni 10

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Neni 11

Shkalla tatimore

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013 dhe me ligjin nr. nr. 85/2014, 17.7.2014 dhe me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind.
2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.

Neni 12

Shpenzimet e njohura

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ky ligj.

Neni 13

Shpenzimet e panjohura

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

1. Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet e mëposhtme:
 - a) kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës e të truallit;
 - b) kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të veprimtarisë, të cilat amortizohen, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;
 - c) vlera e shpërblimeve në natyrë;
 - ç) interesat e paguar, të cilët tejkalojnë normën mesatare të interesit 12-mujor të kredisë, për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë;
 - d) gjokat, kamatëvonesat dhe kushtet e tjera penale;
 - dh) krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera speciale, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore;
 - e) tatimi mbi të ardhurat personale dhe ato nga biznesi;
 - ë) shpenzimet për përfaqësim dhe për pritje-përcjellje, të cilat e tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;
 - f) shpenzimet e konsumit personal, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave;
 - g) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar për qëllime tatimore në ligjin nr. 7892, datë 21.11.1994, “Për sponsorizimet”, nuk njihen si shpenzime të njohura shumat e sponsorizuara që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shumat e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit;
 - gj) shpenzimet për dhurata;
 - h) çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi;
 - i) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, të faturuara nga persona të tretë, për të cilat nuk është paguar tatimi në burim, brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi”.
 - j) humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, transitimit dhe magazinimit tej normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;
 - k) shpenzimet për pagat, shpërblime dhe çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të cilat lidhen me të ardhurat nga marrëdhëniet me punësimin, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë dhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - l) shumat e paguara në *cash*, mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
 - Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - ll) nëse gjatë periudhës tatimore huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkualuar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm;
 - m) borxhi i keq, nëse nuk plotësohen tri kushtet e përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Një borxh i keq, që është mbledhur, duhet të përfshihet si e ardhur në çastin e mbledhjes;

n) shpenzimet për udhëtime, ushqim, akomodim dhe lëvizje duhet të kufizohen te shumat e specifikuar me udhëzim të Ministrit të Financave;

nj) shpenzimet për asetet kapitale, përveç shpenzimeve për tokën, veprat e artit dhe pasuri të tjera që nuk amortizohen, në pronësi të tatimpaguesit dhe të përdorura për veprimtaritë e biznesit të tatimpaguesit, do të mbulohen gjatë kohës përmes shpenzimeve të amortizimit, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

i) kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e të pajisjeve, me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, në mënyrë lineare, me 5 për qind;

ii) amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind;

iii) kompjuterët, sistemet e informacionit, produktet *software* dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave amortizohen në bazë të vlerës së grupit, me 25 për qind;

iv) të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind.

2. Baza e amortizimit është vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore, duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë, gjatë periudhës tatimore dhe, duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera të pavullnetshme, gjatë periudhës tatimore. Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet së ardhurës së tatueshme dhe baza e amortizimit merret zero. Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit është një shpenzim i zbritshëm i veprimtarisë. Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë, nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

Neni 14

Mbajtja e regjistrimeve

(Ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

Librat dhe regjistrimet, që kërkohet të mbahen nga tatimpaguesit, janë: libri i shitjes (i qarkullimit), libri i blerjeve, libri i shpenzimeve dhe i të ardhurave dhe libri i aktiveve të biznesit, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 15

Parapagimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, ndryshuar pika 1, 2 dhe 3, shtuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 85/2014, 17.7.2014, ndryshuar pika 1 dhe 4 me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

1. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

2. Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të

tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

3. Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, të periudhës paraardhëse, organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të parashikuara me udhëzim të Ministrit të Financave.

3/1. Nëse organet tatimore vlerësojnë dhe kanë të dhëna se tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën vijuese tatimore, do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, ato mund të rregullojnë në rritje parapagimet, në përputhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e vlerësuar prej tyre.

4. Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti. Me kryerjen e pagesës dhe marrjen e konfirmimit bankar të kryerjes së pagesës, tatimpaguesi shkon te zyrat e shërbimit tatimpagues tatimor dhe, kundrejt paraqitjes së dokumentit bankar të pagesës, merr “Pullën e tatimit” të këstit, për të cilin ka bërë pagesën. Dizenjot dhe elementet e pullës caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Tatimpaguesi e vendos pullën e tatimit lart certifikatës së regjistrimit në QKR për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dhe shpenzimet përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. “Pulla e tatimit” duhet të përmbajë elemente të sigurisë së lartë për të shmangur falsifikimin e tyre. Për kryerjen e pagesës dhe marrjen e konfirmimit bankar të kryerjes së pagesës, tatimpaguesit shkojnë te zyra e shërbimit tatimpagues tatimor dhe, kundrejt paraqitjes së dokumentit bankar të pagesës, marrin “Pullën e tatimit”, për të cilën kanë bërë pagesën.

5. Drejtoritë rajonale tatimore bëjnë regjistrimin e arkëtimit tremujor të tatimit, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së tatimit me zyrat e tatimeve të bashkive. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 16

Deklarimi

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, me ligjin nr. 85/2014, 17.7.2014 dhe me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t’u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Detyrimin për paraqitjen e deklaratës vjetore në afatin e mësipërm e kanë edhe të gjithë tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë. Këta tatimpagues e plotësojnë këtë deklaratë sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave.

Neni 17

Administrimi i tatimit

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

Neni 18

Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësisve të qeverisjes vendore dhe në buxhetin e shtetit dhe komisioni i agjentit tatimor (ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësisve të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore. Komisioni kalon në llogari të Buxhetit të Shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të "Pullave të tatimit".

Neni 19

Bashkëpunimi

(ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

1. Drejtoria rajonale tatimore njofton bashkinë jo më pak se një herë në gjashtë muaj për punën e bërë për nivelin e vjeljes së këtij tatimi.

2. Bashkia, kur e gjykojnë të nevojshme, i kërkojnë organit tatimor kryerjen e veprimeve për plotësimin e detyrave për administrimin e tatimit dhe derdhjen në favor të saj, sipas afatit ligjor të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël.

KREU IV

TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Neni 20

Përcaktimi dhe llojet

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013 ndryshuar pika 1 dhe shtuar shkronja "b" e pikës 2, me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

1. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

2. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat;
- b) taksa mbi tokën bujqësore.
- c) taksa mbi truallin.

3. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive të dbënat e regjistrimit elektronik të pasurisë.

Neni 21

Rregulla të përbashkëta të taksës për pasurinë e paluajtshme

(Shtuar fjali në pikën 3, me ligjin nr.10 117, datë 23.4.2009, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015, shfuqizuar fjalia e fundit e pikës 3 me ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017, ndryshuar pika 2, shtuar pika 2, ndryshuar fjali në pikën 3 me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

1. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

2. Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme - ndërtesa.

2.1 Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 2 dhe 2.1, që i bashkëngjiten këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 2, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

4. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;

b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak në raport me dëmin e shkaktuar, deri në vlerën 75 për qind.

Neni 22

Taksa mbi ndërtesat

(shtuar një paragraf në pikën 1, me ligjin nr. 9764, datë 9.7.2007, shtuar shkronja “ç” me ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013, shtuar një paragraf në pikën 1, me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, shtuar fjalia e dytë në paragrafin e parë me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar plotësisht me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

6. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.

Neni 22/1

Baza e taksës

(shtuar me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Neni 22/2

Shkalla e taksës

(shtuar me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Neni 22/3

Informacioni lidhur me taksën mbi ndërtesën

(shtuar me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me:

- a) natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjes të informacionit të marrë nga burime të ndryshme;
- b) prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme.

Neni 22/4

Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë

(shtuar me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë:

a) menaxhon regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

b) udhëheq, nga pikëpamja metodologjike, në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme;

c) përcakton nivelin e vlerësuar të taksës së pasurisë së paluajtshme për ndërtesat, si dhe detyrimin e taksës së pronës, me metoda alternative të vlerësimit.

Këshilli i Ministrave vendos kritere dhe rregulla në lidhje me procedurat dhe elementet që përdoren për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Neni 22/5

Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

(shtuar me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;

b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);

c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;

ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;

d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbledhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave.

3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23

Taksa mbi tokën bujqësore

(Ndryshuar pika 1 me ligjin me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji.

3. Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Neni 23/1

Taksa mbi truallin

(Shtuar me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2.1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2.1, të këtij ligji.
3. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Neni 24

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

(Shtuar një paragraf me ligjin nr.10 146, datë 28.9.2009)

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive, për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë për regjistrimet e reja të kryera dhe për ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, këshilli i bashkisë vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 25

Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimi i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

KREU V TAKSA TË TJERA VENDORE

Neni 26

Taksa e fjetjes në hotel

(Ndryshuar me ligjin me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015; shtuar pika 7 me ligjin nr. 106, datë 30.11.2017)

1. Për qëllim të këtij ligji, me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.

3. Niveli tregues i taksës është sipas aneksit 8 bashkëlidhur këtij ligji

4. shfuqizuar.

4. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

5. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

6. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridikionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

7. Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

Neni 27

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009 dhe shtuar pika 2/1, me ligjin nr.10 146, datë 28.9.2009 ndryshuar plotësisht me ligjin me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

2/1. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind e kësaj vlere, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri 4 për qind e saj.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

5. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

6. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Neni 28

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin 3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

3. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Neni 29

Përfashtime nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Përfashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;

b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";

c) subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përfashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 30

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

(Shfuqizohet me ligjin nr. 10 457, datë 21.7.2011)

Neni 31

Përfashtimi nga pagimi i taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

(Shfuqizohet me ligjin nr. 10 457, datë 21.7.2011)

Neni 32

Taksa të tjera

(Ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 dhe shkronja "ç" e pikës 2, me ligjin nr. 10 117, datë 23.4.2009 dhe shfuqizuar shkronja "b" e pikës 1 me ligjin nr.10 146, datë 28.9.2009, shtuar shkronja "d" me ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013 dhe ndryshuar plotësisht me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

Këshilli bashkiak cakton bazën dhe nivelin e taksës së tabelës.

Neni 32/1

Taksa e tabelës

(Shtuar me ligjin Nr.10 146, datë 28.9.2009)

Kategoritë e bazës së taksës së tabelës dhe niveli i tyre jepen në ankesin nr.7, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 33

Taksa e përkohshme

(Ndryshuar me ligjin nr.10 117, datë 23.4.2009, shtuar një fjali me ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013, shfuqizuar fjalia e dytë me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

Këshilli bashkiak, kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda juridiksionit të tij. Antenat e telefonisë celulare, si dhe çdo lloj antene tjetër transmetimi, të vëna në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nuk janë subjekt i taksave me karakter të përkohshëm.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 34

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

(Ndryshuar me ligjin nr.9931, datë 9.6.2008)

Shkeljet e dispozitave për taksat e tjera vendore, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

KREU VII TARIFAT VENDORE DHE ADMINISTRIMI I TYRE

Neni 35

Tarifat vendore dhe administrimi i tyre

(Ndryshuar pika 2, me ligjin nr.10 117, datë 23.4.2009, shtuar pika 4 me ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013, shfuqizuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, shtuar pika “c” me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015)

1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë ose qarkut klasifikohet si tarifë kur:

- a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”
- b) nuk është taksë bashkiake, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligj.
- c) paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.

Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga një agjent.

Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të.

4. Nuk konsiderohen tarifa, në kuptim të këtij ligji dhe të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” tarifat e antenave të telefonisë celulare, si dhe të çdo lloj antene tjetër transmetimi, të vëna në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 36

Fillimi i ushtrimit të kompetencave

(Shtuar pika 3 dhe 4 me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013)

1. Ushtrimi i kompetencave të këtij ligji nga bashkitë dhe qarqet fillon në datën 1 janar 2007.

2. Organet tatimore të pushtetit qendror, nga njëra anë dhe bashkitë, nga ana tjetër, bashkëpunojnë për të bërë kalimin e kompetencave për administrimin e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe të të gjithë dokumentacionit përkatës, si dhe për mënyrën e procedimit, brenda vitit kalendarik 2006.

Çdo bashki kompensohet financiarisht, në përpjesëtim me koston e ulur të shpenzimeve administrative të administratës tatimore qendrore, për shkak të kalimit të kompetencave të administrimit në pushtetin vendor. Ky kompensim përdoret nga bashkitë për të përballuar koston administrative shtesë për administrimin e kësaj takse.

3. Për vitin 2014, tatimpaguesi parapaguan tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të ndarë në katër keste vjetore, në bazë të fitimit të tatueshëm për vitin 2013, sipas deklaramit të të ardhurave personale të biznesit të vogël, të bërë në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

4. Brenda datës 30 janar 2014, njësitë e qeverisjes vendore u përcjellin drejtorive rajonale tatimore të gjitha të dhënat për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 në 8 milionë lekë.

Neni 37

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministri i Financave nxjerr aktet e nevojshme për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me përgjegjësitë e dhëna, sipas neneve 8 e 9 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 38

Shfuqizime

Ligji nr.7805, datë 16.3.1994 "Për tatimin mbi pasurinë"; paragrafi i dytë i nenit 51 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar; ligji nr.8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; nenet 32/1, 32/2, 32/3, 32/4, 32/5, 32/6, 32/7 dhe 32/8 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar; ligji nr.8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore për biznesin e vogël", i ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore, për aq sa bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2007.

Shpallur me dekretin nr.5118, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ANEKSI 1

NIVELET TREGUESE TË TAKSËS SË NDËRTESES

(Ndryshuar me ligjin nr.9764, datë 9.7.2007 dhe me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013 dhe ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015; shfuqizuar me ligji nr. 106/2017, datë 30.11.2017)

ANEKS 2

KATEGORITË MINIMALE DHE NIVELET TREGUESE TË TAKSËS MBI TOKEN BUJQËSORE

1	Klasifikimi sipas rretheve		
	2	3	3
Tiranë	Shkodër	Gjirokastër	Bulqizë
Durrës	Elbasan	Përmet	Has
Kavajë	Berat	Pogradec	Kukës
Krujë	Korçë	Librazhd	Tropojë
Lezhë	Delvinë	Dibër	Pukë
Lushnjë	Kurbin	Mat	Mirditë
Fier	Peqin	Skrapar	Malësi
Vlorë	Kuçovë	Mallakastër	e Madhe
Sarandë		Devoll	Gramsh
		Tepelenë	Ersekë

Vlera e taksës në lekë/hektar/vit

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës				
I	5 600	4 200	2 800	1 400
II	4 900	3 500	2 100	1 200
III	4 200	2 800	1 400	1 100
IV	3 600	2 300	1 350	1 000
V	3 000	1 900	1 250	900
VI	2 400	1 600	1 200	800
VII-X	1 800	1 400	1 100	700

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Aneksi 2.1

NIVELET TREGUESE TË TAKSËS SË TRUALLIT (JO HAPËSIRË PUBLIKE)

Klasifikimi sipas bashkive	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime biznesi
I		
Bashkia Tiranë	0,56 lekë/m2	20 lekë/m2
Bashkia Durrës		
Bashkia Kavajë		
Bashkia Krujë		
Bashkia Lezhë		
Bashkia Lushnjë		
Bashkia Fier		
Bashkia Vlorë		
Bashkia Sarandë		
II		
Bashkia Shkodër	0,42 lekë/m2	18 lekë/m2
Bashkia Elbasan		
Bashkia Berat		
Bashkia Korçë		
Bashkia Delvinë		
Bashkia Kurbin		
Bashkia Peqin		
Bashkia Kuçovë		

III		
Bashkia Gjirokaštër	0,28 lekë/m2	15 lekë/m2
Bashkia Përmet		
Bashkia Pogradec		
Bashkia Librazhd		
Bashkia Dibër		
Bashkia Skrapar		
Bashkia Mallakastër		
Bashkia Devoll		
Bashkia Tepelenë		
IV		
Bashkia Bulqizë	0,14 lekë/m2	12 lekë/m2
Bashkia Kukës		
Bashkia Tropojë		
Bashkia Pukë		
Bashkia Mirditë		
Bashkia Malësi e Madhe		
Bashkia Gramsh		
Bashkia Ersekë		
Bashkia Has		
Të gjitha bashkitë e tjera		

ANEKSI 3

NIVELET E TAKSËS SË KALIMIT TË PRONËSISË MBI NDËRTESAT

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë e ndërtesave	Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë	Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Vlorë	Bashkia Ura Vajgurore, Njësia Administrative Ura Vajgurore
	Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës	Bashkia Fier, Njësia Administrative Fier	Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative Kuçovë
		Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë	Bashkia Skrapar, Njësia Administrative Skrapar
		Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Pogradec	Bashkia Poliçan, Njësia Administrative Poliçan
		Bashkia Korçë, Njësia Administrative Korçë	Bashkia Bashkia Dibër, Njësia Administrative Peshkopi
		Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Elbasan	Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Bulqizë
		Bashkia Berat, Njësia Administrative Berat	Bashkia Mat, Njësia Administrative Burrel
		Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Lushnjë	Bashkia Klos, Njësia Administrative Klos
		Bashkia Gjirokastrë, Njësia Administrative Gjirokastrë	Bashkia Durrës, Njësia Administrative Sukth
		Bashkia Shkodër, Njësia Administrative Shkodër	Bashkia Durrës, Njësia Administrative Manzë
		Bashkia Kavajë, Njësia Administrative Kavajë	Bashkia Shijak, Njësia Administrative Shijak
		Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Lezhë	Bashkia Krujë, Njësia

			Administrative Krujë
			Bashkia Cërrik, Njësia Administrative Cërrik
			Bashkia Belsh, Njësia Administrative Belsh
			Bashkia Peqin, Njësia Administrative Peqin
			Bashkia Gramsh, Njësia Administrative Gramsh
			Bashkia Librazhd, Njësia Administrative Librazhd
			Bashkia Përrenjas, Njësia Administrative Përrenjas
			Bashkia Patos, Njësia Administrative Patos
			Bashkia Roskovec, Njësia Administrative Roskovec
			Bashkia Divjakë, Njësia Administrative Divjakë
			Bashkia Mallakastër, Njësia Administrative Ballsh
			Bashkia Libohovë, Njësia Administrative Libohovë
			Bashkia Tepelenë, Njësia Administrative Tepelenë

			Bashkia Memaliaj, Njësia Administrative Memaliaj
			Bashkia Përmet, Njësia Administrative Përmet
			Bashkia Këlcyrë, Njësia Administrative Këlcyrë
			Bashkia Dropull, Njësia Administrative Dropull i Poshtëm
			Bashkia Maliq, Njësia Administrative Maliq
			Bashkia Pustec
			Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Ersekë
			Bashkia Devoll, Njësia Administrative Bilisht
			Bashkia Kukës, Njësia Administrative Kukës
			Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë
			Bashkia Tropojë, Njësia Administrative Bajram Curri
			Bashkia Mirditë, Njësia Administrative Rrëshen
			Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç
			Bashkia Malësi e Madhe, Njësia

			Administrative Koplik
			Bashkia Vau i Dejës, Njësia Administrative Vau i Dejës
			Bashkia Pukë, Njësia Administrative Pukë
			Bashkia Fushë- Arrëz, Njësia Administrative Fushë-Arrëz
			Bashkia Kamzë, Njësia Administrative Kamzë
			Bashkia Vorë, Njësia Administrative Vorë
			Bashkia Rrogozhinë, Njësia Administrative Rrogozhinë
			Bashkia Selenicë, Njësia Administrative Selenicë
			Bashkia Himarë, Njësia Administrative Himarë
			Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë
			Bashkia Konispol, Njësia Administrative Konispol
			Bashkia Finiq, Njësia Administrative Finiq
			Bashkia Delvinë, Njësia Administrative Delvinë
			Bashkia Krujë,

			Njësia Administrative Krujë Bashkia Krujë, Njësia Administrative Fushë- Krujë Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Mamurras Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Ersekë Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Leskovik Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë
Lekë/m²			
I. Ndërtesa banimi	1 000	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2 000	700	300
III. Ndërtesa të tjera	1 500	500	200

Shënim I: Të gjitha njësitë administrative të tjera zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3.

ANEKS 4 TAKSAT VJETORE PËR REGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË MJETEVE

Nr	Tipi i mjetit	Taksë Regjistrimi (në lekë)
1.	Çiklomotorë	0
2.	Motomjete	600
3.	Automjete: Autoveturë: <=4+1 vende, benzinë Autoveturë: <=4+1 vende, naftë Autoveturë > 4+1 deri <= më 8+1 vende, benzinë Autoveturë > 4+1 deri <= më 8+1 vende, naftë	2 400 2 400 4 800 4 800
4.	Automjet transport i përzier deri 3t Automjet transport i përzier 3t deri <= 3,5t	3 600 3 600
5.	Kamion: Nga 3,5t – 7,5t	4 800

	Nga 7,5t – 18t Më i madh se 18t	6 000 8 000
6.	Autobusë: Nga 8+1 deri <= 32+1 vende >32+1 deri<= 42+1 vende Mbi 42+1 vende, artikulare	6 000 7 200 8 400
7.	Automjet për përdorim të veçantë: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18 t	3 600 4 800 6 000 8 000
8.	Automjet transporti të veçantë: <= më 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18 t	3 600 4 800 6 000 8 000
9.	Tërheqës rrugor	6 000
10.	Autokamp	4 800
11.	Rimorkio: <=750kg (karrel) shtojcë Nga >750kg deri në <= 1500kg Nga >1500kg deri në <= 7000kg Më i madh se 7000kg	3 000 3 000 3 000 4 000
12.	Gjysmë rimorkio: <= 7000kg dhe >7000kg	4 000
13.	Makina bujqësore: <= me 3 5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18 t	3 000 3 000 3 600 3 600
14.	Makina teknologjike: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18 t	3 600 4 800 6 000 8 000
15.	Mjete rrugore të veçanta: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18 t	3 600 4 800 6 000 8 000

ANEKS 5
TABELA E TAKSIMIT TE SUBJEKTEVE TE BIZNESIT TE VOGEL

NË MIJË LEKË KATEGORIA I

		1	2	3	4	5	6	7
		NIVELI TREGUES I TAKSES						
Nr.	Xhiro/ Aktivitet	Deri 2000	2000 - 3.00 0	+3000 - 4000	+4000 - 5000	+5000 - 6000	+6000 - 7000	+7000 - 8000
a)	Shitje me pakicë	45	68	83	98	113	128	143
b)	Shitje me shumicë	45	68	83	98	113	128	143
c)	Prodhim	33	55	70	85	100	115	130
d)	Shërbime	25	48	63	78	93	108	123
e)	Profesione të lira	38	60	75	90	105	120	135
f)	Ambulant	8						

KATEGORIA II

		1	2	3	4	5	6	7
		NIVELI TREGUES I TAKSËS						
Nr.	Xhiro/ Aktivitet	Deri në 2000	2000 - 3000	+3000 - 4000	+4000 - 5000	+5000 - 6000	+6000 - 7000	+7000 - 8000
a)	Shitje me pakicë	25	48	63	78	93	108	123
b)	Shitje me shumicë	25	48	63	78	93	108	123
c)	Prodhim	23	45	60	75	90	105	120
d)	Shërbime	20	43	58	73	88	103	118
e)	Profesione të lira	30	53	68	83	98	11	128
f)	Ambulant	5						

KATEGORIA III

		1	2	3	4	5	6	7
		NIVELI TREGUES I TAKSËS						
Nr.	Xhiro/ Aktivitet	Deri në 2000	2000 - 3.000	+3000 - 4000	+4000 - 5000	+5000 - 6000	+6000 - 7000	+7000 - 8000
a)	Shitje me pakicë	23	45	60	75	90	105	120
b)	Shitje me shumicë	23	45	60	75	90	105	120
c)	Prodhim	20	43	48	73	88	103	118
d)	Shërbime	20	43	58	73	88	103	118
e)	Profesione të lira	22	45	60	75	90	105	120
f)	Ambulant	5						

KATEGORITË I, II, III

		NIVELI TREGUES I TAKSËS						
Nr.	Xhiro/ Aktivitet							
g)	Transport							
	Transport							

1)	pasagjerësh							
	Automjet deri 5 vende	17,5	-	-	-	-	-	-
	Automjet 6-9 vende	35	-	-	-	-	-	-
	Automjet 10-25 vende	40	-	-	-	-	-	-
	Automjet 26-42 vende	45	-	-	-	-	-	-
	Automjet mbi 42 vende	48	-	-	-	-	-	-
2)	Transport Mallrash		-	-	-	-	-	-
	Automjet deri 2 tonë	28	-	-	-	-	-	-
	Automjet 2-5 tonë	40	-	-	-	-	-	-
	Automjet 5-10 tonë	48	-	-	-	-	-	-
	Automjet 10-16 tonë	50	-	-	-	-	-	-
	Automjet mbi 16 tonë	75	-	-	-	-	-	-
3)	Transport Ujor							
	Transport detar brenda vendit	55	-	-	-	-	-	-
	Transport në liqene brenda vendit	48	-	-	-	-	-	-
	Varka për shetitje	15	-	-	-	-	-	-

Klasifikimi:

Në kategorinë I: Bashkia e Tiranës, Bashkia e Durrësit.

Në kategorinë II: Bashkitë: Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat, Lezhë dhe Kavajë.

Në kategorinë III: Të gjitha bashkitë e tjera.

Në komuna niveli tregues i taksës është 50 për qind e nivelit tregues të tij për çdo kategori të rrethit në të cilin ndodhet komuna.

Shënim: Ambulantë konsiderohen vetëm bizneset pa vend fiks që kanë qarkullim jo më të madh se 2 milionë lekë në vit. Nëse vlerësohet se qarkullimi është më i madh ato klasifikohen në një nga kategoritë e tjera të biznesit dhe taksohen sipas asaj kategorie.

ANEKSI 6

NIVELI TREGUES I TAKSËS SË ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE

Bashkitë		
Zona 1	Zona 2	Zona 3
Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë	Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Vlorë	Të gjitha bashkitë e tjera
Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës	Bashkia Fier, Njësia Administrative Fier	
	Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë	
	Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Pogradec	
	Bashkia Korçë, Njësia Administrative Korçë	
	Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Elbasan	
	Bashkia Berat, Njësia Administrative Berat	
	Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Lushnjë	
	Bashkia Gjirokastrë, Njësia Administrative Gjirokastrë	
Lekë/m² në muaj		
120	90	60

Shënim: Për njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës në njësitë administrative të përcaktuara në tabelë.

TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashki Kat.I	Bashki Kat.II	Bashki Kat.III
I.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	deri në 2 m ²	lekë/m ² /vit	0	0	0
b	mbi 2 m ² deri 10 m ²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	15 000	10 000	7 000
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	20 000	15 000	11 500
	-elektronike	lekë/m ² /vit	35 000	20 000	15 000
c	mbi 10 m ² deri 20 m ²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	12 750	8 500	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	17 000	12 750	9 775
	-elektronike	lekë/m ² /vit	29 750	17 000	12 750
ç	mbi 20 m ² deri 40 m ²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	8 250	5 500	3 850
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	11 000	8 250	6 325
	-elektronike	lekë/m ² /vit	19 250	11 000	8 250
d	mbi 40 m ²				
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	6 000	4 000	2 800
	-me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	8 000	6 000	4 600
	-elektronike	lekë/m ² /vit	14 000	8 000	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim				
	Tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120	120	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		Bashkia Tiranë	Bashkia Durrës dhe gjithë bashkitë e tjera të Kat.II	Bashkitë e Kat.III
	-e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	45 000	22 500	13 500
	-Elektronike	lekë/m ² /vit	90 000	45 000	27 000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /ditë	1 000	1 000	1 000

Shënim: Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I: Tiranë, Durrës

Kategoria II: Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastrë, Lezhë, Krujë.

Kategoria III: Të gjithë bashkitë e tjera

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do t'i shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., një tabelë të thjeshtë 15 m², shuma e taksës vetore do të llogaritet: (10 m² x 15 000 lekë) + (5 m² x 12 750 lekë) = 150 000 + 63 750 = 213 750 lekë në vit (ose 17 812 lekë/muaj). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m², do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në panje jo ballore, në tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

Aneksi 8
TAKSA E FJETJES NË HOTEL

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel	Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë, Kashar, Dajt, Farka	Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Vlorë	Bashkia Ura Vajguore, Njësia Administrative Ura Vajguore
	Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës	Bashkia Fier, Njësia Administrative Fier	Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative Kuçovë
		Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë	Bashkia Skrapar, Njësia Administrative Skrapar,
		Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Pogradec	Bashkia Poliçan, Njësia Administrative Poliçan
		Bashkia Korçë, Njësia Administrative Korçë	Bashkia Dibër, Njësia Administrative Peshkopi
		Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Elbasan	Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Bulqizë
		Bashkia Berat, Njësia Administrative Berat	Bashkia Mat, Njësia Administrative Burrel
		Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Lushnjë	Bashkia Klos, Njësia Administrative Klos
		Bashkia Gjirokastrë, Njësia Administrative Gjirokastrë	Bashkia Durrës, Njësia Administrative Sukth
		Bashkia Shkodër, Njësia Administrative Shkodër	Bashkia Durrës, Njësia Administrative Manzë
		Bashkia Kavajë, Njësia Administrative Kavajë	Bashkia Shijak, Njësia Administrative Shijak
		Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Lezhë	Bashkia Krujë, Njësia Administrative Krujë
			Bashkia Cërrik, Njësia

			Administrative Këlcyrë
			Bashkia Dropull, Njësia Administrative Dropull i Poshtëm
			Bashkia Maliq, Njësia Administrative Maliq
			Bashkia Pustec
			Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Ersekë
			Bashkia Devoll, Njësia Administrative Bilisht
			Bashkia Kukës, Njësia Administrative Kukës
			Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë
			Bashkia Tropojë, Njësia Administrative Bajram Curri
			Bashkia Mirditë, Njësia Administrative Rrëshen
			Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç
			Bashkia Malësi e Madhe, Njësia Administrative Koplik
			Bashkia Vau i Dejës, Njësia Administrative Vau i Dejës
			Bashkia Pukë, Njësia Administrative Pukë
			Bashkia Fushë-Arrëz, Njësia

			Administrative Fushë-Arrëz
			Bashkia Kamzë, Njësia Administrative Kamzë
			Bashkia Vorë, Njësia Administrative Vorë
			Bashkia Rrogozhinë, Njësia Administrative Rrogozhinë
			Bashkia Selenicë, Njësia Administrative Selenicë
			Bashkia Himarë, Njësia Administrative Himarë
			Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë
			Bashkia Konispol, Njësia Administrative Konispol
			Bashkia Finiq, Njësia Administrative Finiq
			Bashkia Delvinë, Njësia Administrative Delvinë
			Bashkia Krujë, Njësia Administrative Krujë
			Bashkia Krujë, Njësia Administrative Fushë- Krujë
			Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç
			Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Mamurras
			Bashkia Kolonjë,

			Njësia Administrative Ersekë Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Leskovik Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë
Lekë për natë fjetje			
Hotelet 4-5 yje	350	175	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	140	70	35

LIGJ
Nr. 68/2017

PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE¹⁶

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt:

- a) përcaktimin e rregullave, të parimeve e procedurave të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore, taksat e ndara, transfertat nga Buxheti i Shtetit, si dhe të ardhurat e tjera të parashikuara me ligj;
- b) përcaktimin e rregullave bazë për madhësinë dhe ndarjen e transfertave të qeverisjes qendrore të njësitë të vetëqeverisjes vendore;
- c) përcaktimin e rregullave për politikat, instrumentet dhe procedurat për menaxhimin e financave publike në nivel vendor;
- c) çështje të tjera të rëndësishme për financimin e funksioneve të vetëqeverisjes vendore.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

- 1. Të sigurojë mënyrën e financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore në përputhje me parimet e autonomisë vendore, të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë, Kartën Europiane për Vetëqeverisjen Vendore dhe ligjin për vetëqeverisjen vendore.
- 2. Të garantojë transparencën dhe parashikueshmërinë e transfertave nga qeverisja qendrore për njësitë të vetëqeverisjes vendore.
- 3. Të sigurojë mjaftueshmërinë e burimeve financiare në dispozicion të njësive të vetëqeverisjes vendore për financimin e funksioneve dhe të kompetencave të tyre.
- 4. Të garantojë autonominë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet së drejtës për të vendosur e mbledhur taksa dhe tarifa vendore.
- 5. Të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial, nëpërmjet përcaktimit të një mekanizmi efektiv për ekualizimin fiskal.
- 6. Të vendosë rregulla që sigurojnë disiplinë fiskale, politika të qëndrueshme dhe transparente për menaxhimin e fondeve publike, përfshirë rregulla për parashikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore.
- 7. Të vendosë rregulla për shpërndarjen e burimeve financiare vendore, në përputhje me prioritetet strategjike dhe nevojat e komuniteteve vendore.

¹⁶Ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 është botuat në Fletoren Zyrtare nr.113, datë 22 maj 2017.

8. Të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore.

9. Të përcaktojë instrumentet dhe procedurat për menaxhimin e financave vendore dhe të rregullojë marrëdhëniet me qeverisjen qendrore në këtë fushë.

10. Të sigurojë konsultimin e vazhdueshëm të qeverisjes qendrore me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet instrumenteve të përcaktuara të konsultimit, duke analizuar mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në ligj.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Baza e taksës” është vlera mbi të cilën zbatohet taksa vendore dhe, për qëllime të këtij ligji, sipas llojit të taksës mund të kuptojë pasurinë, të ardhurat, çmimin ose vlerën e transaksionit.

2. “Buxhet” është tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

3. “Detyrime të konstatuara dhe të papaguara ndaj të tretëve” janë të gjitha llojet e detyrimeve financiare, të cilat nuk janë paguar brenda afateve të përcaktuara në ligj apo në marrëveshjet kontraktore respektive.

4. “Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore” është organi përfaqësues i bashkive dhe qarqeve, i përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji për vetëqeverisjen vendore.

5. “Njësitë e vetëqeverisjes vendore” janë bashkitë dhe qarqet, të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

6. “Programi buxhetor afatmesëm” është parashtrimi për tre vjet i planeve të shpenzimeve të buxhetit vendor, nëpërmjet lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve me veprimtaritë, produktet, objektivat dhe qëllimet e politikës.

7. “Publikim” është bërja publike e vendimeve, raporteve dhe dokumenteve të njësisë së vetëqeverisjes vendore në Buletinin e Njoftimeve Publike, në fagen zyrtare të internetit të njësisë dhe çdo formë tjetër të paraqitjes së informacionit/dokumenteve për publikun.

8. “Taksë ose tatim i ndarë” është një taksë kombëtare ose tatim i përcaktuar sipas ligjit për procedurat tatimore ose ligjeve të veçanta tatimore, të ardhurat respektive prej të cilave ndahen, plotësisht ose pjesërisht, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

9. “Taksë vendore” është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

10. “Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

11. “Të ardhura nga burimet e veta” janë të gjitha të ardhurat që krijohen dhe administrohen në nivel vendor, nën autoritetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas legjislationit në fuqi.

12. “Transfertë e pakushtëzuar” është një transfertë e dhënë nga Buxheti i Shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi.

13. “Transfertë e kushtëzuar” është një transfertë nga Buxheti i Shtetit apo të tretë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që përdoret vetëm për funksionin e deleguar, projekte të veçanta dhe sipas llogarisë ekonomike për të cilin është dhënë ose sipas përcaktimeve të legjislationit apo marrëveshjes.

14. “Transfertë specifike” është një formë e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që përdoret vetëm për funksionin vendor për të cilin është dhënë dhe për rastet specifike të parashikuara në këtë ligj.

Neni 4

Parime të autonomisë fiskale

1. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur, në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi.
2. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për të përfituar transfertë të pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit, e cila ndahet sipas kritereve të përcaktuara në ligj.
3. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për të përfituar nga ndarja e të ardhurave nga taksat kombëtare dhe tatimet, të cilat ndahen sipas kritereve të përcaktuara në ligj.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë në përdorimin e të ardhurave të veta, të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave nga taksat e ndara.
5. Propozimet e qeverisjes qendrore për ndryshime në legjislacion, me efekt pakësimin e nivelit dhe/ose të llojeve të të ardhurave vendore dhe/ose transferimin e funksioneve ose kompetencave në nivel vendor, konsultohen paraprakisht me njësitë e vetëqeverisjes vendore.
6. Në rastet kur ulen apo hiqen taksa ose tarifa vendore nga qeverisja qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen plotësisht, nëpërmjet rritjes së transfertës së pakushtëzuar, taksave të ndara, transferimit në nivel vendor të një takse tjetër kombëtare ose kombinimi i tyre.
7. Funksionet ose kompetencat që u transferohen apo delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe vendosja e një standardi të ri kombëtar për kryerjen e funksioneve ose kompetencave, shoqërohen kurdoherë me mjetet dhe burimet e nevojshme financiare për ushtrimin e tyre.

Neni 5

Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore

Në menaxhimin e financave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe në këto parime:

- a) Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.
- b) Ndryshimet në politikën fiskale vendore të taksave dhe tarifave vendore miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se 30 ditë pas miratimit nga Kuvendi të ndryshimeve në legjislacionin fiskal, me impakt në të ardhurat e vetëqeverisjes vendore. Vendimi i këshillit i njësisë së vetëqeverisjes vendore për detyrimet fiskale vendore publikohet brenda 15 ditëve nga miratimi i tij.
- c) Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë financimin e prioriteteve strategjike të njësisë, në përputhje me politikat sektoriale e ndërsektoriale kombëtare dhe me nevojat e komunitetit, të cilit i shërbejnë.
- ç) Programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.
- d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të ulin nivelin e taksave apo të tarifave vendore në buxhetin e vitit të fundit të mandatit të tyre, me përjashtim të rasteve kur ekziston një plan i detajuar ndër vite, i cili është miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
- dh) Me qëllim përdorimin me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në realizimin e përgjegjësisë të tyre, përfshirë konsultimin dhe koordinimin e prioriteteve strategjike.
- e) Detyrimet tatimore të pambledhura në kohë, prej më shumë se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, nuk përfshihen në parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në projektbuxhetin për vitin buxhetor pasardhës. Përdorimi i të ardhurave shtesë nga mbledhja e detyrimeve tatimore të pambledhura në kohë i nënshtrohet procesit të rishikimit të buxhetit vjetor, sipas përcaktimeve të nenit 46 të këtij ligji.

KREU II

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE NË MENAXHIMIN E FINANCAVE VENDORE

Neni 6

Kompetencat e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton:

- a) drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme publike në fushën e financave të njësisë;
- b) prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore;
- c) rishikon politikat fiskale vendore, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- ç) programin buxhetor afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- d) buxhetin vjetor të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- dh) huamarrjen vendore dhe marrjen e masave për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 7

Kompetencat e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozon këshillit të njësisë prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë, politikën fiskale vendore, programin buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetin vjetor, huamarrjen vendore, si dhe rregulla, procedura ose masa të nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Kryetari është përgjegjës për zbatimin e akteve të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe raporton në këshillin e njësisë, sipas përcaktimeve ligjore, të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli.

3. Kryetari i njësisë, si rregull, është nëpunës autorizues për menaxhimin e financave publike vendore. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore mund ta delegojë këtë kompetencë, me shkrim, te zëvendëskryetari ose te një nga zëvendëskryetarët e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 8

Kompetencat e Ministrit të Financave

1. Ministri i Financave është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e rregullave, të standardeve e procedurave për menaxhimin financiar në nivel vendor.

2. Ministri i Financave monitoron, periodikisht, zbatimin dhe përputhshmërinë e veprimtarisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyr në rastet e përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore në fuqi.

Neni 9

Këshilli Konsultativ i Vetëqeverisjes Vendore me Qeverisjen Qendrore

1. Këshilli Konsultativ i Vetëqeverisjes Vendore me Qeverisjen Qendrore, i krijuar sipas nenit 12, të legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, është forumi kryesor në të cilin qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Objekt i konsultimit ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore janë edhe funksionet dhe/ose kompetencat e deleguara pushtetit vendor, transferimi i funksioneve ose kompetencave të reja dhe propozimet e politikave për çështje që prekin interesat e pushtetit vendor, në përputhje me legjislacionin përkatës.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen gjatë vitit kalendarik për financat e tyre, mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e burimeve të tyre për arritjen e qëllimeve dhe kryerjen e shërbimeve të përcaktuara për to në ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe ligjet e tjera në fuqi.

KREU III

TË ARDHURAT E VETA TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 10

Financimi i njësive të vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 11

Të ardhurat nga taksat vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të administrojnë taksat vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Llojet e taksave vendore janë si më poshtë:
 - a) taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
 - b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
 - c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;
 - ç) taksa e tabelës;
 - d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
 - dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
 - e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
 - ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Neni 12

Rregulla të përbashkëta për taksat vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë, mbajnë dhe përditësojnë Regjistrin e Personave Fizikë e Juridikë që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish. Forma dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave. Të dhëna statistikore mbi këtë regjistër i dërgohen Ministrisë së Financave të paktën një herë në vit.

2. Baza e taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, çdo përjashtim apo ulje, afati i pagesave, si dhe gjobat e kamatëvonesat e aplikueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, botohen dhe bëhen të njohura publikisht.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të hyjnë në marrëveshje me njëra-tjetrën apo me agjentë tatimore për mbledhjen e të ardhurave vendore me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas një procedure transparente dhe konkurruese.

4. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja, kryesisht, përdoren për financimin e investimeve publike vendore.

5. Për taksën e pasurisë së paluajtshme, këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë plus 30 për qind dhe minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

Neni 13

Rregulla për vendosjen e taksave të përkohshme vendore

1. Këshilli njësisë së vetëqeverisjes vendore ka të drejtë të vendosë taksë të përkohshme për ofrimin e shërbimeve dhe të investimeve publike specifike, për një periudhë të caktuar kohore.
2. Vendosja e taksës së përkohshme paraprihet nga hartimi i planit, që përmban, të paktën:
 - a) përcaktimin e shërbimit apo investimit specifik që financohet nga taksa e përkohshme;
 - b) kohëzgjatjen e taksës së përkohshme, e cila nuk mund të zbatohet për më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi, dhe shumën totale e vjetore të të ardhurave që pritet të mblidhen;
 - c) koston dhe afatet e kryerjes së shërbimit e investimit, përfshirë pjesën që financohet nga taksa e përkohshme dhe nga burime të tjera, përfshirë edhe pjesën e financimit nga buxheti i bashkisë.
3. Ky plan i paraqitet komunitetit vendor në, të paktën, tre konsultime publike, të kryera në një periudhë jo më pak se pesë muaj.
4. Pas këtyre dëgjësive publike, plani miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.
5. Taksa të përkohshme mund të vendosen edhe për qëllime që i shërbejnë vetëm disa zonave të caktuara të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
6. Baza e llogaritjes së taksës së përkohshme për çdo tatimpagues është vlera e taksës së pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesit në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
7. Niveli i taksës së përkohshme nuk mund të jetë më i lartë se 35 për qind e bazës së taksës, sikurse përcaktuar në pikën 6 të këtij neni.
8. Të ardhurat nga taksa e përkohshme mund të shpenzohen vetëm për qëllimet e përcaktuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore që miraton taksën dhe nuk mund të konsiderohen si të ardhura korrente në llogaritjen e kufijve të borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të aplikojnë me shumë se dy taksa të përkohshme gjatë një viti buxhetor.

Neni 14

Tarifa vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.
2. Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e koston të shërbimit publik të ofruar nga njësi e vetëqeverisjes vendore.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit apo përfituesit, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë.
4. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në ligje të veçanta, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton nivelet e tarifave vendore.
5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë të ardhura nga këto tarifa vendore:
 - a) tarifa për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave;
 - b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;
 - c) tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet;
 - c) tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit;
 - d) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie e licencave, lejeve e autorizimeve;
 - dh) tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara në ligj;
 - e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore;
 - ë) tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj.

Neni 15

Tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave si më poshtë:

- a) për zënien e hapësirës në zonat publike ose para mjediseve të biznesit, për qëllime biznesi, përfshirë këtu tavolinat jashtë për bare dhe restorante;
- b) për përdorimin e tabelave të reklamave;
- c) për zënien e hapësirave të parkimit për mjetet motorike;
- ç) për zënien e sipërfaqeve për kamping, ngritje tendash dhe mjeteve të tjera për përdorim të përkohshëm;
- d) për zënien e brigjeve ujore për biznes dhe qëllime të tjera;
- dh) për mbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve e të mjeteve të lundrimit dhe objekteve të tjera në det, lumenj ose liqene;
- e) për mbajtjen dhe përdorimin e barkave e të platformave pluskuese, përjashtuar këtu barkat që përdoren nga organizatat e angazhuara në mirëmbajtjen dhe shënjimin e rrugëve ujore;
- ë) për restorante dhe mjedise të tjera ushqimi dhe argëtimi pranë detit, lumenjve ose liqeneve;
- f) për zënien e hapësirës publike për rulotë dhe trajlerë, përveç automjeteve bujqësore dhe makinerive bujqësore;
- g) për zënien e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit;
- gj) tarifa të tjera, që mund të vendosen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Në vendosjen e këtyre e tarifave, si rregull, ndiqen këto parime dhe kritere:

- a) vendndodhja (zona) ku ushtrohet veprimtaria, për të cilën vendoset tarifa;
- b) karakteristika të tjera objektive dalluese të personave fizikë ose juridikë që zënë hapësirën publike.

3. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton, me vendim, nivelin e tarifave vendore, zonat dhe përdoruesit, përfshirë përjashtimet e lehtësimet, afatet dhe metodat e pagesës së tarifave.

Neni 16

Tarifa për shërbime administrative

Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për lëshimin e dokumenteve zyrtare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nëse niveli i këtyre tarifave nuk përcaktohet në ligje të tjera, këto tarifa mbulojnë kostot aktuale të shërbimit për të cilin bëhet pagesa e tarifës.

Neni 17

Tarifa të tjera

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë, i matshëm dhe i atribuueshëm për aktivitetin në fjalë.

Neni 18

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve të tjera publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore propozojnë ose miratojnë, sipas legjislacionit në fuqi, tarifa për mbledhjen dhe heqjen e mbetjeve, si dhe për furnizimin me ujë dhe kanalizimet.

2. Niveli i tarifave të shërbimeve publike, si rregull, synon mbulimin e kostos dhe është në përpjesëtim të drejtë me konsumin nga individët, personat fizikë ose juridikë.

3. Rregullat për përcaktimin e nivelit të tarifave të shërbimeve publike përcaktohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi. Autoritetet e qeverisjes qendrore, përgjegjëse për politikën kombëtare të këtyre funksioneve, mund të rekomandojnë metodologji kombëtare për caktimin e nivelit të tarifave për këto shërbime.

Neni 19

Të ardhurat nga asetet dhe veprimtaritë ekonomike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi ose në përdorim të tyre, sipas legjislacionit në fuqi. Të ardhurat nga qiraja konsiderohen të ardhura korrente dhe mund të përdoren për çdo shpenzim të autorizuar në buxhet.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë të ardhura nga shitja e pronave të veta, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të ardhurat nga shitja e aseteve në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, me jetëgjatësi më të madhe se një vit, konsiderohen si të ardhura kapitale dhe përdoren për qëllime investimi.

4. Të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe dividendi që i përket njësisë së vetëqeverisjes vendore në shoqëritë tregtare fitimprurëse, përveç atyre të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, kalojnë në buxhetin e përgjithshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

5. Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në çdo rast, i nënshtrohet një procedure transparente dhe konkurruese. Asetet dhe pronat e ofruara për shitje ose dhënie me qira duhet të publikohen, së bashku me kriteret që duhet të plotësohen, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Të ardhurat nga donacionet

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organet e tyre kanë të drejtë të pranojnë donacione, të cilat regjistrohen në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Donacionet e pranuar nga institucionet dhe ndërmarrjet në varësi apo në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të raportohen te kjo e fundit, në çastin që ato merren.

3. Donacionet në të mira materiale regjistrohen si asete të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. Të ardhurat nga donacionet nuk konsiderohen si të ardhura operative për qëllim të llogaritjes së kufirit të borxhit të qeverisë vendore.

5. Donacionet e përfituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhen kurdoherë publike, përfshirë emrin e donatorit, shumën dhe qëllimin e donacionit.

Neni 21

Burimet e financimit të qarkut

1. Qarku krijon të ardhura nga burimet e veta vendore dhe të ardhura që rrjedhin nga burime kombëtare.

2. Të ardhurat nga burimet e veta vendore dhe kombëtare përbëhen nga:

a) transfertat e pakushtëzuara nga Buxheti i Shtetit;

b) transfertat e kushtëzuara për kryerjen e funksioneve dhe të kompetencave të deleguara përkatëse nga bashkitë përbërëse;

c) taksa të vendosura në nivel qarku, të përcaktuara në përputhje me ligjin;

c) tarifat për shërbimet publike të kryera nga qarku.

3. Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak.

4. Kriteret dhe rregullat për krijimin dhe administrimin e të ardhurave nga burimet e veta vendore janë të njëjta me ato të përcaktuara për të ardhurat nga burimet vendore të bashkive.

5. Të ardhurat e qarkut nga ndarja e të ardhurave kombëtare krijohen dhe administrohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj dhe në ligje të tjera në fuqi.

KREU IV

TRANSFERTAT NGA BUXHETI I SHTETIT DHE TRANSFERTA TË TJERA

Neni 22

Llojet e transfertave nga Buxheti i Shtetit

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga qeverisja qendrore transferta të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara dhe një pjesë nga të ardhurat nga taksat kombëtare.

2. Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga tatimet dhe taksat e ndara përdoren në autonomi të plotë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Transferta e kushtëzuar përdoret për qëllimin dhe në mënyrën e përcaktuar nga organi që jep transfertën.

Neni 23

Transferta e pakushtëzuar

1. Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit u jepet njërive të vetëqeverisjes vendore për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

2. Shuma totale vjetore e fondeve për t'u ndarë ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, në një vit të dhënë buxhetor, është jo më pak se 1 për qind e produktit të brendshëm bruto, të parashikuar në raportin për vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike të miratuar nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Në çdo rast, transferta e pakushtëzuar nuk mund të jetë më e vogël se shumta totale e ndarë në vitin e mëparshëm buxhetor.

4. Shuma totale e transfertës së pakushtëzuar, pas përfundimit të periudhës tranzitore të transferimit të funksioneve të reja në nivel vendor, rritet me madhësinë e transfertave specifike që vendoset të përfshihen brenda transfertës së pakushtëzuar. Përfshirja e fondeve për funksione të decentralizuara rishtazi në transfertën e pakushtëzuar, kur është e nevojshme, shoqërohet me ndryshimin e formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, për të siguruar një financim të përshtatshëm dhe për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

Neni 24

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore

1. Transferta e pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore ndahet sipas formulës që i bashkëlidhet si aneks ligjit të buxhetit vjetor. Transferta e pakushtëzuar ndahet ndërmjet bashkive dhe qarqeve.

2. Në ndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë, formula ndjek, por nuk kufizohet në kriteret e mëposhtme:

a) popullsia rezidente, e cila është produkt i Census-it më të fundit, të korrigjuar me popullsinë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas një koeficienti të publikuar në anekset e ligjit të buxhetit vjetor. Sipas këtij kriteri shpërndahen deri në 80 për qind e transfertës për bashkitë;

b) dendësia e popullsisë, që reflekton diferencat në kostot e ofrimit të shërbimeve ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore. Sipas këtij kriteri shpërndahen deri në 15 për qind e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë;

c) numri i nxënësve në arsimin parauniversitar. Sipas këtij kriteri shpërndahen jo më pak se 5 për qind të transfertës së pakushtëzuar për bashkitë.

3. Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar siguron ekualizimin fiskal ndërmjet bashkive. Ekualizimi fiskal bazohet në:

a) “kapacitetin fiskal” të çdo bashkie, i cili, në kuptim të këtij ligji dhe në funksion të llogaritjes së transfertës së pakushtëzuar, llogaritet si totali i të ardhurave faktike të çdo njësie nga taksat e ndara, të mbledhura në vitin buxhetor paraardhës;

b) “pragun e ekualizimit”, i cili, në kuptim të këtij ligji, llogaritet si raporti i të ardhurave për frymë nga taksat e ndara të bashkisë me mesataren kombëtare të të ardhurave për frymë të po këtyre taksave, mbi apo nën të cilin ajo përfiton/kontribuon nga fondi i ekualizimit i transfertës së pakushtëzuar, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në ligjin për buxhetin vjetor;

c) “koeficientin e ekualizimit”, i cili, në kuptim të këtij ligji, llogaritet si masa me të cilën bashkitë me të ardhura për frymë nga taksat e ndara mbi apo nën pragun e ekualizimit do të japin apo do të marrin fonde ekualizuese, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në ligjin vjetor të buxhetit;

c) “fondin e kompensimit”, i cili, në kuptim të këtij ligji, është fondi i nevojshëm për të siguruar ekualizimin fiskal ndërmjet bashkive dhe llogaritet si shuma e fondeve të nevojshme për të siguruar që të gjitha bashkitë të arrijnë në pragun e ekualizimit të zgjedhur. Ky fond krijohet nga kontributet që japin bashkitë me të ardhura nga taksat e ndara mbi pragun e ekualizimit të përzgjedhur.

4. Bashkitë me kapacitet fiskal nën pragun e ekualizimit kompensohen sipas koeficientit të ekualizimit dhe fondit të kompensimit të krijuar nga kontributi i njësive me kapacitet fiskal mbi pragun.

5. Në ndarjen e transfertës së pakushtëzuar për qarqet, formula ndjek, por nuk kufizohet në kriteret e mëposhtme:

a) shuma fikse, sipas së cilës ndahet 20 për qind e transfertës së dedikuar për qarqet;

b) popullsia residente, e cila është produkt i Census-it më të fundit, të korrigjuar me popullsinë, sipas Regjistrit të Gjendjes Civile. Sipas këtij kriteri shpërndahen deri në 50 për qind e totalit të transfertës së dedikuar për qarqet;

c) dendësia e popullsisë. Sipas këtij kriteri shpërndahen deri në 30 për qind e totalit të transfertës së dedikuar për qarqet.

6. Në ligjin për buxhetin vjetor, në një aneks të veçantë të tij përfshihen:

a) parashikime trevjeçare të të ardhurave nga taksat e ndara për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) parashikime trevjeçare të fondeve nga transfertat e pakushtëzuara, transfertat specifike dhe transfertat për funksionet e deleguara për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c) kriteret që përdoren për të përcaktuar këto transfertat.

Neni 25

Të ardhurat nga taksat e ndara

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni.

2. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;

b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;

c) 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;

c) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

4. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe

taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

Neni 26

Transfertat për funksione ose kompetenca të reja të njësitë e vetëqeverisjes vendore

Çdo transferim i funksioneve ose kompetencave të reja të njësitë e vetëqeverisjes vendore shoqërohet me rritjen e burimeve të financimit në përpjesëtim me kostot e ushtrimit të tyre, sipas këtyre kriterëve:

a) njësia e qeverisjes qendrore, përgjegjëse për funksionin/kompetencën që transferohet, përllogarit shpenzimet e përgjithshme vjetore për to për tre vitet e fundit, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore;

b) njësia e qeverisjes qendrore, përgjegjëse për funksionin/kompetencën që transferohet, përgatit një raport për standardin e ofrimit të shërbimit dhe nivelin aktual të shpërndarjes së shërbimit, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë një vlerësim të kostove shtesë për shpërndarjen e shërbimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;

c) raportet, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, janë subjekt i konsultimit me Ministrinë e Financave dhe Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje dhe plani për rritjen e transfertës së pakushtëzuar dhe trajtimin e çështjeve ligjore e financiare për rritjen e aksesueshmërisë së shërbimit.

Neni 27

Transferta të kushtëzuara

1. Transferta e kushtëzuar jepet për:

a) funksione të deleguara njësive të vetëqeverisjes vendore;

b) projekte të veçanta, të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar, ku kërkohet bashkëpunimi me vetëqeverisjen vendore.

2. Njësia e qeverisjes qendrore, propozuese për transferimin e funksionit dhe të transfertës së kushtëzuar përkatëse, konsultohet paraprakisht në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

3. Fondet vjetore që shpërndahen në formën e transfertave të kushtëzuara, të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të jenë të planifikuara paraprakisht në programin buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes qendrore përkatëse. Kriteret dhe procedurat për shpërndarjen e këtyre fondeve përcaktohen me ligjin për buxhetin vjetor.

4. Njësitë e qeverisjes qendrore, përgjegjëse për akordimin e transfertave të kushtëzuara, publikojnë një aneks të veçantë, si pjesë e projektbuxhetit vjetor, programit buxhetor afatmesëm dhe raportit të zbatimit të buxhetit të tyre, në të cilin përfshihet një listë e plotë e transfertave të kushtëzuara, qëllimi, përfituesi, vlera totale, shuma e lëvruar dhe pjesa e mbetur për t’u financuar në vitet në vijim për njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në përfundimin e projekteve.

Neni 28

Transfertat specifike

1. Transfertat specifike financojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për:

a) financimin e funksioneve të reja të transferuara të njësitë e vetëqeverisjes vendore, për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme ekuivalente dhe të qëndrueshme financimi;

b) financimin e shërbimeve në raste të emergjencave apo situatave të ngjashme me interes kombëtar, ku kërkohet bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë për të vendosur për shpenzimet brenda funksionit, sipas transfertës specifike të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Transferta specifike vjetore, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore është, të paktën, sa mesatarja vjetore e shpenzimeve totale që qeverisja qendrore ka kryer për të njëjtin funksion në tre vitet e fundit para transferimit të funksionit në secilën nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura.

4. Njësitë e qeverisjes qendrore, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, janë përgjegjëse për monitorimin e përdorimit të fondeve të dhëna për njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertave specifike.

5. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore në fund të vitit buxhetor rezulton me fonde të papërdorura nga transferata specifike për funksionin për të cilin janë dhënë këto fonde, ato trashëgohen për të njëjtin funksion në vitin pasardhës buxhetor.

Neni 29

Transfertat dhe ndihmat nga njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore

Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të marrë dhe të japë transferata monetare ose ndihma me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore për ofrimin e të mirave dhe/ose shërbimeve, sipas marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet tyre.

Neni 30

Transfertat dhe ndihmat ndërkombëtare

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të marrë transferata monetare dhe/ose ndihma nga një qeveri e huaj ose organizatë ndërkombëtare sipas marrëveshjes së veçantë të nënshkruar ndërmjet tyre. Kushtet bazë të një marrëveshjeje të tillë i raportohen Ministrisë së Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes.

2. Për organizimin e aktiviteteve të ndryshme ndërkombëtare, për raste emergjencash civile ose raste fatkeqësish natyrore, njësia e vetëqeverisjes vendore mund të japë transferata monetare dhe/ose ndihma për njësitë vendore të shteteve të tjera. Këto transferata dhe/ose ndihma miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

KREU V

HUAMARRJA VENDORE

Neni 31

E drejta e huamarrjes së njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin hua afatshkurtër dhe hua afatgjatë, në përputhje me përcaktimet në ligjet që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, huamarrjen vendore dhe menaxhimin e sistemit buxhetor.

2. Ministria e Financave mund të kërkojë auditimin e jashtëm, të pavarur, për llogaritë e njësisë së vetëqeverisjes vendore para miratimit të huas afatgjatë vendore.

KREU VI

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Neni 32

Plani Strategjik i Zhvillimit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës për përgatitjen e planit strategjik të zhvillimit të njësisë përkatëse, i cili miratohet me vendim nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Plani Strategjik i Zhvillimit:

a) përmban politikat për zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shtrihet në një afat kohor jo më pak se 5 vite;

b) merr në konsideratë nevojën dhe potencialet e zhvillimit vendor si dhe prioritetet rajonale e kombëtare të zhvillimit strategjik. Ky plan paraqet synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikon veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse;

c) zbatohet nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësisë.

3. Kostot e përlogaritura në planin strategjik të zhvillimit mbështeten në parashikime realiste të burimeve të financimit për të njëjtën periudhë.

4. Para miratimit në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, projekti i planit strategjik të zhvillimit konsultohet me njësinë përkatëse të koordinimit të strategjive në qeverisjen qendrore, Ministrinë e Financave, komunitetin vendor dhe grupet e interesit, si dhe me njësi të tjera, me të cilat kufizohet territori i saj.

KREU VII PËRGATITJA, SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I BUXHETIT

Neni 33

Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.

2. Kalendari miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore jo më vonë se data 31 dhjetor dhe hyn në fuqi në ditën e parë të çdo viti buxhetor.

3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor tek të gjitha njësitë shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 34

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve

1. Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

- a) dy vitet para vitit buxhetor;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

2. Në këtë raport përfshihen:

- a) metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave;
- b) analiza të efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese;
- c) analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.

3. Në përgatitjen e këtij raporti, njësia e vetëqeverisjes vendore mbështetet në udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave.

4. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo më vonë se data 1 mars.

5. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.

6. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm jo më vonë se data 15 mars.

Udhëzimi për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.

2. Udhëzimi i përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përmban:

- a) përcaktimin e programeve buxhetore dhe të ekipeve të menaxhimit të programeve përkatëse;
- b) tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme;
- c) afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.

Programi buxhetor afatmesëm vendor

1. Qëllimi i programit buxhetor afatmesëm vendor është të bëjë të zbatueshëm planin strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të financave vendore dhe shërbimeve për një periudhë trevjeçare.

2. Programi buxhetor afatmesëm i njësisë së vetëqeverisjes vendore pasqyron mënyrën e krijimit dhe të shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme të saj, në përputhje me rregullat dhe afatet e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë menaxhimin e sistemit buxhetor. Programi buxhetor afatmesëm vendor miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, me propozimin e kryetarit të njësisë.

3. Programi buxhetor afatmesëm vendor përdor klasifikimet buxhetore, të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Programi buxhetor afatmesëm vendor përfshin informacionin për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore për:

- a) secilën kategori të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b) shpenzimet sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik për çdo program buxhetor;
- c) qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse. Të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore;
- ç) vlerësimin e kostove të politikave aktuale dhe atyre të reja, të planifikuara për financim nëpërmjet shpenzimeve buxhetore vendore vjetore dhe afatmesme;
- d) informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara nga çdo program buxhetor dhe niveli i përmbushjes së tyre.

5. Brenda datës 1 qershor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i dërgon Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm.

6. Ministria e Financave analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe ia dërgon, zyrtarisht, këtyre të fundit brenda datës 20 qershor.

7. Projekti paraqitet në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë dhe shoqërohet me mendimin zyrtar të Ministrisë së Financave.

8. Brenda datës 30 qershor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm, duke shprehur edhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave.

9. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik.

10. Procedura të tjera më të hollësishme për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 37

Udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.

2. Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tavanëve të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.

3. Udhëzimi plotësues i përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përmban:

- a) tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi për secilin nga tre vitet e ardhshme;
- b) afatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.

Neni 38

Programi buxhetor afatmesëm i rishikuar

1. Pas marrjes së udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nis menjëherë punën për përgatitjen e projektit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm.

2. Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit. Procesverbalet e takimeve, së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, bëhen pjesë e dokumentit të projektit të programit buxhetor afatmesëm.

3. Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë.

4. Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor.

Neni 39

Programi buxhetor afatmesëm përfundimtar

1. Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga Ministria e Financave dhe bashkërendimit me projektbuxhetin vjetor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit projektin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim e miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, së bashku me projektbuxhetin vjetor, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në një aneks të veçantë të projektit të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar, paraqet mendimet e Ministrisë së Financave dhe vlerësimin e tij për marrjen në konsideratë të tyre.

2. Projekti i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor.

3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për të publikuar dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre, jo më vonë se data 31 dhjetor.

Neni 40
Buxheti vjetor

1. Pas miratimit të projektit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit projektbuxhetin vjetor.

2. Projektbuxheti vjetor përbën vitin e parë të programit buxhetor afatmesëm.

3. Projektbuxheti vjetor përfshin dokumentacionin bazë dhe dokumentacionin shoqërues si më poshtë:

Dokumentacioni bazë:

a) fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitin e ardhshëm, të ndara në korrente dhe kapitale;

b) tavanet për çdo program, për vitin e dytë dhe të tretë të programit buxhetor afatmesëm;

c) një tabelë përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme;

c) numrin e punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për vitin e ardhshëm;

d) përputhshmërinë me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

Dokumentacioni shoqërues:

a) informacion të detajuar për shpenzimet, sipas klasifikimeve buxhetore;

b) listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, e cila përmban:

i) koston e plotë të projekteve;

ii) vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës;

iii) vlerën e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor;

iv) vlerën e mbetur për t'u financuar në vitet pasardhëse buxhetore;

v) burimet e financimit;

c) llogaritjen e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore, si pjesë e paketës fiskale të parashikuara në këtë buxhet vjetor;

c) listën e njësive shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

d) objektivat kryesorë të programeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

dh) informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe një analizë të elementeve të riskut, të cilat karakterizojnë këtë borxh;

e) risqet fiskale dhe masat mbrojtëse, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të Ministrit të Financave;

ë) detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës;

f) listën e plotë të projekteve koncesionare /partneriteteve publike private në vazhdim, vlerën totale të kontraktuar të investimit dhe implikimet buxhetore për çdo projekt, sipas legjislacionit në fuqi;

g) një përmbledhje të të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë;

gj) projektin e parë të planit të arkës së projektbuxhetit, të paraqitur për miratim;

h) sipas rastit, një përmbledhje të pagesave të vonuara ndaj palëve të treta, përfshirë edhe origjinën e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre.

Neni 41
Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratim në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor.

2. Çdo anëtar i këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga kryetari. Këto ndryshime duhet të jenë në përputhje me parimet dhe rregullat e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji.

3. Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor, miraton projektbuxhetin sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji.

4. Në rastin kur buxheti nuk miratohet brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, prefekti i kërkon kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore thirrjen e një mbledhjeje të dytë të këshillit, e cila duhet të mbahet jo më vonë se data 5 janar e vitit pasardhës. Nëse edhe në këtë rast këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk arrin të miratojë buxhetin, Këshilli i Ministrave vendos shpërndarjen para kohe të tij.

5. Në rast të mosmiratimit të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 4, të këtij neni, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore zbaton procedurat për buxhetin e përkohshëm vendor, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për të publikuar buxhetin vjetor, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tij, në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore jo më vonë se 15 ditë pas miratimit nga këshillat e njësive përkatëse. Një kopje e buxhetit vjetor vendor dërgohet në Ministrinë e Financave jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tij.

KREU VIII ZBATIMI I BUXHETIT

Neni 42

Administrimi i mjeteve monetare

1. Të ardhurat e miratuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për buxhetin vjetor përbëjnë kufirin minimal për t’u arkëtuar gjatë vitit buxhetor.

2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.

3. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara në sistemin e thesarit në emër të njësisë së vetëqeverisjes vendore transferohen me bazë ditore në llogarinë unike të thesarit pranë Bankës së Shqipërisë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga sistemi i thesarit informacion bankar ditor dhe raport mujor për të gjitha të ardhurat e mbledhura, sipas klasifikimit buxhetor në fuqi.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësime sistematike për të identifikuar risqet dhe marrin masa për të shmangur evazionin fiskal.

5. Niveli, kohëzgjatja dhe struktura e detyrimeve tatimore të evidentuara e të paarkëtuara në kohë evidentohehen dhe raportohen si pjesë e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Neni 43

Detajimi i fondeve buxhetore vendore

1. Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore të buxhetit vjetor, nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore detajon fondet buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese dhe ua dërgon zyrtarisht njësive shpenzuese.

2. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për të realizuar detajimin e fondeve buxhetore në sistemin informatik financiar të qeverisjes qendrore.

Neni 44

Kontrolli i shpenzimeve

1. Pas miratimit të buxhetit vjetor, njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatisin planin e arkës për zbatimin e buxhetit vjetor, sipas përcaktimeve të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore përgatit planin vjetor të prokurimit për të gjitha projektet e reja dhe ato në vazhdim dhe e dërgon atë pranë strukturës përgjegjëse për thesarin, në fillim të vitit buxhetor. Sistemi i thesarit verifikon nëse plani i prokurimit është në përputhje me buxhetin e miratuar. Planin e prokurimit, i konfirmuar nga sistemi i thesarit, dërgohet në Agjencinë e Prokurimit Publik.

3. Për kryerjen e pagesave, njësia e vetëqeverisjes vendore, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së faturës origjinale të operatorit ekonomik, paraqet kërkesën për pagesa në sistemin e thesarit, së bashku me dokumentet shoqëruese justifikuese të shpenzimit, sipas përcaktimit në procedurat e thesarit. Kërkesat për prokurim nënshkruhen nga titullari i autoritetit kontraktor të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Thesari autorizon pagesën nëpërmjet sistemit informatik financiar të Qeverisë.

4. Pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit, çdo muaj, raport të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës. Ky raport përmban të dhënat faktike të regjistruara në vitet e mëparshme për të njëjtët tregues dhe vlerësimin për pritshmëritë për nivelin e realizimit deri në fund të vitit buxhetor. Raporti i dërgohet për informim këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës dhe bëhet publik.

Neni 45

Rishpërndarja e fondeve buxhetore

Rishpërndarjet e fondeve të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore kryhet në përputhje me parashikimet e nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 46

Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo më vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji.

Neni 47

Menaxhimi i likuiditetit dhe kontrolli i angazhimeve

1. Angazhimet buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore kufizohen në disponue-shmërinë e parashikuar të mjeteve monetare dhe në shpërndarjet e miratuara buxhetore.

2. Njësive të vetëqeverisjes vendore u jepet informacion për kufijtë e angazhimit të tyre, të paktën një herë në muaj, nga struktura përgjegjëse e thesarit në degë.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të zbatojnë angazhimet sipas renditjes së regjistrimit të tyre në sistemin informatik financiar të qeverisjes qendrore. Në rast se njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin angazhime buxhetore disavejçare, ato regjistrojnë angazhimet kundrejt planit vjetor për tre vite në vijim dhe, nëse angazhimi buxhetor është më i gjatë, mbetja regjistrohet në janar të vitit të katërt në sistemin informatik financiar të Qeverisë.

KREU IX MONITORIMI, MBIKËQYRJA DHE AUDITIMI I JASHTËM

Neni 48

Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor

1. Nëpunësit autorizues të njësive të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrit të Financave për monitorimin e zbatimit të buxhetit.

2. Monitorimi i zbatimit të planeve strategjike të zhvillimit kryhet nëpërmjet monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor.

3. Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit publikohen nga nëpunësi autorizues në faqen zyrtare të njësisë përkatëse, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit, dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave.

4. Për raportimet e ndërmjetme, kur nga ana e Ministrisë së Financave vërehet problematikë serioze në zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, Ministri i Financave përgatit një raport me komente e rekomandime dhe ia dërgon kryetarit dhe këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

5. Brenda 30 ditëve pas dërgimit të raportit vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, Ministria e Financave përgatit raport me komente dhe rekomandime për të. Një kopje e këtij raporti i dërgohet kryetarit dhe këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

6. Me kërkesë të këshillit, nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore raporton gjatë vitit edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.

Neni 49

Auditimi i brendshëm

1. Në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet njësia e auditimit të brendshëm, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm.

2. Njësia e auditimit të brendshëm kryen veprimtarinë e saj, bazuar në planin strategjik dhe vjetor të auditimit. Raportet finale të auditimit i dërgohen palës së audituar si dhe kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

3. Njësia e auditimit të brendshëm e njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave raportin vjetor të veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për auditimin e brendshëm.

Neni 50

Auditimi i jashtëm

1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.

2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë.

3. Ministri i Financave dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit përcaktojnë me udhëzim të përbashkët rastet kur auditimi realizohet nga auditues të tjerë ligjorë, si dhe procedurat, afatet dhe standardet e auditimit të jashtëm nga këta auditues.

4. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore e dërgon raportin e auditimit të jashtëm në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore si pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit vendor. Një kopje e këtij raporti i dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Financave.

5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.

Neni 51

Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet pranë këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës buxhetor, raport për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit vjetor të vitit paraardhës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për çdo njësi shpenzuese të saj.

2. Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor duhet të jetë i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor.

3. Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor përfshin, por nuk kufizohet në:

a) raportin e performancës vjetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila bazohet në raportin e monitorimit vjetor të buxhetit;

b) pasqyrat financiare vjetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, dokumentacionin bazë dhe atë shoqërues, sipas përcaktimit në nenin 40 të këtij ligji;

c) raportin e auditimit të jashtëm.

4. Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda muajit qershor të vitit buxhetor pasardhës. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe një kopje i dërgohet Ministrisë së Financave, jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të tij.

KREU X

KONTABILITETI DHE RAPORTIMI

Neni 52

Kontabiliteti

1. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet për funksionimin dhe zbatimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Procedurat dhe rregullat për menaxhimin e aktiveve miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi. Informacioni në lidhje me transferimin dhe asgjësimin e aktiveve të trupëzuara bëhet pjesë e dokumentit të buxhetit dhe e raportit vjetor.

3. Procedurat standarde për ruajtjen, arkivimin dhe asgjësimin e dokumenteve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore bëhen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 53

Pasqyrat financiare dhe konsolidimi

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit çdo vit pasqyrat financiare të konsoliduara, sipas përcaktimeve dhe afateve të specifikuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.

2. Pasqyrat financiare të institucioneve ose njësive shpenzuese, në varësinë apo pronësinë e plotë ose të pjesshme të njësisë së vetëqeverisjes vendore, konsolidohen ose gjendja e tyre financiare paraqitet në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit vendor, përpjesëtimisht me pjesën takuese.

Neni 54

Raportimi financiar

1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore publikon treguesit financiarë në një aneks të veçantë të projektbuxhetit vjetor dhe raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit.
2. Treguesit financiarë që publikohen përfshijnë, por nuk kufizohen në raportin e:
 - a) shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme;
 - b) të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme;
 - c) të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme;
 - ç) të ardhurave faktike të mbledhura, kundrejt planit të periudhës dhe planit vjetor të të ardhurave nga dy kategoritë kryesore të taksapaguesve, personave fizikë e juridikë (familjarë dhe subjekteve juridike);
 - d) shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme;
 - dh) shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme;
 - e) huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të përgjithshme;
 - ë) huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta;
 - f) detyrimeve financiare të papaguara në kohë ndaj të tretëve ndaj të ardhurave të përgjithshme;
 - g) detyrimeve tatimore të paarkëtuara në kohë ndaj të ardhurave tatimore;
 - gj) shpenzimeve për partneritetet publike private ndaj shpenzimeve të përgjithshme;
 - h) shpenzimeve për politikat e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme;
 - i) shpenzimeve për politikat që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme.

KREU XI

VËSHITRËSITË FINANCIARE DHE MASAT PËR ZGJIDHJEN E TYRE

Neni 55

Probleme financiare

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet me probleme financiare kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë 15 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
2. Nëse në muajin pasues totali në vlerë i detyrimeve financiare të konstatuara dhe të papaguara tejkalon nivelin prej 20 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton këshillin e njësisë për arsyet e situatës së krijuar dhe propozon masat përkatëse për daljen nga situata e problemeve financiare.

Neni 56

Vështirësia financiare

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi financiare kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 55, të këtij ligji, dhe vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta rritet progresivisht mbi nivelin prej 25 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara.
2. Brenda 20 ditëve nga konstatimi, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe ia dërgon këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këshilli shqyrton dhe miraton planin brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Një kopje e planit të miratuar nga këshilli i dërgohet, zyrtarisht, Ministrisë së Financave, e cila mund të japë rekomandime konkrete për rregullimin e situatës së vështirësisë financiare.
3. Propozimi i daljes nga situata e vështirësisë financiare, i paraqitur nga kryetari për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, si rregull, bazohet në një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

- a) autorizimi i kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore që, me burimet e veta në dispozicion, të risjellë situatën e pagesave në normalitet brenda 60 ditëve nga njoftimi i këshillit;
- b) përdorimi i fondit rezervë dhe i kontingjencës për të reduktuar detyrimet ndaj të tretëve;
- c) rishikimi i buxhetit për të adresuar problemin, duke ndryshuar zërat e shpenzimeve;
- ç) rritja e nivelit të taksimit, brenda kufijve të lejuar në ligj;
- d) negociimi me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të palikuiduara.

4. Plan i miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore për daljen nga situata e vështirësisë financiare publikohet në Buletin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 57

Vështirësia serioze financiare

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara.

2. Me konstatimin e situatës së vështirësisë serioze financiare, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton menjëherë këshillin e njësisë dhe Ministrinë e Financave.

3. Ministria e Financave, me marrjen e njoftimit nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose kur e konstaton vetë, i propozon Këshillit të Ministrave masat për daljen nga situata e vështirësisë serioze financiare. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave vendos:

a) të japë mbështetje financiare në formën e ndihmës apo huas, duke përcaktuar edhe planin për daljen e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga situata e vështirësisë serioze financiare, si dhe planin e kthimit të shumës së dhënë;

b) të mandatojë Ministrinë e Financave për të negociuar ristrukturimin e borxheve dhe të detyrimeve të papaguara;

c) të shpallë njësinë e vetëqeverisjes vendore në mbikëqyrje financiare dhe të autorizojë Ministrinë e Financave si mbikëqyrës financiar të saj, duke respektuar rigorozisht këto kushte:

i) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të marrë asnjë vendim që mund të çojë në shtimin e detyrimeve të saj financiare;

ii) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të vendosë shërbime të reja publike, të themelojë sipërmarrje publike apo çdo institucion tjetër;

iii) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të shlyejë asnjë detyrim financiar, të krijuar para shpalljes së rastit të vështirësisë financiare, përveç detyrimeve të përcaktuara shprehimisht në planin e rehabilitimit financiar.

4. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, brenda 30 ditëve nga shpallja e njësisë në mbikëqyrje financiare, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të këtij neni, miraton një plan rehabilitimi financiar, të cilin ia dorëzon për miratim Ministrisë së Financave. Përgatitja e planit të rehabilitimit bëhet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, me asistencën e Ministrisë së Financave. Në rast se njësia e vetëqeverisjes vendore nuk e dorëzon planin e rehabilitimit brenda këtij afati, plani përgatitet nga Ministria e Financave.

5. Zbatimi i planit të rehabilitimit është i detyrueshëm për njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe ajo dorëzon, të paktën një herë në 30 ditë, ose sa herë që kërkohet nga Ministria e Financave, raporte të hollësishme për realizimin e masave, sipas këtij plani.

6. Procedura më të detajuara për menaxhimin e situatave të vështirësive serioze financiare përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 58

Dalja nga gjendja e vështirësisë serioze financiare

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave shpall se njësia e vetëqeverisjes vendore pushon së qeni subjekt i masave, sipas nenit 57, të këtij ligji, në rast se:

- a) nuk rezulton me detyrime të papaguara ndaj të tretëve për dy vite të njëpasnjëshme;
- b) bën kërkesë për çlirimin nga këto masa dhe Ministria e Financave vlerëson se njësia e vetëqeverisjes vendore ka ndërmarrë masa, me të cilat mund të përmirësohet gjendja financiare dhe të eliminohen kushtet që kanë shkaktuar rastin e vështirësisë serioze financiare.

Neni 59

Paaftësia paguese

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në situatën e paaftësisë paguese nëse nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe/ose nëse raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara ndaj shpenzimeve vjetore të miratuara është më i lartë sesa 1.3.

2. Me konstatimin e situatës së paaftësisë paguese, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton menjëherë këshillin e njësisë dhe Ministrinë e Financave.

3. Ministria e Financave, me marrjen e njoftimit nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose kur e konstaton vetë, i propozon Këshillit të Ministrave për vendosjen nën administrim të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave për vendosjen nën administrim të njësisë së vetëqeverisjes vendore që ndodhet në situatën e paaftësisë paguese përcaktohet plani i veprimit për daljen nga kjo gjendje, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe afati i zbatimit të tij.

5. Procedura më të detajuara për menaxhimin e situatave të paaftësisë paguese përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 60

Dalja nga gjendja e paaftësisë paguese

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore e marrë nën administrim del nga gjendja e paaftësisë paguese dhe rikthehet në menaxhimin dhe funksionimin e saj, sipas përcaktimeve ligjore, vetëm kur vërtetohet se ajo është në gjendje të shlyejë pa vonesa të gjitha detyrimet financiare ndaj të tretëve.

2. Për këtë qëllim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore harton një raport për gjendjen financiare të njësisë së marrë në administrim dhe ia dërgon për miratim Ministrisë së Financave.

3. Pas shqyrtimit të raportit, por jo më vonë se 30 ditë nga marrja e tij, Ministri i Financave i propozon Këshillit të Ministrave daljen nga paaftësia paguese të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe kthimin e saj në funksionim normal, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

KREU XII

SHKELJET DHE SANKSIONET

Neni 61

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Për mosrespektimin e dispozitave të këtij ligji mbahet përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Veprimet në kundërshtim me këtë ligj dhe /ose mosveprimet sipas këtij ligji, dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) kur nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk zhvillon konsultime me komunitetin vendor dhe grupet e interesit, sipas përcaktimeve në nenet 5, shkronja “ç”, dhe 13, pika 3, të këtij ligji, dënohet nga nëpunësi i parë autorizues me gjobë nga 90 000 deri në 150 000 lekë;

b) kur nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk publikon në mënyrën dhe afatet e përcaktuara dokumentet e përcaktuara në nenet 5, shkronja “b”; 32, pika 6; 36, pika 9; 38, pika 2; 39, pika 3; 41, pika 6; 48, pika 3; dhe 56, pika 4, të këtij ligji, dënohet nga nëpunësi i parë autorizues me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

c) kur nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara në nenet 43, pika 1, dhe 48, pikat 1, 3 e 6, të këtij ligji, dënohet nga nëpunësi i parë autorizues me gjobë nga 90 000 deri në 150 000 lekë;

ç) kur nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk njofton apo dërgon dokumentacionin në Ministrinë e Financave, sipas përcaktimeve në nenet 12, pika 1; 36, pika 5; 38, pika 3; 48, pika 3; 51, pika 4; 56, pika 2; 57, pikat 2 e 5; dhe 59, pika 2, të këtij ligji, dënohet nga nëpunësi i parë autorizues me gjobë në masën 90 000 deri në 150 000 lekë.

3. Kur autoritetet përgjegjëse të qeverisjes qendrore nuk kryejnë në kohë transferimin e fondeve në favor të njësisë së vetëqeverisjes vendore për transfertat nga Buxheti i Shtetit, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 25, të këtij ligji, dënohen nga Ministri i Financave me gjobë, në masën 100 000 deri në 200 000 lekë.

4. Kur institucionet e njësisë së qeverisjes qendrore përgjegjëse nuk dërgojnë dokumentacionin e nevojshëm, të përcaktuar me ligj, për taksat vendore dhe taksat e ndara, dënohen nga Ministri i Financave me gjobë, në masën 100 000 deri në 200 000 lekë.

5. Procedurat e konstatimit, të shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

6. Masa e dënimit, e përcaktuar me gjobë, shlyhet me këste mujore. Këstet mujore shlyhen sipas përcaktimeve të ligjit për kundërvajtjet administrative.

7. Gjambat ekzekutohen, përkatësisht, nga zyra e financës së njësisë së vetëqeverisjes vendore ose njësisë së qeverisjes qendrore, në të cilën paguhet personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ dhe derdhen në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose njësisë së qeverisjes qendrore.

8. Personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, brenda 45 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

9. Në zbatim të këtij neni, “nëpunës i parë autorizues” është nëpunësi i përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

KREU XIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 62

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 1; 33, pika 1; 34, pikat 3 e 5; 36, pika 10; 40, shkronja “e”; 48, pika 1; 53, pika 1; 57, pika 6; dhe 59, pika 5, të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit që, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 50, pika 3, të këtij ligji.

Neni 63

Dispozitë kalimtare

1. Taksat e përkohshme, të vendosura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën e miratimit të tyre.

2. Në pikën 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9975, datë 27.8.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, shifra “18 për qind” zëvendësohet me shifrën “25 për qind”.

3. Në pikën 3, të nenit 21, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, fjalia “Ndërsa për tatimpaguesit e biznesit të vogël kufijtë janë plus 10/minus 30 për qind”, shfuqizohet.

Neni 64
Shfuqizime

Ligji nr. 7776, datë 22.12.1993, “Për buxhetin lokal”, të ndryshuar, nenet 23, 24 dhe 25, të ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008, “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 65
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të neneve 23, 25, pika 1, 55, 56, 57, 58, 59 dhe 60, të këtij ligji, që hyjnë në fuqi në datën 1 janar 2018.

Miratuar në datën 27.4.2017

Shpallur me dekretin nr. 10323, datë 18.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

KAPITULLI III
SHËRBIMET DHE PËRKUJDESJA SHOQËRORE

LIGJ
Nr. 9374, datë 21.4.2005

PËR NDIHMËN SHTETËRORE¹⁷
(Ndryshuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009, nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i procedurave, sipas të cilave lejohet dhe kontrollohet ndihma shtetërore, për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe zbatimin e angazhimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare, që përmbajnë dispozita për ndihmën shtetërore.

¹⁷ Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 36, datë 27 maj 2005.
Ligji nr.10 183, datë 29.10.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, datë 7 dhjetor 2009.
Ligji nr. 21/2016, datë 10.3.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, datë 31 mars 2016.

Neni 2

Fusha e zbatimit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009)

Ky ligj zbatohet për veprimtaritë, që ushtrohen në të gjithë sektorët e prodhimit dhe të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të sektorëve të bujqësisë e të peshkimit.

Neni 3

Përkufizime

Shtuar pika 14 dhe 15 me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009

Ndryshuar pika 9 dhe shtuar pikat 17, 18, 19, 20 me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Dhënës të ndihmës shtetërore" (në vazhdim "dhënës") janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër, që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.

2. "Ndërmarrje" është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike.

3. "Ndërmarrje të vogla e të mesme" janë ndërmarrjet, që kanë jo më shumë se 250 punonjës dhe një xhiro vjetore jo më të madhe se 40 milionë euro ose një llogari të bilancit jo më të madhe se 27 milionë euro dhe që nuk janë të zotëruara në një masë më të madhe se 25 për qind të kapitalit ose të së drejtës së votës nga një ose disa ndërmarrje, që nuk cilësohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

4. "Produkt" është çdo mall i shitur ose i blerë apo çdo shërbim i ofruar ose i hedhur në treg nga ndërmarrjet.

5. "Përfitues i ndihmës shtetërore" është çdo ndërmarrje ose individ, që merr ndihmë shtetërore.

6. "Skemë e ndihmës shtetërore" është çdo akt normativ, mbi bazën e të cilit, në formë të përgjithshme dhe pa pasur nevojën e akteve të tjera zbatuese, mund t'u jepet ndihmë ndërmarrjeve.

7. "Ndihmë individuale" është çdo ndihmë, që i jepet një përfituesi të ndihmës shtetërore.

8. "Intensiteti i ndihmës shtetërore" është ekuivalenti i grantit, i shprehur në përqindje të totalit të kostove të pranueshme ose të shpenzimeve të përfituesit të ndihmës shtetërore.

9. "Ndihmë e paligjshme" është çdo ndihmë shtetërore e dhënë dhe e zbatuar pa miratimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore ose çdo ndihmë, për të cilën është njoftuar komisioni përkatës, por nuk është marrë miratimi i tij.

10. "Ndërmarrje në vështirësi" është ndërmarrja, e cila nuk është e aftë që nëpërmjet burimeve të veta ose nëpërmjet fondeve, që ajo mund të përfitojë nga aksionerët ose kreditorët e saj, të pakësojë humbjet, të cilat, pa ndërhyrjen e dhënësve të ndihmës, do ta detyrojnë atë brenda një periudhe, afatshkurtër ose afatmesme, të largohet nga veprimtaria ekonomike.

11. "Ndihmë shtetërore për rastet e shpëtimit" është një mbështetje financiare për një ndërmarrje në vështirësi, për një periudhë kohore, gjatë së cilës duhet të përgatitet plani i ristrukturimit ose i likuidimit.

12. "Ndihmë shtetërore për ristrukturim" është një mbështetje financiare, që jepet për ristrukturimin e veprimtarisë së një ndërmarrjeje dhe për sigurimin, brenda një periudhe të arsyeshme, të rentabilitetit afatgjatë të saj.

13. Ndihmë për sektorë të ndjeshëm" është ndihma për ata sektorë, ku kapaciteti i prodhimit është më i madh se kërkesa në treg për produktin në fjalë.

14. "Ndihmë rajonale" është ndihma që jepet për zhvillimin e zonave të prapambetura në Republikën e Shqipërisë".

15. “Ndihma për riskun e kapitalit” është financimi që u bëhet ndërmarrjeve, nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital në formën e kuotave, të aksioneve ose obligacioneve të konvertueshme në aksione, në fazat e para të rritjes/themelimit dhe administrimit të tyre.

16. “Ndihma për mbrojtjen e mjedisit” është çdo veprim i ndërmarrë për të rregulluar apo parandaluar dëmet, që u shkaktohen mjedisit fizik ose burimeve natyrore nga veprimtaria e përfituesit të ndihmës, në mënyrë që të pakësohet shkalla e rrezikut, i cili vjen prej dëmit, ose të sigurohet përdorimi sa më eficient i burimeve natyrore.

17. “Shpërdorim i ndihmës” është çdo ndihmë e përdorur nga përfituesi në kundërshtim me një vendim të marrë nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në përputhje me këtë ligj.

18. “Burime shtetërore” janë burimet e Buxhetit të Shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njërive të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu.

19. “Ndihmë horizontale” është ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, e dhënë në çdo formë, ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion, ndihma për mbrojtjen e mjedisit, ndihma për trajnim, ndihma për punësim, ndihma për punonjësit në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara, ndihma për shpëtim dhe ristrukturim.

20. “Ndihmë e palejueshme” është ndihma shtetërore e dhënë në kundërshtim me kriteret dhe rregullat e miratuara sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën shtetërore.

Neni 4

Ndalimi i ndihmës shtetërore

(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.

2. Format e ndihmës shtetërore përfshijnë kryesisht:

- a) grantet dhe subvencionet;
- b) përjashtimin, uljen dhe diferencimin e taksave;
- c) faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave;
- ç) faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve;
- d) garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulëta;
- dh) uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;
- e) uljen e çmimit të produkteve të ofruara, shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut ose blerjen e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut;
- ë) zmadhimin e kapitalit shtetëror të ndërmarrjet ose ndryshimin e vlerës së tij në rrethana, të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat, që vepron në kushte ekonomike normale.

3. Çdo ndihmë e ndaluar është e rimbursueshme.

Neni 5

Ndihma për eksport

(Shtuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009)

Ndalohet ndihma që është e lidhur drejtpërdrejt me kuotat e eksportit dhe me shpenzimet korrente, të lidhura me veprimtarinë e eksportit, si dhe ndihma, që kushtëzohet me përdorimin e produkteve vendase kundrejt produkteve të importuara.

Neni 6

Ndihma për sektorët e ndjeshëm
(Shfuqizohet me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

Shfuqizohet.

Neni 7

Ndihma shtetërore e lejueshme

Ndihmë shtetërore e lejueshme është:

- a) ndihma me karakter social, që jepet për individë, nëse kjo ndihmë është dhënë pa krijuar diskriminim lidhur me origjinën e produkteve në fjalë;
- b) ndihma që jepet për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga gjendja e jashtëzakonshme.

Neni 8

Ndihma "De minimis"

(Ndryshuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009 dhe nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Ndihma "De minimis" është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

2. Vlera maksimale, kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës "De minimis" përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8/1

Ndihma shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

(Shtuar me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Ndihma shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të lejohet, sipas këtyre kategorive:

- a) ndihmë për investime;
- b) ndihmë për ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara nga sipërmarrëset femra;
- c) ndihmë për këshillim;
- ç) ndihma për pjesëmarrje në panaire;
- d) ndihma për riskun financiar;
- dh) ndihma për ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara.

2. Kushtet, kriteret, intensiteti i ndihmës dhe procedurat për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore për ndërmarrjet e vogla e të mesme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ndihma në formën e shërbimeve këshillimore dhe për pjesëmarrjen në panaire për ndërmarrjet e vogla e të mesme

(Ndryshuar titulli dhe shfuqizuar pika "a", me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

Shfuqizuar.

Neni 9/1

Ndihma për ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara

(Shtuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

Shfuqizuar.

Neni 10

Ndihma shtetërore për punësim

(Ndryshuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009 dhe ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Ndihma për punësim mund të lejohet nëse jepet, për:
 - a) punësimin e punëkërkuarve të papunë në vështirësi, në formën e subvencionit të pagës, të sigurimeve të detyrueshme shoqërore e shëndetësore dhe kostove të trajnimit;
 - b) punësimin e punëkërkuarve të papunë me aftësi të kufizuara, në formën e subvencionit të pagës, sigurimeve të detyrueshme shoqërore e shëndetësore dhe kostot e trajnimit;
 - c) mbulimin e kostove shtesë për përshtatjen e arsyeshme të vendeve të punës për punësimin e punëkërkuarve të papunë me aftësi të kufizuara.
2. Kushtet, kriteret, intensiteti i ndihmës dhe procedurat për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore për punësim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Ndihma për trajnim

(Ndryshuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009 dhe nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Ndihma shtetërore për trajnim është ndihma e dhënë nga burimet shtetërore për trajnim të përgjithshëm dhe të veçantë.
2. Përfituesi i ndihmës, sipas këtij neni, është subjekti fizik/juridik publik ose privat që kryen trajnimin.
3. Kushtet, kriteret, intensiteti i ndihmës dhe procedurat për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore për trajnim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion

(Ndryshuar me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Në ndihmën shtetërore për kërkim, zhvillim dhe inovacion përfshihen:
 - a) ndihma për projektet e kërkimit e të zhvillimit;
 - b) ndihma për investime në infrastrukturën e projekteve kërkimore shkencore;
 - c) ndihma për klasterat e inovacionit;
 - ç) ndihma për nxitjen e projekteve të inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
2. Kushtet, kriteret, intensitetet e ndihmës dhe procedurat për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore për kërkim e zhvillim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Ndihma shtetërore e lejueshme

- Ndihma shtetërore mund të lejohet nëse ajo:
- a) nxit zhvillimin ekonomik të rajoneve të Republikës së Shqipërisë, të karakterizuara nga standarde jetese shumë të ulëta, ose të zonave ku ka papunësi serioze;
 - b) nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë ose jepet për të mënjanuar gjendje të rënda në ekonominë e vendit;

c) lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

ç) nxit zhvillimin kulturor dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë;

d) është në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose me aktet e tjera normative të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 13/1

Ndihma për mbrojtjen e mjedisit

(Shtuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009)

(Ndryshuar me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Në ndihmën për mbrojtjen e mjedisit përfshihen:

a) ndihma për investim për eficiencën dhe kursimin e energjisë;

b) ndihma për investim për prodhimin e energjisë dhe për veprimtari operationale nga burime të rinovueshme;

c) ndihma për investim për rehabilitimin e zonave të ndotura;

ç) ndihma për investim për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve;

d) ndihma për investim për infrastrukturën e energjisë;

dh) ndihma për studime mjedisore;

e) ndihma për investim në rehabilitimin e pyjeve;

ë) ndihma në sektorin e trajtimit të ujërave të zeza në zonat bregdetare.

2. Kushtet, kriteret, intensitetet e ndihmës dhe procedurat për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore për mjedisin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13/2

Ndihma në formën e riskut të kapitalit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

(Shtuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009)

Skemat e ndihmës në formën e riskut të kapitalit për ndërmarrjet e vogla e të mesme lejohen vetëm nëse:

a) masa e ndihmës ka formën e pjesëmarrjes në një fond fitimprurës privat investimesh, të menaxhuar në kushtet e tregut;

b) kështet, që u jepen ndërmarrjeve përfituese nga fondi i investimit gjatë një periudhe prej 12 muajsh, nuk duhet të kalojnë vlerën 200 000 euro;

c) risku i kapitalit kufizohet vetëm në ofrimin e kapitalit bazë, kapitalit themeltar dhe/ose për zgjerimin e kapitalit;

ç) nga fondi i investimit investohet në ndërmarrjet e vogla e të mesme përfituese në formën e kuotave, të aksioneve ose obligacioneve të konvertueshme në aksione, të paktën 70 për qind e buxhetit të tij të përgjithshëm;

d) investitorët privatë mbulojnë jo më pak se 25 për qind të financimit të fondit të investimeve.

Neni 13/3

Ndihma për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik

(Ndryshuar me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Ndihma për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik është ndihma në formën e kompensimit, e cila u jepet ndërmarrjeve të ngarkuara për kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm publik dhe ekonomik.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për përcaktimin e kushteve, kritereve, intensiteteve të ndihmës dhe procedurave për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore, sipas këtij neni.

Neni 14

Ndihma rajonale

1. Ndihma rajonale mund të lejohet, nëse ajo mbulon deri në 50 për qind të vlerës së investimit fillestar ose të kostos së pagave të punonjëse për dy vjet për vendet e reja të punës. Investimi dhe vendet e reja të punës duhet të ruhen për një periudhë prej pesë vjetësh. Në çdo rast, intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75 për qind të vlerës.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të mbulon çështjet e ekonomisë, miraton rregulloren për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale.

Neni 15

Ndihma shtetërore për ndërmarrjet në vështirësi

1. Ndihma për shpëtimin e një ndërmarrjeje në vështirësi mund të lejohet nëse nuk kalon vlerën e nevojshme dhe jepet në formën e garancive shtetërore ose të huave me çmimin e tregut, për një periudhë 6-mujore, gjatë së cilës është përgatitur likuidimi ose një plan ristrukturimi.

2. Ndihma për ristrukturim mund të lejohet nëse mbështetet në një plan ristrukturimi, i cili parashikon masa ristrukturimi, që sigurojnë një rentabilitet afatgjatë të ndërmarrjes.

3. Në rastin e skemave të ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim, plani i ristrukturimit miratohet nga dhënësi i ndihmës dhe i paraqitet Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

4. Ndihma për shpëtim dhe/ose ristrukturim lejohet një herë në 10 vjet.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të mbulon çështjet e ekonomisë, miraton rregulloren për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim.

KREU II

STRUKTURAT E KONTROLLIT TË NDIHMËS SHTETËRORE

Neni 16

Komisioni i Ndihmës Shtetërore

(Ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 5, me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Komisioni i Ndihmës Shtetërore (në vazhdim “Komisioni”) është organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore. Komisioni është i pavaruar në kryerjen e funksioneve të veta.

2. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, me kryetar ministrin që mbulon çështjet e ekonomisë. Anëtarët e tjerë emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave, të ministrit përgjegjës për integrimin evropian e të ministrit të Drejtësisë dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.

3. Anëtarët e Komisionit emërohen për një periudhë 4-vjeçare dhe duhet të jenë profesionistë e me përvojë në fushën e ekonomisë.

4. Këshilli i Ministrave përcakton masën e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit dhe burimin e mbulimit.

5. Anëtarët e Komisionit, të propozuar nga ministrat përkatës sipas pikës 2, janë nëpunës civilë.

Neni 17

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

(Ndryshuar shkronja "b", me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

- a) vlerëson dhe autorizon skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale, në bazë të propozimeve të Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore;
- b) urdhëron kthimin e ndihmës së paligjshme dhe të palejueshme;
- c) mbikëqyr përdorimin e ndihmës shtetërore dhe rezultatin ekonomik të përfutur nga dhënia e saj;
- ç) merr vendime të tjera, në bazë të procedurave të këtij ligji;
- d) nxjerr udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij ligji;
- dh) harton, me ndihmën e Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore, raportin vjetor për ndihmat shtetërore dhe e paraqet atë pranë Këshillit të Ministrave, i cili ia përcjell Komisionit Europian;
- e) bashkëpunon me organizmat ndërkombëtarë, në kuadër të marrëveshjeve dhe angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 18

Drejtoria e Ndihmës Shtetërore

Drejtoria e Ndihmës Shtetërore në ministrinë që mbulon çështjet e ekonomisë (në vazhdim "Drejtoria"), si strukturë administrative për kontrollin e ndihmës shtetërore, në veçanti, kryen këto detyra:

- a) grumbullon, përpunon dhe mbikëqyr të dhënat për ndihmën shtetërore;
- b) merr njoftimet dhe përgatit vendimet e Komisionit;
- c) merr raportet nga dhënësi i ndihmës për mënyrën e zbatimit dhe rezultatin ekonomik, të arritur nga përdorimi i kësaj ndihme;
- ç) mban regjistrin e ndihmës shtetërore;
- d) merr vendime, në bazë të dispozitave të këtij ligji;
- dh) harton udhëzime dhe i paraqet për miratim pranë Komisionit;
- e) përgatit raportin vjetor për ndihmat shtetërore;
- ë) bashkëpunon me institucionet e huaja kompetente dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë për çështjet e ndihmës shtetërore.

KREU III

PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Neni 19

Parimi i përgjithshëm

Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, strukturat e ndihmës shtetërore, gjatë ushtrimit të funksioneve, zbatojnë Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 20

Njoftimi i ndihmës

1. Dhënësi i ndihmës, përveç rasteve të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, njofton Drejtorinë për çdo plan për dhënie të ndihmës.
2. Drejtoria, brenda 15 ditëve pune, njofton dhënësin e ndihmës për marrjen e këtij njoftimi.
3. Në njoftim, dhënësi i ndihmës duhet të japë të gjitha të dhënat e nevojshme për marrjen e një vendimi, sipas nenit 22 të këtij ligji.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon çështjet e ekonomisë, miraton rregulloren për procedurat dhe formën e njoftimit.

Neni 21

Pezullimi i ndihmës

Përveç rasteve të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, ndihma nuk vihet në zbatim përpara se Komisioni të marrë një vendim për lejimin e saj, me ose pa kushte.

Neni 22

Procedurat e shqyrtimit dhe vendimet

(Shtuar pika 2/1, me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Drejtoria shqyrton menjëherë njoftimin dhe nëse është i plotë, ia paraqet Komisionit për vlerësim.

2. Komisioni merr vendim të miratojë, me ose pa kushte, ose të mos miratojë ndihmën e njoftuar.

2/1. Komisioni, për çdo njoftim, merr një nga vendimet e mëposhtme:

a) masa e njoftuar nuk përbën ndihmë shtetërore;

b) autorizon zbatimin e ndihmës së njoftuar, që është në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore;

c) fillon procedurën e hetimit, kur ekzistojnë dyshime serioze mbi pajtueshmërinë e masës së njoftuar me legjislacionin e ndihmës shtetërore. Masa nuk zbatohet derisa hetimi të ketë përfunduar;

ç) ndalon zbatimin e ndihmës kur, pas përfundimit të hetimit, konstaton se ndihma e njoftuar nuk është në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

3. Vendimet e Komisionit merren brenda 60 ditëve kalendarike. Afati fillon të nesërmen e ditës së dorëzimit të njoftimit të plotë.

4. Vendimet e Komisionit merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 23

Propozime për masa të përshtatshme

Për skemat e ndihmës, të miratuara në mbështetje të pikës 2 të nenit 22 të këtij ligji dhe skemat e ndihmës, që kanë filluar të zbatohen përpara hyrjes në fuqi të tij, Komisioni mund të propozojë masa për përshtatjen e tyre me dispozitat e ligjit.

Neni 24

Kërkesa për informacion shtesë

1. Kur Drejtoria e gjykon jo të plotë informacionin e siguruar nga njoftimi i një plani për ndihmë, sipas nenit 20 të këtij ligji, ajo kërkon nga dhënësi i ndihmës informacionin e nevojshëm shtesë. Drejtoria, brenda 15 ditëve pune, njofton dhënësin e ndihmës për marrjen e përgjigjes.

2. Kur dhënësi i ndihmës nuk e siguron informacionin e kërkuar ose jep informacion jo të plotë, brenda periudhës së përcaktuar, Komisioni merr vendim, në bazë të informacionit në zotërim.

Neni 25

Procedura për ndihmën e paligjshme

Kur Komisioni ose Drejtoria ka informacion për një ndihmë që mendohet e paligjshme, i kërkohet dhënësit të ndihmës të paraqesë informacionin e nevojshëm për shqyrtim.

Neni 26

Vendimi për pezullimin e ndihmës së paligjshme

Komisioni mund të marrë një vendim, me anë të të cilit i kërkon dhënësit të ndihmës pezullimin e zbatimit të çdo ndihme të paligjshme, derisa Komisioni të ketë marrë një vendim për lejueshmërinë e kësaj ndihme.

Neni 27

Kthimi i ndihmës

1. Në rastet e ndihmës së paligjshme, kur merret një vendim për moslejimin e saj, Komisioni urdhëron kthimin e ndihmës nga përfituesi.

2. Ndihma që kthehet duhet të përfshijë edhe interesin, me një normë të përshtatshme. Interesi paguhet nga data në të cilën ndihma e paligjshme është në dispozicion të përfituesit, deri në datën e kthimit të saj.

Neni 28

Ekzekutimi i kthimit

1. Vendimi për kthimin e ndihmës së paligjshme përbën titull ekzekutiv.

2. Vlera e kthyer e ndihmës, së bashku me interesin, depozitohen në buxhetin e dhënësit të ndihmës.

Neni 28/1

Autorizimi ex-post i ndihmës

(Shtuar me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

Kur ndihma horizontale është vënë në zbatim pa njoftuar Komisionin, ky i fundit, në raste të caktuara, mund të japë një autorizim “ex-post” në qoftë se vlerëson se masa është në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore. Komisioni mund të autorizojë një ndihmë “ex-post”, duke përcaktuar kushte dhe afate të veçanta.

Neni 29

Komunikimi i vendimeve

Vendimet e marra nga Komisioni, në përputhje me këtë ligj, i komunikohen dhënësit të ndihmës.

Neni 30

Ankimi

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 21/2016, datë 10.3.2016)

1. Kundër vendimeve të Komisionit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

2. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimeve të Komisionit.

Neni 31

Publikimi i vendimeve

Vendimet e marra nga komisioni botohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 32
Raportet vjetore

1. Dhënësit e ndihmës detyrohen që, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të paraqesin pranë Drejtorisë raporte vjetore për të gjitha skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale të dhëna.

2. Brenda datës 30 qershor, Komisioni paraqet pranë Këshillit të Ministrave raportin vjetor të vitit pararendës për skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale të dhëna.

Neni 33
Sekreti profesional

Komisioni, Drejtorja dhe dhënësi i ndihmës, nëpunësit e tyre dhe vartës të tjerë, përfshirë ekspertë të caktuar nga Komisioni, janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional të informacioneve, që ata kanë arritur të marrin gjatë zbatimit të procedurave të këtij ligji.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34
Ngritja e strukturave të ndihmës shtetërore

1. Komisioni i Ndhmës Shtetërore e fillon ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj një muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Deri në ngritjen e Komisionit, procedurat në zbatim të këtij ligji, përveç atyre vendimmarrëse, kryhen nga Drejtorja e Ndhmës Shtetërore në ministrinë që mbulon çështjet e ekonomisë.

Neni 35
Fuqia prapavepruese

1. Ngarkohen të gjithë dhënësit e ndihmës që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të raportojnë pranë Drejtorisë për të gjitha skemat ekzistuese të ndihmës.

2. Nëse një skemë ekzistuese e ndihmës nuk raportohet brenda periudhës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, zbatohen dispozitat për ndihmën e paligjshme. Kthimi i ndihmës do të bëhet që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 36
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë rregulloret e përcaktuara në nenet 14, 15 dhe 20.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2006.

Shpallur me dekretin nr.4564, datë 6.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu

LIGJ
Nr. 9355, datë 10.3.2005

PËR NDIHMËN SHOQËRORE

(Ndryshuar me ligjet: nr.9602, datë 28.7.2006, nr.10 137, datë 11.5.2009, nr.10 252, datë 11.3.2010, nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 25/2013, datë 14.2.2013, nr. 47/2014, datë 24.4.2014, nr. 44/2016, datë 21.4.2016, nr. 121/2016, datë 24.11.2016¹⁸)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014)

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të përcaktojë ndihmën shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit e përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Neni 2

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në Shqipëri.

Neni 3

Parimet bazë, mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore, janë:

- a) respekti dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit;
- b) universaliteti;
- c) barazia e mundësive;

¹⁸ Ligji nr.9602, datë 28.7.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84, datë 9 gusht 2006.

Ligji nr.10 137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.86, datë 12 qershor 2009.

Ligji nr.10 252, datë 11.3.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 34, datë 2 prill 2010.

Ligji nr.10 399, datë 17.3.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 34, datë 7 prill 2011.

Ligji nr. 25/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.29, datë 11 mars 2013

Ligji nr. 47/2014, datë 24.4.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.72, datë 23 maj 2014

Ligji nr. 44/2016, datë 21.4.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 77, datë 9 maj 2016 dhe i fillon efektet nga data 1 shtator 2016.

Ligji nr. 121/2016, datë 24.11.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.236, datë 7 dhjetor 2016.

- c) e drejta për të përfituar;
- d) partneriteti;
- dh) transparenca dhe paanshmëria;
- e) decentralizimi;
- ë) pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit;
- f) mosdiskriminimi;
- g) karakteri subvencionues;

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr.9602, datë 28.7.2006, shtuar pika 23, me ligjin nr.10 252, datë 11.3.2010, nr.10 399, datë 17.3.2011, ndryshuar pika 13, me ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014, ndryshuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016, shfuqizuar pikat 5, 15, dhe 16 me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Ndihmë ekonomike” është mbështetja, në para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

1/1. “Përfitime në natyrë” është mbështetja në mallra ushqimore dhe të përdorimit të përditshëm e në veshmbathje, që u jepen familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. “Pagesë për personat me aftësi të kufizuar” është pagesa mujore, në lekë, që u jepet personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të këtij ligji.

3. “Person me aftësi të kufizuar” është individ, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisë, të intelektit, psikiko-mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.

4. “Invalid pune” është individ që është deklaruar i tillë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfiton nga ligji nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve”, i ndryshuar.

5. Shfuqizuar.

6. Bashki/njësi administrative” është institucioni, nën juridiksionin e të cilit subjektet përfituese, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar kompensimin e të ardhurave materiale ose/dhe monetare, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe shërbime shoqërore.

7. “Administrator shoqëror” është nëpunësi civil i njësive të vetëqeverisjes vendore, i cili vlerëson, verifikon e administron procesin dhe dokumentacionin për aplikimin e përfitimit e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët në nevojë, nëpërmjet përdorimit të regjistrit elektronik kombëtar.

8. “Familje” është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën shtëpi.

9. “Familje kujdestare” është një familje alternative, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 266 të ligjit nr. 9062, datë 8. 5. 2003 “Kodi i Familjes”.

10. “Kryetar i familjes” është personi, sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive 18-65 vjeç, anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari, kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.

11. “Familje në nevojë” është familja që nuk ka të ardhura ose ka të ardhura të pamjaftueshme nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera.

12. Shfuqizuar.

13. “Të ardhura të familjes” janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, përfshirë dhe ata anëtarë që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin anëtarët e familjes me aftësi të kufizuar, në kuptim të këtij ligji dhe të familjes në nevojë sipas pikës 4 të nenit 19.

14. “Jetim” është fëmija, deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” .

15. Shfuqizuar.

16. Shfuqizuar.

17. “Vendbanim” është vendi ku familja ose personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë ose të realizimit të interesave të vet, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

18. “Vendqëndrim” është vendi ku banohet për një kohë të caktuar për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor, pushimi, shërbimi të detyruar ushtarak apo vuajtjeje dënimi, si dhe raste të tjera të kësaj natyre.

19. “Burime jetese” janë të gjitha mjetet monetare ose të ardhurat në natyrë, të cilat bëjnë të mundur jetesën.

20. Shfuqizuar.

21. Shfuqizuar.

22. “Veprim i qëllimshëm” është çdo veprim që synon të shmangë punësimin e shpërblyer, kualifikimin për punësim dhe për mundësi punësimi, trajtimin mjekësor në rastet e përdoruesit të drogës ose të përdoruesit me tepri të alkoolit, mospërdorimin e kapitalit atje ku është mundësia për të siguruar mjetet e domosdoshme të jetesës, dhënies reale të të ardhurave, si dhe çdo veprim që nxit ndarjen e familjeve, që vërtetohet se kanë të njëjtën strehë, për përfitim nga ndihma ekonomike.

23. “Viktimë e trafikimit”, nënkupton personin fizik, që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës “e” të nenit 4 të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””.

24. “Paraplegjik” është çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme.

25. “Tetraplegjik” është çdo person që vuan nga paraliza e katër anësive.

26. “Fëmijë” është fëmija, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

27. “Person mbi moshë pune” është personi fizik që, në çastin e vlerësimit të kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike, është mbi moshën e përcaktuar për atë vit, për të drejtën e pensionit, sipas nenit 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

28. “Individ në nevojë” është personi fizik që është: jetim, viktimë e trafikimit, viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare.

29. “Viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare” është çdo person, sipas përkufizimit të dhënë në pikën 4 të nenit 3 të ligjit nr. 9969, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, për të cilin është lëshuar urdhër mbrojtjeje ose urdhër mbrojtjeje i menjëhershëm, me vendim të gjykatës.

30. Shfuqizuar.

31. “Kujdestar me pagesë” është personi i caktuar për t’u kujdesur për personin me aftësi të kufizuara, që ofron shërbim për të në veprimtarinë e përditshme, në shtëpi, në udhëtim, në punë, në shkollë dhe në veprimtaritë shoqërore.

32. “Formula e unifikuar e pikëzimit” është një formulë e pranueshmërisë së familjeve për ndihmë ekonomike, duke përdorur koeficientë dhe ndryshore të përcaktuara qartë, të cilët dalin nga lidhjet reciproke, objektive, me statusin ekonomik dhe me varfërinë.

33. “Vlerësimi biopsikosocial” është një proces vlerësimi i faktorëve të ndryshëm dhe të ndërvuar, të cilët dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët. Këta faktorë janë: struktura trupore, funksionet trupore e psikologjike, si dhe faktorë personalë, shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë.

34. “Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar” është një ekip i përzgjedhur, me mjek dhe punonjës social/psikolog, të cilët janë të punësuar pranë drejtorisë

rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për procesin e vlerësimit biopsikosocial të aplikuesve për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga mjekët, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara dhe verifikimin e informacionit me institucione të tjera.

35. “Ri/integrimi social” është tërësia e veprimtarive të integruara në pagesa dhe shërbime, që synojnë fuqizimin ekonomik të përfituesve të ndihmës ekonomike nëpërmjet punësimit.

KREU II PËR FITUESIT E NDIHMËS DHE TË SHËRBIMIT SHOQËROR

Neni 5

(Shtuar pika 4, me ligjin nr.10 252, datë 11.3.2010, ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, ndryshuar pika 5, me ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014)

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet në nevojë.
2. Jetimët, të cilët nuk janë në institucione.
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.
4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre.
5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, përfitojnë sipas përcaktimeve të nenit 23, pika 3, të këtij ligji.

Neni 6

(Ndryshuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 7

(Shfuqizuar pika 1, me ligjin nr.9602, datë 28.7.2006)

Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

1. Shfuqizuar.
2. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha.
3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.
4. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

Neni 8

Personat përfitues që përcaktohen në pikat 1, 2, 3 të nenit 7 të këtij ligji, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.

Neni 9

(Shtuar pika 4 dhe 5 me ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014)

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

1. Shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të personave dhe të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë.
2. Azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit.
3. Shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave.
4. Personat që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuajnë dënimin me heqje lirie.
5. Personat që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e Buxhetit të Shtetit, për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar.

KREU III

LLOJET E PËRFTIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 10

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

1. Ndihma ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave. Masat përjashtuese nga skema e ndihmës ekonomike për familjet, të cilat nuk zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike vlerësohen sipas nevojave dhe mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke u dhënë pesha specifike të qarta, objektive e transparente, si pjesë e një formule të pikëzuar. Kriteret dhe detajet e formulës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

1/1. Rishikimi i parametrave të programeve të ndihmës ekonomike, duke përfshirë rishikimin e kriterëve të vlerësimit për ndihmën dhe aftësinë e kufizuar dhe përditësimin e formulës së unifikuar të pikëzimit, e cila ndihmon në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, bazuar në ndryshimin e nivelit të varfërisë në vend, realizohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës për ndihmën shoqërore.

2. Familjet dhe individët në nevojë kanë të drejtë të marrin përfitime në natyrë, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Shfuqizohet.

4. Fëmijët e familjes në nevojë, të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe jetimët që nuk janë në institucione që ndjekin arsimin e detyrueshëm, sipas ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, marrin një pagesë shtesë, deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

6. Masa mujore e ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes, procedurave, dokumentacionit dhe kriterëve që duhet të plotësojnë familjet dhe individët në nevojë për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore nxjerr udhëzim për mënyrën e përlogaritjes së masës së ndihmës ekonomike.

Neni 11

(ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014, nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

1. Pagesa për personat me aftësi të kufizuar jepet në formën e një kësti mujor, në lekë. Masa e pagesës për këta individë dhe për kujdestarët e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përfituesve, të klasifikuar me vendim të KMCAP-it në grupet e aftësisë së kufizuar, u ndërpritet pagesa pas 48 muajve punësimi. Procedurat në rastet e rikthimit në skemën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

(shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 13

(shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 14

(shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 15

(Shtuar pika 3, 4 dhe 5, me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 16

(shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 17

(Shtuar një fjali në paragrafin e dytë, me ligjin nr.10 252, datë 11.3.2010 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 18

(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

KREU IV

KRITERET E PËRFTIMIT DHE PROCEDURA E DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 19

(Shtuar pikat 4 dhe 5, me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë.

1. Ndihmë ekonomike të plotë përfitojnë familjet ose individët që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Përfshihen nga llogaritja e të ardhurave, sipas pikës 3 të këtij neni, familjet në nevojë kur:

a) nuk kanë kryefamiljarë, për arsye të vdekjes së të dy prindërve, të cilët kanë pasur fëmijët në ngarkim;

b) njëri prej prindërve është duke vuajtur dënimin me burgim, për vepra penale, me vendim gjykatë të formës së prerë, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, të cilët kanë pasur fëmijët në ngarkim;

c) njërit prind i është hequr e drejta prindërore me vendim gjykatë, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, në gjendjen familjare të të cilit ka fëmijë;

ç) kanë si kryefamiljar një person me aftësi të kufizuara, fizike e mendore, i verbër, paraplegjik/tetraplegjik ose invalid pune, dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension;

d) kanë si kryefamiljar nënën, ndërkohë që prindi tjetër nuk jeton, si dhe kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë ose persona mbi moshë pune, të cilët nuk përfitojnë pension;

dh) kanë si kryefamiljar një pjesëtar të familjes që është mbi moshë pune dhe, kur anëtarët e familjes së tij janë fëmijë dhe persona mbi moshë pune, pavarësisht nga të ardhurat, nga pensioni apo toka;

e) janë familje të mbyllura në shtëpi, si pasojë e gjakmarrjes;

ë) janë familje që i përkasin minoritetit rom;

f) janë familje në nivelin e varfërisë, sipas listës së përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse.

5. Këshilli i Ministrave, kur e sheh të nevojshme, parashikon edhe raste të tjera të përjashtimit nga llogaritja e të ardhurave, përveç atyre të parashikuara në pikën 4 të këtij neni.

Neni 20

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, me ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014, nr. 44/2016, datë 21.4.2016 dhe shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

1. Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj, me vendim të strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Bashkia/njësia administrative njofton kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit për vendimin e drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet publikimit të tij, dhe kryen veprimet financiare për pagesën.

1/1. Pagesa e personave me aftësi të kufizuar shpërndahet një herë në muaj, me vendim të këshillit bashkiak.

2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga:

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë.

Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar ndihmë ekonomike paraqiten tek administratori shoqëror në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe nivelet minimale dhe maksimale të masës për përfitimin e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar pagesë për personat me aftësi të kufizuar paraqiten tek administratori shoqëror në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të kujdestarëve të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Shfuqizuar.

Neni 21

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik,

të kryer nga administratori shoqëror. Këto familje në nevojë do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind dhe/ose me fonde të buxhetit vendor, sipas përcaktimeve që do të bëhen nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 22

(Ndryshuar me ligjin nr. 47/2014, datë 24.4.2014 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 23

(shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 24

(shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 25

(Shfuqizuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

KREU V

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SKEMËS SË NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 26

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 25/2013, datë 14.2.2013, shfuqizuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të legjislacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore grumbullon informacione, statistika dhe raporte nga njësitë vetëqeverisjes vendore, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, arritjen e standardeve për ndihmën ekonomike, kryerjen e pagesës për personat me aftësi të kufizuar. Përmbajtja, që do të kenë informacionet dhe raportet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, treguesit statistikorë, që do të mbledhen, periodiciteti i mbledhjes së tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, shtuar pika 6 dhe 7, me ligjin nr. 25/2013, datë 14.2.2013, shfuqizuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016, shfuqizuar pika 5, shkronjat "b" dhe "c", 6 e 7)

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion publik, në varësi të ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.

2. Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Shfuqizuar.

4. Shfuqizuar.

5. Shërbimi Social Shtetëror përgjigjet për zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në fushën e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për:

a) programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar;

b) Shfuqizuar.

c) Shfuqizuar.

dh) ngre dhe administron regjistrin elektronik kombëtar, i cili përfshin aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

e) kontrollin e veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe pranë pushtetit vendor, për ndihmën shoqërore. Procedura e kryerjes së kontrollit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Shfuqizuar.

7. Shfuqizuar.

Neni 27/1

(Shtuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për ndihmën ekonomike, kanë këto përgjegjësi:

1. Verifikimin e të dhënave të regjistruara nga administratori shoqëror në regjistrin kombëtar elektronik të të dhënave dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse për familjet/individët në nevojë, të cilët janë propozuar me vendim të Këshillit bashkiak, që të trajtohen me ndihmë ekonomike.

2. Vendimmarrjen për:

a) caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, që plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe masën e përfitimit të tyre. Për familjen në proces zgjidhjeje martese, kur nuk ka ende një vendim të formës së prerë, masa e përfitimit caktohet e ndarë për të dy bashkëshortët;

b) refuzimin e kërkesës për caktimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për familjet/individët në nevojë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Dërgimin e vendimit, për rastet e parashikuara në shkronjat “a” e “b”, të pikës 2, të këtij neni, kryetarit të bashkisë:

a) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;

b) për të kryer veprimet financiare për pagesën, për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Neni 28

Ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore harton dhe paraqet pranë Ministrisë së Financave nevojat për fonde nga buxheti për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar.

Neni 29

(shtuar një paragraf në pikën 7 me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 44/2016, datë 21.4.2016, shfuqizuar pikat 3, 4, 5, 6, 8 e 12 me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016))

Këshilli bashkiak ka këto përgjegjësi:

1. Merr vendimin për propozimin që familja/ individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse të përfitimit. Ky vendim i përcillet menjëherë, zyrtarisht, strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Miraton fondin për pagesën e personave me aftësi të kufizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Shfuqizuar.

5. Shfuqizuar.

6. Shfuqizuar.
7. Shfuqizuar.
8. Shfuqizuar.
9. Shfuqizuar.
10. Shfuqizuar.
11. Shfuqizuar.
12. Shfuqizuar.

Neni 30

Për administrimin e skemës së ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, pranë qarqeve, bashkive ose komunave ngrihen strukturat përkatëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave, në zbatim të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30/1

(Shtuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, për efekt të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, kryen këto detyra:

1. Harton projektvendimin për familjet/ individët në nevojë, nën juridiksionin e bashkisë, për trajtim me ndihmë ekonomike dhe përlogarit fondin për mbulimin e tyre.
2. Paraqet në këshillin bashkiak projektvendimin për propozimin për familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe masën e përfitimit për këto familje/individë në nevojë.
3. Harton projektvendimin për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar;
4. Harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar.
5. Grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 31

(Ndryshuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016, shfuqizuar fjalë në pikat "a", "c", shkronjat "ë", "j", fjalë në shkronjën "g" dhe shkronja "gj" me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Administratorët shoqërorë në bashki ose njësi administrative kanë për detyrë:

- a) të identifikojnë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar;
- b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dy herë në vit dhe, për familjet që shpallen përfituese për herë të parë, verifikimi i parë të kryhet brenda tre muajve;
- c) të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki të dhënat për familjet/individët në nevojë, që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar;
- ç) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar, si edhe të administrojnë këtë dokumentacion;
- d) Shfuqizuar.
- dh) Shfuqizuar.
- e) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësi të vetëqeverisjes vendore;
- ë) shfuqizuar;

- f) shfuqizuar;
- g) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar;
- g) Shfuqizuar.
- h) të hedhin në regjistrin elektronik kombëtar të dhënat e deklaruara nga aplikuesit për ndihmë ekonomike;
- i) të kontribuojnë në procesin e hartimit të projektvendimit për propozimin që familja /individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe të listës së personave me aftësi të kufizuar;
- j) të raportojnë pranë bashkisë të dhëna statistikore për numrin dhe fondin për familjet /individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar.

KREU VI FINANCIMI I NDIHMËS

Neni 32

(Shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 33

(Shfuqizuar fjalë me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Financimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe buxhetet e qeverisjes vendore.

Neni 34

Burimet e financimit të ndihmës dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar përbëhen nga:

- a) fondet e Buxhetit qendror të Shtetit;
- b) fondet nga taksat dhe tarifatat vendore.

Neni 35

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011)

Ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore programon fondet për bllok-ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe detajon që në fillim të vitit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore.

Kriteret dhe treguesit, që përdoren për programimin e bllok-ndihmës, përcaktohen në bazë të treguesve të vlerësimit të varfërisë dhe rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011 nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Ministria përgjegjëse për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore transferon çdo dy muaj fondin e bllok-ndihmës ekonomike në bashki.

Neni 37

(Shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 38

(Shtuar dy paragrafë, me ligjin nr.10 252, datë 11.3.2010 dhe ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 39

(Shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 40

(Shtuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011)

Kontrolli për përdorimin e fondeve të ndihmës, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror bëhet nga organet e specializuara të kontrollit, në përputhje me ligjin nr. 9009, datë 13. 2. 2003 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

KREU VII

Neni 41

Sanksionet

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 27/1, 30/1 dhe 31, të këtij ligji, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbëjnë vepër penale:

a) përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";

b) ndëshkohen me masë disiplinore.

2. Struktura përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuara, për shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në nenet 31 e 42/1 të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, konstaton kundërvajtjen administrative dhe i propozon, për shkelësit, kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore/Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror vendosjen e:

a) gjobës nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë;

b) masës disiplinore;

c) shpërblimin e dëmit, nëse është shkaktuar një i tillë.

3. Struktura përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuara, kur vlerëson se janë konsumuar elementet e veprës penale nga personat e ngarkuar për zbatim, bën kallëzimin penal pranë autoriteteve kompetente për shkelësit e ligjit.

4. Çdo shkelje e menaxhimit të fondeve buxhetore, që programohen dhe përdoren për ndihmën ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 71 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 41/1

Ankimi

(Shtuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011 dhe ndryshuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

1. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë, mund të paraqesë ankesë, me shkrim, pranë bashkisë/njësisë

administrative, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton, me shkrim, ankuesin, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 10 ditëve pune, nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 42

Dispozita kalimtare

(Ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

1. Përdorimi i regjistrit elektronik kombëtar të të dhënave për aplikuesit dhe përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore do të pilotohet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat nuk do të kryhet pilotimi, do të zbatohet legjislacioni në fuqi për aftësinë e kufizuar shoqërore.

Neni 42/1

(Shtuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, nr. 47/2014, datë 24.4.2014, shfuqizuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Neni 42/2

(Shtuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011, shfuqizuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Neni 42/3

(shtuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat do të kryhet pilotimi i regjistrit elektronik kombëtar dhe modeli biopsikosocial i vlerësimit të aftësisë së kufizuar me grup/komision vlerësimi shumë-disiplinor, për të gjithë personat, të cilët kërkojnë të vlerësohen/rivlerësohen për aftësinë e kufizuar, do të ndiqen këto procedura:

1. Kërkesa dhe dokumentacioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar paraqiten pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, e cila hedh të dhënat e aplikuesit në regjistrin elektronik kombëtar, administron dokumentacionin, kryen verifikimin dhe vlerësimin e individëve dhe merr vendimin për aftësinë e kufizuar.

2. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror pajis me dokumentin përkatës personin me aftësi të kufizuar dhe i dërgon kryetarit të bashkisë vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar, për të kryer veprimet financiare.

3. Masa, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar dhe ndihmës personal, si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 42/4

(shtuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016; shfuqizuar me ligjin nr. 121/2016, datë 24.11.2016)

Neni 42/5

(shtuar me ligjin nr. 44/2016, datë 21.4.2016)

1. Familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji, të cilët janë në moshë pune, përfshihen në programe të ri/integrimit social.
2. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë personat që do të përfshihen në programe të ri/integrimit social përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Miratimi i programeve të ri/integrimit social bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 43

(ndryshuar me ligjin nr.10 399, datë 17.3.2011)

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 10, 11, nenit 15 pika 4, 18, 19, 20, nenit 22 pika 1, 23, 26, 27, 29, 30, 35, 38 dhe 39 të këtij ligji.

Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore të nxjerrë udhëzime në zbatim të neneve 10 pika 7 dhe 15 pika 5.

Neni 44

Ligji nr. 7710, datë 18. 5. 1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, i ndryshuar, vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij dhe neni 2 i ligjit nr. 8626, datë 22. 6. 2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” shfuqizohen.

DISPOZITË KALIMTARE E LIGJIT NR. 25/2013, DATË 14.2.2013

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4520, datë 25.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr. 22/2018

PËR STREHIMIN SOCIAL¹⁹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aftësi paguese” është tërësia e mjeteve financiare që një familje mund të përdorë për pagesën e qirave ose të kësteve të kredive, në raport me të ardhurat familjare, në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. “Administrator shoqëror” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.
3. “Azilkërkues” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin për azilin në Republikën e Shqipërisë.
4. “Banesë” është bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm që ka hyrje të pavarur (derë) dhe dalje në rrugën publike.
5. “Banesë sociale” është tërësia e banesave të përfituara sipas programeve sociale të parashikuara nga ky ligj.
6. “Banesë sociale me qira” është banesa që jepet me qira, në pronësi publike, nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë e mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat.
7. “Banesë me kosto të ulët” është banesa që ndërtohet në përputhje me të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi dhe që vihet në dispozicion të njërit prej programeve të strehimit të parashikuara nga ky ligj.
8. “Banesë e përkohshme” është banesa e destinuar për strehim të përkohshëm, në kushtet e emergjencës së strehimit të individëve të pastrehë ose që kanë nevojë për strehim të menjëhershëm dhe me afat të shkurtër, sipas parashikimeve të këtij ligji, derisa t’u zgjidhet mundësia për strehim të qëndrueshëm.

¹⁹ Ligji nr. 22/2018, datë 3.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 30 maj 2018.

9. “Banesë e specializuar” është banesa me infrastrukturë të përshtatur dhe të aksesueshme për të plotësuar nevojat funksionale, shëndetësore dhe të sigurisë fizike, për grupet në nevojë.

10. “Çmim mesatar i banesave në treg” është mesatarja e çmimeve të shitjes së banesave në treg gjatë një viti, e cila llogaritet sipas metodologjisë që miratohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

11. “Dëbim” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale, informale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, pa një proces të rregullt ligjor, në mungesë të konsultimit dhe ofrimit të strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe pa siguruar një mbrojtje ligjore efektive.

12. “Ent menaxhues” është një ent publik ose një person fizik/juridik privat, që ushtron veprimtarinë vetëm pas regjistrimit në një regjistër të posaçëm në njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe është përgjegjës për administrimin dhe mbikëqyrjen e banesave sociale.

13. “Emigrantë të rikthyer” janë kategoritë e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

14. “Familjet e punonjësve të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë” janë të gjitha kategoritë që përfshihen në ligjin nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës.

15. “Familje njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë” është nëna apo babai i vetëm që kanë në ngarkim fëmijë.

16. “Fondi publik i banesave sociale” është tërësia e banesave sociale në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, që krijohet nëpërmjet blerjeve në treg të lirë, investimeve për ndërtime të reja, kalimit të pronësisë nga partneritete publike private ose nëpërmjet përfitimit nga mënyrat e tjera, që vijnë nga ndërtimet private, si dhe nga burime të tjera, të parashikuara në këtë ligj.

17. “Grant i menjëhershëm” është mbështetje financiare e menjëhershme, që përfitojnë pa të drejtë kthimi disa kategori të specifikuara, në masën e përcaktuar sipas parashikimeve në këtë ligj.

18. “Grante konkurruese” janë fonde të kushtëzuara që përdoren nga ministria përgjegjëse për strehimin, për financimin e plotë ose të pjesshëm të projekteve që propozohen dhe zbatohen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për qëllime të këtij ligji.

19. “Institucion që menaxhon kredinë” është banka ose institucioni financiar, i cili ka nënshkruar një kontratë me institucionin investues për menaxhimin e një programi kreditimi me kushte lehtësuese në sektorin e strehimit.

20. “I pastrehë” është çdo individ/familje që nuk ka banesë, i cili/e cila banon në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, dhe nuk ka mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë.

21. “Kalim i pronësisë mbi banesat sociale” është transferimi i pronësisë nga pronari ekzistues te një pronar i ri, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.

22. “Kontratë qiraje sociale” është një kontratë qiraje, niveli i qirasë së të cilës kontrollohet dhe/ose mund të subvencionohet nga institucionet shtetërore.

23. “Kredi hipotekore” është huaja që jepet për strehim, e cila sigurohet nëpërmjet hipotekës mbi një pasuri të paluajtshme, me afat të gjatë maturimi dhe interes më të ulët se kreditë tregtare.

24. “Kredi me kushte lehtësuese” është kredia/huaja, interesat e së cilës subvencionohen nga institucionet shtetërore.

25. “Kushte emergjence për strehim” janë kushtet në të cilat ndodhen individët/familjet që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe në banesat që prishen për shkak të ndërtimeve të veprave publike, të cilët nuk përfitojnë kompensim financiar nga procedurat e shpronësimit.

26. “Normë e strehimit” është koeficienti që shpreh sipërfaqen minimale të banimit që duhet të ketë një individ në banesë. Ky koeficient shprehet në sipërfaqe, në metër katror për individ.

27. "Individ/familje në nevojë për strehim" është individ/familja që ka banesë, por e ka nën normën e strehimit, që nuk ka të ardhura që të sigurojë pagesën për një qira të përballueshme në tregun e lirë.

28. "Persona me aftësi të kufizuara (në vijim PAK)" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

29. "Programe sociale strehimi" janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që nuk kanë banesë dhe banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim apo në një banesë të përkohshme, në kuptim të këtij ligji, që nuk kanë mundësi ekonomike e financiare për të siguruar një banesë, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të sigurojnë pagesën për një qira minimale në tregun e lirë.

30. "Pronar social" është çdo subjekt publik, përveç njësisë të vetëqeverisjes vendore, si edhe çdo subjekt privat, që investon në banesa sociale me qira ose që disponon banesa për t'i dhënë me qira, për familjet në nevojë për strehim.

31. "Punëtor emigrant" janë kategoritë e përcaktuara në ligjin nr. 9555, datë 8.6.2006, "Për ratifikimin e konventës evropiane "Për statusin ligjor të punëtorëve emigrantë"" dhe në legjislacionin në fuqi për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi.

32. "Punonjës të Policisë së Shtetit" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për Policinë e Shtetit.

33. "Qiramarrës" është individ ose familja që banon me kontratë qiraje sociale.

34. "Qira e përballueshme" është ajo pjesë e qirasë, të cilën familja/individ arrin ta paguajë me të ardhurat e veta dhe që zë jo më shumë se:

a) 25 për qind të të ardhurave të një familjeje me të ardhura mesatare;

b) 20 për qind të të ardhurave të një familjeje me të ardhura të ulëta;

c) 15 për qind të të ardhurave të një familjeje me të ardhura shumë të ulëta.

35. "Qira reale" është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë.

36. "Qira mesatare" është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

37. "Qira sociale" është qiraja me të cilën jepen banesat sociale me qira dhe që llogaritet, në çdo rast, me një kosto më të ulët sesa qiraja reale.

38. "Refugjat" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

39. "Strukturë përgjegjëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore" është një drejtori, sektor ose njësi e qëndrueshme dhe e trajnuar, që mbulon çështjet e strehimit.

40. "Strehim" është tërësia e elementeve financiare, sociale dhe institucionale të procesit të sigurimit të banesës.

41. "Subjekte private" janë personat fizikë dhe juridikë privatë, sipas përcaktimit të dhënë nga Kodi Civil.

42. "Subvencion i qirasë" është shuma e të hollave që jepet nga institucionet shtetërore për llogari të përfituesit, me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesit.

43. "Subvencion i interesave të kredisë" është shuma në të holla që përfiton individ/familja nga institucionet shtetërore, me qëllim mbulimin e interesave të kredisë, të marrë me kushte lehtësuese për blerjen e banesave me kosto të ulët.

44. "Të ardhura familjare" janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuar, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme.

Në këto të ardhura nuk përfshihen të ardhura nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, përfitimet e personave me aftësi të kufizuara, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuar, e parashikuar në ligjin nr. 9355 datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, në ligjin nr. 8098 datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar dhe ligjit nr. 8626 datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik"; nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike; nga rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar.

45. “Të ardhura mesatare” është niveli mesatar i konsumit familjar, sipas nivelit më të ulët territorial të disagregimit të të dhënave nga INSTAT-i dhe që publikohet në mënyrë periodike. Për efekt të llogaritjes së nivelit të të ardhurave mesatare, familjet grupohen si më poshtë:

a) familje me të ardhura mesatare, që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 për qind e të ardhurave mesatare;

b) familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 për qind e të ardhurave mesatare;

c) familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare;

ç) familje pa të ardhura, që janë familje me ndihmë ekonomike, si dhe ato që përveç ndihmës ekonomike përfitojnë pagesat sipas paragrafit të dytë të pikës 44 të këtij neni.

46. “Viktimë e dhunës në familje” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje””.

47. “Viktimë trafikimi” ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

48. “Viktimë e mundshme e trafikimit” është personi, për të cilin agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar gjykojnë se mund të jetë trafikuar dhe ka të njëjtin kuptim, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”.

49. “Vajzat nëna” janë vajzat që bëhen ose janë në pritje për t’u bërë nëna, të vetme, pavarësisht nga mosha e tyre, të cilat marrin përsipër të gjitha përgjegjësitë për të lindur dhe rritur fëmijën e tyre pa ndihmë financiare.

50. “Zhvendosje” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, me ose kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, mbështetur në konsultim me subjektet e prekura, në ofrimin e strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe në garantimin e mbrojtjes ligjore efektive.

51. “Komisioni i strehimit” është Komisioni që ngrihet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ka në përbërje përfaqësues të komuniteteve të interesuara.

KREU II

PARIMET E POLITIKAVE TË STREHIMIT

Neni 3

Parimi i përballueshmërisë së strehimit

1. Strehimi konsiderohet i përballueshëm nëse familja me të ardhura:

a) mesatare nuk shpenzon më shumë se 25 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm;

b) të ulëta nuk shpenzon më shumë se 20 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm;

c) shumë të ulëta nuk shpenzon më shumë se 15 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm.

2. Në shpenzimet për strehimin nuk përfshihen shpenzimet për shërbime të furnizimit me ujë dhe me energji elektrike.

3. Strehimi i familjeve pa të ardhura sigurohet nga institucionet shtetërore, nëpërmjet njërit prej programeve të strehimit social të parashikuara nga ky ligj.

Neni 4

Parimi i strehimit të përshtatshëm

1. Strehimi konsiderohet i përshtatshëm për një individ dhe/ose familje atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.
2. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson:
 - a) hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
 - b) shërbime bazë, brenda mjedisit të banimit;
 - c) qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë;
 - ç) qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve;
 - d) akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare;
 - dh) qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët, duke lehtësuar shkallën e plotësimit të nevojave të veçanta të banimit për ta.
3. Strehimi nuk duhet të çojë drejt veçimit të një grupi përfituesish nga grupet e tjera.

Neni 5

Parimi i sigurisë së qëndrimit

1. Qëndrimi në një vendbanim, strehim të përkohshëm ose të përhershëm është i pacenueshëm, përveç rasteve që janë në kundërshtim me parimet Kushtetuese, si dhe ato të parashikuara me ligj.
2. Ndalohet dëbimi i individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre.
3. Zhvendosja e individëve/familjeve në rastet e parashikuara në ligj kryhet në përputhje me parimet e njoftimit, konsultimit dhe strehimit të përshtatshëm, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 6

Procedura e zhvendosjes

1. Në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim bëhet i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, prishje të objektit për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit ose raste të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera, njësia e vetëqeverisjes vendore kryen procedurën e mëposhtme:
 - a) njofton me shkrim individin/familjen për arsyet e zhvendosjes 30 ditë përpara nxjerrjes së aktit administrativ për zhvendosjen nga banesa;
 - b) informon individin/familjen për mundësitë alternative të strehimit;
 - c) nxjerr aktin administrativ për zhvendosjen nga banesa 45 ditë përpara zhvendosjes, duke njoftuar edhe formën e miratuar për strehim alternativ.
2. Zhvendosja, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk zbatohet pa siguruar më parë sistemimin me strehim të përshtatshëm të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpronësim.
3. Kundër vendimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për zhvendosje nga banesa, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
4. Individët/familjet që preken nga zhvendosja përfitojnë ndihmë juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
5. Procedurat e zhvendosjes dhe të bashkëpunimit institucional përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Parimi i respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në planifikimin e zonave të banimit e të programeve të strehimit, respektojnë traditat dhe kulturat e ndryshme të komuniteteve.

2. Ndërtimi i banesave duhet të mundësojë shprehjen e identitetit kulturor dhe diversitetin e komuniteteve, pa cenuar standardet e nevojshme të cilësisë së strehimit.

Neni 8

Parimi i pjesëmarrjes

Çdo subjekt që zbaton një program social strehimi përfshin në proces konsultimi komunitetin që preket dhe/ose atë që përfiton nga programi, në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Neni 9

Parimi i transparencës dhe i informimit të publikut

Organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë:

a) informacion të plotë, të lehtë për t’u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm për çdo individ/familje. Informacioni duhet të përmbajë:

i) llojin e programit social të strehimit që zbatohet në atë njësi të vetëqeverisjes vendore;
ii) kushtet që duhet të plotësojnë subjektet e interesuara për t’u përfshirë në programin specifik të strehimit;

iii) dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklaron subjekti i interesuar;

iv) procedurën që do të ndiqet nga njësia e vetëqeverisjes vendore për miratimin e përfituesve;

v) organin ankimor, të cilit duhet t’i drejtohet subjekti që nuk është përzgjedhur si fitues, afatet kohore dhe formatin e ankimit;

b) transparencë në procesin e përzgjedhjes e të publikimit, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës për të interesuarit;

c) ndihmë për plotësimin e formularëve të aplikimit për strehim, për individët me aftësi të kufizuar në të parë dhe në të folur, nëpërmjet interpretuesit të gjuhës së shenjave ose lehtësuesit të komunikimit, të moshuarit, për personat që nuk kuptojnë gjuhën shqipe ose ata që nuk dinë shkrim e këndim, si dhe të sigurojnë që çdo individ /familje, të cilët kanë vështirësi komunikimi për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore ose sociale, të marrin informacionin dhe ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.

Neni 10

Parimi i mosdiskriminimit

1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese.

2. Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t’i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.

KREU III PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT

Neni 11

Llojet e programeve sociale të strehimit

1. Në programet sociale të strehimit përfshihen:
 - a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;
 - b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
 - c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;
 - ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
 - d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;
 - dh) programi i banesave të specializuara.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.
3. Individit/familja nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë.

Neni 12

Ndërthurja e programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale

1. Programet sociale të strehimit ndërthuren me programe të tjera të shërbimeve sociale, kryesisht ato të punësimit, arsimimit e kujdesit shëndetësor.
2. Ministria përgjegjëse për strehimin dhe ministria e linjës, sipas llojit të shërbimit, hartojnë udhëzime të përbashkët për të caktuar mënyrën e ndërveprimit të këtyre programeve.

Neni 13

Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit

1. Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:
 - i) i fatkeqësive natyrore;
 - ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;
 - iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;
 - iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
 - c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.
2. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”.
3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.
4. Të drejtën për të përfituar nga programi i banesave sociale të specializuara e kanë edhe të miturit nën moshën 18 vjeç, pas liritimit ose përfundimit të programit të masës alternative të

shmangies, në rastin kur bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrativ, mbeten të pastrehë, për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjen e tyre.

Neni 14

Rregulla të përgjithshme për aplikimin në programet sociale të strehimit

1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/ vendqëndrimit të aplikantit.

2. Individidi/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë.

3. Dokumentacioni për të përfituar strehim, sipas çdo programi, afatet dhe procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Rregulla të përzgjedhjes përmes sistemit të pikëzimit

1. Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimet e parashikuara në këtë ligj, si dhe kriteret e bëra publike përpara fillimit të procesit të aplikimit.

2. Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

4. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojë listat e përfituesve brenda një afati dymujor, nga data e njoftimit nga ana e subjektit publik ose privat që ofron dhe realizon një nga programet sociale të strehimit, kur ky subjekt nuk është vetë njësia e vetëqeverisjes vendore. Marrëdhënia e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit që financon projektin përcaktohet me marrëveshje të posaçme.

5. Hartimi i listës së përfituesve kryhet nga zyra përgjegjëse ose struktura e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 16

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve

Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
 - i) nuk disponojnë banesë në pronësi;
 - ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;
 - iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;
 - iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;
 - vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.
- b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
 - i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;

- ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
- iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
- iv) bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.
- c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
 - i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - ii) individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;
 - iii) familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimimit të banesave ish-pronarëve;
 - iv) emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit;
 - v) familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - vi) punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);
 - vii) punonjësit e reparit RENE;A;
 - viii) punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - ix) viktimat e dhunës në familje;
 - x) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
 - xi) anëtarët e komunitetit rom;
 - xii) anëtarë të komunitetit egjiptian;
 - xiii) të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;
 - xiv) vajzat nëna;
 - xv) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.
- ç) Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj.

KREU IV PROGRAMI I BANESAVE SOCIALE ME QIRA

Neni 17

Kuptimi i programit të banesave sociale me qira (BSQ)

1. Programi i banesave sociale me qira është programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social.
2. Banesat sociale me qira përfshijnë:
 - a) banesat sociale që ndërtohen ose blihen nga tregu i lirë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të jepen me kontratë qiraje sociale;
 - b) banesat ekzistuese në treg, në pronësi të pronarit social;
 - c) objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së një veprimtarie, të cilat kanë kaluar në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe, në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, janë miratuar për t'u kaluar në fond banesash sociale me qira, që subvencionohen.

Neni 18

Fondi publik i banesave sociale

1. Fondi publik i banesave sociale është në pronësi të pushtetit vendor ose qendror dhe krijohet nga fonde të pushtetit vendor dhe/ose qendror, të subjekteve private fitimprurëse ose jofitimprurëse, donacione, si dhe:

a) ndërtime të reja;

b) blerje të banesave në treg të lirë ose pas ankandit të parë të banesave që shiten sipas parashikimeve të nenit 557 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet e blerjes së banesave pas ankandit të parë, në kontratën e shitjes parashikohet marrëveshja kufizuese që ndalon tjetërsimin e pasurisë ose ndryshimin e destinacionit të saj për përdorim si banesë sociale për të paktën 10 vjet nga data e blerjes;

c) përshtatje të objekteve të dala jashtë funksionit;

ç) kalimi i pronësisë mbi pronat e konfiskuara, si pasuri të vëna me aktivitet të paligjshëm.

2. Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, në territorin nën juridiksionin e saj, në përputhje edhe me planet vendore, duhet të parashikojë sipërfaqen e truallit për ndërtimin e një numri të mjaftueshëm banesash sociale, bazuar në nevojat për strehim.

Neni 19

Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik

1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 20

Përcaktimi i kufijve të të ardhurave të individëve/familjeve që përfitojnë nga banesat sociale me qira

1. Nga fondi i banesave sociale me qira, jo më pak se 80 për qind e familjeve që përzgjidhen të trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura nga 0 deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

2. Pjesa tjetër, jo më shumë se 20 për qind e familjeve mund të përzgjidhet brenda intervalit 100–120 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare.

Neni 21

Blerja e banesave sociale në treg

1. Blerja e banesave sociale në treg, që i shtohen fondit të banesave sociale me qira, si rregull, realizohet në ato raste kur ndërtimi i banesave të reja kushton më shumë sesa vlera e banesave në treg.
2. Banesa sociale mund të blihet nga tregu, përjashtimisht, kur vlera e banesës në treg është më e lartë se kostoja e ndërtimit, vetëm kur:
 - a) vërtetohen kushte emergjente për strehim;
 - b) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk disponon truall për ndërtim banesash të reja.
3. Kushtet, normat dhe standardet që duhet të plotësojnë banesat sociale me qira dhe procedura e blerjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Pronësia e banesave sociale me qira

1. Banesat sociale me qira regjistrohen në pronësi të subjektit që e ka financuar.
2. Kur banesat sociale me qira financohen tërësisht nga buxheti i shtetit ose bashkërisht nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore, ato regjistrohen në zyrën vendore të regjistrimit të pronave, në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore ose të institucionit publik të parashikuar në nenin 72, shkronja “g”, me shënimin përkatës për marrëveshjen kufizuese që ndalon tjetërsimin e pasurisë.

Neni 23

Statusi i pronarit social

1. Çdo subjekt publik, përveç njësive të vetëqeverisjes vendore, si edhe çdo subjekt privat, që investon në banesa sociale me qira ose që disponon banesa për t'i dhënë me qira, për familjet në nevojë për strehim, regjistrohet pranë njësive të vetëqeverisjes vendore me statusin e “pronarit social” nëse plotëson kushtet dhe kriteret e këtij neni.
2. Njësia e vetëqeverisjes vendore, brenda muajit janar të çdo viti, publikon thirrjet për aplikimet për çdo subjekt të interesuar, i cili kërkon të regjistrohet si pronar social. Thirrja për aplikim përmban, veç të tjerave, kushtet për përfitimin e statusit “pronar social” dhe lehtësitë fiskale që miratohen nga këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore.
3. Struktura përkatëse e njësive të vetëqeverisjes vendore, pasi verifikon kushtet e banesës dhe përshtatshmërinë e saj me normat e strehimit, përgatit raportin e vlerësimit dhe ia drejton për miratim titullarit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në rast vlerësimi negativ, njoftohet subjekti i interesuar.
4. Subjektit publik ose privat i jepet statusi “pronar social” kur:
 - a) banesa e tij plotëson kushtet teknike dhe normat e strehimit në fuqi, referuar raportit të strukturës së njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - b) qiraja me të cilën ofrohet banesa me qira nuk është më e lartë sesa qiraja mesatare në tregun e lirë;
 - c) nënshkruan një kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku bien dakord për mënyrën e menaxhimit të banesës së tij;
 - ç) nënshkruan deklaratën se nuk do të refuzojë qiramarrësin për arsye që përbëjnë diskriminim.

Neni 24

Marrëveshja ndërmjet pronarit social dhe njësive të vetëqeverisjes vendore

Pronari social dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë një marrëveshje. Kjo marrëveshje parashikon:

- a) afatin e marrëveshjes, që nuk mund të jetë më pak se 3 vjet;

- b) masën e qirasë mujore dhe mënyrën e shlyerjes së saj;
- c) mënyrën e administrimit të pronës dhe të marrëdhënieve me qiramarrësin.

Neni 25

Mbështetja e pronarit social

Pronari social mbështetet nëpërmjet financimeve për subvencionin e qirasë për familjet përfituese.

Neni 26

Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale me qira

1. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së fondit publik të banesave sociale me qira. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të ngarkojnë strukturat përgjegjëse të tyre për të kryer funksionet menaxhuese për administrimin, në rastin kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një enti menaxhues.

2. Me administrim kuptohen të gjitha veprimet dhe vendimet që merren për pronën, ndër të tjera:

- a) mbledhja e qirasë;
- b) evidenca e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- c) planifikimi financiar;
- ç) mbajtja e bilancit;
- d) ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të detyrimeve e të drejtave të palëve kontraktuese.

3. Me mirëmbajtje kuptohet tërësia e veprimeve dhe investimet e nevojshme për punime, ndreqje të nevojshme dhe riparime kapitale për përmirësimin e pronës.

4. Banesat sociale me qira, të cilat vihen në dispozicion të programit nga subjektet private, si pronarë socialë, administrohen dhe mirëmbahen në bazë të një kontrate që vetë këto subjekte lidhin me entet menaxhuese publike ose private. Një kopje e kësaj marrëveshjeje depozitohet pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore që kujdeset për strehimin.

Neni 27

Enti menaxhues

1. Pronari social ka të drejtë të regjistrohet si ent menaxhues. Në rastin kur nuk regjistrohet si ent menaxhues dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk kryen funksionet e entit menaxhues, atëherë pronari social dhe njësia e vetëqeverisjes vendore përzgjedhin një nga administratorët/shoqëritë administruuese, të regjistruara në librin e bashkisë, sipas ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009, ‘Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit’.

2. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren për mënyrën e funksionimit të entit menaxhues, si dhe për kontrollin e mbikëqyrjen e këtij të fundit.

Neni 28

Kushtet e menaxhimit të banesave sociale me qira

Çdo subjekt që ka në pronësi dhe/ose administron banesa sociale me qira duhet të sigurohet që të plotësohen:

- a) Kushtet dhe standardet e banimit, nëpërmjet:
 - i) plotësimit të kushteve të përshtatshme të banimit, në përputhje me standardet e ndërtimit;
 - ii) mirëmbajtjes së banesave, në mënyrë të tillë që të sigurojë, së paku, standardet, në bazë të të cilave ajo është ndërtuar ose blerë;
 - iii) plotësimit të të gjitha standardeve për sigurinë dhe kushtet higjieno-sanitare e shëndetësore të banesave.
- b) Kushtet e informimit dhe barazisë, nëpërmjet:

- i) trajtimit të gjithë qiramarrësve në mënyrë të barabartë;
 - ii) informimit të duhur për qiramarrësit për llojin dhe standardin e shërbimeve që ata mund të presin nga enti menaxhues, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me menaxhimin e banesave;
 - iii) formave të qarta e të thjeshta për paraqitjen e ankesave dhe që sigurojnë zgjidhjen e shpejtë, të drejtë e të kujdesshme të tyre;
 - iv) mundësive të ndryshme për qiramarrësit që të angazhohen në menaxhimin e banesave të tyre;
 - v) formave dhe mënyrave që qiramarrësit të kontrollojnë e të sigurojnë zbatimin e standardeve të menaxhimit.
- c) Fqinjësia e mirë, nëpërmjet:
- i) dhënies së informacionit të nevojshëm për qiramarrësit, për të drejtat dhe detyrimet e tyre për marrëdhëniet e fqinjësisë, respektimin e privatësisë, ruajtjen e qetësisë e të pastërtisë, shmangien e sjelljeve e të veprimeve ofenduese, keqdashëse dhe/ose kriminale;
 - ii) reagimit të menjëhershëm ndaj veprimeve që shqetësojnë ose vënë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e banorëve.
- ç) Qëndrueshmëria dhe transparenca financiare, duke siguruar, ndër të tjera:
- i) transparencën në përcaktimin e qirasë për çdo qiramarrës;
 - ii) mbledhjen e qirave në kohë dhe evidentimin e çdo shkeljeje të këtij afati;
 - iii) menaxhimin e rasteve të debitorëve, duke evidentuar shkaqet dhe duke propozuar zgjidhjet e duhura;
 - iv) auditin e brendshëm dhe kontrollin financiar nga strukturat përkatëse shtetërore dhe vendore.
- d) Mirëmbajtja e rrjeteve, sistemeve dhe pajisjeve, duke siguruar vendosjen në një vend të dukshëm të raportit vjetor të kontrollit të rrjeteve, sistemeve dhe pajisjeve, ku, sipas rastit, përfshihen:
- i) sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe i largimit të ujërave të ndotura;
 - ii) sistemi dhe pajisjet elektrike;
 - iii) sistemi i përqendruar i furnizimit me gaz;
 - iv) pajisjet individuale të gazit, që përdoren nga qiramarrësit;
 - v) ashensori.
- dh) Lidhja e kontratës së qirasë, ku përcaktohet afati kohor, masa e qirasë dhe kushtet e shfrytëzimit të banesës, si dhe të drejtat e detyrimet që burojnë nga standardet e menaxhimit të banesave me qira, të përcaktuara në këtë nen.

Neni 29

Lidhja e kontratës së qirasë

1. Kontrata e qirasë lidhet ndërmjet pronarit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij dhe, sipas rastit, individit përfitues ose, në rastin e familjeve, prej bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, në bazë të dispozitave të Kodit Civil.
2. Kontrata e qirasë lidhet me të drejtë ripërtëritje çdo vit, bazuar në dokumentimin zyrtar që vërteton të ardhurat e çdo individi të familjes.
3. Vërtetimi i të ardhurave, sipas rastit, merret nga qendra e punës ose personi juridik apo fizik që e ka punësuar, ose zyra përkatëse e ndihmës sociale pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, apo Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Në rastin e individëve pa të ardhura apo me të ardhura të ulëta, shpenzimet për lidhjen e kontratës së qirasë përballohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
4. Çdo pjesëtar madhor i familjes vetëdeklaron të ardhurat e veta, sipas pikës 44, të nenit 2, të këtij ligji.
5. Nëse familja siguron një banesë tjetër, kryefamiljari detyrohet të bëjë njoftimin e menjëhershëm pranë entit menaxhues, nga i cili ka përfituar banesën me kontratë qiraje sociale. Afati i njoftimit për lirim e banesës përcaktohet në dispozitat e kontratës.
6. Me lidhjen e kontratës, qiramarrësi është i detyruar të paguajë një paradhënie, në formë garancie, në vlerën e një qiraje mujore. Vlera e garancisë zbritet nga qiraja e muajit të fundit të afatit të qirasë, përveç rasteve kur ajo duhet të përdoret për riparimet e nevojshme të banesës, të diktuar nga

dëmtimi i saj nga qiramarrësi ose përveç rasteve kur palët në kontratën e qirasë kanë parashikuar ndryshe. Për familjet pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulëta, paradhënia paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e cila kryen subvencionimin e qirasë për këto kategori.

Neni 30

Përcaktimi i qirasë

1. Kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore, ose kombinimi i të dyjave, masa e qirasë, e shprehur në lekë/m² sipërfaqe ndërtimi llogaritet nga struktura përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, brenda kufirit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Masa e qirasë miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas metodikës për llogaritjen, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Masa e qirasë vjetore nuk duhet të jetë më e madhe se 3 për qind e kostos së ndërtimit të banesës nga institucionet shtetërore, për banesat e reja, ose 3 për qind e vlerës së banesës së blerë në treg, përveç rastit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni.

4. Për objektet e dala jashtë funksionimit dhe ato të kthyer në fond banesash sociale me qira, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 6, të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet nga këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 2, të këtij neni, bazuar në vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre.

5. Kur banesat sociale me qira financohen sipas përcaktimeve në shkronjat “b” e “c”, të nenit 69, të këtij ligji, masa e qirasë përcaktohet nga subjektet që e kanë financuar dhe njësia e vetëqeverisjes vendore dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zbatohet projekti.

6. Masa e qirasë, e shprehur në lekë për metër katror, duhet të mbulojë kostot për administrim, mirëmbajtje, kosto operationale dhe kosto të investimit ose të shlyerjes së borxhit. Niveli i qirasë sociale nuk duhet të jetë më i lartë se niveli mesatar i qirasë në tregun e lirë.

7. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren për shfrytëzimin e banesave sociale me qira nga qiramarrësit, ku përcaktohen me hollësi të drejtat dhe detyrat e qiramarrësit dhe të entit menaxhues.

Neni 31

Zgjidhja e kontratës së qirasë nga qiradhënësi para afatit

1. Kontrata e qiramarrjes zgjidhet nga qiradhënësi, në mënyrë të njëanshme, para përfundimit të afatit të kontratës, nëse:

- a) qiramarrësi bën deklaram të rremë për të ardhurat;
- b) qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër;
- c) qiramarrësi ia ka lënë me qira një të treti;
- ç) qiramarrësi, pa arsye të justifikuar, nuk ka paguar qiranë për 3 muaj rresht;
- d) të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në pikën 1, të nenit 19, të këtij ligji.

2. Qiradhënësi duhet të njoftojë me shkrim qiramarrësin para zgjidhjes së kontratës, sipas kushteve dhe në adresën e përcaktuar në kontratën e qirasë.

3. Pas zgjidhjes së kontratës, qiramarrësi është i detyruar të bëjë lirim të banesës dhe t’ia dorëzojë pronarit në gjendjen dhe me inventarin që e ka marrë në dorëzim.

4. Në rast se qiramarrësi nuk përmbush detyrimet sipas shkronjës “ç”, pikës 1, të këtij neni, për shkaqe të tilla si: shpenzime të arsyeshme shëndetësore, papunësi e menjëhershme ose humbje e një pjesëtari të familjes, që siguronte të ardhurat dhe këto arsye nuk ndryshojnë me kalimin e tre muajve, qiramarrësi kalon në një nga programet e tjera të strehimit social. Detyrimet e pashlyera për tre muajt e fundit mbulohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Neni 32

Zgjidhja e kontratës së qirasë nga qiramarrësi para afatit

1. Qiramarrësi duhet të njoftojë me shkrim pronarin e banesës për zgjidhjen e kontratës përpara afatit, brenda 3 muajve para zgjidhjes së saj, në adresën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Pronari, nëpërmjet entit menaxhues, bën verifikimin e kushteve të banesës. Në rastet kur vërehen dëmtime të banesës dhe/ose pajisjeve që janë në pronësi të pronarit të BSQ-së, pronari mund të mbajë garancinë për kundërvlerën e dëmtimeve.

2. Në rastin e zgjidhjes së kontratës së qirasë para afatit, me kërkesën e qiramarrësit, garancia e paguar si paradhënie kthehet, me përjashtim të rastit kur qiramarrësi nuk ka përmbushur detyrimet sipas kontratës.

KREU V

SUBVENCIONI I QIRASË

Neni 33

Masa e subvencionit të qirasë

1. Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.

2. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Neni 34

Rregullat e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë

1. Subvencionimi i qirasë si rregull kryhet nga të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Subvencionimi i qirasë mund të bëhet edhe nga pushteti qendror, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 35, të këtij ligji.

2. Aplikimi i individit/familjes për të përfituar nga subvencionimi i qirasë do të bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve për subvencionimin e qirasë miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndërtohet banesa. Kur subvencionimi i qirasë financohet pjesërisht ose plotësisht nga qeverisja qendrore, lista e përfituesve, e miratuar nga bashkia, i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehimin, e shoqëruar me kërkesën për financim.

3. Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme:

- a) individët me statusin e jetimit;
- b) personat me aftësi të kufizuara;
- c) të moshuarit;
- ç) invalidët e punës;
- d) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- dh) emigrantët e rikthyer;
- e) punëtori emigrant;
- ë) azilkërkuesit;
- f) familjet e komunitetit rom;
- g) familjet e komunitetit egjiptian;
- gj) Viktimat e dhunës në familje;
- h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
- i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë;

j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimë për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individë nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji;

k) të miturit, 14–18 vjeç, dhe të rinjtë, 18–21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri;

l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara;

ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012.

Radha e përparësisë së këtyre kategorive përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 35

Administrimi i kërkesave për planifikimin e fondeve nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë

1. Brenda muajit nëntor të çdo viti rishikohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikimet dhe dokumentacioni i nevojshëm, i përditësuar, për risubvencionim për vitin pasardhës nga përfituesit ekzistues dhe i përcillen ministrisë përgjegjëse për strehimin.

2. Kërkesat e aplikuesve të rinj, për përfitimin e subvencionimit, mund të paraqiten në çdo kohë gjatë vitit, por jo më vonë se muaji nëntor për vitin pasardhës.

3. Rregullat për administrimin e kërkesave të njësisë së vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit mbi subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social

1. Subvencionimi i qirasë për banesat bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me miratimin e këshillave të njësisë së vetëqeverisjes vendore të veta, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur:

- a) nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg;
- b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave;
- c) familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe kur nuk përfiton nga një program tjetër.

2. Bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se:

a) familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira, e cila ndodhet pranë vendit të punës, shkollës së fëmijëve, qendrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera;

b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është sipas pikës 5, të nenit 30, të këtij ligji.

Neni 37

Administrimi i subvencionit të qirasë në pronësi të pronarit social

1. Subvencioni paguhet drejtpërdrejt në llogari të pronarit, ndërsa qiramarrësi përfiton vetëm të drejtën për të përdorur banesën me qira.

Subvencioni i qirasë jepet me miratimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje

me buxhetin që jepet çdo vit për subvencionimin e qirave, sipas nenit 33, të këtij ligji, dhe bazuar në kriteret që duhet të plotësojë familja për të përfituar subvencionimin e qirasë sipas këtij ligji.

2. Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara në pikën 3, të nenit 34, të këtij ligji, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyra e llogaritjes së subvencionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Përcaktimi i vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë

1. Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm, dhe miratohet me vendim të Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes.

3. Mënyra e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Procedura e subvencionit të qirasë së banesave në pronësi të pronarit social

1. Brenda një muaji nga data e miratimit nga komisioni i strehimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore të listës së individëve/familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë së banesave në treg të lirë, subjekti përfitues depoziton pranë komisionit të strehimit kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet tij dhe pronarit social.

2. Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë. Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

3. Pas depozitimit të kontratave të qirave të subjekteve përfituese, komisioni i strehimit i përcjell Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore listën dhe kontratat e qirasë, me qëllim që ai të vendosë miratimin e vlerave konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues. Mbledhja e Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore zhvillohet jo më vonë se një muaj nga data kur mbërrijnë listat e miratuara nga komisioni i strehimit.

4. Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga data e lidhjes së kontratës, pavarësisht nga data e miratimit të vlerës së subvencionit për përfituesin konkret.

5. Subvencioni i qirasë rinovohet çdo vit, sipas kontratës së qirasë dhe të ardhurave të deklaruar të familjes, sipas përcaktimeve në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 29, të këtij ligji.

6. Subvencioni i qirasë e humbet vlefshmërinë kur kontrata zgjidhet sipas përcaktimit të nenit 32 të këtij ligji.

KREU VI

PROGRAMI PËR PËRSHTATJEN E PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË OBJEKTEVE DHE BANESAVE

Neni 40

Kuptimi dhe qëllimi

1. Programi për përshtatjen e objekteve, pronë shtetërore, nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njërive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit, për t'i kthyer ato në banesa, me qëllim strehimin. Procesi i kthimit të këtyre objekteve në fond banese miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësisë të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit për këtë qëllim.

3. Me përmirësim të kushteve të banesave ekzistuese dhe, nëse është e nevojshme, deri në ndërtim të ri, kuptohet tërësia e punimeve që duhet të kryhen, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas kushteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 41

Objektet/banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve

1. Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri, janë:

- a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;
- b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

2. Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 42

Instrumentet e programit të kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese

1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për:

- a) përmirësimin e kushteve të banimit e jetesës, deri në ndërtim të ri, për banesat në rrezik shembjeje;
- b) përmirësimin e kushteve të banimit në banesat e amortizuara;
- c) rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cilat nuk klasifikohen si banesë, nga vetë familjet që nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin.

2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 43

Përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit

1. Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:

- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale;
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktimat të trafikimit /viktimat të mundshme të trafikimit;
- g) viktimat të dhunës në familje.

KREU VII
PROGRAMI I BANESAVE ME KOSTO TË ULËT (BKU)

Neni 44

Kuptimi i banesave me kosto të ulët

1. Banesë me kosto të ulët (BKU) konsiderohet banesa që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi, që është e paracaktuar për t'u disponuar në pronësi nga përfituesi, nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.

2. Banesat me kosto të ulët që sigurohen nëpërmjet ndërtimit, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku vlerat e tregut janë me të larta se kostoja e ndërtimit, shiten me çmim nën vlerën e tregut, por jo nën vlerën e koston së ndërtimit.

3. Në rastet kur vlera e banesës në tregun e lirë është më e ulët se kostoja e ndërtimit, këto banesa blihen dhe përfshihen në programin e BKU-së, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 45

Format e sigurimit dhe burimet e financimit

1. Banesat me kosto të ulët sigurohen nga subjekte publike ose private, nëpërmjet ndërtimit ose blerjes nga tregu.

2. Banesat me kosto të ulët mund të financohen me fondet e buxhetit të shtetit, me fondet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, fondet e institucioneve publike, nëpërmjet donacioneve e kredive dhe nëpërmjet nxitjes së nismës private. Forma dhe procedurat e nxitjes së nismës private dhe të bashkëpunimit me sektorin privat rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar.

3. Normat dhe standardet e banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët konkrete në varësi të nivelit të të ardhurave të tyre, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për lehtësimin e blerjes së BKU-së nga përfituesi përdoren instrumentet financiare të mëposhtme:

- a) granti i menjëhershëm; dhe/ose
- b) subvencioni i interesave të kredive.

Neni 46

Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët

1. Përfitojnë grant të menjëhershëm familjet të cilat kanë në përbërje:

- a) një person me aftësi të kufizuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në nënndarjen "i", të shkronjës "c", të nenit 16, të këtij ligji, për këto kategori;
- b) një individ me statusin e jetimit, i cili, në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç;
- c) kryefamiljarin e vetëm, në rastin kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç;
- ç) familjet e komunitetit rom dhe egjiptian.

2. Shuma e grantit të menjëhershëm, që përfiton individi, është në masën 10 për qind të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

3. Granti i menjëhershëm për kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, akordohet nga buxheti i shtetit, sipas procedurave, kriterëve dhe përparësive që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47

Subvencionimi i interesave të kredive

1. Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese nga një institucion financiar, që ka lidhur marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për strehimin, ministrinë përgjegjëse për financën ose me njësinë e vetëqeverisjes vendore.

2. Financimi nga buxheti i shtetit dhe/ose i njësive të vetëqeverisjes vendore jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje, të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë dot pagesat e kredisë për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në atë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit. Masa e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurat e dhënies së saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kushtet e dhënies së kredisë për familjet përfituese përcaktohen me marrëveshje të përbashkët të institucionit financiar dhe ministrit përgjegjës për strehimin ose, sipas rastit, të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucionit që jep e menaxhon kredinë.

4. Masa e subvencionit, që rezulton në fund të periudhës së maturimit të kredisë, nuk duhet të kalojë më shumë se 100 për qind të vlerës së banesës. Në rast se nga llogaritjet rezulton një subvencion më i madh për përballimin e kësteve të kredisë, ose kur kësti i kredisë edhe pas subvencionit të interesave të kredisë është i papërballueshëm, sipas kuptimit të nenit 3, të këtij ligji, familja përzgjidhet për t'u trajtuar në njërin nga programet e tjera sociale të strehimit.

Neni 48

Përfituesit nga programi i banesave me kosto të ulët

1. Përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët familjet me të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 45, shkronja "a", e këtij ligji, të cilat, në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore:

a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje apo sëmundje e rëndë) ose force madhore;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;

c) janë të zhvendosura nga banesat, sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij ligji.

2. Kur përfitues është një familje që ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale nga procesi i privatizimit ose nëpërmjet blerjes në tregun e lirë dhe sipërfaqja e banimit është nën normat e strehimit, bëhet shkëmbimi i banesës nën normë për të marrë një banesë në normat e nevojshme të strehimit, duke u llogaritur diferenca ndërmjet vlerës së banesës ekzistuese me vlerën e banesës me kosto të ulët që merr. Banesa ekzistuese nën normë bëhet pjesë e fondit publik të banesave dhe vihet në dispozicion të programit të banesave me kosto të ulët.

3. Normat e strehimit, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, edhe procedura e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Administrimi i kërkesave për këto banesa bëhet nga strukturat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 49

Kufizimet

1. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët, nuk mund t'i kalojë të drejtat që ajo ka mbi këtë banesë të një individ tjetër ose ta lëshojë atë me qira gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.

2. Familja, që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer kredinë, duke u bërë pronare e saj, në rast tjetërsimi të banesës humbet të drejtën për të përfituar nga programet e strehimit për një

periudhë 10-vjeçare, me përjashtim kur e tjetëron banesën për arsye madhore, si vdekje apo sëmundje e rëndë.

3. Nëse, për arsye madhore, si vdekje apo sëmundje e rëndë, familja që ka përfituar banesë me kosto të ulët e tjetëron atë, i lind e drejta për të aplikuar në një nga programet e strehimit.

KREU VIII PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E ZONËS ME QËLLIM STREHIMI

Neni 50

Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bazë të përcaktimit të zonave të banimit, dokumenteve të planifikimit qendror e vendor, vlerësimit të nevojave për strehim social dhe kërkesave për ndërtim banesash sociale, planifikojnë sipërfaqet e nevojshme të truallit për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin.

2. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin bëhet për ndërtimin e banesave sociale, në bazë të dokumenteve të planifikimit qendror e vendor.

3. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin përfshin hartimin dhe miratimin e projektit të ndërtimit, deri në përfundimin e tij.

4. Zhvillimi i zonës, sipas pikës 3, të këtij neni, bëhet me investimet nga buxheti i shteti, buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe/ose në bashkëpunim me sektorin privat, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimin realizohet në troje që janë pronë e shtetit ose private.

6. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin mund të zbatohet edhe në zonat:

- a) me ndërtime të palegalizuara, që nuk mund të legalizohen;
- b) me ndërtime të papërfunduara, të identifikuar si të tilla nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- c) e vjetra industriale, jofunksionale, të zëna nga individë të pastrehë, pa autorizime përkatëse për strehim.

7. Trualli i pajisur me infrastrukturë, pjesë e zhvillimit të një zone me qëllim strehimin, mund t'u ofrohet për ndërtim, pa shpërblim, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, edhe familjeve përfituese që marrin përsipër të ndërtojnë banesën mbi të me shpenzimet e tyre, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 51

Përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin

1. Përparësi në përfitimin nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin kanë familjet/individët e pastrehë, të cilët, në zonën përkatëse, e kanë siguruar strehimin në:

- a) ndërtime të palegalizuara, që nuk mund të legalizohen;
- b) zonat e vjetra industriale, jofunksionale, të zëna nga individë të pastrehë, pa autorizime përkatëse për strehim.

2. Kriteret për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, me qëllim strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Partneriteti publik-privat për ndërtime në zona të zhvilluara me qëllim strehimin

1. Ndërtimi i banesave në kuadrin e partneritetit publik-privat bazohet, por pa u kufizuar, në parimet e mëposhtme:

a) parimin e kthimit të investimit subjektit privat dhe një fitim të arsyeshëm për një periudhë kohore të caktuar;

b) alokimin e risqeve, sipas parimit se pala, e cila do të mbajë riskun, është ajo e cila është në pozitë më të mirë për të përballuar riskun dhe/ose për të minimizuar pasojat e tij;

c) vlerësimin e drejtë të përfitimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në favor të realizimit të programeve sociale të strehimit, nëpërmjet përcaktimit të vlerës më të mirë për para.

2. Marrëveshja për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet partneritetit publik-privat, bazohet në një nga format e mëposhtme:

a) financimi i ndërtimit nga subjekti privat në truallin ose truallin e pajisur me infrastrukturë në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në këmbim të përfitimit nga njësia vendore të një përqindjeje të caktuar sipërfaqe ndërtimi, të përshtatur në apartamente, sipas normave të strehimit, si kundërvlerë e vlerës së truallit të pajisur me infrastrukturë. Vlera e truallit që do të shkëmbehet me sipërfaqe ndërtimi, vlerësohet me vlerat e tregut nga ekspertë të licencuar;

b) financimi i ndërtimit nga subjekti privat dhe shfrytëzimi si banesa sociale me qira për një periudhë kohe të përcaktuar në marrëveshje midis financuesit dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në përfundim të afatit të marrëveshjes, çështjet mbi pronësinë e banesave sociale rregullohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjes së partneritetit publik-privat;

c) bashkëfinancim i ndërtimit nga subjekti privat dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nga buxheti i vet dhe/ose me mbështetje të buxhetit të shtetit, përkundrejt përfitimit të një numri banesash sociale dhe ose me kosto të ulët.

3. Procedura e përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas formës së përcaktuar në pikën 2, shkronjat “a” dhe “c”, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas formës të përcaktuar në pikën 2, shkronja “b”, të këtij neni, kushtet e përgjithshme të marrëveshjes midis palës publike dhe asaj private, përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet /partneritetin publik privat. Referuar kësaj pike, projektet propozohen vetëm në formën e propozimeve të kërkuara.

Neni 53

Administrimi i programit të zhvillimit të zonës me qëllim strehimin

1. Ministria përgjegjëse për strehimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë për përcaktimin e standardeve dhe të modaliteteve të realizimit të programit të zhvillimit të zonës me qëllim strehimin me pronarin e truallit, kur ofrohet nga privati.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore ka kompetencën për të rregulluar përdorimin e tokës në juridiksionin e saj, me qëllim zhvillimin e zonës, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për strehimin.

KREU IX

PROGRAMI I STREHËVE TË PËRKOHSHME

Neni 54

Strehët e përkohshme dhe rastet e përdorimit

1. Strehët e përkohshme janë objekte ose pajisje që montohen dhe çmontohen lehtë dhe që shërbejnë për strehim të përkohshëm. Me strehim të përkohshëm kuptohet strehimi për një afat deri në dy vjet. Menjëherë me strehimin në strehët e përkohshme, përfutjesit e këtij programi duhet të aplikojnë në programet e tjera sociale të strehimit.

2. Strehët e përkohshme shërbejnë për strehimin e:

- a) refugjatëve;
- b) individëve që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të fatkeqësive natyrore a njerëzore;
- c) individëve që zhvendosen për shkak të investimeve publike ose private dhe nuk përfitojnë kompensim, vetëm në ato raste kur njësisë e vetëqeverisjes vendore dëshmon se nuk disponon asnjë alternativë tjetër strehimi në kuadër të programeve të tjera të strehimit social;
- ç) emigrantëve të rikthyer;
- d) personave të pastrehë, që banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim.

Neni 55

Kushtet që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme

1. Strehët e përkohshme vendosen në vende të përshtatshme, të pastra e të sigurta nga përmytjet dhe rreziqe të tjera.
2. Strehët e përkohshme sigurojnë mbrojtjen e duhur nga kushtet atmosferike. Zonat në të cilat instalohen strehët e përkohshme duhet të jenë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme, tualete dhe dushe.
3. Kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për strehimin.

Neni 56

Burimet e financimit të strehëve të përkohshme

1. Strehët e përkohshme financohen me fondet e buxhetit të shtetit, me fondet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet donacioneve e kredive të institucioneve publike ose private, vendase apo të huaja.
2. Sigurimi i strehëve të përkohshme bëhet nga institucionet publike ose private, nëpërmjet ndërtimit, instalimit ose blerjes së objekteve apo pajisjeve.

Neni 57

Administrimi dhe mirëmbajtja e strehëve të përkohshme

1. Ndërtimi, instalimi dhe ngritja e strehëve të përkohshme sigurohen nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me subjektet ose institucionet publike apo private që financojnë ngritjen e tyre.
2. Përcaktimi i institucioneve publike që administrojnë strehët, i kriterëve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Institucionet publike, të ngarkuara për administrimin e strehëve të përkohshme dhe mirëmbajtjen e tyre, mund të lidhin kontrata me subjekte publike ose subjekte private fitimprurëse ose jofitimprurëse.
4. Procedurat që lidhen me administrimin dhe mirëmbajtjen e strehëve të përkohshme, kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU X

PROGRAMI I BANESAVE TË SPECIALIZUARA

Neni 58

Kuptimi dhe qëllimi

1. Banesat e specializuara janë banesat në të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore adresojnë një nevojë specifike strehimi, në të cilat përfshihen banesat për:

- a) të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara;
- b) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
- c) viktimat e dhunës në familje;
- ç) fëmijët, të cilët janë pa kujdes prindëror ose janë marrë në mbrojtje nga institucionet shtetërore dhe që përgatiten për të kaluar në jetën e pavarur, të miturit nga 14–18 vjeç ose të rinjtë nga 18–21 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve që lidhen me drejtësinë penale;

d) vajzat nëna.

2. Kushtet dhe normat e projektimit të banesave të specializuara hartohen nga ministria përgjegjëse për strehimin, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 59

Banesat e specializuara për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara

1. Banesat e specializuara sociale për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme, të përshtatur dhe të aksesueshme për lehtësimin e sigurimin e marrjes së ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të njoftimit, në raste emergjencash.

2. Banesat e specializuara për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara jepen në uzufukt, me afat sa jetëgjatësia e përfituesve. Kur kjo kategori nuk ka të ardhura familjare /individuale, atëherë dhënia në uzufukt bëhet pa shpërblim.

3. Për banesat e kësaj kategorie parashikohen në katet e para mjedise të nevojshme për fizioterapi, shërbime mjekësore, shërbime sociale, si dhe mjedise të përbashkëta për jetë komunitare.

Neni 60

Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje

1. Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje pajisen me shërbimin e punonjësve të specializuar socialë dhe u garantohe mbrojtje nga punonjësit e Policisë së Shtetit në rastet e rrezikut për jetën dhe shëndetin.

2. Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë, në raste rreziqesh ose emergjencash.

3. Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje jepen me qira, duke iu nënshtruar respektimit të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga programi i banesave sociale me qira, i parashikuar në këtë ligj. Këto kategori përfitojnë nga programi i banesave të specializuara derisa t'u sigurohet përfitimi nga një prej programeve të tjera sociale të strehimit.

Neni 61

Banesat e specializuara për të miturit 14–18 vjeç ose të rinjtë 18–21 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve rehabilituese

1. Banesat e specializuara për të miturit nga mosha 14 deri në 18 vjeç, pas lirimit ose kryerjes së programeve rehabilituese, përdoren në rastet kur nga organet kompetente vendoset se rikthimi i tyre në familje rrezikon kryerjen e së njëjtës vepre penale apo të një vepre tjetër penale.

2. Banesat e specializuara për të miturit, sipas pikës 1, të këtij neni, pajisen me shërbimin e kujdestarisë për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre për arsimim, shëndetësi, mirërritje, punësim, me qëllim integrimin dhe rishoqërimin në komunitet.

3. Banesat e specializuara për të rinjtë nga 18–21 vjeç jepen me qira, në rastin kur këta nuk kanë banesë ose kur referohet nga shërbimet sociale dhe shërbimi i provës që të jetojnë veçmas nga familjet

e tyre. Në rastin kur të rinjtë nuk janë në marrëdhënie pune, banesa jepet në huapërdorje derisa njësia e vetëqeverisjes vendore të mund të sigurojë punësimin e tyre.

4. Në banesat e specializuara për të miturit dhe të rinjtë, të parashikuara nga ky nen, ofrohet shërbimi i psikologut ose punonjësit social, për të siguruar monitorimin e tyre, me qëllim integrimin dhe rishoqërimin në komunitet.

5. Banesat e specializuara sociale për të miturit (14–18 vjeç) dhe të rinjtë (18–21 vjeç) duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë në raste rreziqesh ose emergjencash.

Neni 62

Banesat e specializuara për vajzat nëna

1. Banesat e specializuara për vajzat nëna sigurojnë sistemimin në to të vajzave nëna gjatë dhe pas shtatzënisë, derisa fëmija të arrijë moshën 5 vjeç, kur ato janë nëna të vetme, nuk kanë mundësi strehimi, për shkak të mospranimit të gjendjes së tyre nga ana e familjarëve të tyre dhe kur nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të siguruar strehimin.

2. Banesat e specializuara për vajzat nëna duhet të pajisen me shërbimin e nevojshëm shëndetësor, të specializuar për kujdesin dhe mbrojtjen e shëndetit të nënës e të fëmijës dhe infrastrukturën përkatëse, si dhe me shërbimin e psikologut e të punonjësit social.

3. Banesat e specializuara për vajzat nëna jepen në huapërdorje ose uzufukt pa shpërblim, për një afat deri në 5 vjet, kur vajzat nëna nuk kanë të ardhura, ose me qira, për sa kohë janë të identifikuara si të tilla, duke iu nënshtruar respektimit të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga programi i banesave sociale me qira, të parashikuara në këtë ligj.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa për të ndërthtur programin e banesave të specializuara edhe me programe për sigurimin e mirërritjes së fëmijës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të kujdesen edhe për punësimin e vajzave nëna dhe sistemimin e fëmijëve të tyre në sistemin parashkollor publik.

5. Pasi fëmija arrin moshën 5 vjeç, vajzat nëna kalojnë nga programi i banesave të specializuara në një program tjetër social, që i përgjigjet gjendjes së tyre ekonomike dhe nivelit të të ardhurave që ato sigurojnë.

Neni 63

Mënyrat e financimit të programit të banesave të specializuara

1. Fondi i banesave të specializuara mund të sigurohet nëpërmjet investimit për ndërtim, blerjes në tregun e lirë ose marrjes me qira nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

2. Banesat e specializuara financohen me fondet e buxhetit të shtetit, të njërive të vetëqeverisjes vendore ose me bashkëfinancim, nëpërmjet donacioneve e kredive të institucioneve publike apo private.

3. Të ardhurat e grumbulluara nga qiratë e banesave të specializuara shkojnë në favor të këtij programi, për mirëmbajtjen e tyre.

Neni 64

Administrimi dhe mirëmbajtja

1. Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave të specializuara bëhen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin kontrata për mirëmbajtjen e banesave të specializuara me entet menaxhuese, si dhe me organizatat jofitimprurëse.

3. Mënyra e administrimit dhe e mirëmbajtjes përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministritë përgjegjëse për strehimin dhe ministritë përgjegjëse për çështjet sociale, veprimtaria e të cilave ndërthuret me kategoritë që përfshihen në këtë program dhe përfitojnë prej tij.

KREU XI

VERIFIKIMI I GJENDJES EKONOMIKE DHE SOCIALE TË FAMILJES

Neni 65

Mënyra e verifikimit

1. Mbështetja nga buxheti i shtetit dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore për përfituesit nga programet sociale të strehimit jepet pas verifikimit të gjendjes ekonomike e financiare të familjes..

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

Neni 66

Ankimi

1. Pas verifikimit nga administratorët shoqërorë, strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore njoftojnë zyrtarisht familjen për rezultatet e verifikimit të gjendjes ekonomike.

2. Kundër vendimit të administratorëve shoqërorë individ/familja ka të drejtë të ankohet brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit, pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar një rivlerësim të dytë. Vendimi i rivlerësimit merret nga kryetari dhe i njoftohet ankuesit.

3. Vendimi i rivlerësimit të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të ankimohet në gjykatën kompetente, në përputhje me afatet dhe procedurën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU XII

FINANCIMI I PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT

Neni 67

Burimet e financimit të programeve sociale të strehimit

Programet sociale të strehimit financohen nga:

a) fondet buxhetore, që jepen çdo vit për programe strehimi nga ministria përgjegjëse për strehimin;

b) fonde nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore;

c) kontribute dhe investime nga sektori privat ;

ç) kontributet nga donatorë të ndryshëm, vendas ose të huaj;

Neni 68

Programet 5-vjeçare të strehimit

1. Strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare strehimi për popullsinë nën juridiksionin e tyre, duke u mbështetur në analizën e nevojave për strehim dhe në përputhje me strategjinë e strehimit social, sipas parashikimeve të këtij ligji. Ky program miratohet nga këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Programet 5-vjeçare të strehimit përmbajnë:

a) burimet e financimit, që përfshijnë fonde nga buxheti i shtetit, fondet e siguruar nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, si dhe fonde nga burime të tjera, duke përcaktuar origjinën e tyre;

b) nevojat për strehim, sipas parashikimeve të këtij ligji, duke përcaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre sociale;

c) lidhjet e këtij programi me programe të tjera të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe mënyrën e ndikimit të tyre te njëra-tjetra;

ç) masën e rritjes së fondit publik të banesave, brenda një viti financiar, me ndërtesa që do të jepen me qira, uzufrukt ose huapërdorje, si dhe numrin dhe kategoritë e familjeve që do të përfitojnë banesa sociale me qira, uzufrukt ose huapërdorje;

d) numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët dhe mënyrat e bashkëpunimit me sektorin privat;

dh) masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndihmë të përfituesve për shlyerjen e qirave ose interesave të kredive me kushte lehtësuese;

e) numrin dhe sipërfaqet e trojeve të pajisura me plan zhvillimi, infrastrukturë për ndërtim banesash, numrin dhe llojin e banesave që do të ndërtohen, familjet që do të përfitojnë, formën e bashkëpunimit me sektorin privat, si dhe masën e përqindjen e kontribuesve;

ë) numrin e strehëve të përkohshme dhe të banesave të specializuara që do të ndërtohen ose do të vihen në dispozicion të përfituesve;

f) numrin e banesave ekzistuese ose të reja, që do të përfitojnë nga programi i granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të banimit;

g) numrin e banesave që do të përfitohen si rezultat i zbatimit të programit për zhvillimin e zonave me qëllim strehimin, për banesa sociale;

gj) numrin, vendndodhjen dhe profilin e familjeve që jetojnë në banesa që nuk mund të legalizohen dhe që preken nga investime publike ose private, sipas planeve rregulluese.

Neni 69

Kushtet për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore përfiton nga fondet e investimeve të buxhetit të shtetit për ndërtimin e banesave sociale dhe/ose atyre me kosto të ulët kur:

a) ka vlerësuar nevojat për strehim;

b) ka ngritur strukturën përgjegjëse për menaxhimin e strehimit ose ka përcaktuar përgjegjësitë në një nga strukturat;

c) ka hartuar programin 5-vjeçar të strehimit;

ç) ka parashikuar zonat e ndërtimit të banesave në instrumentin vendor të planifikimit urban;

d) ka dërguar informacionin vjetor me të dhënat, sipas shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 73, të këtij ligji.

2. Mënyra e aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit miratohen me udhëzim të ministrit të linjës, që ka në dispozicion fondet.

Neni 70

Mënyra e planifikimit

Fondet e buxhetit të shtetit dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për çdo program, ndahen në:

a) grante konkurruese për investime në ndërtim dhe/ose blerje trualli;

b) kredi afatgjata për investime në ndërtim dhe/ose blerje trualli;

c) subvencione për individë ose familje;

ç) fond për asistencë teknike;

d) fond për studime në fushën e projektimit e të ndërtimit për programe sociale strehimi.

KREU XIII
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL DHE AFATET E NGRITJES SË KAPACITETEVE
PËR ZBATIMIN E KËTIJ LIGJI

Neni 71

Këshilli Kombëtar për Strehimin

1. Këshilli Kombëtar për Strehimin (KKS) është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për strehimin.

2. Këshilli Kombëtar për Strehimin kryesohet nga ministri përgjegjës për strehimin dhe në përbërje të tij ka 7 anëtarë, prej të cilëve 2 janë anëtarë të ministrisë përgjegjëse për strehimin, 1 anëtar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, 1 anëtar nga ministria përgjegjëse për çështjet vendore, 1 anëtar përfaqësues nga grupet e interesit dhe shoqëria civile dhe 1 anëtar nga shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Strehimin është 4 vjet, me të drejtë riemërimi.

4. Këshilli Kombëtar për Strehimin mbledhet, të paktën, dy herë në vit dhe në ushtrimin e detyrave të tij mbështetet nga sekretariati teknik pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin.

5. Rregulla të hollësishme për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit, si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këshilli Kombëtar për Strehimin, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për strehimin, këshillon për:

a) linjat kryesore të ndërhyrjes në sektorin e strehimit, sipas objektivave të përcaktuar nga politika e strehimit dhe programet ekonomike kombëtare;

b) plotësimin e nevojave parësore për strehim;

c) kriteret e ndarjes së burimeve të financimit për programet sociale të strehimit, sipas këtij ligji;

ç) këshillon për programet kombëtare 5-vjeçare të strehimit dhe për rishikimin eventual të tyre. Programet kombëtare 5-vjeçare të strehimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 72

Funksionet e ministrisë përgjegjëse për çështjet e strehimit

Në zbatim të këtij ligji, ministria përgjegjëse për strehimin, nëpërmjet strukturës përkatëse:

a) harton strategjinë kombëtare 10-vjeçare të strehimit, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave;

b) përditëson planin e veprimit të strategjisë kombëtare 10-vjeçare të strehimit, në bazë të programeve 5-vjeçare të njërive të vetëqeverisjes vendore për strehimin;

c) planifikon fondet e buxhetit të shtetit për mbështetjen e realizimit të programeve vjetore të strehimit, bazuar edhe në kërkesat e njërive të vetëqeverisjes vendore;

ç) informohet për administrimin e kërkesave për strehim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) krijon bazën e të dhënave në nivel kombëtar, që përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për strehimin, për:

i) nevojat për strehim, me programe sociale strehimi;

ii) inventarin e banesave sociale me qira, pronë publike;

iii) kushtet fizike dhe teknike të banesave sociale me qira;

iv) numrin e familjeve të strehuara me programet sociale të strehimit;

v) sipërfaqen e nevojshme të truallit që duhet pajisur me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash;

vi) sipërfaqet e trojeve, të pajisura me infrastrukturë për ndërtim banesash;

dh) përcakton koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, në kuadër të programeve të këtij ligji, e cila miratohet çdo vit me udhëzim të Këshillit të Ministrave;

e) përcakton, çdo vit, shpërndarjen e fondeve që financohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera financimi;

ë) në përputhje me strategjinë 10-vjeçare të strehimit dhe planin e veprimit, drejton dhe ndjek mbështetjen e njësisë të vetëqeverisjes vendore për asistencën teknike, si dhe për studime e kërkime shkencore në fushën e projektimit dhe të ndërtimit për programe sociale strehimi;

f) mbikëqyr realizimin e investimeve në programet sociale të strehimit me financime ose bashkëfinancime nga buxheti i shtetit;

g) zbaton programe, sipas këtij ligji, nëpërmjet institucionit publik që themelohet, organizohet dhe funksionon me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 73

Funksionet e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për zbatimin e politikave të strehimit, sipas programit të parashikuar në këtë ligj.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e programeve të strehimit, sipas këtij ligji, kryen funksionet e mëposhtme:

a) Identifikon nevojat për strehim dhe miraton listat e përfituesve brenda një afati 2-mujor nga data e njoftimit nga ana e subjektit publik ose privat që ofron dhe realizon një nga programet sociale të strehimit, kur ky subjekt nuk është vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji.

b) Harton programe 5-vjeçare për strehimin, bazuar në burimet financiare që zotëron.

c) Planifikon fonde vjetore nga buxheti i saj për mbështetjen e realizimit të secilit program të strehimit, bazuar në kërkesat e qytetarëve.

ç) Evidenton sheshet e ndërtimit dhe përgatit listën e tyre, në zbatim të programeve të strehimit, të hartuara në bazë të këtij ligji.

d) Evidenton banesat në rrezik shembjeje dhe përgatit listën e tyre.

dh) Brenda muajit janar të çdo viti, paraqet pranë ministrit përgjegjës për strehimin kërkesën për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji, nga fondet e buxhetit të vitit korrent, shoqëruar me informacionin, i cili përmban:

i) numrin e familjeve të regjistruara për t'u trajtuar me programet sociale të strehimit;

ii) numrin e familjeve që janë trajtuar brenda një viti;

iii) të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore, që do të përdoren për programet sociale të strehimit në vitin pasardhës, dhe sasinë e fondeve që kërkohet nga buxheti i shtetit, në bazë të programit 5-vjeçar të strehimit;

iv) sipërfaqet e trojeve, të miratuara për programet sociale të strehimit;

v) nivelin e qirasë së miratuar me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

e) Krijon bazën e të dhënave, në nivel vendor, për aplikimet e bëra për programet sociale të strehimit, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për strehimin.

ë) Krijon dhe administron, në nivel vendor, bazën e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim, sipas këtij ligji.

f) Përcakton kostot maksimale të lejueshme, brenda kufijve të përcaktuar nga ministri përgjegjës për strehimin, për ndërtimin e banesave, sipas këtij ligji.

g) Siguron ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira.

gj) Organizon fushata të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve për mundësitë që ofrohen nga programet sociale të strehimit.

h) Merr masa për publicitetin dhe transparencën e organizimit të procedurave që lidhen me zbatimin e programeve të banesave sociale.

i) Njofton, çdo vit, ministrin përgjegjës për strehimin për ecurinë e programeve të strehimit, sipas këtij ligji.

j) Kryen të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në këtë ligj.

3. Organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë planin e veprimit dhe projektbuxhetin përkatës për zbatimin e programeve afatgjata të strehimit.

4. Kryetari dhe këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të kryejnë, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, detyrimet dhe të përmbushin kompetencat e tyre.

5. Në rastet kur programi i strehimit financohet plotësisht ose pjesërisht me fondet e buxhetit të shtetit dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk përmbush detyrimin e dakordësuar në marrëveshjen e posaçme, zbatimi i programeve të strehimit për afatin e marrëveshjes i kalon ministrisë përgjegjëse për strehimin.

6. Procedurat për zbatimin e pikës 5, të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Neni 74

Ngritja e kapaciteteve dhe afatet

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve në këtë ligj, krijon strukturën përgjegjëse dhe të qëndrueshme për zbatimin e këtij ligji, bazuar në burimet financiare e njerëzore në dispozicion të saj.

2. Ministria përgjegjëse për strehimin, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, harton dhe miraton programet e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore, në zbatim të këtij ligji.

3. Ministria përgjegjëse, sipas pikës 2, të këtij neni, në bashkëpunim me institucionet vendase e të huaja dhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Strehimit, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, realizojnë fazën e parë të trajnimit për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, pas 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, plotësojnë detyrimet sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 73, të këtij ligji.

KREU XIV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75

Rimbursimi në rastin e përfitimit të padrejtë

1. Individit/familja që ka përfituar nga programet e strehimit, duke paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, ose në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë ligj, detyrohet të rimbursojë shumën e përfituar padrejtësisht. Pavarësisht nga rimbursimi i kësaj shume, njësia e vetëqeverisjes vendore bën kallëzim penal, kur konstaton se ka elemente të veprës penale.

2. Rimbursimi i shumës së përfituar padrejtësisht, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet sipas kërkesës së njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në rast të moskzekutimit vullnetar, njësia e vetëqeverisjes vendore paraqet kërkesëpadi në gjykatën kompetente, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 76

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, 13, 14, 16, 21, 30, 35, 37, 45, 46, 48, 51, 52, 57, 58, 71, 73 dhe 77 të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për strehimin, ministri përgjegjës për çështjet vendore dhe ministri përgjegjës për çështjet sociale për nxjerrjen e akteve përkatëse nënligjore, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Dispozita kalimtare

1. Privatizimi i banesave apo objekteve të kthyer në fond banese bëhet bazuar në sipërfaqet e banimit, të përcaktuara për normat e strehimit. Çdo sipërfaqe e përfutur mbi atë të normave të strehimit do të llogaritet me çmim tregu. Këtu përfshihen:

a) banesat, që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, si dhe i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”, të cilat nuk janë regjistruar në ZVRPP;

b) objektet që kanë mbetur të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura. Përshtatimisht për ushtarakët dhe ish-ushtarakët e Forcave të Armatosura, sipërfaqja mbi normat e strehimit trajtohet njëjloj si sipërfaqja brenda normave të strehimit.

Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve për privatizim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) banesat dhe objektet e kthyer në fond banese me vendime të organeve të vetëqeverisjes vendore, ato që kanë kaluar në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, si dhe ato që figurojnë ende në pronësi të shtetit, ku, me autorizime të dhëna nga organet kompetente, janë sistemuar me strehim banorët përpara vitit 2004;

ç) banesat dhe objektet e kthyer në fond banese me vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat i kanë kaluar në administrim Entit Kombëtar të Banesave me qëllim privatizimin e tyre.

2. Banesat e ndërtuara me fonde publike nga Enti Kombëtar i Banesave, të cilat deri në fund të vitit 2007 rezultojnë me kontrata të palidhura dhe kanë kaluar në pronësi të organeve të vetëqeverisjes vendore ku ato ndodhen, do të përdoren në funksion të njërit prej programeve sociale të strehimit ose për privatizim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kur këto banesa nuk kanë kaluar në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore, ato mbeten në pronësi të EKB-së dhe do të përdoren në funksion të njërit prej programeve sociale të strehimit ose për privatizim.

3. Rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit, sipas pikave 1 e 2, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Banesat e ndërtuara për familjet e shpërngulura për shkak të ndërtimit të veprave publike, të tilla si Hidrocentrali i Banjës, Hidrocentrali i Fierzës, të cilat ende figurojnë të paprivatizuara, privatizohen falas, me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe sipas listës emërore që kanë trashëguar.

5. Familjeve të shpërngulura për shkak të ndërtimit të veprave publike dhe në pamundësi financiare, të cilat kanë përfutur kredi nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, u falen detyrimet monetare, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

6. Për objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, kalimi i së drejtës së pronësisë mbi objektin dhe truallin realizohet pa pagesë nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat dhe afatet që ndiqen nga ALUIZNI për kalimin e së drejtës së pronësisë.

7. Banesat e ndërtuara me fonde publike nga Enti Kombëtar i Banesave ose të transferuara nga të tretët tek enti, të cilat nuk janë pajisur me dokument pronësie, trajtohen sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, nga ALUIZNI, dhe regjistrohen në emër të EKB-së. Pas regjistrimit, EKB-ja mund të ndjekë procedurat e privatizimit ose mund t’i përdorë në funksion të programeve sociale të strehimit.

8. Familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, që nuk përfitojnë kredi me interes 0 për qind, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012, trajtohen me prioritet, me një nga programet e strehimit social, të parashikuara në këtë ligj.

9. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe deri në dy vjet pas hyrjes së tij në fuqi, parashikojnë që në programet sociale të strehimit jo më pak se 5 për qind e vendeve nga çdo

program, për çdo vit brenda kësaj periudhe, të plotësohen nga familje të komuniteteve rome e egjiptiane. Familjet e komuniteteve rome dhe egjiptiane konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit për të gjitha kriteret e parashikuara në ligj, si dhe për përparësitë ose pikëzimet e vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të këtij ligji, deri në dy vjet nga hyrja në fuqi e tij. Me përfundimin e afatit të përcaktuar, ai do të rivlerësohet në përputhje me politikat qeveritare të përfshirjes sociale ndaj këtyre komuniteteve.

10. Programet që janë në proces në zbatim të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, si dhe ato që do të zbatohen me fondet e planifikuara për vitin 2018 dhe 2019, do të trajtohen sipas dispozitave të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 78

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 79

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.5.2018

KAPITULLI IV
ARSIMI, SPORTI DHE SHËRBIMET ARGËTUESE

LIGJ
Nr. 69/2012

PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË²⁰

(Ndryshuar me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti, qëllimi dhe fusha e zbatimit të ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.
2. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.
3. Fusha e zbatimit të këtij ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 2

Përkufizime

(Ndryshuar pikat 8, 10, 12 dhe 19, shtuar pika 23 me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arsimi parauniversitar” përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas “Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit”, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht:
 - a) “Niveli me kodin 0”, arsimi parashkollor;
 - b) “Niveli me kodin 1”, arsimi fillor;
 - c) “Niveli me kodin 2”, arsimi i mesëm i ulët;
 - ç) “Niveli me kodin 3”, arsimi i mesëm i lartë.

²⁰ Ky ligj është përafuar plotësisht me: Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000, Numri CELEX 32000X1218(01) Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria C, Nr 364, datë 18.12.2000, faqe 1-22.

Ligji nr. 69/2012, datë 21.6. 2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 26 korrik 2012.

Ligji nr. 56/2015, datë 28.5.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 23 qershor 2015.

2. “Arsim në distancë” është mënyrë arsimimi, ku pjesa më e madhe e procesit mësimor kryhet kur mësuesi dhe nxënësi nuk janë zakonisht në të njëjtin vend e në të njëjtën kohë dhe realizohet kryesisht me ndihmën e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit.
3. “Fushë e të nxënit” është një lëndë ose bashkësi lëndësh që shqyrtojnë realitetin nga këndvështrime të caktuara.
4. “Gjimnaz” është shkolla e mesme e përgjithshme.
5. “Institucion arsimor” është kopshti ose shkolla.
6. “Institucion arsimor plotësues” është institucioni që pasuron përvojat mësimore dhe jetësore të nxënësve.
7. “Këshilli i prindërve” është organ i përbërë nga përfaqësues të prindërve të nxënësve të institucionit arsimor.
8. “Kurrikula” është sistem i përbërë nga disa elemente, si: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet mësimore, vlerësimi, që, të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohej dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore.
9. “Kornizë kurrikulare” është dokumenti themelor i kurrikulës, ku përshkruhen synimet e përgjithshme të saj, kompetencat themelore, rezultatet e pritshme për nxënësit, për sa i përket dijeve, aftësive dhe qëndrimeve në fund të arsimit bazë dhe atij të mesëm të lartë, synimet e fushave të të nxënit dhe parimet e përgjithshme të procesit të mësimdhënies e nxënies e të vlerësimit të nxënësve.
10. “Kompetenca themelore” është kompetenca, për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje shoqërore dhe për punësim.
11. “Kopsht” është institucioni arsimor që ofron shërbim arsimor të nivelit me kodin 0.
12. “Kurrikula bërthamë” është kurrikul e përbashkët për të gjithë nxënësit e një niveli në sistemin arsimor.
13. “Ministri” është ministri që mbulon çështjet e arsimit parauniversitar.
14. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e arsimit parauniversitar.
15. “Mësues” është personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesisë në arsimin parauniversitar.
16. “Nxënës” është personi që arsimohet në arsimin parauniversitar.
17. “Nxënës me aftësi të kufizuara” është personi, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.
18. “Partner social” janë sindikatat, me të cilat ministri nënshkruan kontratën kolektive të punës.
19. “Program mësimor” është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënit, metodologjitë e të nxënit dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.
20. “Shkollë” është institucioni që ofron shërbim arsimor për nivelet me kodet 1, 2, 3.
21. “Shkollë private” është shkolla jopublike, e cila nuk themelohet, financohet dhe administrohet nga qeveria qendrore ose vendore.
22. “Veprimtari plotësues” janë veprimtaritë që planifikohen nga institucioni arsimor dhe kanë për qëllim pasurimin e përvojave mësimore e jetësore të nxënësve.
23. “Tekst shkollor” është teksti që përdoret në procesin e të nxënit si një nga burimet e dijes dhe të informacionit, në format të printuar dhe/ose digjital, i hartuar sipas kërkesave të programit mësimor të një fushe të nxëni, nga botues privatë dhe institucione publike me të drejtë botimi, i certifikuar nga ministria.

Neni 3

Qëllimi i sistemit arsimor parauniversitar

(Ndryshuar me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

1. Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit:

- a) të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike;
- b) të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme;
- c) të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

2. Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- a) kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- b) përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- c) zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- ç) zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- d) aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- dh) aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- e) zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- ë) përdorin teknologjitë e reja.

Neni 4

Kuadri rregullator dhe mbështetës i sistemit arsimor

Sistemi arsimor parauniversitar mbështetet në traditën e arsimit shqiptar, funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin shqiptar në fuqi dhe zhvillohet sipas vlerave të përbashkëta të sistemeve arsimore bashkëkohore.

Neni 5

E drejta për arsimim

1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

2. Në shkollat publike arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i lartë janë falas.

Neni 6

Parime të përgjithshme

1. Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor.

2. Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.

3. Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.

4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.

5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

7. Veprimtaria e institucioneve në sistemin arsimor parauniversitar dhe e punonjësve të tyre është transparente dhe e bazuar në llogaridhënie ndaj përfituesve të shërbimit arsimor.

8. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e nxënësve, e punonjësve arsimorë, e prindërve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë, më poshtë “prindër”, për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t’u dëgjuar për këto pikëpamje.

9. Sistemi arsimor parauniversitar funksionon mbi bazën e decentralizimit dhe autonomisë së institucioneve arsimore.

10. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e organizimit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit.

11. Shërbimi arsimor mbështetet dhe vlerësohet mbi bazën e standardeve. Vlerësimi është i brendshëm dhe i jashtëm.

Neni 7 **Laiciteti**

1. Arsimi parauniversitar është laik.

2. Përjashtim bëjnë ato institucione arsimore që themelohen nga bashkësi fetare të njohura me ligj, sipas përcaktimeve të nenit 42 pika 4 të këtij ligji.

Neni 8 **Depolitizimi**

Arsimi parauniversitar është i depolitizuar.

Neni 9 **Gjuha e arsimimit**

Në institucionet arsimore, gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj.

Neni 10 **Arsimimi për pakicat kombëtare**

1. Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore.

2. Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare.

3. Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor përcaktohen me akte të veçanta të ministrit.

Neni 11 **Arsimimi për fëmijët shqiptarë jashtë vendit**

Ministria, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe institucione të tjera shtetërore, mbështet zbatimin e programeve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët e diasporës, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 12
Arsimimi në dy gjuhë

Arsimimi në dy gjuhë në arsimin e mesëm të lartë realizohet sipas marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

Neni 13
Kompetencat themelore
(Ndryshuar me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

Kompetencat themelore për të gjithë nxënësit janë:

- a) kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- b) kompetenca e të menduarit;
- c) kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
- ç) kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
- d) kompetenca personale;
- dh) kompetenca qytetare;
- e) kompetenca digjitale.

KREU II
INSTITUCIONET ARSIMORE DHE FORMAT E ARSIMIMIT

Neni 14
Institucionet në sistemin arsimor parauniversitar

Në sistemin arsimor parauniversitar funksionojnë kopshtet, shkollat dhe institucionet plotësuese, të cilat janë publike ose private.

Neni 15
Qendrat kulturore të fëmijëve

Qendrat kulturore të fëmijëve janë institucione plotësuese, të cilat janë në varësi të njërive të qeverisjes vendore dhe hapen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16
Format e arsimimit

Format e arsimimit në shkolla janë:

- a) arsimim me kohë të plotë;
- b) arsimim me kohë të pjesshme;
- c) arsimim në distancë.

Neni 17
Arsimimi në kushtet e shtëpisë

Arsimimi në kushtet e shtëpisë ofrohet në raste të veçanta, për të gjitha klasat e arsimit bazë ose vetëm për disa prej tyre. Ministri përcakton rastet e veçanta, kriteret dhe procedurat për arsimimin në kushtet e shtëpisë.

Neni 18

Arsimimi në institucionet joshkollore

Ministria, në bashkëpunim me organet përkatëse, siguron arsimimin për individët e moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit dhe në institucione të përkujdesjes shoqërore.

Neni 19

Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve

Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore

1. Njësitë arsimore vendore u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore.

2. Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

KREU III

NIVELET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 21

Arsimi parashkollor

1. Arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor.

2. Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga tre deri në gjashtë vjeç. Fëmijëve të moshës pesë vjeç u mundësohet ndjekja e klasës përgatitore edhe pranë shkollave të arsimit bazë, me synim integrimin në arsimin e detyruar.

Neni 22

Arsimi bazë

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

1. Arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës.

2. Arsimi bazë përfshin arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët. Arsimi fillor përbëhet nga pesë klasa, nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Arsimi i mesëm i ulët përbëhet nga katër klasa, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë.

3. Shkollat e arsimit të orientuar mund të nisin në klasa të caktuara të arsimit bazë, duke siguruar formimin e mjaftueshëm të nxënësve në lëndët e kulturës së përgjithshme.

4. Arsimi bazë me kohë të plotë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët që janë shtetas shqiptarë me banim në Republikën e Shqipërisë nga mosha gjashtë vjeç deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj. Nxënësi ka të drejtë

ta ndjekë arsimin bazë me kohë të plotë deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi, që ka mbushur moshën shtatëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka përfunduar arsimin bazë, lejohet të përfundojë klasën që po ndjek. Nxënësit, që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme.

5. Nxënësi, që nuk ka ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë me kohë të plotë, ka të drejtë ta ndjekë arsimin bazë me program mësimor individual, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Neni 23

Arsimi i mesëm i lartë

1. Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Këshilli i Ministrave zhvillon politika që synojnë krijimin e mundësisë për çdo nxënësi që përfundon arsimin bazë të regjistrohet në arsimin e mesëm të lartë.

2. Në klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë me kohë të plotë pranohen nxënës të moshës jo më të madhe se tetëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi deri në moshën njëzet e një vjeç lejohet të ndjekë arsimin e mesëm të lartë trevjeçar, kurse deri në moshën njëzet e dy vjeç arsimin e mesëm të lartë katërvjeçar. Nxënësi, që ka mbushur përkatësisht moshën njëzet e një vjeç në arsimin e mesëm të lartë trevjeçar apo njëzet e dy vjeç në atë katërvjeçar dhe nuk ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë, lejohet të vazhdojë klasën që ndjek deri në fund të atij viti shkollor.

Neni 24

Llojet e arsimit të mesëm të lartë

1. Llojet e arsimit të mesëm të lartë janë gjimnazi, arsimi i mesëm profesional dhe arsimi i mesëm i orientuar.

2. Gjimnazi përbëhet nga tri klasa. Nxënësve, që kanë mbushur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk e kanë përfunduar gjimnazin, u mundësohet ndjekja e gjimnazit me kohë të pjesshme ose në distancë.

3. Arsimi i mesëm profesional është me kohëzgjatje dy deri katërvjeçare dhe është i strukturuar në tri nivele kualifikimi, në përputhje me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

4. Shkolla të arsimit të orientuar janë shkollat artistike, shkollat sportive, shkollat për gjuhët e huaja dhe shkolla për fusha të tjera të të nxënësve. Pranimi në shkollat e arsimit të orientuar bëhet sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU IV

DREJTIMI I SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Neni 25

Funksionet kryesore të ministrisë

Funksionet kryesore të ministrisë janë:

- a) përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimor;
- b) zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
- c) vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve;
- ç) kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë dhe i përdorimit të fondeve në institucionet arsimore;
- d) hartimi dhe zbatimi i politikave të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë dhe akreditimi i programeve trajnuese;

dh) sigurimi i mbështetjes profesionale nga institucione të specializuara, vendase ose të huaja, për kërkime dhe eksperimentime në fushën e arsimit;

e) bashkëpunimi në fushën e arsimit me ministritë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore dhe me organizma të tjerë qeveritarë ose joqeveritarë, të vendit ose të huaj;

ë) publikimi për çdo vit shkollor i raportit të arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar.

Neni 26

Ministri

1. Ministri është përgjegjës për realizimin e programit politik qeverisës në fushën e arsimit parauniversitar.

2. Përveç detyrave të tjera të përcaktuara në këtë ligj, ministri:

a) nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji;

b) propozon buxhetin e arsimit parauniversitar, sipas përcaktimeve në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;

c) miraton dokumentacionin kurrikular, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

ç) miraton strukturën e vitit shkollor;

d) miraton ngarkesën mësimore, javore e vjetore, të punonjësve arsimorë dhe numrin e nxënësve për klasë për institucionet arsimore publike;

dh) miraton kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e regjistrimit të nxënësve në institucionet arsimore;

e) miraton rregulloren tip të institucioneve arsimore;

ë) miraton kriteret për dhënien e certifikatave e të çmimeve dhe i lëshon ato për nxënësit dhe punonjësit e sistemit arsimor.

f) nënshkruan me partnerët socialë kontratën kolektive të punës të nivelit të parë.

Neni 27

Inspektorati Shtetëror i Arsimit

1. Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në vijim “inspektorati”, është institucion në varësi të ministrit dhe funksionon në mbështetje të ligjit nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Funksionet kryesore të inspektoratit për arsimin parauniversitar janë:

a) vlerësimi i cilësisë së shërbimit të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore;

b) kontrollimi i pajtueshmërinë së veprimtarisë të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

c) këshillimi i drejtuesve dhe i punonjësve të institucioneve arsimore e të njësive arsimore vendore;

ç) informimi i ministrit, njësive arsimore vendore dhe institucioneve për gjetjet e inspektimeve arsimore, si dhe bërja publike e tyre;

d) përhapja e praktikave të suksesshme të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore.

3. Inspektimi, sipas këtij neni, rregullohet nga ligji nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj.

Neni 28

Njësia bazë e qeverisjes vendore

1. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:
 - a) ndërtimi dhe rikonstrukcioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transfertat e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
 - b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
 - c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
 - ç) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.
3. Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.
4. Njësia bazë e qeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet:
 - a) nxënësit e familjeve në nevojë;
 - b) nxënësit me arritje të shkëlqyera;
 - c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;
 - ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

Neni 29

Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar është organ këshillimor i ministrit për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar.
2. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar jep mendime për:
 - a) hartimin e strategjive, programeve kombëtare dhe akteve ligjore;
 - b) projektbuxhetin për arsimin parauniversitar;
 - c) çështje të tjera të politikave arsimore, me kërkesën e ministrit.
3. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar ushtrohet në përputhje me rregulloren, që miratohet nga Këshilli i Ministrave.
4. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga katërmëdhjetë anëtarë, me këtë përbërje:
 - a) përfaqësuesi i Ministrit të Financave;
 - b) përfaqësuesi i Ministrit të Brendshëm;
 - c) përfaqësuesi i Ministrit të Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
 - ç) një përfaqësues i shoqatës së bashkive me numrin më të madh të bashkive;
 - d) një përfaqësues i shoqatës së komunave me numrin më të madh të komunave;
 - dh) dy përfaqësues nga partnerët socialë;
 - e) një përfaqësues i shoqatës kombëtare të prindërve;
 - ë) gjashtë personalitete të njohura për kontribute në fushën e arsimit, shkencës dhe në jetën publike, të cilët zgjidhen me konkurrim publik.
5. Anëtarët e Këshilli Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, të cilët i nënshtrohen konkurrimin publik, përzgjidhen nga një komision, i ngritur pranë ministrit, i përbërë nga një përfaqësues i kabinetit të Kryeministrit, një përfaqësues i ministrit dhe një përfaqësues i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve përcaktohen me udhëzim të ministrit dhe bëhen publike.
6. Këshilli i Ministrave cakton në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar gjashtë nga kandidatët e përzgjedhur me konkurrim publik.

7. Anëtarët, personalitete të njohura për kontribute në fushën e arsimit, zgjidhen me mandat 4-vjeçar.

8. Anëtarët e përmendur në shkronjën “ë” të pikës 4 të këtij neni përfitojnë pagesë, në masën dhe mënyrën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Njësitë arsimore vendore

1. Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitë arsimore vendore, të cilat krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e tyre miratohen me urdhër të Kryeministrit.

2. Njësitë arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi.

3. Njësia arsimore vendore është përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të saj.

4. Njësia arsimore vendore:

a) zbaton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;

b) mbështetet institucionet arsimore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor;

c) bashkëpunon me njësinë bazë të qeverisjes vendore për planifikimin, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, si dhe për rastet e braktisjes së shkollës;

ç) siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore, sipas formulës “për nxënës”.

d) përdor fondin e veçantë të buxhetit vjetor për shpërblimin e punonjësve të institucioneve arsimore publike me arritje të shquara. Kriteret e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Drejtuesi i njësisë arsimore vendore, përgjegjësit e sektorëve dhe specialistët e tyre përzgjidhen me konkurrim të hapur, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

6. Kandidati për drejtues i njësisë arsimore vendore duhet të ketë të paktën kategorinë “mësues i kualifikuar” dhe të mos bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike.

Neni 31

Këshilli vendor i arsimit parauniversitar

1. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar është organ këshillimor, në nivel qarku, për politikat e zhvillimit të arsimit parauniversitar, brenda juridiksionit territorial të qarkut. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar krijohet me vendim të kryetarit të këshillit të qarkut dhe funksionon sipas rregullores së miratuar prej tij.

2. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe përbëhet nga përfaqësues të qeverisjes vendore dhe personalitete të njohura për kontribute në jetën publike. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit vendor të arsimit parauniversitar përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 32

Institucioni arsimor

1. Institucioni arsimor ka për detyrë krijimin e mjedisit miqësor për nxënësit dhe të mundësive që secili nxënës të shfaqë, të zhvillojë individualitetin dhe të realizojë potencialin e tij në përputhje me këtë ligj.

2. Institucioni arsimor funksionon sipas rregullores së tij të brendshme, e cila është në përputhje me këtë ligj e aktet e tjera ligjore në fuqi dhe miratohet nga titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse.

3. Institucioni arsimor u ofron nxënësve mjediset dhe pajisjet për veprimtari sportive, kulturore e zbavitëse edhe pas orëve mësimore, si dhe në ditët e pushimit.

4. Ndalohet organizimi i veprimtarive partiake në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar.

Neni 33

Komisioni i etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor

Në institucionin arsimor funksionon komisioni i etikës dhe sjelljes, i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë ankesat e nxënësve, të prindërve e të punonjësve të institucionit ndaj shkeljeve të normave të etikës dhe të sjelljes dhe t'i propozojë drejtorit të institucionit masat përkatëse.

Neni 34

Bordi i institucionit arsimor

1. Çdo institucion arsimor ka bordin e tij të përbërë nga prindër, nxënës, mësues, përfaqësues të qeverisë vendore dhe të komunitetit. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve të institucionit.

2. Detyrat kryesore të bordit janë:

- a) miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit;
- b) miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni;
- c) miraton kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor;
- ç) merr pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit.

3. Përbërja e bordit, të drejtat, detyrat e tjera dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve përcaktohen në udhëzimin e ministrit.

Neni 35

Këshilli i mësuesve

1. Këshilli i mësuesve të institucionit arsimor, i cili ka në përbërje të gjithë mësuesit dhe kryesohet nga drejtori, është organ kolegjal këshillimor për drejtimin e veprimtarisë së institucionit.

2. Detyrat dhe funksionet e këshillit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 36

Qeveria e nxënësve

1. Qeveria e nxënësve është organizëm që mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës. Ajo ngrihet dhe funksionon sipas udhëzimit të ministrit.

2. Kryetari i qeverisë së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë zgjidhet nga nxënësit me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.

3. Qeveria e nxënësve përzgjedh mësuesin ndihmës.

4. Në shkollë funksionojnë edhe organizime të tjera të nxënësve, të ngritura për interesat e tyre shkencore, kulturore dhe sportive.

KREU V
FINANCIMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 37

Planifikimi i financimit në arsimin parauniversitar publik

1. Burimet për financimin e arsimit parauniversitar janë:
 - a) Buxheti i Shtetit;
 - b) të ardhurat e njësisë të qeverisjes vendore;
 - c) dhurimet e sponsorizimet;
 - ç) të ardhurat e përftuara nga institucionet arsimore;
 - d) të ardhura të tjera të ligjshme.
2. Financimi nga Buxheti i Shtetit planifikohet me formulën “për nxënës”, sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike.
3. Në Buxhetin e Shtetit, për njësitë bazë të qeverisjes vendore, caktohet një fond “për nxënës”, i cili përdoret për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore publike, në përputhje me standardet e mirëmbajtjes për institucionet arsimore, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Mallra dhe shërbime të caktuara për institucionet arsimore publike njehsohen me formulën “për nxënës”, sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit dhe Ministrit të Financave.
5. Shtesa mbi pagë ose përfitime të tjera për punonjësit arsimorë dhe/ose për mësuesit që punojnë në zonat larg vendbanimit të tyre, jepen sipas kriterëve të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

Neni 38

Financimi i institucioneve arsimore publike

1. Institucioni arsimor publik përfiton nga njësia bazë e qeverisjes vendore përkatëse një fond, sipas formulës “për nxënës”, që e përdor për shpenzime të vogla, për ndërhyrje emergjente, sipas kriterëve dhe procedurave të vendosura nga Këshilli i Ministrave.
2. Nga buxheti i ministrisë veçohet një fond, fondi i cilësisë, për të cilin konkurrojnë institucionet arsimore publike me projekte për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit dhe Ministrit të Financave.
3. Ministria dhe Ministria e Financave miratojnë hapjen dhe mbylljen e llogarisë buxhetore të një institucioni arsimor publik. Institucionet arsimore publike të miratuara mbajnë llogari buxhetore pranë degës së thesarit në njësinë përkatëse arsimore vendore. Rregullat e administrimit financiar janë të njëjta me ato të institucioneve të tjera publike.

Neni 39

Mbështetja financiare për arsimin parauniversitar privat

1. Ministria mbështet financiarisht, sipas mundësive dhe programeve të miratuara, institucionet arsimore private vendase, të cilat janë jofitimprurëse dhe kanë të paktën pesë vjet që funksionojnë si institucione private. Sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetja financiare për shkollat private diferencohet sipas renditjes së tyre në provimet kombëtare të arsimit bazë ose të maturës shtetërore, si dhe në testimet ose konkurset ndërkombëtare.
2. Shkollat private e përdorin mbështetjen financiare vetëm për nxënësit e shkëlqyer në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Mbledhja dhe përdorimi i fondeve financiare në institucionet arsimore publike

1. Institucionet arsimore publike, në pajtueshmëri me politikat e tyre, përfitojnë fonde financiare ose mbështetje materiale nga dhurues ose sponsorizues, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga ministri, në bashkëpunim me Ministrin e Financave. Dhurimet dhe sponsorizimet shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor.

2. Institucionet arsimore publike lejohen të sigurojnë të ardhura nga shërbime për të tretët, në përputhje me fushën e veprimtarisë së institucioneve. Fondet e siguruar nga shërbimet për të tretë përdoren sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

KREU VI

HAPJA DHE MBYLLJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Hapja dhe mbyllja e institucioneve arsimore publike

1. Hapja dhe mbyllja e një institucioni arsimor publik bëhen me urdhër të ministrit, me propozim të përbashkët të njësisë bazë të qeverisjes vendore dhe të njësisë arsimore vendore. Kriteret dhe procedurat e hapjes dhe të mbylljes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Hapja dhe mbyllja e institucioneve arsimore të pakicave kombëtare bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Hapja dhe mbyllja e institucioneve arsimore private

1. Institucionet arsimore private krijohen dhe funksionojnë sipas këtij ligji, përveç rasteve kur ligji ka formulim të veçantë për institucionet arsimore publike, si edhe akteve nënligjore të nxjerra në mënyrë specifike për to.

2. Licencimi i institucioneve private bëhet nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit, sipas vendimit të ministrit. Institucioni arsimor privat fillon veprimtarinë e tij vetëm pas marrjes së licencës. Licencimi i tij bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

3. pezullimi dhe revokimi i institucioneve arsimore private, të cilat përmenden në pikën 2 të këtij neni, kryhet nga Qendra Kombëtare e Licencimit me vendim të ministrit.

4. Institucionet arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare, ose që themelohen apo administrohen nga bashkësitë fetare, hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesve të bashkësive fetare. Kriteret dhe procedurat e hapjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Shkollat private, në të cilat mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj, ose që lëshojnë diplomë të huaj apo të ngjashme me të, hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Kriteret dhe procedurat e hapjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në shkollat private të përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij neni, lëndët gjuhë shqipe dhe letërsi, histori e kombit shqiptar dhe gjeografi e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

7. Institucioni arsimor privat e ndërpret veprimtarinë e tij vetëm në fund të vitit shkollor.

Neni 43

Vlefshmëria e licencës

1. Licenca vlen vetëm për subjektin përgjegjës dhe vetëm për atë nivel arsimor, vendndodhje dhe mjedise, për të cilat është dhënë fillimisht.
2. Çdo ndryshim i bërë nga ana e subjektit të licencuar duhet të miratohet nga ministri dhe Qendra Kombëtare e Licencimit. Në rast se ndryshimet e bëra kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, licenca revokohet dhe kërkesa trajtohet si aplikim i ri.

KREU VII KURRIKULA

Neni 44

Parime të përgjithshme

1. Kurrikula zhvillohet si një e tërë për të gjitha nivelet arsimore, për sa i përket formimit të vlerave, aftësive e koncepteve kryesore, si dhe parimeve të mësimdhënies, të të nxënësve dhe të vlerësimit të nxënësve.
2. Kurrikula është në përputhje me ecurinë e zhvillimit fizik, mendor, shoqëror, etik të nxënësve dhe veçoritë e tyre individuale të të nxënësve.
3. Kurrikula hartohet dhe zbatohet në bazë të kompetencave themelore të nxënësve.
4. Kurrikula, sipas niveleve arsimore dhe klasave, hartohet dhe zhvillohet në bazë të kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar.
5. Kurrikula mishëron parimin e integritetit nëpërmjet fushave të të nxënësve dhe lëndore.
6. Kurrikula u mundëson nxënësve zgjedhje individuale, sipas nevojave dhe interesave të tyre.

Neni 45

Dokumentacioni kurrikular

(Ndryshuar shkronja "c" e pikës 2 me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

1. Kurrikula përbëhet nga kurrikula bërthamë, kurrikula me zgjedhje, si dhe kurrikula për veprimtaritë plotësuese.
2. Ministri, pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, miraton:
 - a) kornizën kurrikulare;
 - b) planin mësimor për çdo nivel arsimor;
 - c) kurrikul bërthamë;
 - ç) programet lëndore, përveç atyre që hartohen nga institucioni arsimor.
3. Kurrikula, që hartohet në nivel institucioni arsimor, miratohet nga drejtori i tij pas marrjes së pëlqimit nga njësia arsimore vendore.

Neni 46

Kurrikula në institucionet arsimore private

Institucioni arsimor privat zbaton planin dhe programin mësimor të miratuar në momentin e licencimit. Për çdo ndryshim kërkohet miratimi i ministrit.

Neni 47

Tekstet shkollore

(Ndryshuar pika 1, shfuqizuar pikat 2,3 me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

1. Tekstet shkollore përzgjidhen nga mësuesit në bazë shkolle, pas certifikimit nga ministria. Procedurat e përzgjedhjes përcaktohen me udhëzim të ministrit. Përgjashtimet nga ky rregull përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Tekstet për nxënësit janë alternative. Numri i alternativave të teksteve shkollore kufizohet në jo më shumë se tre alternativa për çdo lëndë ose fushë të të nxënës.

Tekstet shkollore sigurohen nga botuesit, vendas ose të huaj, mbi bazën e standardeve të teksteve, nëpërmjet një konkurrimi të hapur, të barabartë dhe transparent, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore bëhet nëpërmjet njësite tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave nga subjekte të licencuara, me çmime të vendosura nga botuesit e të vlerësuara nga ministria në procesin e certifikimit të tekstit.

KREU VIII VLERËSIMI I NXËNËSVE

Neni 48

Qëllimi, kriteret dhe mënyrat e vlerësimit

1. Vlerësimi i nxënësve ka për qëllim të evidentojë arritjet e të nxënës.
2. Nxënësit e klasave të para, të dyta dhe të treta vlerësohen me fjalë dhe shprehje. Nxënësit e klasave të tjera vlerësohen me nota, numra të plotë nga 4 deri në 10, ku nota më e ulët kaluese është pesa. Nxënësit e arsimit të mesëm të lartë vlerësohen edhe me kredite dhe me shprehje në vlerësimin përfundimtar.
3. Nxënësi i klasave të para, të dyta dhe të treta nuk e përsërit klasën, me përjashtim të rasteve kur kërkohet nga prindërit e tij.
4. Rregullat e kalimit ose të përsëritjes së klasës dhe të njehsimit të notës vjetore lëndore, të notës së tij mesatare për një vit shkollor, si dhe të krediteve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 49

Provimet kombëtare dhe testet ndërkombëtare

1. Vlerësimi i jashtëm i nxënësve realizohet nëpërmjet provimit të arsimit bazë dhe provimit të maturës shtetërore. Formë tjetër e vlerësimit të jashtëm është ai me një numër të caktuar nxënësish.
2. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
3. Hartimi i testeve, administrimi dhe vlerësimi në provimet kombëtare kryhen nga mësues të certifikuar. Pagesa e tyre bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi.
4. Ministria siguron pjesëmarrjen e Shqipërisë në testime ndërkombëtare.

Neni 50

Provimet kombëtare të arsimit bazë

1. Në provimet kombëtare të arsimit bazë nxënësit vlerësohen në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe gjuhë e huaj.
2. Nxënësit e pakicave kombëtare vlerësohen në lëndët gjuhë amtare, gjuhë shqipe, matematikë dhe, sipas dëshirës, edhe në një gjuhë të huaj.
3. Organizimi dhe zhvillimi i provimeve kombëtare të arsimit bazë rregullohen me udhëzim të ministrit.

Neni 51
Matura shtetërore

Arsimi i mesëm i lartë përfundon me provimet e maturës shtetërore. Në provimet e maturës shtetërore nxënësit japin një numër lëndësh të përbashkëta dhe një numër lëndësh me zgjedhje. Të gjithë nxënësit kanë këto tre lëndë të përbashkëta: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë dhe një gjuhë e huaj. Lëndët me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit. Organizimi dhe zhvillimi i provimeve kombëtare të maturës shtetërore rregullohen me udhëzim të ministrit.

Neni 52
Dokumente të përfundimit të shkollimit

1. Dokumenti i përfundimit të arsimit bazë është dëftesa e arsimit bazë, e cila lëshohet nga drejtori i shkollës pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare të arsimit bazë. Dokumenti i përfundimit të arsimit të mesëm të lartë është diploma e maturës shtetërore, e cila lëshohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve pasi nxënësi është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të maturës shtetërore.

2. Në përfundim të çdo klase, nxënësi pajiset me dëftesë klase. Kriteret për lëshimin e dëftesës përcaktohen me udhëzim të ministrit.

3. Shkolla private e arsimit të mesëm të lartë e licencuar mund të lëshojë diplomë të një institucioni arsimor të huaj ose të ngjashëm me të. Ministri përcakton procedurat e njësimin të këtyre diplomave.

4. Kriteret dhe procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 53
Medalja e Artë
(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

1. Nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u jepet “Medalje e artë” nga Kryeministri, me propozimin e ministrit.

2. Kriteret dhe procedurat për dhënien e “Medaljes së artë” përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU IX
STATUSI I PERSONELIT MËSIMOR

Neni 54
Drejtori i institucionit arsimor

1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor.

2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për:

- a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;
- b) përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor;
- c) zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës;
- ç) menaxhimin e personelit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit.

3. Drejtori i institucionit arsimor publik kryen edhe këto detyra:

- a) menaxhon institucionin, përfshirë edhe menaxhimin financiar;
- b) përdor një fond të veçantë vjetor nga buxheti i njësisë arsimore vendore për shpërblimin për merita profesionale të mësuesve, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, pas këshillimit me partnerët socialë dhe bordin e institucionit;

c) punëson mësues me kohë të plotë ose të pjesshme dhe mësues ndihmës, me fonde të siguruar nga institucioni, sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit dhe Ministrisë të Financave. Masa e pagesës përcaktohet sipas akteve nënligjore në fuqi.

4. Drejtori i institucionit arsimor lejon të përdoren nga nxënësit vetëm botime ndihmëse dhe materiale të tjera mësimore, të miratuara nga ministri nëpërmjet udhëzimeve të tij.

Neni 55

Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor

1. Drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues i njësisë bazë të qeverisjes vendore, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit dhe dy mësues të institucionit arsimor të zgjedhur nga këshilli i mësuesve. Njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë institucion arsimor, drejton komisionin e vlerësimit. Procedurat për emërimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të institucionit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Kandidati për drejtor i institucionit arsimor duhet të ketë të paktën kategorinë “mësues i kualifikuar” dhe të mos bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike.

3. Titullari i njësisë arsimore shkarkon drejtorin e institucionit arsimor publik për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tij nënligjore, shkelje të etikës e të sjelljes në institucion, si dhe për mosrealizime të institucionit.

4. Emërimi dhe/ose shkarkimi i drejtorit në institucionin arsimor privat kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij. Kriteret e kualifikimit, të përcaktuara për drejtorin e institucionit arsimor publik, janë të njëjta edhe për drejtorin e institucionit arsimor privat.

5. Drejtori i institucionit emëron dhe shkarkon nëndrejtorin pas marrjes së pëlqimit të këshillit të mësuesve.

Neni 56

Mësuesi

1. Mësuesi zhvillon mësimdhënien me synim zotërimin e kompetencave themelore, në bazë të standardeve të të nxënit dhe duke përzgjedhur ndërmjet metodave dhe praktikave bashkëkohore më të mira, vendase e të huaja.

2. Mësuesi ka të drejtë:

- a) të ketë, në përputhje me këtë ligj, liri profesionale në zbatimin dhe zhvillimin e kurrikulës;
- b) t'i sigurohen kushtet e mjaftueshme në institucion për mësimdhënie efektive;
- c) t'i krijohen mundësi për zhvillim profesional;
- ç) të zgjidhet dhe të zgjedhë në bordin e institucionit dhe në komisionin e etikës dhe sjelljes.

3. Mësuesi ka detyrë:

- a) të zbatojë këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij;
- b) të përkujdeset për mbarëvajtjen e çdo nxënësi të tij;
- c) të zbatojë dhe të zhvillojë kurrikulën;
- ç) të përditësojë kompetencat profesionale;
- d) të zbatojë rregulloren e institucionit;
- dh) të japë ndihmesën e tij për mbarëvajtjen e institucionit ku punon.

Neni 57

Profesioni i mësuesit

1. Mësuesi në institucionin arsimor duhet të ketë fituar diplomën e mëposhtme në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të:

a) Mësuesi i arsimit parashkollor: diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”;

b) Mësuesi i arsimit fillor, mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe mësuesi i gjimnazit: diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare.

2. Mësuesi i shkollave të arsimit profesional, që jep lëndë profesionale, ai i arsimit të orientuar dhe mësuesi, që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara, duhet të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit.

3. Diplomat e njëvlershme me diplomat e sipërpërmendura përcaktohen me udhëzim të ministrit.

4. Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar në provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

5. Institucionet arsimore, që shërbejnë për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve të mësuesisë dhe të praktikave profesionale të atyre që janë të diplomuar për mësues, përzgjidhen në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

Neni 58

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

1. Institucioni arsimor planifikon zhvillimin profesional të mësuesve, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit.

2. Format e zhvillimit profesional janë: zhvillimi i brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata.

3. Mësuesit dhe drejtorët trajnohen të paktën 3 ditë në vit.

4. Trajnimet zhvillohen sipas sistemit “kërkesë - ofertë”, në bazë të kërkesave nga institucionet arsimore dhe të ofertave nga agjenci trajnuese që mund të jenë publike ose private. Programet trajnuese akreditohen nga ministria.

5. Njësitë arsimore vendore organizojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, në bashkëpunim me agjenci trajnuese, me programe trajnimi të akredituara, të përzgjedhura me konkurrim të hapur, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit.

6. Burimet financiare për trajnimet janë nga kontributi vetjak i punonjësit arsimor, Buxheti i Shtetit, projekte të organizatave jofitimprurëse, të fondacioneve, të institucioneve, vendase ose të huaja, dhe burime të tjera të ligjshme.

Neni 59

Kualifikimi i mësuesve

1. Kategoritë e kualifikimit të mësuesve janë tri:

a) “Mësues i kualifikuar”;

b) “Mësues specialist”;

c) “Mësues mjeshtër”.

2. Rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvojës, trajnimit dhe pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit. Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

3. Çdo kategori kualifikimi shoqërohet me një shtesë në pagë, masa e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 60

Pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit

(Ndryshuar pikat 1,3 me ligjin nr.56/2015, datë 28.5.2015)

1. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. Në komisionet e vlerësimit marrin pjesë përfaqësues të prindërve. Procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni për:

- a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore;
- b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion;
- c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

3. Drejtori i institucionit arsimor publik fillon procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe vendos largimin pasi konsultohet me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

KREU X

TË DREJTAT DHE DETYRAT E NXËNËSVE DHE PRINDËRVE

Neni 61

Të drejtat dhe detyrat e nxënësit

1. Nxënësi ka të drejtë:

- a) të për zgjedhë një institucion arsimor, publik ose privat;
- b) të ndjekë institucionin arsimor publik që është në zonën e përcaktuar nga njësia bazë përkatëse e qeverisjes vendore;
- c) t'i sigurohet nga institucioni shërbim arsimor cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tij, si dhe ndihmë e posaçme për të përballuar vështirësitë e tij të veçanta të të nxënësit;
- ç) të informohet për të drejtat e detyrimet e tij, rregulloren e institucionit arsimor, për kurrikulën që institucioni i ofron, për format e vlerësimit, për provimet kombëtare, si dhe të vihet në dijeni me shkrim për rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare të arsimimit të tij;
- d) të shprehë pikëpamjet për çështje të arsimimit të tij, të ankohet për qëndrimet ndaj tij dhe të ketë vëmendjen e punonjësve të institucionit arsimor për këto pikëpamje e ankesa;
- dh) të zgjidhet në bordin e shkollës pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç;
- e) të transferohet nga një shkollë në një shkollë tjetër të të njëjtit nivel arsimor.

2. Nxënësi ka detyrë:

- a) të respektojë të drejtat e nxënësve të tjerë dhe të punonjësve të institucionit, të njohura me ligj;
- b) të mësojë rregullisht;
- c) të vijojë rregullisht dhe të marrë pjesë në veprimtari të tjera të institucionit;
- ç) të respektojë rregullat e institucionit për mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë e të mjedisit dhe të kërkojë respektimin e tyre nga nxënësit e tjerë dhe punonjësit arsimorë;
- d) të respektojë rregulloren e institucionit.

Neni 62

Të drejtat dhe detyrat e prindërve

1. Prindërit janë partneri kryesor i institucionit arsimor në mbarëvajtjen e fëmijës dhe të institucionit.

2. Prindi ka të drejtë:

- a) të informohet nga institucioni arsimor përkatës për legjislacionin arsimor në fuqi, për rregulloren e institucionit dhe për kurrikulën që institucioni i ofron fëmijës së tij;
- b) të informohet për kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit të institucionit dhe të kërkojë përmbushjen e tyre sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar;
- c) të informohet për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla;
- ç) të vihet në dijeni për drejtimit kryesore të veprimtarisë së institucionit dhe arritjet e institucionit në krahasim me institucione të ngjashme.

3. Prindi ka detyrë:

- a) të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht;
- b) të njoftojë për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij;
- c) të marrë pjesë në takimet për çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tij;
- ç) të kontribuojë në mbarrëvajtjen e institucionit.

KREU XI

ARSIMIMI I FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 63

Parime të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara

1. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t'i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës.

2. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.

3. Nxënësve, që nuk dëgjojnë e nuk flasin, u garantohej e drejta e komunikimit në gjuhën e shenjave, ndërsa atyre që nuk shikojnë, përdorimi i shkrimit Brail.

Neni 64

Ndjekja e institucioneve arsimore nga fëmijët me aftësi të kufizuara

1. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohet arsimimi në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, sipas kritereve të miratuara nga ministri dhe Ministri i Shëndetësisë.

2. Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkollë të specializuara deri në moshën 19 vjeç.

3. Njësia arsimore vendore krijon një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.

4. Prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me aftësi të kufizuara do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur e gjykojnë se ai nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.

5. Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe në këshillim me prindërit e komisionin, siguron arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.

6. Njësia arsimore vendore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, i siguron arsimim në shtëpi nxënësve që nuk mundën të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë.

Organizimi i arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara

1. Nxënësit me aftësi të kufizuara mësojnë sipas planit mësimor e programeve lëndore të zakonshme, të përshtatura për ta, ose sipas planit mësimor e programeve lëndore të specializuara për ta.

2. Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës.

3. Nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit. Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve.

4. Njësia përkatëse bazë e qeverisjes vendore u siguron nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.

KREU XII

SHKELJET E KËRKESAVE LIGJORE NË FUSHËN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale

1. Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave personale të nxënësve dhe të punonjësve të sistemit arsimor bëhen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

2. Nxënësit janë të detyruar të japin të dhënat personale, sipas pikës 1 të këtij neni. Institucioni arsimor njofton paraprakisht personat për këtë detyrim ligjor.

3. Institucioni arsimor mbledh e përpunon të dhëna personale të personave dhe i vendos ato në dokumentet zyrtare, si dhe në dosjen vetjake të personit. Këto të dhëna personale përcaktohen me udhëzim të ministrit, pasi merret mendimi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. Pëlqimi për t’i përdorur të dhënat personale jepet nga vetë personi kur ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përndryshe jepet nga prindërit e tij. Pëlqimi paraqitet me shkrim.

Mbrojtja e të dhënave personale të nxënësve

1. Personi ka të drejtë të njihet me të dhënat e tij personale, që disponon institucioni arsimor përkatës.

2. Punonjësit e institucionit arsimor nuk kanë të drejtë t’u vënë në dispozicion të tjerëve, jashtë institucionit, të dhëna personale të një personi, duke treguar identitetin e tij, me përjashtim të rasteve kur personi paraqet kërkesën ose jep pëlqimin.

3. Drejtuesi i institucionit arsimor u dërgon zyrtarisht institucioneve, që përcaktohen me udhëzim të ministrit, të dhëna personale pa identifikuar personat.

4. Rezultatet e nxënësve në provimet kombëtare dhe të dhënat e tyre për hyrjen në institucionet e shkollave të larta, si dhe rezultatet e mësuesve në provimet e kualifikimit nuk zbulojnë identitetin e personit.

5. Punonjësi i institucionit arsimor e ka të ndaluar të japë të dhëna për arritjet mësimore dhe sjelljen e një nxënësi të institucionit arsimor në mënyrë publike ose t'ia japë ato një personi të veçantë.

6. Të dhënat personale të një grupi personash mund t'u vihen në dispozicion institucioneve të tjera për studime, vetëm pas miratimit me shkrim të drejtorit të institucionit arsimor, pa zbuluar identitetin e tyre.

KREU XIII KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 68

Ndjekja e arsimit të detyrueshëm

Mosregjistrimi dhe mungesat e paarsyeshme të fëmijës në mësim për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor vlerësohen si rast i neglizhencës prindërore dhe trajtohen në përputhje me ligjin nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Neni 69

Ushtrimi i veprimtarisë së institucioneve arsimore private pa licencë

1. Hapja dhe ushtrimi i veprimtarisë së institucioneve arsimore private pa licencën përkatëse, sipas këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësi dënohet me dënim administrativ kryesor gjobë, në vlerën nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë, dhe me dënim administrativ plotësues “ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë”.

2. Vendimi për dënimin e kundërvajtësit, sipas pikës 1 të këtij neni, është në kompetencën e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe merret në vend me konstatimin e shkeljes.

Neni 70

Shkelja e kërkesave ligjore nga institucionet arsimore private

1. Shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore private përbën kundërvajtje administrative, që konstatohet dhe dënohet nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit me këto dënime administrative kryesore:

a) paralajmërim;

b) gjobë në vlerën nga 10 000 deri në 100 000 lekë.

2. Kur është e nevojshme, Inspektorati vendos që dënimi administrativ kryesor, sipas pikës 1 të këtij neni, të shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim.

3. Në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda, që përbëjnë mosplotësim të kushteve të licencimit për institucionin arsimor privat, Inspektorati merr vendimin për dënimin e kundërvajtësit, me dënimin kryesor të parashikuar nga shkronja “b” e pikës 1 të këtij neni dhe, nëse është e nevojshme, propozon dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë. Vendimi përfundimtar për pezullimin apo heqjen e licencës është në kompetencën e ministrit.

4. Institucioni arsimor privat, licenca e të cilit është pezulluar, mund ta fitojë atë për vitin pasardhës shkollor, në qoftë se plotëson kushtet e licencimit.

5. Në rast të pezullimit dhe/ose heqjes së një licence, njësia arsimore vendore përkatëse i vendos nxënësit në institucione të tjera arsimore, publike ose private. Shpenzimet për përfundimin e një viti shkollor, për të gjithë nxënësit e regjistruar në atë shkollë private, përballohen nga garancia bankare e institucionit arsimor privat të mbyllur. Modalitetet e transferimit të nxënësve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

6. Ministri miraton rregulloren e inspektimit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 71

Shkelja e kërkesave ligjore nga institucionet arsimore publike

1. Shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore publike përbën kundravajtje administrative nga drejtori i institucionit arsimor publik, që konstatohet dhe dënohet nga Inspektorati me këto dënime administrative kryesore:

- a) paralajmërim;
- b) gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës mujore.
2. Pika 2 e nenit 70 zbatohet edhe në këtë rast.

3. Përveç zbatimit të dënimit administrativ, sipas pikës 1 të këtij neni, Inspektorati Shtetëror i Arsimit informon për shkeljet e konstatuara edhe njësinë arsimore vendore përkatëse.

KREU XIV

DISPOZITAT E FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 72

1. Ligji nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që lidhet me arsimin parauniversitar dhe është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

2. Aktet e tjera normative, të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar.

3. Institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore private plotësuese, të licencuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për lejet, licencat dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”, dhe ato të licencuara me ligjin e sipërpërmendur, përshtatin dokumentacionin e organizimit dhe të funksionimit institucional, si dhe atë mësimor, në përputhje me këtë ligj, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Struktura e re e arsimit bazë, neni 22 i këtij ligji, i shtrin efektet duke filluar nga viti shkollor 2015 - 2016. Provimi i gjuhës së huaj i maturës shtetërore i shtrin efektet e zbatimit në maturën shtetërore 2014. Provimi i gjuhës së huaj i arsimit bazë i shtrin efektet e zbatimit në vitin 2015.

5. Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe ka formimin përkatës universitar, ruan vendet e punës dhe u nënshtrohet trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin. Ky përcaktim vlen edhe për mësuesit që kanë përfunduar arsimin e lartë pedagogjik 3-vjeçar, përpara hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës.

Personeli mësimdhënës, që është i punësuar me kontratë të përhershme dhe që ka mbaruar një shkollë të mesme pedagogjike ose shkollë tjetër të profilizuar për mësuesi, siç janë shkollat e mesme të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja dhe fizkulturës, dhe që ka fituar tri shkallët e kualifikimit, ruan vendet e punës dhe u nënshtrohet trajnimeve për përditësimin e dijeve që lidhen me profesionin.

Neni 73

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ministri nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji brenda nëntë muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda nëntë muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 74
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.6.2012

Shpallur me dekretin nr. 7696, datë 18.7.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 79/2017

PËR SPORTIN²¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Europiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë;
- b) përcaktimi i kompetencave të autoriteteve qendrore e vendore në fushën e sporteve;
- c) përcaktimi i bazave të përgjithshme dhe ligjore të organizimit e të zhvillimit të sportit;
- ç) përcaktimi i marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet organizatave sportive dhe institucioneve të pushtetit qendror dhe institucioneve të pushtetit vendor;
- d) krijimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin sistematik nga të gjitha moshat të edukimit fizik dhe sportit, të mbështetura nga institucionet e pushtetit qendror dhe njësitë e qeverisjes vendore;
- dh) të shërbejë si mbështetje ligjore, financiare dhe organizative për funksionimin e institucioneve dhe të organizatave sportive, publike e private.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të funksionimit dhe të organizimit të sportit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

²¹ Ligji nr. 79/2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 114, datë 22 maj 2017.

1. “Agjencia Botërore e Antidopingut” është organizatë ndërkombëtare e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton veprimtarinë kundër dopingut në sport, e themeluar dhe e financuar në mënyrë të barabartë nga lëvizja sportive botërore.

2. “Ambient sportiv” është çdo ambient ose pjesë e një ndërtese apo hapësire të mbyllur rreth saj, që shërben për veprimtari sportive.

3. “Doping në sport” është përdorimi apo administrimi prej sportistëve i substancave doping dhe i metodave doping, të klasifikuara si të tilla në listën vjetore të Agjencisë Botërore të Antidopingut.

4. “Edukimi fizik” është lëndë mësimore, pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar dhe universitar, e cila fokusohet në zhvillimin e aftësive që ndihmojnë në kryerjen me lehtësi dhe kënaqësi të veprimtarisë fizike ditore. Nëpërmjet saj fitohen aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në një gamë të gjerë veprimtarish sportive.

5. “*Fair play*” është loja e ndershme, respektimi i rregullave dhe trajtimi i barabartë i të gjithë pjesëmarrësve.

6. “Federata sportive” është personi juridik, që krijohet në formën e shoqatës, anëtarë të së cilës janë shoqatat sportive, shoqëritë sportive dhe klubet sportive që ushtrojnë veprimtari në një sport të caktuar, dhe që ka për qëllim organizimin, zhvillimin, promovimin, kontrollin, rregullimin dhe përhapjen e një sporti të caktuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

7. “Gjykata e Arbitrazhit të Sportit (CAS) në Lozanë të Zvicrës” është një organ ndërkombëtar gjyqësor, i krijuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me sportin përmes arbitrazhit. Selia e saj është në Lozanë (Zvicër) dhe gjykatat e saj janë të vendosura në qytetin e Nju Jorkut, Sidneit dhe Lozanës.

8. “Klub sportiv” është personi juridik, që ushtron veprimtari sportive në një sport ose shumë sporte.

9. “Këshilli i Arbitrazhit Sportiv” është organi kolegjal, që drejton, autorizon, mbikëqyr dhe kontrollon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin nëpërmjet paneleve të gjyqimit të mosmarrëveshjeve.

10. “Komiteti Olimpik Ndërkombëtar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton Lëvizjen Olimpike Botërore.

11. “Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpike në Shqipëri.

12. “Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar Special” është një organizatë e pavarur jofitimprurëse, e cila drejton lëvizjen olimpike për personat me paftësi intelektuale në Shqipëri.

13. “Lëvizja olimpike” është veprimi i bashkërenduar, i organizuar, universal dhe i përhershëm i të gjithë individëve dhe subjekteve, që janë frymëzuar nga vlerat e olimpizmit në të pesta kontinentet dhe që kryhet nën autoritetin suprem të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

14. “Mjedis sportiv” është një hapësirë e mbuluar ose jo, e rrethuar ose jo, e destinuar për organizimin e veprimtarive sportive, si lojëra sportive, gara sportive, palestra sportive ose fitnesi apo e përdorur përkohësisht për organizimin e veprimtarive sportive promocionale, lojërave zbavitëse dhe veprimtarive sportive rekreative.

15. “Objekt sportiv” është sendi i paluajtshëm, i ndërtuar në përputhje me kushtet e nevojshme për zhvillimin e një apo disa sporteve, në bazë të rregullave teknike, të miratuara nga federata kombëtare e sportit përkatës.

16. “Organizatë sportive” është Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat, klubet sportive dhe shoqatat, të cilat zhvillojnë veprimtari sportive.

17. “Organizata Kombëtare Antidoping” është organizata jofitimprurëse që ushtron veprimtarinë kundër dopingut në Republikën e Shqipërisë.

18. “Qendra sportive kombëtare” është institucioni publik, që përdoret vetëm në funksion të veprimtarive me karakter sportiv, i specializuar në sigurimin e shërbimit dhe të trajtimit për përgatitjen e ekipeve olimpike dhe atyre kombëtare në të gjitha disiplinat sportive.

19. “Sport” është tërësia e veprimeve psiko-fizike, që synojnë zhvillimin e ushtruesve, argëtimin, edukimin, ruajtjen dhe forcimin e shëndetit, përmirësimin e mirëqenies së gjithanshme të tyre dhe arritjen e suksesit në garat sportive.

20. “Sportist” është individ, ushtrues i një sporti në forma të ndryshme, i anëtarësuar në një organizatë sportive.

21. “Sportistë të nivelit të lartë” janë persona që praktikojnë sistematikisht dhe në mënyrë të organizuar sportin, duke marrë pjesë në veprimtari sportive dhe duke arritur rezultate të larta në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

22. “Sport amator” është veprimtaria sportive, ku pjesëmarrësit për përgatitjen dhe përfaqësimin në të mbështeten te vullnetarizmi.

23. “Sport profesionist” është veprimtaria e sportistëve, të cilët zhvillojnë veprimtari sportive në mënyrë profesionale dhe që janë të pajisur me kontratë me klubin përkatës nga i cili paguhen.

24. “Sport shkollo” është veprimtaria e organizuar kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, nëpërmjet së cilës menaxhohen dhe trajnohen aftësitë kryesore të nxënësve për t’u përfshirë në ushtrimin e disiplinave të ndryshme sportive.

25. “Sport për të gjithë” përfaqëson një kompleks veprimtarish për praktikimin e lirë të ushtrimeve fizike në një mjedis tërësisht të sigurt, të organizuar ose të pavarur, në mënyrë individuale ose në grup.

26. “Specialist i sportit” është një punonjës i sportit, i cili ka fituar një diplomë edukimi të sportit apo një certifikatë të përputhshme ose diplomë të kualifikimit profesional të edukimit të sportit ose certifikatë të përputhshme kualifikimi profesional.

27. “Shoqatë sportive” është personi juridik, që krijohet nga anëtarët që ushtrojnë veprimtari sportive në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

28. “Shoqëri sportive” është një person juridik, që krijohet dhe funksionon në formën e shoqërisë tregtare, që ushtron veprimtari sportive me qëllime fitimprurëse, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi.

29. “Terren sportiv” është çdo mjedis apo sipërfaqe e hapur, në të cilën ushtrohet veprimtari sportive.

30. “Trajner” është profesionisti i licencuar në fushën e trajnimit sportiv, i cili stërvit një individ apo ekip dhe e përgatit atë për garim apo ndeshje.

31. “Veprimtari sportive” janë të gjitha format e veprimtarive fizike e sportive, të cilat, nëpërmjet pjesëmarrjes së organizuar apo të rastësishme, synojnë shprehjen ose përmirësimin e aftësive fizike e psikike, zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore ose arritjen e rezultateve sportive në garat e të gjitha niveleve dhe të gjitha grup-moshave, duke respektuar frymën sportive dhe duke vlerësuar ndershmërinë sportive. Veprimtari sportive janë veprimtaritë konkrete, të zhvilluara në një formë, kohë apo vend të caktuar.

Neni 4

Parimet bazë të funksionimit të sportit në Republikën e Shqipërisë

Parimet bazë të sportit janë:

- a) parimi i barazisë, si një e drejtë e çdo shtetasi për t’u marrë me sport;
- b) parimi i qasjes sistematike, shkencore dhe të diferencuar të edukimit fizik e të sportit gjatë gjithë jetës së njeriut;
- c) parimi i lidhjes së edukimit fizik dhe sportit me shëndetin, arsimin dhe kulturën në një sistem të vetëm funksional, për të rritur ndikimin e saj të balancuar në të gjithë popullsinë;
- ç) parimi i lojës së ndershme dhe korrekte, i udhëhequr nga idealet olimpike dhe parimet e etikës sportive;
- d) parimi i sigurisë, që ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarive sportive në një mjedis të sigurt.

Neni 5

E drejta e të ushtruarit të sportit

1. Të ushtruarit e sportit është një e drejtë e të gjithë shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Askush nuk mund të privohet nga kjo e drejtë pa shkak të mbështetur në ligj.
2. Nuk përbëjnë shkelje të së drejtës për të ushtruar sportin rastet kur kufizimet për pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive përcaktohen në rregulloret e organizimit të tyre.
3. Ndalohet diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe, si bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqërore.
4. Ndalohen organizimi dhe propaganda politike e fetare në veprimtaritë sportive.

Neni 6

Edukimi fizik dhe sporti në sistemin arsimor

1. Sporti është pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike dhe jopublike.
2. Edukimi fizik në arsimin parauniversitar është pjesë e kurrikulës bërthamë dhe kurrikulës me zgjedhje të planit mësimor. Edukimi fizik në kurrikulën bërthamë zhvillohet me minimumi tre orë mësimore në javë për klasat 1-12. Përgjashtimet nga ky rregull përcaktohen nga ministri përgjegjës për arsimin, ndërsa për arsimin profesional nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin profesional. Në arsimin universitar edukimi fizik përcaktohet në aktet e brendshme të vetë institucioneve të arsimit të lartë.
3. Të gjitha institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore krijojnë kushtet e nevojshme që nxënësit, studentët, efektivat e policisë dhe të Forcave të Armatosura të zhvillojnë veprimtari fizike dhe sportive, individuale dhe/ose të organizuara.
4. Përveç disiplinës mësimore të përfshirë si pjesë e kurrikulës, aktivitetet sportive në institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare jashtë procesit mësimor organizohen edhe nga shoqatat sportive shkollore dhe shoqatat sportive universitare, të cilat mund të jenë të një sporti ose të shumë sporteve, veprimtaria e të cilave koordinohet sipas përkatësisë nga Federata e Sportit Shkollor dhe Federata e Sportit Universitar.
5. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar janë persona juridikë, që organizohen dhe funksionojnë në zbatim të kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse. Ministria përgjegjëse për sportin njih vetëm një federatë të sportit shkollor dhe një federatë të sportit universitar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e këtyre federatave.
6. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar, krahas detyrave statutores, kanë edhe këto detyra:
 - a) Federata Shqiptare e Sportit Shkollor:
 - i) të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë veprimtaritë sportive me nxënësit e të gjithagrup-moshave të arsimit parauniversitar në nivel rajonal dhe kombëtar, në të gjitha disiplinat sportive;
 - ii) të organizojë kampionatin e shkollave në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallë kampionin kombëtar të shkollave;
 - iii) të organizojë ekipet përfaqësuese në veprimtaritë ndërkombëtare të sportit shkollor.
 - b) Federata Shqiptare e Sportit Universitar:
 - i) të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë veprimtaritë sportive me studentët e arsimit të lartë, në nivel rajonal e kombëtar, në të gjitha disiplinat sportive;
 - ii) të organizojë universiadat në të gjitha disiplinat sportive dhe të shpallë kampionin kombëtar të universiteteve;
 - iii) të organizojë ekipet përfaqësuese në aktivitetet ndërkombëtare të sportit universitar.
7. Shkollat sportive janë institucione arsimore të arsimit të mesëm të lartë me orientim sportiv të

të nxënit. Pranimi në shkollat e arsimit të orientuar bëhet sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen me akte nënligjore.

8. Të gjitha institucionet arsimore parauniversitare dhe universitare, publike ose jopublike, zbatojnë standardet në fuqi për zhvillimin e orës mësimore të edukimit fizik dhe sporteve për nxënësit dhe studentët.

KREU II SHTETI DHE SPORTI

Neni 7

Sporti në Republikën e Shqipërisë

1. Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari publike.
2. Shteti nxit zhvillimin e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitë, duke mbështetur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, nëpërmjet krijimit të kushteve ligjore, financiare dhe të infrastrukturës sportive.
3. Shteti nxit dhe mbështet përfshirjen në veprimtari sportive të personave me aftësi të kufizuara, si dhe ndihmon nëpërmjet sportit integrimin e tyre në jetën shoqërore.
4. Shteti mbështet organizatat sportive dhe subjektet sponsorizuese të veprimtarive sportive, nëpërmjet krijimit të lehtësive fiskale.
5. Ndihmat apo sponsorizimet me materiale dhe pajisje sportive për organizatat sportive shqiptare, të cilat vijnë nga institucione ndërkombëtare apo çdo formë tjetër sponsorizimi, në kuadër të bashkëpunimit, nxitjes së sportit dhe rritjes së nivelit të sportit në rang ndërkombëtar, përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.
6. Procedurat e përjashtimit dhe listat e materialeve e të pajisjeve sportive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ministria përgjegjëse për sportin dhe njësitë e qeverisjes vendore

1. Ministria përgjegjëse për sportin harton dhe zbaton politikën shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive.
2. Ministria përgjegjëse për sportin bashkë-punon me to për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar pavarësinë e funksionimit të tyre, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion, dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.
3. Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikat vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitë, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre.

Neni 9

Këshilli i Lartë i Sportit

1. Këshilli i Lartë i Sportit është organ këshillimor, pranë ministrit përgjegjës për sportin, i cili merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave për sportin.
2. Përbërja strukturore dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Sportit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Ministri përgjegjës për sportin është kryetar i Këshillit të Lartë të Sportit dhe emëron anëtarët e tij. Ministri përgjegjës për sportin miraton rregulloren e organizimit e të funksionimit të Këshillit të Lartë të Sportit.

KREU III ORGANIZIMI I SPORTIT

Neni 10

Organizimi kombëtar i sportit

Organizimi kombëtar i sportit përbën tërësinë e organizatave e të institucioneve që ushtrojnë veprimtari në fushën e sportit, të ndara në organizata sportive dhe struktura shtetërore për shërbime sportive.

Neni 11

Organizatat sportive në Republikën e Shqipërisë

Organizatat sportive në Republikën e Shqipërisë janë:

- a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar;
- b) federatat sportive;
- c) shoqatat sportive;
- ç) shoqëritë sportive;
- d) klubet sportive.

Neni 12

Qendra Sportive Kombëtare

1. Qendra Sportive Kombëtare janë Tërësi Olimpik Park dhe Qendra Olimpikë Korçë.
2. Këto qendra janë në pronësi të njëjësive të qeverisjes vendore përkatëse dhe përdoren vetëm në funksion të veprimtarive me karakter sportiv.

Neni 13

Financimi i organizatave sportive

1. Federatat sportive dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar financohen me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, në formë transferte, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme. Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të ministrit përgjegjës për sportin.
2. Ministria përgjegjëse për sportin mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e transfertës së Buxhetit të Shtetit në të gjitha organizatat sportive që kanë përfituar nga fondet publike.

Neni 14

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

1. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është person juridik, që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në përputhje me Kartën Olimpikë dhe statutin e tij të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente.
2. Lëvizja olimpikë drejtohet dhe bashkë-rendohet nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.
3. Ndryshimet statutoire miratohen nga ministri përgjegjës për sportin brenda 60 ditëve nga data e depozitimit. Pas kalimit të këtij afati, ndryshimet statutoire konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, ndryshimet statutoire regjistrohen në gjykatë.
4. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar mund të financohet me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit në formë transferte, si dhe burime të tjera të ligjshme.
5. Ministria përgjegjëse njeh vetëm një Komitet Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e këtij Komiteti.

6. Në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar aderojnë federatat shqiptare, organizata të tjera sportive dhe persona juridikë dhe fizikë, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në statutin e këtij Komiteti.

7. Vendimet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar bëhen publike nëpërmjet dërgimit zyrtar tek të gjithë anëtarët e tij.

Neni 15

Programet kryesore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar bashkërendon fondet e veta me ato të pushtetit qendror e vendor në zbatim të programeve si më poshtë:

- a) programi i edukimit olimpik;
- b) programi rinor i lëvizjes olimpike;
- c) programi i zhvillimit rajonal të lëvizjes olimpike;
- ç) programi i përgatitjes dhe pjesëmarrjes së sportistëve më të mirë të vendit në Lojërat Olimpike dhe në garat e tjera olimpike, ndërkombëtare e rajonale.

Neni 16

Federatat sportive

1. Federata shqiptare është person juridik që organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kuadrit ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe ushtron veprimtarinë në një sport të caktuar në përputhje me statutin e saj, të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin brenda

60 ditëve nga data e depozitimit, përpara kërkesës për regjistrim në gjykatën kompetente. Pas kalimit të këtij afati, statuti konsiderohet i miratuar në heshtje.

2. Federatat sportive pas titullit të përkatësisë duhet të shënojnë emërtimin “Federatë shqiptare”.

3. Të drejtën për të përfituar emërtimin “Federatë shqiptare” e një sporti të caktuar e gëzon ajo organizatë sportive, e krijuar me nismën e personave juridikë, personave fizikë dhe klubeve sportive të atij sporti, që kanë pranuar emërtimin dhe statutin e federatës. Pas përfundimit të kësaj procedure, statuti i miratuar regjistrohet në gjykatë.

4. Ministria përgjegjëse për sportin njeh vetëm një federatë në një sport të caktuar dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e kësaj federate.

5. Kërkesat e personave juridikë, personave fizikë dhe klubeve sportive të atij sporti për anëtarësim në federatë merren në shqyrtim në mbledhjen e parë të organeve përkatëse të federatës. Vendimi i organeve përkatëse të federatës duhet të jetë i arsyetuar. Kundër vendimit për anëtarësim mund të paraqitet ankim pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

6. Asnjë person nuk mund të marrë pjesë në asnjë veprimtari sportive pa u anëtarësuar më parë pranë federatës përkatëse.

7. Ndryshimet statutoire miratohen nga ministri përgjegjës për sportin sipas së njëjtës procedure që miratohet dhe statutin.

8. Federatat shqiptare gëzojnë të drejtën për t’u anëtarësuar në organizata të tjera sportive të nivelit më të lartë, brenda dhe jashtë vendit.

9. Vendimet dhe veprimtaritë sportive të federatave sportive shqiptare bëhen publike nëpërmjet dërgimit zyrtar tek të gjithë anëtarët e saj.

10. Personat me aftësi të kufizuara mund të organizohen në shoqata sportive dhe të anëtarësohen në federata, të cilat kanë ekskluzivitetin e trajtimit të të gjitha çështjeve të një sporti.

Neni 17

Emërtimi “Federatë shqiptare”

1. Shteti i delegon të drejtën e organizimit e të zhvillimit të veprimtarive sportive kombëtare e ndërkombëtare vetëm një federatë sportive, në një sport të caktuar.

2. Akti i emërimit “Federatë shqiptare” të një sporti të caktuar jepet nga ministri përgjegjës për sportin, pas opinionit të marrë nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Ky Komitet paraqet opinionin jo më vonë se 15 ditë nga dita e marrjes së njoftimit.

3. Akti i emërimit “Federatë shqiptare” e një sporti i revokohet një organizatë sportive dhe ministri përgjegjës për sportin kërkon nga gjykata kompetente heqjen e emërimit “Federatë shqiptare” nëse:

- a) veprimtaria e saj nuk zhvillohet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në statut;
- b) asambleja e përgjithshme e saj merr vendime në kundërshtim me ligjin;
- c) pushon së funksionari si rezultat i shpërbërjes së saj.

Neni 18

Detyrat e federatave

1. Federata shqiptare e një sporti të caktuar, krahas detyrave statutore, ka edhe këto detyra:

a) të organizojë, të drejtojë, të kontrollojë dhe të vëzhgojë aktivitetet sportive zyrtare në nivel kombëtar, në bazë të rregulloreve të miratuara;

b) të organizojë kampionatin kombëtar dhe të shpallë “Kampionin kombëtar” dhe “Ekipin kampion kombëtar” në sportin përkatës;

c) të organizojë Kupën e Shqipërisë dhe të shpallë “fituesin e Kupës së Shqipërisë” në sportin përkatës;

ç) të marrë masa për parandalimin dhe të luftojë dhunën, si dhe të promovojë sportin e pastër dhe tolerancën;

d) të përdorë simbolet e federatës ose të autorizojë përdorimin e tyre nga anëtarë të tjerë, për çdo qëllim;

dh) të organizojë ekipin kombëtar dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari;

e) të organizojë veprimtari zyrtare me karakter ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë me miratimin e ministrit përgjegjës për sportin.

ë) të licencojë trajner për sportin përkatës;

f) të japë pëlqimin për kryerjen e veprimtarive sportive, për anëtarët e saj.

2. Asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.

Neni 19

Shoqatat sportive

1. Shoqatat sportive kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Mënyra e krijimit, forma e organizimit dhe e funksionimit dhe objekti i veprimtarisë së shoqatave sportive mbështeten në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, kuadrin ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe në bazë të këtij ligji.

3. Shoqatat sportive kombëtare nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të marrin pjesë në to pa u regjistruar si anëtarë në federatën shqiptare të sportit përkatës.

4. Shoqatat sportive mund të përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera.

Neni 20
Shoqëritë sportive

1. Shoqëritë sportive kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Mënyra e krijimit, forma e organizimit dhe e funksionimit, si dhe objekti i veprimtarisë së shoqërive sportive mbështeten në legjislacionin për shoqëritë tregtare.
3. Shoqëritë sportive nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të marrin pjesë në to, pa u regjistruar si anëtare në federatën shqiptare të sportit që ushtrojnë.
4. Shoqëritë sportive mund të përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera.

Neni 21
Klubet sportive

1. Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose për organizatat jofitimprurëse.
2. Çdo organizatë, që ka personalitet juridik, ka të drejtë të krijojë klube sportive të një ose shumë sporteve, të cilat kanë personalitet juridik të ndarë nga ai i themeluesit dhe organizohen e funksionojnë në bazë të aktit themelues të organit krijues.
3. Procedurat e transformimit të klubeve realizohen me vendim të organit krijues brenda një periudhe kohore prej gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Klubet sportive mund të përfitojnë financime nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera.

Neni 22
Kapitali shtetëror

Në shoqëritë tregtare me objekt ushtrimin e veprimtarisë sportive në një sport të caktuar, pjesa e kapitalit shtetëror ose aksioneve/kuotave të zotëruara nga shteti mund të privatizohet nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për privatizimin, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

KREU IV
DREJTËSIA SPORTIVE

Neni 23
Shqyrtimi administrativ

1. Federatat sportive krijojnë organet e gjyimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara në statutin e tyre.
2. Organet e gjyimit disiplinor të federatave shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së federatave përkatëse.
3. Vendimet e organeve të gjyimit disiplinor të federatave mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike nga shpallja e tyre.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit organizohet dhe funksionon Këshilli i Arbitrazhit Sportiv.
2. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organ kolegial që drejton, autorizon, mbikëqyr dhe kontrollon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështje të lidhura me sportin nga panelet e gjyimit të mosmarrëveshjeve, të përbërë nga arbitra/ ndërmjetës, të zgjedhur nga lista e arbitrave dhe ndërmjetësve që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga asambleja e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.
3. Kriteret për arbitrat dhe ndërmjetësit miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, me shumicë të cilësuar të të gjithë anëtarëve të këtij Komiteti.
4. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv përbëhet nga shtatë anëtarë, me përvojë jo më pak se dhjetë vjet në fushën e jurisprudence ose ekonomisë, përfaqësues të:
 - a) Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (katër anëtarë);
 - b) Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Special (një anëtar);
 - c) Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (një anëtar).
5. Të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv përcaktohen në rregulloren e tij, e cila miratohet në Asambleenë e Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar me shumicë të cilësuar të anëtarëve.
6. Veprimtaria e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv bazohet në rregulloren e brendshme dhe Kodin e Arbitrazhit Sportiv.
7. Panelet e gjyimit të mosmarrëveshjeve kanë përgjegjësinë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lidhura me sportin. Mënyrat e formimit të paneleve të gjyimit të mosmarrëveshjeve përcaktohen në Kodin e Arbitrazhit Sportiv. Arbitrat apo ndërmjetësit e paneleve të gjyimit të mosmarrëveshjeve e bazojnë veprimtarinë në rregullat e procedimit, të parashikuara në Kodin e Arbitrazhit Sportiv. Për realizmin e misionit të tij, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv duhet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme, legjitimitetin e paneleve të gjyimit të mosmarrëveshjeve, mbikëqyrjen e zhvillimit procedural të çështjeve dhe ekzekutimin e vendimeve.
8. Vendimet e paneleve të arbitrave/ ndërmjetësve ankimohen pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv brenda tridhjetë ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv shqyrton ankimin brenda tridhjetë ditëve dhe merr vendim. Vendimet e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS), në Lozanë të Zvicrës.
9. Të gjitha organizatat sportive dhe çdo sportist apo trajner me titull individual kanë të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjet, përpara Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.
10. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat shqiptare të sportit, klubet dhe shoqatat sportive, shoqëritë dhe çdo sportist apo trajner me titull individual pranojnë autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv. Ky detyrim përcaktohet në statutet e tyre, të cilat duhet të ndryshohen për të përfshirë këtë dispozitë brenda nëntë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nëse nuk e kanë të parashikuar.

KREU V

SPORTISTI, TRAJNERI DHE STATUSI I NIVELIT TË LARTË NË SPORT

Neni 25

Sportisti

1. Sportisti ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, shoqërinë sportive, klubin sportiv ku dëshiron të anëtarësohet, në varësi të sportit që ushtron, dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre.

2. Pjesëmarrja në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës.

3. Transferimi i sportistit nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive, të miratuara nga federata shqiptare e atij sporti dhe nga ato ndërkombëtare.

Neni 26

Kategoritë e sportistëve

1. Sportistët ndahen në amatorë dhe profesionistë, sipas kushteve të përcaktuara në statutet dhe rregulloret e federatave sportive kombëtare.

2. Sportistë amatorë janë ata sportistë, që praktikojnë sportin e tyre dhe nuk kanë ndonjë kontratë pune të lidhur me klubin sportiv apo shoqatën ku janë regjistruar.

3. Sportistët profesionistë janë ata persona që praktikojnë sportin si një profesion dhe fitojnë të ardhura në bazë të nënshkrimit të kontratës së punës me shoqatat, shoqëritë apo klubet sportive në të cilat ata janë anëtarë.

Neni 27

Sporti dhe statusi i sportistit të nivelit të lartë

1. Sportistët, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare: “rekord olimpike”, “rekord botëror”, “rekord evropian”, “vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpike”, “vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate botërore” dhe “vendi i parë deri në të tretin në kampionate evropiane” dhe “vendi i parë në Lojërat Mesdhetare”. Në veprimtari kombëtare zyrtare: “sportisti i cili thyen rekordin kombëtar” dhe “vendi i parë në kampionatin kombëtar”.

2. Njësitë e qeverisjes qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë dhe mbështesin trajtimin, shpërblimin dhe integrimin në sistemin arsimor, social dhe profesional të sportistëve të nivelit të lartë.

3. Kriteret, mënyra e shpërblimit dhe përfitimi i trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Institucionet arsimore publike me drejtim sportiv, siguri kombëtare dhe mbrojtje, sigurojnë kryerjen e studimeve për sportistët, të cilët plotësojnë kriteret e përfitimit të statusit të sportistit të nivelit të lartë, pa konkurs dhe sipas një plani individual.

Neni 28

Trajneri

1. Klubet sportive, shoqatat dhe shoqëritë sportive duhet të punësojnë trajnerë të licencuar nga federata shqiptare e sportit përkatës dhe të nënshkruajnë kontratë punësimi, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

2. Klubet sportive, shoqatat, shoqëritë sportive dhe federatat shqiptare të sporteve përkatëse kanë përgjegjësi për kualifikimin dhe trajnimin e mëtijshëm të tyre në bashkëpunim me institucione të fushës.

Neni 29

Detyrimet e sportistit dhe trajnerit

1. Sportisti duhet të respektojë rregullat e federatës përkatëse kombëtare dhe asaj ndërkombëtare, parimet etike të sportit dhe të *fair-play*-t, kushtet e Konventës Ndërkombëtare të Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë.

2. Trajnerët respektojnë rregullat e *fair-play*-t, parimet e Kodit të Etikës, Konventën Ndërkombëtare të Antidopingut, si dhe rregulloret e federatave kombëtare përkatëse.

KREU VI INFRASTRUKTURA SPORTIVE

Neni 30

Objektet sportive

1. Objektet sportive janë publike ose private.
2. Objektet sportive publike janë në pronësi të pushtetit qendror ose atij vendor, sipas juridiksionit të tyre. Ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e tyre.
3. Objektet sportive ngrihen dhe mirëmbahen për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive sportive.

Neni 31

Ndërtimi i objekteve sportive

1. Objektet sportive për zhvillimin e veprimtarive sportive zyrtare ndërtohen në përputhje me standardet dhe kushtet teknike të miratuara nga federatat ndërkombëtare të sportit përkatës.
2. Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieno-shëndetësore për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve sportive.

Neni 32

Përdorimi i objekteve sportive

1. Organet shtetërore ose organizatat sportive, që kanë në pronësi ose në përdorim objekte sportive, duhet të bëjnë një herë në vit verifikimin paraprak të kushteve të përcaktuara në këtë ligj.
2. Në rastet kur konstatohet se kushtet dhe kriteret nuk janë plotësuar sipas standardeve të miratuara nga organizatat ndërkombëtare të sporteve përkatëse, organet shtetërore ose organizatat sportive, që kanë në pronësi ose në përdorim objekte sportive, marrin masa për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive sportive deri në përmbushjen e tyre.

Neni 33

Shfrytëzimi i objekteve sportive

1. E drejta e shfrytëzimit të objektit sportiv i takon personit fizik apo juridik, që ka në administrim objektin sportiv apo kujtdo tjetër të cilit ky i fundit i jep të drejtën e shfrytëzimit.
2. E drejta e shfrytëzimit të veprimtarisë sportive, që zhvillohet në objektin sportiv, i përket organizatorit të kësaj veprimtarie.
3. Marrëdhëniet ndërmjet pronarit ose administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore.
4. Zotëruesi i së drejtës së shfrytëzimit të një veprimtarie sportive nuk mund t'u vërë sportistëve, pjesëmarrës në këtë veprimtari sportive, asnjë detyrim që cenon lirinë e tyre, qoftë atë të të shprehurit apo çdo lloj lirie tjetër individuale.

Neni 34

Destinacioni dhe privatizimi i objekteve sportive

Destinacioni i objekteve sportive nuk mund të ndryshojë, pavarësisht nga pronësia, subjekti administrues apo dhënia me koncesion.

KREU VII E DREJTA E TRANSMETIMIT, REKLAMAT DHE SPONSORIZIMET

Neni 35

Të drejtat e transmetimit

1. Organizatorët e veprimtarive sportive janë pronarë të së drejtës së transmetimit të kësaj veprimtarie. Ata mund ta shesin këtë të drejtë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me konkurrim publik.

2. Marrëdhëniet juridiko-civile me operatorët televizivë përcaktohen në kontratat e veçanta që lidhen ndërmjet palëve, të hartuara në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi që rregullojnë këto çështje.

Neni 36

Transmetimi i veprimtarive sportive

1. E drejta e transmetimit audioviziv të veprimtarive sportive kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipeve kombëtare të Republikës së Shqipërisë në rrugë ajrore, tokësore ose me çdo lloj mënyre tjetër transmetimi rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

2. Të ardhurat e përfituara nga e drejta e transmetimit audioviziv u kalojnë organizatorëve të veprimtarisë sportive në masën nëntëdhjetë për qind, ndërsa dhjetë për qind i kalon Buxhetit të Shtetit.

3. Transmetimi i informacionit nga operatorët e tjerë audiovizivë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Neni 37

Reklamimi

Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, ku ata zhvillojnë veprimtarinë sportive, për qëllime reklamimi ose sponsorizimi me personat fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese të lidhura me to.

Neni 38

Sponsorizimi

1. Klubet sportive ose sportistët, për sportet individuale, në përputhje edhe me rregulloret e federatave përkatëse të sportit, kanë të drejtë të vendosin në uniformat që përdorin gjatë zhvillimit të veprimtarisë sportive emrin e shoqërisë sponsorizuese, të shoqërisë sportive ose klubit sportiv, gjithmonë në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e sponsorizimit ndërmjet klubit, federatës së sportit ose sportistëve dhe sponsorizuesit. Kontratat hartohen në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe sipas standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare.

2. Madhësia dhe forma e mbishkrimeve duhet të jenë në përputhje me normat e rregullores së federatës përkatëse sportive dhe me aktet ligjore në fuqi.

KREU VIII FINANCIMI I SPORTIT

Neni 39

Financimi nga buxheti i shtetit

1. Fondet e Buxhetit të Shtetit për sportin përcaktohen në Buxhetin vjetor të Shtetit.

2. Në financimin e sportit përfshihen edhe burimet financiare nga pushteti vendor, organizatat sportive, federatat ndërkombëtare sportive, bastet sportive, donacionet, sponsorizimet, e drejta televizive, reklama dhe nga ndonjë burim tjetër i ligjshëm.

Neni 40

Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit

Pranë ministrisë përgjegjëse për sportin krijohet Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit nga të ardhurat që sigurohen nga bastet sportive dhe lojërat e fatit, sipas legjislacionit në fuqi për lojërat e fatit. Kriteret për shpërndarjen dhe përdorimin e Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit për organizatat sportive miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41

Organizimi i veprimtarive sportive

1. Organizuesi i veprimtarisë sportive duhet të njoftojë njësitë e qeverisjes vendore dhe organet e rendit në territorin administrativ ku do të zhvillohet veprimtaria.

2. Afati për informimin e njësisë së qeverisjes vendore dhe organeve të rendit është jo më pak se shtatë ditë kalendarike përpara zhvillimit të veprimtarisë.

Neni 42

Organizimi i lojërave olimpike rajonale, garat finale botërore dhe kampionatet europiane e botërore

1. Lojërat olimpike dhe veprimtaritë me karakter olimpik organizohen nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

2. Garat finale botërore dhe kampionati europian e ai botëror në Republikën e Shqipërisë organizohen nga federatat sportive me mbështetjen e strukturave përgjegjëse të sportit në ministrinë përgjegjëse për sportet.

3. Për organizimin e lojërave olimpike, të garave finale botërore dhe të kampionatit europian e të kampionatit botëror duhet të plotësohen kërkesat e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe të federatave sportive ndërkombëtare.

4. Sportistët dhe ekipet që përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në garat sportive ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e federatave përkatëse sportive, përdorin simbolin kombëtar.

KREU IX

ANTIDOPINGU NË SPORT

Neni 43

Përdorimi i substancave dhe metodave doping

1. Në procesin stërvitor dhe në veprimtaritë sportive është i ndaluar përdorimi i substancave dhe metodave doping.

2. Lista e substancave dhe metodave doping të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.

3. Përdorimi i substancave dhe metodave doping, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga federatat përkatëse.

Organizata Kombëtare Antidoping

1. Veprimtarinë kundër dopingut në Republikën e Shqipërisë e ushtron Organizata Kombëtare Antidoping. Organizata Kombëtare Antidoping është organizatë jofitimprurëse, e themeluar nga jo më pak se tre federata shqiptare të sporteve olimpike. Organizimi dhe funksionimi i Organizatës Kombëtare Antidoping bëhen sipas statutit të miratuar nga ministri përgjegjës për sportin dhe gjykata kompetente.

2. Ndryshimet statutoire miratohen nga ministri përgjegjës për sportin, brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të dokumentit me ndryshimet përkatëse. Pas kalimit të këtij afati, ndryshimet statutoire konsiderohen të miratuara në heshtje. Pas përfundimit të kësaj procedure, ndryshimet statutoire regjistrohen në gjykatë.

3. Organizata Kombëtare Antidoping mund të financohet me fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit, organizmat ndërkombëtarë në të cilat aderohet, federatat shqiptare të sportit, si dhe burime të tjera të ligjshme.

4. Ministria përgjegjëse për sportin njihet vetëm një Organizatë Kombëtare Antidoping dhe asnjë organizatë tjetër nuk mund të ushtrojë atributet e saj.

5. Organizata Kombëtare Antidoping ndërmerr masat e nevojshme, sipas Konventës Europiane Antidoping, për kontrollin antidoping të sportistëve dhe merr masat e parashikuara ndaj personave që përdorin ose nxisin përdorimin e dopingut.

6. Federatat shqiptare të sportit pranojnë autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping për kontrollin e sportistëve, anëtarë të tyre, dhe dënimin e përdoruesve të dopingut. Ky detyrim përcaktohet në statutin e federatës.

7. Organizata Kombëtare Antidoping dhe të gjitha organizatat sportive janë të detyruara të respektojnë antidopingun, sipas përcaktimeve të bëra në dispozitat e Konventës Ndërkombëtare Kundër Dopingut në Sport, 2005, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9623, datë 16.10.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër Dopingut në Sport, 2005", dhe Konventës Europiane Antidoping të vitit 1989, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9242, datë 17.6.2004, "Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989".

KREU X

KONTROLI MJEKËSOR DHE KËRKIMI SHKENCOR

Kontrolli mjekësor në sport

1. Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në një federatë dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e anëtarësuar pajisen me kartelë mjekësore vetjake.

2. Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të licencuar, të paktën një herë në gjashtë muaj, për matjen e parametrave jetësorë. Sporte të veçanta, për natyrën e veçantë të tyre, parashikojnë në rregulloret e funksionimit kontrole mjekësore më të shpeshta.

3. Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Qendrës së Shërbimit të Sportit dhe Përgatitjes së Ekipeve Kombëtare.

4. Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.

Neni 46

Sigurimi shëndetësor i sportistëve

1. Organizatat sportive, anëtare të federatave përkatëse, janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë sportive.
2. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
3. Organizata sportive, anëtare e federatave që lejojnë pjesëmarrjen e sportistëve të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. Federatat sportive përkatëse janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve të ekipeve kombëtare gjatë grumbullimeve stërvitore dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare.

Neni 47

Kërkimi shkencor dhe kualifikimi në sport

Shteti mbështet dhe financon kërkimin shkencor në sport. Kualifikimi dhe kërkimi në sport realizohen nga institucionet shkencore të specializuara.

KREU XI

PARANDALIMI I DHUNËS NË SPORT

Neni 48

Ndalimi i provokimeve dhe i sjelljeve të palejuara

1. Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve.
2. Gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen ndalohen sjelljet e palejuara të mëposhtme:
 - a) sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve;
 - b) gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve;
 - c) shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor;
 - ç) ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike;
 - d) dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv;
 - dh) veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë;
 - e) hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv;
 - ë) hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik;
 - f) djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj. ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv;
 - g) përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës;
 - gj) trukimi i rezultateve të veprimtarive sportive.
3. Organizatori i veprimtarisë sportive është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.

Neni 49

Sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive

1. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.

2. Gjatë veprimtarive sportive, personat, në cilësinë e përfaqësuesit të federatave, gjyqtarëve dhe vëzhguesve, janë të paprekshëm.

Neni 50

Detyrimi për njoftimin e Policisë së Shtetit

Organizatori i një veprimtarie sportive është i detyruar të njoftojë Policinë e Shtetit me shkrim të paktën shtatë ditë kalendrike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarrëvajtjen e saj. Në këtë njoftim, organizatorët duhet të përcaktojnë edhe shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF) të kontraktuar për marrjen e masave të sigurisë në mjediset sportive.

Neni 51

Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike

1. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjediset sportive është detyrë institucionale e organeve të Policisë së Shtetit.

2. Administratorët e objekteve dhe mjediseve sportive, në bashkëpunim me klubet sportive, nëpërmjet shoqërive private të sigurisë fizike, duhet të marrin këto masa:

- a) të kryejnë kontrollin rigoroz të tifozëve në portat e hyrjeve në mjedisin sportiv;
- b) të kryejnë sigurimin e vendkalimeve publike në mjedisin sportiv;
- c) të kryejnë drejtimin e spektatorëve tek ulëset në mjedisin sportiv dhe mbajtjen e tyre nën kontroll;
- ç) të kryejnë sigurimin dhe mbrojtjen e lojtarëve nga futja e tifozëve në mjedisin sportiv.

3. Administratorët e mjediseve sportive marrin masat për caktimin e një ambienti të përshtatshëm për drejtuesit e njësisë policore për monitorimin e situatës së rendit publik në mjedisin sportiv.

Neni 52

Roli i oficerit të sigurisë

1. Në veprimtaritë ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, federatat shqiptare të sportit marrin masa për sigurinë e ekipeve kombëtare nëpërmjet kontaktimit të oficerit të sigurisë.

2. Oficeri i sigurisë duhet të ketë qenë në nivelin drejtues në Policinë e Shtetit, të ketë përvojë në organizimin dhe menaxhimin e masave të sigurisë gjatë veprimtarive sportive dhe ndeshjeve të futbollit, si dhe të ketë gatishmërinë për të punuar me autoritetet publike dhe të Policisë së Shtetit.

3. Oficeri i sigurisë mban kontakte me autoritetet policore, shërbimet e urgjencës dhe përfaqësuesit e tifozëve. Ai është përgjegjës për vlerësimin dhe raportimin tek organizatori i veprimtarisë sportive dhe ndeshjeve të futbollit, duke marrë masat që ato të mos ndikojnë në sigurinë e veprimtarisë.

4. Oficeri i sigurisë është përgjegjës për vlerësimin e adresimin e rreziqeve dhe për marrjen e masave në koordinim me policinë, shërbimet e emergjencës, autoritetet publike dhe çdo subjekt tjetër të përfshirë në menaxhimin e ngjarjes.

Neni 53

Ndalimi i hyrjes në mjediset sportive

1. Ndalohet hyrja deri në një vit në mjediset sportive e personave, ndaj të cilëve janë zbatuar dispozitat e parashikuara në nenin 49, të këtij ligji, më shumë se një herë.
2. Ndalohet hyrja në mjediset sportive deri në dy vjet e personave, ndaj të cilëve janë zbatuar dispozitat e parashikuara në nenin 49, të këtij ligji, më shumë se dy herë.
3. Vendimin për ndalimin e hyrjes në mjediset sportive e jep Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë komisariatit të Policisë së Shtetit, nën juridiksionin e të cilit zhvillohet veprimtaria sportive ku është konstatuar kundërvajtja.
4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.
5. Komisariati i policisë njofton me shkrim personin, ndaj të cilit jepet vendimi, federatën shqiptare të sportit përkatës dhe klubin sportiv, tifoz i të cilit është personi.
6. Kundër vendimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjes pranë komisariatit të policisë, për sanksionet e parashikuara në ligj, bëhet ankim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit, sipas dispozitave të ligjit për kundërvajtjet administrative, në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave. Përbërja, kompetencat dhe procedurat e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

Neni 54

Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës

1. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës është një organ këshillimor pranë ministrit përgjegjës për sportin. Ky komision harton politika për parandalimin e dhunës gjatë veprimtarive sportive dhe shfaqjeve sportive. Përbërja, funksionimi, kompetencat dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve të këtij komisioni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Komisioni Kombëtar Kundër Dhunës në Sport dhe të gjitha organizatat sportive, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport, ku aderon Republika e Shqipërisë.

KREU XII

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 55

1. Shkelja e dispozitave detyruese të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.
2. Shkelja e pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
3. Shkelja e nenit 49, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga dhjetë mijë deri në pesëdhjetë mijë lekë, e cila vendoset nga Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë komisariatit të policisë vendore, bazuar në aktkonstatimin e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Neni 56

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative

1. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.
2. Shuma e arkëtuar nga vjelja e gjobave derdhet njëqind për qind në favor të Buxhetit të Shtetit.

Neni 57

Masat

1. Dënohen me gjobë në shumën nga njëqind mijë deri në pesëqind mijë lekë organizatat sportive, si dhe anëtarët e tyre në rast se:

a) kryejnë veprimtari sportive pa marrë më parë pëlqimin nga federata sportive përkatëse, në të cilën janë të anëtarësuar;

b) organizojnë ose bëjnë propagandë politike e fetare gjatë veprimtarive sportive.

2. Gjobat vendosen nga komisionet e disiplinës të organizatave sportive dhe derdhen njëqind për qind në buxhetin e federatës përkatëse. Dënimi me gjobë mund të shoqërohet edhe me masa të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë sportive për një periudhë kohore nga gjashtë muaj deri në një vit. Masat shoqëruese jepen nga komisionet disiplinore të federatave përkatëse.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 58

Ndryshimi i statuteve të organizatave sportive

Statutet e organizatave sportive, të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e këtij ligji, ndryshohen nga organizatat dhe paraqiten për miratim pranë ministrisë përgjegjëse për sportin brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 59

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 6; 9, pika 2; 27, pika 3; 40 dhe 54, pika 1, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministrat përgjegjës që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 1, dhe 40, të këtij ligji.

3. Deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, zbatohen aktet nënligjore që janë në fuqi.

Neni 60

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 61

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Miratuar në datën 27.4.2017

Shpallur me dekretin nr. 10333, datë 18.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.

LIGJ
Nr. 112/2013

**PËR DEKORATAT, TITUJT E NDERIT, MEDALJET DHE TITUJT VENDORË
TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË²²**

(Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, datë 19.2.2015)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 92 shkronja “ç” dhe 113 pika 1 shkronja “dh” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është njohja e përkushtimit ndaj Republikës së Shqipërisë, interesave kombëtarë dhe shoqërisë, nëpërmjet përcaktimit të rregullave për vlerësimin e personave me merita dhe kontribut të veçantë për vendin, si dhe shpërblimin e tyre.

Neni 2

Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i llojeve të dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit, që jepen në Republikën e Shqipërisë, si dhe i autoriteteve shtetërore përgjegjëse, rregullave, procedurave dhe kritereve për propozimin, shqyrtimin, dhënien dhe mbajtjen e tyre.

Neni 3

Parimi i përgjithshëm

1. Dhënia e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.

2. Përfitimi i një dekorate, titulli nderi, medaljeve apo titulli vendor nderi nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohej si e tillë, në rrugë individuale apo institucionale.

3. Personi që ka marrë një dekoratë nga Presidenti i Republikës nuk mund të përfitojë më vonë në kohë një titull nderi, medalje apo titull vendor nderi.

Neni 4

Shpërblimi

1. Dhënia e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit mund shoqërohet me një shpërblim financiar, sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës.

²² Ligji nr. 112/2013, datë 4.4.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 15 prill 2013.
Ligji nr.10/2015, datë 19.2.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.32, datë 9 mars 2015.

2. Masa dhe rregullat për dhënien e shpërblimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

3. Efektet financiare përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për autoritetin përgjegjës përkatës.

Neni 5 **Përfundim**

Ky ligj nuk zbatohet për medaljet apo certifikatat që japin autoritetet ushtarake dhe policore për pjesëtarët e Forcave të Armatosura apo të Policisë së Shtetit, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

KREU II DEKORATAT, TITUJT E NDERIT, MEDALJET DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT

SEKSIONI 1 DEKORATAT DHE TITUJT E NDERIT

Neni 6 **Dhënia e dekoratave dhe titujve të nderit**

1. Dekoratat dhe titujt e nderit jepen me synim shpërblimin e akteve të veçanta, merite apo trimërie, ndaj kombit shqiptar apo interesave të tij.

2. Presidenti i Republikës është i vetmi autoritet që jep dekorata dhe tituj nderi në nivel kombëtar.

3. Ato përbëhen prej një medaljeje të madhe dhe një medaljeje të vogël, të dyja të arta, sipas specifikimeve konkrete të miratuara nga Presidenti i Republikës.

4. Dekoratat dhe titujt e nderit jepen kryesisht nga Presidenti i Republikës ose me propozim të:

- a) Kryetarit të Kuvendit;
- b) Kryeministrit;
- c) ministrave;
- ç) Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese;
- d) Kryetarit të Gjykatës së Lartë;
- dh) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- e) Shefit të Shtabit të Përgjithshëm;
- ë) Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- f) Avokatit të Popullit;
- g) Kryetarit të Akademisë së Shkencave.

Neni 7 **Llojet e dekoratave dhe titujve të nderit**

Dekoratat dhe titujt e nderit në Republikën e Shqipërisë, sipas rëndësisë, janë:

1. “Dekorata e flamurit kombëtar”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për merita të jashtëzakonshme për lartësimin e shtetit dhe të kombit shqiptar.

2. Dekorata “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për ndihmesë të qenësishme ose kontribut madhor në mbrojtjen, forcimin apo përparimin e faktorit shqiptar kudo në botë.

3. Dekorata “Nderi i kombit”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare që, me veprat dhe emrin e tyre, nderojnë kombin shqiptar brenda dhe jashtë vendit.

4. Dekorata “Nënë Tereza”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për akte të shquara humanizmi ndaj kombit shqiptar dhe njerëzimit.

5. “Dekorata e artë e shqiptonjës”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për trimëri në luftën e armatosur dhe për veprimtari ose akte të guximit qytetar në kohë paqeje.

6. Dekorata “Pishtar i demokracisë”, e cila u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për shërbime të shquara dhe sakrifica të kryera për kombin shqiptar dhe demokracinë.

7. Titulli “Kalorës i urdhrit të Skënderbeut”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për akte të veçanta heroike në mbrojtjen, forcimin dhe përparimin e Republikës së Shqipërisë.

8. Titulli “Kalorës i urdhrit të flamurit”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për veprimtarinë e tyre në dobi të shtetit dhe kombit shqiptar.

9. Titulli “Martir i demokracisë”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja, që janë martirizuar për veprimtarinë e tyre të shquar për lirinë, demokracinë dhe përparimin shoqëror të Republikës së Shqipërisë dhe të kombit shqiptar.

10. Titulli “Mjeshtër i madh”, i cili u jepet punonjësve të fushave të ndryshme të shkencës, artit, sportit, drejtimit, prodhimit dhe biznesit për punë të shquara dhe kontribut thelbësor në zhvillimin e sektorit.

11. Titulli “Naim Frashëri”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja, punonjësve të shkencës, artit, kulturës dhe arsimit për veprimtari të çmuara dhe lartësimin e Republikës së Shqipërisë në fushën përkatëse.

12. Titulli “Për merita të veçanta civile”, i cili u jepet personaliteteve shqiptare dhe të huaja për merita të veçanta civile në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 2

MEDALJET

Neni 8

Dhënia e medaljeve

1. Me dhënien e medaljeve shpërblehet veprimtaria e shquar në një fushë të veçantë profesionale.

2. Ato përbëhen prej një medaljeje dhe një certifikate, sipas specifikimeve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Medaljet jepen kryesisht, ose me propozim të subjekteve të interesuara, ku përfshihen drejtuesit e institucioneve shtetërore.

Neni 9

Autoriteti përgjegjës

(Shfuqizuar shkronja “c” me ligjin nr.10/2015, datë 19.2.2015)

Autoriteti përgjegjës për dhënien e medaljeve, sipas llojit të tyre, është:

a) Kuvendi;

b) Kryeministri;

c) *Shfuqizuar*;

ç) ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike;

d) ministri, ku përfshihet çdo ministër i ndryshëm nga ministri përgjegjës për Forcat e Armatosura dhe ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 10

Medalja që jep Kuvendi

Kuvendi, me propozim të 1/5 së deputetëve, jep medaljen “Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë” për personalitete shqiptare ose të huaja, për vepra me efekte të spikatura në historinë dhe kulturën e kombit shqiptar, të cilat njihen si arritje madhore.

Neni 11

(Shfuqizuar me ligjin nr.10/2015, datë 19.2.2015)

Neni 12

Lloji i medaljeve që jep ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike

Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, kryesisht, ose me propozim të titullarëve të institucioneve të varësisë, jep këto medalje:

1. “Medalja e nderit” u jepet punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, punonjësve të shërbimeve mbështetëse, si dhe punonjësve të huaj të policisë, të atashuar në vendin tonë, të cilët shquhen për merita dhe shërbime të veçanta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit e të qetësisë publike, në ruajtjen dhe administrimin e pronës dhe në ushtrimin e përgjegjësisë të tjera të parashikuara nga ligji për Policinë e Shtetit, si dhe në mbështetjen e Policisë së Shtetit.

2. Medalja “Për trimëri” u jepet punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të cilët tregojnë cilësi të veçanta, kurajë e guxim në realizimin e detyrave, misionëve dhe zgjidhjen e situatave të jashtëzakonshme.

3. Medalja “Për shpëtim jete” u jepet punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të cilët kryejnë akte ose veprime heroike në një konflikt, operacion a situatë të jashtëzakonshme për shpëtimin e jetës së personaliteteve, kolegëve, duke vënë në rrezik jetën e tyre.

Neni 13

Lloji i medaljeve që japin Kryeministri dhe ministrat

Kryeministri dhe ministrat, kryesisht, ose me propozim të titullarëve të institucioneve të varësisë, japin këto medalje:

1. Medalja “Mirënjohje publike”, për personalitete të shquara ose personalitete shqiptare dhe të huaja me kontribut të veçantë në fushën e veprimtarisë brenda përgjegjësisë së tyre.

2. Medalja “Vlerësim profesional”, për personalitete të shquara, në veprimtarinë profesionale, në fushën e veprimtarisë brenda përgjegjësisë së tyre.

SEKSIONI 3

TITUJT VENDORË TË NDERIT

Neni 14

Dhënia e titujve vendorë të nderit

1. Titujt vendorë të nderit jepen për shpërblimin e veprimtarisë së shquar brenda juridiksionit të njësisë të qeverisjes vendore ose për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit vendor.

2. Ato përbëhen prej një rrethi të argjendtë dhe një certifikate, sipas specifikimeve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15
Autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse për dhënien e titujve vendorë të nderit janë:
 - a) këshilli komunal ose bashkiak;
 - b) këshilli i qarkut.
2. Titujt vendorë të nderit jepen, kryesisht, ose me propozimin e:
 - a) çdo anëtar i të këshillit komunal ose bashkiak;
 - b) kryetarit të komunës ose bashkisë;
 - c) çdo anëtar i të këshillit të qarkut;
 - ç) kryetarit të këshillit të qarkut.

Neni 16
Llojet e titujve vendorë të nderit

1. Titulli “Qytetar nderi” i jepet nga këshilli komunal apo bashkiak çdo personaliteti shqiptar ose të huaj për veprimtari të shquar në dobi të komunës apo bashkisë përkatëse ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të saj.
2. Titulli “Nderi i qarkut” i jepet nga këshilli i qarkut çdo personaliteti shqiptar ose të huaj për veprimtari të shquar në dobi të qarkut përkatës apo për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tij.

KREU III
**PROCEDURA E DHËNIES SË DEKORATAVE, TITUJVE TË NDERIT, MEDALJEVE
OSE TITUJVE VENDORË TË NDERIT**

Neni 17
Komisioni këshillimor

1. Çdo autoritet përgjegjës për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendorë të nderit krijon pranë tij një komision këshillimor, të përbërë prej 5 anëtarësh, ku 3 anëtarë duhet të jenë punonjës nën varësinë e tij dhe 2 anëtarët e tjerë personalitete të jashtme.
2. Në rastin e medaljes “Qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë”, funksionet e komisionit këshillimor ushtrohen nga njëri prej komisioneve të përhershme të Kuvendit, i cili mbulon fushën që përfshin aktin për të cilin është propozuar dhënia e medaljes.
3. Të gjitha propozimet për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit i dërgohen autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre, i cili i përcjell menjëherë për vlerësim në komisionin këshillimor.
4. Komisioni këshillimor shpreh mendimin e tij edhe nëse nisma për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljeve ose titujve vendorë të nderit ndërmerret kryesisht nga autoriteti përgjegjës për dhënien e tyre.
5. Mbledhjet e komisionit këshillimor zhvillohen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.
6. Rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit këshillimor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastin e komisionit këshillimor për dhënien e dekoratave dhe titujve të nderit, rregullat miratohen nga Presidenti i Republikës.

Neni 18

Propozimi për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit

1. Propozimi duhet të dërgohet jo më vonë se 90 ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit, me përjashtim të rasteve të veçanta kur respektimi i këtij afati është bërë objektivisht i pamundur.

2. Në aktin e propozimit përcaktohen:

- a) autoriteti propozues dhe baza ligjore për propozimin;
- b) emri, mbiemri dhe prezantimi i personit të propozuar;
- c) arsyet e hollësishme që çojnë në propozimin e personit;
- ç) lloji i dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit;
- d) elementet që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve përkatëse për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit;
- dh) vërtetimi se personi i propozuar nuk është dënuar ndonjëherë për shkelje të rënda të ligjit ose nuk është nën hetim;
- e) në rastin e dekoratave, vërtetimi se personit të propozuar nuk i është dhënë më parë një dekoratë e njëjtë ose më e lartë se ajo e propozuar.

Neni 19

Shqyrtimi i propozimit

1. Komisioni këshillimor verifikon nëse akti i propozimit përmban të gjitha elementet e kërkuara nga ky ligj.

2. Nëse propozimi nuk është i plotë, komisioni këshillimor kërkon me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së propozimit, plotësimin e tij nga autoriteti propozues. Plotësimi i propozimit bëhet jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

3. Nëse propozimi është i plotë, komisioni këshillimor paraqet mendimin e tij pranë autoritetit përgjegjës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së propozimit.

4. Procedurat për shqyrtimin e dhënies së një dekorate, medalje ose titulli nderi nuk mund të zgjasin më shumë se 60 ditë kalendarike.

5. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dekorimit, dhënies së titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 20

Miratimi i propozimit

1. Propozimi miratohet:

- a) me dekret, në rastin e dekoratave dhe titujve të nderit;
- b) me vendim, në rastin e medaljes së dhënë nga Kuvendi;
- c) me urdhër, në rastin e medaljeve të dhëna nga Kryeministri dhe ministrat;
- ç) me vendim, në rastin e titujve vendorë të nderit.

2. Në rast se propozimi miratohet, dekreti, urdhri ose vendimi i dërgohet komisionit këshillimor, me qëllim përgatitjen e medaljeve, rrathëve të argjendta dhe certifikatave përkatëse.

3. Pas përgatitjes së medaljeve, rrathëve të argjendta dhe certifikatave përkatëse, komisioni këshillimor njofton autoritetin propozues për miratimin e propozimit dhe njofton për organizimin e ceremonisë për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit, duke dërguar të dhëna për programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia.

Neni 21
Refuzimi i propozimit

1. Kur propozimi për dekorim, dhënien e titullit të nderit, medaljes, titullit vendor të nderit nuk miratohet, komisioni këshillimor i bën njoftimin autoritetit propozues për mosmiratimin.

2. I njëjti propozim nuk mund të bëhet pa kaluar 1 vit kalendarik nga njoftimi i refuzimit të propozimit.

Neni 22
Organizimi i ceremonisë

1. Ceremonia e dhënies së dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit organizohet nga autoriteti që ka bërë propozimin, në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për dhënien e tyre.

2. Dhënia e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendorë të nderit bëhet në çdo rast me ceremoni, e cila mund të jetë publike ose jopublike, sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës.

3. Ceremonia e dhënies së dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i tij/i saj.

4. Si rregull, dhënia e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit është e lidhur me përvjetorë e ngjarje të rëndësishme historike e aktuale, si dhe me festat kombëtare.

5. Dekoratën, titullin e nderit, medaljen ose titullin vendor të nderit e jep autoriteti përgjegjës ose një person i autorizuar prej tij.

6. Dekorata, titulli i nderit, medalja ose titulli vendor i nderit i jepet vetë personit. Në rast se nderimi bëhet pas vdekjes, dekorata, titulli i nderit, medalja ose titulli vendor i nderit u jepet familjarëve më të afërt të personit.

7. Në raste të veçanta, për personalitete me merita shumë të spikatura, ceremonia organizohet në selinë e autoritetit përgjegjës dhe dekorata, titulli i nderit, medalja ose titulli vendor i nderit jepet nga titullari i autoritetit përgjegjës.

8. Çasti i dorëzimit të dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht, nëpërmjet të njëjtut akt, me të cilin është dhënë fillimisht, për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dekorimit, dhënies së titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 23
Mbajtja e medaljeve
(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr.10/2015, datë 19.2.2015)

1. Personeli ushtarak i Forcave të Armatosura, në raste ceremoniale, vendos në uniformën ceremoniale dekoratat dhe medaljet që i jepen, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Medaljet e dhëna nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike mbahen në uniformën e punonjësit të policisë dhe në uniformën ceremoniale.

3. Rregullat e hollësishme për mbajtjen dhe përdorimin e dekoratave dhe medaljeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24
Dispozitë kalimtare

Dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit, që janë dhënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihen.

Neni 25
Shfuqizime

Ligji nr. 8113, datë 28.3.1996 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 9215, datë 1.4.2004 “Për medaljet për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, pika 1 e nenit 124 dhe pikat 1 dhe 3 të nenit 125 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 26
Aktet nënligjore
(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10/2015, datë 19.2.2015)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatim të pikës 2 të nenit 4, të pikës 2 të nenit 8, të pikës 2 të nenit 14 dhe të pikës 5 të nenit 17 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor, të dalë në bazë dhe për zbatim të pikës 3 të nenit 23 të këtij ligji.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8092, datë 8.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIG J
Nr.10 253, datë 11.3.2010

PËR GJUETINË²³
(Ndryshuar me ligjin nr.43/2013, datë 14.2.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- a) përcaktimin e rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike;
- b) menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj;
- c) garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike;
- ç) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë;
- d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Gjueti” është veprimtaria e specializuar e shfrytëzimit të faunës së egër, që ka të bëjë me ndjekjen, kapjen, vrasjen e kafshëve e të shpendëve, objekt gjuetie, me metodat e përcaktuara me ligj.
2. “Gjueti e qëndrueshme” është përdorimi i gjuetisë vetëm në respektim të vijueshëm të ruajtjes së biodiversitetit, të tërësisë së ekosistemit dhe të baraspeshës ekologjike.
3. “Menaxhimi i jetës së egër” është zbatimi i njohurive shkencore dhe tradicionale për përkujdesjen e popullatave të llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre, në mënyrë përfituese për mjedisin dhe shoqërinë.
4. “Sezoni i gjuetisë” është koha kur është e lejuar gjuetia për lloje të faunës së egër, objekt gjuetie.
5. “Zonë gjuetie” janë pjesë të sipërfaqeve tokësore dhe ujore, të shpallura si të tilla me një akt normativ, ku jetojnë lloje të faunës së egër, objekt gjuetie dhe të cilat mund të shfrytëzohen për ushtrimin e gjuetisë.

²³ Ligji nr. 10 253, datë 11.3.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.39, datë 12 prill 2010.
Ligji nr.43/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, datë 12 mars 2013.

6. “Zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim” janë pjesë të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, të paracaktuara për shtimin e popullatave të llojeve, objekt gjuetie.

7. “Rezervate të mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie” është sipërfaqe jo më e vogël se 40 ha që përdoret për kultivimin gjysmënatyror të një apo disa llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

8. “Menaxhuesi i zonës së gjuetisë” është personi fizik ose juridik, që menaxhon zonën e gjuetisë, sipas dispozitave të këtij ligji.

9. “Trofe të gjuetisë” janë pjesë të objekteve të gjuetisë të përpunuara, të fituara me anë të gjuetisë, të cilat shfrytëzohen për qëllime shkencore, estetike, kulturore dhe studimore.

10. “Produkte të gjuetisë” janë objekte gjuetie të përfutuara me anë të gjuetisë, të kapura gjallë, të therura, të rrjepura, pjesët e tyre, si mish e nënprodukte të tij, përfshirë trofetë e gjuetisë.

11. “Norma e gjahut” është sasia e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, e lejuar për t’u vrarë nga një gjahtar në një ditë gjuetie.

12. “Kapaciteti i lejuar i zonave të gjuetisë” nënkupton:

a) sasinë maksimale të gjuetarëve, që mund të gjuajnë në një ditë, në një zonë të gjuetisë, duke respektuar rregullat e sigurimit teknik;

b) numrin e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, që mund të gjuhen në një ditë, në një zonë të gjuetisë.

13. “Lloje, objekt gjuetie, në kushte gjysmë të lira” është mbajtja e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, në kushte të krijuara artificialisht, ku ato ushqehen, kryesisht, me ushqime natyrore, por nuk kanë mundësi të lëvizin lirshëm jashtë kufijve të pjesës së izoluar të zonës së gjuetisë.

14. “Lloje, objekt gjuetie, në gjendje robërie” është mbajtja e individëve të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, në territore të rrethuara, ku ato nuk kanë mundësi të ushqehen me ushqime natyrore dhe të dalin nga këto territore.

15. “Dhënia me qira e zonës së gjuetisë” është dhënia në shfrytëzim e zonës së gjuetisë, nëpërmjet procedurave të ofertës publike, personave fizikë apo juridikë, për një afat deri në 10 vjet.

16. “Plani menaxhues” është dokumenti zyrtar, në bazë të të cilit bëhet menaxhimi i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie dhe i zonës së gjuetisë për një afat kohor prej 10 vitesh.

17. “Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie” është dokumenti që, në përputhje me planin 10-vjeçar të menaxhimit të një zone gjuetie, jep me hollësi veprimet për menaxhimin e gjuetisë në një zonë konkrete, gjatë një viti.

18. “Gjueti turistike” është veprimtaria e kryer nga gjuetarë, që udhëtojnë në distanca të konsiderueshme nga vendi ku jetojnë ose nga zona e tyre e gjuetisë dhe shpesh jashtë vendit, për qëllime gjuetie.

19. “Gjueti turistike e organizuar” është përdorimi i paguar i veprimtarisë së gjuetisë dhe i produkteve të saj, të lidhura me krijimin dhe përdorimin e shërbimeve.

20. “Operator i tureve të gjuetisë” është agjencia ose janë agjentët që sigurojnë shërbime për turistët gjuetarë.

21. “Manuali i gjuetarit” është tërësia e rregullave dhe e kërkesave, që karakterizojnë gjuetinë dhe figurën e gjuetarit.

22. “Trajner” është personi i specializuar për stërvitjen e qenve të gjahut.

23. “Ministria” është ministria përgjegjëse për gjuetinë.

24. “Ministri” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për gjuetinë.

KREU II

LLOJET E FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE

Neni 3

Llojet, objekt gjuetie

1. Gjuetia ushtrohet vetëm mbi individë të llojeve të faunës së egër, që janë shpallur objekt gjuetie me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Për përgatitjen e listës, ministria bashkëpunon me institucionet kërkimore-shkencore përkatëse dhe me Agjencinë e Mjedisit dhe të Pyjeve.

2. Janë objekt i gjuetisë individë të llojeve të faunës së egër, lokalë ose migratorë, që jetojnë në gjendje të lirë në kushte natyrore apo që janë riprodhuar për t'u gjuajtur në territore të rrethuara, në gjendje gjysmë të lirë a në robëri.

3. Nuk janë objekt i ushtrimit të gjuetisë dhe nuk lejohen të gjuhen individët:

a) e llojeve të faunës së egër, të mbrojtura nga konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) e llojeve të faunës së egër, që janë të rralla, të kërcënuara, në rrezik zhdukjeje dhe që bëjnë pjesë në listën e llojeve të mbrojtura;

c) e të gjitha llojeve të shpendëve të egër migratorë, të cilët, pas vlerësimit të popullatave të tyre, rezultojnë shumë të rrallë. Vlerësimi i llojeve migratore është pjesë e inventarizimit.

Neni 4

Gjuajtja e llojeve të ndaluara

1. Gjuajtja e individëve të llojeve të ndaluara, përjashtimisht, mund të bëhet në rastet:

a) e shtimit intensiv dhe të pakontrolluar të popullatës së një lloji;

b) e shfaqjes së situatave epizodike në llojet e faunës së egër;

c) e shkaktimit të dëmtimeve të vazhdueshme nga individët e një lloji.

2. Gjuajtja për rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni bëhet me autorizim të ministrit, në të cilin saktësohen lloji, sasia, zona e gjuetisë dhe koha e gjuetisë.

Neni 5

Gjuetia reduktuese

1. Kur popullata e një lloji të faunës së egër e lejuar për gjueti është shtuar shumë dhe prish ekuilibrin e zonës, zhvillohet gjuetia reduktuese.

2. Gjuetia reduktuese autorizohet nga ministri me propozimin e DSHP-së, e cila merr në konsideratë informacionin e menaxhuesit të zonës, shoqatave të gjuetisë, njësive të qeverisjes vendore dhe institucionet kërkimore-shkencore.

3. Gjuetia reduktuese kryhet me gjuetarë të pajisur me leje vetëm gjatë sezonit dhe me metodat e lejuara të gjuetisë.

Neni 6

Gjuajtja për qëllime kërkimore-shkencore

1. Gjahu për qëllime shkencore përfshin gjuajtjen ose zënien e kafshëve të egra për hulumtime shkencore, për mësim universitar, për shumim të kafshëve për gjah ose për qëllime të tjera didaktike.

2. Individë të llojeve të faunës së egër, që nuk janë objekt gjuetie, mund të gjuhen për nevoja të punës kërkimore-shkencore, me miratim të veçantë të ministrit.

3. Gjuajtja për qëllime kërkimore-shkencore bëhet me autorizim të ministrit, brenda 20 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës, në të cilin përcaktohet koha, vendi dhe metoda e lejuar e gjuetisë, llojet, objekt gjuetie, arsyetimi i veprimtarisë që do të kryhet, si dhe detyrimi për të raportuar numrin e kafshëve të vrara.

4. Institucioni kërkimor-shkencor e realizon gjuajtjen, duke angazhuar gjuetarë të pajisur me leje gjuetie. Në përfundim të gjuajtjes, ai dorëzon në DSHP raportin për rezultatet e arritura dhe të dhënat konkrete për individët e vrarë apo të kapur.

Neni 7

Vrasja emergjente e kafshës së egër

1. Në rastet kur kafsha e egër kërcënon dëmtimin e shpejtë dhe të rëndë të jetës së njerëzve, mund të bëhet vrasja emergjente e saj, për të parandaluar rrezikun në jetën e njerëzve.

2. Personat, që vrasin kafshët e egra gjatë rasteve të emergjencës, informojnë për këtë rast menaxhuesin e zonës dhe DSHP-në përkatëse.

3. Gjahtarët, që plagosin gjitarë të mëdhenj, i ndjekin gjurmët e kafshës së plagosur e, nëse është e nevojshme, lajmërojnë menaxhuesin e zonës më të afërt të gjuetisë.

KREU III

ZONAT E GJUETISË

Neni 8

Zonat e lejuara për gjueti

1. Gjuetia zhvillohet vetëm në zonat e lejuara për ushtrimin e gjuetisë.

2. Zonat e gjuetisë përfshijnë fondin pyjor dhe kullësor, tokat bujqësore, sipërfaqet ujore të brendshme, toka të pafrytshme, të populluara me lloje të faunës së egër, objekt gjuetie.

3. Sipërfaqet e përmendura në pikën 2 të këtij neni përdoren për gjueti vetëm kur janë të përfshira në territoret e një zone konkrete, të lejuar për gjueti.

4. Zonat e gjuetisë shtrihen në sipërfaqe që janë me pronësi shtetërore, private apo në përdorim komunal.

Neni 9

Zonat rezidenciale të gjuetisë

1. Për ushtrimin e gjuetisë nga personalitete politike e shtetërore të vendit, nga anëtarë të trupit diplomatik, të akredituar në vendin tonë, si dhe nga personalitete, që vizitojnë vendin tonë dhe ftohen për gjueti nga personalitetet vendase, krijohen zonat rezidenciale të gjuetisë.

2. Miratimi i këtyre zonave, rregullat e ruajtjes dhe të përdorimit të tyre, si dhe përcaktimi i rrethit të personave që kanë të drejtë të gjuajnë në to, caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 10

Kriteret për krijimin e zonave të lejuara për gjueti

Për krijimin e zonave të gjuetisë mbahen parasysh këto kriteret:

a) zona e gjuetisë krijohet në sipërfaqe jo më të vogla se 500 ha, ndërsa zona për kultivimin e llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, krijohet në sipërfaqe jo më të vogla se 50 ha;

b) zona të mos përfshijë vendbanime dhe qendra ekonomike, tregtare, arsimore, sportive e fetare dhe të ndodhet jo më pak se 300 metra larg prej tyre;

c) zona të jetë në vende, ku ushtrimi i gjuetisë nuk mbart rrezik për jetën, shëndetin dhe pronën e njerëzve;

ç) zona të jetë e populluar me llojet e faunës së egër, objekt gjuetie, që jetojnë natyrshëm apo që kultivohen në të;

d) numri i individëve të llojeve, që mund të jetojnë e kultivohen në atë sipërfaqe, të mundësojë gjuajtjen e tyre të programuar.

Neni 11

Vendet e ndaluara për gjueti

1. Ushtrimi i gjuetisë ndalohet në:

- a) të gjitha sipërfaqet, që nuk përfshihen në një nga zonat e gjuetisë;
 - b) në monumentet e natyrës, rezervat strikte natyrore, parqet kombëtare dhe zonat Ramsar;
 - c) kullotat dhe livadhet në fazën e korrjes;
 - ç) fushat e kultivuara për prodhimin e varieteteve të farave;
 - d) vreshtat e mbjella rishtazi;
 - dh) vreshtat nga krasitja deri në vjeljen e prodhimit;
 - e) sipërfaqet e mbjella me drithëra, nga 1 prilli deri në përfundimin e korrjes së tyre;
 - ë) sipërfaqet ligatinore bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendët migratorë;
 - f) sipërfaqet ku zhvillohet akuakultura;
 - g) parcelat eksperimentale;
 - gj) hapësirat detare;
 - h) zonat e shpallura si zona me rëndësi të veçantë për shpendët;
 - i) zonat urbane dhe industriale;
 - j) aeroportet, heliodromet, rrugët dhe hekurudhat;
 - k) territoret e reparteve, të bazave e të instalimeve ushtarake;
 - l) varrezat dhe oborret e mbyllura;
 - ll) fidanishtet, pemishtet, vreshtat dhe kopshtet e destinuara për prodhim intensiv, në sipërfaqe deri në 100 ha, nëse janë të rrethuara, që pengon migrimin natyror të kafshëve të egra;
 - m) territoret, ku vërtetohet prania e sëmundjeve me patogjenitet të lartë.
2. Sipërfaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të atyre të përcaktuara në shkronjat “c”, “d”, “dh” dhe “e”, nuk mund të përfshihen në territoret e zonave për gjueti.
3. Ministria publikon në faqen e saj të internetit hartat, ku pasqyrohen zonat e lejuara dhe territoret e ndaluara për gjueti.

Neni 12

Propozimi i zonës së gjuetisë

1. Drejtoritë e shërbimit pyjor, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, studiojnë dhe propozojnë zonat e gjuetisë në shkallë vendi, duke i paraqitur propozimin me materialet përkatëse ministrisë. Materialet përmbajnë:

- a) të dhëna mbi sipërfaqen, shtrirjen dhe kufijtë e saj;
- b) hartën dhe skicat për plan-vendosjen;
- c) mendimin e njëjësive të qeverisjes vendore, në territoret e të cilave shtrihet zona që propozohet dhe të shoqatave të gjuetarëve.

2. Në përgatitjen e propozimit për shpalljen e zonave të gjuetisë zbatohen kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.

3. Zonat e gjuetisë miratohen me urdhër të veçantë të ministrit.

Neni 13

Shqyrtimi i propozimit

1. Drejtoritë përkatëse teknike të ministrisë, brenda 20 ditëve pune nga regjistrimi i tij në protokoll, shqyrtojnë propozimin, si dhe:

- a) studiojnë dokumentet e paraqitura nga DSHP-ja, duke kërkuar, sipas rastit, edhe plotësime e saktësime të tyre;
- b) vlerësojnë përputhshmërinë e propozimit me kërkesat e këtij ligji;
- c) vlerësojnë përputhshmërinë e propozimit me politikat, strategjitë e planet e veprimit për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit;
- ç) hartojnë mendimin e tyre me shkrim për propozimin e DSHP-së, të cilin ia përcjellin ministrit për nënshkrim.

2. Ministri miraton zonën e gjuetisë brenda një muaji nga data e paraqitjes së propozimit në protokollin e ministrisë.

Neni 14

Shpallja e zonës së gjuetisë

1. Ministria, brenda 5 ditëve nga miratimi i ministrit, shpall zonën e gjuetisë, duke njoftuar me shkrim DSHP-në që ka bërë propozimin, organet e qeverisjes vendore ku ndodhet zona, si dhe shoqatën e gjuetarëve.

2. Shpallja e miratimit të zonës së gjuetisë përfundon me publikimin e saj në shtyp dhe në faqen e internetit të ministrisë.

3. Personat, që mendojnë se cenohen nga shpallja e zonës së gjuetisë, mund të ankohen në gjykatë brenda një muaji nga shpallja e miratimit të zonës së gjuetisë.

Neni 15

Kufijtë e zonës së gjuetisë

1. Kufijtë e një zone gjuetie duhet të kenë vijimësi territoriale dhe të jenë në përputhje me relievin.

2. Përcaktimi i kufijve quhet i përfunduar, kur pronari ose menaxhuesi i zonës vendosin në terren shenjat dalluese të kufijve.

3. Ministri miraton udhëzimin për mënyrat e shënimit të kufijve të zonës së gjuetisë.

4. Askush nuk mund të marrë, të dëmtojë, të lëvizë ose të shkatërrojë shenjat e kufijve të zonës së gjuetisë, pa lejen e menaxhuesit të saj.

5. Nëse tokat e një zone të miratuar bëhen të papërshtatshme për gjueti, për shkak të ndërrimit të destinacionit, ministria miraton zvogëlimin e sipërfaqes së zonës së gjuetisë dhe menaxhuesi vendos në terren shenjat e kufijve të rinj.

Neni 16

Heqja e statusit të zonës së gjuetisë

1. Çdo zonë gjuetie e humbet statusin kur:

- a) për interesa të sigurisë kombëtare dhe për nevoja të mbrojtjes, organet kompetente vendosin ndryshimin e destinacionit të përdorimit të saj;
- b) për nevoja të zhvillimit rajonal, organet kompetente vendosin ndryshimin e destinacionit të përdorimit të saj;
- c) për shkak të përdorimit të keq dhe mbishfrytëzimit, zona humbet funksionet, për të cilat është krijuar;

ç) si pasojë e ndërhyrjeve të ligjshme, sipërfaqja e saj është zvogëluar nën minimumin e përcaktuar me këtë ligj.

2. Statusin e zonës së gjuetisë e heq organi që e ka miratuar. Heqja e statusit shpallet dhe publikohet me të njëjtat kërkesa e procedura, si dhe dhënia e tij.

Neni 17

Zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim

1. Për shtimin e popullatave të llojeve të faunës, objekt gjuetie, krijohen zona të ripopullimit dhe të kapjes së gjahut për ripopullim.

2. DSHP-të, në zbatim të objektivave të ministrisë për gjuetinë, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, paraqesin në ministri propozimet e tyre për shpalljen e zonave të ripopullimit në territoret që ato administrojnë.

3. Zona të ripopullimit shpallen territore të pyjeve dhe kullotave, jo më të vogla se 1 000 ha, ku popullatat e një ose disa llojeve, objekt gjuetie, rezultojnë të pakësuara ndjeshëm nga mbingjuajtja ose për shkaqe të tjera.

4. Krijimi i zonave të ripopullimit mbështetet në kërkesat si më poshtë:

- a) zona të ketë qenë tradicionalisht habitat i llojeve që do të ripopullohen;
- b) sipërfaqja e saj të jetë biologjikisht e mjaftueshme për jetesën normale të llojeve;
- c) zona të plotësojë kushtet për ushqim dhe riprodhim;
- ç) shtimi dhe ripopullimi të bëhen me lloje vendase tradicionale;
- d) të përcaktohen qartë në terren dhe në harta kufijtë e zonës.

5. Zonat e ripopullimit shpallen me urdhër të ministrit për një afat, të paktën, 5-vjeçar. Gjatë këtij afati, në këto zona, gjuetia është e ndaluar.

6. Pas ripopullimit, këtyre zonave u hiqet statusi si zona të ripopullimit dhe mund të shpallen edhe si zona të lejuara për gjueti, duke zbatuar procedurat për shpalljen e zonave të gjuetisë, të parashikuara nga ky ligj.

Neni 18

Rezervate të mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie

në të cilat fauna e egër mbarështohet në gjendje gjysmënatyrore me ndërhyrjen e njeriut me ushqim, me kushte strehimi e shumimi.

2. Personave fizikë dhe juridikë dhe shoqatave të gjuetarëve mund t'u jepen në përdorim për mbarështim gjysmënatyror, të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, sipërfaqe pyjore e kullosore jo më të vogla se 40 ha dhe për një afat 10-vjeçar.

3. Këto sipërfaqe jepen nga DSHP-ja ose njësisë e qeverisjes vendore që i ka në administrim, mbi bazën e procedurave të konkurimit dhe lidhjes së kontratës me fituesin.

4. Pronarët privatë të pyjeve dhe kullotave mund të krijojnë në pronat e tyre rezervate të mbarështimit të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie.

5. Kriteret për sipërfaqet që mund të jepen për mbarështim të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, për dokumentet që paraqet kërkuesi, për procedurat e konkurimit, rregullat e administrimit dhe të gjuetisë në këto sipërfaqe nga përdoruesi, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 19

Zonat për stërvitjen e qenve të gjahut

1. Qentë e gjahut stërviten vetëm në zona të përcaktuara për këtë qëllim nga DSHP-të.

2. Gjuetarët dhe trajnerët respektojnë kufijtë e zonës dhe rregulloren e përdorimit të zonave të stërvitjes së qenve të gjahut, të miratuar nga DSHP-ja.

KREU IV MENAXHIMI I GJUETISË

Neni 20

Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e gjuetisë

1. Menaxhimi i gjuetisë është administrimi i zonave të gjuetisë dhe zhvillimi i veprimtarisë së gjuetisë në to organizohet e drejtohet nga ministria dhe kryhet nga strukturat e shërbimit pyjor dhe nga menaxhuesit e zonave të gjuetisë.

2. Në menaxhimin e gjuetisë, ministria përgjigjet për:

- a) miratimin, organizimin dhe funksionimin e zonave të gjuetisë;
- b) rrjetin e zonave të gjuetisë në shkallë vendi;
- c) hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve e të programeve të zhvillimit të gjuetisë në shkallë vendi e për çdo zonë;
- ç) realizimin e procesit të monitorimit dhe inventarizimin e llojeve, objekt gjuetie;
- d) formatimin dhe administrimin e dokumentacionit standard, ku pasqyrohen të dhënat për gjuetinë për çdo zonë e në shkallë vendi, si dhe veprimtaritë menaxhuese të saj;
- dh) investimet dhe projektet për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e zonave të gjuetisë.

3. DSHP-të menaxhojnë dhe kontrollojnë administrimin e zonave të gjuetisë, që janë në territorin e tyre dhe kryerjen e veprimtarisë së gjuetisë në to.

4. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë përgjigjet për menaxhimin e zonës së tij të gjuetisë dhe të veprimtarisë së gjuetisë që zhvillohet në të.

Neni 21

Planet për menaxhim

Menaxhimi i zonave të gjuetisë dhe i llojeve, objekt gjuetie, kryhet në bazë të:

- a) të programit kombëtar të zhvillimit të gjuetisë;
- b) të planit menaxhues të secilës zonë gjuetie.

Neni 22

Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë

1. Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë pasqyron synimet dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjuetisë, metodat dhe rrugët për arritjen e tyre. Ai hartohet nga ministria për një periudhë 10-vjeçare dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

2. Ministria, gjatë përgatitjes së këtij programi, këshillohet me ministrinë përkatëse e me shoqatën e gjuetarëve, si dhe siguron që programi të jetë në përputhje me planet e zhvillimit të territorit dhe me kërkesat e dokumenteve ndërkombëtare të kësaj fushe, ku vendi ynë është palë.

3. Ministria, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përgatit programin e parë kombëtar të zhvillimit të gjuetisë. Pas miratimit, programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë publikohet në faqen e internetit të ministrisë.

Neni 23

Përmbajtja e programit kombëtar

Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë është dokumenti shtetëror që përmban:

- a) synimet e politikave shtetërore për gjuetinë;
- b) kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjuetisë;
- c) rrjetin e zonave të gjuetisë, në shkallë vendi;

- ç) llojet e faunës së egër, objekt gjuetie;
- d) kuotat e përafërta vjetore të gjuajtjes për çdo lloj të faunës së egër, objekt gjuetie;
- dh) investimet, projektet dhe ndërhyrjet përmirësuese për çdo zonë gjuetie;
- e) shtimin e popullatave të llojeve, objekt gjuetie dhe shpërndarjen e individëve në zona.

Neni 24

Plani i menaxhimit të zonës së gjuetisë

1. Menaxhimi i zonave të gjuetisë realizohet sipas planeve menaxhuese 10-vjeçare, të cilat i hartojnë menaxhuesit e zonave të gjuetisë për zonën që menaxhon secili.
2. Plani menaxhues i zonës hartohet në përputhje me programin kombëtar të zhvillimit të gjuetisë, me planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, me kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokave bujqësore e me planet e rregullimit të territorit.
3. Plani menaxhues i zonës përmban të dhënat për zonën, llojin dhe numrin e përafërt të individëve të llojeve të faunës së egër, masat e kultivimit, të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tyre dhe mban parasysh gjendjen numerike, strukturën e moshës dhe të gjinisë së llojeve të faunës së egër.
4. Planet menaxhuese të zonave të gjuetisë miratohen nga ministri, me propozimin paraprak të DSHP-së përkatëse.
5. Nëse në procesin e miratimit ministria kërkon përmirësimin e planit menaxhues 10-vjeçar, menaxhuesi i zonës së gjuetisë bën përmirësimin e tij brenda 40 ditëve. Nëse ministri, brenda 30 ditëve, nuk deklarohe për planin, ky plan vlerësohet i miratuar.
6. Në rast të ndryshimit të përhershëm dhe qenësor të kushteve e të rrethanave, ku bazohet plani menaxhues 10-vjeçar i zonës, plani rihartohet në përputhje me kushtet e reja.
7. Deri në miratimin e planeve 10-vjeçare, menaxhimi i zonave të gjuetisë bëhet duke u mbështetur në planin vjetor të përdorimit të zonës së gjuetisë.

Neni 25

Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie

1. Përpara çeljes së sezonit të gjuetisë, menaxhuesit e zonave të gjuetisë hartojnë planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, pa të cilin gjuetia nuk mund të ushtrohet në asnjë zonë.
2. Plani përmban veprimet konkrete të menaxhuesit për:
 - a) përlllogaritjet e përafërta për fondin, për kapacitetin e zonës, për mundësinë e gjuajtjes;
 - b) shtimin e individëve të llojeve, objekt gjuetie;
 - c) ndërtimet, në dobi të llojeve të faunës së egër, si mjedise për të pirë ujë e çerdhe;
 - ç) mbjellje bimësh e sigurim ushqimi për llojet e egra, në periudha të vështira;
 - d) ndërtime në dobi të gjuetarëve, si pika vëzhgimi e ngrehina të thjeshta për ndenje;
 - dh) vendosje shenjash të kufijve, mirëmbajtje rrugësh e shtigjesh për gjuetarët.
3. Planet miratohen nga DSHP-të përkatëse brenda 20 ditëve nga dorëzimi për miratim. Nëse DSHP-ja nuk e miraton brenda këtij afati, plani quhet i miratuar. Miratimi i planeve të zonave përfundon një muaj para çeljes së sezonit të gjuetisë.
4. Menaxhuesit e zonave të gjuetisë paraqesin raport vjetor te pronari i zonës dhe DSHP-ja përkatëse, për përmbushjen e planeve vjetore.
5. Të gjitha veprimtaritë e menaxhimit janë në përputhje me planet vjetore menaxhuese të miratuara. Nëse, për shkak të fatkeqësive natyrore ose të rasteve të tjera emergjente, nuk mund të zbatohet plani vjetor menaxhues, menaxhuesi njofton menjëherë DSHP-në përkatëse.
6. Metodikat e hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të gjuetisë dhe planeve vjetore të përdorimit dhe procedurat e miratimit të tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 26

Menaxhuesi i zonës së gjuetisë

1. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë është personi juridik ose fizik që përzgjidhet sipas një procedure ligjore konkurrimi.

2. Kërkesat dhe rregullat për të përzgjedhur menaxhuesin e zonës së gjuetisë miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 27

Të drejtat dhe përgjegjësitë themelore të menaxhuesve të zonave të gjuetisë

1. Menaxhuesit e zonave të gjuetisë:

a) sigurojnë funksionimin e shërbimit profesional për zbatimin e planit menaxhues të gjuetisë dhe shërbimin e ruajtjes së gjahut;

b) organizojnë veprimtaritë e gjuetisë dhe u ofrojnë shërbime të tjera gjuetarëve.

2. Detyrat e menaxhuesit, në lidhje me planin e menaxhimit, inventarin e llojeve dhe rregulloren e administrimit, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 28

Dhënia në përdorim e zonave të gjuetisë

1. Zonat e gjuetisë mund t'u jepen me qira shoqatës së gjuetarëve dhe personave fizikë e juridikë me kërkesën me shkrim të tyre. Dhënia me qira bëhet me kontratë për një afat jo më shumë se 10 vjet.

2. Zonat e gjuetisë jepen me qira, përmes ofertës publike, e cila shpallet pas themelimit të zonës.

3. Procedurën e ofertimit për dhënien me qira të zonës së gjuetisë e zhvillon, sipas përkatësisë së pronës, DSHP-ja, në territorin e së cilës ajo gjendet, në bazë të dispozitave të ofertimit publik.

4. Për çdo rast të dhënies me qira të zonës së gjuetisë njoftohet shoqata e gjuetarëve.

Neni 29

Konkurrimi

Konkurruesit, brenda një muaji nga shpallja e ofertës, paraqesin në DSHP dokumentet si më poshtë:

a) kërkesën, që përmban gjenealitetet e kërkuarit (emrin, mbiemrin, adresën, pikën e kontaktit e të komunikimit) dhe përmbajtjen e shkurtër të kërkesës;

b) plan-biznesin dhe investimet që do të bëjë në zonë;

c) vlerën e qirasë dhe afatin e pagesës së saj;

ç) autodeklarimin se i zotëron njohuritë dhe përvojën për të përdorur zonën e gjuetisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji e me aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 30

Vlera fillestare e qirasë

1. Vlera fillestare për qiranë e zonës së gjuetisë përcaktohet sa 50 për qind e vlerës të gjuetisë vjetore të kafshëve të egra, të planifikuara sipas planit të përdorimit të llojeve të zonës së gjuetisë, të llogaritura sipas çmimit të tregut.

2. Vlera fillestare për qiranë e zonës së gjuetisë shërben si çmim dysHEME për personat që do të marrin pjesë në konkurrim.

Neni 31
Kontrata e qirasë

DSHP-ja lidh me fituesin kontratë për dhënien me qira të zonës së gjuetisë, e cila duhet të përmbajë edhe:

- a) emërtimin, madhësinë, kufijtë dhe infrastrukturën e zonës së gjuetisë;
- b) llojin dhe numrin e përafërt të kafshëve të egra, objekt gjuetie;
- c) masat për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e zonës së gjuetisë;
- ç) detyrimet për të investuar në zonë;
- d) formën, sasinë dhe afatin e pagesës së qirasë.

Neni 32
Zgjidhja e parakohshme e kontratës

1. Kontrata e qirasë mund të zgjidhet para skadimit të afatit, për të cilin është lidhur, nëse:
 - a) qiramarrësi nuk e përdor zonën e gjuetisë në përputhje me këtë ligj dhe me kërkesat e kontratës;
 - b) për shkak të moszbatimit të masave të parashikuara në planin e menaxhimit, fondi i kafshëve të egra ka rënë nën minimumin e parashikuar në këtë plan;
 - c) qiramarrësi nuk bën investimet e parashikuara dhe nuk i shfrytëzon ato për qëllime të përcaktuara në kontratë;
 - ç) qiramarrësi nuk e paguan qiranë për dy herë radhazi, në masën dhe afatin e parashikuar në kontratë.
2. Në rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës së qirasë, ekspertët konstatojnë gjendjen faktike të zonës së gjuetisë e të zbatimit të planit të saj menaxhues. Qiramarrësi detyrohet të bëjë kompensimin e dëmit real, të shkaktuar në zonë, sipas çmimeve të tregut.
3. Përcaktimi i vlerës reale të dëmit bëhet me akt ekspertimi, të hartuar nga ekspertë të pranuar nga të dyja palët kontraktuese ose të vendosura nga gjykata.
4. Në të gjitha rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës së qirasë zhvillohet procedura e re e ofertimit publik për dhënien e zonës së gjuetisë në përdorim. Deri në dhënien e saj në përdorim gjuetia ndalohej, ndërsa masat e kultivimit dhe të mbrojtjes së kafshëve të egra i merr pronari i zonës ose personi i autorizuar prej tij.

KREU V
USHTRIMI I GJUE TISË

Neni 33
Sezoni i gjuetisë

1. Gjuetia ushtrohet vetëm brenda sezonit të hapur për gjueti, i cili përcaktohet sipas kriterëve gjeografike, klimatike e biologjike dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Për çdo vit, ministria publikon hapjen e sezonit të gjuetisë në faqen e saj të internetit.
2. Kohëzgjatja e gjuetisë sipas llojeve, si dhe ditët e lejuara për gjueti, brenda sezonit të gjuetisë, caktohen me urdhër të veçantë të ministrit.
3. Dita e gjuetisë fillon pas lindjes së diellit dhe përfundon me perëndimin e tij.

Neni 34
Ndërhyrjet e detyruara në sezon

Nëse moti i keq, gjuetia e tepruar ose rrethana të tjera zvogëlojnë popullatën e llojeve të faunës, objekt gjuetie, ministri, në bazë të kërkesës së arsyetuar të DSHP-së përkatëse, mund të

ndalojë ose të shkurtojë sezonin e hapur të gjuetisë. Ndalimi ose shkurtimi mund të jenë tërësorë ose të pjesshëm apo vetëm për disa lloje, objekt gjuetie, mund të shtrihen në të gjithë vendin ose në zona të veçanta gjuetie.

Neni 35

Gjuetari

Gjuetar mund të jetë personi fizik që:

- a) ka mbushur moshën 22 vjeç;
- b) ka leje të mbajë armë;
- c) ka fituar testin për çështjet teorike dhe praktike, që lidhen me veprimtarinë e gjuetisë;
- ç) është pajisur me leje gjuetie;
- d) njeh dhe respekton manualin e gjuetarit;
- dh) merr pjesë në monitorimin dhe inventarizimin e faunës së egër të zonës së tij.

Neni 36

Testimi i gjuetarit

1. Personat, që synojnë të ushtrorjnë gjuetinë, i nënshtrohen testimit të gjuetarit, sipas programit të miratuar nga ministri.

2. Programet e testimit hartohen nga ministria, në bashkëpunim me shoqatën e gjuetarëve e me strukturat universitare të biologjisë dhe përmbajnë njohuri teorike dhe praktike për veprimtarinë e gjuetisë e legjislacionin për të, për menaxhimin dhe përdorimin e llojeve, objekt gjuetie, njohuri për biologjinë e llojeve të faunës, për mënyrat, metodat dhe mjetet e gjuetisë, njohuri për armët e gjuetisë dhe përdorimin e tyre, për qentë e gjuetisë dhe për sëmundjet e llojeve, objekt gjuetie.

3. DSHP-të organizojnë testimin dhe formojnë komisionin e testimit, që funksionon në bazë qarku. Komisioni drejtohet nga drejtori i DSHP-së dhe ka në përbërje përfaqësues të strukturave menaxhuese të pyjeve, të Policisë Pyjore, të shoqatës së gjuetarëve dhe të strukturave universitare të biologjisë. Komisioni i testimit mblidhet një herë në vit, jo më vonë se një muaj para çeljes së sezonit të gjuetisë.

4. Personat, që kalojnë me sukses testimin, pajisen me certifikatë. Format i certifikatës miratohet nga ministri.

Neni 37

Kërkesa për t'u pajisur me leje gjuetie

1. Personat e testuar bëjnë kërkesë me shkrim për t'u pajisur me leje gjuetie nga DSHP-ja e zonës, ku ka vendbanimin kërkuesi. Kërkesa përmban gjenealogjetet e kërkuetit, zonën ku do të ushtrorjë gjuetinë dhe kohëzgjatjen e ushtrimit të saj.

2. Kërkesa shoqërohet me fotokopjen:

- a) e certifikatës së testimit;
- b) e lejes për mbajtjen e armës së gjuetisë;
- c) e kartës së identitetit.

3. DSHP-ja shqyrton kërkesën me dokumentet dhe përgjigjet brenda 5 ditëve pune nga marrja e tyre në dorëzim. Nëse DSHP-ja nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, leja quhet e miratuar.

4. Ndaj refuzimit të DSHP-së, kërkueti mund të ankohet te ministri brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Ndaj vendimit të ministrit ose mospërgjigjes së tij, pas kalimit të afatit 10-ditor, kërkueti mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve.

Neni 38
Leja e gjetisë

1. Leja e gjetisë është dokumenti shtetëror, që i njeh të drejtën e ushtrimit të gjetisë personit, që plotëson kushtet dhe kërkesat e këtij ligji. Format i lejes së gjetisë miratohet nga ministri.

2. Leja e gjetisë është personale dhe e patransferueshme. Ajo mbahet nga gjetari sa herë që ai shkon për gjetje dhe u paraqitet organeve të kontrollit, kur e kërkojnë.

Neni 39
Format e lejes së gjetisë

1. Në varësi të vendit ku do të ushtrohet gjetja, leja e gjetisë jepet:
 - a) në të gjitha zonat për gjetje të vendit;
 - b) në të gjitha zonat për gjetje të qarkut ku banon gjetari.
2. Në varësi të kohës kur do të ushtrohet gjetja, leja e gjetisë jepet për një afat 5-vjeçar ose për një sezon gjetje, në përputhje me kërkesën e gjetarit.

Neni 40
Regjistri i lejeve të gjetisë

1. Drejtoritë e shërbimit pyjor administrojnë regjistrin e lejeve të gjetisë, sipas formatit të miratuar nga ministri.
2. Në regjister shënohen leja e dhënë, emri dhe mbiemri i personit, të cilit i është dhënë leja, kohëzgjatja e saj dhe zona ku ushtrohet, ndëshkimet eventuale të dhëna për mbajtësin e saj gjatë sezonit të gjetisë dhe heqja e lejes.
3. Regjistri i lejeve të gjetisë publikohet në faqen e internetit të DSHP-ve dhe është i hapur për publikun.

Neni 41
Heqja e lejes së gjetisë

1. Leja e gjetisë hiqet në çdo kohë kur mbajtësi i saj:
 - a) bëhet, nga ana shëndetësore, i paaftë për të ushtruar gjetinë;
 - b) ka dhënë dokumente apo të dhëna të falsifikuara për kërkimin e lejes;
 - c) është ndëshkuar me masë administrative më shumë se dy herë;
 - ç) është dënuar penalisht nga gjykata e krimeve të rënda;
 - d) ia jep lejen një personi tjetër për ta përdorur.
2. Komisioni i shqyrtimit të kundërvajtjeve i DSHP-së që e ka lëshuar, pas shqyrtimit të shkeljes që ka evidentuar inspektori i organeve të kontrollit, merr vendim për heqjen e lejes.
3. Ndaj vendimit të komisionit, gjetari mund të ankohet te ministri brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Ndaj vendimit të ministrit, ose kur ky nuk përgjigjet brenda 10 ditëve, ankimi mund të bëhet në gjykatë brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit 10-ditor.

Neni 42
Leja e gjetisë për shtetasit e huaj

1. Ushtrimi i gjetisë nga shtetasit e huaj, rezidentë dhe jorezidentë në Shqipëri, mund të kryhet kur ata pajisen me leje gjetje.
2. Rregullat dhe procedurat e pajisjes së tyre me leje përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Brendshëm.

Neni 43

Gjuetia turistike e organizuar

1. Operatorët e tureve të gjuetisë, që kanë për objekt të miratuar organizimin e gjuetisë turistike, organizojnë dhe drejtojnë zhvillimin e tureve të gjuetisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji e të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Me “Guida gjuetie” nënkuptohen personat fizikë, të aftë për të drejtuar grupet e gjuetarëve, duke lehtësuar transportin, lëvizjen, akomodimin e tyre dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin normal të gjuetisë në një tur gjuetie.

3. Marrëdhëniet ndërmjet grupeve të gjuetisë turistike dhe operatorëve të tureve të gjuetisë apo guidave, që i organizojnë e akomodojnë turet e gjuetisë, rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar dhe vullnetit të lirë të palëve.

Neni 44

Pagesat për ushtrimin e gjuetisë

1. Për ushtrimin e gjuetisë, gjuetari bën pagesën, e cila përfshin:

- a) tarifën e lejes;
- b) kuotën e gjuetisë për përdorimin e zonës së gjuetisë;
- c) pagesën për çdo individ të llojeve, objekt gjuetie.

2. Niveli, koha dhe mënyra e pagesave të gjuetisë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Financave.

3. Pagesa e gjuetisë shlyhet nga gjuetari, njëherësh, në çastin e marrjes së lejes së gjuetisë, duke paraqitur në DSHP mandat-pagesën, që vërteton derdhjen e shumës në Buxhetin e Shtetit.

Neni 45

Metoda, teknika dhe mjete të ndaluara në gjueti

1. Askush nuk ka të drejtë të vrasë ose të zërë individë të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, duke përdorur mjete dhe metoda të zënies ose të vrasjes në shkallë të gjerë dhe në mënyrë joselektive si:

- a) helm;
- b) mjete, që shkaktojnë vrasje masive;
- c) eksplozivë, kurthe, gropa, gracka, ngjitës për shpendë, grepa, rrjeta, karrem të helmuar ose mjete mashtruese;
- ç) karrem të gjallë, të verbuar ose të sakatuar;
- d) kuaj, qerre, automjete, barka me motor, që lundrojnë me shpejtësi mbi 5 kilometra në orë ose aeroplan për ndjekje;
- dh) drita artificiale ose pasqyra ndriçuese;
- e) pajisje elektronike për të përmirësuar pamjen në dritë të dobët;
- ë) pajisje për imitim të zërit;
- f) rrymën elektrike për të vrarë ose paralizuar;
- g) tym ose gaz, që i detyrojnë kafshët të dalin nga vendet ku fshihen;
- gj) rrjetat për kapjen e shpendëve.
- h) armë automatike ose gjysmautamatike.

2. Gjuetari mund të përdorë qentë për ndjekjen e kafshës së plagosur, por nuk i lejon ata që ta mundojnë atë.

Neni 46

Veprime të ndaluara në gjueti

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohet:

- a) gjuetia, pa qenë i pajisur me leje gjuetie;
- b) gjuetia e kafshëve dhe e shpendëve të egër, që nuk janë në listën e llojeve, objekt gjuetie;
- c) gjuetia jashtë zonave të lejuara të gjuetisë;
- ç) ushtrimi i gjuetisë në periudhën e ndaluar e jashtë sezonit të lejuar për gjueti;
- d) ushtrimi i gjuetisë me mjete, mënyra e metoda, që ndalohen nga ky ligj e nga aktet nënligjore në zbatim të tij;
- dh) vrasja e shpendëve në kohën kur u bien pendët, kur kanë ngrirë nga të ftohtit, si dhe kapja e kafshëve gjatë përmbytjeve;
- e) ushtrimi i gjuetisë gjatë vërshimeve të ujërave, orteqeve të borës, akullit, zjarrit ose kushteve të tjera të jashtëzakonshme natyrore, që vështirësojnë dukshëm lëvizjen e kafshëve;
- ë) prishja e çerdheve, dëmtimi, mbledhja, marrja e vezëve dhe e të porsalindurve, vrasja ose nxjerrja nga strofka dhe shfarosja e atyre që ndodhen në të;
- f) vrasja e gjahut në kohën e riprodhimit dhe të rritjes së të vegjëlve;
- g) gjuetia gjatë periudhës së shumimit apo të kujdesit për të vegjlit dhe për llojet migratore, gjatë kthimit të tyre në territoret e shumimit;
- gj) ushtrimi i gjuetisë në det dhe në sipërfaqet ku zhvillohet akuakulturë intensive;
- h) vrasja ose kapja e individëve të llojeve, objekt gjuetie, mbi sasi të lejuara;
- i) gjuajtja gjatë natës, duke filluar me perëndimin e diellit deri në lindjen e tij;
- j) dëmtimi i rrethimeve, i ndërtimeve për gjuetinë, i vendeve të gjuetisë, i tabelave e shenjave të kufijve, i kullave të vrojtimit dhe i kafazëve të vendosur për zogjtë.

Neni 47

Armët e gjuetisë

1. Gjuetia lejohet të kryhet vetëm me armë gjuetie të prodhuara për këtë qëllim dhe që plotësojnë kërkesat teknike të sigurisë.
2. Rregullat e mbajtjes, të ruajtjes dhe përdorimit të armës së gjuetisë gjatë gjuetisë dhe në çdo kohë e vend tjetër miratohen me udhëzimin e përbashkët të ministrit dhe të Ministrit të Brendshëm.
3. Gjuetari i pajisur me armë gjahu të licencuar mund të mbajë thika dhe mjete të mprehta, si pajime të domosdoshme gjahu, që shërbejnë për gjueti.

Neni 48

Deklarimi i gjahut

1. Në përfundim të ditës së gjuetisë, gjuetari deklaron te menaxhuesi i zonës numrin e kafshëve e të shpendëve të vrara, duke i treguar ato, likuidon në vend pagesën për secilën dhe merr mandat-pagesën përkatëse.
2. Çdo gjuetar njofton dhe çon në qendrën më të afërt veterinare gjahun me shenja sëmundjeje.

Neni 49

Pronësia e gjahut

1. Gjahu i vrarë gjatë ushtrimit të gjuetisë i përket personit që e ka vrarë atë.
2. Gjuetarët e huaj kanë të drejtë ta marrin me vete gjahun e vrarë prej tyre, pasi të jenë pajisur me vërtetimin e menaxhuesit të zonës së gjuetisë. Ministri miraton formatin e vërtetimit për nxjerrjen e gjahut jashtë shtetit.

Neni 50
Trofetë e gjuetisë

1. Trofetë e gjuetisë vlerësohen nga komisioni i vlerësimit të trofeve, që krijohet me urdhër të ministrit.

2. Komisioni i vlerësimit të trofeve përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët propozohen nga shoqata e gjuetarëve, si gjuetarë me shumë përvojë, nga fakultetet e biologjisë të universiteteve shtetërore dhe nga ministria. Në bazë të këtyre propozimeve, ministri miraton përbërjen e komisionit.

3. Komisioni i vlerësimit të trofeve vepron pranë ministrisë për një afat 10-vjeçar. Ai mbledhet sa herë që paraqiten kërkesa për shqyrtim dhe e shqyrton secilën brenda një muaji nga regjistrimi i saj në protokoll.

4. Për vlerësimin e trofeve të gjuetisë, kërkuesi paguan një tarifë prej 5 000 lekësh.

5. Funksionimi i komisionit dhe dokumentet që ai administron bëhen sipas rregullores së organizimit dhe funksionimit të tij, që miratohet nga ministri.

Neni 51
Tregtimi i gjahut

1. Personat fizikë dhe juridikë mund të tregtojnë individë të vlarë të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, pjesë të tyre dhe trofe nga gjuetia, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe kur ato figurojnë në listën e hartuar, sipas aneksit III të direktivës për shpendët, e miratuar me udhëzim të ministrit dhe vetëm kur janë të pajisur me vërtetimin e lëshuar nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë.

2. Individët e llojeve të faunës së egër, pjesët e tyre dhe trofetë e siguruar në mënyrë të paligjshme konfiskohen nga organet e kontrollit për zbatimin e këtij ligji.

Neni 52
Shoqata dhe federata e gjuetarëve

1. Shoqata e gjuetarëve, si bashkim vullnetar i gjuetarëve dhe federata, si bashkim shoqatash, formohen sipas dispozitave të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

2. Federata përfaqëson bashkimin e shoqatave dhe mbron interesat e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Shoqata dhe federata kryejnë veprimtari që lidhen me trajnimin e gjuetarëve, me bashkëpunimin për ruajtjen e ekosistemeve dhe pasurimin e burimeve të gjuetisë, me mbrojtjen e mjedisit, kultivimin e etikës së gjuetarit dhe të traditave të gjuetisë.

Neni 53
Të drejtat dhe detyrat e shoqatës dhe federatës

Në funksion të zbatimit të dispozitave të këtij ligji, shoqata dhe federata kanë të drejtat dhe detyrat si më poshtë:

- a) administrojnë regjistrin e anëtarëve të vet;
- b) marrin pjesë në testimin e gjuetarëve;
- c) japin mendim për krijimin e zonave të gjuetisë;
- ç) marrin pjesë aktive në përpunimin e politikave, të planeve të menaxhimit e projekteve për gjuetinë;
- d) luajnë rol aktiv në menaxhimin e zonave të gjuetisë;
- dh) mbajnë lidhje të ngushta pune me strukturat përkatëse të shërbimit pyjor;
- e) organizojnë veprimtari kualifikuese dhe edukuese për anëtarët e vet, për të respektuar manualin e gjuetarit.

KREU VI MONITORIMI DHE KONTROLLI

Neni 54

Monitorimi i gjuetisë

1. Monitorimi i gjuetisë është proces i detyrueshëm, që drejtohet nga ministria, e cila harton programet e monitorimit, përcakton metodat e grumbullimit të të dhënave e të përpunimit të tyre, si dhe ndjek zbatimin e tij.

2. Si pjesë përbërëse e monitorimit të faunës së egër, monitorimi i gjuetisë përmbledh monitorimin e veprimtarisë së gjuetisë dhe monitorimin e zonave të gjuetisë.

3. Strukturat menaxhuese të pyjeve dhe kullotave, Policia Pyjore, njësitë tekniko-organizative të qeverisjes vendore, menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe shoqatat e gjuetarëve ndjekin në vijimësi zhvillimin e gjuetisë, duke nxjerrë të dhënat, sipas treguesve të përcaktuar në programin e monitorimit të gjuetisë.

4. Të dhënat vjetore të monitorimit grumbullohen në nivel qarku në DSHP, e cila ia dërgon Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve brenda muajit maj për vitin paraardhës. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve përpunon të dhënat e grumbulluara dhe rezultatet i publikon brenda muajit qershor në faqen e saj të internetit.

Neni 55

Inventarizimi i llojeve, objekt gjuetie

1. Popullatat e llojeve, objekt gjuetie, inventarizohen çdo vit në çdo zonë gjuetie, për të identifikuar sasinë e tyre, shtesën natyrale vjetore të popullatës së secilit lloj, si dhe për të planifikuar sasinë e individëve, që mund të gjuhen gjatë sezonit të ardhshëm në zonën konkrete. Në sezonin e ardhshëm nuk mund të planifikohen për t'u gjuajtur më shumë se 10 për qind e shtesës natyrale të popullatës së llojit.

2. Inventarizimi dhe regjistrimi i llojeve dhe popullatave të tyre kryhen në bashkëpunim me shoqatat e gjuetarëve dhe gjuetarët e zonës, nën drejtimin e menaxhuesit të saj, duke mbajtur parasysh kërkesat e veçanta të çdo lloji.

3. Menaxhuesit e zonave të gjuetisë, krahas grumbullimit të të dhënave për numrin e kafshëve të egra brenda zonës, grumbullojnë edhe të dhëna të tjera për gjendjen e kushtet e jetesës së kafshëve në zonën e gjuetisë dhe shënimet i dërgojnë në DSHP-në përkatëse, e cila mban regjistrin e kafshëve të egra të zonave të gjuetisë.

4. Metodika e regjistrimit dhe inventarizimit të llojeve dhe popullatave të tyre, si dhe dokumentet e formatuara, ku pasqyrohen të dhënat dhe rezultatet e inventarizimit të llojeve, objekt gjuetie, miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 56

Kontrolli mbi gjuetinë

Kontrolli mbi gjuetinë, si pjesë e kontrollit për mbrojtjen e faunës së egër, është veprimtaria shtetërore, që siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të konventave përkatëse, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 57

Organet e kontrollit

1. Organi i specializuar i kontrollit për zbatimin e këtij ligji është Policia Pyjore, në bashkëpunim me menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe me organet e kontrollit të njëjësive të qeverisjes vendore.

2. Kur organet e specializuara të kontrollit pengohen në kryerjen e detyrës, sipas pikës 1 të këtij neni, kërkojnë ndihmën dhe bashkëpunojnë me strukturat e Policisë së Shtetit e të policisë bashkiake/komunale.

Neni 58

Kontrolli doganor

1. Fauna e egër, objekt gjuetie dhe produktet e gjuetisë në import dhe eksport i nënshtrohen legjislacionit doganor në fuqi dhe udhëzimit të ministri për këtë qëllim.

2. Individë të vrarë të llojeve, objekt gjuetie, eksportohen, kur ato shoqërohen me vërtetim nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë dhe me raport nga shërbimi veterinar.

KREU VII SANKSIONET

Neni 59

Kundërvajtjet administrative

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.43/2013, datë 14.2.2013)

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me dënim kryesor me gjobë si më poshtë:

1. Ushtrimi i gjuetisë pa u pajisur me leje gjuetie, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Ushtrimi i gjuetisë jashtë sezonit të gjuetisë, të përcaktuar në urdhrin përkatës të ministrit, qoftë edhe pa pasur gjah të vrarë ose të kapur, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Gjuetia e kafshëve të egra, që nuk janë në listën e llojeve, objekt gjuetie, me gjobë, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

4. Gjuetia në zonat e ndaluara për gjueti, me gjobë, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

5. Ushtrimi i gjuetisë me armë, që nuk lejohen për t'u përdorur si armë gjuetie, si dhe pa pasur lejen e armës së gjuetisë, me gjobë, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

6. Ushtrimi i gjuetisë pa pasur me vete lejen e gjuetisë, me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

7. Mosdeklarimi i gjahut të vrarë dhe mospagimi i tarifës për çdo individ të vrarë, me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

8. Mosçuarja te veterineri i individit të vrarë, që dyshohet për sëmundje, me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

9. Mbledhja dhe grumbullimi i vezëve të shpendëve, objekt gjuetie, me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

10. Mosndalimi i mjeteve pas sinjalit të organeve të kontrollit për zbatimin e këtij ligji, me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

11. Gatimi në lokale i individëve të llojeve të kafshëve, shpendëve të egër dhe i peshqve e gjallesave të tjera të detit, që nuk lejohen të gjuhen, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

12. Ushtrimi i gjuetisë në det, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

13. Ushtrimi i gjuetisë duke gjuajtur nga makina, nga mjetet e lundrimit (veç barkave që përdoren për gjueti) dhe nga mjetet e fluturimit, me gjobë, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

14. Ushtrimi i gjuetisë me mjete e mënyra, që përbëjnë rrezik për njerëzit, për kafshët e shpendët, me anë të zjarrit, me materiale që marrin zjarr shpejt, me lëndë eksplozive dhe helmuese, me hapje gropash, me dritë, me ajër e gaz të komprimuar dhe natën, me gjobë, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

15. Gjuetia me mjete dhe mënyra, që shkaktojnë vrasjen ose kapjen në masë të kafshëve e të shpendëve të egër, si gracka, kosha, rrjeta, stampa imituese, aparate zëndjellëse apo kafshëve të gjalla, që përdoren si karrem, që mund të jenë të verbra ose të gjymtuara, me gjobë, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

16. Gjuetia me mjete elektrike, që mund të përdoren për vrasje dhe trulllosje, ndriçues për qitje natën, të përbërë nga zmadhues dhe zvogëlues elektronikë, pasqyra dhe mjete të tjera verbimi, me gjobë, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

17. Mbajtja e armëve të gjuetisë të karikuara gjatë kalimit në qendrat urbane (në këmbë ose në makinë) dhe transporti i tyre të mbushura, mbajtja dhe përdorimi i armëve të gjahut nga pesona të tjerë të paautorizuar, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

18. Gjuajtja e shpendëve në kohën kur u bien pendët, kur kanë ngrirë nga të ftohtit, si dhe kapja e kafshëve gjatë përmytjeve, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

19. Prishja e çerdheve, dëmtimi, mbledhja dhe marrja e vezëve dhe e të porsalindurve, vrasja ose nxjerrja nga strofka dhe shfarosja e atyre që ndodhen në to, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

20. Kapja e gjahut në kohën e riprodhimit dhe të rritjes të së vegjëlve, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

21. Vrasja ose kapja mbi sasi të lejuara, duke përdorur qen të tjerë, veç atyre të gjuetisë, ose gjuetia me zagarë, duke kërkuar territorin pa armë gjahu, me gjobë, në masën 3 000 (tre mijë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë.

22. Dëmtimi i rrethimeve, i ndërtimeve për gjuetinë, i vendeve të gjuetisë, i tabelave të çfarëdo lloji e natyre qofshin, i kullave të vrojtimit dhe i kafazëve të vendosur për zogjtë, me gjobë, në masën 3 000 (tre mijë) lekë deri në 5 000 (pesë mijë) lekë.

Neni 60

Dokumentimi

(Ndryshuar me ligjin nr.43/2013, datë 14.2.2013)

1. Inspektimi dhe dënimi i shkeljeve bëhen nga inspektori i Policisë Pyjore, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Gjahu i vrarë ose i kapur konfiskohet, leja e gjuetisë i merret, ndërsa armët e mjetet e gjahut sekuestrohen me procesverbal dhe i dorëzohen me procesverbal Policisë së Shtetit. Arma e sekuestruar i kthehet gjuetarit sezonin e ardhshëm pasi të ketë paguar gjobën përkatëse.

3. Masat e konfiskimit të gjahut të vrarë, marrjes së lejes së gjuetisë dhe sekuestrimi i armës janë dënime plotësuese, që mund të jepen krahas dënimit kryesor me gjobë.

Neni 61

Shqyrtimi dhe ankimi

(Ndryshuar me ligjin nr.43/2013, datë 14.2.2013)

Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 62

Pagimi i gjobës

(Ndryshuar me ligjin nr.43/2013, datë 14.2.2013)

1. Gjobat për kundërvajtjet administrative, sipas këtij ligji, paguhen brenda 30 ditëve. Personit nuk i kthehen leja dhe arma e gjuetisë pa paguar më parë gjobën.
2. Të ardhurat e grumbulluara nga pagesa e gjobave derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 63

Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 3 pika 1, 9 pika 2, 22 pika 1, 33 pika 1 dhe 44 pika 2, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri që, në zbatim të neneve 15 pika 3, 18 pika 5, 25 pika 6, 26 pika 2, 27 pika 2, 50 pika 5, 55 pika 4 dhe 58 pika 1, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
3. Ngarkohen ministri dhe Ministri i Brendshëm që, në zbatim të nenit 59 pika 2, të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të këtij ligji.
4. Ngarkohen ministri dhe Ministri i Financave që, në zbatim të nenit 33 pika 2, të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të këtij ligji.

Neni 64

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 7875 datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Dispozitë kalimtare e ligjit nr.43/2013, datë 14.2.2013

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 65

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6482, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KAPITULLI V
MJEDISI DHE BURIMET NATYRORE

LIGJ
Nr.9693, datë 19.3.2007

PËR FONDIN KULLOSOR²⁴

*(ndryshuar me ligjet: nr.9996, datë 22.9.2008, nr.10 137, datë 11.5.2009, nr. 14/2012, datë 16.2.2012,
nr. 38/2013, datë 14.2.2013, nr. 49/2016, datë 5.5.2016)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë trajtimin bashkëkohor të kullotave dhe livadheve, përcaktimin e aftësisë mbajtëse dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të fondit kulloros, nëpërmjet unifikimit të kërkesave dhe rregullave, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore, të organeve të specializuara kërkimore-shkencore, pronarëve privatë dhe të biznesit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha kullotat e livadhet dhe për sipërfaqet me drurë e shkurre, që përdoren për kullotë, pavarësisht nga lloji dhe format e pronësisë së tyre.

2. Nuk janë objekt i këtij ligji tokat bujqësore, arat, kopshtet frutore, pyjet, edhe pse mund të përdoren për kullotje të bagëtive apo për kositje bari.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kullotë” është sipërfaqe toke, më e madhe se 0,5 ha, me bimësi barishtore natyrore të dendur, në formë të qëndrueshme ose me bimësi tjetër, që plotëson kërkesat për kullotje, së bashku me infrastrukturën përkatëse.

²⁴ Ligji nr.9996, datë 22.9.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, datë 10 tetor 2008.
Ligji nr.10 137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 12 qershor 2009.
Ligji nr. 14/2012, datë 16.2.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 14 mars 2012.
Ligj nr. 38/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 12 mars 2013.
Ligji nr. 49/2016, datë 5.5.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 92, datë 31 maj 2016.

2. “Livadh” është sipërfaqe toke, homogjene, e mbuluar me bar, i cili mund të kositet për t’u përdorur për blegtorinë, ose që përdoret për kullotje e që nuk i përket fondit të tokës bujqësore.

3. “Ekonomi kullosore” është territori i ndarë në ngastra e nënngastra, që shërben si element bazë për organizimin, planifikimin dhe monitorimin e objektivave të mbarështimit të kullotës.

4. “Ngastër” e “nënngastër” janë pjesë të sipërfaqes së ekonomisë kullosore, që shërbejnë si njësi bazë për planifikimin e aftësive mbajtëse të saj, për vlerësimin e kullotës dhe mënyrën e trajtimit, në përputhje me objektivat e mbarështimit të kullotës.

5. “Burime kullosore” është tërësia e elementeve natyrore të sipërfaqes së kullotës, të vlerësueshme e të përdorshme për kullotë. Në fondin kullor, si burime natyrore përfshihen toka, uji, bimësia barishtore, bimësia pyjore e jopyjore.

6. “Fond kullor” është sipërfaqja e kullotave dhe e livadheve natyrore, shtetërore, bashkiake dhe private, infrastrukturat e tyre, sipërfaqet e fondit pyjor me drurë e shkurre, që përdoren si kullota, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura shkëmbore në brendësi të tyre.

7. “Ekosistem kullor” është kompleksi dinamik jetësor, bimë, kafshë, mikrobe dhe mjedisi jo i gjallë, që ndërvepron si njësi funksionale.

8. “Infrastrukturë kullosore” janë zyrat, rrjeti rrugor, lerat, koritat, çezmat, rrethimet e gardhimet, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese, si dhe ngrehinat e tjera, të ngritura në fondin kullor shtetëror, bashkiak e privat, për vendosjen e fermave gjatë sezonit kullor.

9. “Regjistër i fondit kullor” është regjistri zyrtar, ku regjistrohen, ruhen e përditësohen të dhënat kryesore për çdo njësi të ekonomisë kullosore apo ndryshimet periodike të sipërfaqes, kapacitetit mbajtës, shoqëruar me hartat përkatëse.

10. “Trajtim i kullotave” janë operacionet teknike, që kryhen në kullotat, që kanë si qëllim shtimin e sipërfaqeve të dobishme, rritjen e kapaciteteve mbajtëse dhe vazhdimësinë e rigjenerimit natyror të tyre.

11. “Dëmtim i kullotave dhe i mjedisit kullor” është prishja e elementeve fizike, kimike e strukturore të ekosistemit kullor, që ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e prodhimitarisë, pakësimin e shumëllojshmërisë barishtore apo cilësinë e tyre.

12. “Mbarështim kullote” është mënyra e drejtimit dhe e planifikimit, në nivel ekonomie, që siguron përmbushjen e kërkesave për administrimin teknik të kullotave, duke ruajtur integritetin ekologjik, ekonomik e shoqëror për çdo njësi mbarështimi.

13. “Mbrojtje e kullotave” janë veprimtaritë, që parandalojnë degradimin e tokës e të mbulesës bimore, ruajnë dhe përmirësojnë kullotat dhe infrastrukturën e tyre nga ndikimet negative të faktorëve njerëzorë e natyrorë.

14. “Plan mbarështimi” është dokumenti themelor për menaxhimin e kullotave, i cili përmban njësitë e ekonomisë, që shërbejnë për marrjen e të dhënave për tokën, zonalitetin klimatik, faunën, biodiversitetin, mbulesën barishtore etj., si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe trajtimin e qëndrueshëm të ekonomisë kullosore, organizimin, planifikimin e punimeve dhe përcaktimin e kapaciteteve kullosore.

15. “Ministria” është ministria përgjegjëse për kullotat e livadhet.

16. “Ministër” është autoriteti përgjegjës për kullotat e livadhet.

KREU II FONDI KULLSOR

Neni 4 Përbërja

1. Fondi dhe burimet kullosore përmbledhin:
 - a) kullotat dhe livadhet;
 - b) sipërfaqet pyjore me drurë e shkurre, që shërbejnë si kullota;
 - c) bimësinë barishtore, drurët, shkurret e bimët mjekësore, eterovajore e tanifere, natyrore, që rriten në kullota e livadhe;

- c) infrastrukturën e kullotave;
 - d) sipërfaqet shkëmbore apo moçalore në përbërje të kullotave.
2. Fondi kullosor është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Ai mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Neni 5

Pronësia

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 49/2016, datë 5.5.2016)

1. Fondi kullosor, sipas pronësisë, ndahet në:
 - a) fond kullosor shtetëror, që përmbledh kullotat dhe livadhet në pronësi të bashkisë, në territorin administrativ të së cilës ndodhen;
 - b) fond kullosor privat, që përmbledh kullotat dhe livadhet në pronësi private.
2. Në fondin kullosor shtetëror bëjnë pjesë:
 - a) kullotat dhe livadhet në administrim të ministrisë;
 - b) kullotat dhe livadhet në administrim të bashkive dhe atyre kolektive.
3. Pronarët privatë i gëzojnë të drejtat mbi kullotat e livadhet, që kanë në pronësi, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 6

Klasifikimi

1. Sipas kohës së përdorimit, kullotat, livadhet dhe sipërfaqet me drurë e shkurre ose me bimësi pyjore, që përdoren për kullotje, klasifikohen në kullota verore dhe kullota dimërore.
2. Klasifikimi i tyre bëhet në përputhje me kriteret teknike të miratuara nga ministri.

Neni 7

Inventarizimi

(ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 49/2016, datë 5.5.2016)

1. Kullotat e livadhet inventarizohen çdo 10 vjet, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit.
2. Bashkitë dhe pronarët privatë të kullotave e livadheve i japin ministrisë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet të dhëna të nevojshme për inventarizimin e kullotave që zotërojnë, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 8

Regjistrimi

1. Kullotat dhe livadhet shtetërore, së bashku me infrastrukturën e tyre, regjistrohen në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
2. Ngarkohen ministria dhe bashkitë përkatëse që, brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përfundojnë regjistrimin e kullotave e të livadheve, që kanë në zotërim, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.

Neni 9

Regjistri i fondit kullosor

1. Kullotat dhe livadhet regjistrohen duke u shënuar në regjistrin zyrtar të fondit kullosor, ku hidhen edhe të dhënat e kërkuara, sipas kriterëve e rregullave të miratuara.
2. Rregullat për mbajtjen e regjistrit të fondit kullosor, për regjistrimin, përditësimin dhe ndryshimet e gjendjes së kullotave e livadheve, miratohen nga ministri.

3. Regjistri i fondit kullësor krijon bazën e të dhënave për kullotat e livadhet në shkallë vendi, qarku, rrethi, bashkie dhe për çdo ekonomi kullësore.

4. Ministria, në bazë të regjistrit të fondit kullësor, përgatit dhe shpall çdo vit të dhënat për kullotat e livadhet.

5. Sipërfaqet me drurë e shkurre dhe me bimësi pyjore, të cilat, në përputhje me objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve, përdoren për kullotë, bëjnë pjesë në fondin kullësor, për efekt të mënyrës së përdorimit, por nuk regjistrohen në regjistrin e fondit kullësor si të tilla.

Neni 10

Ndryshimi i destinacionit

(ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 2/1 dhe 2/2, me ligjin nr. 14/2012, datë 16.2.2012)

1. Heqja e një kullote apo livadhi nga fondi kullësor ose ndryshimi i destinacionit për një sipërfaqe kullote bëhet:

a) për sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit;

b) për sipërfaqe mbi 1 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pjesë të fondit kullësor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore me kërkesën e pronarit apo bashkisë i cili e ka në pronësi këtë fond. Ndryshimi i formës së përdorimit të fondit kullësor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, pavarësisht nga madhësia e sipërfaqes, bëhet vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe politikave parësore shtetërore afatgjata.

2/1. Kërkesa për kalimin e pjesëve të fondit kullësor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore paraqitet në bashkinë, në territorin e së cilës ndodhet fondi kullësor, që shqyrtohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar.

2/2. Kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të bashkive, në fond kullësor (kullotë, livadh), dhe regjistrimi në kadastrën kombëtare të fondit kullësor bëhen me kërkesë të pronarit apo bashkisë. Kërkesa paraqitet pranë ministrisë që mbulon pyjet dhe miratohet nga ministri përkatës.

3. Heqja, shtimi dhe ndryshimi i destinacionit të kullotave dhe livadheve, pas miratimit të organit kompetent, pasqyrohen në regjistrin e fondit kullësor.

4. Rregullat dhe procedurat, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

RUAJTJA, TRAJTIMI DHE PËRDORIMI

Neni 11

Synimet

Ruajtja, trajtimi e përdorimi i kullotave dhe livadheve realizohen duke zbatuar kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe synojnë:

a) ruajtjen dhe shtimin e vazhdueshëm të burimeve natyrore të kullotave e livadheve;

b) ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe gjallërinë e ekosistemeve natyrore kullësore;

c) përmirësimin dhe nxitjen e aftësive prodhuese të kullotave e livadheve;

ç) ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të diversitetit biologjik të ekosistemeve kullësore;

d) përmirësimin e mënyrave të mbarështimit të kullotave, në mënyrë të veçantë për parandalimin e gërryerjes dhe të degradimit të tokës;

dh) nxitjen e shërbimeve të tjera socialekonomike dhe sigurimin e përfitimeve të shumëfishta për shoqërinë.

Neni 12

Strategjia dhe plani i veprimit

1. Strategjia dhe plani i veprimit për kullotat e livadhet janë dokumente shtetërore, që shprehin politikën e shtetit shqiptar për të sotmen dhe ardhmërinë e kullotave, ku mbështeten të gjitha veprimtaritë për ruajtjen, trajtimin dhe përdorimin e fondit kullosor.

2. Strategjia hartohet për një periudhë 10-vjeçare. Planet e veprimit, në zbatim të kërkesave të strategjisë, hartohen e zbatohen për periudha deri 3-vjeçare.

3. Strategjia e fondit kullosor pasqyron:

- a) politikat për ruajtjen e mjedisit natyror të kullotave;
- b) masat për rritjen e aftësive e të kapaciteteve kullosore;
- c) zgjerimin e mundësive për rritjen e investimeve publike e private në kullota e livadhe dhe angazhimin e bizneseve në to;
- ç) promovimin e zgjidhjeve e të rrugëve të reja, për një trajtim bashkëkohor të kullotave dhe për përdorimin racional të tyre.

Neni 13

Hartimi dhe miratimi i strategjisë dhe i planit të veprimit

Strategjia dhe plani i veprimit hartohen nga ministria, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe me bashkitë dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Planet e mbarështimit

(ndryshuar pika 5, me ligjin nr. 49/2016, datë 5.5.2016)

1. Kullotat dhe livadhet trajtohen dhe përdoren në përputhje me planet e mbarështimit dhe të inventarizimit.

2. Planet e mbarështimit hartohen nga strukturat përkatëse të pyjeve dhe kullotave, njësitë e qeverisjes vendore, pronarët privatë dhe miratohen nga drejtoria që mbulon kullotat në ministri.

3. Planet e mbarështimit përmbajnë, të paktën:

- a) kufijtë dhe ndarjen në njësi të ekonomisë, që shërbejnë për marrjen e të dhënave për tokën, zonalitetin klimatik, faunën, biodiversitetin dhe mbulesën barishtore;
- b) masat, që parashikohen për administrimin dhe trajtimin e qëndrueshëm të ekonomisë kullosore;
- c) organizimin, planifikimin e punimeve dhe rritjen e kapaciteteve kullosore;
- ç) veprimtaritë e ndryshme, që mund të ushtrohen në kullotë e livadhe; hartografinë dixhitale dhe bazën e të dhënave;
- dh) analizën ekonomike;
- e) numrin e krerëve, sipas llojit të blegtorisë, që mendohet të mbahet në kullotën e parashikuar.

4. Planet e mbarështimit hartohen për një periudhë 10-vjeçare.

5. Planet e mbarështimit të kullotave, para se të miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet, shqyrtohen nga një komision teknik, në përbërje të të cilit është edhe një përfaqësues i bashkisë. Komisioni ngrihet me urdhër të ministrit.

6. Ministri miraton rregulloren e organizimit e të funksionimit të komisionit.

Neni 15

Përdorimi për kullotje

(shtuar pika 3/1, ndryshuar pika 6, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

1. Kullotat dhe livadhet shtetërore jepen në përdorim për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit, përkundrejt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Për përdorim të përkohshëm kullosor, ato u jepen personave fizikë e juridikë për një periudhë kohe deri në 3 vjet. Kur personi fizik ose juridik synon të bëjë investime për përmirësimin e kullotës apo të infrastrukturës së saj, sipas një plani mbarështimi të miratuar nga drejtoria që mbulon kullotat, marrja në përdorim mund të zgjatet deri në 10 vjet, me kusht që investimet e planifikuara të realizohen.

3. Dhënia në përdorim për kullotje bëhet në përputhje me aftësitë mbajtëse kullosore, të përcaktuara në planin e mbarështimit për çdo ngastër ose nënngastër.

3/1. Dhënia në përdorim për kullotje, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë III.4, të shtojcës së ligjit për licencat dhe miratohet sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji.

4. Dhënia për kullotje e kullotave dhe e livadheve bëhet në bazë të një kontrate, që lidhet ndërmjet strukturës përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe kërkuesit.

5. Personi fizik ose juridik, që ka marrë kullotë apo livadh për kullotje ose kositje, nuk mund ta japë atë apo pjesë të saj tek të tretë me nënkontratë.

6. Rregullat e hollësishme për dhënien në përdorim të kullotave apo livadheve për kullotje ose kositje miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 16

Përfashtimi nga kullotja

1. Përfashtohen përkohësisht nga kullotja:

- a) ngastrat eksperimentale të kullotave dhe livadheve;
- b) ngastrat, ku kryhen punime përmirësuese;
- c) ngastrat e degraduara.

2. Përfashtimi bëhet me urdhër të ministrit, ku specifikohen ngastrat, sipas të dhënave të regjistrit të fondit kullosor, si dhe shënohet periodha e përfashtimit.

Neni 17

Përdorimi i sipërfaqes dhe i tokës

(shtuar pika 3/1, ndryshuar pika 4, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

1. Dhënia në përdorim e sipërfaqes së kullotave dhe livadheve, në radhë të parë, lejohet për ndërtime të përkohshme, si depo e qendra të staneve, qendra të përpunimit të bulmetit, për mullinj, për shtëpi të përkohshme verimi për blegtorët, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë.

2. Personi fizik apo juridik, që merr kullotën për kullotje, sipas nenit 15 të këtij ligji, merr për objektet, që do të ndërtojë në sipërfaqen e marrë, edhe miratimin nga struktura përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki. Për kullotat bashkiake miratimi jepet nga bashkia.

3. Sipërfaqe të caktuara dhe toka të fondit kullosor, pronë shtetërore, mund të jepen në përdorim, për të zhvilluar në to veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike, vetëm kur:

a) veprimtaria është parashikuar në planin e mbarështimit të kullotës apo livadhit, ose kur nuk bie në kundërshtim me synimet e kërkesat e këtij plani;

b) ushtrimi i veprimtarisë nuk e dëmton mjedisin rrethues dhe nuk ka pasoja të vazhdueshme negative mbi të;

c) subjekti realizon, në vijimësi dhe përfundimisht, rehabilitimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, në përputhje me planin e rehabilitimit, të hartuar prej tij e të miratuar nga struktura përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

3/1. Dhënia në përdorim sipas pikës 1 të këtij neni, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë III.4, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.

4. Procedurat e dhënies në përdorim të sipërfaqes së kullotës, sipas pikës 2 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

5. Personi fizik apo juridik paguan për sipërfaqen që merr në përdorim tarifën vjetore të përdorimit. Vlera e tarifave përlogaritet sipas llojit të veprimtarisë, kohëzgjatjes së saj dhe sipërfaqes së zënë. Tarifat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Kur veprimtaritë, që kërkojnë të ushtrohen, sipas pikës 3 të këtij neni, janë të përhershme apo afatgjata, si poligone ushtarake, miniera, pika të përhershme turistike, llixha e pika kurative, pista e stacione skish, subjekti kërkues zbaton procedurat për heqjen e kësaj sipërfaqeje nga fondi kullosor.

Neni 18

(ndryshuar me ligjin nr.9996, datë 22.9.2008)

1. Subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fondin kullosor, sipas nenit 17 pika 3 të këtij ligji, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik, i cili organizohet nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose, për kullotat bashkiake, nga njësia e qeverisjes vendore. Me subjektin fitues lidhet kontrata, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet, që duhen zbatuar gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të veprimtarisë.

2. Kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet, për pjesëmarrjen në konkurrimin publik, miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 19

Rehabilitimi

1. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fondin kullosor, kanë detyrimin të rehabilitojnë sipërfaqen e përdorur, sipas një plani rehabilitues të hartuar nga subjekti e të miratuar nga struktura përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

2. Ministri miraton udhëzimin për rehabilitimin e sipërfaqeve kullosore.

Neni 20

Ngastrat eksperimentale

Ngastrat e kullotave dhe të livadheve, të caktuara për konservimin e germoplazmës, in situ dhe ex situ, për grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen dhe certifikimin e farnave, përcaktohen dhe mbahen në administrim nga strukturat menaxhuese të kullotave, në bashkëpunim me organet e specializuara kërkimore-shkencore përkatëse.

Neni 21

Bimët mjekësore

Vjelja e bimëve mjekësore, që rriten në kullota e livadhe, bëhet nga persona fizikë dhe juridikë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7722, datë 15.6.1993 “Për mbrojtjen e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore” .

KREU IV PARANDALIMI I DËMTIMEVE

Neni 22

Djegia

1. Djegia e kullotave dhe livadheve nga pronari, nga përdoruesi apo nga persona të tjerë është e ndaluar dhe ndëshkohet, sipas rastit, nëse është kundërvajtje administrative, në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose, nëse përbën vepër penale, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

2. Djegia e kullotës apo livadhit mund të lejohet vetëm në raste të veçanta dhe me miratimin e struktursës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, në territorin e së cilës ndodhet.

3. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, për djegien e kullotës, jep miratim me shkrim, në përputhje me udhëzimin e ministrit, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat e këtij veprimi.

4. Në rast zjarri në kullota dhe livadhe, drejtoria që mbulon kullotat në ministri, bashki, pronarët privatë, Forcat e Armatosura e çdo shtetas, që ndodhet në afërsi, njoftojnë organet e mbrojtjes nga zjarri (MNZ), organet e shërbimit pyjor e të pushtetit vendor, si dhe marrin pjesë për shuarjen e tij. Shpenzimet për shuarjen e tij i ngarkohen personit që ka vënë zjarrin ose përballohen nga pronari, kur zjarri ka ndodhur për shkaqe natyrore.

Neni 23

Veprime të ndaluara

1. Në fondin kullosor ndalohet çdo veprim, që dëmton mbulesën barishtore e shkurreve të kullotave, që shkakton ndotjen e mjedisit dhe prish ekuilibrin ekologjik të tyre. Veprime të tilla janë:

- a) hedhja dhe depozitimi i lëndëve e i mbetjeve radioaktive;
- b) hedhja dhe depozitimi i mbetjeve të çdo lloji;
- c) shkarkimet e kimikateve nga industritë kimike;
- ç) shkarkimet e ujërave të ndotura industriale, urbane e bujqësore;
- d) veprimtaritë, që shkaktojnë gërryerjen dhe degradimin e tokës;
- dh) hapja dhe shfrytëzimi i gurorëve ose i karrierave të çdo lloji, që përdorin lëndë plasëse;
- e) ndryshimi i destinacionit të përdorimit të ujit për pirje nga blegtoria.

2. Mund të ushtrohen me miratim paraprak të organeve përkatëse dhe nën kontrollin e tyre:

a) ndërhyrjet për pasurimin dhe përmirësimin e bimësisë dhe të kapacitetit të kullotave e livadheve;

b) ndërhyrjet për pasurimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në tërësi apo të veprave të veçanta të saj;

- c) përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve;
- ç) prerja e pemëve, e drurëve dhe e shkurreve;
- d) pastrimi i kullotave dhe i livadheve.

KREU V
ADMINISTRIMI I FONDIT KULLOSOR

Neni 24

Ministria përgjegjëse për kullotat dhe livadhet

(ndryshuar me ligjin nr. 49/2016, datë 5.5.2016)

1. Ministria është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen dhe miradministrimin e fondit kullor, pjesë e zonave të mbrojtura.

2. Ministria është organi qendror përgjegjës për hartimin e politikave dhe kuadrit ligjor, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të fondit kullor. Ajo drejton dhe organizon:

a) hartimin e politikave, të strategjive, planeve të veprimit e të mbarështimit në nivel kombëtar, për zhvillimin dhe menaxhimin e integruar të kullotave e livadheve, ruajtjen e mjedisit, të ekulibrit biologjik dhe të biodiversitetit në fondin kullor;

b) sigurimin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

c) hartimin e programeve studimore dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore-shkencore, në bashkëpunim me organet e specializuara kërkimore-shkencore e me departamentet e Universitetit Bujqësor;

ç) planifikimin dhe përdorimin e fondeve për studime në ekonomitë kullorore, për vlerësimin dhe rritjen e aftësisë mbajtëse të kullotave dhe livadheve, si dhe për kryerjen e punimeve e të ndërtimeve në to, sipas projekteve, në nivel kombëtar;

d) punën për përcaktimin e ekonomive kullorore dhe ndarjen e tyre në ngastra e nënngastra;

dh) zgjerimin e mundësive për rritjen e investimeve private në kullota e livadhe dhe angazhimin e bizneseve në to;

e) promovimin e zgjidhjeve e të rrugëve të reja, për trajtim bashkëkohor të kullotave, për rritjen e përdorimit racional të tyre.”.

Neni 25

Certifikimi i ekspertëve dhe licencimi i tyre

(ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

1. Për të siguruar asistencë të kualifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit, të ekspertizave, të projekteve operationale dhe zbatimin e tyre në kullotat shtetërore dhe private, ministri, që mbulon fondin kullor, certifikon ekspertë në fushën e kullotave dhe të livadheve.

2. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte juridike ose fizike, tregtare, i nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat”.

3. Këshilli i Ministrave miraton kriteret, rregullat dhe procedurat për certifikimin e ekspertëve dhe licencimin në fushën e kullotave dhe të livadheve.

Neni 26

Kompetencat e bashkive dhe të pronarëve privatë

(ndryshuar me ligjin nr. 49/2016, datë 5.5.2016)

Bashkitë janë pronarë të kullotave shtetërore që gjenden brenda territorit administrativ të tyre. Bashkitë dhe pronarët privatë, që zotërojnë kullota dhe livadhe, kanë këto kompetenca:

a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij;

b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet;

c) marrin masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre;

ç) raportojnë në ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet të dhënat, që u kërkojnë për inventarizimin dhe regjistrimin në regjistrin e fondit kullosor të kullotave dhe livadheve, në përputhje me formularët tip;

d) njoftojnë ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet për infeksionet dhe dëmtuesit, që shfaqen në kullota e livadhe.

Neni 27

Investimet

1. Ministria dhe bashkitë, që zotërojnë kullota e livadhe, sigurojnë fonde dhe mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit e nga donacione të ndryshme, për ruajtjen dhe përmirësimin e fondit kullosor.

2. Fondet e siguruara për investime në kullota e livadhe përdoren për:

a) hartimin e planeve të mbarështimit;

b) punimet e pastrimit, të mirëmbajtjes e të përmirësimit rrënjësor të tyre;

c) ndërtimin e veprave për shfrytëzimin racional të tyre dhe për përmirësimin e infrastrukturës;

ç) mbrojtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit;

d) parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;

dh) studime e kërkime shkencore.

KREU VI

MONITORIMI DHE KONTROLLI

Neni 28

Monitorimi

1. Monitorimi i kullotave dhe i livadheve nënkupton përfshirjen e tyre në kërkesat e programeve të biomonitorimit, që programohet dhe realizohet si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe kryhet në përputhje me kërkesat e këtij programi. Monitorimi përfshin edhe ekonominë kullosore, që bëjnë pjesë në fondin kullosor.

2. Të dhënat e monitorimit përpunohen nga strukturat menaxhuese të kullotave dhe shpallen çdo vit në internet.

3. Ministri miraton rregulloren e biomonitorimit.

Neni 29

Organet e kontrollit

(shfuqizuar pika 2, me ligjin nr. 49/2016, datë 5.5.2016)

1. Kontrolli për zbatimin e këtij ligji bëhet nga Policia Pyjore dhe strukturat menaxhuese të kullotave e livadheve në nivel qendror dhe vendor.

2. Shfuqizuar.

KREU VII

SANKSIONET

Neni 30

Dokumentimi

(ndryshuar me ligjin nr. 38/2013, datë 14.2.2013)

1. Ushtrimi i kontrollit dhe dokumentimi i tij bëhen nga organet e kontrollit, të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Të drejtën e vendosjes së gjobës, si dënim administrativ kryesor, të parashikuar në nenin 34 të këtij ligji, e kanë organet e kontrollit, të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji.

Neni 31

Vendimi dhe e drejta ankimit

(ndryshuar me ligjin nr. 38/2013, datë 14.2.2013, nr. 49/2016, datë 5.5.2016)

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative merret nga Policia Pyjore, në zbatim të legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të pikës 1, të këtij neni, bëhet ankim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Procedura e ekzekutimit të vendimit të dënimit me gjobë bëhet në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 32

Ankimi

(shfuqizuar me ligjin nr. 38/2013, datë 14.2.2013)

Neni 33

Vlerësimi i dëmit

1. Për çdo rast kundërvajtjeje administrative apo vepre penale vlerësohet edhe dëmi që është shkaktuar dhe kërkohet zhdëmtimi i tij nga personi përgjegjës.

2. Kriteret për përcaktimin e vlerës së dëmit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 34

Kundërvajtjet administrative

(ndryshuar pika 3, me ligjin nr.9996, datë 22.9.2008)

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

1. Kullotja pa kontratë dhe kullotja në kullota të tjera, veç atyre të specifikuara në kontratë, dënohen me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

2. Kositja e barit në livadhe, pa miratimin e drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

3. Ushtrimi pa kontratë i veprimtarive në sipërfaqet dhe tokat e fondit kullosor dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 200 000 lekë.

4. Kullotja e bagëtive në parcelat eksperimentale dhe në sipërfaqet, ku kryhen punime përmirësuese ose që janë të degraduara e të lëna pushim, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

5. Prishja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, topografike, i tabelave të vendosura në fondin kullosor dënohet me gjobë në masën 20 000 lekë.

6. Hedhja e mbeturinave apo e inerteve brenda kufijve të kullotave apo livadheve dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

7. Shkarkimet e kimikateve në fondin kullosor dënohen me gjobë nga 70 000 deri në 100 000 lekë.

8. Shkarkimet e ujërave të ndotura industriale, urbane e bujqësore dënohen me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

9. Hapja dhe shfrytëzimi i guroreve apo i karrierave të çdo lloji, që përdorin lëndë plasëse, dënohen me gjobë në masën 100 000 lekë.

10. Ndryshimi i destinacionit të përdorimit të ujërave, që përdoren për pirje nga blegtoria, pa miratimin e drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

11. Dëmtimi i infrastrukturës, si i rrugës, burimeve e veprave ujore, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

12. Ndërhyrjet për pasurimin dhe përmirësimin e bimësisë dhe të kapacitetit të kullotave e livadheve, pa miratimin e drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

13. Përdorimi i plehrave kimike dhe i pesticideve, pa miratimin e drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

14. Prerja e pemëve, e drurëve dhe e shkurreve, pa miratimin e drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

15. Pastrimi i kullotave dhe i livadheve, pa miratimin e drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

16. Ndërtimi e vënia në funksionim e veprimtarive, që shkaktojnë degradimin dhe gërryerjen e tokës, dënohen me gjobë nga 30 000 deri në 50 000 lekë.

Neni 35

Sekuestrimi dhe masat urgjente

(ndryshuar me ligjin nr. 38/2013, datë 14.2.2013)

1. Mjetet dhe pajisjet, që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes dhe çdo përfitim pasuror i siguruar prej saj, sekuestrohen dhe kalojnë në llogari të administruesit të kullotës.

2. Masa e sekuestrit, sipas pikës 1 të këtij neni, është dënim plotësues.

3. Struktura përgjegjëse, në varësi të rastit, merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 36

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10 pika 4,13, 17 pika 5, 25 pika 2 dhe 33 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 2, 7 pika 1, 9 pika 2, 14 pika 6, 17 pika 4, 18 pika 3, 19 pika 2, 22 pika 3 dhe 28 pika 3 të këtij ligji.

Neni 37

Shfuqizime

Ligji nr. 7917, datë 13.4.1995 “Për kullotat dhe livadhet” dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

DISPOZITË KALIMTARE ME LIGJIN NR. 38/2013, datë 14.2.2013

Neni 5 Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

DISPOZITË KALIMTARE ME LIGJIN NR. 49/2016, datë 5.5.2016

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për kullotat, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton transferimin e kullotave në pronësi të bashkive.

Neni 38 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5243, datë 30.3.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ Nr. 111/2012

PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE²⁵

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

(i përditësuar, 2018)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim:

a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme

²⁵ Ky ligj është përafruar plotësisht me: Direktivën 2000/60/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2000, "Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave". Numri CELEX: 32000L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 327, datë 22.12.2000, faqe 1 – 73.

Ligji nr.111/2012, datë 15.11.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.157, datë 6 dhjetor 2012.

Ligji nr.6/2018, datë 8.2.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, datë 7 mars 2018.

apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre;

b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit;

c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit të efektshëm të tyre;

ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike;

d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave socialë dhe ekonomike të vendit.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë marrëdhëniet juridike që lindin nga përdorimi i burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

a) ujërat brendshme detare, ujërat territoriale, vijën bregdetare, zonën ekonomike ekskluzive, shelfin kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike, ujërat ndërkufitare, burimet natyrore dhe ujërat e lagunave e zonat e mbrojtura;

b) ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, me përjashtim të ujërave minerale dhe gjeotermale që janë të përshtatshme për nxjerrjen e lëndëve të para minerare ose shfrytëzimin e energjisë termike të akumuluar për qëllime të prodhimit të energjisë, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 3

Objekti i ligjit

Dispozitat e këtij ligji kanë si objekt të përcaktojnë:

a) sigurimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve ujore;

b) zbatimin e planeve konkrete për përmirësimin e burimeve ujore, mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore, të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, zonës ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre;

c) promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit nëpërmjet mbrojtjes afatgjatë të burimeve ujore;

ç) zbatimin e metodave dhe kushtet për menaxhimin e integruar, përdorimin racional të burimeve ujore e mbrojtjen e cilësisë ekologjike të tyre;

d) krijimin e strukturave administrative për menaxhimin e burimeve ujore, si dhe ushtrimin e funksioneve të tyre;

dh) marrjen e masave për zbutjen efektive të përmbytjeve dhe thatësirave;

e) monitorimin e statusit të ujërave, përdorimin racional dhe pakësimin e ndotjes;

ë) parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm, mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së brigjeve, të ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore.

Neni 4

Përkufizime

(ndryshuar fjalë në pikat 1, 15, 31, 32, 33, 61 dhe 64, ndryshuar pikat 8, 42 dhe 60, shfuqizuar pikat 29, 30, shtuar pika 95 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” është institucioni që është ngritur dhe funksionon sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit .

2. “Agjencia Rajonale e Mjedisit” është dega rajonale përkatëse e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

3. “Akuifer” është një apo disa shtresa nënsipërfaqësore të shkëmbinjve a formacioneve të tjera gjeologjike të tokës, me porozitet dhe përshkueshmëri të mjaftueshme, që mundësojnë ose një rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose nxjerrjen e një sasi të konsiderueshme të ujërave nëntokësore.

4. “Autoriteti përkatës i qeverisjes vendore” është njësia e qeverisjes vendore, në territorin e së cilës kryhet veprimtaria lidhur me ujërat.

5. “Autorizim” është akti administrativ, me anën e të cilit i njihet titullarit të saj e drejta të kryejë një apo disa veprime, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të. Formulari i autorizimit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Ujit.

6. “Autorizim i posaçëm” është akti administrativ, me anën e të cilit i njihet titullarit të saj e drejta të kryejë një veprim të caktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të. Formulari i këtij autorizimi përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Ujit.

7. “Basen ujqor” është sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një numri përrenjsh, lumenjsh apo edhe liqenesh, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një lumë, i cili derdhet në det, në një grykëderdhje të gjerë të vetme, në një deltë apo në një lumë tjetër.

8. “Brigjet” janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve.

9. “Burimet ujore” janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.

10. “Burimet ujore gjeotermale” janë ujërat që kanë temperatura vazhdimisht më të larta se temperaturat mesatare vjetore atmosferike të rajonit, me efektin e temperaturës së nëntokës, në varësi të strukturës gjeologjike, që mund të përmbajnë materiale të shkrira dhe gaz në një sasi më të lartë se burimet ujore përreth, ku uji, avujt dhe gazi natyrshëm shpërthejnë ose nxirren nga vendet ku ato mbahen nëpërmjet ngrohjes nga nëntoka ose nga shkëmbinjtë e thatë dhe të nxehtë, nëpërmjet strukturave nëntokësore të modifikuara nga njeriu.

11. “Burimet ujore minerale dhe termominerale” janë ujërat e ngrohta dhe të ftohta natyrore që ndodhen natyrshëm në thellësi të ndryshme të nëntokës e në kushte të përshtatshme gjeologjike, që ndodhen ose janë nxjerrë në sipërfaqe të tokës më vete nga një ose shumë burime, që janë të përcaktuara nga përmbajtja e tyre minerale apo komponentë të tjerë, të tillë si uji i pijshëm, uji kurativ dhe emra të ngjashëm.

12. “Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni që ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1999 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

13. “Eutrofikim” është pasurimi i ujit me përbërës ushqyes, veçanërisht me komponime azotike ose fosforike që shkakton zhvillim të shtuar të algave dhe llojeve më të larta bimore, që krijojnë prishje të padëshirueshme të baraspeshës së organizmave të pranishëm në ujë dhe të kualitetit të këtij uji.

14. “Horizont ujqor” është një shtresë nënsipërfaqësore, shtresa të një shkëmbi ose shtresa të tjera gjeologjike me një porozitet të mjaftueshëm dhe një depërtueshmëri për të lejuar një rrjedhje

të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose shkëputjen e sasive të konsiderueshme të tyre.

15. “Inspektorati që mbulon fushën e mjedisit” është autoriteti inspektues, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

16. “Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore” përmban inventarin publik ku regjistrohen të gjitha të dhënat për ujërat nëntokësore, ujërat sipërfaqësore dhe zonat e mbrojtura.

17. “KKU” është Këshilli Kombëtar i Ujit.

18. “Koncesion” është marrëveshja ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, siç përcaktohet në ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

19. “Kontrollet e shkarkimeve” janë kontrollet që kërkojnë një kufi specifik të shkarkimit, për shembull një vleftë kufi të shkarkimit ose ndryshe specifikimin e kufijve apo kushteve mbi efektet, natyrën ose karakteristika të tjera të një emisioni ose kushtet operationale, të cilat ndikojnë në shkarkimet.

20. “Kufi hidrografik i basenit ujëmbledhës” është vija imagjinare, e cila formohet duke lidhur pikat më të larta të peizazhit, si majat e maleve, kodrave, kreshtave që ndajnë luginat nga njëra-tjetra dhe që lë jashtë saj të gjitha degët e përrrenjve dhe lumenjve që rrjedhin në anë të kundërt.

21. “Kufijtë territorialë të menaxhimit” janë kufijtë artificialë të miratuar për arsye menaxhimi, brenda të cilëve përfshihen një ose më shumë basene apo pjesë basenesh hidrografike.

22. “Leje” është akti administrativ, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet”.

23. “Leje mjedisi” është leja e mjedisit e tipit A, B apo C, sipas rastit, siç përcaktohet në ligjin për lejet e mjedisit.

24. “Licencë” është akti administrativ, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet”.

25. “Ligji për mbrojtjen e mjedisit” është ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ashtu siç mund të ndryshojë”.

26. “Liqen” është një trup me ujëra të brendshme sipërfaqësore dhe nëntokësore të qëndrueshme.

27. “Lumë” është një trup ujeror i brendshëm, me ujë, që në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nën tokë.

28. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.

29. Shfuqizuar.

30. Shfuqizuar.

31. “Mjedis” janë përbërësit natyrorë, si ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

32. “Ndotës” është çdo substancë e rrezikshme që shkakton ndotje, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

33. “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimit e tjera të ligjshme të mjedisit, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për mbrojtjen e mjedisit.

34. “Normë e cilësisë së mjedisit për ujërat” është përqendrimi i një substance ndotëse të veçantë ose i një grupi substancash ndotëse në ujë, në sedimente ose në biotë.

35. “Normë e cilësisë së ujërave nëntokësore” është norma mjedisore, teknike dhe shëndetësore që shprehet si përqendrim i një substance ndotëse të veçantë apo i një grupi substancash ndotëse ose si tregues i ndotjes së ujërave nëntokësore.

36. “Normë teknike e shkarkimit në mjedis” janë kufijtë e vlerave dhe të përqendrimeve të parametrave fiziko-kimikë të ujërave të ndotura industriale, të cilat derdhen në sistemin e

kanalizimeve publike, sipas kuptimit të dhënë në vendimin nr. 1340, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës - kanalizimeve”.

37. “Përdorues” është çdo rreth, bashki, komunë, fshat, shoqatë e përdoruesve të ujit, ndërmarrje shtetërore apo private, person fizik dhe juridik, që merret me eksplorimin, prodhimin, përdorimin e burimeve ujore, shkarkon, trajton apo kryen çdo lloj aktiviteti tjetër në fushën e menaxhimit të ujërave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

38. “Përdorim i ujit” janë shërbimet e ujit, si eksplorimi, prodhimi, përdorimi i burimeve ujore, shkarkimi, trajtimi apo kryerja e çdo lloj aktiviteti tjetër në fushën e menaxhimit të ujërave, duke pasur një impakt të rëndësishëm mbi statusin e ujit.

39. “Përmbytje” është mbulimi i përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrënjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore kalimtare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotura.

40. “Potencial i mirë ekologjik” është potenciali ekologjik i një trupi ujqor tepër të modifikuar ose i një trupi ujqor artificial, kur ai vlerësohet po aq “i mirë” sa është përcaktuar në akte ligjore të veçanta.

41. “Prurje me qëndrueshmëri 355 ditë (Q355)” është prurja bazuar në prurjen e mesatareve ditore të studimit hidrologjik, e cila nuk tejkalohet më shumë se 355 ditë në një vit. Kjo nënkupton se mesatarisht prurja natyrale është më e vogël se vlera e Q355 vetëm për 10 ditë të vitit.

42. “QKB” është Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

43. “Regjistër Kombëtar i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore” është portali i integruar i të dhënave elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

44. “Regjistër Kombëtar i Licencave dhe Lejeve” është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi, shpalljeje, si dhe një arkiv elektronik zyrtar që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

45. “Rreziku nga përmbytjet” është kombinimi i probabilitetit të ngjarjes së përmbytjes dhe të pasojave negative të mundshme për shëndetin e njeriut, për gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik që lidhet me ngjarjen e përmbytjes.

46. “Rrjedhje minimale ekologjike” është regjimi i rrjedhjes në një trup ujqor sipërfaqësor, shtrat lumor, basen ujqor apo zonë bregdetare, e nevojshme për të ruajtur një qëndrueshmëri të ekosistemit natyror dhe përfitimeve të tyre.

47. “Servitut” ka kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

48. “Sistemi i kanalizimeve” janë të gjitha tubacionet, kolektorët, pajisjet, ndërtesat dhe strukturat, që shërbejnë për mbledhjen e ujërave të ndotura, stacionet e pompimit ose paratrajtimi i ujërave të ndotura nga njësitë e qeverisjes vendore, por që nuk përfshijnë ujërat e shiut. Instalimet e të tretëve për shkarkimin e ujërave të ndotura, janë, gjithashtu, pjesë e sistemit të kanalizimeve, si dhe pajisjet që duhen për implementimin, zgjerimin, rehabilitimin ose mirëmbajtjen e sistemit.

49. “Status ekologjik” është shprehja e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujore, që lidhen me ujërat sipërfaqësore dhe klasifikohet në përputhje me akte të veçanta ligjore.

50. “Status i mirë ekologjik” është statusi ekologjik i arritur nga një trup ujqor sipërfaqësor që vlerësohet po aq “i mirë” sa është përcaktuar në akte të veçanta ligjore.

51. “Status i mirë i ujërave nëntokësore” është statusi i arritur nga një trup me ujëra nëntokësore, kur si statusi i tij sasior, ashtu edhe statusi i tij kimik vlerësohen të paktën po aq “të mirë”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

52. “Status i mirë i ujërave sipërfaqësore” është gjendja e arritur nga një trup uxor sipërfaqësor, ku si gjendja e tij ekologjike, ashtu edhe gjendja e tij kimike janë vlerësuar të paktën po aq “të mira”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

53. “Status i mirë kimik i ujërave nëntokësore” është statusi kimik i një trupi uxor nëntokësor që vlerësohet po aq “i mirë”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

54. “Status i mirë kimik i ujërave sipërfaqësore” është statusi kimik që kërkohet për të përmbushur objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësore, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

55. “Status i mirë sasior i ujërave nëntokësore” është statusi sasior i një trupi uxor nëntokësor që vlerësohet po aq “i mirë”, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

56. “Status i ujërave nëntokësore” është shprehja e përgjithshme e statusit të një trupi uxor nëntokësor, që përcaktohet nga statusi referuar limiteve të sipërme të standardit, siç përcaktohet në aktet ligjore në fuqi.

57. “Status i ujërave sipërfaqësore” është shprehja e përgjithshme e gjendjes së një trupi uxor sipërfaqësor, që përcaktohet nga gjendja e tij ekologjike, cilësore dhe kimike më e varfër.

58. “Status sasior” është shprehja e masës, në të cilën një trup uxor nëntokësor ndikohet nga nxjerrjet e drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta.

59. “Standarde të cilësisë mjedisore” është përqendrimi i ndotësve të veçantë ose i grupit të ndotësve në ujë, sedimente ose biota, i cili nuk duhet të tejkalohet, me qëllim mbrojtjen e shëndetit njerëzor dhe të mjedisit.

60. “Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)” është organi qendror përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

61. “Subjekt ndotës” është çdo person, fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit, sipas kuptimit që i është dhënë nga ligji për mbrojtjen e mjedisit.

62. “Substanca ndotëse” janë të gjitha substancat e prirura për të shkaktuar ndotje, në veçanti ato që janë përcaktuar si të tilla në akte ligjore e nënligjore specifike.

63. “Substanca prioritare” janë ato substanca ku përfshihen “substancat prioritare të rrezikshme”, të përcaktuara si të tilla në akte ligjore të veçanta, për ndalimin apo ndërprerjen e shkarkimeve, çlirimeve dhe humbjeve të të cilave duhen marrë masa të posaçme.

64. “Substanca të rrezikshme” është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t’u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme, sipas kuptimit që i është dhënë nga ligji për mbrojtjen e mjedisit.

65. “Shelfi kontinental” ka kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

66. “Shërbimet e ujit” janë të gjitha shërbimet që sigurojnë për konsumatorët familjarë, publikë e privatë, si dhe për veprimtaritë e biznesit, nxjerrjen, mbajtjen, ruajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit sipërfaqësor ose nëntokësor, grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, të cilat më pas shkarkohen në ujërat sipërfaqësore.

67. “Shkarkim në ujë” janë shkarkimet në trupat uxorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të ndotura dhe të shiut.

68. “Shkarkime industriale” janë mbetjet e lëngshme, të cilat prodhohen pas proceseve të ndryshme industriale, me rrezik kontaminimi ose ndotjeje të mjedisit ku ato shkarkohen.

69. “Titullar i licencës, autorizimit, lejes, koncesionit” është personi juridik apo fizik, që ka marrë një licencë, autorizim, leje apo koncesion.

70. “Trajtim i kombinuar” është kontrolli i shkarkimeve dhe derdhjeve në ujërat sipërfaqësore, sipas mënyrës së trajtimit të përcaktuar në akte nënligjore të veçanta.

71. “Trup me ujëra nëntokësore” është ai formacion gjeologjik që ka aftësinë e ujëmbajtjes në një vëllim dhe kusht të caktuar dhe që përbën një akuifer.

72. “Trup uxor artificial” është trupi uxor sipërfaqësor i krijuar nga veprimtaria njerëzore, si rezervuar, depo ruajtjeje, kanal, pellg për rritje peshku.

73. “Trup uhor sipërfaqësor” është një element i dallueshëm dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore, p.sh. një liqen, rezervuar, përrua, lumë ose kanal, një pjesë e një përroi, lumi ose kanali, ujëra të përkohshme ose një shtrirje e ujit bregdetar.

74. “Trup uhor tepër i modifikuar” është trupi uhor sipërfaqësor, i cili, si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor, ka ndryshuar rrënjësisht karakterin e tij në krahasim me atë që është shpallur me legjislacionin përkatës nga autoriteti kompetent.

75. “Thatësirë” është periudha e gjatë kohore me prurje të vogla, të cilat janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat për ujë të një kategorie përdoruesish.

76. “Ujërat e brendshme detare” përfshijnë ujërat e limaneve detare, ngushticat, ujërat brenda arkipelagëve, detet e brendshme, hapësirat ujore mes vijës së baticës më të lartë dhe zbaticës më të ulët, si dhe deltat e lumenjve.

77. “Ujërat e ndotura industriale” janë të gjitha ujërat e përdorura që shkarkohen nga mjediset që përdoren për të zhvilluar veprimtari tregtare ose industriale, të cilat nuk janë ujëra të përdorura shtëpiake apo rrjedha të ujërave të shiut.

78. “Ujërat e ndotura shtëpiake” janë ujërat e përdorura nga zonat rezidenciale dhe sektori i shërbimeve, që e kanë origjinën kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe veprimtaritë e sektorit shtëpiak.

79. “Ujërat e ndotura urbane” janë ujërat e përdorura shtëpiake ose një përzierje e ujërave shtëpiake me ujëra të ndotura industriale dhe rrjedhat nga ujërat e shirave.

80. “Ujëra territoriale” kanë kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

81. “Uji i përdorur industrial” është uji i prodhuar nga proceset e ndryshme industriale, i cili mund të jetë me rrezik kontaminimi apo ndotjeje për mjedisin në të cilin ai shkarkohet.

82. “Ujë i pijshëm” është uji i përcaktuar për përdorim nga njerëzit, ku futen:

a) ujërat e trajtuara ose të patrajtuara, të përcaktuara për qëllim pirjeje, gatimi, përgatitjeje të ushqimeve dhe për nevojat e higjienës, pavarësisht nga origjina e tyre dhe nga fakti nëse janë furnizuar prej një rrjeti shpërndarës, publik apo privat, prej depozitave, prej autoboteve, prej puseve, individuale apo kolektive, apo të ambalazhuara në shishe ose enë;

b) ujërat që përdoren në ndërmarrjet e prodhimit të ushqimeve për prodhimin, fabrikimin, përpunimin, ruajtjen apo tregtimin e prodhimeve ose lëndëve të përcaktuara për përdorim nga njerëzit, si dhe ujërat për pastrimin e sipërfaqeve, objekteve apo materialeve që mund të jenë në kontakt me artikuj ushqimorë;

c) artikujt ushqimorë me origjinë ujore;

ç) ujërat e furnizuara për përdorim nga njerëzit, si pjesë e një aktiviteti tregtar apo publik, pavarësisht nga sasia mesatare e ujit të furnizuar në ditë.

83. “Ujëra bregdetare” janë ujërat sipërfaqësore, të cilat ndodhen në brendësi të një vije imagjinare, e cila është e baraslarguar në secilën nga pikat e saj 1 milje detare nga pjesa e jashtme e pikës më të afërt të vijës bazë dhe që shërben si referim për të përcaktuar shtrirjen e ujërave territoriale dhe që shtrihen eventualisht deri në kufirin e jashtëm të ujërave transitore.

84. “Ujëra nëntokësore” janë të gjitha ujërat që ndodhen nën sipërfaqen e tokës apo kanë dalje të drejtpërdrejtë në sipërfaqen e tokës në formën e burimeve natyrore.

85. “Ujëra ndërkufitare” janë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat përshkojnë ose janë të lokalizuara në kufijtë midis dy ose më shumë shteteve.

86. “Ujëra të brendshme” janë të gjitha ujërat e ndenjura ose ujërat e rrjedhshme mbi sipërfaqen e një terreni dhe të gjitha ujërat nëntokësore në drejtim të bazamentit të tokës, mbi të cilën është matur gjerësia territoriale e ujërave.

87. “Ujëra të përkohshme” janë trupat uhorë sipërfaqësorë në afërsi të grykëderdhjeve të lumenjve në det, që janë pjesërisht me karakter të kripur, si rezultat i afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që kryesisht ndikohen nga rrjedha me ujëra të ëmbla.

88. “Ujëra sipërfaqësore” janë ujërat e brendshme, me përjashtim të ujërave nëntokësore, ujërat e përkohshme, ujërat bregdetare dhe ujërat territoriale.

89. “Vlefëta kufitare e shkarkimit” është masa, e shprehur në termat e parametrave specifike të sigurt, përqendrimi dhe niveli i shkarkimit, i cili mund të mos tejkalohet gjatë një ose më shumë periudhave kohore.

90. “Zona ekonomike ekskluzive” ka kuptimin që jepet nga dispozitat e Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë.

91. “Zonë e mbrojtur” është çdo zonë e përcaktuar, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për zonat e mbrojtura .

92. “Zona të veçanta ruajtjeje” janë zonat e përcaktuara, sipas kuptimit të dhënë në ligjin për zonat e mbrojtura .

93. “Zona termominerale” është ajo zonë, kufijtë e së cilës janë përcaktuar me anë të studimeve të kryera nga institucionet e specializuara, kombëtare ose ndërkombëtare, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe që përmbajnë burimet termominerale së bashku me ujërat natyrore minerale.

94. “Zonë e vërshimit” është sipërfaqja në të dyja anët e shtretërve të lumit ku parashikohet të ndodhin përmbytje të përkohshme.

95. “Menaxhimi i përgjithshëm, si pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore”, është koordinimi i të gjitha institucioneve dhe/ose strukturave shtetërore, veprimtaria e të cilave lidhet me përdorimin, shpërndarjen, mbrojtjen, menaxhimin, kontrollin e cilësisë, ushtrimin e veprimtarive në brigje apo në shtratin e burimeve ujore.

Neni 5

Pronësia e burimeve ujore

1. Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore:

a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë;

b) të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrorë apo artificialë, ishujt dhe grumbullimet e rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;

c) toka e përfshirë nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit;

ç) të gjitha strukturat dhe punimet hidroteknike të realizuara nga shteti, si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet, si dhe punimet që lidhen me to.

2. E drejta e pronësisë së shtetit, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe paparashkrueshme.

Neni 6

Parimet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore

1. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore bazohet në parimet e mëposhtme:

a) respektimi i integritetit të baseneve ujore, bazuar në kërkesat sociale dhe ekonomike për burime ujore, duke mbrojtur dhe ruajtur cilësinë e këtyre burimeve dhe cilësinë e mjedisit për brezat e ardhshëm;

b) koordinimi i kontrollit publik mbi burimet ujore përmes planifikimit të territorit dhe projekteve të zhvillimit social-ekonomik, në nivel kombëtar dhe vendor;

c) përdorimi racional i burimeve ujore dhe kontrolli i shkarkimeve;

ç) respektimi i parimit të rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit, përfshirë edhe kostot e mjedisit, në përputhje me parimin “ndotësi paguan”;

d) parimet e mbrojtjes së mjedisit, të përcaktuara në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;

dh) garantimi i një furnizimi të mjaftueshëm të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me cilësi të mirë për një përdorim ujq të qëndrueshëm, të ekuilibruar dhe të barabartë;

e) ndërmarrja e veprimeve parandaluese për të mos dëmtuar burimet ujore, si një përparësi, e cila duhet të korrigjohet që në burim.

2. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore kontribuon në mënyrë të veçantë për:

a) sigurimin e një sasive të mjaftueshme ujërash sipërfaqësore dhe nëntokësore me cilësi të mirë, të nevojshme për një përdorim të qëndrueshëm, të balancuar dhe të drejtë të ujit;

b) reduktimin e ndjeshëm të ndotjes së ujërave nëntokësore;

c) arritjen e objektivave, në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë edhe ato që synojnë të parandalojnë dhe t'i japin fund ndotjes së mjedisit detar.

KREU II

ORGANET E ADMINISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Neni 7

Organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore

(shfuqizuar shkronja “e”, ndryshuar shkronja “ç” e pikës 1 dhe pika 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Organet qendrore për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore janë:

a) Këshilli i Ministrave;

b) Këshillit Kombëtar i Ujit;

c) Shfuqizuar;

ç) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

2. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore në nivel baseni bëhet nëpërmjet:

a) këshillave të baseneve ujore;

b) zyrave të administrimit të baseneve ujore, degë të AMBU-së.

Neni 8

Këshilli i Ministrave

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, miraton:

a) përbërjen dhe rregulloren e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Ujit;

b) mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

2. Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak në Këshillin Kombëtar të Ujit, me propozimin e Kryeministrit:

a) miraton Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore;

b) emëron një komision të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitare;

c) përcakton kufijtë territorialë të çdo baseni ujq të Republikës së Shqipërisë, si dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre;

ç) miraton kufijtë hidrografikë të baseneve ujore;

d) miraton planet e menaxhimit të baseneve ujore;

dh) përcakton zonat, distancat dhe gjerësinë e brigjeve të burimeve ujore.

Neni 9

Këshilli Kombëtar i Ujit

(ndryshuar shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore.

2. Këshilli Kombëtar i Ujit është organ ndërmënytor që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

3. Kompetencat e Këshillit Kombëtar të Ujit janë:

a) miraton planet dhe projektet, ndërrajonale dhe kombëtare, në fushën e bujqësisë, urbanistikës, zhvillimit industrial e territorial, kur ato lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e ujërave;

b) merr masat e duhura për zbatimin e çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, konvente për burimet ujore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;

c) jep leje dhe autorizime për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm;

ç) çdo autoritet kontraktor, përpara se të nisë një procedurë koncesioni për përdorimin e burimeve ujore, duhet të marrë miratimin, në parim, nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

Kur këto burime ujore kanë rëndësi kombëtare, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave, marrëveshja e koncesionit hyn në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi;

d) miraton rregulloren e Këshillit të Basenit Ujor.

4. Aktet me karakter normativ të Këshillit Kombëtar të Ujit botohen në Fletoren Zyrtare.

Neni 10

(shfuqizuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Neni 11

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është person juridik shtetëror, që financohet nga buxheti i shtetit. AMBU-ja organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujor nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka këto kompetenca:

a) harton dhe zbaton politika, strategji, plane, programe dhe projekte, që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiorë dhe cilësorë, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre;

b) zbaton dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare për burimet ujore dhe ato ndërkufitare, palë e të cilave është edhe Republika e Shqipërisë;

c) ushtron funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit;

ç) i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien me koncesion të burimeve ujore;

d) i propozon Këshillit Kombëtar të Ujit dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit dhe shkarkimeve, kur veprimtaria kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm;

dh) harton inventarin kombëtar të burimeve ujore, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor;

e) harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore;

ë) harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit për ujërat ndërkufitare;

f) është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike të burimeve ujore;

g) kërkon nga organet dhe institucionet shtetërore, agjencitë dhe entet publike informacion, të dhëna teknike, analiza apo mbështetje tekniko-konsultative që shërbejnë për nevojat e administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore;

gj) nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujore;

h) nxit studime e kërkime për zhvillimin e të rejave teknike që lidhen me përdorimin, zbulimin, shfrytëzimin, ruajtjen, trajtimin, mbrojtjen, administrimin dhe përdorimin efikas të burimeve ujore;

- i) në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkencore, përcakton fushat e kërkimit dhe të studimit për burimet ujore, si dhe fondet përkatëse për to;
 - j) bashkërendon dhe kontrollon punën e organeve vendore të menaxhimit të burimeve ujore;
 - k) kundërshton në gjykatë vendimet e Këshillit të Basenit Ujor.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton kompetenca të tjera përveç atyre të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 12

Këshilli i basenit ujor

(shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli i basenit ujor është organi përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në basenin përkatës, në nivel vendor.
2. Këshilli i basenit ujor ka këto detyra:
 - a) siguron ruajtjen dhe zhvillimin sa më racional të burimeve ujore brenda kufijve të basenit përkatës ujor;
 - b) siguron shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore brenda kufirit të basenit përkatës ujor, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre;
 - c) siguron mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet, shpërdorimet dhe dëmtimet që prekin cilësinë dhe sasinë e tyre;
 - ç) identifikon trupat ujorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje.
3. Shfuqizuar.

Neni 13

Zyrat e administrimit të baseneve ujore

(ndryshuar titulli dhe emëtime në pikat 1 dhe 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor është struktura në varësi të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore e cila ngrihet dhe funksionon në çdo basen ujor.
2. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor ka këto detyra:
 - a) përpilon projektin e planit për burimet ujore për basenin përkatës dhe e paraqet për miratim në këshillin e basenit ujor;
 - b) harton inventarin e burimeve ujore në sasi dhe cilësi, si dhe bën periodikisht përditësimin e tij;
 - c) nxit pjesëmarrjen e përdoruesve të ujit në drejtimin dhe administrimin e burimeve ujore;
 - ç) përgatit raporte, jep opinione për burimet ujore dhe i paraqet ato për ndjekje të mëtejshme në këshillin e basenit ujor;
 - d) përgatit materialet për mbledhjet e këshillit të basenit ujor.
 - dh) ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe këshillit të basenit ujor.

KREU III

MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE

Seksioni 1

Ndarja e territorit për efekt të menaxhimit të burimeve ujore

Neni 14

Basenet ujore

1. Territori i Republikës së Shqipërisë, për qëllime të menaxhimit të burimeve ujore, ndahet në basene ujore.

2. Ujërat nëntokësore, kur nuk ndjekin plotësisht një basen ujor të veçantë, identifikohen dhe i caktohen basenit ujor më të afërt.
3. Ujërat bregdetare identifikohen dhe i caktohen basenit ujor më të afërt.

Seksioni 2

Dokumentet e planifikimit për menaxhimin e burimeve ujore

Neni 15

Politikat

Politikat janë niveli më i lartë i planifikimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore, dokumentet e të cilave përmbajnë:

- a) qëllimin e planifikimit dhe të zhvillimit të menaxhimit të burimeve ujore, në harmoni me zhvillimin ekonomik, demografik, social, mjedisor, kulturor dhe historik;
- b) masat e zbatimit;
- c) planin e punës dhe buxhetin e nevojshëm për zbatimin e tij.

Neni 16

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore

(ndryshuar emërtimi në pikën 5 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore është një dokument planifikimi që përcakton vizionin e politikave të shtetit, misionin, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujërave për një periudhë afatgjatë.

2. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore bazohet në kërkimet shkencore, vëzhgimin e vazhdueshëm të situatës dhe fenomenet që kanë lidhje me ujin dhe përdorimin e tij, duke respektuar problemet specifike të ujit dhe mbrojtjen e integruar të mjedisit në çdo basen ujor.

3. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik dhe përmban edhe dokumente të tjera përkatëse.

4. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore rishikohet çdo 15 vjet. Strategjia mund të rishikohet dhe të përditësohet edhe para përfundimit të këtij afati, në qoftë se një gjë e tillë diktohet nga ndryshimet në sistemin e ujërave dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit.

5. Organet, entet, institucionet e specializuara në fushën e ujërave, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, hartojnë Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujit, miraton kërkesat për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Neni 17

Planet e menaxhimit të baseneve ujore

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Planet e menaxhimit të baseneve ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujit, miraton kërkesat për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve.

3. Planet e menaxhimit të baseneve ujore rishikohen çdo gjashtë vjet.

Neni 18

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Republika e Shqipërisë lidh marrëveshje me vendet fqinje, me qëllim vendosjen dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre vendeve për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare, për nevojën e forcimit të veprimit kombëtar dhe dypalësh, si dhe për parandalimin e ndotjes së burimeve ujore.

2. Bashkëpunimi ndërkufitar synon mbrojtjen e ujërave ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Neni 19

Zbatimi i marrëveshjeve, konventave dhe protokolleve ndërkombëtare

1. Për mbrojtjen e gjendjes natyrore të ujërave ndërkufitare veprojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Shqipërisë, si dhe marrëveshjet, konventat, protokollet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

2. Ujërat ndërkufitare mund të përdoren vetëm në mënyrë të kontrolluar dhe në kufij të përcaktuar shkencorë, pa dëmtuar kushtet natyrore dhe balancat biologjike dhe ekologjike të tyre.

3. Personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, që shfrytëzojnë pasuritë ujore, natyrore dhe biologjike të burimeve ujore, ose ushtrojnë veprimtari të ndryshme në to, janë të detyruar të mbrojnë ujërat ndërkufitare nga dëmtimet e mundshme dhe të zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

4. Subjektet përkatëse, për projektet dhe veprimtaritë që kërkojnë të ushtrojnë në ujërat ndërkufitare, duhet të pajisen me leje mjedisore dhe për këtë përgatitet raport i thelluar i ndikimit në mjedisin ujor.

Neni 20

Masat për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare

(ndryshuar emërtesa në fjalinë e parë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim dhe së bashku me ministrinë përkatëse, organizojnë punën për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare, kontrollojnë zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe marrin pjesë në:

- a) hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të ujërave ndërkufitare;
- b) hartimin dhe zbatimin e programeve të veçanta të monitorimit;
- c) hartimin dhe zbatimin e planeve për rehabilitimin e zonave të ndotura e të dëmtuara të ujërave ndërkufitare;
- ç) krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor për administrimin dhe mbrojtjen e ujërave ndërkufitare;
- d) sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;
- dh) kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të faunës dhe florës së ujërave ndërkufitare.

Neni 21

Administrimi dhe menaxhimi i ujërave ndërkufitare

(ndryshuar pika 1, shfuqizuar shkronja "a" dhe shtuar shkronja "e" të pikës 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Administrimi i ujërave ndërkufitare kryhet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bazë të planeve të menaxhimit për ujërat ndërkufitare, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Në planet e menaxhimit për ujërat ndërkufitare përfshihen:

- a) Shfuqizuar;
- b) objektivat e menaxhimit të ujërave ndërkufitare;
- c) identifikimi i detyrave të organeve të ndryshme shtetërore, të institucioneve studimore, të organizatave mjedisore për administrimin dhe mbrojtjen e ujërave ndërkufitare;
- ç) masat për të mënjeluar apo reduktuar kërcënimet e identifikuara;
- d) kushtet për kërkimin shkencor, inventarizimin dhe monitorimin;
- dh) kushte të tjera të veçanta.
- e) programi i masave për zbatimin e këtyre planeve.

Neni 22

Komisionet e posaçme për administrimin e ujërave ndërkufitare

(ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Për mbrojtjen dhe administrimin e ujërave ndërkufitare krijohen komisione të posaçme, përbërja, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e të cilave rregullohen me akte ligjore e nënligjore të veçanta.

2. Me propozimin e Kryeministrit, pas miratimit paraprak të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli i Ministrave emëron një komision të posaçëm, që ngarkohet me administrimin e ujërave ndërkufitare, administrimin e marrëdhënieve me shtetet kufitare për këto ujëra, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

Neni 23

(shfuqizuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Neni 24

Hollësitë e strategjisë dhe të planit të menaxhimit të basenit ujq

(shtuar fjalë në shkronjën "j" me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe planin e menaxhimit të basenit ujq përfshihen:

- a) objektivat mjedisorë, referuar në nenin 25 të këtij ligji;
- b) parametrat kimikë dhe ekologjikë për ujërat sipërfaqësore, siç përcaktohet në këtë ligj;
- c) parametrat kimikë dhe sasiorë për statusin e ujërave nëntokësore, siç përcaktohet në këtë ligj;
- ç) kushtet për shpalljen e trupave ujqorë tepër të modifikuar, referuar në nenin 27 të këtij ligji;
- d) specifikimet teknike dhe metodat e standardizuara, lidhur me programin e monitorimit, siç përcaktohet në këtë ligj;
- dh) specifikimet teknike për analizën e karakteristikave të baseneve ujqore, referuar në nenin 37 të këtij ligji;
- e) përmbajtja e programit të masave, referuar në nenin 37 të këtij ligji;
- ë) kushtet dhe masat përkatëse për planifikimin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, referuar në nenet 68 e 69 të këtij ligji;

f) çdo çështje tjetër që ka lidhje me zbatimin e strategjisë dhe planit të menaxhimit të basenit ujqor.

Seksioni 3

Klasifikimi i ujërave

Neni 25

Objektivat mjedisorë

(ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Objektivat mjedisorë për trupat me ujëra sipërfaqësore, nëntokësore, si dhe për zonat e mbrojtura vendosen me qëllim parandalimin e dëmtimit të trupave ujqorë, si dhe mbrojtjen, shtimin dhe rehabilitimin e të gjithë trupave ujqorë, si sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

2. Objektivat mjedisorë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen duke marrë në konsideratë statusin e tyre kimik, ekologjik dhe sasior.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, miraton kriteret për vendosjen e objektivave mjedisorë.

Neni 26

Klasifikimi i ujërave

(ndryshuar pika 3 dhe emërtimi në pikën 4 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Ujërat sipërfaqësore, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të ujit, klasifikohen sipas statusit të tyre kimik dhe ekologjik.

2. Ujërat nëntokësore, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të ujit, klasifikohen sipas statusit sasior dhe kimik.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujit, përcakton ujërat, sipas klasifikimit të tyre.

4. Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozimin e këshillit të basenit ujqor dhe institucioneve të specializuara shkencore që mbulojnë ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, në përputhje me parashikimet e këtij neni, shpall trupat ujqorë artificiale ose tepër të modifikuar dhe e publikon shpalljen në Fletoren Zyrtare.

5. Trupat ujqorë, në bazë të klasifikimit të ujërave të tyre, janë pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të basenit ujqor.

Neni 27

Trupat ujqorë tepër të modifikuar

(ndryshuar emërtimi në pikat 1 dhe 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozim të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të shpallë trupa të caktuar ujqorë si artificiale ose tepër të modifikuar, kur objektivat mjedisorë në lidhje me statusin e mirë apo potencialin e mirë ekologjik të tyre nuk mund të arrihen për shkak të pamundësisë teknike ose kostove tepër të larta;

b) të zgjatë afatet për arritjen e objektivave mjedisorë, me kusht që të mos ndodhë asnjë përkeqësim i mëtejshëm në statusin e trupit ujqor të prekur;

c) të vendosë objektiva mjedisorë specifike për trupa ujqorë të caktuar, kur ata janë shumë të prekur nga aktiviteti njerëzor apo kur kushtet e tyre natyrore janë të tilla që e bëjnë arritjen e objektivave të përgjithshëm mjedisorë të paralizueshëm ose tepër të kushtueshëm.

2. Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozim të këshillit të basenit ujqor, përcakton masa të përshtatshme për parandalimin e përkeqësimit të statusit të trupit që është shpallur si trup ujqor tepër i modifikuar.

3. Çdo shpallje e bërë sipas këtij neni dhe arsyet përkatëse përcaktohen në planin e menaxhimit të basenit ujqor përkatës.

4. Shpalljet e bëra në përputhje me këtë nen rishikohen çdo 6 vjet.

KREU IV KONTROLLI I NDOTJES

Seksioni 1 **Normat e ujit**

Neni 28

Normat e cilësisë së mjedisit për burimet ujore *(ndryshuar fjalë dhe pika 4 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)*

1. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit.

2. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen për të gjitha ujërat, përfshirë edhe ujërat nëntokësore.

3. Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat përcaktohen për të gjitha burimet ujore apo duke iu referuar:

- a) përdorimit aktual ose potencial, të cilit i nënshtrohet çdo trup ujqor i caktuar;
- b) aktiviteteve që kryhen apo janë duke u kryer në trupa të tillë ujqorë;
- c) atyre trupave ujqorë që, për të qenë në gjendje të mbështetin disa veprimtari të caktuara, kërkojnë mbrojtje.

4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore identifikon trupat ujqorë, referuar pikës 3, të këtij neni, sipas procedurës përkatëse dhe në afatet kohore të përcaktuara prej Këshillit Kombëtar të Ujit.

Neni 29

Normat teknike të shkarkimit të ujërave në mjedis *(ndryshuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)*

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton normat teknike të shkarkimit në mjedis për ujin, për substancat e rrezikshme, për substancat dhe parametrat e tjerë, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 30

Shkarkimet industriale dhe trajtimi i tyre *(ndryshuar fjalë në pikat 1 dhe 7 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)*

1. Zyrat e administrimit të baseneve ujore, në bashkëpunim me agjencitë rajonale të mjedisit, përgatisin programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta.

2. Shkarkimi në mjedis i ujërave të përdorura industriale duhet të realizohet në përputhje të plotë me kërkesat e përgjithshme e specifike për lloje të ndryshme të veprimtarive, si rezultat i të cilave kryhen shkarkime të lëngshme në mjedis, me qëllim mbrojtjen e ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore nga kontaminimi apo ndotja.

3. Menaxhimi i ujërave të përdorura industriale duhet të realizohet nga subjekte, të cilat i prodhojnë dhe i shkarkojnë ato në zbatim të parimit “Ndotësi paguan”.

4. Menaxhimi i ujërave të përdorura industriale përfshin trajtimin e pjesshëm apo të plotë të tyre, në afërsi të zonës ku vendoset subjekti, i cili i prodhon ato apo në një zonë të caktuar

industriale. Shkarkimet e lëngëta, pas trajtimit në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura, bëhen kundrejt një tarife dhe në përputhje me normat e cilësisë së këtyre ujërave.

5. Tarifat e shkarkimeve të lëngëta, të prodhuara nga trajtimi i ujërave të përdorura industriale, përcaktohen në bazë të sasisë së shkarkimit dhe përbërjes kimike të tyre.

6. Ujërat e ndotura, që nuk arrijnë karakteristikat e përcaktuara në akte nënligjore, ndalohen të shkarkohen direkt në tokë, në ujë dhe në sistemin publik të kanalizimeve.

7. Monitorimi i cilësisë, sasisë së prodhimit të ujërave të përdorura industriale dhe shkarkimeve në mjedisin ujor sipërfaqësor apo nëntokësor pas trajtimit duhet të kryhet nga organet e përcaktuara me ligje të veçanta, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së (si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore).

Neni 31

Cilësia e ujit të pijshëm

(ndryshuar pika 1 dhe 4 dhe shtuar pika 1/1 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, harton kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm.

1/1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë, miraton kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm.

2. Çdo person fizik a juridik, publik apo privat, që ofron ose shet në publik ujë të pijshëm, detyrohet të jetë i pajisur me leje apo autorizimin përkatës, si dhe të përmbushë kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm, sipas akteve ligjore në fuqi.

3. Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion tjetër, publik a privat, që kanë sistemin e tyre të furnizimit me ujë, detyrohen të marrin masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit të furnizuar.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, në bashkëpunim me institucionin qendror përgjegjës për furnizimin me ujë të popullsisë, nëpërmjet inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit, urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm në qoftë se ai nuk plotëson normat e cilësisë. Ky proces realizohet nën menaxhimin e përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, si pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

Seksioni 2

Kontrolli i ndotjes

Neni 32

Trajtimi i kombinuar

1. Kontrolli i ndotjes bazohet në parimin e trajtimit të kombinuar dhe synon parandalimin e përkeqësimit, shtimin dhe kthimin në gjendje të pranueshme të trupave me ujëra sipërfaqësore.

2. Kontrolli i ndotjes realizohet nëpërmjet zbatimit të vlerave përkatëse kufi të shkarkimeve, bazuar në teknikat më të mira të disponueshme apo dhe në praktikat më të mira mjedisore kur ndikimet janë të shpërndara.

3. Kontrollët më të plotë e më të hollësishme për shkarkimet kryhen, sipas rastit, kur një objektiv mjedisor ose normë mjedisore e cilësisë së ujit kërkon kushte më specifike sesa ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 33

Lejet e mjedisit

(ndryshuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Çdo person fizik ose juridik, që ushtron një aktivitet, prej të cilit shkarkohen ujëra të ndotura në trupat ujorë, duhet të ketë lejen përkatëse të mjedisit, në përputhje me kërkesat e ligjit për lejet e mjedisit.

Neni 34

Zonat e mbrojtura

(ndryshuar fjalë në pikën 2, 3 dhe 4 dhe shtuar pika 2.1 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Zonat e mbrojtura, në bazë të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, përcaktohen me qëllim mbrojtjen e ujërave dhe ekosistemeve ujore dhe përfshijnë masa të veçanta mbrojtëse.

2. Në zonat e mbrojtura përfshihen:

a) zonat higjieno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;

b) zonat e mbrojtura, të përcaktuara sipas ligjit për zonat e mbrojtura;

c) zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve, sipas legjislacionit për peshkimin;

ç) zonat për banjat termale, për trajtimin kurativ dhe rekreacion;

d) zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat në rrezik nga nitratat e nitritet;

dh) zonat e synuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve, ku ruajtja apo përmirësimi i statusit të ujit është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre.

2/1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore, identifikon zonat e mbrojtura, sipas pikës 2 të këtij neni.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore, shpall zonat e mbrojtura, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zyrat e administrimit të baseneve ujore hartojnë, menaxhojnë dhe përditësojnë inventarin e zonave të mbrojtura, si pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura.

5. Plan i menaxhimit të zonës së mbrojtur përfshihet në planin e menaxhimit të basenit ujqor përkatës.

Neni 35

Mbrojtja e zonave të prirura ndaj ndotjes

(shtuar fjalë në pikat 1 dhe 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Ministri përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si nitratat, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet dhe i paraqet për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit.

2. Ministri përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, ministrin përgjegjës për bujqësinë, ministrin përgjegjës për ekonominë dhe ministrin përgjegjës për shëndetësinë, nxjerr rregullore, ku përcaktohen programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, si ato të cituara në pikën 1 të këtij neni, ashtu edhe ato që shkarkohen apo rrjedhin nga veprimtari të tjera bujqësore.

3. Trajtimi i kombinuar, siç përcaktohet në nenin 32 të këtij ligji, zbatohet për shkarkimet nga pikat dhe burimet shpërndarëse në zonat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Seksioni 3

Masat për mbrojtjen e burimeve ujore

Neni 36

Karakteristikat e baseneve ujore

(ndryshuar dhe shtuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Zyra e Administrimit të Basenit Ujqor kryen për çdo basen ujqor përkatës vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, analizën

ekonomike të përdorimit të ujërave, si dhe analiza pas monitorimeve të kryera nga subjektet e kontraktuara nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, përcakton me akt nënligjor specifikimet teknike të nevojshme për kryerjen e analizave dhe rishikimeve, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni.

3. Analizat dhe vlerësimet e përcaktuara në këtë nen do të kryhen pas miratimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe do të përditësohen rregullisht.

Neni 37

Programet e masave për objektivat mjedisorë

(ndryshuar fjalë dhe pika 3 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyra e Administrimit të Basenit Ujor, me qëllim arritjen e objektivave mjedisorë të përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji, harton programin e masave për basenin ujor, duke marrë në konsideratë rezultatet e analizave, siç përcaktohet në nenin 36 të këtij ligji.

2. Programi i masave për basenin ujor rishikohet çdo 6 vjet dhe, në qoftë se është e nevojshme, përditësohet.

3. Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozimin e këshillit të basenit përkatës, miraton programin e masave të hartuara nga Zyra e Administrimit të Basenit Ujor.

KREU V

PËRDORIMI I BURIMEVE UJORE

Neni 38

Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore

Burimet ujore përdoren për:

- a) qëllimet shtëpiake, komunale, bujqësore, përfshirë ujitjen dhe ujin për blegtorinë;
- b) akuakulturë, transport ujor, industrial, prodhim hidroenergetik;
- c) tregti;
- ç) turizëm, argëtim, përfshirë lundrimin për argëtim;
- d) qëllime të tjera, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujërave.

Neni 39

Përdorimi i burimeve ujore

(ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore dhe inspektimit nga inspektorët që mbulojnë fushën e kontrollit të veprimtarisë në përdorimin e burimeve ujore, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së, si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

2. Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë.

3. Sasia e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup ujor natyror përcaktohet sipas planeve të menaxhimit të baseneve dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke u bazuar në karakteristikat specifike dhe vlerat natyrore e ekologjike që ka baseni ujor.

4. Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355).

Neni 40

Përdorimi i lirë i burimeve ujore

1. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht burimet ujore sipërfaqësore për të pirë dhe për nevoja të tjera shtëpiake e të blegtorisë, pa tejkaluar nevojat, sasitë e nevojshme për plotësimin e nevojave individuale dhe familjare të përdoruesit dhe në përputhje me ligjet dhe planet përkatëse të këshillave të baseneve.

2. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht ujërat e brigjeve për t'u larë dhe për sporte ujore.

3. Kushdo ka të drejtë të përdorë burimet ujore në rastet e rënies së zjarrit për shuarjen e tij.

4. Kushdo ka të drejtë të përdorë ujin e shiut që bie në tokë private, me kusht që ky ujë të mos jetë mbledhur në instalime artificiale.

5. Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore kanë të drejtë që gjatë periudhave të mungesës së ujit dhe thatësirave apo kur cilësia e ujit është cenuar, kur përhapen ose ka rrezik të përhapen sëmundje të shkaktuara nga uji, të kufizojnë përdorimin e lirë të ujit në të gjithë vendin ose në zona të veçanta.

Neni 41

Përdorimi me leje i ujit

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Veprimtaritë e mëposhtme, që mund të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, do të ushtrohen në bazë të lejes administrative të lëshuar nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore.

a) Përdorimi i ujit, kur ky realizohet me instalime të përhershme.

b) Ujitja.

c) Përdorime industriale të ujit sipërfaqësor.

ç) Ujë për pishina.

d) Ujë i ambalazhuar.

dh) Ujërat kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale.

e) Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime të ndryshme.

ë) Dhënia në përdorim e burimeve ujore për zhvillimin e akuakulturës.

2. Për përdorimet e mëposhtme kërkohet leja përkatëse e Këshillit Kombëtar të Ujit.

a) Lundrueshmëria.

b) Ndërtimi i strukturave ankoruese, portuale, i veprave mbrojtëse bregdetare dhe ishujve artificiale në det.

c) Përdorimi i ujërave detare për prodhim hidroenergjie.

3. Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujit dhe me propozimin e Kryeministrit, miraton formularin e kërkesës për leje për përdorim të burimeve ujore.

Neni 42

Përdorimi i ujit me autorizim

(ndryshuar pika 5 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Veprimtaritë e mëposhtme mund të kryhen vetëm pasi subjektet përkatëse të pajisen me autorizim nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore:

a) dhënia e ujit bagëtive, kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh;

b) shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime familjare;

c) përdorimi ose ripërdorimi i ujërave të përdorura, përfshirë aplikimin e tyre në tokë.

2. Përdorimi i burimeve ujore për qëllime dhe aktivitete peshkimi përcaktohet me akte ligjore e nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.

3. Të gjitha llojet e kërkimeve, studimeve dhe eksplorimeve në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, edhe kur nuk kanë për objekt ujë, kryhen me autorizim nga organet përkatëse të ujit, për një zonë dhe për një afat të caktuar.

4. Përjashtohen nga kjo kërkesë institucionet monitoruese të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe institucionet shkencore, veprimtaritë e të cilave nuk ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësorë të ujërave.

5. Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujit dhe me propozimin e Kryeministrit, miraton formularin e kërkesës për autorizim për përdorim të burimeve ujore.

Neni 43

Dhënia e koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore

(ndryshuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Dhënia e koncesioneve për përdorimin e burimeve ujore bëhet në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat dhe aktet nënligjore që përcaktojnë kërkesa dhe procedura për dhënien e koncesioneve.

2. Organi kontraktues i menaxhimit të burimeve ujore kombëtare mban regjistrin e koncesionit. Ky regjistër administrohet dhe ruhet nga organi përkatës kontraktues, sipas kërkesave të ligjit për arkivat.

Neni 44

Shfrytëzimi i materialeve inerte

(ndryshuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje administrative për shfrytëzimin e materialeve inerte, si rrëzë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrrenjve, liqeneve me ose pa ujë, vetëm në qoftë se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore, të përcaktuara me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit.

2. Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujit dhe me propozimin e Kryeministrit, miraton formularin e kërkesës për leje dhe rinovim për shfrytëzim materiale inerte nga shtretërit e lumenjve.

Neni 45

Detyrat e përdoruesve të ujit

Përdoruesit e ujit duhet:

- a) të përdorin ujë në mënyrë racionale dhe ekonomike;
- b) të respektojnë kushtet dhe detyrimet e vëna mbi të drejtën e përdorimit të ujit;
- c) të respektojnë kushtet dhe detyrimet e përcaktuara mbi të drejtën e pronësisë;
- ç) të sigurojnë mbrojtjen e ujit nga ndotja, të mbajnë nën kontroll cilësinë e ujit dhe të mbrojnë mjedisin nga ndotësit e ndryshëm;
- d) të respektojnë të drejtat e përdoruesve të tjerë të ligjshëm të ujërave dhe të palëve të treta.

Neni 46

Thatësira dhe mungesa e ujit

(hequr fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Këshilli Kombëtar i Ujit, në kushtet e thatësirës apo të mungesës së ujit, nxjerr vendim për marrjen e masave të nevojshme për thatësirën, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare. Në këtë vendim përcaktohen:

- a) kufizime në disa ose në të gjitha veprimtaritë që përfshijnë përdorimin e burimeve ujore;
- b) kufizimi i përdorimit të ujit, në përputhje me licencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet për përdorimin e ujit.

Neni 47

Trupat ujorë që përdoren si ujë i destinuar për pirje

(ndryshuar emërtimi në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor për basenin ujor përkatës duhet të identifikojë në mënyrë të veçantë:
 - a) të gjitha trupat ujorë të destinuar për konsum njerëzor, që japin mesatarisht mbi 10 m³ në ditë ose që furnizojnë më shumë se 50 njerëz;
 - b) të gjithë trupat ujorë të destinuar për përdorime të tilla në të ardhmen.
2. Këshilli i basenit ujor dhe organet përkatëse të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore duhet të sigurojnë mbrojtjen e burimeve ujore të referuara në këtë nen, me qëllim që të shmangin përkeqësimin e cilësisë së tyre dhe të kryejnë pastrimin e nevojshëm në atë nivel, me qëllim përfundimin e ujit të pijshëm.
3. Shfuqizuar.

KREU VI

BURIMET E UJËRAVE KURATIVE, MINERALE, TERMOMINERALE DHE GJEOTERMALE

Neni 48

Menaxhimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale

(ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Menaxhimi i integruar mbi burimet natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale ka të bëjë me krijimin e një kuadri për mbrojtjen e këtyre burimeve me qëllim:
 - a) monitorimin e cilësisë së ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale nga ministria, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministria përgjegjëse për ekonominë;
 - b) promovimin e përdorimit racional e të qëndrueshëm të këtyre ujërave, i cili kryhet duke u bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve natyrore, të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale;
 - c) reduktimin progresiv të ndotjes së burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, me qëllim parandalimin e ndotjes së mëtejshme të tyre;
 - ç) ndalimin e ndërtimeve rreth zonave të burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale pa lejen e organeve të menaxhimit të burimeve ujore;
 - d) parandalimin e shkarkimeve të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale të përdorura dhe të patrajuara në tokë, në ujë dhe në sistemin publik të kanalizimeve;
 - dh) vlerësimin e shkaqeve të ndotjes së ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale;
 - e) hartimin e planit të menaxhimit të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
 - ë) kontrollin rreth zonave të burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, i cili kryhet nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
 - f) ndalimin e ndryshimit të destinacionit të përdorimit të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale;
 - g) ndalimin e shpimeve dhe ndërhyrjeve në zonën e burimeve natyrore të ujërave kurative, termale, termominerale dhe gjeotermale;

gj) ndalimin e thithjes me pompa të ujit kurativ, termal, termomineral dhe gjeotermal direkt nga gryka e burimit.

2. Çdo person fizik ose juridik, që shfrytëzon burimet natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale, duhet të pajiset me leje pranë organeve të menaxhimit të burimeve ujore, e cila jepet në përputhje me planin e menaxhimit të këtyre ujërave.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton tarifat e përdorimit të ujërave kurative, termominerale dhe gjeotermale.

Neni 49

Pezullimi dhe ndryshimi i përkohshëm i kushteve të lejes për burimet natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale

1. Leja mund të ndryshohet, të pezullohet ose të shfuqizohet kur titullari përkatës i saj nuk përmbush kriteret e dhënies së këtij titulli ose ka shkelur detyrimet e përcaktuara në të.

2. Ndryshimi i kushteve, pezullimi dhe shfuqizimi i lejes kryhen, sipas rastit, nga organi që e ka lëshuar ose organi më i lartë epror:

- a) kur kanë ndodhur ndryshime për shkak të forcave madhore;
- b) me kërkesë të mbajtësit të lejes;
- c) në rast të mosrespektimit nga titullari i kushteve të lejes;
- ç) kur ujërat kurative, minerale dhe termale, me të cilat lidhet leja, nuk janë përdorur sipas afatit të përcaktuar në lejen përkatëse;
- d) me vdekjen e personit fizik apo me mbarimin e personit juridik.

KREU VII

AUTORIZIMET, LEJET DHE KONCESIONET PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE

Neni 50

Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore që lëshojnë autorizime, leje dhe japin koncesione

(ndryshuar fjalë në pikat 4 dhe 6 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore japin autorizime, leje dhe lidhin kontrata koncesioni për përdorimin e ujërave, duke u bazuar në parimet e proporcionalitetit, efikasitetit dhe deburokratizimit, në zvogëlimin e barrierave administrative, si dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj të veçantë ose me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij kreu.

2. Këshilli i basenit ujqor lëshon autorizimet dhe lejet në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe brenda kufijve të një baseni të vetëm.

3. Këshilli Kombëtar i Ujit lëshon leje dhe autorizime në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por në një zonë që i kalon kufijtë e një baseni.

4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore identifikon projektin koncesionar në bazë të klasifikimit të burimeve ujore, planit të menaxhimit të basenit ujqor dhe sipas procedurave, kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me akte ligjore e nënligjore.

5. Autorizimet, lejet dhe koncesionet për përdorimin e ujërave:

- a) janë personale dhe i takojnë titullarit të licencës, autorizimit, lejes, koncesionit përkatës;
- b) nuk mund të transferohen pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
- c) janë të vlefshme për një afat të caktuar dhe rinovohen sipas një procedure të përcaktuar;
- ç) mund të ndryshohen, të refuzohen, të pezullohen ose të shfuqizohen në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

- d) lëshohen pas pagimit të një tarife për shpenzimet administrative;
 - dh) regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve, sipas parashikimeve ligjore e nënligjore përkatëse;
 - e) nuk mund të refuzohen pa një vendim të arsyetuar të organit administrativ që shqyrton kërkesën për autorizim ose leje.
6. Këshilli i Ministrave, në zbatim të ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet, përcakton:
- a) kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit dhe dokumentet shoqëruese, të nevojshme, që paraqiten për këtë qëllim;
 - b) afatin e vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes;
 - c) procedurat dhe afatet e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes administrative;
 - ç) procedurat e revokimit nga organet administrative.

Neni 51

Parimet e përgjithshme për dhënien e autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve

Autorizimi, leja ose koncesioni lëshohet vetëm në qoftë se:

- a) aktiviteti i personit fizik apo juridik, që është titullar i autorizimit, lejes apo koncesionit, nuk ndikon negativisht në përdorimin e ujërave;
- b) është në përputhje me planin e menaxhimit të basenit ujor përkatës;
- c) nuk çon në shkeljen e normave të cilësisë së ujit, të përcaktuara në këtë ligj;
- ç) nuk çon në cenimin e objektivave mjedisore përkatës, të përcaktuar në këtë ligj;
- d) nuk bie ndesh me programin e masave, të parashikuar në bazë të këtij ligji.

Neni 52

Përparësitë në dhënien e lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve

Për dhënien e një lejeje, autorizimi, koncesioni, organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore përkatëse të ujit mbështeten në përparësitë e mëposhtme:

- a) furnizimin me ujë të popullsisë, përfshirë edhe kërkesat e industrive që ndodhen brenda vijës kufizuese të qendrave të banuara dhe që kanë një nivel të ulët konsumi;
- b) përdorimet për ujitje, bujqësi e akuakulturë;
- c) përdorime për prodhim energjie elektrike nëpërmjet burimeve hidrike;
- ç) përdorime të tjera industriale, që nuk përfshihen në kategorinë e mësipërme, përfshirë edhe përdorime në miniera;
- d) peshkim;
- dh) transport ujor;
- e) argëtim e turizëm, përfshirë lundrimin për zbavitje;
- ë) përdorime të tjera.

Neni 53

Kushtet e përgjithshme të autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e ujërave

(ndryshuar pika 5 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Autorizimi, leja apo kontrata koncesionare për përdorimin e ujërave përmban këto të dhëna të përgjithshme:

- a) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;
- b) të dhënat për identifikimin e titullarit;
- c) llojin e veprimtarisë që lejohet dhe qëllimin, për të cilin do të përdoret uji;
- ç) sasinë e ujit që mund të përdoret, duke iu referuar ose një vëllimi fiks, ose një pjese të rrjedhës;

d) vëllimin e rrjedhës së kthyer, në qoftë se ka, dhe vendin ku rrjedha e kthyer do të shkarkohet;

dh) sipërfaqen e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit, në rastet kur uji do të përdoret për ujtime;

e) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira publike;

ë) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimit apo në përdorimin e së mirës publike;

f) periudhën e vlefshmërisë së licencës, autorizimit, lejes apo koncesionit.

2. Licenca, autorizimi, leja apo kontrata koncesionare përmban detyrime kushtet e përgjithshme të mëposhtme, në bazë të të cilave operatori detyrohet:

a) të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;

b) të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë licenca, autorizimi, leja apo kontrata koncesionare;

c) të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;

ç) të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen, autorizimin apo koncesionin;

d) të regjistrojë vëllimin e ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer;

dh) të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore.

3. Kushtet e posaçme, dokumentet shoqëruese, afati i vlefshmërisë, procedurat e shqyrtimit dhe vendimmarrja përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Licenca dhe leja e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në Regjistrin e Licencave dhe Lejeve, përveç rastit kur hyrja në fuqi e aktit që e miraton atë lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

5. Lejet e përdorimit të ujit përfshihen në kategorinë përkatëse të ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet.

Neni 54

Pezullimi dhe ndryshimi i përkohshëm i kushteve të autorizimeve, lejeve apo koncesioneve

1. Autorizimi, leja dhe koncesioni mund të pezullohen ose të ndryshohen kur titullari përkatës nuk përmbush kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

2. Pezullimi dhe ndryshimi i kushteve që përmbahen në licencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet kryhen nga organi lëshues:

a) si pasojë e një urdhri për thatësirën, të lëshuar në bazë të këtij ligji;

b) kur kanë ndodhur ndryshime për shkak të forcave madhore;

c) me kërkesë të mbajtësit të titullit;

ç) në rast të mosrespektimit nga titullari të kushteve të autorizimit, lejes ose koncesionit.

Neni 55

Anulimi e shfuqizimi i autorizimeve dhe lejeve dhe zgjidhja e kontratës koncesionare

(ndryshuar fjalë në titull dhe në pikën 1, pika 2, dhe shfuqizuar pika 3, me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Zgjidhja e kontratës koncesionare dhe shfuqizimi ose anulimi i autorizimeve dhe lejeve mund të bëhen në rastet kur:

a) bazuar në interesin publik dhe në përputhje me planin e menaxhimit të baseneve ujore, është i domosdoshëm përdorimi i ujërave për një qëllim tjetër parësor, në përputhje me kategorizimet, sipas përparësive të përcaktuara në nenin 52 të këtij ligji;

b) titullari i autorizimit, lejes, koncesionit nuk respekton kushtet përkatëse edhe pas pezullimit të lejes, autorizimit për një afat të caktuar;

c) me kërkesën e titullarit të autorizimit, lejes, koncesionit;

ç) ujërat, me të cilat lidhet leja, autorizimi ose koncesioni, nuk janë përdorur për një periudhë prej tre vjetësh;

d) me vdekjen e titullarit apo me mbarimin e personit juridik.

e) është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

2. Kundër vendimeve të organeve të menaxhimit të burimeve ujore për shfuqizimin ose anulimin e autorizimit/lejes bëhet ankim në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Shfuqizuar.

4. Për ankimet ndaj procedurave të dhënies së koncesionit dhe zgjidhjes së kontratës së koncesionit do të zbatohet legjislacioni në fuqi për koncesionet.

Neni 56

Shpuesit profesionistë

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Shpuesi profesionist për ujë, që e ushtron veprimtarinë mbi bazë tregtare, duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse, sipas parashikimeve të ligjit për licencat, autorizimet dhe lejet.

2. Organet e menaxhimit të burimeve ujore japin leje për kryerjen e shpimit pasi shpuesi profesionist paraqet projektin teknik dhe hidrogeologjik për shpimin, të hartuar nga subjekte juridike të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Shpuesi profesionist, jo më vonë se një muaj pas përfundimit të shpimit, u paraqet organeve të administrimit të burimeve ujore, në dy kopje, një raport të hollësishëm hidrogeologjik në lidhje me shpimin, me mostrat e shtresave të shpuara, si dhe gjithë dokumentacionin përkatës, projektin fillestar të shpimit dhe relacionin pas shpimit. Organet e administrimit të burimeve ujore i dërgojnë një kopje Arkivit Qendror Gjeologjik.

4. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar duhet t'u japë informacionin përkatës organeve të menaxhimit të burimeve ujore për projektet hidrogeologjike dhe relacionet e shpimit, të dorëzuara nga subjektet pranë këtij institucioni.

5. Leja e shfrytëzimit për nxjerrje uji lëshohet nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, pasi shpuesi profesionist paraqet relacionin teknik dhe hidrogeologjik për përdorimin potencial të pusit, të hartuar nga subjekte juridike të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së shpimit për nxjerrje uji nga ana e subjekteve fizike, juridike apo personave të palicencuar, pa leje përkatëse të shpimit nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.

KREU VIII

ZONAT DHE SIPËRFAQET E MBROJTURA

Neni 57

Zonat e mbrojtjes higjiëno-sanitare

(shtuar pika 1/1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Zonat e mbrojtjes higjiëno-sanitare përcaktohen rrotull burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore të ujit, që furnizojnë popullsinë urbane e rurale me ujë, me qëllim që të ruhet cilësia e ujit pranë burimit.

1/1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, përcakton kufijtë e zonave të mbrojtjes higjiëno-sanitare.

2. Kufijtë e këtyre zonave miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin, ministrit përgjegjës për ekonominë, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve.

3. Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare përbëhen nga:

a) zona e parë e mbrojtjes rrotull burimit, që kontrollohet nga operatori që nxjerr, prodhon dhe shpërndan ujë të pijshëm. Kjo zonë rrethohet;

b) zona e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës ndalohen ndërtimet, zhvillimi i industrisë, kryerja e veprimtarive bujqësore e blegtorale, hapja e puseve, hapja e kanaleve, depozitimi apo shkarkimi i ndotjeve, i ujërave të ndotura, i substancave kimike e toksike, përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, përdorimi si varrezë apo groposja e kafshëve të ngordhura;

c) zona e mbrojtjes së largët, brenda së cilës veprimtaritë e parashikuara në shkronjën “b” të kësaj pike do të jenë objekt i autorizimeve të posaçme administrative.

4. Personat fizikë dhe juridikë, interesat e të cilëve dëmtohen nga përcaktimi i zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare, kompensohen sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 58

Mbrojtja e zonave të prirura ndaj ndotjes

(ndryshuar dhe shtuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementeve apo substancave të dëmshme, si kimikatat e ndryshme, biocidet, për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, agrikulturës, mjedisit, të cilat i paraqet për miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit.

2. Ministri përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe ministrin përgjegjës për ekonominë, nxjerr rregullore që përcakton programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse, me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme, si ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ashtu edhe ato që shkaktohen apo rrjedhin nga veprimtari të tjera bujqësore, industriale dhe veprimtaria njerëzore.

Neni 59

Zonat e mbrojtjes emergjente

1. Organet e burimeve ujore mund të përcaktojnë dhe të shpallin zona ose sipërfaqe të mbrojtura sa herë që burimet sipërfaqësore ose nëntokësore rrezikohen seriozisht në sasi e cilësi, si dhe kur ekziston rreziku i përhapjes së sëmundjeve infektive, sipas evidencave nga organet kompetente.

2. Regjimi i këtyre zonave ose sipërfaqeve, si dhe kufizimet e tyre vendosen dhe ndryshojnë sipas rrethanave specifike, të cilat përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 60

Zona të veçanta ruajtjeje

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore, identifikon si “zona të veçanta ruajtjeje”: basene, pjesë basenesh, rrjedha ujore, lumenj.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore, miraton zonat e veçanta të ruajtjes, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 61

Bashkërendimi i planeve të rregullimit të territorit me ato të burimeve ujore

(bequr fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Autoritetet, që hartojnë planet dhe studimet e rregullimit të territorit, marrin në konsideratë planet e menaxhimit të burimeve ujore.

Neni 62

Tokat e mbuluara me ujë

1. Kënetat ose sipërfaqet e mbuluara me ujë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, përfshirë edhe ato që janë krijuar artificialisht, quhen toka të mbuluara me ujë. Këshilli Kombëtar i Ujit përcakton kufijtë e tyre.

2. Të gjitha veprimtaritë, që kryhen ose ndikojnë mbi to, janë objekt i autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve.

Neni 63

Zonat e rrezikshme për shëndetin

Këshilli Kombëtar i Ujit, në bashkëpunim me organet përkatëse shëndetësore dhe ato të mbrojtjes së mjedisit, përcakton zonat e rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve, që janë shpallur si të dëmshme për interesat publike dhe vendos tharjen e tokave që janë nën ujë.

KREU IX

MBROJTJA E BRIGJEVE

Neni 64

Mbrojtja e brigjeve

Mbrojtja e brigjeve është detyrë publike, që realizohet me anë të ndërtimeve, rindërtimeve dhe mirëmbajtjes së pritave, veprave veshëse dhe veprave e masave të tjera teknike, ku përfshihen edhe ato biologjike.

Neni 65

Mbrojtja e përkohshme

Personat fizikë a juridikë, vendas dhe të huaj, pas marrjes së miratimit nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, mund të kryejnë veprimtari mbrojtëse të përkohshme në raste emergjence.

Neni 66

Veprimtaritë ndërtimore në brigje

(shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Organet përgjegjëse të planifikimit të territorit në njësitë e qeverisjes vendore lëshojnë leje për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen e objekteve mbrojtëse të brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, vetëm pasi pajisen me autorizim të posaçëm nga organet e administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore.

Organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë autorizim të posaçëm për ushtrimin e veprimtarive ndërtimore në brigje, vetëm për qëllime publike. Veprimtaritë për qëllime publike përcaktohen rast pas rasti nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.

Veprimtari të ndaluara në brigje dhe plazhe

1. Në brigje, plazhe dhe në zonat e vërshimit ndalohen:
 - a) ndryshimi ose zhvendosja e mbulesës bimore natyrore apo artificiale;
 - b) marrja e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa;
 - c) ndërtimi i vendeve të parkimit për mjete ujore dhe automjete tokësore;
 - ç) krijimi i vendeve të thata për rrjetat;
 - d) gjermimi, shpimi ose shpëlarjet;
 - dh) hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gjermimeve të ndryshme, si dhe veprimtarive të tjera që gjenerojnë mbetje;
 - e) shkarkimi i ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara.
2. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me organet përgjegjëse të rregullimit e planifikimit të territorit, me qëllim sigurimin dhe mirëmbajtjen e bregut, kanë të drejtë të kufizojnë ose të ndalojnë shfrytëzimin e plazhit, të fundit të detit, të dunave, të brigjeve të pjerrëta dhe të çdo sipërfaqeje tjetër që është përcaktuar për mbrojtjen e bregut dhe mirëmbajtjen e tij.

KREU X

EFEKTET E DËMSHME TË UJIT

Përmbytjet

1. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, për të garantuar sigurinë e njerëzve, gjësë së gjallë dhe të pronave, marrin masat e nevojshme brenda sipërfaqeve që preken nga përmbytjet. Në rast përmbytjesh të mëdha, ato, në bashkëpunim me strukturat dhe organet përgjegjëse për emergjencat civile, urdhërojnë ekzekutimin e punimeve të emergjencës, duke kërkuar nga përdoruesit e ujit të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për këtë qëllim.
2. Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me strukturat dhe organet e qeverisjes vendore, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar.
3. Çdo person fizik apo juridik, subjekt i lejes, autorizimit, koncesionit detyrohet të bashkëpunojë me dhënien e çfarëdolloj ndihme dhe informacioni me autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në këtë nen për eliminimin e pasojave të përmbytjeve dhe efekteve të tjera të dëmshme të ujit.
4. Shkarkimet maksimale nga përdoruesit e ujit bëhen në përputhje me kushtet dhe kriteret përcaktuara në planet e menaxhimit të baseneve, si dhe akte të tjera nënligjore.
5. Për pikën 4 të këtij neni përjashtim bëjnë rastet kur shkarkimet bëhen të detyruara nga ardhja e plotave maksimale.
6. Kushtet dhe kriteret për shkarkimet maksimale miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Tokat e përmbytura

1. Tokat, që mund të përmbysten gjatë daljes nga shtrati i zakonshëm i liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lumenjve, përrrenjve e rrjedhave të tjera, ruajnë statusin e tyre të mëparshëm ligjor.
2. Këshilli Kombëtar i Ujit, pas marrjes së mendimit nga strukturat drejtuese vendore, si dhe nga strukturat dhe organet përgjegjëse për emergjencat civile, në raste të veçanta vendos kufizime për përdorimin e zonave të përmbytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit, kur këto rrezikojnë jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë apo pronën publike e private.

3. Magazinimi i materialeve dhe lëndëve që mund të shpëlahen në ujë dhe ndërtimi i objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet janë të ndaluar.

Neni 70

Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet

(ndryshuar fjalë në pikat 1 dhe 2 dhe shtuar pika 5 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për emergjencat civile, harton akte nënligjore për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për emergjencat civile dhe me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me zyrat e administrimit të baseneve ujore harton për rrethet e basenit ujor të tij planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, i cili fokusohet në parandalimin, mbrojtjen, gatishmërinë, përfshirë parashikimin e përmbytjeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm, të cilin e paraqet për bashkërendim në strukturat përgjegjëse për emergjencat civile.

3. Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet hartohet duke marrë në konsideratë karakteristikat përkatëse të baseneve ujore. Planet e menaxhimit të përmbytjeve përfshijnë edhe promovimin e praktikave të përdorimit të qëndrueshëm të tokës, përmirësimin e aftësisë mbajtëse të ujit, kontrollin nga përmbytjet të zonave të caktuara, në rast përmbytjeje.

4. Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet është pjesë përbërëse e planit të menaxhimit të basenit ujor.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për emergjencat civile, pas miratimit paraprak nga Këshilli Kombëtar i Ujit, miraton aktin nënligjor për planet dhe rregullat për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, të hartuara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

KREU XI

VEPRAT DHE OBJEKTET UJORE

Neni 71

Ndërtimi

1. Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e burimeve ujore dhe parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit, që bëhen për shërbime publike, është objekt i autorizimeve, lejeve ose koncesioneve, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Personi juridik, përgjegjës për ndërtimin, brenda 30 ditëve nga përfundimi i veprës a objektit, duhet të njoftojë organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore, që kanë lejuar kryerjen e veprimtarisë, që të kryejnë inspektimin përfundimtar në këtë vepër a objekt ujor.

Neni 72

Kompetencat e organeve të menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore

1. Organet e administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit dhe organet e qeverisjes vendore, kanë të drejtë të mbikëqyrin e të detyrojnë subjektet, persona fizikë apo juridikë, për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private, si dhe të servituteve që nevojiten për hyrjen në instalime të tilla, për punën përgatitore dhe për ndërtimin.

2. Organet e administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit, kanë të drejtë të kontrollojnë vënien në punë në afatet e përcaktuara në leje dhe

mirëmbajtjen e objekteve ujore, si dhe të vendosin sanksione e të detyrojnë vendosjen e tubacioneve të transportit të ujit të pijshëm ose atij të kanalizimeve.

3. Organet e menaxhimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit, kryejnë kontrole periodike të punimeve dhe objekteve ujore. Për këtë qëllim, personat e autorizuar prej tyre kanë të drejtë të inspektojnë veprat, objektet dhe të kërkojnë të dhëna e dokumentacionin lidhur me to.

KREU XII SHKARKIMET DHE KANALIZIMET

Neni 73

Shkarkimet e lëngshme

(shtuar pika 1/1 dhe shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë bëhen me leje ose autorizim, të lëshuar nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1/1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për ujësjellës-kanalizimet, harton normat e shkarkimeve të lëngshme dhe kërkesat e përgjithshme e specifike për lloje të ndryshme të veprimtarive, si rezultat i të cilave kryhen shkarkime të lëngshme në mjedis.

2. Këshilli Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për ujësjellës-kanalizimet, miraton normat e shkarkimeve të lëngshme dhe kërkesat e përgjithshme e specifike për lloje të ndryshme të veprimtarive, si rezultat i të cilave kryhen shkarkime të lëngshme në mjedis.

Neni 74

Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura

(shtuar pika 1/1 dhe ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Për të gjitha veprimtaritë që gjenerojnë ujëra të ndotura është e detyrueshme të lidhen dhe të përdoren kanalizimet e ujërave të ndotura, në përputhje me legjislacionin që rregullon shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe me aktet nënligjore që zbatohen në këtë fushë.

1/1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për ujësjellës-kanalizimet, harton kriteret mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të kanalizimeve.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për ujësjellës-kanalizimet, miraton kriteret mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të kanalizimeve.

3. Sistemi i ujërave të ndotura planifikohet i tillë që të largojë me shpejtësi e të derdhë në vende të caktuara, larg vendbanimeve njerëzore, ujërat e kanalizimeve që vijnë nga godinat publike ose private.

4. Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve duhet jetë i tillë që të shmangë derdhjet, të cilat, në destinacionin e tyre përfundimtar, ndotin ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, si dhe ujërat bregdetare.

5. Subjekte të caktuara mund të marrin përgjegjësinë e grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe derdhjes në vendet e caktuara të ujërave të kanalizimeve.

Neni 75

Sistemi individual dhe kolektiv i kanalizimeve

1. Kur disa persona përdorin një sistem të përbashkët për kanalizimet, përgjegjës para organeve të administrimit të burimeve ujore është enti që i shërben sistemit kolektiv të kanalizimeve.

2. Në rastin e një sistemi individual kanalizimesh, shkarkuesi është përgjegjës para organeve të administrimit të burimeve ujore, qoftë ky familjar ose jofamiljar.

Neni 76

Implantet e trajtimit të ujërave të ndotura

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për ujësjellës-kanalizimet, miraton rregullore dhe akte normative për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

KREU XIII

LEJET DHE AUTORIZIMET PËR SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

Neni 77

Dispozita të përbashkëta për leje dhe autorizime

1. Kërkesa për leje dhe autorizim për shkarkimet duhet të përmbajë në hollësi kriteret që duhet të plotësohen nga shkarkuesi, siç parashikohet në aktet nënligjore në fuqi. Në to përfshihen një përshkrim i implantit të trajtimit, i pajisjeve dhe i procedurave monitoruese për të siguruar funksionimin e tij korrekt, si dhe çdo përkufizim i vendosur për përmbajtjen kimike dhe bakterologjike të shkarkimit.

2. Karakteristikat e lejeve dhe autorizimeve të shkarkimit janë të njëjta me ato të përdorimit të ujit. Në çdo rast, ato përmbajnë kushtet lidhur me implantet e trajtimit e të monitorimit, si dhe në bazë të tyre do të vendoset për standardet e ujërave të trajtuara.

3. Lejet dhe autorizimet për veprimtaritë e shkarkimit të lëngjeve që mund të shkaktojnë infiltrimin ose akumulimin me kohë në ujërat sipërfaqësore, shtretërit natyrorë ose artificialë, shtresat ujëmbajtëse ose ujërat nëntokësore do të jepen vetëm pas një studimi kompleks të bërë brenda një viti nga data e kërkesës për leje shkarkimi. Studimi do të kryhet nga institucione të licencuara ose të akredituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Ripërdorimi i ujërave të ndotura është objekt i lejeve administrative. Në rast se ripërdorimi i ujërave do të bëhet nga një subjekt i ndryshëm nga subjekti i parë, atëherë të dyja subjektet duhet të pajisen me leje të veçanta. Këshilli Kombëtar i Ujit përcakton rregullat për ripërdorimin e drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura, duke u bazuar në proceset e trajtimit, cilësisë dhe qëllimin e përdorimit të këtyre ujërave pas trajtimit.

Neni 78

Lejet administrative

(ndryshuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Leja, autorizimi për shkarkimin nga shoqëritë ose industrinë, që bëjnë ose mund të bëjnë shkarkime ujërash të ndotura, jepen në bazë të akteve nënligjore dhe vetëm me kushtin që të jetë marrë më parë leja, autorizimi për përdorimin e burimit ujor.

Neni 79

Refuzimi i lejeve dhe autorizimeve

Organet e administrimit të ujit kanë të drejtë të refuzojnë lejet dhe autorizimet për veprimtari ose procese industriale, derdhjet e të cilave, pavarësisht nga trajtimi, paraqesin një rrezik serioz për ndotjen e burimeve ujore, sistemin ekologjik dhe mjedisin.

Neni 80

Ndryshimi i lejeve

(ndryshuar emërtimi me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli i basenit ujqor ka të drejtë të vendosë në lidhje me pezullimin e përkohshëm, të përhershëm ose ndryshimin e lejes dhe autorizimit, kur është në kompetencën e këtij organi, nëse rrethanat, në të cilat është bazuar dhënia e tyre, kanë ndryshuar ose kur krijohen rrethana të reja, të cilat, nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies, do të kishin çuar në refuzim të lejes ose lëshimin e lejes me kushte dhe afate të tjera.

2. Këshilli i basenit ujqor, për rastet kur kompetencën për pezullimin e përkohshëm, të përhershëm ose ndryshimin e lejes dhe autorizimit e ka Këshilli Kombëtar i Ujit, bën propozimet përkatëse me vendim formal, i cili i dërgohet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore për t'u shqyrtuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

Neni 81

Ndërprerja e veprimtarive të shkarkimit të ujërave të ndotura

Organet e administrimit të ujit kanë të drejtë të urdhërojnë ndërprerjen e menjëhershme të të gjitha veprimtarive apo të pjesëve të veçanta të tyre, lidhur me shkarkimet e ujërave të ndotura, nga të cilat rezultojnë shkarkime të paautorizuara që dëmtojnë interesin publik.

Neni 82

Pagesat për shpenzimet administrative

Aktivitetet e autorizuara të shkarkimit u nënshtrohen pagesave administrative, sipas kriterëve dhe tarifave të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

KREU XIV SERVITUTET

Neni 83

Servitutet

Pronarët e tokave, për çështjet e servituteve që lidhen me rrjedhjen dhe marrjen e ujërave, u referohen përcaktimeve të bëra në dispozitat e Kodit Civil.

Neni 84

Veprimtaritë përbri brigjeve

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Veprimtaritë përbri brigjeve përcaktohen në planet dhe studimet e planifikimit dhe rregullimit të territorit. Këto dokumente miratohen paraprakisht në Këshillin Kombëtar të Ujit.

KREU XV MONITORIMI

Neni 85

Monitorimi i statusit të ujërave të brendshme detare, sipërfaqësore, nëntokësore dhe zonave të mbrojtura

(shfuqizuar pika 3, shtuar pika 6/1 dhe fjalë në pikën 7 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli i basenit ujor zbaton programin e monitorimit të statusit të ujërave, në mënyrë që të përcaktohet një rishikim koherent dhe i kuptueshëm i statusit të ujit, brenda secilit basen.
2. Për ujërat sipërfaqësore, programe të tilla mbulojnë:
 - a) statusin ekologjik, kimik e mikrobiologjik, potencialin ekologjik, si dhe biodiversitetin;
 - b) vëllimin dhe nivelin ose shkallën e rrjedhjes që kërkohet për të arritur statusin përkatës ekologjik dhe kimik, potencialin ekologjik.
3. Shfuqizuar.
4. Sipas rastit, programet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni plotësohen duke iu referuar edhe specifikimeve të dhëna në legjislacionin për zonat e mbrojtura.
5. Programi për ujërat nëntokësore mbulon dhe trajton monitorimin e statusit kimik dhe sasior.
6. Këto programe do të vihen në zbatim jo më vonë se 6 vjet pas miratimit të këtij ligji
- 6/1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, harton kërkesat për programet e monitorimit.
7. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton kërkesat për programet e monitorimit, sipas këtij neni.

Neni 86

Monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave

(shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton rregulloren për hartimin e programit të monitorimit sistematik të kushteve të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe të zonave të mbrojtura.
2. Rregullorja përcakton parametrat që do të monitorohen, procedurat dhe masat teknike të nevojshme, përfshirë, por pa u kufizuar në kërkesat për marrjen e mostrave dhe analizave për secilin parametër, kontrollin e cilësisë, praktikat laboratorike, regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave.
3. Rregullorja përcakton kriteret për botimin e buletineve periodike vjetore dhe shumëvjeçare, me akses publik, të monitorimit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe të zonave të mbrojtura.

Neni 87

Monitorimi i trupave ujorë të përcaktuar për prodhimin e ujit të pijshëm

(ndryshuar emërtimi me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor është institucioni përgjegjës për monitorimin e trupave ujorë sipërfaqësore dhe nëntokësore, të përcaktuar për prodhimin e ujit të pijshëm.

KREU XVI
KADASTRA KOMBËTARE E BURIMEVE UJORE DHE REGJISTRI KOMBËTAR
I AUTORIZIMEVE, LEJEVE E KONCESIONEVE PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE
UJORE

Neni 88

Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore
(ndryshuar emërtimi me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është organi që krijon, menaxhon dhe përditëson Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.
2. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore përmban të dhëna për:
 - a) ujërat sipërfaqësore që klasifikohen sipas statusit të tyre kimik dhe ekologjik;
 - b) zonat e mbrojtura;
 - c) trupat ujorë tepër të modifikuar;
 - ç) lejet e mjedisit për të ushtruar veprimtari, si rezultat i të cilave shkarkohen ujëra të përdorura në trupat ujorë;
 - d) zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat ndaj nitrates;
 - dh) zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare;
 - e) zonat e mbrojtjes emergjente;
 - ë) zona të veçanta ruajtjeje;
 - f) zonat e rrezikshme për shëndetin;
 - g) trupat ujorë të përcaktuar për prodhimin e ujit të pijshëm.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton kërkesat, kushtet, procedurat, fondet e nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.
4. Të gjitha institucionet, entet dhe subjektet e tjera, publike ose jopublike, që merren me menaxhimin e burimeve ujore, detyrohen të caktojnë një përfaqësues që mban marrëdhënie me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe dërgon të dhënat në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore, në bazë të formave dhe procedurave përkatëse të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore dhe të dhënat e saj mbahen, menaxhohen dhe përditësohen nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik.

Neni 89

Funksionet e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore
(ndryshuar emërtimi me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Informacioni në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore organizohet sipas të dhënave elektronike të integruara për burimet ujore, në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me njëra-tjetrën. Organet përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore krijojnë, mbajnë dhe menaxhojnë përkatësisht bazën e të dhënave.
2. Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore dhe të dhënat e tij publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.
3. Të dhënat e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore përdoren nga autoritetet dhe institucionet e tjera publike, kombëtare ose vendore, në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore.
4. Çdo institucion hedh në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore pjesën e vet të të dhënave dhe i publikon ato në faqen e vet elektronike.

Neni 90

**Regjistri Kombëtar i autorizimeve, lejeve e koncesioneve
për përdorimin e burimeve ujore**
(ndryshuar emërtimi me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor mban regjistrin ku shënohen të gjitha licencat, autorizimet, lejet, koncesionet e lëshuara, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore krijon, mban, menaxhon dhe përditëson Regjistrin Kombëtar për të gjitha lejet, autorizimet dhe koncesionet e lëshuara nga organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore.

3. Në çdo regjistër evidentohen:

a) të dhënat për të gjitha kërkesat, autorizimet, lejet dhe koncesionet e reja, të kërkuara në përputhje me këtë ligj ose për ndryshimin, rinovimin apo heqjen dorë nga ato ekzistuese;

b) procedurat e vënies në zbatim të këtyre autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve.

4. Zyrat e administrimit të baseneve ujore, i përcjellin Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore të dhënat dhe informacionin që disponojnë në regjistrat e tyre, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

**KREU XVII
INFORMIMI I PUBLIKUT DHE KONSULTIMI**

Neni 91

E drejta për të marrë dhe për të përdorur informacionin për burimet ujore

1. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën t'i mundësohet dhënia e informacionit të disponueshëm në lidhje me burimet ujore.

2. Publikut i jepet informacion për dokumentet bazë dhe të dhënat e përdorura për hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve, si dhe i krijohet mundësia për të marrë pjesë në procesin e konsultimit dhe komentimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore.

**KREU XVIII
DISPOZITAT FINANCIARE**

Neni 92

Tarifat për përdorimin e ujit

1. Këshilli i Ministrave miraton tarifat që paguhen për përdorimin e ujit, duke pasur parasysh këto faktorë:

a) llojin e ujit që kërkohet për përdorim;

b) qëllimin e përdorimit të ujit;

c) stinën e vitit, gjatë së cilës përdoret uji;

ç) sasinë e ujit që do të merret;

d) zërat e shpenzimeve të planifikimit, ndërtimit, shfrytëzimit, mirëmbajtjes e amortizimit të objekteve ujore dhe të ardhurat e parashikuara për përdoruesin e ujit nga përdorimi i këtij objekti ujor;

dh) përshtatshmërinë e impianteve për trajtimin dhe largimin e ujit pas përdorimit, në kuptimin e ndikimit mbi shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujit dhe mjedisin.

2. Tarifat e përdorimit të ujërave ndërkufitare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Përfshihen nga pagimi i tarifave të ujit forcat zjarrfikëse, qofshin këto subjekte publike apo private, të cilat përdorin ujin për rastet e shuarjes së zjarrit.

Neni 93

Shpenzimet administrative

(ndryshuar fjalë me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Kushdo, që kërkon të ushtrojë veprimtari që lidhen me përdorimin apo shkarkimin e ujit, për ndërtimin e objekteve a veprave ujore, sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë për shpenzimet administrative.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Kryeministrit, miraton tarifën për shpenzimet administrative.

Neni 94

Mbledhja e tarifave dhe pagesave për shpenzimet administrative

1. Tarifat e përdorimit të ujit dhe pagesat për shpenzimet administrative mbledhen nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.

2. Të ardhurat, që krijohen nga shpenzimet administrative, gjohet dhe tarifën për përdorimin e ujit kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

Neni 95

Organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Organet e administrimit të burimeve ujore, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, për bujqësinë, strukturat dhe organet e emergjencave civile, të rregullimit të planifikimit të territorit janë përgjegjëse për marrjen e masave dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së.

2. Inspektoratet, që mbulojnë fushën e mjedisit, shëndetësisë dhe bujqësisë, janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së (si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore).

3. Inspektorati, që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, dhe agjencitë rajonale të mjedisit janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

4. Përdoruesit e angazhuar në fushën e menaxhimit të ujërave, mbi të cilët zbatohet ky ligj, u japin inspektorëve që mbulojnë fushën e mjedisit të gjithë asistencën e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në atë veprimtari, për marrjen, analizimin dhe grumbullimin e gjithë informacionit të nevojshëm për realizimin e detyrave të tyre, për qëllime të këtij ligji, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

5. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj, me ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe me ligjin për inspektimin, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së (si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore).

KREU XIX KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 96

Inspektimi dhe konstatimi i shkeljes administrative

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet nga inspektoratet kombëtare përgjegjëse për kontrollin e territorit, mjedisit dhe ujërave, në përputhje me këtë ligj, ligjin për inspektimin dhe aktet ligjore e nënligjore për funksionimin e tyre, nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së (si një pjesë e ciklit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore).

2. Kur konstaton shkeljen e dispozitave të këtij ligji, inspektorati përgjegjës vendos dënimin kryesor me gjobë, si dhe dënime të tjera plotësuese, duke përfshirë detyrimin për rregullimin e pasojave të ardhura tek burimet ujore ose detyrimin për shpërblimin e dëmit përkatës.

3. Këshilli i Ministrave miraton procedurën e vlerësimit të dëmit dhe rregullimit të pasojave të ardhura te burimet ujore.

Neni 97

Sanksionet administrative

(ndryshuar pika 3, 17 dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si më poshtë:

1. Shkarkimi në mjedis i ujërave të përdorura industriale, në kundërshtim me parashikimin e pikës 7 të nenit 30 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

2. Veprimet e kryera në kundërshtim me nenin 39 të këtij ligji, lidhur me sasinë e rrjedhjes minimale ekologjike për çdo trup uJOR natyror, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

3. Veprimet e kryera në kundërshtim me shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 1, të nenit 41, të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative. Kur për veprimtarinë ligji parashikon dhënien e lejes nga Këshilli i Basenit UJOR, kundërvajtja administrative dënohet me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë. Kur për veprimtarinë ligji parashikon dhënien e lejes nga Këshilli Kombëtar i Ujit kundërvajtja administrative dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

3/1. Veprimet e kryera në kundërshtim me shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 41, të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

4. Mospajisja me autorizim nga organet e administrimit dhe menaxhimit të ujërave për veprimtaritë e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 42 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë.

5. Nxjerrja e materialeve inerte, si rrëzë, zhavor, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë, në kundërshtim me nenin 44 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

6. Shpimet dhe ndërhyrjet në zonën e burimeve natyrore të ujërave kurative, termale, termominerale dhe gjeotermale, si dhe thithja me pompa e ujërave kurative, termale, termominerale dhe gjeotermale direkt nga gryka e burimit, në kundërshtim me shkronjat “g” dhe “h” të pikës 1 të nenit 48 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

7. Shfrytëzimi i burimeve natyrore të ujërave kurative, minerale, termominerale dhe gjeotermale pa lejen e organeve të menaxhimit të burimeve ujore, si dhe ndryshimi i destinacionit të këtyre burimeve, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 48 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

8. Ushtrimi i aktivitetit mbi bazë tregtare nga shpuesit profesionistë të puseve pa licencë nga QKB-ja, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 56 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë.

9. Mosparaqitja në afat e raportit të shpimit nga ana e shpuesit profesionist në organet e administrimit të burimeve ujore, në përfundim të shpimit, e parashikuar në pikën 3 të nenit 56 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë.

10. Ushtrimi i veprimtarisë së shpimit për nxjerrje uji nga subjekte fizike, juridike apo persona të palicencuar, që ndërmarrin operacione shpimi pa u pajisur më parë me lejen për shpim nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, të parashikuar në pikën 6 të nenit 56 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë.

11. Kryerja e veprimtarive pa lejet apo autorizimet përkatëse në zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 3 të nenit 57 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

12. Veprimet që kryhen në kundërshtim me nenet 67, 69 pika 3 dhe 84 të këtij ligji, lidhur me veprime për mbrojtjen e brigjeve, kryerjen e veprimtarive në brigje pa lejet përkatëse, për kryerjen e veprimtarive të ndaluara në brigje dhe plazhe, për magazinimin e materialeve e lëndëve dhe ndërtimin e objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet, si dhe për ndërtimin e veprave dhe objekteve ujore pa lejet përkatëse, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

13. Veprimet që kryhen në kundërshtim me pikën 4 të nenit 68 të këtij ligji, lidhur me shkarkimet maksimale nga përdoruesit e ujit, të cilat nuk bëhen në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në planet e menaxhimit të baseneve, si dhe akteve të tjera nënligjore, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.

14. Veprimet që kryhen në kundërshtim me pikën 1 të nenit 71 të këtij ligji, lidhur me ndërtimin e veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e burimeve ujore, pa lejen apo autorizimin përkatës, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

15. Mosnjoftimi i organeve të administrimit apo menaxhimit të burimeve ujore për përfundimin e veprës apo objektit brenda afatit ligjor, sipas pikës 2 të nenit 71 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 300 000 lekë.

16. Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë apo në gropa, pa miratimin e lëshuar nga organi i menaxhimit të burimit ujor, parashikuar në pikën 1 të nenit 73 të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.

17. Krahës dënimit me gjobë, në varësi të ndotjes dhe dëmtimit, vendoset dhe pezullimi i pjesshëm apo i plotë i aktivitetit, detyrimi për rregullimin e pasojave të ardhura të burimet ujore nëpërmjet kthimit në gjendjen e mëparshme ose detyrimin për shpërblimin e dëmit përkatës në rast se rehabilitimi kryhet nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, si edhe sekuestrimi i mjeteve dhe pajisjeve, të cilat kalojnë në rezervat e shtetit.

Këshilli i Ministrave miraton procedurën që ndiqet për rregullimin e pasojave të ardhura të burimet ujore dhe për mënyrën e shpërblimit të dëmit.

Neni 98

Klasifikimi i masave administrative

Masat e gjobës, pezullimit të veprimtarisë deri në 10 ditë, pezullimit të veprimtarisë për një afat dymujor ose heqjes së lejes, të parashikuara në këtë ligj, janë dënime kryesore, ndërsa masat e tjera si sekuestrimi i mjeteve dhe pajisjeve, materialeve inerte gjendje janë dënime plotësuese.

Neni 99

Ankimi

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Kundër vendimit të organeve të menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda afateve ligjore nga data e njoftimit të vendimit.

2. Kundër vendimit të inspektorateve kombëtare përgjegjëse në fushën e kontrollit të territorit, mjedisit dhe ujërave mund të bëhet ankim ose ankim i veçantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 100

Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative

Ekzekutimi i masave administrative në zbatim të këtij ligji bëhet në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

KREU XX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 101

Propozimi dhe miratimi i akteve nënligjore

(ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.2.2018)

1. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 8; 11, pika 2; 16, pika 6; 17, pika 2; 22, pika 2; 25, pika 3; 26, pika 3; 29; 31, pika 1/1; 34, pika 3; 36, pika 2; 41, pika 3; 42, pika 5; 44, pika 2; 48, pika 3; 50, pikat 1 dhe 6; 53, pika 3; 57, pika 2; 59, pika 2; 60, pika 2; 68, pika 6; 70, pika 5; 73, pika 2; 74, pika 2; 76; 78; 82; 85, pika 7; 86, pika 1; 88, pika 3; 92, pikat 1 dhe 2; 93, pika 2; dhe 96, pika 3, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Këshilli Kombëtar i Ujit miraton aktet në zbatim të neneve 9, pika 3 shkronja “d”; 26, pika 4; 27, pikat 1 dhe 2; 28, pika 4; 35, pika 1; 37, pika 3; 44, pika 1; 46; 58, pika 1; 62, pika 1; 63; 69, pika 2; dhe 77, pika 4, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

3. Ministri përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë, ministrin përgjegjës për ekonominë dhe ministrin përgjegjës për shëndetësinë, nxjerr rregullore për zbatimin e pikës 2, të nenit 35, të këtij ligji.

4. Ministri përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe ministrin përgjegjës për ekonominë, nxjerr rregullore për zbatimin e pikës 2, të nenit 58, të këtij ligji.

Neni 102

Kur leja ose autorizimi i lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ajo shfuqizohet, por pa i hequr të drejtën titullarit të vazhdojë aktivitetin deri në mbarim të afatit dhe, me mbarimin e tij, të aplikojë një leje ose autorizim të ri.

Neni 103
Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohen.

Neni 104
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.11.2012

**Shpallur me dekretin nr.7845, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ
Nr. 24/2017

PËR ADMINISTRIMIN E UJITJES DHE TË KULLIMIT²⁶

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë kuadrin institucional që t’i shërbejë një politike kombëtare për ujitjen, kullimin, mbrojtjen nga përmytja dhe erozioni;
- b) të përcaktojë kuadrin ligjor për krijimin dhe/ose funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit;
- c) të përcaktojë të drejtat dhe detyrat e personave fizikë e juridikë që merren me ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja dhe erozioni;
- ç) të rregullojë transferimin e sistemeve të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja te drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, bashkitë dhe organizatat e përdoruesve të ujit.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

²⁶ Ligji nr. 24/2017, datë 9.3.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 27 mars 2017.

1. “Ministri” është ministri përgjegjës për bujqësinë.
2. “Ministria” është ministria përgjegjëse për bujqësinë.
3. “Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit” është personi juridik publik, i krijuar në përputhje me kreun III të këtij ligji.
4. “Përfitues” janë fermerët ose banorët që jetojnë në zonat nën ujitje dhe/ose nën kullim, të përcaktuara në këtë nen, të cilët përfitojnë nga shërbimet përkatëse.
5. “Organizatë” është organizata e përdoruesve të ujit, e cila organizohet dhe vepron sipas këtij ligji.
6. “Stacion pompash kullimi” është tërësia e pompave, të vendosura në grup apo të veçanta, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe aksesore të tjerë në funksion të tyre, që shërbejnë për kullimin e tokave.
7. “Vepra të mbrojtjes nga përmytja” janë pendë/argjinaturë të mbrojtjes nga përmytja dhe ndërtime të përgjatë lumenjve, bregdetit, përrenjve dhe rrjedhave të tjera ujore, kanaleve të ujërave të larta, kanale kullues për parandalimin nga përmytja dhe erozioni të tokave bujqësore dhe të zonave rurale.
8. “Zonë nën kullim” është një zonë e caktuar gjeografike që përfiton prej një sistemi kullimi.
9. “Zonë e shërbimit të ujitjes” është një zonë e caktuar gjeografike që furnizohet me ujë dhe përdor një ose disa sisteme ujitjeje.
10. “Sistem ujitjeje” është një rrjet kanalesh ujitëse, së bashku me veprat përkatëse hidroteknike, rezervuarët, digat, strukturat devijuese, stacionet e pompave, rrugë, ndërtesa të furnizuara nga një kanal parësor ose një rezervë ujore parësore, për ujitjen e një sipërfaqeje toke. Sistemi i ujitjes përfshin edhe tokën bashkëngjitur me kanalet e ujitjes, e cila është mbajtur nën pronësinë e shtetit për sigurimin e aksesit në kanale të tilla.
11. “Sistem kullimi” është një rrjet kullimi, me kanale të ndërtuara/tubacione dhe kanale natyrore, si dhe me veprat përkatëse hidroteknike, përfshirë stacionet e pompave të kullimit, rrugët dhe ndërtesat. Sistemi i kullimit shërben për të kulluar tokën, përfshirë edhe tokën bujqësore, rrugët dhe zonat urbane. Sistemi i kullimit përfshin edhe tokën bashkëngjitur me kanalet kulluese, të ndërtuara dhe ato natyrore, e cila është mbajtur në pronësinë e shtetit, për sigurimin e aksesit në kanale të tilla.
12. “Kanal kryesor ujitës” është kanali ujitës që transporton ujë nga një lumë, përrua, rezervuar ose burime të tjera ujore drejt një ose më shumë sistemeve ujitëse dhe çdo stacioni pompimi mbi ose të lidhur me këtë kanal.
13. “Rezervuar” është rezervë artificiale uji, formuar nga akumulimi ose bllokimi i ujit me anë të një dige.
14. “Digë” ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”.
15. “Infrastruktura e ujitjes dhe e kullimit” janë asetet e patundshme, pjesë përbërëse të një sistemi ujitjeje apo kullimi.
16. “Infrastruktura kryesore e ujitjes dhe e kullimit” janë veprat kryesore hidroteknike të një sistemi ujitjeje apo kullimi.

Neni 3

Pronësia e burimeve ujore

Burimet ujore të lumenjve, përrenjve, liqeneve natyrore, të ujëmbledhësve, ujërave nëntokësore dhe ujërat e sistemeve ujitëse e të kullimit janë pronë e shtetit.

Neni 4

Parimet kryesore

Administrimi i sistemeve të ujitjes, i sistemeve të kullimit dhe i veprave të mbrojtjes nga përmytja kryhet në përputhje me këto parime:

- a) sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e të gjithë përfituesve;

b) sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë për rregullimin e regjimit ujqor në tokë, si të tepcës dhe deficitit të lagështisë, për të parandaluar erozionin dhe ndotjen, gjithnjë në funksion të mbrojtjes së mjedisit;

c) përfituesit nga sistemet e ujitjes, të kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja përballojnë shpenzimet e funksionimit e të mirëmbajtjes së tyre.

Neni 5

Administrimi i ujitjes dhe kullimit

1. Ministria është organi kryesor përgjegjës për politikën e administrimit të ujitjes dhe të kullimit.
2. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit kryejnë detyrat e përcaktuara në kreun III të këtij ligji.
3. Bashkitë kryejnë detyrat e përcaktuara në kreun IV të këtij ligji.
4. Organizatat kryejnë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes, që u është transferuar atyre në përdorim, në përputhje me kreun V të këtij ligji.

Neni 6

Detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë

1. Ministria ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) përcakton politikën kombëtare të ujitjes dhe të kullimit;
 - b) mbikëqyr funksionimin dhe veprimtarinë e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit;
 - c) mbikëqyr infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit nga ana teknike;
 - ç) propozon krijimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit;
 - d) ndërmer veprime të nevojshme për të garantuar sigurinë e veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe të digave, që janë pjesë e sistemeve të ujitjes;
 - dh) këshillon e udhëzon drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, bashkitë dhe organizatat për çështje ligjore, teknike e financiare;
 - e) kryen kontrolle financiare të drejtorive të ujitjes e të kullimit;
 - ë) kryen kontrollin teknik e fizik të sistemeve të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytjet;
 - f) monitoron cilësinë e ujërave të ujitjes e kullimit dhe të tokave nën sistemin e këtyre ujërave;
 - g) ndërmer veprime të nevojshme në rast thatësire të zgjatur dhe përmbytjeje;
 - gj) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në këtë ligj.
2. Rregulla dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU II

INFRASTRUKTURA E UJITJES DHE E KULLIMIT

Neni 7

Inventari i infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja

1. Ministria mban inventarin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, që administrohen nga drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit.
2. Bashkitë mbajnë inventarin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja, të transferuar në pronësi të tyre.

Neni 8

Bazat për transferimin dhe përdorimin e infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja

1. Transferimi i infrastrukturës së ujitjes, të kullimit dhe të veprave të mbrojtjes nga përmbytja bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton me vendim transferimin e infrastrukturës në përgjegjësi administrimi, në pronësi, dhënien me koncesion/partneritet publik privat, sipas dispozitave ligjore në fuqi, pa ndryshuar destinacionin.
3. Në rastet kur infrastruktura e transferuar në pronësi humb destinacionin, për shkaqe të pavarura nga pronari i saj, ndryshimi i destinacionit të pronës bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit dhe bashkia, së cilës i është transferuar infrastruktura e ujitjes, kullimit apo vepra të mbrojtjes nga përmbytja, nuk mund ta shesin, ta lënë në hipotekë ose ta tjetërsojnë në mënyra të tjera infrastrukturën ose çdo pjesë të saj.
5. Dhënia në përdorim e infrastrukturës mbi bazën e së drejtës kontraktuale bëhet me marrëveshje me shkrim, në formën e parashikuar, ndërmjet ministrisë/bashkisë dhe cilitdo që i transferohet infrastruktura, për jo më pak se 10 vjet. Në marrëveshje përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.

Neni 9

Transferimi i infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja

1. Ministria propozon:
 - a) infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja që i transferohen në përgjegjësi administrimi drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit;
 - b) infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja që u transferohen në pronësi bashkive.
2. Çdo transferim bëhet duke iu referuar një planimetrie ose harte, e cila përshkruan infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja që janë objekt transferimi.

Neni 10

Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja

1. Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në administrim të saj.
2. Bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi të saj.
3. Çdo drejtori e ujitjes dhe e kullimit dhe bashki merr masat e nevojshme për të ruajtur dhe mirëmbajtur infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara në to, përfshirë edhe sipërfaqet e tokës bashkëngjitur.

Neni 11

Humbja e destinacionit

1. Për infrastrukturën e ujitjes, të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja, që administrohen nga drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit dhe bashkitë, por që kanë humbur destinacionin për bujqësinë, Këshilli i Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për çështjet vendore, mund të përcaktojë:
 - a) daljen jashtë përdorimi të tyre për qëllime ujtieje dhe kullimi;
 - b) përdorimin e këtyre aseteve për qëllime të tjera;

c) privatizimin e këtyre aseteve, së bashku me sipërfaqen përkatëse të tokës, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në rastin kur rezervuarët për ujitje humbin destinacionin, digat e tyre shemben ose modifikohen në mënyrë të tillë që të mos jenë në gjendje të mbledhin apo të akumulojnë rezerva ujore.

KREU III DREJTORITË E UJITJES DHE TË KULLIMIT

Neni 12

Krijimi i drejtorive të ujitjes dhe të kullimit

1. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit krijohen si struktura në varësi të ministrisë, si persona juridikë publikë, që kanë për qëllim të kryejnë detyrat e parashikuara në këtë ligj.

2. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit:

- a) përcakton organizimin dhe funksionimin e drejtorive;
 - b) përmбан zonat e shërbimit përkatës të ujitjes, të kullimit dhe mbrojtjes nga përмbyтja;
 - c) përcakton vendndodhjen;
 - ç) përcakton detyra dhe përgjegjësi specifike, përveç sa përcaktohet në nenin 13 të këtij ligji.
4. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit financohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 13

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit

1. Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përмbyтja në administrim të saj, brenda zonës përkatëse të shërbimit, në mënyrë që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit, si dhe të parandalojë përмbyтjen.

2. Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit:

- a) pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitës;
- b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit (hidrovoret);
- c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përмbyтja;
- ç) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe veprave të mbrojtjes nga përмbyтja dhe, kur është e nevojshme, kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre;
- d) merr masa specifike në rast përмbyтjeje dhe thatësire të zgjatur;
- dh) merr masa për zbatimin e planit periodik dhe të azhurnuar të emergjencave nga përмbyтja;
- e) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të;
- ë) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet.

3. Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit, me urdhër të ministrit, ndërmerr, në raste të veçanta, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e përkohshme të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përмbyтja të transferuara bashkisë, në raste të tilla si cenim i sigurisë së digave dhe përмbyтje.

4. Veprimtaritë që realizohen nga drejtoria e ujitjes dhe e kullimit, sipas këtij neni, financohen nga buxheti i shtetit i miratuar për ministrinë.

Neni 14

Organizimi i drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit

1. Struktura dhe organika e drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit miratohet nga Kryeministri, pas propozimit të ministrit, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve në drejtorinë e ujitjes dhe të kullimit rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.
3. Marrëdhëniet e punës së punonjësve adminis-trativë të këtyre drejtorive rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

KREU IV BASHKITË

Neni 15

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive

1. Bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastruk-turën e ujitjes dhe të kullimit të transferuar në pronësi, që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit.
2. Bashkia shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes, në mënyrë të tillë që çdo fermer të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar.
3. Bashkia, brenda zonës së vet të shërbimit:
 - a) pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitëse;
 - b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe të kullimit;
 - c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në zonat e banuara;
 - ç) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe, kur është e nevojshme, kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre;
 - d) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të;
 - dh) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet;
 - e) përmbush detyrat, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore;
 - ë) monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti.
4. Bashkia bashkëpunon për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit me drejtorinë përkatëse të ujitjes dhe të kullimit, në rastet kur kjo e fundit administron infrastrukturën kryesore në këto sisteme.

Neni 16

Burimet e të ardhurave

- Burimet e të ardhurave për bashkinë, për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në nenin 15, të këtij ligji, përbëhen nga:
- a) tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit;
 - b) tarifa e shërbimit të ujitjes;
 - c) fonde nga Buxheti i Shtetit, që u transferohen bashkive, sipas përcaktimeve të ligjit vjetor të Buxhetit të Shtetit apo legjislacionit të financave vendore;
 - ç) burime të tjera nga të ardhurat e veta;
 - d) donacione, grante dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

Neni 17

Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës

1. Bashkia mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes. Afati i pagesës së kësaj tarife është brenda datës 31 janar të çdo viti.
2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes i njoftohet, me shkrim, zotëruesit të tokës dhe përllogaritet duke iu referuar madhësisë së sipërfaqes së saj, në përpjesëtim me madhësinë e përgjithshme të zonës së shërbimit të ujitjes.
3. Kjo tarifë përfshin shpenzimet e mirëmbajtjes vjetore të sistemit të ujitjes, shpenzimet për përgatitjen e këtij sistemi për stinën e ardhshme të ujitjes dhe koston e pastrimit të kanaleve kulluese.

Neni 18

Tarifa e shërbimit të ujitjes

1. Bashkia vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo fermeri.
2. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe.
3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi përllogaritet duke iu referuar shpenzimeve për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, përfshirë çdo shpenzim të bërë për furnizimin e një rezerve të tillë ujore.

Neni 19

Miratimi i tarifave

Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe tarifa e shërbimit të ujitjes miratohen nga këshilli bashkiak.

Neni 20

Transferimi i përgjegjësi të ujitjes

1. Bashkia mund t'i transferojë përgjegjësitë e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes, organizatave, brenda zonës së saj të shërbimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 8, të këtij ligji. Në këtë rast, tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe tarifa e shërbimit të ujitjes mbledhen nga organizata.
2. Bashkia, në bashkëpunim me drejtorinë e ujitjes dhe të kullimit, nxisin dhe mbështesin krijimin dhe funksionimin e organizatave, të cilat sigurojnë menaxhimin e ujitjes me pjesëmarrjen e fermerëve.
3. Bashkia mund t'i transferojë përgjegjësitë e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes edhe shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, të krijuara sipas ligjit nr. 38/2012, "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", brenda zonës së saj të shërbimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
4. Marrëveshja tip për dhënien në përdorim të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit shoqërive të bashkëpunimit bujqësor miratohet nga ministri.

KREU V

ORGANIZATAT E PËRDORUESVE TË UJIT

Neni 21

Statusi juridik

1. Organizata është person juridik, me vetë-financim, që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse.
2. Çdo organizatë ka emrin dhe zonën ku ajo ushtron veprimtarinë e saj.

Neni 22

Qëllimi i krijimit të organizatës

1. Qëllimi i krijimit të organizatës është shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes të transferuar në përdorim, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes, dhe siguri i ujit për ujitje për anëtarët e saj.
2. Organizata u shërben interesave publikë dhe interesave të anëtarëve.

Neni 23

Anëtarësia

1. Çdo person fizik a juridik që ka në pronësi ose në përdorim tokë brenda zonës së shërbimit të ujitjes të një organizate, ka të drejtën të bëhet anëtar i kësaj organizate.
2. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga krijimi i një organizate janë të lidhura me tokën në pronësi ose në përdorim, që ndodhet brenda zonës së shërbimit të ujitjes, pavarësisht nga qëllimi i përdorimit, dhe transferohen së bashku me tokën në çastin kur organizata shpërbëhet ose kur toka nuk përfshihet më brenda zonës së shërbimit të ujitjes, pas një ndryshimi në statutin e organizatës.

Neni 24

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të organizatës

1. Anëtari i organizatës ka të drejtë:
 - a) të përfitojë nga shërbimet e ofruara nga organizata;
 - b) të ketë të drejta të barabarta në furnizimin me ujë, në dispozicion të organizatës, për ujitje;
 - c) të votojë;
 - ç) të propozojë çështje për diskutim për në asamblenë e përgjithshme;
 - d) të zgjidhet dhe të propozojë kandidatë për t'u zgjedhur në organet e organizatës.
 - dh) të marrë pjesë personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme;
 - e) të shqyrtojë regjistrat dhe llogaritë e organizatës;
 - ë) të kompensohet për dëmtimin e tokës dhe të prodhimit në këtë sipërfaqe, si rrjedhojë e veprimtarive të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, të ndërmarra nga organizata në atë tokë.
2. Anëtari i organizatës ka detyrë:
 - a) të zbatojë statutin, rregulloren e brendshme dhe vendimet e organizatës;
 - b) të paguajë të gjitha detyrimet financiare dhe tarifat e caktuara nga organizata;
 - c) të mbrojë pasurinë e organizatës;
 - ç) të sigurojë informacionin që i kërkohet nga organizata për tokën dhe përdorimin e saj;
 - d) të lejojë stafin e organizatës të ketë akses në tokën e tij, me ose pa makineri, sipas rastit, për kryerjen e veprimeve për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes.

Neni 25

Statuti

1. Veprimtaria dhe rregullat për zgjedhjen, funksionimin e organizimit të organeve të saj rregullohen nga statuti i organizatës, i cili duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, ku përcaktohen:
 - a) adresa e selisë së organizatës;
 - b) përshkrimi i zonës së shërbimit nën ujitje, sipas hartave dhe projekteve që i bashkëlidhen statutit;
 - c) kuota vjetore e anëtarësimit;
 - ç) të drejtat dhe detyrat e anëtarëve;

- d) mënyra e organizimit, funksionet, përbërja dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese;
 - dh) rregullat për organizimin e mbledhjeve, njoftimin, pjesëmarrjen, procedurën e votimit për marrjen e vendimeve;
 - e) burimet financiare, mënyra e administrimit dhe e kontrollit të tyre;
 - ë) mënyra e miratimit të ndryshimeve;
 - f) marrëdhëniet me organin mbikëqyrës.
2. Organizata dërgon statutin e vet të bashkia përkatëse, e cila, brenda 30 ditëve nga marrja e tij, duhet ta miratojë ose të kërkojë ndryshimin e dispozitave që nuk janë në përputhje me këtë ligj.
3. Ministri miraton statutin tip të organizatës.

Neni 26 Regjistrimi

Pas miratimit të statudit nga bashkia, organizata regjistrohet në gjykatën kompetente. Me regjistrimin në gjykatë, organizata fiton statusin juridik.

Neni 27 Procedura e krijimit të organizatës

1. Për krijimin e një organizate, jo më pak se dhjetë zotërues të sipërfaqeve të tokës, të vendosura brenda zonës së shërbimit të ujitjes, ngrenë një grup nismëtar, i cili, pasi identifikon zonën e shërbimit të ujitjes që do të mbulojë organizata, i dorëzon një kërkesë me shkrim bashkisë, për të filluar procedurat.
2. Bashkia, në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse të ujitjes dhe të kullimit, shqyrtojnë realizueshmërinë hidraulike dhe ekonomike të zonës së shërbimit të ujitjes së organizatës së propozuar dhe, nëse gjykojnë se ajo, në parim, mund të jetë e suksesshme, i shpall zyrtarisht grupit nismëtar fillimin e procedurave të krijimit, duke njoftuar edhe këshillin e basenit ujëmbledhës.
3. Me ndihmën e bashkisë, grupi nismëtar organizon, ndërmjet anëtarëve të mundshëm të organizatës së propozuar, zgjedhjen e komitetit themelues, të përbërë prej jo më shumë se 11 personash, që përfaqësojnë, në mënyrë sa më të plotë, zonën e shërbimit të ujitjes.
4. Komiteti themelues harton projektstatutin e organizatës së propozuar, përgatit planin e zonës së shërbimit të ujitjes, listën e anëtarëve të propozuar të organizatës dhe harton projekt-buxhetin e planin e punës për vitin e parë të funksionimit të organizatës.
5. Pas njohjes së projektstatutit nga anëtarët e mundshëm të organizatës dhe pas marrjes së mendimeve të tyre, komiteti themelues i dërgon për miratim bashkisë dokumentet e sipërpërmendura.
6. Bashkia mund të refuzojë miratimin e projektstatutit dhe të dokumentacionit mbështetës nëse:
 - a) statuti nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
 - b) zona e shërbimit të ujitjes së propozuar nuk përbën një zonë toke të dallueshme nga ana hidraulike, për të bërë të mundur furnizimin me ujë nga një ose më shumë sisteme ujitjeje;
 - c) në bazë të të dhënave për madhësinë e zonës së shërbimit të ujitjes së propozuar, numrit të anëtarëve të ardhshëm, mënyrave të përdorimit të tokës brenda zonës së shërbimit të propozuar të ujitjes gjykohet se organizata e propozuar nuk do të jetë ekonomikisht e suksesshme.
- Kur bashkia refuzon miratimin e projektstatutit dhe të dokumentacionit mbështetës, njofton komitetin themelues për arsyet e refuzimit.
7. Komiteti themelues, brenda 30 ditëve nga miratimi i statudit, thërret mbledhjen e parë të asamblesë së përgjithshme, gjatë së cilës zgjidhen organet drejtuese të organizatës dhe komiteti themelues shpërndahet.

Neni 28

Organet përbërëse të organizatës

Organet përbërëse të organizatës janë:

1. Asambleja e përgjithshme.
2. Këshilli administrativ.
3. Kryetari.
4. Komisioni i auditimit.

Neni 29

Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i organizatës dhe mbledhet, të paktën, një herë në vit.

2. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret nga këshilli administrativ, kur ky i fundit e shih të nevojshme. Mbledhja thirret edhe me kërkesë të, të paktën, 20 për qind të anëtarëve të përfaqësuesve të tyre ose siç përcaktohet në statut dhe njoftimi bëhet me shkrim.

3. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e tyre. Sesionet e asamblesë së përgjithshme drejtohen nga kryetari i organizatës ose, në mungesë të tij, nga një person tjetër, i parashikuar në statut.

4. Asambleja e përgjithshme ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) zgjedhjen e këshillit administrativ dhe të komisionit të auditimit;
- b) miratimin e bilancit vjetor, raportit vjetor dhe buxhetit të propozuar;
- c) miratimin e planit të shfrytëzimit, mirëmbajtjes së sistemeve ujëtare, si dhe planit të alarmit të evakuimit dhe të ndihmës për mbrojtjen e popullatës e të vlerave materiale, në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digës;
- ç) miratimin e programit të shpërndarjes së ujit dhe planit të ujitjes, në funksion të planifikimit vjetor të mbjelljeve;
- d) miratimin e nivelit të tarifave dhe të detyrimeve që do të mbledhen nga organizata, si dhe sanksionet që do të vendosen prej saj;
- dh) propozimin e ndryshimeve në statut;
- e) miratimin e rregullores së brendshme, në përputhje me statutin.

Neni 30

Këshilli administrativ

1. Këshilli administrativ është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e organizatës. Ky këshill jep llogari përpara asamblesë së përgjithshme për mbikëqyrjen e funksionimit të organizatës dhe përbëhet, minimumi, prej tre anëtarësh, dhe maksimumi, prej njëmbëdhjetë anëtarësh.

2. Anëtarët e këshillit administrativ janë anëtarë të organizatës dhe zgjidhen nga asambleja e përgjithshme në mbledhjen vjetore, për një afat deri në katër vjet. Anëtarët që plotësojnë afatin mund të rizgjidhen. Askush nuk gëzon të drejtën për t'u zgjedhur nëse ka ndaj organizatës detyrime financiare, si pagesa, tarifa, sanksione.

3. Çdo anëtar i këshillit administrativ, në çdo çast, vepron në interes të organizatës, duke deklaruar çdo interes financiar personal për çështjet që shtrohen për diskutim në mbledhjet e këshillit dhe, në këtë rast, nuk merr pjesë në diskutim.

4. Detyrat e këshillit administrativ janë:

- a) thirrja e sesioneve të asamblesë së përgjithshme;
- b) përgatitja e projektbuxhetit, planit të punës, planit të shfrytëzimit, mirëmbajtjes, planit të alarmit të evakuimit dhe të ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe të vlerave materiale, në rastet e

jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digës, për t'ia kaluar për miratim asamblesë së përgjithshme;

c) përgatitja e kontratave, në përputhje me buxhetin e miratuar, me planin e punës dhe me planin e shfrytëzimit e të mirëmbajtjes;

ç) rekrutimi dhe shkarkimi i administratorit të organizatës;

d) propozimi i çështjeve që do të vendosen nga asambleja e përgjithshme;

dh) monitorimi i funksionimit të organizatës;

e) ndjekja e zbatimit të procedurave financiare të organizatës;

ë) çështje të tjera, të përcaktuara në statut.

Neni 31

Kryetari i organizatës

1. Kryetari i organizatës zgjidhet nga këshilli administrativ prej anëtarëve të tij.

2. Kryetari i organizatës është, njëkohësisht, edhe kryetar i këshillit administrativ.

3. Kryetari ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) thërret dhe kryeson mbledhjet e këshillit administrativ dhe të asamblesë së përgjithshme;

b) përfaqëson organizatën në marrëdhëniet me të tretët, sipas përcaktimeve të statutit;

c) nënshkruan kontrata dhe dokumente të tjera ligjore, në përputhje me vendimet e këshillit administrativ;

ç) ndërmerr detyra të tjera, të përcaktuara në statut.

Neni 32

Komisioni i auditimit

1. Komisioni i auditimit përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, që zgjidhen nga asambleja e përgjithshme për një periudhë katërvjeçare. Anëtarët e komisionit të auditimit mund të rizgjidhen vetëm një herë.

2. Komisioni i auditimit ka për detyrë të kontrollojë në vazhdimësi veprimtarinë ekonomiko-financiare të organizatës dhe të raportojë në mbledhjen vjetore të asamblesë së përgjithshme.

Pas miratimit në këtë asamble, raporti i dërgohet bashkisë dhe drejtorisë së ujitjes dhe kullimit.

3. Largimi nga detyra i anëtarëve të komisionit të auditimit bëhet në bazë të përcaktimeve të statutit.

Neni 33

Stafi ekzekutiv

1. Organizata punëson një staf ekzekutiv, përfshirë edhe një administrator.

2. Administratori caktohet me konkurrim nga këshilli administrativ dhe duhet të ketë kualifikimin dhe përvojën e duhur në menaxhimin e ujitjes. Ai i raporton këshillit administrativ dhe merr pjesë në mbledhjet e tij, kur i kërkohet një gjë e tillë, por nuk gëzon të drejtën e vendimmarrjes apo të votimit.

3. Punonjësit e tjerë të stafit ekzekutiv caktohen nga administratori, nëpërmjet konkurrit, në përputhje me buxhetin vjetor, të miratuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Stafi ekzekutiv i organizatës punësohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës.

Neni 34

Burimet e të ardhurave të organizatës

1. Burimet e të ardhurave të organizatës janë:

a) tarifa vjetore e mirëmbajtjes;

b) tarifa e shërbimit të ujitjes;

c) dhurimet ose grantet;

- ç) burime të tjera, që nuk bien ndesh me ligjin.
2. Organizata krijon një fond rezervë, ku depozitohen të gjitha bilancet pozitive të të ardhurave, të cilat përdoren për riparime emergjence dhe rehabilitim të infrastrukturës së ujitjes.
3. Tarifat e paguara nga çdo anëtar, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, përcaktohen në statutin e organizatës.
4. Mbledhja e tarifës vjetore të mirëmbajtjes dhe shërbimit të ujitjes realizohet nga organizata.

Neni 35

Tarifa vjetore e mirëmbajtjes

1. Organizata mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes. Afati i pagesës së kësaj tarife është brenda datës 31 janar të çdo viti.
2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes i njoftohet me shkrim zotëruesit të tokës dhe përlogaritet duke iu referuar madhësisë së asaj sipërfaqeje, në përpjesëtim me madhësinë totale të zonës së shërbimit të ujitjes.
3. Kjo tarifë përfshin:
- a) shpenzimet e mirëmbajtjes vjetore të sistemit të ujitjes, shpenzimet për përgatitjen e këtij sistemi për stinën e ardhshme të ujitjes dhe koston e pastrimit të kanaleve kulluese të transferuara;
- b) pjesën për fondin rezervë të organizatës.

Neni 36

Tarifa e shërbimit të ujitjes

1. Organizata vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo anëtar.
2. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje, apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe.
3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi përlogaritet duke iu referuar shpenzimeve të organizatës për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, përfshirë çdo shpenzim të bërë nga organizata për nxjerrjen dhe/ose furnizimin e një rezerve të tillë ujore.

Neni 37

Bashkimi ose ndarja e organizatave

Bashkimi ose ndarja e organizatave bëhet në përputhje me statutin e tyre dhe vendimet përkatëse të asambleve të përgjithshme dhe, pas miratimit nga bashkia, ndiqet procedura në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 38

Ndryshimi i statutit

Organizata, me vendim të dy të tretave të asamblesë së përgjithshme, vendos ndryshimin e statutit. Vendimi i asamblesë së përgjithshme i dorëzohet bashkisë, së bashku me një kërkesë me shkrim dhe një kopje të statutit që përmban ndryshimet e propozuara.

Procedura e miratimit të ndryshimeve në statut është ajo e përcaktuar në nenin 25, të këtij ligji.

Neni 39

Shpërndarja dhe likuidimi i organizatave

1. Organizata mund të shpërndahet nëse:
- a) detyrat e saj nuk ekzistojnë më;

- b) detyrat e saj, praktikisht, nuk mund të përmbushen më;
- c) ekzistenca e mëtejshme e saj nuk kërkohet për arsye të tjera.

2. Asambleja e përgjithshme e një organizate, me dy të tretat e votave të anëtarëve të saj, vendos që organizata të shpërmdahet.

Kërkesa për shpërndarjen e një organizate i dorëzohet bashkisë, e cila, nëse bindet se plotësohet njëri nga kushtet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, miraton shpërndarjen e organizatës dhe ndjekjen e procedurave për likuidimin e organizatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Në rast se bashkia vlerëson se ekziston njëri nga rastet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, dhe në rast se është në interes publik, i kërkon organizatës të aplikojë për shpërndarjen e saj. Nëse organizata nuk vepron brenda 30 ditëve, bashkia mund të vazhdojë procedurat e shpërndarjes.

KREU VI MBIKËQYRJA E SEKTORËVE TË UJITJES DHE TË KULLIMIT

Neni 40

Regjistrat

1. Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit mban këta regjistra:
 - a) planimetrinë që tregon zonën nën shërbimin e ujitjes dhe të kullimit;
 - b) inventarin e pasurive;
 - c) regjistrin e kontratave të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe ndërtimit të infrastrukturës;
 - ç) regjistrin për inspektimet në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja.
2. Çdo bashki/organizatë mban këta regjistra:
 - a) regjistër të anëtarëve, i cili përshkruan madhësinë dhe vendndodhjen e pronës së çdo pronari. Regjistri rishikohet çdo vit;
 - b) planimetrinë që tregon zonën e shërbimit nën ujitje dhe kullim;
 - c) regjistër për sasinë e ujit të marrë prej bashkisë/organizatës;
 - ç) regjistër për sasinë e ujit ose numrin e ujitjeve të përfituara nga anëtarët;
 - d) regjistër për pagesat e detyruara, tarifat për t'u paguar dhe ato të paguara;
 - dh) inventarin e pasurive;
 - e) regjistër për inspektimet dhe kontrollet e infrastrukturës së ujitjes, si dhe regjistër për inspektimet dhe kontrollet e digës, sipas legjislacionit përkatës.
3. Forma dhe përmbajtja e regjistrave në këtë nen përcaktohen me urdhër të ministrit.

Neni 41

Llogaritë financiare

Çdo drejtori e ujitjes dhe e kullimit, bashki dhe organizatë, mban llogari të faturave dhe të shpenzimeve, si dhe përgatit bilancin vjetor e raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 42

Kontrolli financiar i llogarive dhe i të ardhurave vjetore

1. Llogaritë e çdo drejtorie të ujitjes dhe të kullimit, që përfshijnë bilancin vjetor dhe raportin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë ligj u nënshtrohen kontrollit/auditimit vjetor nga ministria.
2. Llogaritë e çdo organizate, që përfshijnë bilancin vjetor dhe raportin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë ligj, u nënshtrohen kontrollit /auditimit vjetor nga bashkia.

3. Kontrolli/auditimi kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

Neni 43

Regjistri i drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, të bashkive dhe të organizatave

1. Ministria krijon regjistrin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, të bashkive dhe të organizatave.
2. Regjistri i drejtorive të ujitjes dhe të kullimit përmban emrin, vendndodhjen dhe zonën përkatëse të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit;
3. Regjistri i bashkive përmban këto të dhëna:
 - a) emrin e bashkisë;
 - b) vendndodhjen;
 - c) zonën përkatëse të shërbimit të ujitjes dhe të kullimit dhe madhësinë e tyre;
 - ç) emrat dhe adresat e personave përgjegjës.
4. Regjistri i organizatave përmban këto të dhëna:
 - a) emrin e organizatës;
 - b) vendndodhjen e organizatës;
 - c) zonën përkatëse të shërbimit të ujitjes dhe madhësinë e saj;
 - ç) numrin e anëtarëve të organizatës;
 - d) emrat dhe adresat e administratorit dhe kryetarit.

Neni 44

Mbikëqyrja teknike

1. Ministria u kërkon drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të dhëna dhe dokumentacion për shfrytëzimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës që u është transferuar atyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Ministria autorizon stafin e vet të kontrollojë infrastrukturën që është transferuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dhe u kërkon drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave, kur kjo është e nevojshme, të marrin përsipër punime specifike:
 - a) për të siguruar mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture;
 - b) për të parandaluar dëmet ose cenimin e kësaj infrastrukture;
 - c) për të parandaluar dëmet e pronës shtetërore ose dëmet e pronës së të tretëve;
 - ç) në interes publik.

Neni 45

Servitutet

1. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, bashkitë dhe organizatat përfitojnë servitut, në përputhje me Kodin Civil.
2. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, bashkitë dhe organizatat autorizojnë persona, të cilët kanë të drejtë të hyjnë në tokë private, për të kryer kontrole dhe punë emergjente për infrastrukturën që u është transferuar drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit, bashkisë ose organizatës.
3. Sipërfaqja mbi të cilën është vendosur sistemi ujitës dhe kullues, së bashku me strukturat përkatëse, regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, ku bëhet edhe regjistrimi i servituteve të krijuara në bazë të këtij neni.

Neni 46

Kundërvajtjet administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si të tilla:

- a) ndërtimi, rehabilitimi ose modifikimi i një sistemi ujitjeje apo kullimi pa lejen përkatëse;
 - b) dëmtimi i sistemit të ujitjes, i sistemit të kullimit ose i veprave të mbrojtjes nga përmbytja;
 - c) ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujitjes, sistemet e kullimit ose veprat e mbrojtjes nga përmbytja;
 - ç) ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve më afër se 8 metra nga bordura e kanalit kryesor (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues ose vija e takimit të skarpatës së jashtme të bankinës së kanalit ujitës me sipërfaqen e tokës), ose e një sistemi kryesor kullimi, apo më afër se 4 metra nga bordura e çfarëdo kanali ujitjeje ose kullimi;
 - d) mosmbajtja e regjistrave të përcaktuar në nenin 40 të këtij ligji;
 - dh) mosmbajtja e llogarive financiare, në përputhje me nenin 41, të këtij ligji;
 - e) mosparaqitja siç duhet e informacionit dhe e dokumentacionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 44, të këtij ligji;
 - ë) pengimi, bllokimi ose ndalimi në mënyra të tjera i stafit të autorizuar për inspektimin e infrastrukturës, në përputhje me pikën 2, të nenit 45, të këtij ligji.
2. Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, bashkitë dhe organizatat, në rast se konstatojnë kundër-vajtjet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 1, të këtij neni, njoftojnë Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Kundërvajtjet administrative dënohen me 50 mijë lekë gjobë dhe kundërvajtësi është i detyruar të përballojë shpenzimet për rikthimin e objektit të dëmtuar në gjendjen e mëparshme.
3. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të pikës 1, të këtij neni, dënohen me 25 mijë lekë gjobë, sipas rastit, nga ministria ose bashkia.
4. Të ardhurat e vjela nga gjobat për kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në këtë nen, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 47

Ankimi

1. Kundër vendimeve të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit mund të bëhet ankimi në gjykatën administrative përkatëse, brenda 5 ditëve nga njoftimi i tij.
2. Kundër vendimeve të strukturave të ministrisë dhe bashkisë mund të bëhet ankimi në gjykatën administrative përkatëse, brenda afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 48

Ekzekutimi i vendimit

1. Ankimi në gjykatë kundër vendimeve të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit nuk pezullon ekzekutimin e tyre.
2. Ekzekutimi i vendimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 49

Bordet e kullimit, të krijuara në zbatim të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në krijimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 12, të këtij ligji.

Neni 50

Dispozita të fundit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për administrimin e ujërave të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda tre muajve nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 51

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10093, datë 23.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr.10 431, datë 9.6.2011

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT²⁷

(Ndryshuar me ligjin nr.31/2013, date 14.2.2013)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe

²⁷ Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” të ndryshuar. Numri CELEX: 32004L0035, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 143, datë 30.4.2004, faqe 56-75.

Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 30 qershor 2011.

Ligji nr.31/2013, date 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 12 mars 2013.

përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Neni 2

Objekti

Ky ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- ç) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- d) ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- dh) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- e) mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Neni 4

Fusha e zbatimit të ligjit

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik” janë:
 - a) organet e qeverisjes qendrore dhe vendore apo organet e tjera të administratës publike, përfshirë organizmat këshillues publikë, në nivel kombëtar, rajonal apo vendor;
 - b) çdo person, fizik apo juridik, që ushtron funksione administrative publike, përfshirë edhe detyra, veprimtari ose shërbime specifike që kanë të bëjnë me mjedisin;
 - c) çdo person, fizik apo juridik, që ka përgjegjësi a funksione publike apo që siguron shërbime publike, që kanë të bëjnë me mjedisin dhe janë nën kontrollin e një organizmi apo personi që përfshihet në grupimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni.
2. “Cilësi e mjedisit” është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.
3. “Dëmtim i mjedisit” është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.
4. “Kapacitet bartës” është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, vetitë e tij natyrore.
5. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
6. “Ministër” është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit.

7. “Mjedis” janë përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.

8. “Mjedis i kërcënuar” është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnisë së një ndotjeje të konsiderueshme.

9. “Ndërhyrje negative në mjedis” është çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut, që mund të prekë kapacitetin bartës të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose që ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin.

10. “Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit.

11. “Operator” është personi fizik apo juridik, që operon apo kontrollon instalimin, ose të cilit i është deleguar fuqi ekonomike vendimtare për funksionet teknike të instalimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12. “Publik” është një ose më shumë persona, fizikë apo juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikave kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre.

13. “Rrezik ndaj mjedisit” është mundësia që paraqet një veprimtari njerëzore për të shkaktuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, dëmtimin e mjedisit apo për të vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e njeriut.

14. “Skema e ekomenaxhimit dhe auditimit” është një instrument menaxhimi për organizatat e biznesit dhe organizatat të tjera për të vlerësuar, për të raportuar e për të përmirësuar performancën e tyre në mjedis.

15. “Subjekt ndotës ose ndotës” është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit.

16. “Substanca” janë elementet kimike dhe përbërjet e tyre në gjendjen e tyre natyrore apo siç prodhohen nga industria.

17. “Substancë e rrezikshme” është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t’u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.

18. “Shkarkim” është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.

19. “Veprimtari” është veprimtaria prodhuese ose operacione të instalimeve dhe impianteve të tyre.

KREU II

PARIMET E MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 6

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

Neni 7

Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

1. Masat për mbrojtjen e mjedisit merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis.

2. Gjatë përcaktimit të masave dhe veprimtarive specifike të mbrojtjes së mjedisit zbatohet një qasje paraprake me qëllim që, në rast se ka kërcënime për dëme të rënda apo të pakthyeshme mbi mjedisin, mungesa e sigurisë shkencore të mos pengojë apo të mos shtyjë në kohë marrjen e masave efektive me kosto më të ulët, që parandalojnë dëmtimin e mjedisit.

Neni 8

Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore

1. Mbrojtja e mjedisit realizohet duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfutuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve.

2. Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve, brenda kompetencave të tyre, nxitin marrjen e masave dhe kryerjen e veprimtarive për mbrojtjen e burimeve natyrore.

Neni 9

Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit

1. Masat dhe veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit merren:

a) për të zëvendësuar ndërhyrjet që mund të sjellin efekte të dëmshme mbi mjedisin me ndërhyrje të tjera që paraqesin një rrezik apo kërcënim më të vogël apo kompensojnë efektet e dëmshme të pashmangshme;

b) për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira mjedisore, përdorimin e produkteve, të pajisjeve e të aparaturave, si dhe për zbatimin e proceseve të prodhimit, që janë më pak të dëmshme apo të padëmshme për mjedisin.

2. Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin përdorimin, për efekte të mjedisit, të teknikave më të mira të disponueshme.

Neni 10

Parimi i qasjes së integruar

1. Qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit, në tërësinë e tij.

2. Autoritetet publike, gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, cenueshmërinë e mjedisit, lidhjen ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe jo të përtëritshme, trashëgiminë kulturore dhe të pasurive materiale, tërësinë e ndërveprimeve të tyre të ndërsjella, si dhe ndërveprimin ndërmjet projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

Neni 11

Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit e miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të

ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm.

2. Republika e Shqipërisë siguron bashkëpunimin dhe solidaritetin për zgjidhjen e problemeve mjedisore globale dhe ndërqeveritare përmes marrëveshjeve ndërkombëtare e shkëmbimit të informacionit mjedisor.

3. Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre, sigurojnë mënyrën dhe kushtet e bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

Neni 12

Parimi “Ndotësi paguan”

Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar.

Neni 13

Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut

1. Çdo person ka të drejtë t’i jepet në kohë informacion për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra, në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin të cilit ai i referohet, si dhe me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare”.

2. Gjatë zgjidhjes institucionale të problemeve të mbrojtjes së mjedisit, autoritetet publike përkatëse sigurojnë që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e të programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësit e mjedisit, si dhe në hartimin dhe miratimin e rregulloreve e të akteve me karakter të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, vendimmarrjen për dhënien e lejeve përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin, të cilit ai i referohet.

Neni 14

Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

1. Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre:

a) nxitin veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit, që parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e tij, si dhe projekte, që ulin përdorimin e substancave të caktuara, të lëndëve të para e të energjisë, apo që e ndotin më pak mjedisin;

b) mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre për masat vullnetare që ato mund të ndërmarrin, me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis.

2. Autoritetet publike, fusha e veprimit të të cilave përfshin funksione të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

KREU III

MBROJTJA E PËRBËRËSVE TË MJEDISIT

Neni 15

Mbrojtja e integruar

Përbërësit e mjedisit mbrohen nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre.

Neni 16

Mbrojtja e ajrit

1. Mbrojtja e ajrit përfshin masat për mbrojtjen e përbërësve dhe cilësisë së tij, me synim shmangien apo reduktimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut, cilësinë e jetës dhe mjedisin në tërësi, si dhe parandalimin e pakësimit e ndotjes që shkakton dëmtimin e shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimatike globale.

2. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së ajrit përcaktohen në këtë ligj dhe me legjislacionin e posaçëm në fuqi.

Neni 17

Mbrojtja e ujërave

1. Mbrojtja e ujërave përfshin masat për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, në tranzicion, të ujërave bregdetare dhe të detit, në tërësi, me qëllim shmangien apo pakësimin e efekteve të dëmshme mbi ekosistemet ujore, mjedisin në tërësi, shëndetin e njeriut dhe cilësinë e jetës.

2. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së ujërave, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 18

Mbrojtja e tokës

1. Mbrojtja e tokës përfshin ruajtjen e cilësive dhe të funksioneve natyrore të tokës, parandalimin e dëmtimit të saj, monitorimin e gjendjes së tokës dhe ndryshimet në cilësinë e saj, si dhe përmirësimin dhe rehabilitimin e tokës së dëmtuar.

2. Mbrojtja e shtresës vegetative të tokës synon mbrojtjen e aftësisë për të prodhuar, si dhe përmirësimin e rehabilitimin e saj.

3. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së tokës dhe të shtresës vegetative të saj përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 19

Mbrojtja e natyrës

1. Mbrojtja e natyrës përfshin:

a) ruajtjen e biodiversitetit, të ekosistemeve e të peizazhit natyror;
b) masat për mbrojtjen e pyjeve: natyrore, pjesërisht natyrore, komplekseve pyjore dhe të tokës pyjore, rrjedhave dhe burimeve ujore, florës dhe faunës në një rajon pyjor, si dhe të stacioneve të gjeneve dhe farërave të varieteteve vendase të drurëve.

2. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së natyrës dhe të pyjeve përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 20
Ndryshimet klimatike

1. Ndryshime klimatike janë ndryshimet e shkaktuara nga ndikimet e njeriut në sistemin klimatik.
2. Masa të veçanta për ndryshimet klimatike përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.
3. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet akteve nënligjore, mbështet dhe nxit:
 - a) reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serë;
 - b) marrjen e masave të sigurta për kapjen dhe ruajtjen e dioksidit të karbonit;
 - c) përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetin e përdorimit të saj.

KREU IV
MBROJTJA E MJEDISIT NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT

Neni 21
Strategjitë dhe planet mjedisore

1. Ministria përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare në mënyrë periodike.
2. Ministria, sipas rastit, përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit.
3. Strategjitë dhe planet e referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave.
4. Këshilli i Ministrave miraton strategjitë dhe planet e referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 22
Planet vendore të veprimit për mjedisin

1. Autoritetet e qeverisjes vendore përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji.
2. Planet e veprimit, vendore, për mjedisin rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave.
3. Këshilli i autoritetit të qeverisjes vendore përkatëse miraton planet e referuara në pikën 1 të këtij neni.
4. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.

Neni 23
Planet e zhvillimit

1. Planet e zhvillimit, në kuptim të këtij ligji, përfshijnë instrumentet e parashikuara në planifikimin kombëtar, vendor e ndërvendor, dhe planifikimin e integruar, siç përcaktohet në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.
2. Gjatë hartimit dhe miratimit të planeve të zhvillimit, autoriteti publik përkatës mban parasysh veçanërisht ndjeshmërinë e mjedisit të një zone të caktuar, kapacitetin bartës të saj, lidhjen dhe harmoninë e vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe të papërtëritshme, trashëgiminë kulturore, si dhe tërësinë e ndërveprimeve ndërmjet zhvillimeve ekzistuese dhe atyre të planifikuara në mjedis.
3. Planet e zhvillimit përfshijnë masa për mbrojtjen e tokës, të ujërave, detit, ajrit, pyjeve, klimës, ekosistemeve, peizazhit natyror, vlerave kulturore dhe fizike, masat për menaxhimin e mbetjeve, masat për mbrojtjen kundër zhurmave, dridhjeve, erërave të pakëndshme dhe zjarrit, si

dhe masa të tjera që kanë lidhje me to, që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, të përcaktuara në përputhje me këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 24

Vlerësimi strategjik mjedisor

1. Vlerësimi strategjik mjedisor kryhet për:

a) planet dhe programet në fushën e bujqësisë, pyjeve, peshkimit, energjetikës, industrisë, minierave, transportit, telekomunikacioneve, menaxhimit të mbetjeve, menaxhimit të ujërave, turizmit, planifikimit të territorit, si dhe për planet e programet e zhvillimit kombëtar, rajonal e vendor;

b) dokumentet e planifikimit strategjik, në bazë të të cilave bëhet planifikimi i zbatimit të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, siç përcaktohet në nenin 21 të këtij ligji;

c) planet dhe programet që mund të kenë efekt mbi zonat veçanërisht të mbrojtura, siç parashikohet në aktet ligjore të posaçme.

2. Planet dhe programet e referuara në pikën 1 të këtij neni, të cilat parashikojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel vendor dhe/apo ndryshime jothelbësore të tyre, kërkojnë kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor vetëm në rast se ministria vlerëson se ato mund të kenë efekte të rëndësishme në mjedis.

3. Planet dhe programet, që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, por që përcaktojnë kuadrin për miratimin e zhvillimit të projekteve në të ardhmen, i nënshtrohen vlerësimit strategjik mjedisor vetëm në rast se ministria vlerëson se ato mund të kenë efekte të konsiderueshme në mjedis.

4. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Neni 25

Vlerësimi i ndikimit në mjedis

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

2. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

5. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

KREU V
PARANDALIMI DHE KONTROLI I NDOTJES

SEKSIONI 1
NORMAT E MJEDISIT

Neni 26
Normat e cilësisë së mjedisit

1. Me “Normë të cilësisë së mjedisit” kuptohet kufiri i lejuar i përqendrimit të një ndotësi apo grupi të caktuar ndotësish në ajër, ujë ose tokë.
2. Normat e cilësisë së mjedisit për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish të secilit prej përbërësve të mjedisit, si dhe afatet për arritjen e normave të cilësisë së mjedisit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 27
Normat teknike të shkarkimeve në mjedis

1. Me “Normë teknike të shkarkimeve në mjedis” kuptohet masa, përqendrimi ose niveli i shkarkimit në mjedis nga një veprimtari, të cilat nuk duhet të tejkalohen gjatë një apo më shumë periudhave kohore. Normat teknike të mjedisit vendosen për grupe apo kategori të caktuara substancash.
2. Vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit për një veprimtari specifike nuk duhet të jenë më pak shtrënguese se norma teknike e shkarkimeve mjedisore përkatëse.
3. Normat teknike të shkarkimeve në mjedis, në mënyrë të përgjithshme, zbatohen në pikën ku bëhet shkarkimi nga veprimtaria.
4. Normat teknike të shkarkimeve në mjedis për ndotës apo grupe specifike ndotësish, për përbërës të veçantë të mjedisit, si dhe afatet e përkohshme për arritjen e këtyre normave përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 28
Kërkesat themelore për produktet

1. Kërkesat themelore për produktet, makineritë, pajisjet dhe teknologjitë e prodhimit, që mund të rrezikojnë apo të kërcënojnë mjedisin, parashikohen nga kuadri ligjor për sigurinë e përgjithshme të produkteve, kërkesat themelore ndaj produkteve joushqimore dhe vlerësimin e përputhshmërisë.
2. Atje ku është e nevojshme, këto kërkesa themelore përfshihen në lejen përkatëse të mjedisit, sipas seksionit 2 të këtij kreu.

SEKSIONI 2
LEJET E MJEDISIT

Neni 29
Lejet e mjedisit

1. Veprimtaritë, që shkaktojnë ndotje në mjedis, pajisen me lejen përkatëse të mjedisit, ku përcaktohen, me shkrim, kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.
2. Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej tri nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në

mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut:

- a) kategoria e veprimtarive A, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A;
- b) kategoria e veprimtarive B, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B;
- c) kategoria e veprimtarive C, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C.

Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet tri niveleve përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit.

3. Lejet e mjedisit, të përcaktuara në këtë ligj, miratohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe përfshihen në kategorinë III. 1 të shtojcës së tij.

Neni 30

Parandalimi i aksidenteve madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme

1. Çdo veprimtari, ku substancat dhe preparatet kimike të rrezikshme janë ose mund të jenë të pranishme në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëme në mjedis apo në shëndetin e njeriut në rastin e një aksidenti madhor, i nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin dhe kufizimin e këtyre aksidenteve.

2. Masat për parandalimin e aksidenteve madhore, që përfshijnë substanca të rrezikshme, përcaktohen në këtë ligj dhe në ligjin për parandalimin e aksidenteve madhore, që përfshijnë substanca të rrezikshme.

Neni 31

Tavanet e shkarkimeve

1. Për qëllime të këtij neni, me “Tavan kombëtar shkarkimi” kuptohet sasia maksimale e një substance, të referuar në pikën 2 të këtij neni, e shprehur në kilotonë, e cila lejohet të shkarkohet nga territori i Republikës së Shqipërisë gjatë një viti kalendarik.

2. Republika e Shqipërisë merr masat e nevojshme për të kufizuar shkarkimet kombëtare të ndotësve acidifikues dhe eutrofikues dhe prekursorëve të ozonit.

3. Masat e referuara në pikën 2 të këtij neni kufizojnë tavanet kombëtare vjetore të atyre substancave dhe, në veçanti, të dioksidit të squfurit, oksideve të azotit, përbërjeve të paqëndrueshme organike dhe amoniakut, në sasi jo më të mëdha se tavanet e shkarkimeve të miratuara për secilën nga këto substanca.

4. Kur është e nevojshme, leja përkatëse e mjedisit, sipas përcaktimit të nenit 29 të këtij ligji, përmban kushtet që sigurojnë respektimin e tavaneve kombëtare të shkarkimeve.

5. Tavanet kombëtare të shkarkimeve dhe masat e referuara në pikën 2 të këtij neni, për mbrojtjen e efektshme të njerëzve nga rreziqet e njohura në shëndet nga ndotja e ajrit, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 32

Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

1. Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve përmban informacionin për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve dhe të mbetjeve, vlerësimin e prirjeve të tyre, monitorimin e progresit të bërë përmes politikave e programeve mjedisore, të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe mundëson të drejtën e publikut për t’iu dhënë ky informacion.

2. Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve administrohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

3. Operatori i veprimtarive, të cilave u referohet ky nen, mban, përditëson dhe i raporton çdo vit Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e këtij neni.

4. Kërkesat e hollësishme për funksionimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, lista e veprimtarive dhe ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe formulari i deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve nga operatori miratohen nga Këshilli i Ministrave.

SEKSIONI 3 MASA TË TJERA TË KONTROLLIT TË NDOTJES

Neni 33

Menaxhimi i integruar i mbetjeve

1. Menaxhimi i integruar i mbetjeve synon parandalimin ose reduktimin e mbetjeve dhe ndikimeve të dëmshme të tyre mbi mjedisin, si dhe përdorimin e efektshëm të burimeve natyrore, me qëllim mbrojtjen e mjedisit, të burimeve, të shëndetit të njeriut, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

2. Masat për menaxhimin e mbetjeve përcaktohen me ligj të posaçëm.

Neni 34

Kimikate

1. Mbrojtja nga efektet e dëmshme të kimikateve, përbërjeve dhe preparateve të tyre përfshin masat dhe procedurat e mbrojtjes nga efektet e tyre të dëmshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

2. Masat për zbatimin e mbrojtjes nga efektet e dëmshme të kimikateve përcaktohen me ligj të posaçëm.

Neni 35

Substancat ozonholluese

1. Rregullat për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve të pajisjeve, që përmbajnë këto substanca, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Veprimtaritë e lidhura me substancat ozonholluese licencohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe përfshihen në kategorinë III. 3 të shtojcës së tij.

Neni 36

Organizmat e Modifikuar Gjenetikut

1. Ndalohet shkarkimi i qëllimshëm në mjedis apo hedhja në treg e Organizmave të Modifikuar Gjenetikut, që mund të shkaktojnë efekte të dëmshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislati në fuqi, në përputhje me parimin e parandalimit dhe masave paraprake.

2. Ky nen nuk zbatohet për ushqimet dhe ushqimin për kafshë, që përmbajnë Organizma të Modifikuar Gjenetikut, të cilat rregullohen me ligj të posaçëm.

3. Rregullat e hollësishme për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të Organizmave të Modifikuar Gjenetikut, për qëllime të tjera, përveç hedhjes së tyre në treg, si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Ndotësit organikë të qëndrueshëm

1. Ndalohen prodhimi, importi, hedhja në treg dhe përdorimi i kimikateve dhe pesticideve, që shfaqin karakteristika të ndotësve organikë të qëndrueshëm, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

2. Lista e substancave, të referuara në pikën 1 të këtij neni, kontrolli i prodhimit, importit, hedhjes në treg dhe përdorimit, përjashtimet nga masat e kontrollit dhe reduktimi, minimizimi e eliminimi i shkarkimit të këtyre substancave miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 38

Mbrojtja nga zhurmat dhe dridhjet

1. Mbrojtja nga zhurmat dhe dridhjet përfshin masat e mbrojtjes nga zhurmat dhe dridhjet, ndaj të cilave njerëzit janë të ekspozuar, në veçanti në zona të banuara, në parqe publike apo në zona të tjera të qeta në zona urbane, në zona të qeta në zona rurale, pranë shkollave, spitaleve, si dhe pranë ndërtesave e zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave dhe/ose dridhjeve.

2. Masat për zbatimin e mbrojtjes nga zhurmat dhe dridhjet përcaktohen me ligj të posaçëm.

Neni 39

Erërat e pakëndshme

1. Mbrojtja nga erërat e pakëndshme përfshin masat mbrojtëse ndaj shkarkimit të substancave me erë të pakëndshme ose potencialisht të pakëndshme nga veprimtaritë që i gjenerojnë ato dhe ndaj të cilave ekspozohen njerëz.

2. Masat për mbrojtjen ndaj erërave të pakëndshme dhe kriteret e vlerësimit për veprimtaritë e reja dhe ekzistuese me shkarkime me erë të pakëndshme ose potencialisht të pakëndshme apo për burimet e këtyre erërave miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 40

Mbrojtja nga rrezatimi

1. Mbrojtja nga rrezatimi jonizues dhe jojonizues synon parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e rrezikut ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut, si dhe ndaj mjedisit.

2. Masat për mbrojtjen nga rrezatimin jonizues dhe jojonizues përcaktohen me ligj të posaçëm.

KREU VI

MONITORIMI I GJENDJES SË MJEDISIT

SEKSIONI 1

GJENDJA E MJEDISIT

Neni 41

Monitorimi i gjendjes së mjedisit

1. Monitorimi i gjendjes së mjedisit është vëzhgimi dhe regjistrimi, sipas një plani dhe rregulli të caktuar, i cilësisë së mjedisit dhe i ndryshimeve të gjendjes së përbërësve të tij. Në veçanti, ai përfshin:

- a) cilësinë e ujërave sipërfaqësore;
- b) cilësinë e ujërave nëntokësore;
- c) cilësinë e ajrit;

- c) mbetjet;
- d) zhurmat;
- dh) rrezatimet;
- e) cilësinë e tokës;
- ë) florën, faunën, biodiversitetin, pyjet;
- f) ndikimet e sektorëve ekonomikë mbi përbërësit e mjedisit;
- g) monitorimin e fenomeneve natyrore dhe ndikimin e mundshëm të tyre mbi mjedisin;
- gj) monitorimin e ndikimeve të ndotjes së mjedisit mbi shëndetin e njeriut.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat dhe procedurat për hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit.

Neni 42

Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit

1. Në zbatim të nenit 41 të këtij ligji, ngrihet Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit, i cili shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit.

2. Organizimi dhe funksionimi i rrjetit dhe mënyra, procedura dhe forma e paraqitjes së të dhënave në këtë rrjet miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 43

Kufizimi i pronësisë dhe i të drejtave të tjera reale për monitorimin e mjedisit

1. Çdo personi fizik apo juridik, subjekti privat ose publik, i kufizohet e drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi pronën në atë pjesë të saj, ku vendosen objekte dhe/ose aparatura matëse për kryerjen e monitorimit të mjedisit në rastet kur mendohet që kryerja e monitorimit të mjedisit është në interes të publikut, në përputhje me sa parashikohet në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

2. Me qëllim kryerjen e monitorimit të mjedisit, personi i autorizuar përdor kryesisht tokën në pronësi të shtetit, atje ku ndërhyrja për përdorimin aktual të asaj pjese toke është minimale. Gjatë kryerjes së veprimtarive që kanë të bëjnë me instalimin e një objekti/impianti, të tilla si aparatet dhe pajisjet matëse, të referuara në pikën 1 të këtij neni, personi i autorizuar minimizon ndërhyrjen për përdorimin e asaj pjese toke sa më shumë të jetë e mundur dhe pas kryerjes së veprimtarisë e rikthen tokën në gjendjen e saj të mëparshme.

SEKSIONI 2

MONITORIMI I PËRPUTHSHMËRISE

Neni 44

Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë

1. Operatori i veprimtarive, të përfshira në kategoritë A, B dhe C, të referuara në nenin 29 të këtij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.

2. Operatori i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara, përmes procedurës për verifikimin e matjeve, të parashikuara në legjislacionin e posaçëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit, si dhe mban këto pajisje e instrumente në një gjendje të përshtatshme pune.

3. Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar.

4. Rezultatet e vetëmonitorimit u jepen autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

KREU VII INFORMACIONI MJEDISOR

Neni 45

Qëllimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor

1. Sistemi i informacionit mjedisor i shërben mbrojtjes dhe menaxhimit të integruar të mjedisit dhe përbërësve të tij, monitorimit të zbatimit të politikave mjedisore, raportimeve të ndërsjella, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe sigurimit të informimit të publikut.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron sistemin e informacionit mjedisor.

3. Autoritetet publike bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me qëllim sigurimin e funksionimit të duhur të këtij sistemi. Mjetet, metodologjia dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit, në lidhje me funksionimin e këtij sistemi, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

4. Sistemi i informacionit mjedisor përmban të dhëna për gjendjen e mjedisit, ngarkesën ndotëse dhe ndikimet në mjedis, reagimin e publikut dhe, veçanërisht, të dhëna për:

a) gjendjen e përbërësve të mjedisit, të mbledhura dhe të përpunuara në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera të posaçme;

b) shkarkimet e ndotësve në mjedis, të përfuara nga Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;

c) karakteristikat natyrore dhe fizike të përbërësve të mjedisit dhe fenomenet natyrore që kanë ndikim mbi to;

ç) mjedisin dhe përbërësit e tij, të përfuara nga projekte dhe programe kërkimore dhe vlerësuese;

d) burimet natyrore dhe përdorimin e tyre;

dh) zonat e përcaktuara si të mbrojtura apo të rrezikuara, në bazë të akteve normative të posaçme apo konventave ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

e) biodiversitetin dhe përbërësit e tij;

ë) efektet e ndotjes në mjedis dhe shëndetin e njeriut;

f) mbetjet dhe menaxhimin e ndotjeve;

g) substancat e rrezikshme;

gj) aksidentet industriale dhe ekologjike;

h) masat e sigurisë dhe masat që duhen marrë në rast aksidentesh;

i) ndotësit e mjedisit;

j) masat e politikave mjedisore, planet dhe programet e mbrojtjes së mjedisit;

k) veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit;

l) lejet e lëshuara për kryerjen e veprimtarive ndotëse dhe përmbajtjen e tyre.

Neni 46

Informimi i publikut në lidhje me çështjet mjedisore

1. Informacioni mjedisor përfshin çdo informacion të paraqitur në formë audioje, vizuale, elektronike, me shkrim ose në ndonjë mënyrë tjetër në lidhje me:

a) gjendjen e përbërësve të mjedisit, të tillë si: ajri dhe atmosfera, uji, toka, peizazhi dhe zonat natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare e detare, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, përfshirë Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht, dhe ndërveprimin ndërmjet tyre;

b) faktorë të tillë, si substancat, energjia, zhurmat, rrezatimi, vibracionet, erërat e pakëndshme apo mbetjet, përfshirë mbetjet radioaktive, shkarkimet në ajër dhe ujë, si dhe shkarkime të tjera në mjedis, të cilat kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit e mjedisit, të referuar në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) masa të tilla, si politikat, legjislacioni, planet, programet, marrëveshjet mjedisore, si dhe veprimtaritë që kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit dhe faktorët e referuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, si dhe masat apo veprimtaritë e përcaktuara për të mbrojtur këta përbërës;

ç) raportet në lidhje me zbatimin e legjislacionit mjedisor;

d) analizat kosto-përfitime dhe analiza të tjera ekonomike, si dhe parashikimet e përdorura brenda kuadrit të masave dhe veprimtarive, të referuara në shkronjën “c” të kësaj pike;

dh) gjendjen dhe sigurinë e shëndetit të njeriut, përfshirë ndotjen e zinxhirit ushqimor, atje ku është e nevojshme, kushtet e jetesës, objektet me vlera kulturore dhe arkeologjike, si dhe strukturat e ndërtuara, për sa kohë që ato ndikohen apo mund të ndikohen nga gjendja e përbërësve të mjedisit, të referuar në shkronjën “a” të kësaj pike, ose nga ndikimi në ato përbërës të secilës prej çështjeve të referuara në shkronjat “b” dhe “c” të kësaj pike.

2. Autoritetet publike përkatëse, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare”, i sigurojnë publikut mundësinë për të marrë informacionin mjedisor që ato disponojnë.

Neni 47

E drejta për të pasur informacion mjedisor

1. Çdo personi fizik dhe juridik i sigurohet informacioni i disponueshëm për mjedisin, pa qenë nevoja të shfaqë një interes specifik për të.

2. Procedurat dhe kërkesat e tjera të hollësishme për zbatimin e këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 48

E drejta për padi gjyqësore

Në rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjeje dhe dëmtimi të tij, publiku ka të drejtë:

a) t’u kërkojë autoriteteve publike përkatëse marrjen e masave të duhura brenda afateve dhe në përputhje me autoritetin që u jep ligji;

b) të ngrejë padi në gjykatë, në përputhje me kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kundër autoritetit publik ose personit fizik e juridik, që ka sjellë dëme në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë.

Neni 49

Pjesëmarrja e publikut dhe publiku i përfshirë në vendimmarrje

E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së autoriteteve publike për mjedisin përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

KREU VIII

PËRGJEGJËSIA MJEDISORE

Neni 50

Përgjegjësia për dëmin në mjedis

1. Qëllimi i përgjegjësisë për dëmin në mjedis, mbështetur në parimin “Ndotësi paguan”, është:

a) parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit;

- b) rehabilitimi i mjedisit;
 - c) prezantimi i masave dhe i praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit.
2. Përgjegjësia për dëmin në mjedis përcaktohet në bazë të:
- a) dëmit të shkaktuar në mjedis nga çdonjëra prej veprimtarive të rrezikshme, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, si dhe nga kërcënimi i mundshëm për një dëm të tillë;
 - b) dëmi i shkaktuar ndaj llojeve të mbrojtura dhe habitateve natyrore nga çdo veprimtari profesionale e ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, si edhe nga çdo kërcënim i mundshëm i këtij dëmi, si pasojë e kryerjes së këtyre veprimtarive, për shkak të pakujdesisë së operatorit.
3. Këshilli i Ministrave miraton:
- a) listën e veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin, në kuptim të pikës 2 të këtij neni;
 - b) kriteret, në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis.
4. Ministri miraton:
- a) masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar;
 - b) metodën për specifikimin e shpenzimeve për përcaktimin dhe eliminimin e kërcënimit dhe të dëmit.
5. Operatori, që kryen veprimtaritë e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, i cili ka shkaktuar një dëm apo paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për dëme në mjedis, është përgjegjës për këtë dëm.
6. Operatori është përgjegjës nëse:
- a) nuk merr masat e nevojshme parandaluese;
 - b) nuk merr masat e nevojshme zhdëmtuese;
 - c) nuk njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për rrezikun e dëmit në mjedis, i cili mund të ishte shkaktuar, pavarësisht nga masat e marra apo se dëmi mund të ketë ndodhur ose jo.
7. Në rast se dëmi në mjedis nuk ka ndodhur, por ekziston një kërcënim i drejtpërdrejtë për një dëm të tillë, operatori merr menjëherë dhe pa vonesë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit në mjedis. Nëse operatori nuk e përmbush këtë detyrim, Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr masat e nevojshme parandaluese dhe operatori është përgjegjës për të mbuluar koston përkatëse.
8. Në rast se, pavarësisht nga masat e referuara në pikën 6 të këtij neni, operatori nuk arrin të eliminojë kërcënimin e drejtpërdrejtë të dëmit në mjedis, ai njofton menjëherë dhe pa vonesë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, e cila:
- a) i kërkon operatorit të sigurojë informacion për çdo kërcënim për dëmet në mjedis ose për rastet kur dyshohet për ekzistencën e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për dëme në mjedis;
 - b) i kërkon operatorit të marrë masat e nevojshme dhe i jep atij udhëzime për masat parandaluese;
 - c) merr masat e nevojshme parandaluese apo cakton një subjekt tjetër, fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, me shpenzimet e operatorit.
9. Në rast se dëmi në mjedis ka ndodhur, operatori:
- a) informon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për dëmin e shkaktuar;
 - b) kryen rehabilitimin e të gjithë dëmit, në përputhje me parimin “Ndotësi paguan”;
 - c) merr të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin në mjedis, me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme në mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore;
 - ç) merr të gjitha masat e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 4 të këtij neni.
10. Në rast se disa operatorë kryejnë një nga veprimtaritë e referuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, brenda të njëjtit territor, ata mbajnë bashkërisht dhe reciprokisht përgjegjësinë për

dëmin e shkaktuar nga kryerja e asaj veprimtarie, në përputhje me përcaktimet e legjislationit në fuqi.

11. Në rast se dëmi në mjedis ka ndodhur, Agjencia Kombëtare e Mjedisit:

a) i kërkon operatorit të sigurojë informacion të mëtijshëm për dëmin e shkaktuar;
b) merr, i kërkon apo i jep udhëzime operatorit për të marrë të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin në mjedis, me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtijshme në mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore;

c) i kërkon operatorit të marrë masat e nevojshme rehabilituese, si dhe i siguron atij udhëzimet e duhura për masat rehabilituese që duhet të merren;

ç) merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, me shpenzimet e operatorit, në rast se operatori nuk e ka përmbushur këtë detyrim;

d) merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, në rast se operatori nuk mund të identifikohet, apo nuk i kërkohet të përballojë shpenzimet, siç parashikohet në pikat 2 e 3 të nenit 54 të këtij ligji.

12. Agjencia Kombëtare e Mjedisit specifikon masat rehabilituese për sa i përket dëmit të shkaktuar në mjedis.

13. Në rastin e një dëmi të shkaktuar në mjedis, operatori përcakton dhe propozon masat e nevojshme rehabilituese, siç parashikohet në shkronjën “a” të pikës 4 të këtij neni, dhe ia paraqet ato Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për miratim. Gjatë përcaktimit të masave rehabilituese, operatori merr parasysh që këto masa të jenë të përshtatshme dhe efikase për eliminimin e të gjithë dëmit që i është shkaktuar mjedisit.

14. Në rast se dëmi i shkaktuar në mjedis është i tillë që masat rehabilituese nuk mund të merren njëherazi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton masat parësore dhe me kosto më të ulët që do të ndërmerren. Në përcaktimin e masave parësore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr parasysh natyrën, shkallën dhe rëndësinë e secilit prej dëmeve të shkaktuara në mjedis, rrezikun ndaj shëndetit të njeriut, si edhe aftësinë e rehabilitimit natyror të mjedisit.

15. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për identifikimin e operatorit që paraqet kërcënimin e drejtpërdrejtë për një dëm të mundshëm apo që ka shkaktuar dëmin në mjedis, për vlerësimin e rëndësisë së dëmit të shkaktuar, si dhe për përcaktimin e masave rehabilituese.

Neni 51

Shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese

1. Operatori mbulon shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese për dëmin që ai ka shkaktuar në mjedis.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, operatori nuk bën kompensimin e shpenzimeve për marrjen e masave parandaluese e rehabilituese për dëmin e shkaktuar në mjedis, në rast se ai vërteton që dëmi i shkaktuar apo kërcënim i për shkaktimin e një dëmi në mjedis:

a) është pasojë e një fenomeni natyror të paparashikueshëm dhe të pashmangshëm, i cili nuk mund të parandalohej apo të eliminohej;

b) është shkaktuar nga një palë e tretë dhe/ose ka ndodhur pavarësisht nga marrja e masave të duhura;

c) është pasojë e zbatimit të një vendimi të detyrueshëm, të lëshuar nga një autoritet publik.

3. Operatori nuk është i detyruar të kompensojë shpenzimet për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese, në rast se vërtetohet që dëmi në mjedis nuk është shkaktuar për faj të tij, por është shkaktuar nga:

a) një shkarkim apo veprimtari tjetër e autorizuar apo në përputhje me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit;

b) një shkarkim, veprim, apo një produkt i përdorur a i prodhuar nga veprimtaria, potenciali dëmtes i të cilit në momentin e shkaktimit të dëmit, ishte i panjohur nga shkenca.

Neni 52

Kompensimi i dëmit në mjedis

1. Subjektet fizike apo juridike dhe shoqatat mjedisore në territorin, që preket drejtpërdrejt apo vuan pasojat e dëmit të shkaktuar në mjedis, kanë të drejtë t'i kërkojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të kërkojë nga operatori:

a) rikthimin e mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme;

b) kompensimin e dëmit të shkaktuar në mjedis, në përputhje me sa parashikohet në këtë ligj, nëse rikthimi i mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme është i pamundur.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlerëson se rehabilitimi dhe kthimi i mjedisit në gjendjen që kishte para se të shkactohej dëmi është i pamundur, detyron operatorin të paguajë kompensimin për dëmin e shkaktuar në mjedis.

Neni 53

Detyrimi për të vënë paraprakisht në dispozicion fonde për kompensimin e dëmit

1. Operatori, që kryen cilëndo nga veprimtaritë e përmendura në listën e referuar në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 50 të këtij ligji, vë, paraprakisht, në dispozicion fondet e nevojshme për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis.

2. Këshilli i Ministrave miraton metodat dhe procedurat për sigurimin e fondeve të tilla, si garancitë apo siguracionet e nevojshme.

Neni 54

Burime të tjera për mbulimin e shpenzimeve për masat rehabilituese

1. Buxheti i Shtetit siguron burimet për rehabilitimin e dëmit, pasojat e të cilit duhen eliminuar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 4 të nenit 50 të këtij ligji, kur identifikimi i operatorit është i pamundur.

2. Buxheti i Shtetit siguron fondet financiare për korrigjimin e një dëmi shumë të madh në mjedis, që është shkaktuar nga një veprimtari që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur operatori i referuar në pikat 1 e 2 të këtij neni identifikohet më pas, i kërkon atij rimbursimin e shpenzimeve të bëra për eliminimin e pasojave të dëmit në mjedis brenda një periudhe prej pesë vitesh nga identifikimi i këtij të fundit.

KREU IX

INSTRUMENTET DHE MJETET E POLITIKËS SË MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 55

Ekoetiketa

1. Ministria i jep ekoetiketën, si një shenjë dalluese dhe njohjeje, personave fizikë dhe juridikë, që prodhojnë apo shpërndajnë produkte, të cilat, në krahasim me produktet apo shërbimet e barasvlershme, gjatë ciklit të jetës së tyre kanë ndikim më pak negativ dhe sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje të mjedisit, si dhe përdorim me efektshmëri më të lartë të përbërësve të tij.

Produkte të tilla, si ato ushqimore, pijet, produktet farmaceutike dhe pajisjet mjekësore profesionale apo shërbime të lidhura me to nuk janë objekt i këtij neni.

2. Vlerësimi i efekteve më pak negative, të referuara në pikën 1 të këtij neni, ka të bëjë me përdorimin racional të burimeve natyrore dhe të energjisë, reduktimin e shkarkimeve në mjedis, përdorimin e mbetjeve që kanë vlerë apo me metoda të tjera, që bëjnë të mundur shfrytëzimin e mbetjeve para asgjësimit të tyre në fushën përkatëse (landfill) dhe marrjen e masave të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

3. Prodhuesi, importuesi, shpërndarësi i një prodhimi apo shërbimi mund të kërkojë të pajiset me ekoetiketën, e cila duhet të përmbajë bashkëlidhur të gjitha dokumentet dhe provat që produkti në fjalë i përmbush kërkesat e përcaktuara.

4. Ministria mund ta heqë ekoetiketën e dhënë kur personi i referuar në pikën 3 të këtij neni nuk vepron në pajtim me kërkesat, në bazë të të cilave është dhënë etiketa, ose nuk i përmbush më kërkesat e përcaktuara për pajisjen me etiketë.

5. Ministria promovon përdorimin e produkteve dhe shërbimeve, që kanë ekoetiketën, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit të konsumatorëve, prodhuesve, tregtuesve dhe publikut.

6. Këshilli i Ministrave miraton procedurën dhe kërkesat për pajisjen me ekoetiketën, mënyrën e dhënies, përdorimit dhe vlefshmërisë së saj, përbërjen dhe funksionimin e komisionit për lëshimin e ekoetiketave, pjesëmarrjen e individëve, shoqatave dhe të autoriteteve publike në procedurën e dhënies së ekoetiketës, të referuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 56

Skema e ekomenaxhimit dhe auditimit

1. Ministria nxit përdorimin e skemës së ekomenaxhimit dhe auditimit dhe pjesëmarrjen vullnetare të organizatave, me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e performancës mjedisore të tyre dhe të palëve të tjera të interesuara.

2. Këshilli i Ministrave miraton procedurat dhe kërkesat për dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit.

Neni 57

Marrëveshjet vullnetare

1. Organizata dhe grupe, që përfaqësojnë interesa të caktuar, grupe operatorësh ose operatorë individualë, mund të lidhin marrëveshje vullnetare me autoritetet përkatëse, në mënyrë që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor.

2. Procedurat dhe kërkesat e tjera të hollësishme për zbatimin e këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.

3. Secila prej këtyre marrëveshjeve vullnetare është e detyrueshme nga çasti i nënshkrimit dhe mospërmbushja e kushteve të caktuara në të konsiderohet si një shkelje e kontratës.

Neni 58

Edukimi dhe trajnimi për mbrojtjen e mjedisit

1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe për formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë, nxitin, mbështetin dhe organizojnë edukimin dhe trajnimin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përmes sistemit arsimor, kërkimit shkencor, formave të të mësuarit, të të formuarit dhe të trajnimit gjatë gjithë jetës.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe për formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë, formulojnë udhëzimet e duhura për një

program mësimor dhe edukativ, në përputhje me përparësitë dhe objektivat e programeve strategjike kombëtare e ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

KREU X ORGANET SHTETËRORE PËR MJEDISIN

SEKSIONI 1 AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Neni 59

Organizimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj.

4. Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.

5. Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit.

Neni 60

Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione:

a) hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit;

c) kryerjen e shërbimeve të matjes së shkarkimeve në mjedis me kërkesë të ministrit;

ç) këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;

d) krijimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor;

dh) krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;

e) sigurimin e informacionit mjedisor për publikun, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ë) sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

f) sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

g) menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet.

2. Kjo agjenci kryen edhe funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm.

Neni 61

Nëpunësit dhe punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil, të parashikuara për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet ndryshe në

këtë ligj. Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është “eprori i drejtpërdrejtë”, në përputhje me këto dispozita. Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

SEKSIONI 2 INSPEKTIMI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 62

Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit

(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1, shtuar pika 3 me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

1. Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, në vijim “Inspektorati”. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ka këto funksione:

a) siguron kontrollin shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;

b) siguron përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për lejet e mjedisit;

c) përgatit programet vjetore të inspektimit dhe për sigurimin e zbatimit të tyre;

ç) siguron informimin për publikun për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) siguron informimin për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

dh) siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

e) kryen kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur. Inspektori i mjedisit mund të kryejë edhe detyra të tjera, të përcaktuara në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit;

ë) çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

2. Inspektimi për zbatimin e këtij ligji, për sa i përket tregtimit të produkteve, lëndëve të para, substancave kimike dhe paketimit të kimikateve, si dhe etiketimit të produkteve dhe informacionit që përmban paketimi, lidhur me ndikimet në mjedis, kryhet nga strukturat inspektuese përkatëse, sipas legjislacionit të posaçëm.

3. Funksionet e inspektimit ushtrohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit për inspektimin.

Neni 63

Fusha e inspektimit

Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit përfshin:

a) kontrollin dhe nxitjen e përputhjes së veprimtarive me kërkesat e legjislacionit përkatës;

b) monitorimin e ndikimit të veprimtarive mbi mjedisin për të përcaktuar nëse kërkohen veprime të mëtejshme, duke përfshirë shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit, për të siguruar përputhjen me legjislacionin përkatës;

c) kontrollin e përmbushjes të standardeve të cilësisë së mjedisit;

- ç) verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë;
- d) kontrollin dhe promovimin e përputhjes me kërkesat e lejes përkatëse të mjedisit;
- dh) verifikimin dhe vlerësimin e monitorimit të përputhjes së bërë nga operatori i veprimtarisë;
- e) vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë;
- ë) kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve përkatëse, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e tyre;
- f) kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë;
- g) kontrollin e dokumenteve të mbajtura nga operatori i veprimtarisë;
- gj) kontrollin dhe nxitjen e përputhshmërisë me marrëveshjet vullnetare.

Neni 64

Detyrimi për të siguruar përputhshmërinë

1. Inspektorati ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që, në bazë të këtij ligji, mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit.
2. Inspektorati ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që, në bazë të këtij ligji, mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në dispozitat e legjislacionit për ndërtimet, për veprimtaritë e planifikuara, për të cilat nevojitet kryerja e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Neni 65

Njoftimet për përputhshmërinë

1. Inspektorati, në rast se vlerëson se operatori ka shkelur, po shkel apo ka gjasa të shkelë kushtet e lejes përkatëse të mjedisit, i dërgon atij njoftimin për përputhshmërinë, një kopje e të cilit i dërgohet autoritetit publik, që ka dhënë lejen për ushtrimin e veprimtarisë.
2. Njoftimi për përputhshmërinë bëhet me shkrim dhe:
 - a) përshkruan çështjet që përbëjnë shkelje apo ato që tregojnë se ka gjasa që të ndodhë shkelja;
 - b) përshkruan hapat që merren nga operatori për të korrigjuar shkeljen apo për të korrigjuar çështjet që tregojnë se ka gjasa që të ndodhë shkelja;
 - c) përcakton periudhën kohore kur merren këta hapa.
3. Njoftimi për përputhshmërinë mund të përfshijë hapat që merren për të përmbushur kushtet e lejes përkatëse të mjedisit gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të veprimtarisë, si dhe hapat për korrigjimin e efekteve të ndotjes së shkaktuar nga shkelja.

Neni 66

Njoftimet për pezullimin

(Shtuar pika 5 me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

1. Inspektorati, në rast se është i mendimit që ndërtimi apo kryerja e një veprimtarie ose ndërtimi, apo kryerja e saj në një mënyrë të caktuar përbën rrezik të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit, ai i dërgon njoftimin për pezullimin e asaj veprimtarie pronarit të sendit apo operatorit të veprimtarisë, sipas rastit. Një kopje e njoftimit për pezullim i dërgohet autoritetit publik, që ka dhënë lejen për ushtrimin e veprimtarisë.
2. Njoftimi për pezullimin bëhet me shkrim dhe në të:
 - a) përcaktohet rreziku i mundshëm që ka lidhje me ndërtimin apo kryerjen e veprimtarisë;
 - b) përcaktohen hapat që merren për ta shmangur atë rrezik;
 - c) përcaktohet periudha kohore kur merren këta hapa;
 - ç) deklarohet që leja përkatëse e mjedisit apo pjesë të veçanta të saj nuk janë më të vlefshme, derisa të hiqet ky njoftim.

3. Leja përkatëse e mjedisit nuk është më, plotësisht apo pjesërisht, e vlefshme, siç është përcaktuar në njoftimin për pezullimin, në çastin që pronari i sendit apo operatori e ka marrë këtë njoftim.

4. Inspektorati mund ta revokojë njoftimin për pezullimin në çdo kohë në rast se ai vlerëson që janë marrë hapat e kërkuar nga ky njoftim për shmangien e rrezikut të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit.

5. Masa administrative e njoftimit për pezullimin e veprimtarisë, sipas këtij neni, është masë urgjente dhe mund të jepet krahas masave të tjera të nevojshme, në përputhje me ligjin për inspektimin.

SEKSIONI 3 DISPOZITA TË TJERA INSTITUCIONALE

Neni 67 **Fondi i mjedisit**

1. Për të mbështetur dhe për të nxitur veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit krijohet Fondi i Mjedisit.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për burimin e të ardhurave, mënyrën e funksionimit dhe të përdorimit të Fondit të Mjedisit.

Neni 68 **Licencimi i veprimtarive me ndikim në mjedis**

Veprimtaritë me ndikim në mjedis, të përcaktuara në këtë ligj, licencohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe përfshihen në fushën III të shtojcës së tij.

KREU XI KUNDËRVAJTJET

Neni 69 **Kundërvajtjet**

(Ndryshuar pika 2 dhe 6 me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) mosdhënia e informacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve nga operatori, sipas përcaktimit të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonese, deri në plotësimin e detyrimit;

b) mospërbushja e kërkesave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve dhe të pajisjeve që përmbajnë këto substanca, sipas përcaktimit të nenit 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonese, deri në plotësimin e detyrimit;

c) mospërbushja e kërkesave për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht, për qëllime të tjera, përveç hedhjes së tyre në treg si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, sipas përcaktimit të nenit 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonese, deri në plotësimin e detyrimit;

ç) mospërmbushja e kërkesave për ndalimin e prodhimit, të importit, hedhjes në treg dhe të përdorimit, për reduktimin e shkarkimeve, minimizimin dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm, sipas përcaktimit të nenit 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

d) mospërmbushja e kërkesave për shkarkimin e erërave të pakëndshme nga veprimtaritë e reja dhe ekzistuese, sipas përcaktimit të nenit 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

dh) mosplotësimi nga personi i autorizuar, që kryen monitorimin e mjedisit, sa më shumë të jetë e mundur, i kërkesave për minimizimin e ndërhyrjes mbi përdorimin e tokës dhe mosplotësimi, pas kryerjes së veprimtarisë, sa më shumë të jetë e mundur, i kërkesave për rikthimin e tokës në gjendjen e saj të mëparshme, sipas përcaktimit të nenit 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

e) mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për mundësinë e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për një dëm të tillë nga operatori, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 50 të këtij ligji, si dhe mosmarrja e masave të nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit në mjedis, pavarësisht nga detyrimi i tij për marrjen e masave parandaluese të dëmit në mjedis, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 50 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

ë) mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori se me gjithë masat e marra në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 6 të nenit 50 të këtij ligji, kërcënimi i drejtpërdrejtë i dëmit në mjedis nuk është shmangur, sipas përcaktimit të bërë në pikën 7 të nenit 50 të këtij ligji, pavarësisht nga detyrimi i tij për të siguruar paraprakisht fondet për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis, sipas përcaktimit të nenit 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

f) mospërmbushja e kërkesave të pikës 8 të nenit 50 të këtij ligji, nga operatori, pavarësisht nga detyrimi i tij për të rikthyer mjedisin në gjendjen e mëparshme, rehabilitimin e mjedisit, kompensimin e dëmit të shkaktuar apo për të marrë masa të tjera të përcaktuara në këtë ligj, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

g) përdorimi i ekoetiketës nga zotëruesi i saj edhe pas heqjes së saj nga ministria, sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 55 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

gj) mosplotësimi nga operatori i kërkesave të përcaktuara në njoftimin e përputhshmërisë, brenda afatit të përcaktuar në të, sipas përcaktimit të nenit 65 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në korrigjimin e mospërputhjes;

h) mosplotësimi nga pronari i sendit apo operatori i veprimtarisë i kërkesave të përcaktuara në njoftimin e pezullimit, brenda afatit të përcaktuar në të, sipas përcaktimit të nenit 66 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit.

2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 69 të këtij ligji, e ka inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit. Krahas dënimit kryesor me gjobë, inspektori ka të drejtë të vendosë edhe dënimin plotësues të sekuestrimit të pajisjes, me të cilën, sipas tij, është kryer kundërvajtja e parashikuar në këtë ligj.

3. Pavarësisht nga dënimi i parashikuar në shkronjat “k” dhe “l” të pikës 1 të këtij neni, ministri, me propozimin e inspektoratit, mund të pezullojë apo të revokojë lejen përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj dhe për këtë njofton Qendrën Kombëtare të Licencimit.

4. Në rastin e kundërvajtjeve serioze në këtë ligj, apo kur personi nuk ka paguar gjobën e vendosur sipas këtij ligji, inspektorati ka të drejtë të vërë nën sekuestrim pronën, me të cilën është kryer kundërvajtja.

5. Inspektorati mund të ndërmarrë sanksionet e parashikuara në këtë nen në çdo kohë, por jo më vonë se dy vite kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, sikurse parashikohet dhe në nenin 46 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

6. Inspektori shqyrton, merr vendimin përfundimtar dhe bën dokumentimin e tij në përputhje me ligjin për inspektimin.

7. Gjopa paguhet brenda periudhës së përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

8. Ministri, me propozimin e inspektoratit, në rastet kur gjopa nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, pezullon lejen përkatëse mjedisore deri në pagesën e gjobës.

9. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit apo revokimit të lejes së mjedisit, ka të drejtën e ankimit tek titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

11. Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e shmang subjektin përkatës nga detyrime të tjera të përcaktuara në këtë ligj, si dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU XII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 70

Propozimi i akteve nënligjore

1. Ministri propozon aktet nënligjore, që miratohen nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave dhe/apo ministri miratojnë aktet nënligjore, sipas përcaktimit dhe në zbatim të këtij ligji, brenda një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 21 pika 4, 26 pika 2, 27 pika 4, 31 pika 5, 32 pika 4, 35, 36 pika 3, 37 pika 2, 39 pika 2, 41 pika 2, 42 pika 2, 45 pika 3, 47 pika 2, 49, 50 pika 3, 53 pika 2, 55 pika 6, 56 pika 2, 57 pika 2, 59 pika 4, 61 pika 1 dhe 67 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 50 pika 4 të këtij ligji.

Neni 72

Vazhdimi i efekteve juridike për aktet nënligjore

1. Vendimi nr.860, datë 20.12.2006, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë, të qëndrueshëm”, miratuar në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 37 të këtij ligji.

2. Vendimi nr.847, datë 29.11.2007, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të mjedisit”, miratuar në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 21 të këtij ligji.

3. Vendimi nr. 543, datë 23.6.2005, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese”, miratuar në zbatim të nenit 17 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 35 të këtij ligji.

4. Vendimi nr.1189, datë 18.11.2009, i Këshillit të Ministrave “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, miratuar në zbatim të nenit 53 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 41 të këtij ligji.

Neni 73

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim sa parashikohet në pikat 2 deri në 7 të këtij neni.

2. Pa rënë ndesh me nenin 24 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon Vlerësimit Strategjik Mjedisor deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

3. Pa rënë ndesh me nenin 25 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon vlerësimit të ndikimit në mjedis deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

4. Pa rënë ndesh me nenin 29 të këtij ligji, nenet 34, 36-46 dhe 51/1 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, për lejen, autorizimin dhe pëlqimin mjedisor, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

5. Pa rënë ndesh me nenin 30 të këtij ligji, neni 49 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, për parandalimin e aksidenteve industriale, vazhdon të ketë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tij me ligj të posaçëm.

6. Pa rënë ndesh me nenin 33 të këtij ligji, nenet 20-24 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, për menaxhimin e mbetjeve, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

7. Pa rënë ndesh me nenin 34 të këtij ligji, nenet 20 dhe 23 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, për importimin dhe transitin e lëndëve të rrezikshme, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

Neni 74

Dispozita kalimtare

Funksionet e dhëna nga ky ligj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe, në mënyrë të veçantë, ato të përcaktuara në nenin 60 të tij të kryhen nga ministria, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 75

Ky ligj hyn në fuqi 18 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7033, datë 29.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 9385, datë 4.5.2005

PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR²⁸

(ndryshuar me ligjet: nr.9533, datë 15.5.2006, nr. 9791, datë 23.7.2007 (botuar në fletoren zyrtare nr. 103), nr.9989, datë 15.9.2008 (botuar në fletoren zyrtare nr. 150) nr.10 137, datë 11.5.2009 (botuar në fletoren zyrtare nr. 86), nr.15/2012, datë 16.2.2012 (botuar në fletoren zyrtare nr. 18), nr. 36/2013, datë 14.2.2013 (botuar në fletoren zyrtare nr. 30) dhe nr. 48/2016, datë 5.5.2016, (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(shtuar pika 3, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, organeve të pushtetit vendor, organizatave jofitimprurëse, pronarëve privatë dhe të biznesit, për ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, të tokës pyjore dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre.

2. Ky ligj rregullon edhe veprimtaritë mbrojtëse, shoqërore, ekoturistike dhe ekonomike që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar dhe në burimet e tjera pyjore e jopyjore, në bazë të parimeve të mbarështimit të qëndrueshëm e shumëfunksional, të pasqyruara në strategjinë dhe politikat e zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, si dhe skemën e organizimit e të funksionimit të administratës së Shërbimit Pyjor Shqiptar, marrëdhëniet juridike, përgjegjësitë dhe detyrat e tij, për krijimin e një shërbimi pyjor të qëndrueshëm dhe profesional.

3. Nuk janë objekt i këtij ligji zonat e mbrojtura, fauna e egër, si dhe bimët mjekësore eterovajore e tanifere natyrore, të cilat rregullohen sipas legjislacionit të perkatës në fuqi.

²⁸ Ligji nr.9533, datë 15.5.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, datë 8 qershor 2006.
Ligji nr. 9791, datë 23.7.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 6 gusht 2007.
Ligji nr.9989, datë 15.9.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 150, datë 3 tetor 2008.
Ligji nr.10 137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 12 qershor 2009.
Ligji nr.15/2012, datë 16.2.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 14 mars 2012.
Ligji nr. 36/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 12 mars 2012.
Ligj nr. 48/2016, datë 5.5.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84, datë 19 maj 2016.

Neni 2

Përkufizime dhe fushat e veprimit

(shtuar një paragraf në pikën 21 dhe shtuar pikat 31, 32 dhe 33, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 10, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Burime pyjore" është tërësia e elementeve natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlerë të konsiderueshme, të përdorshme për nevojat e njeriut. Në ekonominë pyjore si burime natyrore përfshihen edhe toka, uji, bimësia jopyjore, e shumëllojshme, ato të natyrës jo të gjallë dhe gjallesat e egra.

2. "Dëmtim i pyjeve dhe i mjedisit pyjor" është prishja e karakteristikave fiziko-kimike e strukturore të ekosistemit pyjor, ulja e prodhimtarisë biologjike dhe e shumëllojshmërisë së ekosistemeve përbërëse të fondit pyjor kombëtar.

3. "Drurë apo grupe drurësh pyjorë" janë drurët pyjorë të veçantë, kudo që ndodhen, një sipërfaqe me drurë pyjorë prej 0,05 hektarësh, brezat mbrojtës, parqet urbane, grupet e drurëve të mbjellë në parcela të vogla dhe që përdoren për kullotë.

4. "Ekonomi pyjore" është sipërfaqja pyjore e ndarë në ngastra e nënngastra, si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit të pyllit dhe që plotëson parimin e vazhdimësisë së prodhimit pyjor.

5. "Ekosistem" është një kompleks dinamik komunitetesh: bimë, kafshë, mikrobe dhe mjedisi jo i gjallë, që ndërveprojnë si njësi funksionale.

6. "Fidanishte pyjore" është një sipërfaqe toke, e destinuar për të rritur e prodhuar, për një periudhë të caktuar kohe, fidanë të llojeve e madhësive të ndryshme, me prejardhje nga farërat, kalemrat, copat, rrënjët, shpatullat e zhardhokët.

7. "Fond pyjor" janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

8. "Grumbull pyjor" është një sipërfaqe pyjore, homogjene nga pikëpamja e përbërjes së llojeve, moshës, klasës së prodhimit, dendësisë, kushteve mjedisore dhe mënyrës së trajtimit silvikulturor.

9. "Infrastrukturë pyjore" janë zyrat, ndërtesat, magazinat, depot, rrjeti rrugor pyjor, teleferikët, makinat, motorët, radiot e antenat e radiokomunikimit, pritrat, pendat, lerat, koritat, çekmat, rrethimet e gardhimet, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese, ato të mbarështimit pyjor, si dhe lehtësitë e tjera të ngritura në fondin pyjor shtetëror për informimin dhe pritjen e vizitorëve.

10. "Inspektor i Policisë Pyjore" është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur, i pajisur me kartë identifikimi, që ka atributet e njohura me këtë ligj, i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet, i cili ka për detyrë zbatimin e ligjit, administrimin, mbrojtjen, parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarive kriminale dhe mbikëqyrjen e fondit pyjor kombëtar.

11. "Kadastra e pyjeve" është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

12. "Mbarështim pyjor" është planifikimi afatmesëm e afatgjatë, në nivel ekonomie pyjore apo të pellgut ujëmbledhës, i cili siguron përmbushjen e kërkesave për ruajtjen e pyllit, duke mbajtur parasysh aspektet ekologjike, ekonomike e shoqërore. Këtu përfshihen mbledhja e të dhënave, përcaktimi i objektivave, i masave për çdo njësi mbarështimi apo për të gjithë ekonominë dhe kontrollin e vazhdueshëm të rezultateve.

13. "Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

14. "Ndotja e pyjeve dhe e mjedisit pyjor" është ndryshimi i cilësisë së tyre, si rrjedhojë e krijimit dhe e futjes së faktorëve fizikë, kimikë apo biologjikë, të burimeve natyrore a njerëzore, nga brenda ose jashtë vendit.

15. "Nëngastër" është një njësi sipërfaqeje me madhësi minimale 0,5 ha, që shërben për vlerësimin e grumbujve pyjorë, planifikimin dhe kontrollin e trajtimeve të njëjta silvikulturore.

16. "Ngastër" është ndarja e sipërfaqes së ekonomisë pyjore në parcela, të cilat shërbejnë si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit të pyllit.

17. "Plan mbarështimi" është një dokument bazë për mbarështimin e pyjeve, i hartuar sipas njësisë të ekonomisë pyjore, me punime terreni e zyre, për njohjen dhe marrjen e të dhënave për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj., si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura, të nevojshme silvikulturore.

18. "Prerje kulturore" është tërësia e punimeve të seleksionimit dhe të rrallimit, pastrimit, çlirimit etj., që zbatohen periodikisht në një grumbull pyjor, nga çasti i krijimit të gjendjes së masivit e deri në moshën e shfrytëzimit, për përmirësimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së prodhimit.

19. "Pronë pyjore" është një sipërfaqe e fondit pyjor, me madhësi të ndryshme, bashkë me infrastrukturën përkatëse, e cila është pronë publike, që zotërohet nga pushteti qendror apo vendor, ose pronë private.

20. "Pyje mbrojtëse" janë pyjet e përcaktuara kryesisht për qëllime mbrojtëse të vetë pyllit, të tokës pyjore dhe të tokave, që shtrihen përreth zonave urbane, pellgjeve ujëmbledhëse, për të luftuar a parandaluar dukuritë e gërryerjes, të ndikimit të erërave, çrregullimeve në rrjedhjet ose burimet ujore dhe sigurimin e funksioneve ekologjike.

21. "Pyll" është sipërfaqja e tokës me një grup të dendur drurësh pyjorë, në formë të qëndrueshme ose me bimësi tjetër të rrallë pyjore, me sipërfaqe më të madhe se një dynym e me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 për qind, që prodhon masë drusore, ushtron ndikim në mjedisin rrethues dhe që siguron funksionet e pyllit.

Për zbatimin e Protokollit të Kiotos pyll vlerësohet edhe sipërfaqja e tokës me një grup të dendur drurësh pyjorë, me sipërfaqe më të madhe se 0,1 ha, me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 për qind dhe me potencial për të arritur lartësi më të madhe se 3 metra, kur pylli ka arritur maturinë në kushte in-situ.

22. "Qeverisje e pyjeve" është tërësia e ligjësisë dhe biologjia e bashkësisë së jetës së pyllit e të tokës pyjore, përcaktimi i qartë i politikave dhe i masave, me të cilat do të ndërhyhet në strukturën funksionale të tyre, për të siguruar rritjen e frytshmërisë teknikoekonomike.

23. "Rrugë pyjore" janë rrugët me parametra të ndryshme nga ato të rrugëve vendore dhe kombëtare, për qarkullimin e automjeteve dhe të mjeteve të tjera, që shërbejnë për transportin e lëndës drusore, të prodhimeve të tjera me origjinë jodrusore, për kryerjen e punimeve të ndryshme dhe lidhjen e sipërfaqes pyjore me rrjetin e rrugëve vendore e kombëtare.

24. "Shfrytëzim i pyjeve" janë ndërhyrja dhe trajtimet silvikulturore në jetën e pyllit, vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera, përpunimi dhe transporti i tyre në moshën e shfrytëzueshmërisë dhe kur është siguruar ripërtëritja natyrore.

25. "Shitja e drurit në këmbë" është operacioni i vlerësimit dhe i shitjes së drurëve të paprërë apo të parrëzuar.

26. "Shkurre" është bimësia drusore, me kërcenj të degëzuar nga baza dhe jo shumë të lartë, që dallohet nga bimësia barishtore prej strukturës drusore, ndërsa nga pylli prej trungut të shkurtër dhe mungesës së trungut kryesor.

27. "Silvikulturë" është shkenca që merret me studimin e ligjësive të jetës dhe të zhvillimit të ekosistemeve pyjore, me përcaktimin e metodave dhe të teknikave të trajtimit të tyre, që synojnë rritjen dhe vazhdimësinë e prodhimit pyjor.

28. "Toka pyjore" janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30 për qind, sipërfaqet e zhveshura, çeltirat, vendet shkëmbore, tokat e

gërryera e joprodhuese, ranishtet, rrugët pyjore, të pakadastruara në fondet e tjera të tokës bujqësore dhe të lidhura ekologjikisht e në mënyrë funksionale me fondin pyjor kombëtar që, të gjitha së bashku, sigurojnë funksionet e pyllit.

29. "Trajtim i pyjeve" janë operacionet silvikulturore, të cilat kanë si qëllim kryesor zhvillimin, vjeljen e prodhimeve pyjore dhe sigurimin e ripërtëritjes natyrore të një pylli, brenda mundësive të një forme të caktuar qeverisjeje.

30. "Veprimtari pyjore" janë të gjitha veprimtaritë mbrojtëse, menaxhuese e qeverisëse, ekonomike e tregtare, të vjeljes së materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore, veprimtaritë çlodhëse, turistike, sportive e argëtuese, si dhe ato kërkimore e shkencore, që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar.

31. "Ministria" është ministria përgjegjëse për pyjet.

32. "Ministër" është ministri përgjegjës për pyjet.

33. "Pyll komunal" është pylli në pronësi apo në përdorim të organeve të qeverisjes vendore.

KREU II

POLITIKAT, PROGRAMET E ZHVILLIMIT DHE PLANET E MBARËSHTIMIT PYJOR

Neni 3

Këshilli i politikave pyjore

1. Politikat sektorale synojnë zbatimin e kërkesave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për pyjet, kullotat dhe burimet e tjera, pyjore e natyrore, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Për hartimin e politikave dhe të strategjive të zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe të kullotave në Republikën e Shqipërisë ngrihet Këshilli i Politikave të Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, i cili funksionon si organ ndërmisor.

Përbërja, funksionet, përgjegjësitë, të drejtat dhe organizimi i brendshëm i këtij këshilli caktohen me urdhër të Kryeministrit.

Neni 4

Programet e zhvillimit

(ndryshuar pika 4, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Qeverisja e fondit pyjor kombëtar mbështetet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm e shumëfunksional të pyjeve e kullotave, të përfshira në strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, në programin kombëtar dhe në planet afatgjata të veprimit.

2. Programi i zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe kullotave përcaktohet nga politika e mbarështimit pyjor, për ruajtjen, zhvillimin e fondit pyjor kombëtar, për sigurimin e kushteve për përdorimin dhe shfrytëzimin e tij edhe për qëllime publike.

3. Programi i zhvillimit të sektorit të pyjeve përshtatet dhe plotësohet, në përputhje me ndryshimet e gjendjes shoqërore e ekonomike të vendit dhe me ndryshimin e kushteve të mbarështimit pyjor.

4. Ministria, në bashkëpunim me bashkitë, harton dhe përpunon programin e zhvillimit të sektorit të pyjeve, i cili miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 5

Planet e mbarështimit

*(ndryshuar pika 4 dhe shtuar pikat 5 e 6, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007,
ndryshuar pika 3, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)*

1. Qeverisja teknike e sektorit të pyjeve dhe të kullotave bëhet sipas planeve të mbarështimit.
2. Planet e mbarështimit pyjor duhet të sigurojnë masat për:
 - a) zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar, ruajtjen dhe krijimin e kushteve natyrore për gjallesat pyjore dhe komunitetet e tyre;
 - b) mbrojtjen, trajtimin dhe kryerjen e punimeve silvikulturore e të punimeve të tjera, të cilat kanë për qëllim sigurimin e funksioneve ekologjike dhe shoqërore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, vjeljen e prodhimeve pyjore dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, duke siguruar vazhdimësinë e prodhimeve pyjore, të burimeve të tjera dhe të gjeneratës së re të masivit pyjor;
 - c) mbarështimin e pyllit dhe të tokës pyjore, për të ruajtur funksionet e tyre, shkallën e ruajtjes së mjedisit pyjor dhe të ripërtëritjes natyrore;
 - ç) përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore e natyrore të ngastrave e ekonomive pyjore, në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të gjallesave pyjore dhe të komuniteteve të tyre.
3. Për të siguruar asistencë të kualifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit, të ekspertizave, të projekteve operationale dhe zbatimin e tyre në fondin pyjor, ministri certifikon ekspertë, të certifikuar në këtë fushë. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, ato i nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat. Këshilli i Ministrave miraton kriteret, rregullat dhe procedurat për certifikimin e ekspertëve dhe licencimin në fushën e fondit pyjor.
4. Plani i mbarështimit të pyjeve shtetërore shqyrtohet nga komisioni teknik pranë Drejtorisë së Politikave Pyjore, i ngritur me urdhër të ministrit. Plani miratohet nga ministri.
5. Planet e mbarështimit të pyjeve komunale dhe private hartohen nga subjekte të licencuara dhe miratohen, sipas rastit, nga këshilli i komunës/bashkisë, në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor.
6. Mënyra e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve, e cila zbatohet për të gjitha format e pronësisë së pyllit, caktohet me udhëzim të ministrit.

KREU III SHËRBIMI PYJOR

Neni 6

Funksionimi i shërbimit pyjor

(shtuar pika 3, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Shërbimi pyjor funksionon në mbështetje të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, të nxjerra nga organet përkatëse, të ngarkuara për zbatimin e ligjit.
2. Shërbimi pyjor ka këto funksione:
 - a) menaxhuese;
 - b) kontrolluese.
3. Funksioni kontrollues ushtrohet nga Policia Pyjore, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Organizimi i shërbimit pyjor

(ndryshuar pikat 2 dhe 3, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 1, 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar pikat 2, 3, dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Shërbimi pyjor organizohet e vepron sipas parimeve të profesionalizmit, pavarësisë, transparencës, shërbimeve ndaj publikut, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

2. Shërbimi pyjor organizohet si më poshtë:

- a) ministria përgjegjëse për pyjet, si organ qendror politikëbërës;
- b) strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki;
- c) Policia Pyjore, pjesë e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet.

3. Strukturat dhe organikat e shërbimit pyjor në ministrinë përgjegjëse për pyjet dhe Policisë Pyjore miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

3/1. Bashkia ngre strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullor brenda kufijve territorialë administrativë, me personel inxhiniero-teknik me arsim pyjor. Raporti midis një nëpunësi të bashkisë me sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullor që ai mbulon është jo më pak se një nëpunës për:

- a) 750–1 000 ha, për pyjet e larta;
- b) 1 500–2 500 ha, për pyjet e ulëta dhe shkurret;
- c) 4 000–6 000 ha, për kullota dhe livadhe.

4. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit shtetëror të ministrisë që mbulon fushën e mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujërave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 8

Bordi Këshillimor i Pyjeve

(shfuqizuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Neni 9

Strukturat e shërbimit pyjor

(ndryshuar pikat 1 dhe 2, me ligjin nr.9533, datë 15.5.2006, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Ministria përgjegjëse për pyjet është organi më i lartë politikëbërës në fushën e pyjeve dhe përgjigjet për hartimin e legjislacionit përkatës të pyjeve, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor kombëtar.

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkive janë organi administrativ i shërbimit pyjor dhe përgjigjen për sigurimin e mbrojtjes, për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullor brenda territorit administrativ të bashkisë.

3. Punonjësit e shërbimit pyjor pajisen me uniformë (me shenja dalluese), me dokument identifikimi, me armatim, me tabela të ndalimit të automjeteve dhe me mjete të tjera teknike, të domosdoshme e të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve e të mjeteve të tjera caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Ministria përgjegjëse për pyjet (ndryshuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Ministria përgjegjëse për pyjet është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, si dhe miratimin e planeve të menaxhimit për fondin pyjor kombëtar.

2. Ministria përgjegjëse për pyjet:

2.1. Është organ i specializuar politikëbërës, me attribute teknike, menaxhuese, kontrolluese e këshillimore.

2.2. Siguron/ofron mbështetje teknike në fondin pyjor kombëtar dhe ka këto detyra:

- a) qeverisjen politike të pyjeve dhe të tokave pyjore;
- b) mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e pyjeve publike dhe private;
- c) ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor kombëtar;
- ç) mbajtjen dhe administrimin e të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit pyjor, të kadastrës pyjore, të projekteve, të financës, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, të të dhënave bazë për tërësinë e fondit pyjor e kullësor dhe të tokave pyjore, si dhe të punimeve e përgjithësimeve statistikore;
- d) ndjekjen e zbatimit të planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit të pyjeve, të kullotave, të florës e të faunës së egër, si dhe të shmangies së sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve;
- dh) ndjekjen, bashkëpunimin, harmonizimin dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore në pyje e kullota;
- e) ndjekjen e përpunimit të metodologjive për mbledhjen e të dhënave të zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, përpunimin e këtyre të dhënave dhe përgatitjen e informacionit për publikun;
- ë) sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;
- f) kontrollin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota, pavarësisht nga burimi i financimit.

Neni 11

Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki (ndryshuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki është organ i specializuar i këtij shërbimi në nivel vendor, me attribute teknike, menaxhuese e këshillimore, në përbërje të bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki kryen shërbime teknike e publike në fondin pyjor vendor dhe ka këto detyra:

- a) qeverisjen tërësore të pyjeve dhe të tokave pyjore;
- b) mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e pyjeve publike dhe private;
- c) ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor;
- ç) mbajtjen dhe administrimin e të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit të fondit pyjor privat brenda njësisë administrative të bashkisë;
- d) të mbajë të dhëna të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në pyjet e kullotat e bashkisë;
- dh) përgatitjen e projekteve për investimet në pyje e kullota;
- e) drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;
- ë) ndjekjen, bashkëpunimin, harmonizimin dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore në pyje e kullota;
- f) mbikëqyrjen e zhvillimit të florës e faunës së egër dhe propozimin e metodave për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik;

- g) sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;
- gj) organizimin e trajnimeve dhe të shërbimeve këshillimore për pronarët privatë;
- h) kontrollin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota, pavarësisht nga burimi i financimit;
- i) mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor bashkiak;
- j) hartimin dhe zbatimin e një programi për trajnimin e punonjësve të shërbimit pyjor dhe aftësimin e tyre profesional;
- k) mbështetjen e zhvillimit të agropylltarisë në bashki.

Neni 12

Funksioni dhe detyrat e Policisë Pyjore

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Policia Pyjore është organ i specializuar i shërbimit pyjor, me funksione kontrolluese. Struktura e Policisë Pyjore, gjatë kryerjes së shërbimit, përfiton status të njëjtë me atë të Policisë së Shtetit.

2. Policia Pyjore kryen këto detyra:

a) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, si dhe propozon heqjen e licencave kur subjektet veprojnë në kundërshtim me këto dispozita;

b) parandalon, zbulon dhe lufton dëmtimin, pushtimin, shpërdorimin, tjetërsimin, shkretimin dhe degradimin e pyjeve e të tokës pyjore, cenimin nga ndërhyrjet e pakontrolluara në fondin pyjor dhe në mjedisin natyror;

c) organizon punën për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;

ç) parandalon dhe merr masa në rastet e shfrytëzimit dhe të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jopyjore, të krimit në sektorin e pyjeve, kullotave, zonat e mbrojtura e pyjet me funksion të veçantë, të florës e faunës së egër, të bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore e tanifere natyrore, të prodhimeve pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, si dhe çdo veprimtari tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj;

d) kontrollon veprimtaritë e subjekteve që grumbullojnë, përpunojnë dhe tregtojnë prodhimet e përftuara nga shfrytëzimi i pyjeve (trupa, lëndë ndërtimi, shtylla miniere, degë voze, dru zjarri, qymyr druri etj.) dhe prodhimet gjysmë të përpunuara (dërrasë, elemente etj.) në qendrat e përpunimit (gatrat, sharrat, cirkulet etj.) në magazinat dhe sheshet e depozitimit;

dh) bllokun veprimtarinë e ushtruar nga çdo person fizik a juridik, që nuk shlyen detyrimet ligjore në afatet e caktuara dhe/ose që nuk respekton kushtet e kontratave;

e) mbron dhe mbështet veprimtarinë e administratës menaxhuese të shërbimit pyjor;

ë) kryen, në bashkëpunim me organet e Policisë së Shtetit, organet tatimore, doganore e financiare, të Policisë së Ndërtimit dhe me organet e qeverisjes vendore, veprimtaritë dhe funksionet që parashikohen nga ligje të tjera;

f) kontrollon zbatimin e punimeve që kryhen sipas projekteve në pyje, kullota, rezervate të gjuetisë dhe zona të mbrojtura;

g) ndërpret të gjitha punimet, që nuk janë në përputhje me projektet e hartuara e të parashikuara në kontratat e nënshkruara;

gj) kontrollon e mbikëqyr mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit nga subjektet private e publike, juridike ose fizike, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar;

h) kontrollon zbatimin e rregullave të sigurisë dhe të shëndetit të punëtorëve, që punojnë në pyje;

i) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për përdorimin dhe vjeljen e prodhimeve pyjore nga burimet pyjore e jopyjore, në pronësi apo në përdorim të bashkive ose në pronësi private.

3. Inspektorët e Policisë Pyjore kanë të gjitha të drejtat për të hyrë, kontrolluar, inspektuar dhe për të marrë masat përkatëse të procedimit, si dhe të bllokimit apo sekuestrimit, në rastet e shkeljes së ligjit. Inspektorët e Policisë Pyjore gjatë kryerjes së detyrës gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore.

KREU IV FUNKSIONET E PYLLIT, PËRBËRJA E PRONËSIA E FONDIT PYJOR KOMBËTAR DHE KADASTRA

Neni 13

Funksionet e pyllit

(shtuar një paragraf, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Funksionet e pyllit janë:

a) ekonomike, që kanë të bëjnë me prodhimin e materialit drusor dhe jodrusor, të bimëve mjekësore, aromatike e eterovajore, si dhe me habitatet e shpendëve dhe të kafshëve të egra apo me prodhime të tjera natyrore të fondit pyjor kombëtar;

b) ekologjike, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e florës dhe faunës së egër, të ruajtjes së burimeve gjenetike, hidrologjike, kundër gërryerjes e biotipike dhe me mbrojtjen e parcelave pyjore eksperimentale;

c) publike, që kanë të bëjnë me veprimtaritë mbrojtëse, argëtuese, çlodhëse, sportive, turistike, edukative, higjieno-sanitare, estetike apo kërkimore e shkencore.

Pyjet janë edhe objekt i sekuestrimit të karbonit. Ministria është organi përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Protokollit të Kiotos. Karboni i sekuestruar llogaritet dhe tregtohet, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Protokollin e Kiotos, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 14

Përbërja e fondit pyjor kombëtar

Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga këto formacione bimore e jobimore:

a) pyjet dhe drurët pyjorë;

b) shkurret;

c) sipërfaqet e zëna nga brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve;

ç) bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore;

d) tokat pyjore, bujqësore (të dhëna në përdorim ose në pronësi të organeve të shërbimit pyjor), liqenet natyrore, tokat e lagëta dhe lagunat (për mbarështimin dhe zhvillimin e faunës së egër, pasuri kombëtare, dhe që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me fondin pyjor);

dh) sipërfaqet e zhveshura si çeltirat, shkëmbinjtë, dunat e ranishtet, që ndodhen në sipërfaqen pyjore dhe pranë tyre (jo më larg se 500 m), por që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me të;

e) infrastruktura rrugore e komunikimit me të gjitha elementet bashkëshoqëruese, pritësit e pendat, lerat, koritat, çezmat, rrethimet apo gardhimet në zonat e mbrojtura, në pyjet me funksion të veçantë, në rezervatat e gjuetisë, si dhe lehtësitë e krijuara e të ngritura për personelin e shërbimit pyjor dhe për pritjen e vizitorëve në to;

ë) ndërtesat, zyrat, magazinat, depot, stacionet pyjore, qendrat e informimit dhe të pritjes së vizitorëve, ujësjellësat, linjat elektrike e telefonike (të ndërtuara nga shërbimi pyjor apo të dhëna në pronësi të tyre), makinat, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese dhe ato të mbarështimit pyjor.

Neni 15

Pronësia e fondit pyjor kombëtar

(shtuar pika 5, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007 dhe me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Fondi pyjor kombëtar, sipas pronësisë, ndahet në:
 - a) fond pyjor në pronësi publike;
 - b) fond pyjor në pronësi private.
2. Shfuqizuar.
3. Fondi pyjor publik ndahet në:
 - a) pyje e toka pyjore në pronësi të bashkisë brenda territorit administrativ ku ato ndodhen;
 - b) zona të mbrojtura, në pronësi të ministrisë përgjegjëse për pyjet.
4. Fondi pyjor privat përbëhet nga:
 - a) pyje dhe toka pyjore në pronësi private;
 - b) drurë dhe grupe drurësh, që ndodhen brenda kufijve të tokave në pronësi private, pyje të reja, të cilat krijohen në këto toka, dhe pjesët e fondit pyjor pronësi private.
5. Kuotat e karbonit, në procesin e sekuestrimit të tij, u përkasin pronarëve, sipas pronësisë që kanë mbi fondin pyjor.

Neni 16

Kadastra Kombëtare e Fondit Pyjor

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Fondi pyjor kombëtar dhe infrastruktura integrale e tij regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë referuar pronësisë së përcaktuar në pikën 3 të nenit 15 të ligjit.
2. Fondi pyjor publik organizohet e trajtohet sipas ekonomive pyjore ose pellgjeve ujëmbledhëse.
3. Kriteret për krijimin dhe organizimin e masiveve pyjore ose të pellgjeve ujëmbledhëse, si njësi prodhimi, për sigurimin e vazhdimësisë së procesit të prodhimit pyjor në nivel rajoni, përcaktohen nga ministria përgjegjëse për pyjet.
4. Fondi pyjor kombëtar trajtohet në përputhje me planet e mbarështimit dhe të inventarizimit.
5. Inventarizimi i pyjeve kryhet për një periudhë jo më pak se 10 vjet, sipas kriterëve e udhëzimeve të përcaktuara me urdhër të ministri përgjegjës për pyjet.
6. Të dhënat e kadastrës së fondit pyjor pasqyrohen çdo vit nga strukturat në varësi të ministrisë përgjegjëse për pyjet, nëpërmjet programeve e sistemeve kompjuterike, duke krijuar bazën e të dhënave në shkallë vendi, qarku dhe sipas ekonomive pyjore apo pellgjeve ujëmbledhëse.
7. Kadastra Kombëtare e Fondit Pyjor është një regjistër zyrtar, ku shënohen të dhënat përkatëse për mënyrën e qeverisjes dhe ndryshimet periodike të fondit pyjor e kullosor.
8. Rregullat e hollësishme për krijimin dhe mbajtjen e Kadastrës Kombëtare të Fondit Pyjor, për regjistrimin, përditësimin dhe ndryshimet në gjendjen e tij, miratohen nga ministri përgjegjës për pyjet.

Neni 17

Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 1 dhe shtuar pikat 1/1 dhe 1/2 me ligjin nr. 15/2012, datë 16.2.2012)

1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t'u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të

shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

- a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit;
- b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë.

1/1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar. Ndryshimi i formës së përdorimit të fondit pyjor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, pavarësisht madhësisë së sipërfaqes, bëhet vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata.

1/2. Kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisje vendore, në fond pyjor, (pyll), dhe regjistrimi në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore. Kërkesa paraqitet pranë ministrisë veprimtaria e së cilës mbulon pyjet, dhe miratohet nga ministri përkatës.

2. Rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kufijtë e fondit pyjor kombëtar janë të përhershëm, të përcaktuar qartë dhe të shënuar në terren, të hedhur në hartë me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja e vazhdueshme e tyre, për të realizuar mbrojtjen e frytshme nga degradimi, tjetërsimi, pushtimi dhe shkretimi.

Neni 18

Ndryshime në Kadastrën Kombëtare të Fondit Pyjor

1. Pronari duhet të marrë miratimin e organeve të shërbimit pyjor përpara ndryshimeve (rritjen ose zvogëlimin e sipërfaqes dhe të vëllimit, ripyllëzimin) në fondin pyjor dhe në tokën pyjore që zotëron.

2. Kur në fondin pyjor ose tokën pyjore, nga KRRTRSH-ja miratohen studime urbanistike për zhvillime turistike, ministria përgjegjëse për pyjet pasi merr dijeni, bën shënimin përkatës në kadastrën e pyjeve.

3. Pronarët e fondit pyjor dhe të tokës pyjore, brenda 6 muajve nga data e konstatimit, kanë detyrimin që, për ndryshimet e bëra në fondin pyjor të njoftojnë struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe kjo e fundit zyrën kadastrale të ministria përgjegjëse për pyjet, për të bërë përditësimin në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve, ndërsa për ndryshimet e ndodhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të papërditësuar, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit njofton drejtorinë përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet për miratimin e veprimtarive në fushën e turizmit, të cilat zhvillohen në fondin pyjor, në përputhje me ligjin “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

Me miratimin e lejes së ndërtimit për zhvillime turistike në sipërfaqet e fondit pyjor apo të tokës pyjore, këshilli i rregullimit të territorit të bashkisë njofton shërbimin pyjor për të bërë përditësimin në kadastrën e pyjeve.

Neni 19

Dhënia në përdorim e fondit pyjor kombëtar

(ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar paragrafi i tretë i pikës 1, me ligjin nr.9989, datë 15.9.2008, shtuar pika 1/1, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar dhe të pyjeve e tokave pyjore mund të jepen në përdorim për punë kërkimore e studimore, për mbarështim të florës dhe faunës së egër e për gjueti, për baza didaktike apo eksperimentale, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike.

Pjesë jopyjore të fondit pyjor kombëtar mund të jepen në përdorim për veprimtari biznesi dhe për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, gjeologjike e minerare, për gurore e kariera, pa cenuar vlerat dhe funksionet e tyre.

Ministri miraton dhe shpall listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari, ndërsa për pyjet komunale, listën e shpallin bashkitë.

1/1. Dhënia në përdorim, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshihet në kategorinë III.4, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra sipas ndarjes në nënkategori.

2. Plotësimi i nevojave të banorëve të komunave me lëndë dhe dru zjarri, për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë e për kullotje, si dhe për grumbullimin e prodhimeve drusore e jodrusore bëhet nga pyjet komunale. Për komunat, që nuk kanë pyje komunale, këto nevoja mund të plotësohen nga pyjet shtetërore, sipas rregullave dhe procedurave të udhëzimit, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit pyjor bashkiak bëhet në bazë të kontratave, të nënshkruara nga kryetari i bashkisë. Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton, për sipërfaqen e fondit pyjor, objekt kontrate, studime urbanistike. Rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar caktohen me udhëzim të ministrit.

4. Kur në sipërfaqet e fondit pyjor ose toka pyjore realizohen studime urbanistike për zhvillime turistike, me miratimin e studimit urbanistik nga KRRTRSH-ja, në këto sipërfaqe zbatohen dispozitat e ligjit “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

KREU V

RUAJTJA DHE ADMINISTRIMI I FONDIT PYJOR KOMBËTAR

Neni 20

Ruajtja e fondit pyjor kombëtar

1. Republika e Shqipërisë zbaton parimet dhe normat e konventave, të marrëveshjeve e traktateve ndërkombëtare, në të cilat është palë, si dhe merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare për pyjet.

2. Ruajtja e pyjeve dhe e mjedisit pyjor nga ndotja dhe dëmtimi me lëndë të gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme, që krijohen ose shkarkohen nga objekte a veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, shoqërore e kulturore, ushtarake, të transportit ose nga veprimtari të tjera, që cenojnë ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore ose dëmtojnë të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, të pushtetit vendor dhe për personat fizikë a juridikë, vendas e të huaj.

3. Personat fizikë a juridikë, që kanë në pronësi, në administrim ose në përdorim pyje, grumbuj drurësh ose dru pyjorë, brenda ose jashtë fondit pyjor kombëtar, janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e tyre.

4. Mbrojtja dhe miradministrimi i fondit pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, nga dëmtimi, prerjet ose kullotjet pa leje, sëmundjet dhe insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi janë detyrë e përhershme e organeve të shërbimit pyjor dhe e organeve të qeverisjes vendore, pronarëve, subjekteve që kryejnë veprimtari në këtë fond dhe, sipas rastit, edhe të strukturave të tjera shtetërore (Policia e Shtetit, ajo financiare, doganore, e ndërtimit), të ngarkuara me ligje të tjera.

5. Strukturat e organeve të shërbimit pyjor përgatisin skemën për monitorimin afatgjatë të kushteve të pyjeve, ku përcaktohen vazhdimësia dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre, masat për mbrojtjen e pyjeve dhe të mjedisit pyjor nga ndotja atmosferike, ruajtja e ekuilibrave të sistemeve ekologjike natyrore, duke shmangur sëmundjet dhe shfaqjen e insekteve në pyje, si dhe masat parandaluese nga zjarri.

6. Mbrojtja e mbulesës pyjore dhe e ekosistemeve pyjore të vendit, për të ruajtur prodhimtarinë, diversitetin biologjik dhe peizazhin është një bazë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të sektorit pyjor e të kullotave.

7. Në rast se në fondin pyjor ose në një pjesë pylli dhe në shkurre bie zjarr, organet e shërbimit pyjor, organet e bashkive, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij.

8. Shpenzimet e nevojshme për shuarjen e zjarreve përballohen nga organi, që ka në pronësi pyllin ose kullotën, dhe nga Buxheti i Shtetit, në rastin e një prone private me rëndësi kombëtare, historike, kulturore, arkeologjike, ekologjike etj.

9. Organet e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me bashkitë dhe me strukturat e shërbimit për mbrojtjen nga zjarri dhe të shpëtimit, organizojnë punën për parandalimin e zjarrit në fondin pyjor kombëtar.

Rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësisë të shuarjes së zjarreve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Në zonat pyjore, të caktuara për çlodhje, argëtim, turizëm dhe për pritjen e publikut, organet e shërbimit pyjor caktojnë vendqëndrimet dhe rrugët e lëvizjes, si dhe vendet ku mund të lejohet ndezja e zjarreve.

11. Në fondin pyjor kombëtar mbrohen dhe janë të patjetërsueshme të gjitha veprat hidroteknike (pritat malore, gardhet, pendat), burimet ujore, liqenet natyrore, kënetat e lagunat, përrenjtë e përroskat, veprat e ujit, koritat e ngrehinat e ndërtuara etj., të cilat krijojnë një kompleks të domosdoshëm natyror e të harmonizuar me pyjet e tokën pyjore.

12. Procedurat, rregullat, pagesa për mbrojtjen e fondit pyjor privat nga Policia Pyjore dhe marrëveshja tip caktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për pyjet.

Neni 21

Rehabilitimi dhe përdorimi i fondit pyjor kombëtar

(ndryshuar pika 12, me ligjin nr.9533, datë 15.5.2006)

1. Punimet mbrojtëse dhe ripërtëritëse në fondin pyjor kombëtar kryhen për të parandaluar ose kufizuar veprimet shkatërruese në pyll.

2. Masa për zhvillimin dhe kryerjen e punimeve mbrojtëse e ripërtëritëse ndërmarrin edhe pronarët, për drurët pyjorë, që ndodhen në tokat pyjore, në tokat bujqësore, në afërsi të pyllit, si dhe për drurët, që ndodhen jashtë fondit pyjor kombëtar.

3. Rritja e prodhimtarisë së fondit pyjor kombëtar, nëpërmjet ripërtëritjes së pyjeve të shfrytëzuara, përmirësimit të pyjeve ekzistuese, zbatimit të punimeve të mirëmbajtjes dhe atyre sanitare, në përputhje me funksionin e pyjeve, të nevojave ekonomike dhe të shtimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar, nëpërmjet pyllëzimit të tokave bujqësore, të braktisura e të pandara, të vendeve të zhveshura e të gërryera, të tokave ranore e zhavorrishte e të tjera të kësaj kategorie, është detyrë e administruesve dhe e përdoruesve të këtyre tokave.

4. Rehabilitimi i ekosistemeve pyjore, kullosore, i tokave pyjore të degraduara e të braktisura, i peizazhit pyjor, i habitateve të florës e faunës së egër, kryhet nën drejtimin e strukturave të organeve të shërbimit pyjor.

5. Ruajtja e ekuilibrit mjedisor, nëpërmjet ruajtjes ekologjike në ndërhyrjet në ekosistemet pyjore e kullosore dhe përdorimi i standardeve bashkëkohore për përtëritjen e tyre dhe të mjedisit natyror, është detyrë e organeve të shërbimit pyjor, e bashkive dhe e pronarëve privatë.

6. Rehabilitimi i terreneve të degraduara kryhet nëpërmjet nxitjes dhe mbështetjes së agropylltarisë në pronat publike dhe private.

7. Shpenzimet dhe sigurimi i mjeteve e i pajisjeve për mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar nga zjarret, ndotjet dhe për luftimin e sëmundjeve, të insekteve e të barërave të këqija dhe parazitare përballohen nga Buxheti i Shtetit, në bazë të kriterëve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

8. Nuk lejohen grumbullimi dhe shitja e prodhimeve drusore e jodrusore jashtë mundësive të tyre prodhuese e biologjike. Në raste të emergjencës për përballimin e fatkeqësive e të katastrofave natyrore, sasitë që do të përdoren për grumbullimin dhe shitjen e këtyre prodhimeve, jashtë mundësisë prodhuese e biologjike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Krasitja për gjethe, kullotja e bagëtisë dhe kositja apo grumbullimi i barit në fondin pyjor publik bëhen me leje të organeve të shërbimit pyjor, ndërsa për pyjet në përdorim të bashkive e nga administrata e saj, kundrejt pagesës përkatëse.

10. Kullotja dhe kalimi i bagëtive në pyjet publike, në pyllëzimet e reja, në ngastrat pyjore të shfrytëzuara a në ripërtëritje e sipër, në pyjet e ricunguara, në pyjet mbrojtëse e me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë e të mbarështimit të faunës së egër, si dhe në ato të farërave kryhen në përputhje me rregullat e caktuara nga ministria përgjegjëse për pyjet.

11. Gërmimet në fondin pyjor, publik e privat, dhe në rrjetin e përrenjve për të nxjerrë humus, gurë, rërë, zhavorr, plisa bari ose të tjera si këto, vendosja e kaminave të qymyrit të drurit dhe e eshkës së kovaçit, të furrave të gëlqeres apo hapja e gurorëve bëhen me leje të organeve të shërbimit pyjor dhe të institucioneve të tjera, të ngarkuara me ligj të veçantë, në kohën dhe vendin e caktuar, kundrejt pagesës.

12. Ministria përgjegjëse për pyjet jep lejen për ushtrimin e veprimtarive në fondin pyjor, duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të pajisë subjektet fizike e juridike me lejet përkatëse të ushtrimit të veprimtarive në fushën që mbulon.

13. Qëndrimi i automjeteve, vendosja e rulotave dhe qëndrimi i kafshëve në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në rezervatet e mbarështimit të florës e faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor, me rëndësi të veçantë, bëhen sipas rregullave të caktuara nga ministri përgjegjës për pyjet.

14. Lejimi i ndërtimeve të thjeshta, jo me karakter tregtar, i ngrehinave, i gardhimeve dhe kufizimi i lëvizjeve të vizitorëve, brenda territoreve të rrethuara të pjesëve të fondit pyjor publik dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë, kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ministri përgjegjës për pyjet.

15. Vendosja në fondin pyjor publik e kampingjeve, e çadrave dhe e strehimeve të lëvizshme (rulotat) ose e objekteve të tjera të kësaj natyre bëhet në vendet e caktuara nga organet e shërbimit pyjor.

16. Organet e shërbimit pyjor, kur vërejnë se bimët dhe prodhimet pyjore janë të infektuara nga parazitë karantinorë dhe se janë kryer shkelje të dispozitave ligjore bëjnë menjëherë bllokimin dhe njoftojnë jo vetëm pronarin ose përdoruesin, por edhe eprorët për arsyet e bllokimit.

17. Pjesë apo ekonomi pyjore lejohen të trajtohen edhe për mbarështimin e faunës së egër dhe për ushtrimin e veprimtarisë turistike e të gjuetisë sportive.

18. Personat juridikë e fizikë, të cilët kryejnë veprimtari të lejuara në fondin pyjor publik, pavarësisht nga kontratat që kanë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të lidhin kontratë mirëmbajtjeje dhe përdorimi të zonave të gjelbra pyjore, në përputhje me studimet e

miratuara nga KRRTRSH-ja, në bashkërendim me organet e shërbimit pyjor, për sipërfaqen pyjore a kullosore të zënë me ndërtime dhe për territorin që përdorin apo që kanë me qira.

Për administrimin e fondit pyjor, brenda sipërfaqes së miratuar për zhvillimin e turizmit, subjekti përkatës lidh marrëveshje për shërbimet dhe mirëmbajtjen e këtij fondi me ministrinë përgjegjëse për pyjet për ruajtjen nga dëmtimet dhe prerjet e paligjshme, nga sëmundjet dhe insektet, nga zjarret, si dhe për llojin e pemëve të reja që do të mbillen në territorin e caktuar.

Tarifat për shërbimet e mësipërme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

19. Agjencitë turistike dhe të udhëtimit, që kryejnë veprimtari turistike në fondin pyjor publik, në zonat pyjore të lejuara nga organet e shërbimit pyjor, zbatojnë parimet mjedisore dhe rregullat kombëtare e ndërkombëtare në këtë fushë dhe kujdesen që turistët të respektojnë kodet e sjelljes në natyrë.

20. Kryerja e manovrave ushtarake në fondin pyjor publik bëhet pas vlerësimit të ndikimit në mjedis të këtyre manovrave, me leje të organeve të shërbimit pyjor dhe të agjencive rajonale të mjedisit, në të cilën përcaktohen kushtet për zvogëlimin e efekteve të dëmshme në mjedisin pyjor.

Neni 22

Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor kombëtar

1. Pyjet në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare. Shteti garanton me këtë ligj barazinë e marrëdhënieve të pronësisë në fondin pyjor kombëtar.

2. Administrimi, zhvillimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi i fondit pyjor kombëtar janë detyra të strukturave të organeve të shërbimit pyjor, të pronarëve, të institucioneve të tjera shtetërore dhe të organeve të pushtetit vendor.

3. Qeverisja dhe administrimi i fondit pyjor kombëtar (publik, në përdorim a në pronësi të bashkive dhe privat) bëhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Fondi pyjor publik, vendor a privat, administrohet e trajtohet sipas planeve të mbarështimit, të inventarizimit dhe të funksioneve të këtij fondi.

5. Të gjithë pronarët, administruesit, qiramarrësit dhe përdoruesit e fondit pyjor kombëtar e të tokës pyjore detyrohen të kujdesen, vazhdimisht, për trajtimin dhe zhvillimin e fondit pyjor kombëtar dhe për mbrojtjen e mjedisit pyjor.

6. Administrimi, shtimi dhe trajtimi shkencor i pyjeve mbrojtëse dhe i atyre me funksion të veçantë, pavarësisht ku ndodhen, i drurëve e i shkurreve me vlera të veçanta, i bimëve mjekësore e tanifere, brenda fondit pyjor publik dhe atij vendor, bëhen nën kujdesin e organeve të shërbimit pyjor.

7. Krijimi i pyjeve të reja, ngritja e zonave të reja apo zgjerimi i zonave ekzistuese pyjore kryhen në mbështetje të projekteve dhe me leje të organeve të shërbimit pyjor.

8. Drurët, grumbujt e drurëve e të shkurreve, parqet dhe lulishtet në qytete, në qendra të banuara e në qendra prodhimi mbrohen dhe trajtohen nga pronarët e tyre të ligjshëm.

9. Sipërfaqet dhe objektet në pronësi private, të cilat përfshihen në fondin pyjor publik, mbeten pronë e pronarit të ligjshëm. Ato administrohen e përdoren prej tij dhe në rastet kur do të zhvillohen veprimtari në to, menaxhohen sipas kërkesave të planit të mbarështimit pyjor.

10. Shteti nxit nismat individuale a kolektive për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, nëpërmjet sistemit të kredive lehtësuese, të përdorimit afatgjatë, deri në privatizimin e tyre.

11. Çdo vit, në Buxhetin e Shtetit planifikohen fonde për investime, për rimëkëmbjen e integritetit ekologjik të pyjeve e të kullotave, për ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve, të habitateve, të gjendjes mjedisore dhe të biodiversitetit pyjor.

Neni 23

Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor në pronësi të bashkive

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve vendore apo i pjesëve të tyre bëhen nga bashkitë, sipas planeve të mbarështimit dhe të dispozitave të këtij ligji.

2. Për një administrim të qëndrueshëm e shumëfunksional të fondit pyjor vendor, për rregullimin e përdorimit e të shfrytëzimit të pyjeve, të kullotave dhe të burimeve të tjera pyjore e jopyjore, për mbrojtjen nga zjarri, dëmtuesit etj., brenda territorit administrativ të bashkive, krijohen njësitë tekniko-administrative, në varësi të drejtpërdrejtë të organeve të qeverisjes vendore. Strukturat e ministrisë përgjegjëse për pyjet ndihmojnë, kontrollojnë, këshillojnë dhe sigurojnë mbështetjen teknike për këto njësi dhe për shoqatat e përdoruesve të pyjeve.

3. Organet e qeverisjes vendore kanë për detyrë të marrin masa dhe të planifikojnë fonde për investimet në pyjet, në territorin që ata mbulojnë, për përmirësimin dhe planifikimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregimit të prodhimeve pyjore, si dhe për krijimin e sektorit të agropylltarisë.

4. Shteti mbështet nismat individuale a kolektive të bashkive për shtimin e sipërfaqes së pyjeve, për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, në pronësi të tyre, nëpërmjet sistemit të kredive me kushte lehtësuese.

5. Bashkia, çdo vit, nga të ardhurat e realizuara planifikon fonde për ruajtjen, mirëmbajtjen, kryerjen e punimeve silvikulturore dhe përgjigjet për trajtimin shkencor të tyre.

6. Vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera nga pyjet vendore bëhet në përputhje me këtë ligj.

7. Kriteret e transferimit dhe përdorimit të pyjeve nga bashkitë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor privat

1. Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor privat bëhen nga pronarët, në përputhje me planet e thjeshta të mbarështimit, të miratuara nga shërbimi pyjor.

2. Pronari privat nuk mund të vendosë e të kryejë një shndërrim të pyjeve, të kulturave pyjore apo të ndryshojë zërin kadastral, në pronën pyjore të tij, pa marrë, paraprakisht, miratimin e organit përkatës të shërbimit pyjor.

3. Shteti, brenda mundësive, mjeteve e fondeve që ka, mbështet plotësimin e nismës dhe të përgjegjësisë private, individuale e kolektive, për zgjerimin e sipërfaqes së pyjeve private, për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e burimeve pyjore dhe për krijimin e fermave private pyjore.

4. Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve, i drurëve pyjorë apo i grumbujve pyjorë të veçuar, në pronësi të komuniteteve fetare, bëhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

5. Vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera nga pyjet private bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 25

Pyjet me funksion mbrojtës dhe të veçantë

1. Pyjet, drurët dhe pjesët e fondit pyjor publik, të shpallura me funksion mbrojtës e të veçantë (mbrojtës të klimës, tokës, ujërave, ajrit, të elementeve higjieno-shëndetësorë, me funksion të veçantë pushimi, çlodhjeje, edukimi, turizmi, estetikë, kërkimore dhe shkencore, mbrojtës të natyrës dhe trashëgimisë natyrore e kulturore), ruhen, zhvillohen, mbarështohen dhe administrohen, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit “Për trashëgiminë kulturore”.

2. Kriteret për shpalljen e pyllit me funksion mbrojtës ose të veçantë përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për pyjet.

3. Në pyjet apo në ato pjesë të fondit pyjor kombëtar, me funksion mbrojtës ose të veçantë, kryhen punime përkujdesjeje dhe të prerjeve sanitare, në mbështetje të projekteve të hartuara dhe pas miratimit nga organet e shërbimit pyjor.

4. Pyjet private ose pjesë të tyre mund të përfshihen në listën e pyjeve dhe të pjesëve të fondit pyjor kombëtar, me funksion mbrojtës ose të veçantë, pas marrjes me shkrim të mendimit të pronarit të tyre të ligjshëm.

5. Ministria përgjegjëse për pyjet publikon listën e pyjeve dhe të pjesëve të fondit pyjor kombëtar, me funksion mbrojtës ose të veçantë.

KREU VI TRAJTIMI, SHFRYTËZIMI DHE SHITJA E MATERIALIT DRUSOR DHE E PRODHIMEVE PYJORE E JOPYJORE

Neni 26

Trajtimi dhe shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar

(ndryshuar pikat 2, 3 e 4, shtuar pikat 15 e 16, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9989, datë 15.9.2008, shtuar pika 17, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009, shfuqizuar pika 6 dhe ndryshuar pika 9 me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Shfrytëzimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore lejohet në fondin pyjor shtetëror, vendor ose privat, për qëllime të përfitimit ekonomik dhe vetëm nëpërmjet kryerjes së punimeve të parashikuara në planet e mbarështimit.

2. Personat fizikë dhe juridikë mund ta trajtojnë dhe shfrytëzojnë fondin pyjor kombëtar vetëm kur kanë dalë fitues në procedurat e konkurrimit publik dhe kur lidhin kontratën me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor ose me bashkitë. Kërkesat, që duhet të plotësojnë subjektet për pjesëmarrje në konkurrimin publik, përcaktohen me udhëzim të ministrit. Të drejtat, që sigurohen nga kontrata për trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar, nuk mund t'u transferohen të tretëve. Subjektet, që kanë lidhur kontratën, mund të ndërtojnë ose të vendosin instalime të përkohshme, sipas skemave teknologjike, të miratuara nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

3. Materiali drusor, që shfrytëzohet çdo vit nga fondi pyjor kombëtar, caktohet brenda mundësive vjetore të trajtimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, të përcaktuara në planet e mbarështimit, ndërsa në pyjet, me funksion mbrojtës e të veçantë, lejohet vetëm në rastet kur kryhen punimet e përkujdesjes dhe të prerjeve sanitare.

4. Shfrytëzimi i ngastrave dhe i nënngastrave lejohet vetëm kur kërkohet teknikisht, në rastet e prerjeve farore, dritësuese, përfundimtare apo prerjet në pyjet e dëmtuara nga katastrofat natyrore apo zjarret, nën kontrollin e organeve të shërbimit pyjor.

5. Sipërfaqet e pyjeve të larta përshkohen me prerje kulturore, sipas fazës së zhvillimit, në të cilën gjenden, dhe të kërkesave të silvikulturës.

6. Shfuqizuar.

7. Vjelja e prodhimeve pyjore në pyjet private kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, duke mos cenuar mbrojtjen e tokës dhe të elementeve klimatike, ekologjike e shoqërore. Pronari, paraprakisht, duhet të sigurojë lejen përkatëse dhe damkimin e drurëve prej organeve të shërbimit pyjor.

8. Krijimi i rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë dhe ruajtja e trajtimi i pyjeve të virgjra ose pothuajse të virgjra, duke i kaluar në konservim të plotë, bëhen në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki çdo vit hartojnë dhe dërgojnë për miratim në ministrinë përgjegjëse për pyjet planin e shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të

dyta pyjore e jopyjore. Drejtoria përkatëse e ministrisë përgjegjëse për pyjet kontrollon zbatimin e këtij plani.

10. Shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar organizohet në bazë të vitit pyjor, i cili fillon në datën 1 tetor.

Këshilli i Ministrave cakton kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore.

11. Prerja e drurëve pyjorë në fondin pyjor kombëtar bëhet pas shënimit të tyre me damkë të veçantë nga organet e shërbimit pyjor. Ministri përgjegjës për pyjet, me udhëzim të veçantë, përcakton mënyrën e përdorimit, madhësinë dhe formën e çekiç-damkës.

12. Në trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor publik përdorimi i standardeve për prerjet vjetore të lejueshme, ciklet e prerjeve, teknikat e shfrytëzimit dhe infrastruktura janë të detyrueshme.

13. Operacionet e trajtimit dhe të shfrytëzimit të pyjeve synojnë mbrojtjen e mjedisit pyjor e të biodiversitetit.

14. Grumbullimi i prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvres, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, u lejohe personave juridikë e fizikë, të pajisur me lejen përkatëse, të lëshuar nga organet e shërbimit pyjor dhe në mbështetje të kriterëve dhe të kontingjenteve të caktuara nga ministria përgjegjëse për pyjet.

15. Kur subjekti privat i specializuar kërkon të ndërtojë, me shpenzimet e veta, rrugën, për shfrytëzimin e ngastrave e të nënngastrave pa rrugë autopsyjore, drejtoria përkatëse pyjore kompenson shpenzimet për ndërtimin e rrugës, duke bërë korrektimin e tarifave bazë, në varësi të investimeve të kryera për m³ lëndë drusore në këmbë. Në këto raste, subjekti gëzon të drejtën e shfrytëzimit të tyre deri në prerjet përfundimtare, të përcaktuara në planet e mbarështimit.

16. Kur subjekti privat i specializuar kërkon të marrë sipërfaqe të gjëra nga fondi pyjor, për afate të gjata kohore për të rehabilituar pyjet, kërkesa shqyrtohet, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet.”

17. Dhënia në përdorim e të mirave publike, sipas këtij neni, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë III.4 të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.

Neni 26/1

(shtuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e shfrytëzimit në fondin pyjor, përveçse kur kryhen nga banorët dhe për nevojat e tyre, sipas këtij ligji, mund të realizohen vetëm nga individë të certifikuar, në përputhje me procedurat e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, u nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.

Neni 27

Shitja e materialit drusor dhe e prodhimeve pyjore e jopyjore

(ndryshuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 5 dhe 7, me ligjin nr.9989, datë 15.9.2008)

1. Shitja e materialit drusor në pyjet publike bëhet nga organet e shërbimit pyjor, me ankand, në dy mënyra:

- a) në formën e asortimenteve të gatshme, në anë të rrugës ose në sheshet e depozitimit;
- b) në këmbë (të paprera).

2. Ankandet për shitjen e asortimenteve të gatshme në anë të rrugës, të prodhuara nga subjektet private, për llogari të shërbimit pyjor, zhvillohen vetëm për pyjet e reja kur trajtohen me prerje kulturore, me rallime, të tipit I e II, si dhe për zonat e mbrojtura, në varësi të nevojave të trajtimit të ngastrave e nënngastrave pyjore, të fondeve të planifikuara për këtë qëllim dhe të kërkesave të tregut.

3. Shfrytëzimi dhe prodhimi i asortimenteve të gatshme dhe magazinimi i tyre në anë të rrugës apo në sheshe depozitimi realizohen nga subjekte private, të përzgjedhura, nëpërmjet tenderave, të organizuara nga organet e shërbimit pyjor, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislationit në fuqi. Tenderat zhvillohen për ngastrat dhe nënngastrat, për të cilat janë përgatitur projektet tekniko-ekonomike të trajtimit apo të shfrytëzimit dhe vetëm në rastet kur garantohen efektiviteti ekonomik, miradministrimi dhe ruajtja e asortimenteve deri në shitjen e tyre.

4. Ankandet për shitjen e lëndës drusore në këmbë zhvillohen për pyjet e larta trungishte, pyjet e ulëta cungishte, si dhe për shkurret, që kanë arritur moshën e shfrytëzueshmërisë, sipas fazave të prerjes, të përcaktuara në planet e mbarështimit.

5. Kërkesat dhe rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore përcaktohen me udhëzim të ministrit.

6. Materialet drusore dhe çdo prodhim tjetër me origjinë pyjore, të sekuestruara në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit dhe të tregtimit, ruhen nga subjektet, të cilave u janë sekuestruar, deri në shitjen e tyre nga organet e shërbimit pyjor.

7. Materiali drusor, i përpunuar ose i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me një vërtetim transporti, të lëshuar nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, nga bashkitë ose nga pronari privat, ku vërtetohet prodhimi i tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet nga ministri.

KREU VI/I
MONITORIMI DHE TË DHËNAT
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Neni 27/1
Monitorimi i pyjeve
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Monitorimi i pyjeve, që përfshin monitorimin e treguesve cilësorë dhe sasiorë të tyre, të biodiversitetit në pyje, të dukurive natyrore dhe të ndotjes e të dëmtimit të tyre, është proces i përhershëm dhe i detyrueshëm.

Neni 27/2
Programi i monitorimit
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Në bashkëpunim me organet qendrore dhe vendore, me Fakultetin e Shkencave Pyjore e me shoqatat e përdoruesve të pyjeve, ministria harton programin e monitorimit të pyjeve, si dhe bashkërendon e kontrollon punën për zbatimin e tij. Ministri miraton programin e monitorimit.

2. Programi i monitorimit të pyjeve përcakton treguesit e cilësisë së pyjeve, të biodiversitetit, të zhvillimit të ndotjes dhe dëmtimit, të dukurive natyrore, mënyrat e matjeve, të përpunimit të të dhënave, si dhe raportimin e botimit të tyre.

Neni 27/3

Sistemi i të dhënave

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Për të siguruar grumbullimin, përpunimin dhe botimin e të dhënave për pyjet, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese të pyjeve, me Policinë Pyjore, me qeverisjen vendore, me Fakultetin e Shkencave Pyjore e me shoqatat e përdoruesve të pyjeve, krijon sistemin e të dhënave, të domosdoshme për monitorimin e pyjeve.

2. Sistemi i të dhënave përmbledh tërësinë e treguesve shifrorë, të matshëm e të numërueshëm, që qartësojnë gjendjen e pyjeve dhe prirjet e proceseve që zhvillohen në to.

3. Në krijimin dhe përsosjen e sistemit të të dhënave, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve synon përafrimin e plotë të tij me sistemet që përdor FAO-ja dhe që përcaktohen në direktivat e BE-së.

Neni 27/4

Grumbullimi i të dhënave

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Të dhënat për monitorimin e pyjeve kërkohen, hartohen dhe paraqiten sipas rregullave të miratuara me udhëzim të ministrit. Personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, paraqesin të dhënat brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

2. Të dhënat shoqërohen me shpjegime për interpretimin e tyre, me rekomandime për zgjidhjen e problemeve që dalin dhe dorëzohen në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, në përputhje me formatin që ajo kërkon.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve kontrollon cilësinë e monitorimit, të matjeve, zbatimin e metodikave, kualifikimin e specialistëve që marrin pjesë, pajisjet e përdorura dhe vërtetësinë e rezultateve.

Neni 27/5

Informimi dhe botimi i të dhënave

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve përpunon dhe dërgon për botim të dhënat dhe rezultatet që dalin prej tyre, në media dhe shtyp, në një formë të kuptueshme për publikun.

2. Në bazë të të dhënave dhe të rezultateve të monitorimit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese, harton dhe boton raportin vjetor për gjendjen e pyjeve. Përpunimi dhe botimi i të dhënave për vitin pararendës bëhen brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Publiku dhe organizatat jofitimprurëse informohen për gjendjen e pyjeve, nëpërmjet botimit të të dhënave nga strukturat menaxhuese të pyjeve, nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, nga organet e qeverisjes vendore, si dhe duke kërkuar të dhëna pranë këtyre organeve.

4. Rregullat dhe procedurat për informimin e botimin dhe shpërndarjen e të dhënave janë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 27/6

Tërheqja në vendimmarrje

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Gjatë procesit të vendimmarrjes për pyjet, organet shtetërore, qendrore dhe vendore, sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të komunitetit, të shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe të organizatave jofitimprurëse.

2. Ministri miraton rregullat e procedurat, që realizojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjet e strukturave menaxhuese.

Neni 27/7

Shoqatat e përdoruesve të pyjeve

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Në procesin e zbatimit të këtij ligji, strukturat e menaxhimit të pyjeve dhe organet e qeverisjes vendore përfshijnë edhe shoqatat e përdoruesve të pyjeve.

2. Ministri përcakton rregullat dhe procedurat për përfshirjen e shoqatave, sidomos në hartimin, miratimin dhe zbatimin e:

- a) strategjive, të planeve të veprimit dhe të programeve të zhvillimit të pyjeve;
- b) planeve të mbarështimit e të programeve të monitorimit të pyjeve;
- c) projektakteve normative për pyjet.

3. Përfaqësues të shoqatave të përdoruesve të pyjeve marrin pjesë në borde e komisione, që krijohen për administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve, në nivel vendor dhe qendror.

Neni 27/8

Lidhjet me biznesin

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Lidhjet me biznesin realizohen në rrugë institucionale, nëpërmjet dhomave të tregtisë dhe të industrisë, si dhe të organizatave profesionale të biznesit, të cilat paraqesin pikëpamjet e veta për hartimin dhe zbatimin e programeve të administrimit, të zhvillimit, të mbrojtjes e të shfrytëzimit të pyjeve.

KREU VII

BURIMET FINANCIARE DHE PËRDORIMI I TYRE

Neni 28

Funksionimi dhe përgjegjësitë financiare për pasurinë pyjore e kullosore

Shërbimi pyjor funksionon në përputhje me ligjin organik të Buxhetit të Shtetit dhe është përgjegjës për administrimin e pasurisë dhe të të ardhurave të realizuara nga veprimtaria ekonomike në sektorin e pyjeve e të kullotave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 29

Burimet financiare

Burimet financiare të shërbimit pyjor sigurohen nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) burime të brendshme;
- c) donacione e grante të ndryshme.

Neni 30

Përdorimi i burimeve financiare

Burimet financiare të krijuara sipas nenit 32 përdoren për:

- a) investime në sektorin e pyjeve dhe të kullotave;

- b) mbrojtjen e faunës dhe të biodiversitetit të pyjeve dhe të kullotave;
- c) parandalimin e sëmundjeve, të dëmtuesve dhe të zjarreve në pyje dhe kullota;
- ç) kërkime shkencore në pyje dhe kullota;
- d) krijimin e kushteve për kryerjen e veprimeve turistike dhe çlodhëse;
- dh) shpërblimin e punonjësve për gjrobat dhe sekuestrot e vendosura dhe të vjela sipas kritereve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 31

Ndarja e burimeve financiare

(ndryshuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Burimet financiare, të krijuara sipas nenit 32, të ligjit, derdhen 100 për qind në buxhetin e bashkisë.

Neni 32

Bazueshmëria ligjore e burimeve financiare

Sigurimi dhe përdorimi i të gjitha llojeve të burimeve financiare bëhen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 33

Të ardhurat e siguruar nga pyjet vendore

(shfuqizuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Neni 34

Tarifat në fondin pyjor publik

(ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Tarifat për të gjitha veprimtaritë, që zhvillohen në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, për shërbimet publike e mjedisore, që zhvillohen në fondin pyjor publik, si dhe ato të vlerësimit të dëmeve në pyje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave është struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

KREU VIII

KËRKIMI SHKENCOR NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR

Neni 35

Veprimtaritë kërkimore e shkencore

1. Veprimtaritë kërkimore e shkencore në fondin pyjor kombëtar, për pyjet e tokat pyjore, kullotat, gërryerjet, pyllëzimet e përmirësimet, ripërtëritjen natyrore e problemet gjenetike, farërat e fidanët pyjorë, zjarret dhe luftimin e sëmundjeve e të dëmtuesve, florën e faunën e egër, bimët mjekësore e tanifere natyrore, përgatitjen dhe zbatimin e programeve të monitorimit për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve kryhen nga personat fizikë e juridikë, të cilët plotësojnë kërkesat dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarive kërkimore e shkencore.

2. Zhvillimi i veprimtarive kërkimore e shkencore, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet brenda fushave përkatëse të sektorit të pyjeve dhe të kullotave, në mbështetje të programeve kërkimore-shkencore kombëtare.

3. Institucionet kërkimore, studimore dhe shkencore në fushën e pyjeve e të kullotave sigurojnë konsulencë, oponencë dhe asistencë teknike për ministrinë përgjegjëse për pyjet, në aspekte të veçanta, brenda fushës së veprimtarisë së tyre.

4. Ministri përgjegjës për pyjet dhe ministri përgjegjës për shkencën harmonizojnë programimin dhe zbatimin e punës kërkimore në pyje e kullota, si dhe paraqesin kërkesat për buxhetin përkatës.

Neni 36

Bazat prodhuese dhe eksperimentale të zhvillimit dhe kualifikimit

1. Bazat prodhuese, eksperimentale, të ekstensionit, si për kërkimin shkencor dhe për kualifikimin e nxënësve e të studentëve, të punëtorëve, të specialistëve të pyjeve dhe të fushave të tjera në sektorin pyjor dhe për mjedisin në tërësi ngrihen me miratimin me shkrim të ministri përgjegjës për pyjet, në bazë të kërkesës së institucioneve kërkimore e pedagogjike.

2. Grumbujt e drurëve dhe të llojeve pyjore, të caktuara për konservim, germoplazmë, in situ dhe *ex situ*, për grumbullim, përpunim, shpërndarje dhe certifikim të materialit mbjellës, administrohen nga shërbimi pyjor.

KREU IX

PARASHIKIMET NDËSHKIMORE

Neni 37

Përgjegjësitë për moszbatimin e ligjit

(ndryshuar pika 2, dhe shtuar pika 4, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Shkeljet e dispozitave ligjore sjellin, sipas rastit, përgjegjësi administrative dhe penale.

2. Inspektorët e Policisë Pyjore, kur vërejnë shkeljen e këtyre dispozitave, mbajnë procesverbal, në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin.

3. Të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 38 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Policisë Pyjore.

4. Punonjësit e tjerë të shërbimit pyjor, punonjësit e pushtetit vendor që mbulojnë pyjet dhe pronarët privatë, në rastet kur konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Policinë Pyjore për të kryer procedurat e nevojshme.

Neni 38

(ndryshuar me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si me poshtë:

a) prerja pa leje e pyjeve, e pyjeve të reja, e filizërisë dhe e fidanishteve, si dhe dëmtimi i tyre e i tokës pyjore, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) prerja e drurëve pa damkën e organeve të shërbimit pyjor, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

c) përdorimi i paligjshëm i fondit dhe i tokës pyjore dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) prerja pa leje apo dëmtimi i pyjeve, në pronësi private, nga pronarët apo nga subjektet, të cilave u janë dhënë në përdorim ose me qira, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë;

d) kullotja e bagëtive në pyjet e reja, në pyllëzime, në filizëri e fidanishte, në parcelat gjenetike e eksperimentale e në pyjet mbrojtëse, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

dh) grumbullimi i prodhimeve pyjore e jopyjore, si rrëshirë, boçe, hala, gjethe, bar, lëgushë, humus, plisa, rrënjë e lëvore, lule, fruta, sytha e herbë, kërpudha, bimë mjekësore, eterovajore, tanifere, patavra, cungje, kucka, fashina, thupra, hunj, bandiera, zhuka e kallamishte, gurë, zhavorr e rërë, pa lejen përkatëse të organit të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

e) nxjerrja e rrënjëve të shqopës, bushit, maresë dhe prerja e thuprës së shëlgut e të llojeve të tjera të drurëve pyjorë, gjatë periudhës së vegetacionit, dënohen me gjobë 20 000 (njëzet mijë) deri në 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë;

ë) krasitja për gjethe dhe kositja e grumbullimi i barit në fondin pyjor, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 8 000 (tetë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

f) mbledhja e prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, e bimëve të rralla e të kërcënuara e të tjera të kësaj natyre, jashtë periudhës teknike të vjeljes e me mënyra që sjellin degradimin, kërcënimin, rrallimin, zhdukjen apo dobësimin e funksioneve të tyre, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

g) ndërhyrjet me punime të ndryshme në ligatinat dhe dunat bregdetare, pjesë përbërëse të fondit pyjor kombëtar, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

gj) ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara nga organet e shërbimit pyjor dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

h) prishja apo përdorimi i çekiç-damkës e i damkës nga persona të paautorizuar dhe nga një zonë pyjore në tjetrën, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

i) prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike, i tabelave paralajmëruese apo treguese, të vendosura në fondin pyjor kombëtar, dënohen me gjobë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë;

j) ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të qymyrit të drurit në fondin pyjor, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

k) ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, brenda territoreve të gardhuara të fondit pyjor dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, dënohet me gjobë 20 000 (njëzet mijë) deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

l) hedhja e mbetjeve urbane dhe e inerteve brenda në pyll ose në tokën pyjore dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ll) parkimi i automjeteve, vendosja e rulotave në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në parqet kombëtare, në rezervatet e mbarështimit të florës e të faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor, me rëndësi të veçantë, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 3 000 (tre mijë) deri në 5 000 (pesë mijë) lekë;

m) ndryshimi i zërit kadastral apo i kulturave pyjore nga pronari privat, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

n) mosraportimi nga pronari i ndryshimeve përkatëse në fondin pyjor dhe në tokën pyjore, brenda 6 muajve nga data e vënies re, dënohet me gjobë 3 000 (tre mijë) deri në 5 000 (pesë mijë) lekë;

nj) transferimi i të drejtave, të siguruara nga leja e ushtrimit të veprimtarisë në fondin pyjor kombëtar, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

o) transporti me kamionë i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, i pashoqëruar me lejen tip të transportit, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

p) mosruajtja e materialit drusor dhe e çdo prodhimi tjetër, me origjinë pyjore, të sekuestruar, i cili ndodhet në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit e të tregtimit, nga subjektet, të cilave u është sekuestruar, deri në shitjen e tyre, dënohet me gjobë 8 000 (tetë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

q) tregtimi ose tjetërsimi i materialeve drusore dhe i prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

r) tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitare ose të prekura nga insektet, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

rr) mosnjoftimi i inspektoratit për shkeljet e konstatuara nga subjektet e përcaktuara në pikën 4 të nenit 37 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë gjobë.

2. Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasoja të rënda, Policia Pyjore bën kallëzim penal. Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Sipas nevojave të rastit, krahas dënimit kryesor me gjobë, merren edhe masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 39

Sekuestrimet

Mjetet dhe gjithçka tjetër, që shërben për kryerjen e kundërvajtjes administrative dhe çdo përfitim pasuror, i vënë nëpërmjet kundërvajtjes administrative, sekuestrohen dhe kalojnë në llogari të organeve të shërbimit pyjor.

Neni 40

Vendimi për kundërvajtjet administrative dhe ankimi

(ndryshuar pika 3, me ligjin nr.9533, datë 15.5.2006, ndryshuar me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013 dhe nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative merret nga Policia Pyjore, në zbatim të legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndaj vendimit të dhënë, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, bëhet ankimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Procedura e ekzekutimit të vendimit të dënimit me gjobë bëhet në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 40/1

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007 dhe nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Për çdo rast të kryerjes së kundërvajtjes administrative apo veprës penale në pyje, nga inspektori vlerësohet edhe dëmi që është shkaktuar.

2. Struktura menaxhuese e sipërfaqeve pyjore, pronë shtetërore, ose bashkia përkatëse që ka në pronësi sipërfaqen pyjore, në të cilën ka ndodhur kundërvajtja, janë të detyruara të kërkojnë, në çdo rast, shpërblimin e dëmit nga kundërvajtësi. Këtë të drejtë e gëzon edhe pronari privat për sipërfaqen në pronësi të tij.

3. Në zbatim të këtij neni, Policia Pyjore njofton subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për dënimin e konstatuar dhe u përcjell atyre të gjithë praktikën përkatëse.

4. Kriteret dhe mënyra e caktimit të vlerës së dënimit të shkaktuar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40/2

Likuidimi i gjobës

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Neni 40/3

Lidhja e kontratës

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Personat juridikë e fizikë, që kanë bërë instalime, ndërtime dhe ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor publik, pa lidhur kontrata me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor, duhet t'i lidhin ato brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pas këtij afati, Policia Pyjore bën mbylljen e përhershme të veprimtarive dhe çmontimin e instalimeve.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 41

Shfuqizimi i dispozitave ligjore

Ligji nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë Pyjore”, i ndryshuar, ligji nr.8302, datë 12.3.1998 “Për administrimin e të ardhurave që krijohen në pyje dhe kullota - pasuri shtetërore” dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 42

Aktet nënligjore

(ndryshuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 4, 9 pika 3, 17 pika 1 shkronja “b” e pika 2, 19 pika 2, 20 pika 9, 21 pika 8, 23 pika 7, 26 pikat 2, 8 e 10, 27 pika 5, 38 pika 2 dhe 40/1 pika 2.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të neneve 5 pika 6, 8 pika 2, 16 pikat 5 e 8, 17 pika 1 shkronja “a”, 19 pika 3, 20 pika 12, 25 pika 2, 26 pika 11, 27 pika 7, 27/2 pika 1, 27/4 pika 1, 27/5 pika 4, 27/6 pika 2 dhe 27/7 pika 2.

DISPOZITË KALIMTARE E LIGJIT NR. 36/2013, DATË 14.2.2013

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

DISPOZITË KALIMTARE E LIGJIT NR. 48/2016, DATË 5.5.2016

Dispozitë kalimtare

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për pyjet, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton transferimin e pyjeve në pronësi të bashkive.

Neni 43
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4591, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ²⁹
Nr.10 440, datë 7.7. 2011

PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS³⁰
(Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike.

²⁹ * Ky ligj është përafshuar plotësisht me direktivën 85/337/KEE të Këshillit, datë 27 qershor 1985 "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin", të ndryshuar, numri CELEX: 31985L0337, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 175, datë 5.7.1985, faqe 40-48.

³⁰ Ligji nr.10 440, datë 7.7. 2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 1 gusht 2011.
Ligji nr. 12/2015, datë 26.2.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38, datë 18 mars 2015.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

Neni 4
Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

4. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Neni 5
Përfshirjet nga fusha e zbatimit

Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij ligji:

a) projektet e hartuara për qëllimet e mbrojtjes kombëtare, për të cilat argumentohet se vlerësimi i ndikimit të tyre në mjedis bie ndesh me qëllimet e mbrojtjes kombëtare;

b) Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, ngre grupin e përbashkët të punës, i cili miraton, rast pas rasti, projektet, objekt të shkronjës “a” të këtij neni, si dhe sugjeron e rekomandon masat e nevojshme për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve të rëndësishme negative.

Neni 6
Përkufizime

(Ndryshuar pikat 7,9 dhe shfuqizuar pika 15 me ligjin nr.26.2.2015)

Në këtë ligj termet e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Projekt” është:

a) zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;

b) ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve.

2. “Zhvillues” është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik.

3. “Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.

4. “Publiku” ka kuptimin që jepet në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

5. “Publik i ndikuar” është publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore që shprehin interes.

6. “Vendim” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin është vendosur nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t’i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

7. “Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis”, më poshtë “Deklarata mjedisore”, është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar.

8. “Autoritet publik” ka kuptimin që jepet në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”.

9. “Autoritet i planifikimit” ka kuptimin që jepet në legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit.

10. “Autoriteti përgjegjës për licencimin” është institucioni publik që, brenda funksioneve dhe kompetencave të caktuara në ligj, është përgjegjës për miratimin ose jo të një lejeje/licence të caktuar për projektet që janë subjekt i këtij ligji.

11. “Zonë veçanërisht e mbrojtur” ka kuptimin që jepet në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar.

12. “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” ka kuptimin që jepet në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”.

13. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.

14. “Ministër” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

15. Shfuqizuar.

16. “Seancë dëgjimore me publikun gjatë VNM-së” është procesi i organizuar nga AKM-ja, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore, për marrjen e mendimit të publikut para miratimit të deklaratës për projektin.

17. “Vlerësim ndërkuftar i ndikimeve në mjedis” është procesi i VNM-së, që zhvillohet për projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara (ESPOO) “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar”, që, bazuar nga vendndodhja a teknologjia e tyre, mund të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e shteteve fqinje apo të vendit tonë.

18. “Ekspert i certifikuar i VNM-së” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor.

19. “Ndikim i rëndësishëm në mjedis” është ndikimi në mjedis i një veprimtarie ose projekti, që shkakton dëme të drejtpërdrejta e të pakthyeshme në të dhe që, edhe pas marrjes së masave zbutëse, ndikimi negativ nuk mund të parandalohet, të kontrollohet apo të eliminohet plotësisht.

20. “Natyra 2000” është programi i Bashkimit Europian për mbrojtjen e llojeve dhe habitateve biologjike të rrezikuara.

KREU II PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Neni 7

Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis (Ndryshuar pika 4,5 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

4. Metodologjia kombëtare e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ku përcaktohen metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit.

5. Rregullat, përgjegjësitë dhe afatet për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 8

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;
- b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;
- c) projektet e listuara në shtojcën I, që ndërmerren, ekskluzivisht apo kryesisht, për testimin dhe zhvillimin e metodave ose produkteve të reja, të cilat nuk janë përdorur për më shumë se dy vjet;
- ç) projektet e listuara apo jo në shtojcën I ose II, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo nuk janë të nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojnë efekte negative të rëndësishme në këto zona. Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projekti.

Neni 9

Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis

- 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen:
 - a) projektet e listuara në shtojcën I;
 - b) projektet për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure.
- 2. Zhvilluesi, pavarësisht nga dispozitat e këtij ligji, mund të kërkojë mendim paraprak nga AKM-ja, nëse projekti që synon të zhvillojë është subjekt i këtij ligji.

Neni 10

Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi

(Ndryshuar paragrafi i parë, me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë ministrisë, e cila ia përcjell AKM-së, dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë:

- a) Për projektet e shtojcës II:
 - i) raportin paraprak të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit;
 - ii) projektin teknik të veprimtarisë;
 - iii) faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.
- b) Për projektet e shtojcës I:
 - i) raportin e thelluar të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit;
 - ii) përmbledhjen joteknike të raportit të VNM-së;
 - iii) projektin teknik të veprimtarisë;

- iv) informacion për informimin dhe konsultimin me publikun;
- v) faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 11

Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për VNM-në paraprahe

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Në përfundim të procedurës paraprahe të VNM-së, AKM-ja merr vendim nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.
2. Nëse AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, atëherë në vendimin e saj përcakton:
 - a) arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur mendimi;
 - b) mendimin e institucioneve të konsultuara;
 - c) përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar dhe, nëse është e mundur, për të korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis.
3. Vendimi i AKM-së për VNM-në paraprahe i dërgohet ministrisë, i njoftohet palëve të përfshira në proces dhe publikohet në faqen elektronike të AKM-së dhe ministrisë. Ministria i dërgon zhvilluesit vendimin.

Neni 12

Deklarata mjedisore

(Ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Në përfundim të procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri lëshon deklaratën mjedisore, e cila mund t'i sugjerojë autoritetit planifikues:
 - a) miratimin e lejes së zhvillimit të atij projekti, pa asnjë vërejtje nga pikëpamja mjedisore;
 - b) miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;
 - c) refuzimin e kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.
2. Në rastin e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni deklarata përmban:
 - a) qëndrimin e ministrisë dhe, sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi;
 - b) konfirmimin se ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;
 - c) informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun;
 - ç) arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;
 - d) përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.
3. Në rastin e shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, deklarata mjedisore përmban edhe argumentet përkatëse për refuzimin e kërkesës për leje zhvillimi për projektin.
4. Deklarata mjedisore i njoftohet palëve të përfshira në proces dhe publikohet në faqen elektronike të AKM-së dhe ministrisë. Ministria i dërgon zhvilluesit deklaratën mjedisore.

Neni 13

Transferimi i vendimit apo i deklaratës mjedisore

(Ndryshuar titulli dhe pika 2 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Kur përgjatë kryerjes së procedurës së VNM-së ndodh ndryshimi i zhvilluesit të projektit, zhvilluesi i ri aplikon për procedurë të re VNM-je.

2. Kur zhvilluesi ndryshon pasi ka përfunduar procedura e VNM-së, zhvilluesi i ri kërkon pranë ministrisë të bëhet transferimi përkatës i vendimit apo deklaratës mjedisore, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, referuar në pikën 5, të nenit 7, të këtij ligji.

KREU III

PALËT DHE KONSULTIMI GJATË PROCESIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Neni 14

Palët e përfshira në procesin e VNM-së

1. Në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis marrin pjesë:
 - a) zhvilluesi i projektit;
 - b) ministria dhe strukturat e saj të varësisë;
 - c) ministritë e linjës dhe strukturat e varësisë;
 - ç) njësitë e qeverisjes vendore;
 - d) publiku dhe organizatat jofitimprurëse;
 - dh) institucionet që kanë përgjegjësi të përfshihen në procesin e VNM-së;
 - e) shtetet fqinje, në rast të VNM-së në kontekst ndërkufitar, sipas kërkesave të Konventës së ESPOO-s.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të varësisë së ministrisë, në procesin e VNM-së, rregullohen me udhëzim të ministrit.

Neni 15

Mendimi i institucioneve të tjera

1. Gjatë procedurës së VNM-së, AKM-ja dhe ministria, sipas kompetencave, konsultohen edhe me institucionet e përmendura në shkronjat “c”, “ç” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, duke u dërguar edhe kopje të dokumentacionit të paraqitur nga zhvilluesi i projektit.
2. Institucionet e konsultuara japin brenda afatit të kërkuar mendimin e tyre, sipas funksioneve dhe përgjegjësi përkatese.
3. Nëse institucionet e lartpërmendura nuk paraqesin mendimet e tyre brenda afatit të kërkuar nënkuptohet se ato janë dakord me zhvillimin e projektit dhe nuk kanë komente.

Neni 16

Informimi i publikut gjatë VNM-së

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Zhvilluesi për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij.
2. Informacionin për informimin dhe konsultimin me publikun zhvilluesi e paraqet si pjesë të dokumentacionit të nevojshëm gjatë aplikimit për deklaratën mjedisore në ministri.

Neni 17

Seanca dëgjimore gjatë VNM-së

1. AKM-ja gjatë procedurës së VNM-së së thelluar, zhvillon seancë dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara, duke synuar tërheqjen e mendimit të tyre në vendimarrjen përfundimtare për projektin.

2. Seanca dëgjimore zhvillohet në bashkëpunim edhe me njësinë e qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit.

3. Menjëherë pas përcaktimit të vendit, datës dhe orës për zhvillimin e seancës dëgjimore, njësia e qeverisjes vendore bën njoftimin drejtuar publikut dhe OJF-ve të interesuara për të marrë pjesë në takim.

4. Mendimi dhe komentet e publikut e të OJF-ve, të pranishëm në takim, janë kriter i domosdoshëm, gjatë procesit të vendimmarrjes së VNM-së.

5. Rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

KREU IV

DHËNIA E INFORMACIONIT DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE KONFIDENCIALE

Neni 18

Vënia në dispozicion e informacionit për zhvilluesin

Autoritetet publike, me kërkesë me shkrim të zhvilluesit, vënë në dispozicion të tij informacionin e disponueshëm për përgatitjen e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 19

Informacioni konfidencial

(Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Kur zhvilluesi pretendon se informacioni që paraqet pranë ministrisë është konfidencial, ai ia vërteton ligjërisht konfidencialitetin e informacionit ministrisë në momentin e aplikimit, bazuar në legjislacionin në fuqi.

2. Procedurat e kategorizimit të informacionit si konfidencial kryhen përpara aplikimit në ministri, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

VENDIMI I AUTORITETIT TË PLANIFIKIMIT/LICENCIMIT

Neni 20

Vendimi i autoritetit të planifikimit ose autoriteteve të tjera përgjegjëse për licencimin e veprimtarive

1. Autoriteti i planifikimit ose autoriteti përgjegjës për licencimin, kur shqyrton dhënien ose jo të lejes së zhvillimit/licencës përkatëse për një projekt, apo vendosjen e kushteve për zhvilluesin, merr në konsideratë vendimin dhe deklaratën mjedisore për ndikimet në mjedis të projektit të propozuar.

2. Autoriteti i planifikimit ose autoriteti përgjegjës për licencim, përpara vendimit për dhënien ose jo të lejes së zhvillimit apo licencës përkatëse për një projekt të propozuar, sigurohet që projekti t’i jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me vendim apo deklaratë. Vendimi apo deklarata për projektin e propozuar është i vlefshëm për aq kohë sa është e vlefshme dhe leja e zhvillimit/licenca përkatëse për projektin.

3. Në rast se autoriteti përgjegjës për zhvillimin/licencimin e projektit merr vendim për zhvillimin/licencimin ose jo të projektit, në kundërshtim me deklaratën, atëherë ai jep argumentet përkatëse për këtë vendim.

4. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.

5. Nëse veprimtaria apo projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës apo vendimi për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Neni 21

Zonat veçanërisht të mbrojtura

1. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në rastet kur veprimtaria e propozuar nuk ka të bëjë drejtpërdrejt apo nuk është e nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera mund të shkaktojë efekte të rëndësishme mbi atë zonë.

2. Kur AKM-ja apo ministria, në përfundim të procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti, shprehet se veprimtaria e propozuar, veçmas apo në bashkëveprim me veprimtari ose plane dhe projekte të tjera, të realizuara apo të propozuara, mund të ketë ndikim negativ të rëndësishëm mbi integritetin e një zone veçanërisht të mbrojtur, atëherë autoriteti përgjegjës që mbulon fushën e projektit, nuk lejon zhvillimin e tij, me përjashtim të rasteve kur:

- a) nuk ka zgjidhje tjetër alternative;
- b) veprimtaria e propozuar duhet të zbatohet për arsye urgjente të interesave madhorë të publikut, përfshirë edhe ata me natyrë shoqërore apo ekonomike;
- c) duhen marrë të gjitha masat kompensuese për të siguruar zbatimin e kërkesave të “Natyra 2000”.

3. Arsye urgjente të interesave madhorë të publikut që merren në konsideratë, siç parashikohet në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, kur zona veçanërisht e mbrojtur përmban lloje habitatesh natyrore prioritare dhe/ose specie prioritare, janë vetëm ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut apo sigurinë e publikut, ose që sjellin ndikime të rëndësishme pozitive për mjedisin.

KREU VI

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

Neni 22

Efektet ndërkufitare në Shqipëri

1. Kur AKM-ja merr informacion, apo kur pranë saj është depozituar një raport VNM-je nga një shtet tjetër për një projekt të propozuar, që mund të ketë efekte të rëndësishme mbi mjedisin në Shqipëri, njofton menjëherë ministrinë për të filluar bisedimet me shtetin në fjalë për procedurat dhe afatin e paraqitjes së mendimeve për projektin e propozuar.

2. Kur ministria nuk ka marrë informacion nga shteti tjetër për një projekt të propozuar, që mund të ketë efekte të rëndësishme mbi mjedisin, ajo kërkon:

- a) përshkrimin e projektit së bashku me çdo informacion të disponueshëm për efektet e tij të mundshme ndërkufitare;
- b) informacion për natyrën e vendimit që mund të merret nga shteti tjetër.

3. Ministria, bazuar në informacionin e marrë sipas pikave 1 e 2 të këtij neni dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, vendos nëse duhet të marrë pjesë apo jo në procesin e VNM-së.

4. Nëse ministria vendos të marrë pjesë në procesin e VNM-së, i kërkon shtetit tjetër informacion për projektin.

5. Ministria u dërgon, menjëherë, kopje të këtij informacioni institucioneve të interesuara për të proceduar me procesin e VNM-së së këtij projekti.

6. Për qëllime të këtij neni, me “Zhvilluesi” kuptohet “Ministria”.
7. Ministria i dërgon shtetit tjetër mendimet:
 - a) për projektin e propozuar;
 - b) e dhëna nga institucionet e referuara në pikën 5 të këtij neni;
 - c) e dhëna nga publiku.
8. Ministria merr masa për të zhvilluar konsultime me shtetin tjetër, në veçanti, për:
 - a) efektet e mundshme ndërkufitare të projektit të propozuar;
 - b) masat e parashikuara për reduktimin apo eliminimin e efekteve të tilla;
 - c) lidhjen e një marrëveshjeje, ku të përcaktohet edhe kohëzgjatja e periudhës së konsultimeve.

Neni 23

Vlerësimi i ndikimeve ndërkufitare mbi një shtet tjetër

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Kur ministria gjykon se një projekt i propozuar mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e një apo më shumë shteteve fqinje ose kur merr një kërkesë nga një shtet tjetër, ndjek procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar.
2. Rregullat dhe procedura për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

KREU VII

EKSPERTËT E VNM-SË

Neni 24

Certifikata dhe licenca për hartimin e raportit të VNM-së

(Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Zhvilluesi, për përgatitjen e raportit paraprak dhe raportit të thelluar të VNM-së, ngarkon personin fizik/juridik të licencuar nga QKL-ja, sipas kategorisë III.2.A të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Të drejtën për t’u pajisur me licencë III.2.A e kanë:
 - a) personi fizik i certifikuar nga ministri;
 - b) personi juridik, administratori i të cilit është i certifikuar nga ministri dhe ka të punësuar të paktën 2 ekspertë të certifikuar nga ministri.
3. Personi fizik/juridik i licencuar harton raportin e VNM-së duke krijuar grup specialistësh të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raporti i VNM-së. Raporti i VNM-së nënshkruhet nga personi fizik/juridik i licencuar dhe specialistët e përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së.
4. Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit. Ministri lëshon certifikatën.

KREU VIII

ANKIMI DHE SANKSIONET

Neni 25

(Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

Çdo palë e interesuar, subjekt i këtij ligji, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative te ministri ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të ministrisë dhe AKM-së, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 26

Sanksionet

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

1. Zhvilluesi ngarkohet me përgjegjësi ligjore, sipas legjislacionit në fuqi për pavërtetësinë e fakteve, të të dhënave të paraqitura dhe të dokumenteve që shoqërojnë kërkesën e paraqitur prej tij.

2. Kur, për qëllimet e këtij ligji, zhvilluesi falsifikon dokumente apo përdor dokumente të falsifikuara, ndaj tij zbatohen dispozitat e seksionit VIII të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Në rast të paraqitjes mbi 3 herë të raporteve të VNM-së me dobësi/mangësi, bazuar në metodologjinë kombëtare për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri vendos pezullimin e përkohshëm apo heqjen e certifikatës dhe njofton QKL-në për masën përkatëse.

KREU IX

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Tarifat e shërbimit

1. Për kryerjen e procesit të VNM-së, zhvilluesi paguan tarifën përkatëse të shërbimit, me paraqitjen e raportit paraprak të VNM-së ose me paraqitjen e raportit të thelluar të VNM-së.

2. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet që kryen ministria për procesin e VNM-së, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe Ministrit të Financave.

Neni 28

Raportimet për zbatimin e ligjit

1. Ministria publikon raporte vjetore për zbatimin e këtij ligji.

2. Autoriteti planifikues, si dhe institucionet që licencojnë veprimtari lidhur me projektet që janë subjekt i këtij ligji, njoftojnë menjëherë ministrinë për vendimin, për miratimin ose jo të licencës apo lejes së zhvillimit, me qëllim që t’i mundësojnë kësaj të fundit monitorimin e zbatimit të kërkesave mjedisore nga zbatimi i projektit, si dhe hartimin e raportit për zbatimin e këtij ligji.

3. Ministri, me udhëzim të veçantë, miraton formatin e duhur për përgatitjen e këtij raporti.

Neni 29

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5 të nenit 7, të pikës 5 të nenit 17, të pikës 2 të nenit 23 dhe të pikës 3 të nenit 24 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të pikës 4 të nenit 7, të pikës 2 të nenit 14 dhe të pikës 3 të nenit 28 të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin që, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, të miratojë udhëzimin sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 30

Shfuqizimet

1. Me fillimin e zbatimit të këtij ligji, shfuqizohet ligji nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, që bien ndesh me këtë ligj.

2. Procedurat e VNM-së, deri në fillimin e zbatimit të këtij ligji, zhvillohen në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8990, datë 23.1.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, vendimi nr.1429, datë 29.1.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për vlerësimin e veprimtarive dhe projekteve me ndikime të rëndësishme negative në mjedisin e vendeve fqinje”, shfuqizohet.

Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 18 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7055, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

SHTOJCA I

PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË THELLUAR TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

1. Rafineritë e naftës bruto (duke përjashtuar ndërmarrjet që prodhojnë vetëm lubrifikantë nga nafta bruto) dhe instalimet për gazifikimin ose lëngëzimin e 500 tonë ose më shumë qymyr ose argjilë/shiste bitumonoze në ditë.

2. Termocentrale ose instalime të tjera me djegie, me një prodhim nxehtësie prej 20 ose më shumë megavatësh.

3. Stacionet e energjisë bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë, duke përfshirë edhe çmontimin ose nxjerrjen e tyre nga përdorimi (me përjashtim të instalimeve kërkimore për prodhimin dhe shndërrimin e materialeve të ndashme (të zbërthyeshme) ose të riprodhueshme, fuqia maksimale e të cilave nuk e tejkalon ngarkesën termale të vazhdueshme prej 1 kilovati). Stacionet e energjisë bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë pushojnë së qeni të tillë, kur lënda bërthamore dhe elemente të tjera radioaktive të ndotura janë zhvendosur për një kohë të gjatë nga vendi i instalimit.

4. a) Instalimet për ripërpunimin e lëndës djegëse bërthamore të rrezatuar.

b) Instalimet e projektuara për:

i) prodhimin ose pasurimin e lëndës djegëse bërthamore;

ii) për përpunimin e lëndës djegëse të rrezatuar bërthamore ose mbetjeve me nivel të lartë radioaktiv;

iii) për hedhjen përfundimtare të lëndës djegëse të rrezatuar;

iv) vetëm për asgjësimin/depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive;

v) vetëm për ruajtjen (e planifikuar për më tepër se 10 vjet) të lëndës djegëse të rrezatuar bërthamore ose mbetjeve radioaktive në një vend të ndryshëm nga vendi i prodhimit.

Vepra të integruara për shkrirjen fillestare të hekurit të derdhur dhe çelikut.

Instalime për prodhimin e metaleve bruto johekur nga xeherorët, koncentratet ose materialet dytësore (material që është nënprodukt) prej proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike.

5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin ose transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produktet e çimentos me bazë asbesti, me një prodhim vjetor prej më tepër se 20 000 tonë produkt final, për materiale abrazive me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 tonë produkt final dhe për përdorime të tjera të asbestit me përdorim mbi 200 tonë në vit.

6. Instalime të integruara kimike, domethënë instalime për prodhimin në shkallë industriale të substancave që përdorin proceset e shndërrimit kimik, ku shumë njësi janë vendosur përballë njëra-tjetrës dhe janë të lidhura funksionalisht me njëra-tjetrën për:

- a) prodhimin e kimikateve bazë organike;
- b) prodhimin e kimikateve bazë inorganike;
- c) për prodhimin e plehrave kimike (të thjeshta apo të përbëra) me bazë fosfori, azoti ose potasiumi (fertilizatorë të thjeshtë ose të përbërë);
- ç) për prodhimin e produkteve bazë për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe biocideve;
- d) për prodhimin e produkteve farmaceutike bazë, duke përdorur një proces kimik ose biologjik;

dh) për prodhimin e eksplozivëve.

7. a) Ndërtimi i linjave për trafik hekurudhor me distanca të gjata.

b) Ndërtimi i aeroporteve me pista që kanë një gjatësi bazë prej 2100 m ose më tepër. Në kuptim të këtij ligji, “aeropot” nënkupton aeroporte, të cilat përputhen me përkufizimin e dhënë në Konventën e Çikagos më 1944, që themeloi Organizatën Ndërkombëtare Civile të Aviacionit (shtojca 14 e kësaj konvente).

c) Ndërtimi i autostradave dhe rrugëve ekspres (korsive të autostradave për shpejtësi të lartë). Në kuptim të këtij ligji, “rrugë ekspres” është një rrugë që plotëson kushtet e dhëna në përkufizimin e marrëveshjes europiane mbi Arteriet Kryesore të Trafikut Ndërkombëtar, 15 nëntor 1975.

ç) Ndërtimi i një rruge të re me katër ose më shumë korsi, ose rregullimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese, që ka dy apo më pak korsi, në mënyrë që të bëhet me katër ose më shumë korsi, kur rruga e re ose seksioni i rregulluar dhe/ose i zgjeruar i saj do të jetë 10 kilometra ose më shumë në gjatësi të vazhdueshme.

8. a) Rrugë ujore në brendësi të tokës dhe porte për transportin e brendshëm ujor, që lejojnë kalimin e anijeve me mbi 1350 tonë.

b) Portet tregtare, kalatat për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën dhe portet e jashtme (me përjashtim të kalatave të trageteve) që mund të marrin anije me mbi 1350 tonë.

9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

10. Instalime për asgjësimin e mbetjeve, për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, të mbetjeve jo të rrezikshme me një kapacitet mbi 50 tonë në ditë, sikurse përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

11. Nxjerrja e ujit nëntokësor ose skema të rimbushjes artificiale të ujit nëntokësor, ku volumi vjetor i ujit të nxjerrë apo të rimbushur është 10 milionë metër kub ose më shumë.

12. a) Veprat për transferimin e burimeve ujore midis baseneve lumore, kur ky transferim synon në parandalimin e mungesave të mundshme të ujit dhe ku masa e ujit të transferuar e kalon nivelin prej 20 milionë metër kub në vit;

b) Në të gjitha rastet e tjera, veprat për transferimin e burimeve ujore midis baseneve lumore, kur rrjedha mesatare shumëvjetore e basenit të nxjerrjes është mbi 2000 milionë metër kub në vit dhe ku masa e ujit të transferuar e tejkalon nivelin e 5 për qind të kësaj rrjedhe.

Në të dyja rastet, përjashtohen transferimet e tubacioneve të ujit të pijshëm.

13. Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, me kapacitet mbi 30 000 ekuivalent popullsie, sikurse përcaktohet në legjislacionin për rezervat ujore.

14. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare, ku masa e nxjerrë e tejkalon nivelin prej 50 tonë/ditë në rastin e naftës dhe 10 000 m³/ditë në rastin e gazit.

15. Diga dhe instalime të tjera, që janë projektuar për të penguar daljen e ujit ose për të depozituar ujin në mënyrë të përhershme, ku një masë e re ose shtesë uji e penguar ose e depozituar është mbi 10 milionë m³.

16. Tubacionet me një diametër prej më shumë se 800 mm dhe një gjatësi prej më shumë se 40 km:

- a) për transportimin e gazit, naftës, kimikateve; dhe

b) për transportimin e gazit të dyoksidit të karbonit (CO₂), me qëllim injektimin dhe ruajtjen e tij në formacione gjeologjike nën tokë, përfshirë stacionet e pompimit që lidhen me to.

17. Instalime për mbarëshkrimin intensiv të pulave ose derrave me mbi:

a) 1000 krerë për pulat që rriten për mish, 20 000 vende për pulat që rriten për vezë;

b) 3000 krerë për derra për prodhim mishi (mbi 30 kilogramë); ose

c) 100 krerë për dosa.

18. Impiante industriale për:

a) prodhimin e materialeve të buta ose materialeve të ngjashme fibroze;

b) prodhimin e letrës dhe tabelave me një kapacitet prodhues që e tejkalon masën prej 50 tonësh në ditë.

19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

20. Ndërtimi i linjave elektrike në lartësi me një voltazh mbi 220 kV dhe gjatësi mbi 10 kilometra.

21. Instalimet për depozitimin e naftës, prodhimeve petrokimike ose kimike, me një kapacitet prej 50 000 ose më shumë tonësh.

22. Vendet e injektimit dhe ruajtjes së dyoksidit të karbonit në formacione gjeologjike nën tokë, të përcaktuara me akt normativ të posaçëm.

23. Instalimet për kapjen e gazit të dyoksidit të karbonit (me qëllim injektimin dhe ruajtjen në formacione gjeologjike nën tokë) nga instalime të tjera që mbulohen nga kjo shtojcë, ose ku kapja totale vjetore e dyoksidit të karbonit është 1,5 megatonë ose më shumë se kaq.

SHTOJCA II

PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS PARAPRAKETË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

1. Bujqësia, silvikultura dhe akuakultura.

a) Projekte për ristrukturimin e tokës rurale;

b) Projekte për përdorimin e tokës së pakultivuar ose zonave gjysmënatyrore për qëllime të bujqësisë intensive;

c) Projekte për menaxhimin e ujit për bujqësi, duke përfshirë dhe ujitjen dhe projektet e kullimit të tokës;

ç) Pyllëzimi fillestar dhe shpyllëzimi për qëllimet e ndryshimit në një lloj tjetër të përdorimit të tokës.

d) Instalime për rritjen intensive të kafshëve (projektet që nuk përfshihen në shtojcën I);

dh) Rritje intensive e peshkut;

e) Marrje e tokës nga deti.

2. Industri nxjerrëse.

2.1 Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrje e torfës (projekte që nuk janë përfshirë në shtojcën I);

2.2 Minierat nëntokësore;

2.3 Nxjerrje e mineraleve nga marina ose llumrat lumore;

2.4 Shpim i thellë, në veçanti:

a) shpim gjeotermal;

b) shpim për depozitimin e materialeve të mbetjeve bërthamore;

c) shpim për furnizim me ujë, me përjashtim të shpimit për studimin e stabilitetit të tokës.

2.5 Instalime sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, naftës, gazit natyror dhe xeherorëve, si dhe të argjilave/shisteve bituminoze.

3. Industria e energjisë.

a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);

b) Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë; transmetimin e energjisë elektrike me kablo në lartësi (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);

c) Depozita sipërfaqësore të gazit natyror;

ç) Depozita nëntokësore të gazeve të djegshme;

d) Depozita sipërfaqësore të lëndëve djegëse fosile;

dh) Briketimi industrial i qymyrit dhe i linjtit;

e) Instalime për përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive (në rast se nuk janë përfshirë në shtojcën I);

ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike;

f) Instalime për përdorimin e fuqisë së erës për prodhim energjie (stacione të energjisë së erës);

g) Instalimet për kapjen e gazit të dyoksidit të karbonit (me qëllim injektimin dhe ruajtjen në formacione gjeologjike nën tokë) nga instalime të tjera që nuk mbulohen nga shtojca I e këtij ligji.

4. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve.

a) Instalime për prodhimin e gizës dhe çelikut (shkrirje parësore ose dytësore);

b) Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku:

i) mullinj me rula të nxehtë;

ii) farkat me çekiç;

iii) aplikimi i mbulesave mbrojtëse me metal të shkrirë.

c) Fonderitë e metaleve hekurore;

ç) Instalime për shkrirjen, duke përfshirë aliazhet të metaleve johekurore, përveç metaleve të çmuara, duke përfshirë produktet e rikuperuara (rafinim, derdhje në fonderi etj.);

d) Instalime për trajtimin sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike, duke përdorur një proces elektrolitik ose kimik;

dh) Prodhimi dhe montimi i mjeteve motorike dhe prodhimi i motorëve për këto mjete;

e) Kantier ndërtimi anijesh;

ë) Instalime për ndërtimin dhe riparimin e avionëve;

f) Prodhimi i pajisjeve për hekurudha;

g) Farkëtim me eksploziv;

gj) Instalime për pjekjen dhe aglomerimin e xeherorëve metalorë.

5. Industria minerale.

a) Furrat me qymyr (distilim i qymyrit të thatë);

b) Instalimet për prodhimin e çimentos;

c) Instalime për prodhimin e asbestit dhe prodhimin e produkteve të asbestit, që nuk janë përfshirë në shtojcën I;

ç) Instalime për prodhimin e qelqit, duke përfshirë dhe fibrat e qelqit;

d) Instalimet për shkrirjen e substancave minerale, duke përfshirë dhe prodhimin e fibrave minerale;

dh) Prodhimi i produkteve qeramike nëpërmjet djegies, në veçanti tjegullat për çati, tullat, tullat zjarrduruese, pllakat, veshjet prej guri ose porcelani.

6. Industria kimike (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I).

a) Trajtim i produkteve ndërmjetëse dhe prodhimi i kimikateve;

b) Prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, bojërave dhe llaqeve, elastomerëve dhe peroksive;

c) Depozitat e produkteve të naftës, petrokimike dhe kimike.

7. Industria ushqimore.

a) Prodhimi i vajrave dhe yndyrnave vegjetale dhe shtazore;

b) Prodhimi, përpunimi dhe paketimi i produkteve shtazore dhe bimore;

c) Prodhimi i produkteve me bazë qumështi;

ç) Prodhimi i birrës dhe maltos;

d) Prodhimi i ëmbëlsirave dhe i shurupeve;

dh) Instalime për therjen e kafshëve;

- e) Instalime industriale për prodhimin e niseshtesë;
 - ë) Fabrika për prodhimin e ushqimeve me bazë peshku dhe vajrave të peshkut;
 - f) Fabrika sheqeri.
8. Industria tekstile, e lëkurës, drurit dhe letrës.
- a) Fabrika industriale për prodhimin e letrës dhe kartonit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
 - b) Impiante për paratrajtimin (për operatione të tilla, si: larje, zbardhje, mercerizim) ose ngjyrosja e fibrave apo tekstileve;
 - c) Fabrika për regjie të lëkurave;
 - ç) Instalime për përpunimin dhe prodhimin e celulozës.
9. Industria e gomës.
- Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me bazë elastometri.
10. Prodhime infrastrukturore.
- a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;
 - b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat;
 - c) Ndërtimi i mjediseve të shërbimeve hekurudhore dhe terminaleve të transportit intermodal (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
 - ç) Ndërtimi i fushave ajrore (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
 - d) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
 - dh) Ndërtime në tokë të kanaleve të lundrueshme, që nuk përfshihen në shtojcën I, kanalizime dhe vepra për largimin e ujit të shkaktuar nga përmbytjet;
 - e) Diga dhe instalime të tjera të projektuara për të penguar ose për të mbajtur/depozituar ujë në periudha afatgjata (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
 - ë) Tramvaj, hekurudha nëntokësore dhe në lartësi, linja të varura/teleferikë ose linja të ngjashme të një lloji të veçantë, të përdorura ekskluzivisht ose kryesisht për transport pasagjerësh;
 - f) Instalime tubacionesh naftë dhe gazi (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I) dhe tubacionet e transportit të gazit dyoksid karboni, me qëllim injektimin dhe ruajtjen në formacione gjeologjike nën tokë;
 - g) Instalime të kanaleve ujësjellës/akuedoteve në distanca të largëta;
 - gj) Veprat bregdetare kundër erozionit dhe punimet në det, që mund të ndryshojnë bregun për shkak të ndërtimeve, për shembull: të digave, moleve, bankinave të ankorimit dhe punimeve të tjera për mbrojtje nga deti, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe rindërtimin e veprave të tilla;
 - h) Nxjerrja e ujit nëntokësor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujërave nëntokësore, që nuk janë përfshirë në shtojcën I;
 - i) Veprat për transferimin e burimeve ujore midis baseneve lumore, që nuk janë përfshirë në shtojcën I.
11. Projekte të tjera.
- a) Rrugët e përhershme për gara dhe provat e mjeteve motorike;
 - b) Instalimet për asgjësimin e mbetjeve (projekte të cilat nuk përfshihen në shtojcën I);
 - c) Impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura (projekte që nuk përfshihen në shtojcën I);
 - ç) Vendet për depozitim të llumrave;
 - d) Depot e skrapit të hekurit, përfshirë ato nga automjetet;
 - dh) Bankat e provës për motorët, turbinat ose reaktorët;
 - e) Instalimet për prodhimin e fibrave minerale artificiale;
 - ë) Instalimet për rikuperimin ose shkatërrimin e substancave shpërthyes;
 - f) Qendra blerje/grumbullimi të kafshëve shtëpiake të plakura/të sëmura apo qendrat e asgjësimit të kafshëve dhe produkteve të tyre jo për konsum njerëzor.**
12. Turizmi dhe koha e lirë.
- a) Pistat e skive, teleferikët, ngritësit me kabllo dhe zhvillimet që lidhen me to;

- b) Vendqëndrimet e jahteve dhe anijeve;
- c) Fshatra turistike dhe komplekse hotelesh jashtë zonave urbane bashkë me zhvillimet që i shoqërojnë ato;
- ç) Vendet për kampe të përhershme dhe karavane;
- d) Parqe tematike.

LIGJ
Nr. 81/2017

PËR ZONAT E MBROJTURA³¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky ligj ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale e kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësisë të institucioneve publike dhe personave fizikë/juridikë privatë për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre, nëpërmjet:

a) evidentimit, përcaktimit dhe shtimit të zonave të mbrojtura mjedisore ose zgjerimit të atyre ekzistuese;

b) sigurimit, ruajtjes, rehabilitimit dhe ripërtëritjes së ekosistemeve të habitateve natyrore, të llojeve, të rezervave dhe të peizazheve natyrore brenda zonave të mbrojtura mjedisore;

c) përdorimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore, duke integruar elementë të tij në strategjitë, planet, programet dhe vendimarrjet e të gjitha niveleve.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për sipërfaqet e përfshira brenda kufijve të zonave të mbrojtura mjedisore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet:

³¹ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 maj 1992, "Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër", të ndryshuar", Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 206, datë 22.7.1992, faqe 7-50.

Ligji nr. 81/2017, datë 4.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 116, datë 23 maj 2017.

- a) shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit;
- b) zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm;
- c) lehtësimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e vlerësimit e shërbimeve të ekosistemeve (mjedisore);
- ç) informimin dhe edukimin e publikut për gjendjen dhe dobishmërinë e zonave të mbrojtura mjedisore.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrata e zonës së mbrojtur (AZM)” është organi vendor përgjegjës për ruajtjen dhe menaxhimin e një zone të mbrojtur.
2. “Administrata rajonale e zonave të mbrojtura (AdZM)” është organi lokal përgjegjës, në nivel qarku, për ruajtjen dhe menaxhimin e zonës/zonave të mbrojtura në territorin e këtij qarku.
3. “Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)” është institucioni publik qendror që drejton dhe administron veprimtarinë e ruajtjes e të menaxhimit të të gjitha zonave të mbrojtura mjedisore në Republikën e Shqipërisë.
4. “Biokorridor” (korridor ekologjik) është segmenti i peizazhit, që lidh bioqendrat dhe mundëson migrimin e organizmave e të bashkësive të tyre, si dhe shkëmbimin e të dhënave gjenetike ndërmjet tyre.
5. “Bioqendër” (qendra e biodiversitetit) është pjesa e peizazhit, ku sigurohen kushte afatgjata për riprodhimin dhe veprimtaritë jetësore të organizmave dhe për zhvillimin natyror të bashkësive të tyre.
6. “Ekosistem” është një kompleks dinamik, i përbërë nga komitete të bimëve, kafshëve e mikroorganizmave, si dhe mjedisi jo i gjallë, të cilat ndërveprojnë ndërmjet tyre si një njësi funksionale.
7. “Habitat” është mjedisi i disa individëve bimorë ose shtazorë, i popullatave ose i bashkësive të tyre.
8. “Habitate natyrore” janë sipërfaqet tokësore ose ujore, të dallueshme për nga tiparet gjeografike, abiotike dhe biotike, pavarësisht nëse janë tërësisht natyrore ose gjysmënatyrore.
9. “Habitat i një lloji” është një mjedis që përcaktohet nga faktorë specifikë, biotikë dhe abiotikë, ku lloji jeton në çdo fazë të ciklit biologjik të tij.
10. “Lloje me interes për komunitetin europian” janë lloje që, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, plotësojnë njërën nga kushtet e mëposhtme:
 - a) janë të rrezikuara, me përjashtim të atyre llojeve, shtrirja natyrore e të cilave është e parëndësishme në territor;
 - b) janë të prekshme, që do të thotë se ka të ngjarë të bëhen pjesë e kategorive “të rrezikuara” në një të ardhme të afërt, nëse faktorët shkaktarë vazhdojnë të veprojnë;
 - c) janë të rralla, që do të thotë se janë lloje me numër të kufizuar, të cilat, edhe pse për çastin nuk janë të rrezikuara apo të prekshme, ndodhen në situatë kritike. Këto lloje janë të lokalizuara në sipërfaqe gjeografike të kufizuara, ose janë të shpërndara në sipërfaqe të gjëra;
 - ç) janë endemike dhe kërkojnë vëmendje të posaçme për shkak të natyrës së veçantë të habitatit të tyre dhe/ose ndikimit të mundshëm të shfrytëzimit në habitatin përkatës dhe/ose ndikimit të mundshëm të shfrytëzimit të tyre mbi statusin e ruajtjes.
11. “Lloje prioritare” janë llojet me interes për komunitetin europian, të rrezikuara, për ruajtjen e të cilave Republika e Shqipërisë, për sa i përket shtrirjes së tyre natyrore, ka përgjegjësi të veçantë.
12. “Ministri” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore.

13. “Ministria” është ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore.
14. “Kurorë e gjelbër” përbëhet nga territore ose zona relativisht të vogla, që janë pronë e bashkive dhe plotësojnë masën e gjelbër të qyteteve në zonat periferike urbane.
15. “Park natyror bashkiak” përbëhet nga territore ose zona relativisht të vogla, që janë pronë e bashkive dhe që strehojnë elemente dhe vlera të natyrës së egër, si pyje, kullota, rezervuarë, ligatina, sipërfaqe ujore, detare e bregdetare.
16. “Peizazh” është një pjesë territori, ashtu siç konceptohet prej vetë popullatave, karakteri i të cilit varet nga veprimi i faktorëve natyrorë dhe/apo njerëzorë, si dhe nga ndërveprimi i tyre.
17. “Ranger” është punonjësi i AZM-së, me pozicionin e një ruajtësi e menaxheri të drejtpërdrejtë të zonës së mbrojtur mjedisore.
18. “Ruajtja” është tërësia e masave që ndërmerren për të mbajtur ose rivendosur në një status të favorshëm habitatet natyrore dhe popullatat e llojeve të florës dhe faunës së egër.
19. “Rrjeti i zonave të mbrojtura” është sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore me interes kombëtar në vendin tonë, që përzgjidhen për vlerat e ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve kryesore e përfaqësuese të vendit.
20. “Rrjeti ekologjik” është sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore dhe atyre me interes komunitar, sipas kategorive të shpallura në bazë të procedurave të këtij ligji dhe të lidhura me biokorridore.
21. “Rigjenerim” është procesi i rehabilitimit /restaurimit të ekosistemeve natyrore, i cili sigurohet në rrugë natyrale dhe/ose nëpërmjet ndërhyrjes me përdorim selektiv (të përzgjedhur) të habitateve brenda zonës së mbrojtur mjedisore.
22. “Shëndetësimi” është procesi i trajtimit të pyllit silvikultural nëpërmjet ndërhyrjeve me metoda teknike, duke eliminuar drurët të cilët shfaqin shenja të dëmtimit natyral dhe/ose artificial, të prekur nga sëmundje dhe/ose të dëmtuar për shkaqe natyrore, dhe duke garantuar vijimësinë e grumbullit nëpërmjet drurëve të shëndetshëm brenda zonës së mbrojtur mjedisore.
23. “Status i favorshëm i ruajtjes së një ekosistemi, habitati ose peizazhi” nënkuptohet se:
- a) shtrirja natyrore dhe sipërfaqet brenda kësaj shtrirjeje janë të qëndrueshme ose në rritje;
 - b) struktura dhe funksionet e veçanta, të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen afatgjatë, ekzistojnë dhe mund të vazhdojnë të ekzistojnë për të ardhmen e afërt;
 - c) llojet e veta tipike kanë një status të favorshëm ruajtjeje.
24. “Tipa habitati natyror, me interes për komunitetin europian” janë ato habitate, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që plotësojnë njërën nga kushtet e mëposhtme:
- a) janë në rrezik zhdukjeje në shtrirjen e tyre natyrore;
 - b) kanë një shtrirje të vogël natyrore, si pasojë e regresit të tyre ose sipërfaqes së tyre të kufizuar;
 - c) përfaqësojnë shembuj të jashtëzakonshëm të karakteristikave tipike të rajoneve biogeografike, alpine dhe mesdhetare.
25. “Tipat prioritarë të habitateve natyrore” janë tipat e habitateve natyrore, me interes për Komunitetin Europian, në rrezik zhdukjeje, të cilat ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, për ruajtjen e të cilave Republika e Shqipërisë ka përgjegjësi referuar akteve/marrëveshjeve /protokolleve të posaçme.
26. “Ujëvarë natyrore” është një formacion ku uji, nën veprimin e forcave të natyrës, pa ndërhyrjen e njeriut, bie në shtratin e vet lumor nga një lartësi jo më pak se 1 m.
27. “Zonë” është sipërfaqja e përcaktuar gjeografikisht, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi në aktin e shpalljes së saj si e tillë.
28. “Zonë e mbrojtur” është një hapësirë tokësore, ujore, detare e bregdetare, e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur, me kufij të qartë fizikë dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen/mbrojtjen afatgjatë të natyrës, e lidhur me shërbimet e ekosistemit dhe të vlerave kulturore.
29. “Zonë e mbrojtur detare” është çdo sipërfaqe detare, bregdetare e nënujore, shtrati i detit dhe ishujt, së bashku me ujin, florën, faunën, habitatet e peizazhin dhe karakteristikat historike, kulturore e arkeologjike, që shpallet zonë e mbrojtur detare në njërën prej kategorive të përcaktuara në këtë ligj.

30. “Zonë buferike” është hapësira e kufizuar, në periferi të zonës së mbrojtur mjedisore, që shërben për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjikisht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të zonës së mbrojtur.

31. “Zonë me interes për komunitetin europian” është zona, e cila në rajonet biogeografike ose në rajonet të cilave u përket kontribuon dukshëm në ruajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të një tipi habitati natyror ose lloji për ruajtjen e diversitetit biologjik brenda rajonit biogeografik ose rajoneve në fjalë.

32. “Zona të veçanta ruajtjeje” janë zona me rëndësi për komunitetin europian, të përcaktuara si të tilla nga Republika e Shqipërisë me një akt nominal, ku përcaktohen masat e nevojshme të ruajtjes, me qëllim ruajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të habitateve natyrore ose të popullatave të llojeve, për të cilat është përcaktuar zona.

33. “Zona me rëndësi për biodiversitetin” janë zonat që kontribojnë në mënyrë themelore për ruajtjen e biodiversitetit dhe përfaqësojnë territoret më të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit në shkallë botërore dhe që identifikohen në nivel kombëtar duke përdorur kriteret e standardizuara.

34. “Sistemi kombëtar i territorit të zonave të mbrojtura” është tërësia e të dhënave për administrimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura mjedisore, nën administrim të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore.

35. “Shkallë e parë mbrojtjeje (strikte)” është shkalla e mbrojtjes që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe sigurimin e një zone natyrore të pasqetësuar.

36. “Shkallë e dytë mbrojtjeje” është shkalla e mbrojtjes që ka si funksion ruajtjen parësore të biodiversitetit dhe sigurimin e një zone natyrore pak të shqetësuar nga veprimtaritë tradicionale dhe ekoturistike.

37. “Shkallë e tretë mbrojtjeje” është shkalla e mbrojtjes që ka si funksion ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike e turistike, të infrastrukturës për banorët e zonës dhe komunitetin e biznesit.

Neni 4 Parimet

Menaxhimi e ruajtja e zonave të mbrojtura mjedisore realizohet nëpërmjet zbatimit të parimeve si më poshtë:

a) Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm. Nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të kujdesshëm, burimet e tokës, përfshirë ajrin, ujin, florën dhe faunën, ruhen për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm nëpërmjet zhvillimit që plotëson nevojat e tanishme pa kërcënuar nevojat e brezave të ardhshëm.

b) Parimi i integritetit. Integriteti i politikave të mbrojtjes së mjedisit në ato të zhvillimit ekonomik, pasi zhvillimi i mjedisit është i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të vendit.

c) Parimi “ndotësi paguan”. Subjektet, që me veprimet apo mosveprimet e tyre ndotin dhe/apo dëmtojnë mjedisin brenda e jashtë zonës së mbrojtur, paguajnë për rehabilitimin e tij.

ç) Parimi i parandalimit dhe i marrjes së masave paraprake. Me anë të politikave dhe bazës ligjore përkatëse shteti merr masa paraprake për parandalimin e ardhjes së pasojave negative në mjedis nga aktiviteti njerëzor dhe faktorët natyrorë.

KREU II
SISTEMI KOMBËTAR I ZONAVE TË MBROJTURA
ZONAT E MBROJTURA, SHPALLJA E TYRE DHE KATEGORITË

Seksioni I
Sistemi kombëtar i zonave të mbrojtura

Neni 5
Sistemi kombëtar i zonave të mbrojtura

1. Tërësia e zonave të mbrojtura mjedisore përbën sistemin kombëtar të territoreve të mbrojtura, të shpallura me anë të legjislacionit të veçantë.
2. Në kategorizimin e zonave të mbrojtura mjedisore dhe në përcaktimin e statusit për secilën prej tyre, institucionet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë mbështeten në kriteret e Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës (IUCN).
3. Ministria, në bashkëpunim me AKZM-në, bashkërendon punën për ngritjen dhe administrimin e sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura.
4. Planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi për ngritjen e sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore specifikohet në Planin Specifik të tërësisë së zonave, dokument ky i cili përfshin:
 - a) objektivat e tërësisë së zonave të mbrojtura mjedisore;
 - b) kontributin e secilës zonë të mbrojtur mjedisore në arritjen e objektivave të tërësisë dhe atyre të rrjetit ekologjik;
 - c) mangësitë në mbulimin e të gjitha zonave me vlerë në këtë sistem;
 - c) planin e veprimit për të zbatuar dhe zhvilluar më tej sistemin.
5. Plan i Specifik hartohet nga ministria në përputhje me dokumentin e politikave strategjike të mbrojtjes së biodiversitetit dhe miratohet me urdhrë të ministrit e publikohet në Fletoren Zyrtare. Përditësimi i tij bëhet çdo 5 vjet dhe bëhet i aksesueshëm për publikun në faqen zyrtare elektronike të ministrisë.
6. Kostot e ngritjes, ruajtjes dhe administrimit të sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura mjedisore financohen nga Buxheti i Shtetit dhe donacionet.

Seksioni II
Llojet e zonave të mbrojtura, pronësia dhe format e qeverisjes

Neni 6
Llojet e zonave të mbrojtura

- Zonat e mbrojtura mjedisore, sipas llojit të interesit për të cilin ka marrë statusin e mbrojtjes, janë:
- a) zona të mbrojtura me interes kombëtar;
 - b) zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar ku bëjnë pjesë:
 - i) zonat “Ramsar”;
 - ii) zonat me interes për Komunitetin Europian (SACs), ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs);
 - iii) zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrjetit Emerald);
 - iv) zonat “Rezervë të biosferës”;
 - v) zonat e trashëgimisë natyrore.

Neni 7
Pronësia në zonat e mbrojtura

1. Zonat e mbrojtura mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare.
2. Pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në zonat e mbrojtura mjedisore është:

- a) shtetërore;
- b) private.

Neni 8

Format e administrimit/menaxhimit të zonave të mbrojtura

1. Forma e administrimit/menaxhimit mbi zonat e mbrojtura mjedisore është:
 - a) shtetërore;
 - b) private;
 - c) bashkiake;
 - ç) të kombinuara.
2. Forma e administrimit/menaxhimit për çdo zonë konkrete përcaktohet në vendimet e Këshillit të Ministrave që miraton krijimin e zonës, ndryshimin e statusit apo ndryshimin e sipërfaqes së saj.
3. Propozimi i formës së administrimit/ menaxhimit, që propozohet për miratim, bëhet pasi është marrë mendimi i komunitetit të zonës, i pronarëve privatë, është konsultuar me aktorë të ndryshëm të interesuar dhe është marrë pëlqimi paraprak i kryetarit të bashkisë përkatëse, ku shtrihet zona.
4. Në secilën formë të administrimit/ menaxhimit, menaxhimi dhe ruajtja e zonës mbështetet dhe zbaton parime, rregulla e kërkesa të njëjta që saktësohen në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Seksioni III

Objektivat, kriteret, procedura e shpalljes, zonimi

Neni 9

Objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura

Territoret shpallen zona të mbrojtura mjedisore për të përmbushur objektivat e përgjithshëm si më poshtë:

- a) të mbrojnë drejtimit e zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm të pasurive kombëtare nëpërmjet ruajtjes dhe menaxhimit të ekosistemeve, habitateve e peizazheve përfaqësuese, si dhe integrimin e administrimit të tyre në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë shtetërore, në nivel kombëtar e bashkiak;
- b) të sigurojë përdorimin e qëndrueshëm të elementeve të diversitetit biologjik, nëpërmjet përfshirjes së bashkive në vendimmarrje dhe veprimtari të tjera që lidhen me zonat e mbrojtura, që përfshijnë caktimin dhe përvijëzimin e zonave, hartimin e planeve të administrimit të integruar dhe drejtimin e zonave të mbrojtura;
- c) të përcaktojnë qartë objektivat e ruajtjes/ mbrojtjes për zonën e mbrojtur, duke përcaktuar shkakun e moslejimit të aktiviteteve në të;
- ç) të përjashtojë nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive nga ana e njeriut;
- d) të mos lejojë shfrytëzimin e tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;
- dh) të ndalojë rritjen dhe shpërndarjen e kafshëve dhe bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;
- e) të ndalojë ndërtimin e zonave urbane, si autostradave, hekurudhave, linjave të tensionit të lartë, veprave të mëdha hidrike dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë;
- ë) të ndalojë ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- f) të ndalojë çdo aktivitet që bie ndesh me objektivat e mbrojtjes së zonës.

Shpallja e zonave të mbrojtura

1. Identifikimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura bëhen në përputhje me Planin Specifik të zonave të mbrojtura dhe planin e administrimit të rrjetit ekologjik të vendit, si dhe dokumente të tjera strategjike të fushës së mbrojtjes së natyrës.

2. Zonat e mbrojtura mjedisore shpallen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura.

3. Në vendimin për shpalljen e zonës së mbrojtur mjedisore përcaktohen emërtimi, kategoria, sipërfaqja, institucioni menaxhues, objektivat e ruajtjes së zonës dhe shkalla e mbrojtjes së nënzonave të zonës së mbrojtur.

4. Shpallja e një zone të mbrojtur mjedisore bëhet në përputhje me planin kombëtar të zonave të mbrojtura, pas marrjes së mendimit të institucioneve akademike e shkencore në vend, të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilës ndodhet zona, të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës, të komunitetit të zonës dhe të pronarëve privatë, pronat e të cilëve do të përfshihen në zonën e mbrojtur.

5. Shpallen zona të mbrojtura mjedisore, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së shumëllojshmërisë biologjike, të peizazhit, të trashëgimisë natyrore e kulturore, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore, sipas njëres prej kategorive të caktuara në këtë ligj, territore që përfshijnë:

- a) pjesë tokësore, bujqësore, pyjore e kullosore;
- b) sipërfaqe ujore, liqene, laguna, lumenj, ujëmbledhës, bregdetare, detare e nëndetare, të cilat përmbajnë disa ekosisteme apo habitate karakteristike ose përfaqësuese;
- c) vlera unike të trashëgimisë natyrore biologjike dhe/ose lloje të florës e të faunës së egër të kërcënuar;
- c) trashëgimi të veçanta gjeologjike e gjeomorfologjike;
- d) qendra rurale, turistike e sportive, me karakter të rëndësishëm tradicional, ekologjik, estetik, me vlerë kulturore, arkeologjike, shpirtërore, edukative, rekreative dhe me mundësi hyrjeje për vizitorët, si dhe për kërkime shkencore.

6. Në propozimin për të shpallur një zonë të mbrojtur mjedisore përfshihen të paktën:

- a) argumentimi për krijimin e zonës së mbrojtur që mbështet objektivat e planit kombëtar të rrjetit përfaqësues të këtyre zonave, epërsitë dhe mangësitë e krijimit të zonës, zonimin e saj, si dhe shkallët e mbrojtjes, të propozuara për secilën zonë;
- b) rezultatet e procesit të këshillimit me komunitetin lokal e shoqërinë civile, veçanërisht miratimin me shkrim nga bashkia, brenda dhe rreth zonës së propozuar;
- c) një hartë e formatit GIS të vendit të propozuar;
- c) një vlerësim i ndikimit në mjedis, duke përfshirë identifikimin e proceseve dhe të kategorive të veprimtarive, të cilat mund ta kërcënojnë diversitetin biologjik dhe attribute të tjera të vendit të propozuar, përfshirë zonat përreth;
- d) një vëzhgim i ndikimit social dhe ekonomik të popullatës vendore, që përfshin situatën e përdorimit të territorit të propozuar dhe ndikimin e mundshëm të zonës së mbrojtur në këto përdorime;
- dh) një përshkrim i masave kompensuese, që mund të nevojiten të merren për të adresuar transferimin e pronësisë dhe të të drejtave për përdorimin e elementeve të diversitetit biologjik;
- e) pjesë e dokumentit të planifikimit për zonën përkatëse;
- ë) miratimi i Këshillit Kombëtar të Territorit mbi kufirin e zonës së mbrojtur dhe zonimin e brendshëm të saj.

7. Çdo person fizik a juridik ka të drejtë t'i kërkojë ministrisë që territori i vet privat ose pjesë e territorit në pronësi të tij të shpallen zonë e mbrojtur mjedisore ose të përfshihen në njëren nga kategoritë e zonave të mbrojtura.

8. Bashkia, brenda territorit administrativ të të cilit ndodhet zona, dhe pronarët (kur prona është private), merr masa të përkohshme për mbrojtjen dhe administrimin e zonës gjatë kohës që shqyrtohet propozimi për miratimin e saj.

Neni 11

Kriteret për shpalljen e një zone të mbrojtur

Për t'u shpallur "zonë e mbrojtur mjedisore", territori duhet të plotësojë, të paktën, njërën prej kriterëve të mëposhtme:

- a) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve;
- b) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve;
- c) të ketë përfaqësueshmëri;
- ç) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit;
- d) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet;
- dh) të ketë vlera shkencore;
- e) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/ llojet e prekshme;
- ë) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike;
- f) ka rrezikshmëri të lartë të kërcënohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore;
- g) mund të ofrojë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Neni 12

Procedurat për shpalljen e zonave të mbrojtura

1. Procedura për shpalljen e një zone të mbrojtur mjedisore është si më poshtë:

a) Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore përgatit planin e shpalljes së zonave të mbrojtura, ku përcaktohen zonat që synohen të shpallen të tilla, statusi, kufijtë dhe shkalla e mbrojtjes së secilës prej tyre.

b) Plani hartohet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, ministrinë përgjegjëse për rregullimin e territorit, ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me organet e qeverisjes vendore, me institutet kërkimore-shkencore përkatëse dhe shoqërinë civile.

c) Çdo organ e institucion shtetëror, qendror ose vendor, person juridik ose fizik, shoqatë jofitimprurëse ose komunitet, ka të drejtë të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura propozime për shpalljen e zonave të mbrojtura për ndryshimin ose heqjen e statusit të çdo zone të mbrojtur për zgjerimin ose zvogëlimin e kufijve të zonës dhe për zonimin e brendshëm të tyre.

ç) Për shpalljen e zonave të mbrojtura mjedisore merret parasysh rrjeti ekzistues i zonave të mbrojtura, i paraqitur në strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitetin.

d) Plani i shpalljes së zonave të mbrojtura mjedisore publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe në bashkinë apo qarkun ku ndodhet zona që propozohet të shpallet.

dh) Brenda një muaji nga dita e shpalljes së planit të zonave të mbrojtura, të interesuarit mund të bëjnë vërejtje e sugjerime, të cilat i paraqiten ministrisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura. Me kalimin e këtij afati dhe nëse nuk ka pasur vërejtje e kundërshtime, plani quhet i miratuar dhe në bazë të tij, ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura fillon procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen e projektvendimit për shpalljen e zonave të mbrojtura mjedisore.

2. Për shpalljen e një zone të mbrojtur mjedisore përcaktohen, paraprakisht, statusi i saj, kufijtë dhe zonimi i brendshëm, zona buferike rreth saj, administrata e ruajtjes së zonës dhe varësia e saj, mundësitë e përpunimit e të shfrytëzimit të zonës, të ardhurat që mund të krijohen dhe përdorimi i tyre në dobi të zonës.

3. Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore njofton publikun në faqen zyrtare të internetit të saj për zonat e mbrojtura të miratuara, për monumentet natyrore, për llojet e bimëve dhe të kafshëve veçanërisht të mbrojtura, për gjetjet minerare dhe paleontologjike, duke përcaktuar me hollësi kushtet për mbrojtjen e tyre.

4. Pas hartimit të propozimit për shpalljen e zonës së mbrojtur nga ana e ministrisë përgjegjëse për mjedisin, referuar nenit 10, të këtij ligji, ministri propozon projektvendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës.

Neni 13

Ndarja në nënzona i territorit të zonës së mbrojtur kombëtare

1. Territori i zonës së mbrojtur mjedisore për zonat e mbrojtura të kategorive “Park kombëtar”, “Rezervë natyrore e menaxhuar” dhe “Peizazh i mbrojtur” ndahet në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to, ndërsa për zonat e mbrojtura të kategorive “Rezervë strikte e mbrojtur” dhe “Monumentet e natyrës” nuk do të ketë nënzona, por zonë buferike.

2. Zonimi i brendshëm përmban:

- a) nënzonën qendrore;
- b) nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm;
- c) nënzonën e rekreacionit;
- ç) nënzonën buferike;
- d) nënzonën e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor.

3. Zonimi përputh shkallën e mbrojtjes me veçoritë e nënzonës, duke mbajtur parasysh natyrën e zonës, llojet e veprimtarive njerëzore që zhvillohen në të dhe ndikimin e tyre në mjedis.

a) Në nënzonën qendrore (që ka si funksion ruajtjen tërësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore të pashqetësuar) përdoret shkalla e parë e mbrojtjes (strikte).

b) Në nënzonat e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (që ka funksion ruajtjen parësore të biodiversitetit dhe siguron një zonë natyrore pak të shqetësuar nga veprimtaritë tradicionale dhe ekoturistike) përdoret shkalla e dytë e mbrojtjes.

c) Në nënzonat e rekreacionit (që ka funksion ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit në harmoni me zhvillimin e veprimtarive social-ekonomike e turistike, të infrastrukturës për banorët e zonës dhe komunitetin e biznesit) përdoret shkalla e tretë e mbrojtjes.

4. Nënzonimi brendshëm i një zone bëhet në përputhje me planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur, në bazë të kërkesave për mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur, të miratuar me udhëzim të ministrit.

5. Me qëllim parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjiksht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të një “Rezerve strikte të mbrojtur” dhe “Monumentet e natyrës”, përreth shpallet edhe një zonë buferike.

6. Zonimi i brendshëm i zonave të mbrojtura miratohet edhe nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), me propozimin e ministrit, përpara hyrjes në fuqi të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave që e shpall të mbrojtur zonën mjedisore konkrete, që do t’i miratohet zonimi i brendshëm.

Seksioni IV

Kategoritë e zonave të mbrojtura

Neni 14

Kategoritë e zonave të mbrojtura

Kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore janë:

- a) “Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I)”;
- b) “Park kombëtar (kategoria II)”;
- c) “Monument natyror (kategoria III)”;
- ç) “Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)”;
- d) “Peizazh i mbrojtur (kategoria V)”;

- dh) “Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI)”.
- e) “Park natyror bashkiak (kategoria IV)”;
- ë) “Kurorë e gjelbër (kategoria V)”.

Neni 15

Rezerva strikte natyrore (kategoria I)

1. “Rezervë strikte natyrore” shpallen territore ose zona, që zotërojnë disa ekosisteme të veçanta, karakteristike ose përfaqësuese, dhe/ose lloje të florës dhe/ose të faunës me rëndësi shkencore, të përshtatshme për kërkime shkencore dhe/ose monitorim dhe që janë pak ose aspak të shqetësuara nga njeriu. Kjo kategori përbëhet nga dy nënkategori kryesore:

a) nënkategoria A, që është “zona e mbrojtur”, e menaxhuar kryesisht për qëllime shkencore ose “rezervat shkencor”, që ruhet dhe menaxhohet për qëllime shkencore dhe mbrojtjen tërësore të botës së gjallë;

b) nënkategoria B, që është “zonë e mbrojtur”, e menaxhuar kryesisht për mbrojtjen e natyrës së egër ose “rezervë strikte natyrore”, që ruhet e menaxhohet në mënyrë të atillë që të ruajnë gjendjen e tyre natyrore.

2. Në rezervën strikte natyrore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, pasi në të janë të ndaluara të gjitha aktivitetet njerëzore që mund ta dëmtojnë dhe ku objektivat kryesorë janë:

a) ruajtja e biodiversitetit të zonës duhet të jetë e arritshme nëpërmjet mbrojtjes dhe të mos kërkojë menaxhim aktiv ose manipulim të habitateve;

b) të minimizohen çrregullimet dhe shqetësimet nëpërmjet planifikimit të kujdesshëm të realizimit të kërkimit shkencor dhe të aktiviteteve të tjera të miratuara;

c) të kufizohen kontaktet e publikut me zonën dhe të përjashtohet përdorimi i saj për pushim e çlodhje;

ç) të lejohet prania e vizitorëve pa mjete të motorizuara në atë nivel që t’i shërbejë sa më mirë mirëqenies fizike dhe shpirtërore të tyre dhe të ruhet cilësia e natyrës së egër të zonës për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Neni 16

Parku kombëtar (Kategoria II)

1. “Park kombëtar” shpallen territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1 000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, që ruhen dhe menaxhohen për mbrojtjen e ekosistemeve, llojeve, për edukim dhe rekreacion (çlodhje e argëtim), që rregullojnë përdorimin e qëndrueshëm nga ana e njeriut të burimeve natyrore.

2. Në “Parkun kombëtar” zbatohet shkalla e mbrojtjes mjedisore të zonës që ka si objektiv të mbajë territorin në gjendje natyrore, ku të ruhen komunitetet biotike, të resurseve gjenetike dhe llojeve për të siguruar stabilitetin ekologjik dhe diversitetin dhe ku:

a) përjashtohet njeriu nga shfrytëzimi ose zënia me aktivitete intensive;

b) nuk lejohet shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme sipërfaqen e tokës;

c) janë të ndaluara ndërtimi i zonave urbane, i autostradave, hekurudhave, linjave të prodhimit të energjisë, si hidrocentrale, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë;

ç) nuk lejohet ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;

d) çdo aktivitet që bie ndesh me objektivat e mbrojtjes së zonës dhe që përcaktohen në planin e menaxhimit.

3. Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari që sigurojnë krijimin e mundësive shpirtërore, shkencore, edukative, çlodhëse të vizitorëve, në përputhje me kërkesat mjedisore, kulturore dhe të planit të menaxhimit, por vetëm pasi të pajisen me miratimin e institucioneve shtetërore, që synojnë:

- a) ruajtjen e zonës në një gjendje natyrore ose sa më afër natyrës;
- b) respektimin e vlerave ekologjike, gjeomorfologjike, objekteve të shenjta ose estetike, për të cilat zona merret në mbrojtje;
- c) marrjen në konsideratë që banorët lokalë kanë të drejta, të tilla si, peshkimin, kullotjen dhe drutë e zjarrit, deri në atë masë sa ato të mos dëmtojnë objektivat e tjerë të menaxhimit.

4. Me propozim me shkrim dhe të arsyetuar të administratës së ruajtjes së zonës, AKZM-ja mund të miratojë:

- a) kullotjen dhe kalimin e kafshëve shtëpiake dhe ngritjen e objekteve të lehta ose të përkohshme për mbajtjen e tyre;
- b) vendosjen e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave;
- c) vozitjen me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi jomotorike, gjithmonë në rastin kur për aktivitete të tilla nuk nevojiten investime paraprake, të cilat kërkojnë që të ndryshojë sasia e ujit apo flukset e rrjedhave ujore në vendin e propozuar;
- c) fluturime joushtarake me helikopterë, balona, deltaplane etj;
- d) lëvizje dhe parkim automjeteve jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara;
- dh) ngjitje alpine, ski, kampingje dhe ndezje zjarri jashtë pikave të caktuara;
- e) mbledhje bimësh, frutash, farash e kërpudhash;
- ë) ushtrim veprimtarish të strukturave turistike sezonale që nuk kërkojnë zënie përfundimtare të tokës.

5. Kur administrata e ruajtjes së parkut vëren se cenohet qëllimi për të cilin zona është shpallur “Park kombëtar”, mund të kufizojë ose të ndalojë përkohësisht lëvizjen e mjeteve të transportit, peshkimin dhe veprimtari të tjera të lejuara.

6. Me propozimin e AKZM-së, ministri miraton udhëzimin për procedurat e ndalimit të përkohshëm të veprimtarive të miratuara kur po cenohet qëllimi për të cilin është shpallur zona e mbrojtur mjedisore.

7. Në planin e menaxhimit për parkun, sipas nënzonave të administrimit, caktohen qartazi dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e lejuara, të ndaluara dhe ato për të cilat kërkohet leje e lëshuar nga organet kompetente, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 17

Monument natyror (Kategoria III)

1. “Monument natyror” shpallet formacioni natyror (përfshirë edhe elemente të veçanta biologjike) formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralese ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike.

2. Në një “Monument natyror” zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”. Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument.

3. Monumentet natyrore rrethohen nga zona buferike me gjerësi deri në 200 metra nga perimetri i monumentit.

4. Në përputhje me shkallën e mbrojtjes së monumentit dhe me potencialet turistike e rekreacionin e zonës, ministri miraton me urdhër rregulla të veçanta për vizitat ose kalimin e vizitorëve a të turistëve, për afate të shkurtra kohore.

5. Rivlerësimi i listës së monumenteve të natyrës realizohet nga AKM-ja çdo 5 vjet dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Shpellat, kanionet e ujëvarat si monumente natyrore

1. Shpellë është një zgavër/hapësirë nëntokësore, më e gjatë se 5 m, e krijuar në kushte natyrore nën veprimin e faktorëve me origjinë joorganike, e cila shpallet “Monument natyror”. Kur zgavra/hapësira nëntokësore është vertikale quhet shpellë vertikale.

2. Kanioni është fenomeni geomorfologjik në formën e një gryke të thellë, me shpate të mprehta, të krijuara nga proceset fiziko-natyrore, në bazën e së cilës, përgjithësisht, rrjedhin ujërat sipërfaqësore sipas rëndësisë së evidentuar në propozimin e ministrit për t’u shpallur. Për kanionet merret si njësi për matjen gjatësia e kanionit.

3. Procedura e shpalljes realizohet pas kryerjes së studimit paraprak shkencor për plotësimin e kushteve nga kanionet dhe ujëvarat që ato të shpallen “Monument natyre”.

4. Hyrja në shpella, eksplorimi dhe studimi i tyre nga subjekte të specializuara, vendase ose të huaja, bëhen me miratimin paraprak me shkrim të AKZM-së, pasi ajo është konsultuar me institucionet shtetërore, me institucionet shkencore me organizatat jofitimprurëse të specializuara dhe me bashkinë përkatëse.

5. Rregullat e hyrjes, eksplorimit dhe studimit të shpellave miratohen me udhëzim të ministrit.

6. Zbulimi i shpellave të reja i njoftohet ministrisë dhe AKZM-së me raporte të hollësishme nga subjekti që e ka zbuluar. AKZM-ja bën njoftimet për zbulimin dhe publikon të dhënat e studimeve që gjykon se mund t’u interesojnë grupeve të interesit. Eksploruesve u njihet dhe u sigurohet e drejta e autorësisë së zbulimit, referuar legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit.

7. Rregullat, kriteret dhe procedurat për përdorimin e shpellave për qëllime turistike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore dhe ministrit përgjegjës për turizmin.

8. Për shpellat, kanionet e ujëvarat zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes, duke mos cenuar mundësinë e vizitimit të tyre për qëllime turistike e shkencore.

Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)

1. “Rezervat natyror i menaxhuar ose park natyror” shpallen territoret, që përfaqësojnë zona me ndërhyrje aktive të njeriut për qëllime menaxhimi të llojeve dhe habitateve, në mënyrë që të garantohet ruajtja e habitateve dhe të plotësohen kërkesat specifike të llojeve me rëndësi rajonale e vendore, si dhe zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore.

2. Objektivi i shpalljes së rezervatit natyror të menaxhuar është:

a) sigurimi dhe ruajtja e kushteve të habitatit, të domosdoshme për mbrojtjen e llojeve të rëndësishme, grup-llojeve, komuniteteve biotike ose karakteristikave fizike të mjedisit, që kërkojnë ndërhyrje të veçantë për një menaxhim optimal;

b) lehtësimi i kërkimit shkencor dhe monitorimi mjedisor si aktivitete parësore të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore;

c) dhënia e mundësisë popullsisë lokale të përfshirë brenda zonës të sigurojë përfitime ekonomike si një nga objektivat e menaxhimit;

ç) ngritja e zonave të kufizuara për edukimin mjedisor të publikut, vlerësimin e karakteristikave të habitateve dhe të punës për menaxhimin e llojeve në natyrë.

3. Në “Parkun natyror” nuk lejohet të zhvillohen aktivitetet e mëposhtme:

a) ndryshimet e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve ligatinore;

b) shfrytëzimi dhe zënia e zonës me aktivitete që bien ndesh me qëllimet për të cilat ajo është marrë në mbrojtje.

4. Duke marrë miratimin paraprak me shkrim të administratës së zonës së mbrojtur, në këto zona mund të ushtrohen veprimtaritë e mëposhtme:

a) lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;

b) mbledhja e bimëve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve që nuk dëmtojnë habitatin natyror;

c) ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje;

c) vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;

d) skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara.

5. Rregullat për kalimet e vizitorëve e të turistëve për afate të shkurtra kohore, me qëllim respektimin e masave mbrojtëse të përcaktuara në planin e menaxhimit, miratohen me udhëzim të ministrit, me propozimin e AKZM-së.

6. Në planin e menaxhimit për RNM/PN-të, sipas nënzonave të administrimit, caktohen qartazi dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e lejuara, të ndaluara dhe ato për të cilat kërkohet leje e lëshuar nga organet kompetente, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 20

Peizazh i mbrojtur (kategoria V)

1. “Peizazh i mbrojtur” shpallen territore të mëdha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, sipërfaqet brenda të cilave mund të ketë edhe qendra banimi që zhvillojnë aktivitete, si bujqësia, pemëtaria, pylltaria e peshkimi.

2. “Peizazhi i mbrojtur” menaxhohet për mbrojtjen e vlerave peizazhistike të zonës, diversiteti biologjik, si dhe për çlodhje e argëtim. Kjo kategori përfshin tokë/det/ujë në pronësi publike ose private.

3. Në një “peizazh të mbrojtur” zbatohet shkalla e mbrojtjes që ka si objekt kryesor:

a) fuqizimin e ndërveprimit harmonik të natyrës me kulturën për mbrojtjen e cilësisë të peizazhit, përdorimit tradicional të tokës, praktikave ndërtimore dhe manifestimeve sociale e kulturore, karakteristike të zonës;

b) mbështetjen e atyre mënyrave të jetesës dhe aktiviteteve ekonomike që janë në harmoni me natyrën dhe ruajtjen e konstitucionit shpirtëror dhe kulturor të popullsisë lokale;

c) eliminimin, ku është e domosdoshme, dhe parandalimin e përdorimit të tokës dhe kryerjen e aktiviteteve që janë të papërshtatshme në përmasa dhe/ose përmbajtje;

c) krijimin e mundësive për kënaqësi të publikut përmes çlodhjes dhe turizmit, në përputhje me karakterin dhe përmasat e karakteristikave thelbësore të zonës;

d) nxitjen e aktiviteteve shkencore dhe edukative, të cilat ndihmojnë në zhvillimin dhe mirëqenien për një kohë të gjatë të popullsisë lokale dhe në sigurimin e mbështetjes së gjerë publike për mbrojtjen e mjedisit të zonave të mbrojtura të tilla;

dh) sjelljen e përfitimeve ekonomike dhe dhënien e kontributit në rritjen e mirëqenies së popullsisë lokale përmes shfrytëzimit të produkteve natyrore, si pyje dhe prodhimi i peshkut, dhe shërbimeve, si uji i pastër ose të ardhura që vijnë nga format e përshtatshme të turizmit.

4. Veprimtaritë, që ndryshojnë përdorimin e territorit si ndërtimet, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane, si dhe veprimtari të ngjashme me këto, lejohen të ushtrohen vetëm nëse subjekti që kërkon të kryejë veprimtarinë është pajisur me leje nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

5. Për ushtrimin e veprimtarive të poshtëshënuara është i mjaftueshëm miratimi me shkrim i administratës së zonës së mbrojtur mjedisore:

a) përdorimi i kimikateve e i pesticideve për tokat bujqësore;

b) ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;

c) lëvizja me mjete transporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara. Ky rregull nuk zbatohet për automjetet dhe makineritë shtetërore, bujqësore e pyjore, të zjarrfikësve, autoambulancave, makinerive të shërbimeve veterinarë dhe atyre të menaxhimit të ujërave;

c) organizimi i garave me automjete, motoçikleta e biçikleta;

d) praktika të përdorimit unik apo tradicional të tokës dhe organizime sociale që shprehen në vendbanime njerëzore, zakonet lokale dhe besimet fetare, pas pajisjes me leje mjedisi.

6. Në planin e menaxhimit për PM-të, sipas nënzonave të administrimit, caktohen qartazi dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e lejuara, të ndaluara dhe ato për të cilat kërkohet leje e lëshuar nga organet kompetente, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 21

Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI)

1. “Zona të mbrojtura mjedisore të burimeve të menaxhuara” shpallen terriore të gjera, relativisht të izoluara dhe të pabanuara ose pak të populluara.

2. Këto zona përmbajnë kryesisht sisteme natyrore, që përcaktohen si të tilla që mbarështimi të sigurojë mbrojtje afatgjatë dhe ruajtje të diversitetit biologjik, në të njëjtën kohë.

3. Në një zonë të mbrojtur mjedisore të burimeve të menaxhuara zbatohet shkalla e mbrojtjes, me qëllim:

a) mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik dhe të vlerave të tjera të zonës për një kohë të gjatë;

b) dhënien e kontributit në zhvillimin rajonal dhe kombëtar;

c) nxitjen e praktikës mbarështuese për qëllime të zhvillimit të qëndrueshëm;

ç) mbrojtjen e burimeve gjenetike ose sistemeve drufrutore me karakteristika natyrore;

d) mbrojtjen e burimeve natyrore bazë nga përdorimet për qëllime të tjera të tokës që mund të jenë dëmtoese për diversitetin biologjik të zonës.

Neni 22

Zona të mbrojtura detare

1. “Zonë e mbrojtur detare” shpallet çdo sipërfaqe detare, bregdetare e nënujore, shtrati i detit dhe ishujt, së bashku me florën, faunën, habitatet e peizazhin dhe karakteristikat historike, kulturore e arkeologjike, e destinuar për:

a) mbrojtjen e biodiversitetit, të ekosistemeve, habitateve dhe llojeve të rrezikuara dhe veçanërisht të kërcënuara në mënyrë kritike, të llojeve autoktone dhe atyre migratore të faunës detare apo të shumëllojshmërisë gjenetike;

b) mbrojtjen e cilësisë së ujit, parandalimin dhe shkatërrimin e ndotësve;

c) mbrojtjen e peizazhit dhe të pasurive nënujore, bregdetare e funddetit;

ç) ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike të gjallesave;

d) mbrojtjen e natyrës dhe mbijetesën e llojeve gjatë zhvillimit të turizmit detar, bregdetar e nënujor, duke ruajtur habitatet e llojet;

dh) restaurimin dhe rivendosjen e llojeve të kërcënuara e të ekosistemeve të degraduara, veçanërisht për peshkimin, dhe të gjallesave të tjera si rrjedhojë e veprimtarive me ndikim negativ dhe ndaj ndryshimeve klimatike;

e) përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, detare e bregdetare, ruajtjen afatgjatë dhe praktikën e peshkimit të qëndrueshëm tradicional;

ë) zhvillimin e veprimtarive, me qëllim ruajtjen dhe menaxhimin e integruar të zonës;

f) kërkimin dhe monitorimin për qëllime shkencore.

2. “Zona e mbrojtur detare” trajtohet sipas kategorive të paraqitura në nenin 14 të këtij ligji. Në zonat e mbrojtura detare zbatohen shkallët e mbrojtjes, të specifikuara në nenet përkatëse të kategorive të zonave të mbrojtura dhe që përkojnë me objektivat e mbrojtjes.

3. Në këto zona janë të ndaluara të gjitha veprimtaritë, të cilat:

a) shfrytëzojnë, tjetërsojnë apo modifikojnë habitatet dhe llojet e gjallesave bregdetare e detare;

b) nxjerrin ose mbledhin elemente natyrore detare si të koraleve, bivalvoreve dhe të pasurive të tjera biologjike e jobiologjike natyrore nënujore;

- c) dëmtojnë shpellat dhe habitatet nënujore;
 - ç) marrin çfarëdolloj kampioni detar, gjetje minerare dhe paleontologjike, pastrojnë territore apo marrin shkëmbinj dhe rërë nga funddeti për qëllime të ndryshme nga ato shkencore, kërkimore apo të inventarizimit/evidentimit;
 - d) ndërtojnë mbi e nën sipërfaqen e ujit impiante të akuakulturës dhe shfrytëzimit të peshkimit;
 - dh) hedhin inerte dhe mbetje urbane, derdhin ujëra të zeza të patrajtuara dhe kimikate e hidrokarbure;
 - e) marrin apo zhvendosin objekte me vlera natyrore, historike e arkeologjike, me qëllim këmbimin apo tregtimin e këtyre objekteve;
 - ë) tjetërsojnë territorin e habitateve apo të peizazhit me ndërtime të përhershme, si dhe aktivitete minerare apo të shfrytëzimit të gazit e të naftës;
 - f) dëmtojnë pasuritë e trashëgimisë kulturore.
4. Në planin e menaxhimit për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare, sipas nënzonave të administrimit, caktohen qartazi dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e lejuara, të ndaluara dhe ato për të cilat kërkohet leje e lëshuar nga organet kompetente, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 23

Kurora e gjelbër

1. “Kurorë e gjelbër” shpallet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, në kuptim të zonës së mbrojtur pyjore, një sipërfaqe brenda territorit administrativ të bashkisë me qëllim mbrojtjen e kurorave të gjelbra të çdo bashkie në Republikën e Shqipërisë dhe është detyrim për çdo bashki.
2. “Kurora e gjelbër” siguron përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillim të veprimtarive, që i përshtaten karakterit të zonës dhe që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit.
3. Miratimi i kriterëve dhe procedurave të shpalljes së “Kurorës së gjelbër” dhe përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësive në lidhje me administrimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e kurorës bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon mjedisin.
4. Planet e menaxhimit të “Kurorës së gjelbër” miratohen me urdhër të ministrit dhe i dërgohen për zbatim bashkive.

Neni 24

Parqet natyrore bashkiake

1. “Park natyror bashkiak” shpallet me vendim të këshillit bashkiak, në kuptim të zonës së mbrojtur mjedisore, e njësuar me kategoritë IV të ligjit, brenda territorit administrativ të një ose më shumë bashkive, pas dhënies së miratimit paraprak që bëhet nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura.
2. Parqet natyrore bashkiake sigurojnë përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillimin e veprimtarive, që i përshtaten karakterit të zonës dhe që lidhen ekskluzivisht me nevojat e komunitetit.
3. Miratimi i kriterëve, procedurave të shpalljes dhe administrimit të parqeve natyrore bashkiake bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore.
4. Planet e menaxhimit të parqeve bashkiake miratohen me urdhër të ministrit dhe i dërgohen për zbatim bashkive menjëherë sapo miratohet zona e parkut.
5. Parqet natyrore bashkiake përfshihen në Rrjetin Kombëtar të Zonave të Mbrojtura, pas miratimit të planit të menaxhimit nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore.

Neni 25

Zonë e mbrojtur ndërkufitare

1. “Zona e mbrojtur ndërkufitare” është pjesa e tokës dhe/apo ajo ujore, e shtrirë në më shumë se një shtet, që integrohet në menaxhimin e përbashkët sipas dispozitave ligjore në fuqi të secilit vend

dhe në bazë të konventave e të udhëzimeve ndërkombëtare, të pranuar nga të dyja palët, për krijimin e rrjetit të zonave të mbrojtura dhe për të gjitha veprimtaritë ekonomike, shoqërore, kulturore, historike e argëtuese njerëzore, që ndikojnë në përmirësimin e marrëdhënieve e të jetesës së komuniteteve ndërkufitare.

2. Objektivat kryesorë të mbrojtjes ndërkufitare janë:

- a) mbrojtja dhe mirëmbajtja e natyrës, peizazhit dhe të biodiversitetit;
- b) bashkëpunimi ndërkombëtar;
- c) promovimi i vlerave natyrore, kulturore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm;
- ç) përdorimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i tokës dhe i burimeve natyrore e biologjike;
- d) zbutja e varfërisë dhe rritja e mirëqenies së popullatave ndërkufitare;
- dh) integrimi ndërkufitar ekonomik, social dhe kulturor;
- e) ruajtja e sigurisë, e paqes dhe e përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet popullatave ndërkufitare.

3. Për mirëmenaxhimin e këtyre zonave krijohen komitete të përbashkëta. Përbërja dhe funksionimi i tyre përcaktohen në marrëveshjet e përbashkëta që hartohen për këtë qëllim.

Seksioni V

Zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar

Neni 26

Zonë veçanërisht e mbrojtur si habitat i llojeve të shpendëve ujorë (zonat “Ramsar”) dhe “Zonat e rëndësishme për zogjtë” (IBA)

1. Ligatinat, kënetat, moçalishtet, sipërfaqet ujore natyrore me ujë të ëmbël, të njelmët ose të kripur, të përhershme apo të përkohshme, që përfaqësojnë bioqendra e biokoridore me rëndësi rajonale e kombëtare për vlerat e tyre biologjike, ekonomike, sociale dhe si pasuri të trashëgimisë natyrore shpallen “Zonë veçanërisht e mbrojtur si habitat i llojeve të shpendëve ujorë” dhe përfshihen në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare.

2. Një zonë veçanërisht e mbrojtur mjedisore për ruajtjen e habitateve të llojeve gëzon të paktën një nga veçoritë e mëposhtme:

- a) të jetë përfaqësues i rrallë ose shembull unik i një lloji natyror, i gjetur brenda rajonit përkatës biogeografik;
- b) të konsiderohet i rëndësishëm në qoftë se mbështet plotësisht mbrojtjen e llojeve të rrezikuara ose të rrezikuara në mënyrë kritike apo të kërcënuara të komuniteteve ekologjike;
- c) të jetë i rëndësishëm në qoftë se mbështet popullata të bimëve dhe/ose të kafshëve për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike të një rajoni të veçantë biogeografik;
- ç) të ofrojë kushte ripërtëritjeje natyrore, qetësi, strehimi, folenizimi dhe shumimi për llojet bimore dhe/ose llojet e kafshëve gjatë fazave në ciklet e tyre të jetës;
- d) të ofrojë rregullisht praninë e individëve në një popullatë të një lloji ose nënlojeve të shpendëve ujorë dimëruar e folenizues;
- dh) kur është një burim i rëndësishëm për ushqim për peshqit, të ofrojë vendosjen e vezëve dhe/ose rrugët e migrimit të tyre.

3. Kërkesat për mbrojtjen e habitateve, të llojeve të kërcënuara dhe endemike, të rrugëve të shtegtit dhe kushteve të shumimit kryhen në përputhje me dispozitat e ligjislacionit në fuqi për mbrojtjen e biodiversitetit dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër.

4. Ligatinat dhe tokat e lagëta si ekosisteme të trashëgimisë natyrore janë të patjetërsueshme dhe në to ushtrohen vetëm veprimtaritë tradicionale të bujqësisë, peshkimit, pyjeve dhe turizmi mjedisor, me miratim edhe të AKZM-së.

5. Në “zonën veçanërisht të mbrojtur mjedisore si habitat i shpendëve ujorë”:

- a) çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor ose veprimtari të tjera të çfarëdolloji në një largësi 1 500 m nga vija e ujit, duke përjashtuar ndërtimet me konstruksion të lehtë druri apo materiali tjetër miqësor ndaj mjedisit, duhet miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit;

b) janë të ndaluara veprimtaritë që sjellin dëmtime apo shqetësime për llojet e kafshëve e të shpendëve të egra dhe të peshqve me banim të përhershëm, të përkohshëm dhe në rrugëkalimet e shpendëve shtegtarë e të emigrimit të peshqve.

6. Për zonat “Ramsar” hartohen plane menaxhimi sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 27

Rezervat e biosferës

1. “Rezerva të biosferës” shpallen zonat relativisht të mëdha me ekosisteme tokësore, ujore, bregdetare dhe detare, në të cilat, nëpërmjet menaxhimit të duhur të tokës, ruajtjes së ekosistemit dhe të biodiversitetit, ndërthuret shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për përfitim të komuniteteve lokale. Këto zona bazohen në rregullat dhe principet e programit “Njeriu dhe biosfera” të konventës së UNESCO-s.

2. Tri qëllimet kryesore të “Rezervave të biosferës” janë:

- a) ruajtja e shumëllojshmërisë natyrore dhe kulturore;
- b) sigurimi i modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili mbështet bashkekzistencën e popullsisë lokale me mjedisin prej të cilit varet jeta e tyre;
- c) kërkimi, monitorimi, edukimi dhe trajnimi.

3. “Rezervat e biosferës” bazohen në tre komponentë të ndarjes territoriale:

- a) zonat kufizuese të mbrojtura strikte;
- b) zonat buferike që rrethojnë ose vijojnë pas zonës kufizuese ku lejohen vetëm aktivitetet konservuese të përshtatshme;
- c) një zonë e ndërmjetme fleksibël ku kryhen praktika të mbarështimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

4. Në rastet kur në sipërfaqen e “Rezervës së biosferës” përfshihen edhe territore të zonave të mbrojtura, merret në konsideratë zonimi i territorit të miratuar për to.

Neni 28

Zonat e veçanta të ruajtjes së rrjetit ekologjik të zonave me interes për komunitetin europian

1. “Zona të veçanta ruajtjeje” shpallen zonat ku strehohen tipat e habitateve natyrore me interes për komunitetin europian dhe të habitateve të llojeve me interes për këtë komunitet. Këto zona janë pjesë e rrjetit ekologjik kombëtar dhe mund të përfshijnë edhe zona të mbrojtura brenda rrjetit të zonave të mbrojtura, si dhe ekosisteme, habitate e peizazhe jashtë këtij.

2. Zona, rajoni biogeografik apo llojet, që ndikojnë dukshëm në mirëmbajtjen apo rivendosjen e tipit të habitatit natyror, me interes për komunitetin europian ose me një status ruajtjeje të favorshëm, brenda rajonit apo rajoneve biogeografike në fjalë, shpallen “zona të veçanta ruajtjeje”, me qëllim vendosjen e masave të nevojshme mbrojtëse për mbajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të habitateve natyrore ose të popullatave të llojeve, për të cilat është përcaktuar zona. Këto zona mund të jenë pjesë e rrjetit ekologjik brenda zonave të mbrojtura ose të lidhura me biokorridore me zonat e mbrojtura.

3. Në rrjetin e zonave me interes për komunitetin europian përfshihen zona të veçanta të ruajtjes për:

- a) habitatet dhe/ose llojet;
- b) shpendët.

Neni 29

Kriteret e vlerësimit dhe të shpalljes së zonave me interes për komunitetin europian

1. Vlerësimi i rëndësisë së zonave për çdo habitat natyror, përfshirë tipat e habitateve natyrore kryesore dhe llojet kryesore, bëhet sipas këtyre kriterëve:

A. Kriteve të vlerësimit të zonës për një tip të caktuar habitati natyror, me interes për komunitetin europian, si:

- a) shkalla e përfaqësueshmërisë së tipit të habitatit natyror në zonën përkatëse;
- b) sipërfaqja e zonës së mbuluar nga tipi i habitatit natyror në raport me sipërfaqen e përgjithshme, të mbuluar nga ai tip habitati natyror, brenda territorit kombëtar;
- c) shkalla e ruajtjes së strukturës dhe funksioneve të tipit të habitatit natyror në fjalë dhe mundësitë e ripërtëritjes;
- ç) vlerësimi në nivel ndërkombëtar i vlerës së zonës për ruajtjen e tipit përkatës të habitatit natyror.

B. Kriteve të vlerësimit të zonës për një lloj, me interes për komunitetin europian, si:

- a) madhësia dhe dendësia e popullatës së llojit të pranishëm në zonë në raport me popullatat e pranishme brenda territorit kombëtar;
- b) shkalla e ruajtjes së tipareve të habitatit, të cilat janë të rëndësishme për llojin në fjalë dhe mundësitë e ripërtëritjes;
- c) shkalla e izolimit të popullatës së pranishme në zonë në raport me shtrirjen natyrore të llojit;
- ç) vlerësimi global i vlerës së vendit për ruajtjen e llojit përkatës.

2. Në bazë të kriteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe të të dhënave përkatëse shkencore, ministri përgjegjës për mjedisin miraton me urdhër listën e zonave shqiptare, duke përcaktuar tipat e habitateve natyrore, me interes për komunitetin europian dhe llojet, me interes për këtë komunitet, autoktone për territorin shqiptar e që ndodhen në zonë. Në listë identifikohen ato zona, ku gjenden një ose disa tipa habitatesh natyrore përparësore ose lloje përparësore.

3. Për llojet e kafshëve, që gjenden në sipërfaqe të gjera, zonat përputhen me vendet brenda shpërndarjes natyrore të këtyre llojeve dhe përfaqësojnë faktorët fizikë dhe biologjikë, thelbësorë për jetën dhe riprodhimin e tyre.

4. Për llojet ujore, që gjenden në sipërfaqe të gjera, zonat propozohen vetëm në rastet kur janë qartësisht të identifikueshme dhe përfaqësojnë faktorët fizikë dhe biologjikë, të domosdoshëm për jetën dhe riprodhimin e tyre.

5. Lista dhe të dhënat përkatëse për çdo zonë i dërgohen Komisionit Europian. Në këto të dhëna përfshihen harta e zonës, emri, vendndodhja, shtrirja dhe të dhëna të tjera, si rezultat i zbatimit të kriteve të përmendura në pikën 2 të këtij neni.

6. Rregullat për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 30

Objektivat dhe elementet e rrjetit ekologjik të zonave me rëndësi për komunitetin europian

1. Rrjeti ekologjik i zonave me rëndësi për komunitetin europian (SCIs) përbëhet nga rrjeti i zonave të mbrojtjes dhe ka objektiv mbajtjen ose rivendosjen e një statusi të favorshëm ruajtjeje për ekosistemet, habitatet dhe peizazhet. Ky rrjet konsiston në Zonat e Rëndësisë së Veçantë, sipas direktivës së habitateve dhe Zonat e Mbrojtjes, sipas direktivës së shpendëve.

2. Rrjeti ekologjik formohet nga:

- a) zona qendrore, me rëndësi europiane për ruajtjen e diversitetit biologjik, ku përfshihen ekosisteme natyrore e gjysmënatyrore, habitate dhe peizazhe;
- b) korridoret për të përmirësuar lidhjen e zonave qendrore, duke mbështetur lëvizjen e llojeve;
- c) zonat buferike për të mbështetur dhe mbrojtur rrjetin ekologjik nga ndikimet e jashtme dhe ku brenda tyre të promovohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe ekologjik.

Neni 31

Zhvillimi, planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi i rrjetit

1. Ministria bashkërendon punën për ngritjen dhe funksionimin e rrjetit ekologjik të zonave me rëndësi për komunitetin europian.

2. Planifikimi, bashkërendimi dhe drejtimi i rrjetit ekologjik të zonave me rëndësi për komunitetin europian specifikohen në planin e administrimit të rrjetit, i cili ripunohet periodikisht dhe vihet në dispozicion të organeve shtetërore dhe shoqërisë civile.

3. Në planin e administrimit të rrjetit përcaktohen:

- a) objektivat e rrjetit;
- b) kontributi i secilit element të rrjetit për të arritur këta objektiva;
- c) mangësitë e rrjetit;
- ç) plan veprimi për të arritur objektivat.

Neni 32

Menaxhimi i zonave të veçanta të ruajtjes

1. Ministria përgatit *database*-n e shoqëruar me hartat GIS për zonat e veçanta që duhet të shpallen të mbrojtura.

2. Për “zonat e veçanta të ruajtjes”, ministria merr masa mbrojtëse, ku përfshihen planet menaxhuese të hartuara për zonat ose të integruara në plane të tjera zhvillimi, si dhe masa juridike, administrative, teknike, në përputhje me kërkesat ekologjike të tipave të habitateve natyrore dhe të llojeve, me interes për komunitetin europian.

Seksioni VI

Veprimtaritë ekonomike në zonat e mbrojtura

Neni 33

Veprimtaritë që lejohen pasi të jenë pajisur me miratim paraprak

1. Veprimtaritë që lejohen të ushtrohen në zonat e mbrojtura mjedisore pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak të organit, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të të cilit është veprimtaria e mëposhtme:

- a) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;
- b) monitorime të gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;
- c) ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin;
- ç) struktura në përputhje me përcaktimet e Planit të Menaxhimit në shërbim të aktiviteteve turistike;
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.

2. Në zonat e mbrojtura detare, liqenore dhe lumore lejohen të ushtrohen veprimtaritë e mëposhtme pasi të jenë pajisur me miratimin paraprak:

- a) monitorimet e gjendjes mjedisore, të ekosistemit, të habitateve dhe të llojeve floristike e faunistike;
- b) zhytjet dhe turizmi nënujor i qëndrueshëm me metoda miqësore ndaj mjedisit;
- c) ndërtimet turistike të përkohshme, sezonale me konstruksione të lehta, miqësore ndaj mjedisit;
- ç) çdo veprimtari tjetër në përputhje me Planin e Menaxhimit;
- d) çdo veprimtari tjetër në përputhje me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.

3. Përjashtim nga kërkesa për miratim paraprak bëjnë veprimtaritë ushtarake, të cilat mund të ushtrohen pasi të jenë pajisur me leje mjedisore.

Neni 34

Peshkimi në zonat e mbrojtura detare e bregdetare

1. Në zonat e mbrojtura detare e bregdetare është i ndaluar peshkimi për qëllime tregtimi, referuar dispozitave të legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën. Peshkimi tregtar lejohet vetëm në zonat e mbrojtura detare e bregdetare, pjesë e kategorive IV, V dhe VI, pas miratimit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së të kushteve që duhet të zbatohet peshkimi në këtë zonë.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, peshkimi në zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare dhe peshkimi në ujërat e brendshme, i cili rregullohet me dispozitat e ligjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën, përpara se të miratohet si aktivitet, merr miratimin me urdhër të ministrit. Në rastet kur aktiviteti është duke u kryer sepse është miratuar apo është kontraktuar më parë, rregullat do të përcaktohen në marrëveshjen midis subjektit që ushtron veprimtarinë e peshkimit dhe AdZM-së që mbulon zonën e mbrojtur detare a bregdetare, në bazë të objektivave të mbrojtjes së zonës, kërkesave të planit të menaxhimit të saj dhe lejes së dhënë për peshkimin.

KREU III

NDRYSHIMI I ZONAVE TË MBROJTURA

Neni 35

Heqja dhe ndryshimi i statusit të zonës së mbrojtur

1. Një zone të mbrojtur i hiqet ose i ndryshohet statusi i mbrojtjes, sipas këtij ligji, kur kanë ndryshuar rrethanat dhe qëllimi për të cilat ajo e fitoi këtë status.

2. Heqja e statusit të një zone të mbrojtur kombëtare bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, pas marrjes së mendimit nga ministria/ministritë që mund të ketë/kenë propozuar heqjen ose ndryshimin e statusit nga bashkia, ekspertë të florës dhe faunës, institucionet kërkimore-shkencore, shoqëria civile dhe nga pronarët privatë kur në zonën e mbrojtur janë përfshirë edhe pronat e tyre, si dhe nga subjektet që kryejnë veprimtari në zonë, të pajisur me leje mjedisore.

3. Në propozimin për heqjen e statusit të një zone të mbrojtur mjedisore përfshihen:

- a) argumentimi për heqjen e statusit;
- b) vlerësimi i ndikimit në mjedis, që pasqyron ndikimin në kategorizimin ekzistues të zonës së mbrojtur në biodiversitetin dhe në popullatat ose bashkësitë vendore;
- c) përshkrimi i masave zbutëse;
- ç) rezultatet e proceseve të bashkërendimit dhe këshillimit me grupet e interesit të shoqërisë civile, veçanërisht me popullatat ose bashkësitë brenda dhe përreth zonës së mbrojtur, duke përfshirë një përmbledhje të komenteve të marra dhe reflektimin në propozim.

Neni 36

Ndryshimi i sipërfaqes

1. Miratimi i ndryshimit të sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore, zgjerimi ose pakësimi i saj bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit ku argumentohet nevoja e ndryshimit konkret që do të përmirësojë rrjetin dhe mbrojtjen e zonës pas vendimit të KKT-së për ndryshimin e sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore.

2. Propozimi për ndryshimin e sipërfaqes së zonës konsultohet paraprakisht me komunitetin vendas, me pronarët, pronat e të cilëve, sipas rastit, përfshihen ose hiqen nga sipërfaqja e zonës, me subjektet që ushtrojnë veprimtari brenda zonës, me institucionet shkencore, me organet e qeverisjes vendore ku shtrihet zona dhe argumenton nevojën e ndryshimit.

KREU IV STRUKTURAT E MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA

Neni 37

Ministria

1. Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura mjedisore është institucioni qendror politikëbërës për mbrojtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria është institucioni përgjegjës për propozimin e shpalljes së krijimit, ndryshimit dhe heqjes së zonave të mbrojtura, miratimin e hartimit të planeve të menaxhimit të tyre, zonimin, rritjen e sipërfaqes, rishikimin e statusit të zonave të mbrojtura.

3. Detyrat kryesore të ministrisë janë:

a) identifikimi i masave që lidhen me administrimin e zonave të mbrojtura ekzistuese, klasifikimin e tyre, të rrjetit ekologjik, të zonave “Ramsar”, identifikimin e zonave të reja dhe procedurat për shpalljen e tyre;

b) koordinimi i punës për kryerjen e studimeve, konsultimeve dhe hartografimit për shpalljen e zonave të reja të mbrojtura;

c) koordinimi i punës për identifikimin dhe vlerësimin e habitateve me interes ruajtjeje për llojet e faunës së egër;

ç) siguri dhe përgatitja e politikave kombëtare për menaxhimin e rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipërisë;

d) propozimi për shtimin e zonave të mbrojtura dhe përfshirjen e tyre në rrjetin kombëtar;

dh) dhënia e kontributit dhe koordinimi i punës për përgatitjen e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura për zbatimin e tyre;

e) miratimi dhe publikimi i planit të zonave që do të shpallen të mbrojtura në vitin pasardhës;

ë) miratimi i objektivave për monitorimin e zonave të mbrojtura dhe koordinimi i punës për realizimin e tyre.

Neni 38

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

1. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit, dhe ka për detyrë administrimin e kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. AKZM-ja ka statusin e Drejtorisë së Përgjithshme, në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas administratave rajonale të zonave të mbrojtura.

3. Funksionet, përbërja, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e Agjencisë, si organ qendror i specializuar për zonat e mbrojtura dhe institucioneve të varësisë së saj parashikohen shprehimisht në këtë ligj si dhe miratohen me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

4. Struktura dhe organigrama e AKZM-së dhe institucioneve të varësisë së saj miratohen me urdhër të Kryeministrit.

5. Në detyrat kryesore të AKZM-së përfshihen:

a) udhëheqja, drejtimi, organizimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i strukturave të zonave të mbrojtura që ka në varësi;

b) aktualizimi dhe dinamizimi i përmbajtjes së mbrojtjes e të menaxhimit të zonave, nëpërmjet kultivimit të koncepteve, praktikave e skemave bashkëkohore që përdoren nga vendet e përparuara në punën me zonat e mbrojtura;

c) menaxhimi dhe administrimi i rrjetit të zonave të mbrojtura, habitateve dhe llojeve natyrore e gjysmënatyrore me interes të ruajtjes, në përputhje me legjislacionin mjedisor shqiptar në fuqi, si dhe me konventat e marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore;

- c) krijimi dhe zbatimi i sistemit dokumentar të formatuar e të standardizuar, me të cilin punojnë strukturat menaxhuese të zonave të mbrojtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - d) krijimi i Skedarit, Portalit dhe Databazës Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, si pjesë e veçantë e Portalit, Skedarit Kombëtar të Mjedisit;
 - dh) kryerja e analizave dhe përgjithësimeve periodike për problemet bazë të zonave të mbrojtura dhe informimi i vazhdueshëm i ministrit;
 - e) krijimi dhe zbatimi i metodologjisë për hartimin e planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura;
 - ë) gjallërimi i edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve lokale e të publikut në tërësi për zonat e mbrojtura;
 - f) promovimi i formave, metodave, mënyrave racionale për grumbullimin regjistrimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit për zonat e mbrojtura;
 - g) miratimi i veprimtarive në zonat e mbrojtura, si pjesë e procesit të pajisjes me leje mjedisi për veprimtaritë që kanë ndikim në mjedis në zonat e mbrojtura;
 - gj) mbështetja dhe zhvillimi i aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda zonave të mbrojtura në bashkëpunim me Komisionin e Ndihmës Shtetërore;
 - h) menaxhimi financiar i rrjetit të zonave të mbrojtura.
6. Rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të AKZM-së dhe institucioneve të varësisë së saj miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 39

Administratat rajonale të zonave të mbrojtura

Administratat rajonale të zonave të mbrojtura (AdZM) janë institucione, në varësi të AKZM-së me seli në çdo qark dhe përbëjnë rrjetin institucional vendor të specializuar, që zbatojnë detyrat për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave të mbrojtura mjedisore që ndodhen në qark.

Neni 40

Bashkitë

1. Bashkitë zbatojnë kërkesat e këtij ligji dhe të ligjeve të tyre organike në lidhje me zonat e mbrojtura brenda territorit administrativ ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
2. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre bashkitë, në lidhje me zonat e mbrojtura, bashkëpunojnë me administratën rajonale të zonave të mbrojtura dhe me administratën e zonave përkatëse.
3. Për të zbatuar me efektivitet kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi, bashkitë, sipas hapësirave që u krijon ligji organik dhe mundësive praktike, në përbërje të administratës së tyre krijojnë njësinë e mbrojtjes së mjedisit të saj.
4. Njësia e mbrojtjes së mjedisit pranë bashkisë ka të drejtë t'u kërkojë subjekteve që ushtrojnë veprimtari në territorin e saj që:
 - a) të zbatojnë me përpikëri kërkesat e legjislacionit mjedisor në veprimtarinë që ushtrojnë;
 - b) të respektojnë normat dhe standardet e shkarkimeve në mjedis;
 - c) të ruajnë me përparësi zonat e mbrojtura bashkiake me të gjithë përbërësit e vet nga ndikimet e mundshme negative të veprimtarisë që ushtrojnë;
 - ç) të hartojnë dhe të përditësojnë planet e programet për përballimin e aksidenteve e të emergjencave, si dhe të sqarojnë publikun se si të veprojnë në raste aksidentesh që mund të ndodhin në veprimtarinë e tyre;
 - d) t'i japin në vijimësi informacione dhe të dhëna publikut të zonës për veprimtarinë që ushtrojnë;
 - dh) të përgatitin dhe të dorëzojnë në njësi, brenda afateve dhe modeleve të caktuara, të dhëna e informacione që kërkohen prej saj.

Komitetet e menaxhimit

1. Për të ndjekur zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura ngrihen komitetet e menaxhimit, me përbërje nga bashkia/bashkitë, brenda territorit administrativ të të cilit/cilave ndodhet zona e mbrojtur, AKZM-ja, nga institucionet vendore që kanë lidhje direkte me to, si të bujqësisë, të turizmit, të infrastrukturës, shoqërisë civile, përfaqësues nga pronarët e pyjeve e kullotave që gjenden në zonat e mbrojtura dhe drejtohen nga prefekti.

2. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton vendimin për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore.

3. Komiteti ka funksion mbikëqyrës për zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura mjedisore dhe funksionon sipas rregullores që miratohet nga vetë ai dhe rolin e sekretariatit teknik për të e luan administrata e zonës së mbrojtur, e cila administron gjithë dokumentacionin që pasqyron punën e komitetit.

KREU V

PLANET E MENAXHIMIT

Neni 42

Hartimi dhe miratimi i planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur

1. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, me bashkitë, me publikun e interesuar, shoqërinë civile dhe me pronarët privatë, pronat e të cilëve shtrihen brenda territorit të zonës së mbrojtur, miraton për secilën zonë të mbrojtur planin e menaxhimit të saj, të hartuar nga AKZM-ja.

2. Objektivat dhe kërkesat e politikave, planeve dhe programeve sektoriale që lidhen me to merren parasysh gjatë hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe integrohen në vendimmarrjet kombëtare, rajonale e vendore që prekin zonat e mbrojtura.

3. Në planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur mjedisore përfshihen të paktën:

- a) objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur;
- b) mekanizmat dhe autoriteti drejtues;
- c) proceset dhe kategoritë e veprimtarive që janë kërcënuese për zonën e mbrojtur, përfshirë edhe zonat rrethuese;
- ç) masat rregullatore ose administrative që nevojiten për të shmangur ose pakësuar kërcënimet e identifikuar;
- d) veprimtaritë e lejuara brenda zonës së mbrojtur;
- dh) veprimtaritë e duhura për zonat përreth, duke përfshirë ato në zonat buferike;
- e) kushtet për zhvillimin e shërbimeve të tjera;
- ë) të dhënat për pronësinë e mëparshme të truallit dhe të drejtat për të përdorur elementet e diversitetit biologjik brenda tij, duke përfshirë veprimtaritë tradicionale për jetesën e popullatës të bashkësisë vendore;
- f) kushtet për të zhvilluar veprimtari tradicionale për jetesë të zonës ose të elementeve të diversitetit biologjik brenda saj, nëse ato nuk bien ndesh me objektivat e administrimit të zonës së mbrojtur;
- g) kushtet për të ndarë përfitimet nga krijimi dhe administrimi i zonës së mbrojtur, veçanërisht me bashkësitë dhe popullatat vendore;
- gj) kushtet për kërkim shkencor, inventarizim dhe monitorim;
- h) burimet financiare, përfshirë ato që sjellin fitim;
- i) masat për informimin e publikut dhe përfshirjen e tyre në qeverisjen e zonës;
- j) kushte të tjera të veçanta për zonën në fjalë.

4. Struktura e planit të menaxhimit, përmbajtja dhe kriteret e rishikimit të tij miratohen me udhëzim të ministrit. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur mjedisore janë 10-vjeçare.

5. Në planin e menaxhimit, sipas nënzonave të administrimit, caktohen qartë dhe në mënyrë të detajuar veprimtaritë e ndaluara, ato që mund të ushtrohen pasi të pajisen me leje mjedisi apo që duan miratim të administratës së zonës.

Neni 43

Zbatimi i planit të menaxhimit

1. Plan i menaxhimit është dokumenti bazë për ruajtjen e zhvillimin e zonës dhe zbatohet nga administrata e zonës së mbrojtur. Ai është i detyrueshëm për pronarët privatë, pronat e të cilëve janë përfshirë në zonën e mbrojtur, për subjektet që ushtrojnë veprimtari të miratuar në zonë, për komunitetin lokal, si dhe për çdo person fizik a juridik, vendas apo të huaj, veprimtaria e të cilit mund të ushtrojë ndikim në zonë.

2. Zbatimi i elementeve të planeve të menaxhimit mund të realizohet nga persona fizikë/juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, shoqëria civile, duke zbatuar rregullat dhe procedurat e legjislacionit, në bazë të kriterëve teknike të miratuara me udhëzim të ministrit, referuar pikës 4, të nenit 42, të këtij ligji.

3. Procesi i zbatimit të planit të menaxhimit synon harmonizimin maksimal të kërkesave ligjore për ruajtjen e zonave të mbrojtura me interesat e bashkësive dhe të popullatave vendore për të përfituar në vijimësi prej tyre.

Neni 44

Skedimi dhe shënimi i zonave të mbrojtura

1. Forma e sinjalistikës së një zone të mbrojtur mjedisore dhe mënyra e shënimit të zonave të mbrojtura në terren e në harta miratohen me urdhër të ministrit.

2. Ministria njofton organet përkatëse gjeodezike dhe kartografike për çdo shpallje, ndryshim ose heqje të statusit të çdo zone të mbrojtur mjedisore.

Neni 45

Portali qendror i zonave të mbrojtura

1. Zonat e mbrojtura mjedisore regjistrohen në portalin dhe Bazën e të Dhënave Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, që hartohet dhe administrohet nga ministria. Rregullat për hartimin, përmbajtjen, administrimin, përditësimin dhe formatin e tij miratohen me udhëzim të ministrit, bazuar në ligjin nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

2. Regjistri Kombëtar është i aksesueshëm për publikun nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të ministrisë.

Neni 46

Pyjet, kullotat, ujërat dhe pasuritë e tjera natyrore brenda zonave të mbrojtura

1. Pyjet në zonat e mbrojtura mjedisore përjashtohen nga klasifikimi si pyje prodhuese.

2. Të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekosistemeve të ndryshme realizohen vetëm në rast se janë parashikuar në planin e menaxhimit ose vijnë si pasojë e emergjencave natyrore, sipas projektit teknik dhe me miratim të AKZM-së.

3. Ndërhyrjet e nevojshme për rigjenerimin dhe shëndetësimin kryhen nga banorët e zonave të mbrojtura, me qëllim përballimin e nevojave të tyre për ngrohje, në bazë të miratimit paraprak nga AdZM-ja të projektit teknik e të listës emërore të banorëve të zonës, të konfirmuar nga administratori i njësisë së qeverisjes vendore.

4. Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera, pronë publike dhe private, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga administrata e ruajtjes

së zonës dhe në përputhje me planin e menaxhimit të zonës. Administrata i ushtron këto veprimtari drejtpërdrejt, nëpërmjet komunitetit lokal dhe/ose një subjekti të autorizuar prej saj.

5. Kur këto pasuri janë pronë private, ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me planin e menaxhimit të zonës dhe me miratimin paraprak të administratës së ruajtjes së zonës.

KREU VI ZONIMI DHE NËNZONIMI

Neni 47

Zonimi i territorit të zonës së mbrojtur

1. Për të rritur efektshmërinë e menaxhimit dhe mbrojtjes, territori i zonës së mbrojtur ndahet në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në të.

2. Zonimi i brendshëm mund të përmbajë zonën qendrore, zonën e rekreacionit dhe të përdorimit tradicional dhe zonën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe është pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave që shpall zonën e mbrojtur. Sistemi i zonimit të territorit të një zone të mbrojtur përdoret për kategoritë: “Park kombëtar”, “Rezervat natyror i menaxhuar/Park natyror” dhe “Peizazh i mbrojtur”.

3. Kriteret dhe mënyra e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Zonimi përputh objektivat e mbrojtjes me veçoritë e nënzonës, duke mbajtur parasysh natyrën e zonës, llojet e veprimtarive njerëzore që zhvillohen në të dhe ndikimin e tyre në natyrë.

5. Në vendimin e Këshillit të Ministrave, që shpall zonën e mbrojtur mjedisore, përcaktohen emërtimi, sipërfaqja dhe shkalla e mbrojtjes së nënzonave të saj.

Neni 48

Nënzona qendrore

1. Në nënzonën qendrore të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes. Nënzona ndahet në dy nivele.

2. Në nivelin A janë të ndaluara:

a) prerja e drurëve dhe e shkurreve;

b) përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;

c) ndërtime të çdo lloji;

ç) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave;

d) ndezja e zjarreve;

dh) kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre;

e) ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive;

ë) kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës;

f) lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve;

g) vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi;

gj) riprodhimi intensiv i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

3. Në nivelin B janë të ndaluara:

a) shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive, me mjete dhe mënyra që shkaktojnë ndryshime rrënjësore në biodiversitet, në strukturën dhe funksionet e ekosistemeve ose që dëmtojnë në mënyrë të pandrejqshme sipërfaqen e tokës;

b) neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të “Parkut kombëtar”;

c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;

- c) riprodhimi intensiv, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;
- d) ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, hidrocentraleve, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë;
- dh) larja dhe spërkatja e rrugëve me kimikate;
- e) mbjellja e pyjeve monokulturë;
- ë) ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;
- f) lëvizja e mjeteve të transportit jashtë rrugëve të caktuara;
- g) nxjerrja e mineraleve, gurëve, torfave, me përjashtim të gurëve dhe rërës për mirëmbajtjen e parkut;
- gj) veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara;
- h) organizimi i garave me automjete e motoçikleta.

Neni 49

Nënzona e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm

Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara:

- a) ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- b) depozitimi i kimikateve;
- c) lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;
- ç) mbledhja intensive e bimëve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve;
- d) vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;
- dh) ngjitjet alpine, skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave e shtigjeve të caktuara.

Neni 50

Nënzona e rekreacionit

1. Në nënzonën e përdorimit të qëndrueshëm dhe të rekreacionit të një zone të mbrojtur mjedisore zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara:

- a) mbjellja e pyjeve monokulturë;
- b) neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;
- c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase;
- ç) ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane;
- d) lëvizja me mjete transporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara.

2. Në këtë nënzonë lejohet rekreacioni me karakter turistik e çlodhës për qëllim argëtimi dhe që nuk tjetërsion sipërfaqen e nënzonës për qëllime të tjera ekonomike, pas miratimit nga institucionet e kërkuara në këtë ligj.

Neni 51

Gjuetia

Gjuetia është e ndaluar në të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore.

KREU VII PRONËSIA DHE TË DREJTAT NË ZONAT E MBROJTURA

Neni 52

Pronësia mbi zonat e mbrojtura

1. Zonat e mbrojtura mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare.
2. Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë janë pasuri e paluajtshme, pronë publike ose private.
3. Monumentet natyrore janë pasuri të paluajtshme, pronë publike, dhe janë të patjetër-sueshme.

Neni 53

Pronësia private brenda zonave të mbrojtura

1. Për interes të mbrojtjes së natyrës e të biodiversitetit, në përbërje të zonave të mbrojtura përfshihen edhe toka, pyje, kullota e të tjera prona të paluajtshme private, duke marrë, në çdo rast, pëlqimin e tyre paraprak.
2. Territoret dhe objektet private, të përfshira në zonat e mbrojtura mjedisore, mbeten në pronësi private. Ato administrohen e përdoren prej pronarit/ve/bashkëpronarëve ose prej përdoruesit të ligjshëm, vetëm sipas kërkesave të planit të menaxhimit të zonës dhe zonimit të miratuar.
3. Pronarët dhe përdoruesit e territorit, që do të shpallet zonë e mbrojtur mjedisore, si dhe çdo person ose autoritet, që ka interesa në zonë, kanë të drejtë të ngrenë kundërshtime ndaj synimit për ta shpallur zonë të mbrojtur. Kundërshtimet paraqiten me shkrim brenda 30 ditëve nga data e publikimit të synimit për të shpallur zonën e mbrojtur ose për të zgjeruar sipërfaqen e zonës ekzistuese në ministri.
4. Ministri ia njofton kundërshtimet KKT-së dhe kundër vendimit të kësaj të fundit, të interesuarit kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative, referuar legjislacionit në fuqi.
5. Nga data e njoftimit të propozimit për shpalljen e një territori “zonë e mbrojtur mjedisore” e deri në hyrjen në fuqi të vendimit që e shpall atë zonë të mbrojtur, pronarëve dhe përdoruesve të tokës, pyjeve, kullotave u ndalohen ndërhyrjet që ndryshojnë ose dëmtojnë gjendjen dhe vlerat natyrore të territorit, të propozuar për mbrojtje.

Neni 54

E drejta e kompensimit

1. Pronarëve privatë, prona e të cilëve përfshihet brenda territorit të zonës së mbrojtur mjedisore, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, u njihet e drejta e administrimit dhe përdorimit të saj, sipas kërkesave të planit të menaxhimit. Në rast se pronari nuk është dakord, ai gëzon të drejtën të kërkojë kompensimin me një sipërfaqe tjetër jashtë zonës ose shpronësim për interes publik, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Pronarët privatë, pronat e të cilëve janë përfshirë në zonën e mbrojtur mjedisore, si dhe përdoruesit e këtyre pronave marrin pjesë në planifikimin, ruajtjen dhe përdorimin e burimeve natyrore të zonës. Ata bashkëpunojnë me administratën e zonës dhe zbatojnë rregullat e caktuara, planet e menaxhimit dhe programet e hartuara për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Neni 55

Regjistrimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura

Në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave, që miratojnë zonat e mbrojtura mjedisore, AKZM-ja bën regjistrimin e sipërfaqes së tyre në Skedarin Kombëtar të Zonave të Mbrojtura dhe në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, duke formuar fondin e sipërfaqeve të mbrojtura në shkallë qarku e republike.

Neni 56

Veprimtaritë në zonat e mbrojtura

1. Në zonat e mbrojtura mjedisore mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore dhe çdo lloj veprimtarie tjetër e parashikuar në planin e menaxhimit dhe që nuk ndalohet shprehimisht nga ky ligj.

2. Ministria, AKZM-ja dhe pushteti lokal nxitin dhe përkrahin nisma, projekte, programe e veprimtari, që synojnë përmirësimin e treguesve ekologjikë e natyrorë të një zone të mbrojtur mjedisore ose që ndikojnë pozitivisht në to.

3. Në zonat e mbrojtura mjedisore, veprimtaritë mund të ushtrohen vetëm pasi të jetë marrë më parë leja e mjedisit ose pasi të jetë marrë miratimi me shkrim i organit të mbrojtjes së zonës, në rastet kur kjo kërkohet shprehimisht nga ky ligj.

4. AKZM-ja dhe AdZM-ja hartojnë rregullore për vizitorët, e cila publikohet e shpallet në vende të dukshme të zonës.

Kreu VIII

MENAXHIMI FINANCIAR

Neni 57

Burimet e financimit dhe administrimi

1. Menaxhimi i zonave të mbrojtura mjedisore financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. AKZM-ja është përgjegjëse për administrimin e të gjitha të ardhurave të realizuara nga aktiviteti ekonomik në territorin e zonave të mbrojtura mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi.

3. Përfshirë nga pika 2, e këtij neni, bëjnë rastet kur pjesë të zonave të mbrojtura administrohen nga institucionet në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pasi ruajnë e dëshmojnë dhe përfaqësojnë vlera të trashëgimisë kulturore.

4. Me propozim të AKZM-së, ministri miraton udhëzimin për rregullat e përdorimit e të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe për pagimin e çmimeve për to.

Neni 58

Përdorimi i të ardhurave të siguruara në zonat e mbrojtura

1. Për veprimtaritë e sipërpërmendura, që kryhen brenda zonave të mbrojtura mjedisore, paguhet tarifë vjetore.

2. Të ardhurat e siguruara në zonat e mbrojtura mjedisore, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1, të nenit 57, të këtij ligji, janë të ardhurat nga:

- a) tarifat që paguajnë vizitorët e turistët që vizitojnë zonën;
- b) tarifat që paguhen për ushtrimin e veprimtarive që kryhen në zonat e mbrojtura;
- c) vlerat monetare të zhdëmtimeve që paguajnë dëmtuesit e zonës;
- ç) donacionet e ndryshme;
- d) tarifat që paguhen nga transporti në territoret e tyre dhe në raste jo të parashikuara në ligj.

3. Të ardhurat e administruara sipas pikës 2, të këtij neni, përdoren nga AKZM-ja për:

- a) investimet në zonat e mbrojtura;
- b) përbalimin e shpenzimeve për punësime sezonale për aktivitete brenda zonave të mbrojtura;
- c) hartimin e planeve të menaxhimit e inventarizimit të pyjeve, kullotave, florës e faunës së egër, të zjarreve;
- ç) projektet e pyllëzimit, për përmirësimet, luftimin nga gërryerjet, shtigjet në zonat e mbrojtura;
- d) luftimin e sëmundjeve e të dëmtuesve;

- dh) masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri;
 - e) mbarështimin, ushqimin dhe sigurimin e kushteve të jetesës për faunën e egër;
 - ë) masat për parandalimin dhe luftimin e erozionit;
 - f) ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës brenda zonave të mbrojtura për komunikimin, pritjet malore, gardhimet, ndërtesat;
 - g) blerjet e mjeteve të komunikimit e transportit, mobilimin dhe për përmirësimin e kushteve të punës së AdZM-ve dhe punës në terren;
 - gj) publikimet, ndërgjegjësimin, edukimin dhe informimin e publikut të gjerë;
 - h) rehabilitimin e habitateve, largimin dhe menaxhimin e specieve invazive të huaja;
 - i) mbështetjen e aktiviteteve tradicionale të komuniteteve lokale.
4. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.
5. Financimi i veprimtarive të përmendura në pikën 1, të këtij neni, nuk i nënshtrohet rregullave për prokurimin publik dhe për të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 59

Fondi i Veçantë për Zonat e Mbrojtura

1. Në llogari të AKZM-së krijohet Fondi i Veçantë për Zonat e Mbrojtura me fondet e siguruar nga të ardhurat dhe nga kontributi i donatorëve, i cili përdoret me miratim të ministrit për përballimin e emergjencave, për rehabilitimin e pasojave të zjarreve apo të përmytjeve, të fatkeqësive natyrore, të infeksioneve në bimë a në kafshët e egra për zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike në zonat e mbrojtura për ndërhyrjet e detyrueshme ndaj llojeve të huaja.
2. Me propozim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave miraton vendimin për masën e Fondit të Veçantë për Zonat e Mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij.

KREU IX

PJESËMARRJA E PUBLIKUT, INFORMIMI, MONITORIMI DHE KËRKIMI/STUDIMI SHKENCOR

Neni 60

Monitorimi i veprimtarisë në zonat e mbrojtura

1. Monitorimi i veprimtarisë së zonave të mbrojtura mjedisore ushtrohet nga administrata rajonale e zonave të mbrojtura dhe nga subjektet e angazhuara prej saj në monitorim.
2. Subjektet, që kryejnë veprimtari të lejuar në zonat e mbrojtura mjedisore, vetëmonitorojnë aktivitetin që ushtrojnë, sipas kërkesave të specifikuar nga AKZM-ja në zbatim të programit të monitorimit të zonës dhe ia njoftojnë AdZM-së përkatëse të dhënat që dalin nga vetëmonitorimi.
3. AKZM-ja është përgjegjëse për drejtimin, organizimin, monitorimin e zbatimit të planit, mbikëqyrjen periodike vjetore, rezultatet e monitorimit të tij, si dhe për administrimin e publikimin në faqen zyrtare elektronike të saj të të dhënave përkatëse.
4. Plani i monitorimit dhe i vetëmonitorimit të zonave të mbrojtura është pjesë e monitorimit të gjendjes së mjedisit dhe është pjesë e rrjetit kombëtar të monitorimit të gjendjes së mjedisit, sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.
5. Në zbatimin e programeve të monitorimit, AKZM-ja mund të angazhojë institucione kërkimore-shkencore, si dhe subjekte publike ose private, të specializuara në këtë fushë, në bazë të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

Neni 61

Programet kërkimore kombëtare në zonat e mbrojtura

1. Ministria mbështet dhe promovon programet kërkimore kombëtare pranë zonave të mbrojtura mjedisore kur këto janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe me legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe atë për trashëgiminë kulturore.

2. Me propozim të ministrit, Këshilli i Ministrave miraton vendimin për kriteret e ushtrimit, miratimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore.

Neni 62

Procesi i edukimit brenda zonave të mbrojtura

1. AdZM-të, në bashkëpunim me shoqërinë civile, me shkollat në afërsi të zonës së mbrojtur dhe me bashkitë organizon trajnime dhe fushata sensibilizimi me komunitetet lokale, me nxënësit dhe me subjektet që ushtrojnë veprimtari në zonat e mbrojtura mjedisore.

2. AdZM-të kryesisht dhe/ose në bashkëpunim me shoqërinë civile informojnë dhe sensibilizojnë publikun nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese mbi të drejtat dhe detyrimet për zonat e mbrojtura mjedisore.

Neni 63

E drejta e publikut për pjesëmarrje aktive në planifikimin e përdorimit të burimeve natyrore të zonës së mbrojtur

1. Përdorimi i burimeve natyrore, burimeve të trashëgimisë kulturore që përfshihen në zonat e mbrojtura mjedisore bëhet sipas kërkesave të këtij ligji dhe të legjislacionit mjedisor, të legjislacionit për trashëgiminë kulturore në fuqi, që saktësohen në planet e menaxhimit e në programet e mbrojtjes së zonës.

2. Për planifikimin dhe përdorimin e burimeve natyrore të zonës së mbrojtur mjedisore, kushdo që ka një interes legjitim, ka të drejtë të japë propozimin e tij kur hartohen planet e menaxhimit dhe programet e mbrojtjes në një pronë private, si dhe merret miratimi paraprak i pronarit.

Neni 64

Detyrimi i publikut për të ruajtur zonat e mbrojtura

Të gjithë kanë detyrimin të respektojnë rregullat dhe kufizimet e vendosura nga administrata e ruajtjes së zonës, të cilat janë në përputhje me këtë ligj, kuadrin ligjor për bujqësinë, rregullimin e territorit, turizmin, trashëgiminë kulturore, qeverisjen vendore, institutet kërkimore-shkencore dhe t'i mbrojnë këto zona.

Neni 65

Mbledhja e materialeve biologjike dhe mostrave nga mjediset në zonat e mbrojtura

1. Aksesit, mbledhja dhe përdorimi i materialeve biologjike dhe mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura lejohet vetëm në rastet kur janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

2. Me propozim të ministrit, Këshilli i Ministrave miraton vendimin për kriteret e rregullat dhe për miratimin e lejes për mbledhjen, aksesin dhe përdorimin e materialeve e të mostrave nga mjediset e zonave të mbrojtura mjedisore.

KREU X INSPEKTIMI DHE SANKSIONET

Neni 66 Inspektimi

1. Inspektimi i zonës së mbrojtur realizohet nga:

a) Inspektorati i Policisë Pyjore, brenda detyrave dhe përgjegjësi të caktuara në dispozitat ligjore në fuqi, i cili kryen funksionet kontrolluese në zonat e mbrojtura, pavarësisht nga forma e pronësisë së administrimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) administrata e zonës së mbrojtur, e cila është përgjegjëse për kryerjen e funksioneve kontrolluese në territorin e zonës së mbrojtur, që ka në administrim.

2. Detyrat dhe të drejtat e inspektoratit përcaktohen nga aktet ligjore organike përkatëse, duke përfshirë edhe këto detyra:

a) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për zonat e mbrojtura dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në zonat e mbrojtura;

b) parandalon, zbulon dhe ndëshkon rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimeve dhe degradimit të zonave të mbrojtura;

c) merr masa, në rastet e shfrytëzimit dhe të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jopyjore, të florës e faunës së egër, të bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore e tanifere natyrore, të prodhimeve pyjore e jopyjore të zonave të mbrojtura, si dhe çdo veprimtari tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj;

ç) bën kallëzim penal për shkeljet që parashikohen në Kodin Penal si vepra penale në fushën e zonave të mbrojtura me funksion të veçantë;

d) vendos dënimin administrativ me gjobë, dënimet plotësuese dhe pezullon veprimtarinë e ushtruar nga çdo kundërvajtës;

dh) bashkëpunon dhe mbështet veprimtarinë e administratës së zonës së mbrojtur;

e) raporton periodikisht, çdo muaj, pranë AKZM-së, për rezultatet e inspektimit, sipas formularëve të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKZM-së.

3. Inspektorët e Policisë Pyjore, gjatë kryerjes së detyrës, gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore.

4. Administrata e zonës së mbrojtur:

a) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në zonën e mbrojtur nga subjektet private e publike, juridike e fizike, si dhe i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së heqjen e certifikatës/zgjidhjen e kontratës në rastet kur subjektet veprojnë në kundërshtim me këto dispozita;

b) parandalon, zbulon dhe ndëshkon në bashkërendim me Inspektoratin e Policisë Pyjore në rastet e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimeve dhe degradimit të zonave të mbrojtura brenda territorit të tij administrativ;

c) bashkëpunon me strukturat e ngarkuara me këtë ligj dhe ligje të posaçme, për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;

ç) parandalon dhe merr masa në rastet e shfrytëzimit e të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jopyjore, të florës e faunës së egër, të bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore e tanifere natyrore, të prodhimeve pyjore e jopyjore të zonës së mbrojtur, si dhe çdo veprimtari tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj;

d) bën kallëzim penal për shkeljet që parashikohen në Kodin Penal si vepra penale në zonat e mbrojtura me funksion të veçantë;

dh) bashkëpunon në veprimtarinë e tij me Inspektoratin e Policisë Pyjore;

e) bashkëpunon dhe bashkërendon me inspektoratet e tjera, me Policinë e Shtetit dhe me organet e qeverisjes vendore për parandalimin, kontrollin e kundërvajtësve në zonat e mbrojtura.

5. Drejtorët e AdZM-ve dhe përgjegjësit e sektorit të monitorimit në AdZM dhe AKZM, gjatë kryerjes së detyrës, gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore.

6. Administrata e zonave të mbrojtura pajiset me uniformë me shenja dalluese, me dokument identifikimi dhe me mjete të tjera teknike, të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së.

7. Procedurat e inspektimit bazohen në ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 67

Kundërvajtjet administrative

1. Kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, por përbëjnë kundërvajtje administrative, të cilat grupohen si më poshtë:

a) për ndotjen dhe dëmtimin e zonës së mbrojtur nga shkarkimet mbi normë të veprimtarive që zhvillohen jashtë zonës, por në afërsi të saj, subjekti dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

b) për zhvillimin në zonë të veprimtarive që nuk janë pajisur me leje mjedisi, subjekti dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë;

c) për mospërmbyllje dhe mosrespektim të kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit, sipas parashikimeve të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë;

ç) për dëmtim të zonave të mbrojtura nga pronarët e pasurive private që ndodhen brenda zonës, subjekti dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 80 000 lekë;

d) për dëmtim të zonave të mbrojtura nga përdoruesit e zonës, me gjobë nga 50 000 deri në 80 000 lekë.

2. Krahas dënimit me gjobë, i parashikuar në shkronjat “a” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni, Inspektorati i Policisë Pyjore dhe administrata e zonave të mbrojtura mund t’i propozojnë ministrit heqjen e lejes së mjedisit dhe mbylljen e të gjithë veprimtarisë apo të pjesëve të saj përgjithmonë ose për një kohë të caktuar, referuar legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit.

3. Grupi i inspektimit mund të ndër marrë sanksionet e parashikuara në këtë nen në çdo kohë, por jo më vonë se pesë vite kalendarike nga data e kryerjes së shkeljes, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Vendimi për dënimin me gjobë, ankimi dhe ekzekutimi rregullohen nga legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5. Përmbajtja dhe modeli i procesverbalit për kundërvajtjet në zona të mbrojtura miratohet me urdhër të ministrit.

6. Të ardhurat që vijnë nga ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 68

Vlerësimi i dëmit

1. Personi juridik ose fizik, publik ose privat, që dëmton ose rrezikon dëmtimin, me anë të veprimit apo mosveprimit të tij, të një zone apo një pjesë të një zone të mbrojtur, sipas kuptimit të këtij ligji, përgjigjet për dëmtimet, si dhe përballon kostot e riparimit të dëmit e të rehabilitimit të zonës e të kthimit të saj në gjendjen e mëparshme.

2. Kryerja e vlerësimit të dëmit të shkaktuar në zonë të mbrojtur mjedisore është detyrë e administratës së zonës së mbrojtur.

3. Vlera e dëmit të shkaktuar në zonat e mbrojtura mjedisore, mënyra e vlerësimit, mbledhjes dhe administrimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 69

Vendimi për kundërvajtjet

1. Inspektori i Policisë Pyjore dhe/ose administrata e zonës së mbrojtur merr vendimin për dënimin administrativ për kundërvajtjet e parashikuara në nenin 67, të këtij ligji, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Vendimi për kundërvajtjen administrative përmban dënimin me gjobë për kundërvajtësin dhe dënime plotësuese si më poshtë:

- a) sekuestrimin e mjeteve dhe automjeteve që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes;
- b) sekuestrimin e çdo vlere monetare dhe materiali, lëndë drusore e jodrusore, bimë medicinale, florë dhe faunë, të përfituar nëpërmjet kundërvajtjes;
- c) pezullimin e veprimtarisë dhe çmontimin e instalimeve.

3. Inspektorati i Policisë Pyjore merr në ruajtje të përkohshme mjetet dhe materialet e sekuestruara, sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të këtij neni, derisa vendimi për kundërvajtjen administrative merr formë të prerë.

4. Mjetet dhe materialet e sekuestruara sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të këtij neni, pasi vendimi për kundërvajtjen administrative lihet në fuqi me vendim të formës së prerë, kalojnë në administrim të administratës së zonës së mbrojtur dhe administrohen prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Dorëzimi i mjeteve dhe materialeve të sekuestruara bëhet me procesverbal, të nënshkruar nga palët.

Neni 70

Ankimi dhe ekzekutimi i sanksioneve administrative

1. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të nenit 69, të këtij ligji, bëhet ankim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

2. Procedurat e ekzekutimit të vendimit të dënit me gjobë bëhen në përputhje me ligjin përkatës për kundërvajtjet administrative.

KREU XI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 8; të pikës 7, të nenit 18; të pikës 3, të nenit 23; të pikës 3, të nenit 24; të pikës 6, të nenit 29; të pikës 3, të nenit 41; të pikës 3, të nenit 47; të pikës 4, të nenit 58; të pikës 2, të nenit 59; të pikës 2, të nenit 61, dhe të pikës 2, të nenit 65, të këtij ligji, brenda dy vjetëve nga hyrja e tij në fuqi.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 6, të nenit 16; të pikës 5, të nenit 19; të pikës 4, të nenit 42; të pikës 1, të nenit 45 dhe të pikës 4, të nenit 57, brenda dy vjetëve nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 72

Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura” të ndryshuar, mbeten në fuqi për sa kohë nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 73

Të drejtat e fituara

1. Personat fizikë e juridikë, që kanë fituar të drejta të ushtrojnë veprimtari të caktuara në zonat e mbrojtura, duke lidhur marrëveshje, kontrata apo janë pajisur me leje mjedisi për to, do të vazhdojnë t’i kryejnë normalisht veprimtaritë, përderisa ato nuk ndalohen shprehimisht nga ky ligj apo nuk vijnë haptas në kundërshtim me të.

2. Kur ky ligj e ndalon shprehimisht një veprimtari të pajisur me leje mjedisi apo kur ajo vjen haptas në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, brenda tre muajve nga hyrja e tij në fuqi, AKZM-ja njofton zyrtarisht subjektin të mbyllë veprimtarinë për arsye ligjore dhe të rehabilitojë mjedisin ku është ushtruar veprimtaria.

3. Kur vërtetohen rrethanat e pikës 2, të këtij neni, fillimisht subjekti mund t’i paraqesë AKZM-së, brenda tre muajve nga njoftimi, propozimet e tij për mundësinë e ndryshimit të vendit ku mund të ushtrohet veprimtaria, për përmirësime të domosdoshme teknologjike, për zvogëlim kapacitetesh, për ndryshim të lëndëve të para apo të energjisë, me qëllim që veprimtaria të bëhet e pranueshme dhe mund të vazhdojë të ushtrohet.

4. AKZM-ja i shqyrton brenda një muaji nga dorëzimi propozimet e subjektit dhe, nëse i gjen në pajtim me ligjin, e njofton atë me shkrim që ta pajisë veprimtarinë me leje të re mjedisi, duke respektuar kërkesat dhe procedurat ligjore të procesit të pajisjes me leje mjedisi.

5. Kur propozimet e subjektit nuk mund të pranohen, atij i lihet gjashtë muaj deri në një vit kohë për ta hequr veprimtarinë dhe për të bërë rehabilitimet e kërkuara me shkrim nga AKZM-ja.

6. Nëse subjekti nuk kryen ato që i kërkojnë dhe nuk respekton afatet, ai kualifikohet dëmtues i zonës së mbrojtur dhe përgjigjet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 74

Dispozita kalimtare

1. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çdo administratë rinovon dhe paraqet për miratim në AKZM programin operativ të veprimeve të menjëhershme, përmbajtja e të cilit miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, AKZM-ja harton programin kombëtar të publikimit të informacionit për zonat e mbrojtura, përmbajtja e të cilit miratohet me urdhër të ministrit.

3. Zonat e miratuara me akt specifik përpara hyrjes në fuqi këtij ligji si “Parqe natyrore rajonale” do të shpallen automatikisht pas hyrjes në fuqi të këtij ligji si “Parqe natyrore bashkiake”.

Neni 75

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.5.2017

Shpallur me dekretin nr. 10335, datë 18.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 93/2015

PËR TURIZMIN³²

(ndryshuar me ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt, dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

1. Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari turistike dhe përcaktimi i të drejtave e detyrimeve të subjekteve pjesëmarrëse në këto veprimtari, në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që lidhen me fushën e turizmit.
2. Rregullimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit e të ndërveprimit të organeve të qeverisjes qendrore me ato të qeverisjes vendore në përcaktimin e politikave dhe zhvillimit të strategjive në fushën e turizmit.
3. Përcaktimi i rregullave për bashkërendimin e punës dhe bashkëveprimin e institucioneve përgjegjëse në fushën e turizmit, me qëllim zhvillimin e industrisë së turizmit sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.
4. Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve shtetërore dhe investitorëve potencialë, bazuar në interesin publik për zhvillimin e turizmit.

³² Ky ligj është në përputhshmëri të pjesshme me nenin 2, nenin 3, si dhe me Aneksin e Direktivës së Këshillit nr. 90/314/KEE të 13 qershorit 1990, "Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve", si dhe me nenin 2 dhe nenin 3 të Rregullores së Parlamentit Europian dhe Këshillit nr. 692/2011/BE, datë 6 korrik 2011, "Statistikat Europiane në Turizëm".

Ligji nr. 93/2015, datë 27.7.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 164, datë 21 shtator 2015.

Ligji nr. 114/2017, datë 18.12.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 232, datë 28 dhjetor 2017.

Neni 3

Subjektet dhe fusha e zbatimit

1. Personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, që zhvillojnë veprimtarinë turistike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimtari turistike biznesi, në baza kontraktuale, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, për sa kohë që ato nuk bien në kundërshtim me ligjin e vendit ku zhvillohen këto veprimtari.

Neni 4

Përkufizime

(shtuar pikat 53, 54, 55 me ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjenci udhëtimi” është çdo person fizik ose juridik, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si ndërmjetës, merr përsipër t’u ofrojë turistëve dhe personave të tjerë, si individë apo të organizuar në grup, çdo lloj shërbimi udhëtimi, përfshirë akomodimin në struktura pritëse për turistët, këshillimin dhe ofrimin e shërbimeve të udhëtimit me ajër, me tokë e me det, të ekskursioneve të organizuara, si dhe një sërë shërbimesh të tjera ndihmëse, që lidhen me industrinë e turizmit. Agjencia e udhëtimit zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në kontrata ndërmjetësimi për shitjen e shërbimeve të ofruara nga furnizuesit e shërbimeve të udhëtimit dhe/ose kontrata konsulence me konsumatorin.

2. “Agroturizëm” është veprimtaria pritëse që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtari të bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së ambientit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

3. “Bujtinë” (shtëpi pritëse) është një ndërtesë, një pjesë e së cilës përdoret si rezidencë e pronarit dhe ku ofrohet akomodim dhe ushqim për turistët, përkundrejt pagesës.

4. “Burim turistik” është tërësia e elementeve dhe/ose faktorëve, si potenciale që mundësojnë prodhimin e një eksperience turistike, duke përfshirë burimet e prekshme, burimet e paprekshme si edhe burimet njerëzore.

5. “Certifikatë”, në kuptim të këtij ligji, është dokument i lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin që shërben për të provuar plotësimin e kërkesave dhe standardeve për ushtrimin e veprimtarisë.

6. “Destinacion turistik” është pikë turistike me një përqendrim të lartë të produkteve turistike, i ngritur mbi bazën e studimeve dhe planeve të zonës dhe që ka kapacitete për të tërhequr vizitorë, vendas e të huaj, duke plotësuar e kënaqur kërkesat e tyre.

7. “Ekskursion” është kombinim i organizuar, paraprakisht, i shërbimeve të transportit dhe shërbimeve të tjera, që shiten ose ofrohen për shitje brenda të njëjtit çmim, shërbime që ofrohen për një periudhë më të shkurtër se 24 orë dhe që nuk përfshijnë akomodimin gjatë natës.

8. “Ekskursionist” është vizitori që udhëton për qëllime turizmi pa kaluar natën në vendin e vizituar.

9. “Fjetinë” (Hostel) është ndërtesë që ofron akomodim dhe ushqim me çmime ekonomike, zakonisht për udhëtarë, studentë dhe punëtorë, ku dhoma ndahet mes disa klientëve të ndryshëm.

10. “Fjetje dhe mëngjes (B&B)” është strukturë akomoduese që ofron shërbimin e fjetjes dhe mëngjesit brenda çmimit të dhomës. Kjo strukturë akomoduese nuk ofron shërbim restoranti dhe ambiente të përbashkëta.

11. "Fshat turistik tradicional" është vend i banuar me një përqendrim të lartë të burimeve dhe sipërmarrjeve turistike, i cili ka kapacitet për të tërhequr vizitorë vendas e të huaj, me një infrastrukturë të harmonizuar dhe mjedise që plotësojnë kërkesat e tyre.

12. "Hotel" është ndërtesë me jo më pak se 6 dhoma, ku akomodimi dhe shërbime si ushqim, pije etj. ofrohen nga një staf i kualifikuar, kundrejt një çmimi të afishuar.

13. "Industri turistike" është tërësia e bizneseve që ofrojnë shërbime dhe lehtësi të tjera në funksion të fushës së turizmit.

14. "Kamping" është zonë publike ose private e rrethuar, e pajisur me infrastrukturë të domosdoshme (ujë, tualete, energji elektrike etj.), ku udhëtarët mund të akomodohen në tendat e kampingut, apo të ngrenë tendat e tyre, ose të parkojnë mjetin motorik akomodues (kamper).

15. "Kamper" është mjet motorik i pajisur me kushte të përshtatshme qëndrimi, për ushtrimin e një aktiviteti turistik që ruan aftësinë e përhershme të mjetit lëvizës për t'u zhvendosur në çdo kohë.

16. "Licencë" është akti administrativ i përcaktuar sipas dispozitave të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

17. "Ministria përgjegjëse për turizmin" është ministria që ka si fushë përgjegjësie turizmin.

18. "Motel" është ndërtesë që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi, zakonisht me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vend-ndodhje në periferi të qendrave të banuara, pranë kryqëzimeve dhe rrugëve automobilistike.

19. "Ofruesi i shërbimeve turistike" është sipërmarrja turistike e transportit, akomodimit, argëtimit dhe e të gjitha shërbimeve të tjera për kalimin e kohës së lirë.

20. "Operatori turistik" është personi fizik dhe juridik që zhvillon një veprimtari tregtare, e cila ka të bëjë me dizejnimin dhe organizimin e një udhëtimi/pakete të paraplanifikuara e të promovuar me anë të katalogëve, fletëpalosjeve, reklamave në TV etj., duke qenë përgjegjës për atë produkt, si në rastin e shitjes nëpërmjet agjencive të udhëtimit, ashtu edhe në rastin e shitjes së drejtpërdrejtë të klientit. Operatori turistik nënshkruan kontrata drejtpërdrejt me furnizuesit e shërbimeve turistike, duke i parablerë këto shërbime.

21. "Paketë udhëtimi" është kombinimi paraprak i jo më pak se dy llojeve të shërbimeve të udhëtimit, si transport e akomodim, ose çdo shërbim turistik për qëllim të të njëjtit udhëtim apo pushim, për më shumë se 24 orë, nëse:

a) këto shërbime janë kombinuar nga një operator turistik i licencuar, me kërkesën apo me zgjedhjen e shërbimeve prej turistit, përpara përfundimit të kontratës së lidhur me këtë kombinim shërbimesh; ose

b) pavarësisht nëse janë mbyllur kontrata të veçanta me ofrues të shërbimeve turistike të veçantë, këto shërbime:

i) shiten në të njëjtën pikë shitjeje, nëpërmjet një procesi rezervimi të njëjtë;

ii) ofrohen ose shiten me një çmim të vetëm;

iii) publikohen ose shiten me emërtimin "paketë" ose me një emërtim të ngjashëm me të;

iv) kombinohen pas mbylljes së kontratës, me anë të së cilës operatori turistik i jep të drejtën udhëtarit të zgjedhë midis opsioneve të ndryshme të shërbimeve të udhëtimit; ose

v) blihen prej ofruesve të licencuar të shërbimeve, nëpërmjet proceseve të lidhura rezervimesh elektronike, ku emri dhe të dhënat e tjera të udhëtarit, të domosdoshme për mbylljen e rezervimit, i kalojnë ofruesve të tjerë të shërbimeve në fjalë, jo më vonë se sa koha kur konfirmohet shërbimi i parë.

22. "Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit" është plani i hartuar në përputhje me ligjin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

23. "Produkt turistik" është tërësia e elementeve të ndërthurura, që organizohet si vlerë e veçantë zinxhir, e cila përmban produkte materiale dhe shërbime, vlera natyrore dhe kulturore, superstrukturë dhe infrastrukturë turistike.

24. "Punë artizanale" janë punë të bëra me dorë, me interes kulturor e historik, të prodhuara për shitje për turistët që përfshijnë punime druri, punime argjendi, qëndistari, punime në llak/verniki,

prodhime xhami, kostume, gdhendje, punime guri, piktura, qeramikë, shportari dhe ndonjë lloj tjetër punimi të emërtuar si i tillë.

25. “Qendër kurative” është strukturë akomoduese me vendndodhje në zona me potenciale kuruese natyrore, të cilat stimulohen nga toka, uji, deti, rëra e klima dhe që shërbejnë për kryerjen e terapive kuruese.

26. “Regjistri Qendror i Turizmit” është regjistri publik i sipërmarrjeve turistike që mbahet sipas parashikimeve të këtij ligji dhe që ka qëllime statistikore.

27. “Regjistri kombëtar i burimeve turistike” është sistem informacioni që përmban një bazë të dhënash mbi burimet turistike të vendit.

28. “Resort” është kompleks ndërtesash për pushim dhe argëtim, të grupuara e të administruara së bashku, si hotele, apartamente, vila, studio, që u ofron klientëve akomodim, ushqim, pije, veprimtari sportive e argëtuese dhe shërbime ndihmëse, nëpërmjet një stafi të kualifikuar.

29. “Shërbim turistik” është lehtësia që u ofrohet turistëve nga sipërmarrja turistike.

30. “Shoqërues udhëtimi” është person i punësuar apo i kontraktuar nga një agjenci udhëtimi apo operator turistik për të drejtuar një udhëtim apo një ekskursion. Teknikisht, shoqëruesi i udhëtimit kryhen vetëm shoqërimin e grupit turistik, pa ushtruar funksionin e udhërrëfyesit turistik.

31. “Sipërmarrje turistike” është veprimtari turistik e ndërmarrë nga personi fizik ose juridik, e krijuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

32. “Stacion plazhi” është veprimtari turistik e ushtruar në struktura të ndodhura pranë bregut të detit, të ligeneve ose lumenjve, të pajisura me kabina për plazh, dhoma zhveshjeje, shërbime higjienike, dushe që, sipas rastit, ofron shërbimin e ushqimit dhe pijeve.

33. “Strukturë akomoduese” është struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj.

34. “Suvenire” janë mallra, harta, fotografi, kartolina dhe mallra të tjera të këtij lloji, të ndryshme nga ato të bëra me dorë, që u shiten turistëve si kujtim të vizitës së tyre në Shqipëri.

35. “Timeshare”, i njohur, gjithashtu, si pronësi pushimesh, lejon blerësit të blejnë kohë ose kredite pushimi në njësi të strukturës akomoduese. Pronësia e pushimeve ndahet midis individëve, në bazë të kohës, me intervale javore. Ky produkt pushimi i parapaguar mundëson akomodimin për pushime të ardhshme me çmimin e sotëm.

36. “Turist” është vizitori që qëndron, të paktën për një natë, në vendin që viziton për pushim, biznes dhe qëllime të tjera.

37. “Turizëm” është tërësia e veprimtarive të personave që udhëtojnë dhe qëndrojnë, për jo më shumë se 1 vit, në vende jashtë mjedisit të tyre të zakonshëm, për pushim, biznes dhe qëllime të tjera që nuk kanë lidhje me ushtrimin e ndonjë veprimtarie të paguar në vendin që vizitohet.

38. “Turizëm i qëndrueshëm” është turizmi që përmbush nevojat e turistëve, të komuniteteve pritëse, të sipërmarrjeve turistike dhe të vendimmarrësve lokalë e qendrorë, nëpërmjet menaxhimit të burimeve turistike, ruajtjes së vlerave të vazhdueshme ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, me qëllim që ato të mbeten po aq tërheqëse sa më parë dhe të krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit në të ardhmen.

39. “Turizëm kombëtar” nënkupton turizmin vendas dhe turizmin në dalje.

40. “Turizëm ndërkombëtar” nënkupton turizmin në dalje dhe turizmin pritës.

41. “Turizëm vendas” është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

42. “Turizëm pritës” është tërësia e veprimtarive turistike, të vizitorëve rezident dhe jorezident, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

43. “Turizëm në hyrje” është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori jo rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë.

44. “Turizëm në dalje” është tërësia e veprimtarive turistike të një vizitori rezident jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

45. “Turizëm rural”, veprimtaria turistike që zhvillohet në një mjedis fshati dhe që është e orientuar drejt përdorimit të burimeve lokale të turizmit.

46. “Udhërrëfyes turistik” është çdo person, mbi moshën 18 vjeç, i certifikuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, sipas parashikimeve të këtij ligji, i cili ofron asistencë, informacion dhe interpretime të trashëgimisë kulturore, historike e bashkëkohore për një grup të organizuar turistësh ose individë të veçantë, në një mjedis turistik, qoftë ky qytet, fshat, rrethinë me interesa të veçantë turistike, muze apo ndërtesa të tjera me vlera edukuese, fetare, historike dhe kulturore.

47. “Udhëtar” është individ i që lëviz ndërmjet vendeve të ndryshme, jashtë vendbanimit të zakonshëm, për arsye dhe kohëzgjatje të ndryshme.

48. “Veprimtari turistik” është tërësia e veprim-tarive që zhvillohen në bazë të kërkesës dhe ofertës, në fushën e turizmit, dhe prodhon produkte karakteristike të turizmit.

49. “Vizitor” është çdo person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendbanimi i vet i zakonshëm, për më pak se 1 vit, dhe që nuk ka si qëllim të ndërmarrë veprimtari që paguhen në vendin e vizituar.

50. “Vizitor ditor” është personi që viziton përkohësisht një vend dhe qëndron për më pak se 24 orë, me qëllimin e kalimit të kohës së lirë apo të biznesit, por jo për transit.

51. “Zonë me përparësi zhvillimin e turizmit” është zonë me rëndësi kombëtare në fushën e turizmit, e cila miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

52. “Zyrë e informacionit turistik” është zyrë, qëllimi parësor i së cilës është t’u sigurojë turistëve informacion lidhur me udhëtimet, veprimtaritë dhe objektet turistike, aktivitetet kulturore dhe çështje të tjera, për të lehtësuar vizitën, udhëtimin apo qëndrimin e tyre.

53. “Strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënkupton strukturën akomoduese, që përfshin hotelin dhe/ose resortin me 4 ose 5 yje, e cila përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/2 të këtij ligji.

54. “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënkupton subjektin, i cili financon ndërtimin dhe/ose merr përsipër ndërtimin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/1 të këtij ligji.

55. “Operator menaxhues në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënkupton grupin hotelier, i cili merr përsipër operimin dhe menaxhimin e një strukture akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kontratave “*franchising*” apo kontratave të tjera, të ngjashme me këtë të fundit.

KREU II

PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË TURIZMIT DHE INVESTIMET NË ZHVILLIMIN E TIJ

Neni 5

Parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit

1. Turizmi dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të mbështeten në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Këto parime kanë të bëjnë me aspektet ekonomike, mjedisore e social-kulturore dhe kërkojnë vendosjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet këtyre tri dimensioneve, për të siguruar qëndrueshmërinë e zhvillimit afatgjatë.

2. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit sigurohen nëpërmjet:

a) përfshirjes së organeve të ndryshme publike, të sektorit privat, shoqatave profesionale, tregtare e të mbrojtjes së konsumatorit, të OJF-ve përkatëse, si dhe të popullsisë në procesin e planifikimit;

b) organizimit dhe zbatimit të planifikimit turistik në nivel vendor, në përputhje me Planin Kombëtar të Turizmit, të hartuar dhe të miratuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, si pjesë përbërëse e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në nivel kombëtar;

- c) parashikimit, planifikimit, administrimit dhe kontrollit turistik, duke respektuar mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve turistike, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara për përdorimin e tyre;
- ç) shpërndarjes së drejtë të avantazheve dhe të kostove ndërmjet të gjithë aktorëve të sistemit turistik;
- d) informimit, arsimimit, motivimit dhe përfshirjes së popullsisë vendase në procesin e krijimit të vlerës për turistin;
- dh) vlerësimit paraprak të projekteve të turizmit dhe ndikimit që do të ketë zbatimi i tyre;
- e) përfshirjes së komuniteteve lokale në studimin dhe hartimin e programeve të përbashkëta për zhvillimin e turizmit;
- ë) monitorimit të zbatimit të projekteve të turizmit.

Neni 6

Investimet në zhvillimin e turizmit dhe interesi publik

Zhvillimi i turizmit, nëpërmjet investimeve vendase apo të huaja, në zbatim të këtij ligji, konsiderohet interes publik, duke gëzuar të gjithë mbështetjen dhe lehtësitë e parashikuara në kreun VI të këtij ligji.

KREU III

KUADRI INSTITUCIONAL DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN

Neni 7

Politikat shtetërore për turizmin

1. Institucionet shtetërore si dhe strukturat përgjegjëse për turizmin mbështetin fushën e turizmit, si një sektor kryesor gjithëpërfshirës ekonomik, ndërsektorial dhe ndërrajonal, duke e shndërruar atë në një fushë udhëheqëse në ekonomi, nëpërmjet përmbushjes së kërkesave të turistëve vendas e të huaj për vizita, pushime, çlodhje dhe argëtim, me synimin për të rritur punësimin dhe zhvillimin social e ekonomik të vendit.
2. Drejtimit kryesorë të politikës shtetërore në fushën e turizmit, që bazohen te parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, janë, si më poshtë:
 - a) njohja e turizmit si sektor prioritar i ekonomisë;
 - b) mbështetja e veprimtarive turistike dhe krijimi i kushteve të favorshme ligjore, ekonomike dhe strukturore për zhvillimin e tyre;
 - c) përcaktimi i drejtimeve prioritare për zhvillimin e turizmit në Shqipëri;
 - ç) krijimi i imazhit të Republikës së Shqipërisë si destinacion turistik;
 - d) krijimi i kushteve për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të ligjshme të turistëve e të ofruesve të shërbimeve të turizmit;
 - dh) garantimi i zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit;
 - e) mbështetja dhe bashkëpunimi i organizatave /shoqatave të turizmit në mënyrën e përcaktuar nga ligji;
 - ë) zhvillimi dhe mbështetja e turizmit pritës.

Neni 8

Organet përgjegjëse në fushën e turizmit

Organet përgjegjëse në fushën e turizmit janë:

- a) ministria përgjegjëse për turizmin;
- b) Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit;
- c) Agjencia Kombëtare e Turizmit;

- c) Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
- d) degët territoriale të turizmit;
- dh) inspektorati që mbulon fushën e turizmit;
- e) njësitë e qeverisjes vendore;
- ë) komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike.

Neni 9

Ministria përgjegjëse për turizmin

1. Ministria përgjegjëse për turizmin ka këto detyra:

- a) zbaton parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e industrisë turistike;
- b) harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, Planin Kombëtar të Turizmit dhe përgjigjet për zbatimin e tyre;
- c) harton dhe paraqet për miratim, pranë Këshillit të Ministrave, strategjinë e zhvillimit të turizmit dhe planin e veprimit;
- ç) krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Turizmit dhe Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike;
- d) mbështet dhe bashkëpunon me grupet e interesit në procesin e studimit të tregut, lidhur me burimet dhe produktet turistike, zhvillimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut turistik dhe konkurrencën në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit;
- dh) mbështet financiarisht projektet që ndihmojnë zhvillimin e fushës së turizmit;
- e) mbështet, mbron e zhvillon burimet turistike dhe promovon produktet turistike, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe në bashkëpunim me grupet e interesit;
- ë) merr masa për mbarëvajtjen, mbrojtjen dhe nxitjen e punësimit në industrinë e turizmit, duke i dhënë prioritet punësimit të të rinjve;
- f) nxit, mbështet e promovon edukimin dhe formimin profesional të vazhdueshëm turistik, nëpërmjet institucioneve dhe programeve të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse që mbulojnë fushën përkatëse;
- g) nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucione publike dhe private në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave në fushën e turizmit;
- gj) bashkërendon punën për zbatimin e dispozitave ligjore, përfshirë konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e turizmit;
- h) përfaqëson interesat e Qeverisë pranë organizatave të ndryshme ndërkombëtare, në pajtim me traktate dhe marrëveshje të tjera të nënshkruara nga Qeveria, dhe bashkëpunon me këto organizata e me shtete të tjera;
- i) harton dhe zbaton politikat për sistemet e certifikimit dhe klasifikimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- j) bashkëpunon me organizata ndërkombëtare që veprojnë në fushën e turizmit për programet e asistencës që ato ofrojnë;
- k) i propozon Këshillit Kombëtar të Territorit miratimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- l) bashkëpunon me autoritetet kompetente për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e vizitorëve vendas apo të huaj;
- ll) promovon dhe ndjek zbatimin e Kodit Global të Etikës në Turizëm;
- m) harton politikat e zhvillimit të produktit turistik dhe marketingut në fushën e turizmit, bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit dhe Strategjinë Kombëtare të Marketingut për sektorin e turizmit;
- n) përcakton kriteret për funksionimin e zyrave të informacionit turistik;
- nj) bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse për pajisjen e infrastrukturës rrugore dhe inxhinierike me sinjalistikën turistike, mbrojtjen e integruar të mjedisit, mbrojtjen nga ndërhyrjet e paligjshme dhe dëmtimet në zonat turistike;

o) luan rol koordinues lidhur me zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe menaxhimit të destinacionit;

p) administron çdo ankesë të shtetasve, vendas apo të huaj, ndaj hotelierëve, pronarëve të resorteve turistike, udhërrëfyesve turistikë, agjencive të udhëtimit, operatorëve turistikë dhe sipërmarrjeve të tjera turistike për shërbimet e ofruara, dhe ia përcjell për shqyrtim inspektoratit që mbulon fushën e turizmit;

q) harton programe për mbështetjen e projekteve turistike;

r) mbështet, nxit dhe ndërgjegjëson sipërmarrjet turistike, që ushtrojnë veprimtari turistike si strukturë akomoduese, lidhur me përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore dhe certifikimin “Eco-Certifikatë”.

2. Çdo institucion publik qendror dhe vendor, si edhe çdo organizatë jofitimprurëse në Shqipëri, që përfshihet në programet e asistencës së ofruar nga organizatat ndërkombëtare të lidhura me turizmin, njofton ministrinë për veprimtarinë që kryen, sipas një formati të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin dhe të publikuar në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

Neni 10

Dega territoriale e shërbimit të turizmit

1. Dega territoriale e shërbimit të turizmit krijohet si një strukturë administrative e ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të degës territoriale të shërbimit të turizmit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Dega territoriale e shërbimit të turizmit, në zbatim të këtij ligji, kryen këto funksione:

a) koordinon punën në terren për zbatimin e politikave të zhvillimit të produktit turistik dhe të menaxhimit të destinacionit turistik;

b) këshillon sipërmarrjet turistike për përmbushjen e standardeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve turistike të ofruara;

c) nxit dhe ndërgjegjëson sipërmarrjet turistike dhe komunitetet pritëse për edukimin në vazhdim;

ç) jep informacion për sipërmarrjet turistike, lidhur me kuadrin ligjor dhe standardet në fushën e turizmit, si dhe shpërndan manualët e klasifikimit /certifikimit për sipërmarrjet turistike;

d) këshillon palët e interesuara për ngritjen e sipërmarrjeve turistike;

dh) regjistron çdo kërkesë dhe ankesë që paraqitet nga turistët, përfaqësues të tyre dhe nga shoqatat konsumatore dhe ia përcjell ato inspektoratit që mbulon fushën e turizmit;

e) bashkëpunon me autoritetet vendore për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e turistit në destinacion;

ë) bashkëpunon me autoritetet vendore dhe grupet e interesit për të siguruar informacione në fushën e turizmit, sipas kërkesave dhe detyrave të dhëna nga struktura përgjegjëse për turizmin;

f) bashkëpunon me bizneset turistike për evidentimin dhe vlerësimin e nevojave për trajnime, për përmirësime ligjore e procedurale;

g) mbledh të dhëna dhe harton raporte periodike, në bashkëpunim me nëpunësit e turizmit të njëjësive të qeverisjes vendore, të cilat ia paraqet strukturës përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për turizmin.

Neni 11

Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit

1. Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit, në vazhdim KKSPIT, krijohet si një organ këshillimor për sektorin e turizmit.

2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të KKSPIT-së përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

3. KKSPT-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe në përbërje të tij ka përfaqësues nga shoqatat kombëtare të sipërmarrjeve, që operojnë në fushën e turizmit apo të lidhura me to, përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, dhomat e tregtisë, përfaqësues të shoqatave apo OJF-ve, që operojnë në fushën e turizmit, si dhe përfaqësues të institucioneve /donatorë ndër-kombëtarë.

4. KKSPT-ja ka këto detyra:

a) këshillon ministrin përgjegjës për turizmin për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit përpara miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave;

b) trajton dhe shqyrton çështje që kanë lidhje me veprimtarinë turistike të sektorit privat ose që mund të dalin gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie;

c) siguron bashkëpunim ndërmjet sektorit privat dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin për çështje që mund të lindin gjatë zhvillimit të turizmit, zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit dhe Planit të Veprimit;

ç) jep mendime mbi planifikimin e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;

d) jep mendime gjatë shqyrtimit të akteve ligjore që kanë lidhje me turizmin;

dh) jep informacione për ecurinë e sektorit privat të turizmit dhe i sugjeron ministrisë përgjegjëse për turizmin marrjen e masave për çështje që kanë të bëjnë me turizmin.

Neni 12

Agjencia Kombëtare e Turizmit

1. Agjencia Kombëtare e Turizmit, në vijim AKT, është personi juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin, që ka për qëllim promovimin e turizmit shqiptar, brenda dhe jashtë vendit. AKT-ja e ka selinë në Tiranë.

2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të AKT-së miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Struktura dhe organika e AKT-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit

Drejtori i Përgjithshëm i AKT-së drejton veprimtarinë e përditshme të saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët. Ai ushtron të gjitha kompetencat për drejtimin e veprimtarisë së AKT-së. Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të Përgjithshëm të AKT-së bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 14

Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Turizmit

Agjencia Kombëtare e Turizmit ka këto funksione dhe kompetenca:

1. Zbaton politikat e marketingut në fushën e turizmit, duke promovuar turizmin shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.

2. Ofron informacion për vizitorët, udhëtarët dhe turistët, për shërbimet turistike që ofrohen, për produktet dhe destinacionet turistike, për veprimtari e të dhëna të tjera të dobishme.

3. Promovon produktin dhe destinacionet turistike brenda e jashtë vendit, duke bashkëpunuar me zyrat rajonale të turizmit, pushtetin vendor dhe organizma të tjerë që operojnë në fushën e turizmit.

4. Promovon investimet në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera publike të nxitjes së investimeve në vend.

5. Inicion dhe nxit projekte për turizmin, sipas fushës së vet të veprimtarisë, duke marrë miratimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

6. Propozon dhe harton materialet me karakter promocional, në përputhje me tendencat e tregut turistik, dhe realizon prodhimin e tyre.

7. Zbaton strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit dhe strategjinë kombëtare të marketingut për sektorin e turizmit.

8. I propozon ministrit përgjegjës për turizmin ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e turizmit, duke argumentuar arsyet që lidhen me këto propozime.

9. Monitoron, përmirëson dhe përditëson faqen zyrtare të promocionit të turizmit shqiptar.

10. Mbledh të ardhurat që realizohen nga marrëveshjet e qirasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, dhe bën derdhjen e tyre në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

11. Kontrollon zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet “person i stimuluar”.

Neni 15

Agjencia Kombëtare e Bregdetit

1. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në vijim AKB, është person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin, që ka për qëllim mbrojtjen dhe ndjekjen e zhvillimit të zonës bregdetare shqiptare.

2. Kompetencat, mënyra e organizimit dhe funksionimit të AKB-së miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Struktura dhe organika e AKB-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 16

Inspektorati në fushën e turizmit

1. Inspektorati që mbulon fushën e turizmit, në vijim Inspektorati, është personi juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin. Inspektorati funksionon sipas këtij ligji dhe ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Inspektimi i veprimtarive turistike ka si qëllim të sigurojë zbatimin e legjislacionit të turizmit nga subjektet mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit.

3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Struktura dhe organika e Inspektoratit miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 17

Funksionet dhe kompetencat e Inspektoratit

1. Inspektorati, në zbatim të këtij ligji, kryen këto funksione:

a) kontrollon zbatimin e kriterëve dhe kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;

b) kontrollon dhe inspekton mjediset ku realizohet veprimtaria turistike;

c) bashkëpunon dhe u jep informacion organeve të tjera shtetërore, për rastet që janë në kompetencë të tyre, në lidhje me veprimtarinë turistike;

ç) kontrollon dhe merr masat për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) mbledh dhe administron dokumentacionin e plotë përkatës, përfshirë dokumente elektronike, të cilat kanë të bëjnë me objektin e kontrollit;

dh) ushtron kontroll në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve turistike, të cilat kanë detyrimin të lejojnë dhe të vënë në dispozicion të Inspektoratit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për inspektim;

e) vendos gjoha dhe masa të tjera administrative ndaj personave fizikë a juridikë, kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji.

2. Inspektorati shqyrton ankesat ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, të marrë drejtpërdrejt ose të përcjellë nga çdo institucion tjetër apo individ.

3. Inspektorati merr vendim, pas shqyrtimit të ankesave, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe në përputhje me kompetencat e dhëna me këtë ligj.

4. Rregullorja e shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

Neni 18

Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike

1. Për certifikimin e veprimtarive turistike, për dhënien dhe revokimin e certifikatave përkatëse ngrihet komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike, pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Mënyra e organizimit, e funksionimit dhe përbërja e komisionit të standardizimit të veprimtarive turistike përcaktohet me rregullore të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

3. Komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin dhe përbëhet nga 5 anëtarë.

Neni 19

Njësitë e qeverisjes vendore, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e turizmit

Njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të këtij ligji, kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të krijojnë inventarin e burimeve kryesore turistike të njësisë së qeverisjes vendore dhe inventarin e sipërmarrjeve turistike në nivel vendor;

b) të përcjellin, periodikisht, çdo 6 muaj, inventarët e përmendur në shkronjën “a”, të këtij neni, pranë ministrit përgjegjës për turizmin, për krijimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar;

c) të sigurojnë infrastrukturën mbështetëse për veprimtaritë e biznesit të turizmit në nivel vendor, duke mundësuar respektimin e standardeve nga sipërmarrjet turistike;

ç) të kontribuojnë në zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në nivel vendor, si turizmi kulturor, agroturizmi etj., në bazë të burimeve turistike, duke luajtur rol aktiv në diversifikimin e produktit turistik, në bashkëpunim me të gjitha institucionet qendrore e vendore, si dhe grupet e interesit;

d) të sigurojnë informacion, si pjesë e sistemit të statistikave të turizmit, për ministrin përgjegjës për turizmin;

dh) të bashkëpunojnë për marrjen e masave për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor parësor për vizitorët/turistët, brenda juridiksionit të njësisë së pushtetit vendor, duke zbatuar standardet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe ajo e shëndetësisë;

e) të marrin masa për krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm brenda juridiksionit të territorit të tyre, në përputhje me normat dhe në zbatim të rregulloreve higjieno-sanitare.

Neni 20

Komiteti rajonal i zhvillimit të turizmit

1. Me qëllim bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore dhe njësisve të qeverisjes vendore, për çështjet e turizmit, pranë çdo prefekture krijohen komitetet rajonale të zhvillimit të turizmit, nën drejtimin e prefektit të qarkut. Në përbërje të këtyre komiteteve janë përfaqësues të njësisve të qeverisjes vendore, përfaqësues të qarkut, përfaqësues të shoqatave lokale në

fushën e turizmit, institucioneve arsimore dhe edukuese për turizmin dhe përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Komiteti rajonal i zhvillimit të turizmit ka për detyrë:

a) të sigurojë një forum për të trajtuar çështjet që lidhen apo që lindin nga veprimtaritë turistike në njësitë e qeverisjes vendore;

b) të sigurojë një forum për bashkëpunim, ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe institucioneve të tjera të turizmit në nivel vendor, për çështjet që lindin në fushën e zhvillimit të turizmit, në zbatimin e politikës kombëtare dhe për çështje të tjera të lidhura me këtë fushë;

c) të sigurojë informacion për ministrin dhe AKT-në, për çështjet e lidhura me turizmin, që krijohen në njësitë e qeverisjes vendore, sipas territorit administrativ përkatës.

3. Komiteti mbledhet, të paktën, dy herë në vit dhe në çdo rast tjetër që kërkohet nga prefekti.

4. Organizimi dhe funksionimi i komitetit rajonal të zhvillimit të turizmit përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU IV PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Neni 21

Parimet e planifikimit të zhvillimit të turizmit

1. Planifikimi i zhvillimit të turizmit:

a) mbështetet në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike;

b) është pjesë përbërëse dhe hartohet në përputhje me planin kombëtar të territorit, me strategjinë e turizmit dhe me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit si dhe me dispozitat e legjislacionit për administrimin dhe mbrojtjen e tokës;

c) përqendrohet në zona me potencial më të madh turistik dhe në ato drejtime ku zhvillimi i turizmit mundëson një ristrukturim social dhe ekonomik.

2. Planet e zhvillimit të turizmit shqyrtohen dhe rishikohen në mënyrë periodike, për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me politikat e zhvillimit kombëtar, territorial, mjedisor dhe ato social-ekonomike të komunitetit.

Neni 22

Klasifikimi i burimeve turistike

1. Burimet turistike në Republikën e Shqipërisë klasifikohen në:

a) burime natyrore turistike, ku përfshihen peizazhet natyrore, zonat e mbrojtura, veçoritë gjeografike e biologjike, kushtet klimatike, detare, hidrografike dhe objektet e tjera fizike, natyrore apo gjeomumentale, që janë tërheqëse për turistët;

b) burime njerëzore turistike, të cilat ndahen në:

i) burime materiale njerëzore turistike, ku përfshihen ndërtesat historike e ndërtimet e tjera, reliket si dhe punët artizanale;

ii) burime jomateriale njerëzore turistike, ku përfshihen veprimtaritë e ndryshme kulturore.

2. Burimet turistike shndërrohen në produkte turistike në bazë të një procesi studimi dhe planifikimi, sipas prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit.

Neni 23

Regjistri Kombëtar i Burimeve Turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin identifikon dhe inventarizon burimet turistike nëpërmjet sigurimit të të dhënave të lidhura me to.

2. Ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me organet publike të qeverisjes qendrore dhe vendore, harton dhe administron Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike, si pjesë e sistemit të bazës së të dhënave.

3. Pronarët ose organet përgjegjëse për administrimin e burimeve turistike duhet të regjistrojnë burimet turistike në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike.

4. Ministria përgjegjëse për turizmin monitoron përditësimin e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Burimeve Turistike.

Neni 24

Përgjegjësia për administrimin e burimeve turistike

1. Personat juridikë dhe fizikë, organet publike qendrore e vendore apo personat privatë, që zotërojnë ose administrojnë burime turistike, janë përgjegjës për administrimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të lidhura me të.

2. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për bashkërendimin e veprimtarive të organeve publike, të angazhuara në zhvillimin e turizmit brenda territorit të tyre, për mbrojtjen, rritjen dhe përdorimin e burimeve turistike, për shndërrimin e tyre në produkte turistike, duke maksimizuar potencialin e tyre ekonomik, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit dhe me sugjerimet që rrjedhin nga takimet e komitetit rajonal të zhvillimit të turizmit.

Neni 25

Mbështetja për zhvillimin e turizmit

Organet shtetërore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për turizmin, ndihmojnë në zhvillimin e turizmit duke:

a) nxitur dhe mbështetur planet e zhvillimit të turizmit për çdo bashki, në bazë të studimeve paraprake, në përputhje me planin kombëtar sektorial të turizmit, për zhvillimin e produktit turistik në atë zonë;

b) dhënë informacionin e nevojshëm turistik;

c) ndihmuar në kualifikimin e burimeve njerëzore;

ç) promovuar produktet turistike të zonës;

d) marrë masa për zhvillimin e infrastrukturës së përgjithshme turistike dhe të shërbimeve publike në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit dhe destinacionet turistike;

dh) mbështetur investimet në turizëm në zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë;

e) propozuar politika të lehtësive për bizneset turistike, për individët dhe subjektet juridike në zonat e rëndësishme kombëtare për turizmin.

Neni 26

Përgatitja e planit kombëtar sektorial të turizmit

Ministria përgjegjëse për turizmin, me cilësinë e autoritetit kombëtar sektorial të planifikimit të territorit, përgatit planin kombëtar sektorial të turizmit për gjithë territorin, në përputhje me parashikimet e ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe të dispozitave të legjislacionit që rregullojnë veprimtarinë mbi territorin, ku kërkohet të realizohen këto plane zhvillimi.

Neni 27

Përmbajtja e planit kombëtar sektorial të turizmit

Plani kombëtar sektorial i turizmit përgatitet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe duhet të përmbajë:

a) parashikimet për zhvillimin e turizmit dhe përcaktimin e zonave të veçanta për këtë qëllim;

b) vlerësimin e kapitalit të investimeve të planifikuara, në përputhje me planet në nivel kombëtar dhe vendor, për një periudhë prej 5 vjetësh, 10 vjetësh ose më gjatë;

c) parashikimet e planit të punimeve në infrastrukturën e zonës, të destinacioneve turistike, në përputhje me potencialin turistik, vlerësimin e rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura dhe planet e zhvillimit social-ekonomik kombëtar, rajonal dhe vendor;

ç) parashikimet e veprimtarive të marketingut;

d) parashikimet e veprimtarive arsimuese, të kualifikimit profesional dhe të edukimit në vazhdim.

Neni 28

Caktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit

Me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, Këshilli Kombëtar i Territorit miraton zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si zona të rëndësishme kombëtare, në përputhje me planin e përgjithshëm kombëtar dhe planin kombëtar sektorial të turizmit.

Neni 29

Mbrojtja, ruajtja, përdorimi dhe zhvillimi i burimeve natyrore turistike

1. Me qëllim mbrojtjen, ruajtjen, përdorimin dhe zhvillimin me efikasitet të burimeve natyrore turistike, zhvillimi dhe operimi i një sipërmarrjeje turistike, si hotel, kompleks turistik dhe struktura të tjera akomoduese, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, bëhet në përputhje me planin kombëtar sektorial të turizmit, kategoritë e klasifikimit dhe të planeve të menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe me parashikimet ligjore në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe duke iu referuar dokumenteve të planifikimit.

2. Zhvillimi dhe operimi i një sipërmarrjeje turistike, si hotel, kompleks turistik dhe struktura të tjera akomoduese, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, bazuar në interesin e përgjithshëm publik, mund të bëhet edhe në pronat shtetërore, me kusht që këto struktura, ndërtime, mjedise e shërbime ndihmëse të mos dëmtojnë parametrat natyrorë dhe kulturorë të këtyre zonave dhe të mos rrezikojë aktivitetin turistik, e të jenë në përputhje me planin kombëtar sektorial të turizmit.

3. Shfrytëzimi i burimeve natyrore si det, liqen, lumë apo brigjet e tyre duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos dëmtojë apo shkatërrojë, në asnjë rast, karakteristikat e tyre dhe territorin buzë tyre.

Neni 30

Plani i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përgatit planin e zhvillimit dhe të veprimit për çdo zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, në bashkëpunim me ministrinë, organet publike, organet e qeverisjes vendore, si dhe me grupet e interesit, dhe e paraqet për miratim, sipas parashikimeve të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe mbështetur në dokumentet e planifikimit kombëtar e vendor.

2. Planet e detajuara për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit hartohen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” e rregullores së planifikimit dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

3. Ministria përgjegjëse për turizmin, në cilësinë e autoritetit të planifikimit, zbaton instrumentet për drejtimin e zhvillimit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

4. Planet e zhvillimit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, përveç sa është parashikuar në rregulloren e planifikimit, përmbajnë edhe:

a) identifikimin, vlerësimin dhe klasifikimin e burimeve turistike të disponueshme në këto zona;

b) analizimin e mjedisit ekzistues turistik dhe të potencialit të tij, përfshirë mjedisin natyror, të biodiversitetit, të peizazhit dhe të rrjetit të zonave të mbrojtura, si dhe mjedisin kulturor, ekonomik e social;

- c) përcaktimin e prioriteteve në zhvillimin e zonave përkatëse;
- ç) përcaktimin dhe përshkrimin e zonave të planifikuara për turizëm, të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe të nevojave të tyre për zhvillim turistik, brenda zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;
- d) infrastrukturën e nevojshme për sistemin e ujësjellësit, sistemin e kanalizimeve, furnizimit me energji, internet, mjediset publike dhe shërbimet turistike, që kërkohen për përmirësimin e potencialit turistik të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit;
- dh) planifikimin e sinjalistikës, stendat dhe afishimeve turistike, në bashkërendim me organet publike përgjegjëse;
- e) përcaktimin e mjeteve të mbrojtjes dhe të promovimit të produkteve turistike me vlerë trashëgimie kulturore, historike ose natyrore dhe specifikimin e formave dhe mekanizmave të nevojshëm të bashkëpunimit dhe të bashkë-ndimit me autoritetet kompetente, për të arritur këtë objekt;
- ë) përcaktimin e mjeteve të nxitjes dhe promovimit të turizmit pritës dhe identifikimin e programeve të qarta të punës për ta realizuar këtë;
- f) përcaktimin e mjeteve të zhvillimit dhe të mbështetjes së produkteve të turizmit në të gjitha format e tyre;
- g) përcaktimin e nevojave për financim, me qëllim zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit turistik;
- gj) përcaktimin e burimeve të nevojshme njerëzore për zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit;
- h) parashikimin për monitorimin e zbatimit të planit kombëtar sektorial të turizmit dhe ndjekjen e vlerësimit të performancës në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

KREU V

MBËSHTETJA FINANCIARE E PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT

Neni 31

Mbështetja financiare për projektet në fushën e turizmit

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përgatit programe për mbështetjen e projekteve në fushën e turizmit.
2. Këto programe duhet të jenë në përputhje me objektivat e këtij ligji dhe të sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, të mbrojnë, të ruajnë dhe të promovojnë destinacionet turistike dhe vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, të mundësojnë zhvillimin dhe diversifikimin e produkteve turistike, si dhe të mbështetin profesionalizmin në fushën e turizmit.
3. Ministria përgjegjëse për turizmin, nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit, financon projekte edukimi, promovimi dhe studime apo modele produktesh turistike në ndihmë të zhvillimit të turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj.
4. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.
5. Projektet, të cilat kërkojnë një financim, që arrijnë mbi 50 për qind të fondit vjetor të parashikuar për projektet turistike, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Miratimi i projekteve turistike bëhet nga ministri përgjegjës për turizmin, me propozim të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, të përbërë nga 7 anëtarë:
 - a) 5 nëpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues të strukturave përgjegjëse në ministri;
 - b) 2 përfaqësues nga shoqatat e sektorit të turizmit.
7. Anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në pikën 3, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 32

Kompetencat e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve

1. Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve ka këto kompetenca:
 - a) klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit, duke vlerësuar ndikimin social-ekonomik të tyre;
 - b) propozon miratimin e projekteve, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji.
2. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU VI

INVESTIMET NË TURIZËM

Neni 33

Format e partneritetit

1. Në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit shteti mund të marrë rolin e zhvilluesit, të përfshihet në partneritete publiko-private, të përfaqësohet me aksione në sipërmarrje turistike, të vërë në dispozicion pasuri të paluajtshme, të sigurojë infrastrukturë mbështetëse etj., si dhe kombinime të formave të mësipërme.
2. Për aq sa nuk përcaktohet me këtë ligj, format e partneritetit rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 33/1

Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special

(shtuar me ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017)

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin, jep statusin e veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” për subjektin që plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, në Republikën e Shqipërisë, të certifikuar si e tillë nga struktura përgjegjëse, sipas këtij ligji;
- b) vlera e investimit është të paktën 8 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe të paktën 15 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 5 yje.

Neni 33/2

Aplikimi për statusin “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” dhe marrëveshja me investitorin

(shtuar me ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017)

1. Kriteret e tjera, procedurat dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë subjektet që duan të aplikojnë për statusin “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Subjektet, që përfitojnë statusin “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënshkruajnë marrëveshje zhvillimi me ministrinë përgjegjëse për turizmin, në të cilën parashikohen detyrimet e ndërsjella, afatet e realizimit të projektit, vlera e projektit, ndalimet për tjetërsimin e pronësisë së strukturave të ndërtuara apo pjesëve të tyre, si dhe pasojat nga mosrespektimi i detyrimeve të ndërsjella.

Neni 34

Pasuritë e paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Pasuritë e paluajtshme, në pronësi të shtetit, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me përjashtim të zonave të mbrojtura dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

2. Pasuritë e paluajtshme, në administrim të njësive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin.

3. Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, miraton me vendim të veçantë transferimin, në favor të shtetit, të pasurive të paluajtshme në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Neni 35

Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, miraton vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për projekte investuese në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

2. Kohëzgjatja e vënies në dispozicion është deri në 99 vjet.

3. Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shtetërore mund të bëhet edhe nëpërmjet kontratës simbolike 1 euro.

4. Rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Në rastin e investitorëve me status Investitor Strategjik i Veçantë, sipas përcaktimeve në legjislacionin për investimet strategjike, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, rast pas rasti, transferimin e së drejtës së pronësisë të pasurive të paluajtshme shtetërore tek investitori privat, duke e kushtëzuar kalimin me realizimin e plotë të investimit. Kur vlerësohet nga Këshilli i Ministrave, marrëveshja për realizimin e investimit strategjik propozohet për miratim me ligj të posaçëm në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 36

Marrëveshja me investitorin

1. Ministria përgjegjëse për turizmin nënshkruan marrëveshje zhvillimi me investitorët, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në të cilat parashikohen angazhimet reciproke, karakteristikat, afatet e realizimit dhe vlera e projektit, si dhe garancitë e nevojshme dhe instrumentet e sigurisë për realizimin e investimit.

2. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat dhe formatet e marrëveshjeve me investitorët.

Neni 37

Portet turistike

1. Ministria përgjegjëse për turizmin mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave shpalljen e porteve turistike apo pontileve të përhershme, që shërbejnë si infrastrukturë mbështetëse për strukturat turistike.

2. Këshilli i Ministrave, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, autorizon ndërtimin dhe operimin nga investitorët e strukturave turistike të porteve dhe pontileve të shpallura sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 38

Të drejtat dhe detyrimet e investitorit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit

1. Investitori është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet dhe të sigurojë të gjitha garancitë, financiare apo të çdo lloji, siç përcaktohet në marrëveshjen e nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për turizmin.

2. Investitori zgjedh format e përshtatshme të administrimit dhe të ofrimit të produkteve turistike, përfshirë timeshare etj.

3. Investitori gëzon të drejtën e nënkontraktimit të ndërtimit të strukturave apo të administrimit të sipërmarrjes, apo pjesëve të saj, me kusht që objekti i veprimtarisë të mbetet i pandryshuar. Në çdo rast, investitori mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të marrëveshjes së nënshkruar me ministrinë përgjegjëse për turizmin.

4. Investitori mund të transferojë pronësinë e strukturave të veçanta akomoduese tek të tretët. Transferimi bëhet vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin. Strukturat që parashikohet të transferohen paraqiten të detajuara në projektin e investimit dhe lejimi i transferimit të tyre miratohet si aneks i veçantë i marrëveshjes me investitorin.

5. Transferimi i veprimtarisë, si e tërë apo i një pjese të aksioneve tek të tretët, bëhet vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për turizmin, me kusht që objekti i veprimtarisë të mbetet i pandryshuar.

Neni 39

Shfuqizimi i vënies në dispozicion

1. Në rast mospërmbushjeje apo shkeljeve të dispozitave të marrëveshjes së zhvillimit, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, mund të shfuqizojë të drejtën e fituar të vënies në dispozicion të pasurisë së paluajtshme.

2. Marrëveshja parashikon garanci dhe penalitete specifike ndaj investitorit për kompensimin e interesave të shtetit dhe të të tretëve në rastet e shfuqizimit.

Neni 40

Përdorimi i bregut

1. Për investimet pranë brigjeve të detit apo liqenit mund të vihet në dispozicion një hapësirë e plazhit, në raport me kapacitetin e strukturës akomoduese.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e detajuara për zbatimin e pikës 1 të këtij neni.

Neni 41

Zonat ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar

1. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme kryen regjistrim të veçantë për të gjitha pasuritë që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, për të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar.

2. Regjistrimi i veçantë, sipas pikës 1, kryhet brenda 3 muajve nga miratimi i zonës me përparësi zhvillimin e turizmit.

Neni 42

Investimet jashtë zonave me përparësi zhvillimin e turizmit

Autoritetet vendore të planifikimit, pasi miratojnë lejet e ndërtimit për struktura akomoduese jashtë zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, njoftojnë ministrinë përgjegjëse për turizmin.

KREU VII STRUKTURAT AKOMODUESE

Neni 43

Kategoritë e strukturave akomoduese

Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë:

- a) “Bujtinë” ;
- b) “Fjetinë” (Hostel);
- c) “Kamping”;
- ç) “Hotel”;
- d) “Motel”;
- dh) “Resort”;
- e) “Qendër kurative”;
- ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Neni 44

Kriteret e ndërtimit të strukturave akomoduese

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, miraton rregulloren përkatëse për kushtet dhe kriteret për projektimin dhe ndërtimin e strukturave akomoduese.

Neni 45

Klasifikimi i strukturave akomoduese

1. Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm:

- “Bujtinë” Standard;
- “Fjetinë” Standard, Komfort;
- “Kamping” Standard
- “Hotel” Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
- “Motel” Standard, Komfort, Superior;
- “Resort” Tre yje, katër yje, pesë yje;
- “Qendër kurative” Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
- “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

2. Çdo sipërmarrje turistike, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese.

3. Certifikata e klasifikimit është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rinovimi brenda 30 ditëve nga afati i mbarimit të vlefshmërisë së saj.

4. Riklasifikimi i strukturës akomoduese, përpara periudhës së mbarimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës së klasifikimit, me qëllim ngritjen e nivelit të klasifikimit, bëhet me kërkesë të subjektit.

5. Kushtet, kriteret, tarifat, afatet, si dhe procedura për klasifikimin e strukturave akomoduese, përcaktohen me rregulloren përkatëse, që miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin.

6. Ministria përgjegjëse për turizmin bashkëpunon me agjenci dhe organizata të mirënjohura ndërkombëtare për hartimin e rregullores dhe klasifikimin e strukturave akomoduese.

7. Kostoja e procesit të klasifikimit mbulohet nga sipërmarrjet turistike që certifikohen.

8. Certifikata e klasifikimit regjistrohet automatikisht, pas përfundimit të procesit të klasifikimit në

Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

9. Për çdo ndryshim të të dhënave të deklaruara, sipërmarrja turistike që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e strukturave akomoduese, duhet të njoftojë strukturën përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, brenda 7 ditëve pune.

10. Nuk i nënshtrohen procesit të klasifikimit të strukturave akomoduese, sipas parashikimeve të këtij ligji, strukturat akomoduese që përbëjnë objekt të veçantë të trashëgimisë kulturore, të përcaktuara nga ligji.

Neni 46

Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së strukturës akomoduese

Sipërmarrja turistike, që ushtron veprimtarinë e saj në fushën e strukturave akomoduese, e humbet të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë:

- a) me përfundimin e aktivitetit si person fizik/juridik;
- b) kur i hiqet kjo e drejtë me vendim të komisionit të standardizimit të veprimtarive turistike, pasi nuk plotëson kushtet dhe kriteret e nivelit më të ulët të sistemit të klasifikimit;
- c) sipas përcaktimeve të tjera të bëra në këtë ligj.

KREU VIII

AGJENCITË E UDHËTIMIT DHE OPERATORËT TURISTIKË

Neni 47

Agjencia e udhëtimit

Shërbimet e agjencisë së udhëtimit përfshijnë, por nuk kufizohen me:

- a) shitjen e biletave të avionit, të traqetit, të trenit, të autobusit;
- b) shitjen e paketave të udhëtimit, në emër të operatorëve të udhëtimit, vendas ose ndërkombëtarë;
- c) dhënien e automjeteve me qira, në emër të përfaqësuesve të automjeteve me qira;
- ç) përgatitjen e dokumenteve të udhëtimit, në përputhje me rregullat në fuqi;
- d) dhënien e informacionit të duhur dhe ndihmës për lëshimin e certifikatës për vaksinimin, në rastet e udhëtimit në vende me rrezik epidemiologjik;
- dh) dhënien e informacionit të duhur dhe ndihmës për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të tjera të domosdoshme për hyrjen në një vend të caktuar;
- e) përgatitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme për transportin dhe/ose akomodimin e udhëtarëve.

Neni 48

Licencimi dhe rregullat për ushtrimin veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit

1. Agjencia e udhëtimit, para fillimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, pajiset me licencë, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 16, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Agjencia e udhëtimit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve, me objekt veprimtarie si agjenci udhëtimi;
- b) përfaqësuesi ligjor të mos jetë një person i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të mashtrimit, të mospagimit të taksave dhe tatimeve, të korrupsionit, apo për një vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit, brenda një periudhe 5-vjeçare, që i paraprin kërkesës për licencë;

c) përfaqësuesi ligjor (administratori) ose drejtuesi teknik të zotërojnë një diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve ose dëshmi kualifikimi profesional, në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit;

ç) të zotërojnë një mjedis pune jo më të vogël se 10 m² për ushtrimin e veprimtarisë;

3. Kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit përcaktohen në rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Pas publikimit të licencës në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, ministria përgjegjëse për turizmin bën regjistrimin e kësaj licence në Regjistrin Qendror të Turizmit.

Neni 49

Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit

Revokimi i licencës dhe ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit bëhet sipas përcaktimeve të neneve 12 e 29, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Neni 50

Operatori turistik

Operatori turistik e bën shitjen e produkteve të veta turistike, kryesisht, nëpërmjet agjencive të udhëtimit, pa u kufizuar edhe me shitjen e drejtpërdrejtë të konsumatori. Ai nënshkruan kontrata të drejtpërdrejta me furnizuesit e shërbimeve turistike, duke i parablerë këto shërbime.

Neni 51

Licencimi dhe rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve turistikë

1. Operatori turistik, para fillimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, pajiset me licencë, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 16, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Operatori turistik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimeve, me objekt veprimtarie si operator turistik;

b) përfaqësuesi ligjor të mos jetë një person i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të mashtrimit, të mospagimit të taksave dhe tatimeve, të korrupsionit, apo për një vepër penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit, brenda një periudhe 5-vjeçare, që i paraprin kërkesës për licencë;

c) përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik të zotërojnë një diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve, në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit dhe të kenë një eksperiencë të mëparshme në këtë fushë;

ç) të zotërojnë një mjedis pune jo më të vogël se 16 m² për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik përcaktohen në rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

4. Pas publikimit të licencës në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, ministria përgjegjëse për turizmin bën regjistrimin e kësaj licence në Regjistrin Qendror të Turizmit.

Neni 52

Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së operatorit turistik

Revokimi i licencës dhe ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë së operatorit turistik bëhet sipas përcaktimeve të neneve 12 e 29, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 53

Regjistrimi i udhëtimeve

1. Agjencia e udhëtimit dhe operatori turistik mban regjistër me të dhënat e turistëve, destinacionet e vizituara dhe ditët e qëndrimit dhe i raporton këto të dhëna elektronikisht, një herë në muaj, sipas formularit të miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

2. Një agjenci udhëtimi ose operator turistik duhet t'i ruajë këto raportime, të specifikuara, për tre vjet, nga data e kthimit nga udhëtimi përkatës.

Neni 54

Të dhënat bazë të kontratës me konsumatorin

1. Të dhënat bazë të kontratës së operatorëve turistikë dhe agjencive të udhëtimit me konsumatorin duhet të përmbajnë, të paktën:

- a) licencën e “Operatorit turistik”;
 - b) emrin, adresën dhe të dhëna të tjera kontakti të agjencisë së udhëtimit, operatorit turistik dhe të siguruesit;
 - c) destinacionin e udhëtimit dhe datat e nisjes e të kthimit;
 - ç) mjetin e transportit të përdorur;
 - d) itinerarin e udhëtimit;
 - dh) tipin e strukturës së akomodimit, vendndodhjen, klasifikimin dhe karakteristikat kryesore të saj;
 - e) vaktet e ushqimit, të përfshira në çmimin e paguar;
 - ë) listën e shërbimeve të tjera që ofrohen për klientët brenda çmimit të paguar;
 - f) listën e shërbimeve që nuk përfshihen në çmimin e paguar;
 - g) listën e shërbimeve shtesë, që mund të blihen veçmas;
 - gj) numrin minimal të personave të domosdoshëm për realizimin e paketës së udhëtimit;
 - h) afatin për njoftimin e klientit, në rastin e anulimit nga ana e operatorit turistik;
 - i) afatet dhe penalitetet përkatëse, në rastin e anulimit të shërbimit të blerë nga ana e klientit;
 - j) mundësinë e transferimit të paketës;
 - k) çmimin e paketës së udhëtimit dhe kur paketa lejon rishikim çmimi, një shënim për rishikimin e mundshëm dhe mënyrën e përlllogaritjes së këtij rishikimi;
 - l) tabelën me afatet kohore dhe mënyrën e pagesave;
 - ll) kërkesat e veçanta që klienti ka bërë me dije në momentin e rezervimit dhe për të cilat është rënë dakord nga të dyja palët;
 - m) përgjegjësitë që dalin nga mospërmbushja e detyrimeve në dëm të klientit;
 - n) formatin e garancisë, shtrirjen dhe limitet financiare të përgjegjësisë;
 - nj) detyrimin e përfaqësuesit të huaj për të komunikuar me klientin nëpërmjet operatorit turistik;
 - o) detyrimin e përfaqësuesit të huaj për të ndihmuar në çdo rast.
2. Sipërmarrjet turistike të udhëtimit, për sa u takon paketave të udhëtimit, zbatojnë detyrimet e parashikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 55

Garancitë e operatorëve turistikë

1. Operatorët turistikë duhet të kenë një kontratë të vlefshme sigurimi për mbulimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë aftësinë pague dhe falimentimin. Kontrata e Sigurimit lidhet me një shoqëri sigurimi, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për sigurimet dhe risigurimet.

2. Kontrata e sigurimit duhet të mbulojë dëmet e parashikuara më sipër, si dhe ato të parashikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

KREU IX UDHËRRËFYESI TURISTIK

Neni 56

Kategoritë e udhërrëfyesit turistik në Republikën e Shqipërisë

Udhërrëfyesi turistik në Republikën e Shqipërisë ndahet në kategoritë e mëposhtme:

- a) udhërrëfyes turistik kombëtar, personi, i cili mund të udhëheqë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) udhërrëfyes turistik lokal, personi, i cili mund të udhëheqë vetëm në një zonë të kufizuar;
- c) udhërrëfyes i specialitetit të veçantë, personi, i cili mund të udhëheqë veprimtari të turizmit të aventurës dhe të interesit të veçantë.

Neni 57

Kriteret për certifikimin e udhërrëfyesit turistik

1. Veprimtaria e udhërrëfyesit lejohet për t'u ushtruar, pas pajisjes së këtij të fundit me certifikatë.
2. Kriteret për pajisjen me certifikatë, për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodi i etikës së tyre, parashikohen në rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Ministria përgjegjëse për turizmin lëshon certifikatën e udhërrëfyesit turistik për kategorinë dhe gjuhën përkatëse të udhërrëfyesit.
4. Certifikata që miraton kryerjen e shërbimit të udhërrëfyesit turistik regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.
5. Certifikata e udhërrëfyesit turistik duhet të përmbajë:
 - a) emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, adresën e udhërrëfyesit turistik;
 - b) kategorinë e udhërrëfyesit turistik;
 - c) territorin ku do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik, sipas kategorisë përkatëse;
 - ç) gjuhën në të cilën ai do të ushtrojë veprimtarinë si udhërrëfyes turistik;
 - d) datën e lëshimit të certifikatës.
6. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së udhërrëfyesit turistik është 2 vjet nga data e lëshimit, me të drejtë rinovimi.

Neni 58

Dokumenti identifikues i një udhërrëfyesi turistik

1. Një udhërrëfyes turistik i certifikuar do të pajiset me dokument identifikues zyrtar, që tregon se ai është i certifikuar për të vepruar si udhërrëfyes turistik. Dokumenti identifikues i pajisur me të dhënat e përcaktuara në pikën 5, të nenit 57, përgatitet nga struktura përkatëse në ministri dhe i dorëzohet subjektit bashkë me certifikatën.
2. Udhërrëfyesi turistik duhet ta mbajë dokumentin identifikues zyrtar në një vend të dukshëm të veshjes së vet, gjatë gjithë kohës që kryen shërbimet si udhërrëfyes turistik.
3. Nëse dokumenti identifikues i udhërrëfyesit turistik dëmtohet, shkatërrohet ose humbet, ky i fundit duhet të aplikojë pranë strukturës përgjegjëse në ministri për t'u pajisur me një dokument të ri identifikues.
4. Nëse një dokument identifikues i dëmtuar zëvendësohet me një të ri, udhërrëfyesi turistik, me marrjen e dokumentit të ri, duhet të kthejë të vjetrin.
5. Në rastet e pezullimit, heqjes ose pavlefshmërisë së certifikatës së udhërrëfyesit turistik, ky i fundit duhet ta kthejë dokumentin identifikues pranë strukturës përgjegjëse në ministri, brenda 5 ditëve.

Neni 59

Rinovimi i certifikatës së udhërrëfyesit turistik

Rinovimi i certifikatës së udhërrëfyesit turistik bëhet nga ministria përgjegjëse për turizmin, në bazë të sistemit të krediteve të programit për edukimin profesional në vazhdim, të miratuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me institucionet e akredituara prej saj për realizimin e këtij programi.

Neni 60

Edukimi profesional në vazhdim i udhërrëfyesve turistikë

Ministria përgjegjëse për turizmin nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucionet e akredituara prej saj për organizimin e kurseve të vazhdueshme të edukimit profesional dhe të seminareve informuese për udhërrëfyesit turistikë, me qëllim ruajtjen e standardeve të shërbimit të udhërrëfimit turistik, për të përditësuar dhe pasuruar njohuritë e udhërrëfyesit turistik me të dhëna të reja, duke përmirësuar, në mënyrë të vazhdueshme, cilësinë e këtij shërbimi.

Neni 61

Udhërrëfyesi turistik i huaj

1. Udhërrëfyesi turistik i huaj, i cili nuk është i certifikuar në Republikën e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, mund të shoqërojë grupe vizitorësh apo turistësh të huaj, për qëllime turistike, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e shoqëruesit të udhëtimit. Ai duhet të ketë si shoqërues një udhërrëfyes turistik të certifikuar, sipas parashikimeve të këtij ligji, në bazë të një kontrate shërbimi, i cili duhet të jetë prezent gjatë vizitës të grupit të huaj në territorin shqiptar.

2. Në rastin kur një shtetas i huaj do të ushtrojë profesionin e udhërrëfyesit turistik në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç përbushjes së kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 57, të këtij ligji, ai duhet edhe të jetë rezident, për jo më pak se një vit, në Republikën e Shqipërisë dhe të ketë njohuri bazë të gjuhës shqipe.

Neni 62

Udhërrëfyesi turistik i nderit

1. Shkencëtarëve të shquar dhe ekspertëve nga fusha të caktuara si dhe profesionistëve në fushën e udhërrëfyesve, të dalë në pension, mund t'u njihet cilësia e udhërrëfyesit turistik të nderit.

2. Udhërrëfyesi turistik i nderit mund të ushtrojë veprimtarinë e udhërrëfyesit turistik vetëm përkohësisht.

3. Kushtet dhe mënyra e njohjes së udhërrëfyesit turistik të nderit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

KREU X

TRANSPORTI TURISTIK DHE SIPËRMARRJET E TJERA TURISTIKE

Neni 63

Transporti turistik

1. Veprimtaria e transportit turistik ushtrohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që rregullojnë fushën e transportit.

2. Ministri përgjegjës për turizmin, së bashku me ministrin përgjegjës për transportin, përcaktojnë, me udhëzim të përbashkët, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet në fushën e transportit turistik.

Neni 64
Stacionet e plazhit

1. Ushtrimi i veprimtarisë së stacionit të plazhit ushtrohet bazuar në një kontratë përdorimi për hapësirën e plazhit të vënë në dispozicion, të lidhur midis subjektit dhe autoritetit publik kompetent.
2. Rregullorja për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Verifikimi dhe kontrolli i përmbushjes së kriterëve të përcaktuara kryhet nga autoritetet publike kompetente dhe inspektorati që mbulon fushën e turizmit.

KREU XI
STATISTIKAT

Neni 65
Parimet bazë

1. Mbledhja e të dhënave statistikore bëhet në përputhje me parimet e paanshmërisë, të besueshmërisë, transparencës, ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave, bazuar në ligjin nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, sipas metodologjisë së përcaktuar nga autoritetet përgjegjëse për statistikat zyrtare, me qëllim për të studiuar ecurinë e zhvillimit të turizmit në nivel të përgjithshëm kombëtar.
2. Struktura që merret me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga strukturat akomoduese, operatorët apo agjencitë e udhëtimit, është përgjegjëse për ruajtjen e konfidencialitetit të këtyre të dhënave dhe përpunimi dhe komunikimi i tyre bëhet vetëm në linjë vertikale dhe në mënyrë të përgjithshme.

Neni 66
Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore

1. Struktura përgjegjëse për të dhënat statistikore, në ministrinë përgjegjëse për turizmin, siguron të dhëna mujore nga:
 - a) strukturat akomoduese, për numrin e vizitorëve, numrin e netëve të qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën;
 - b) operatorët turistikë apo agjencitë e udhëtimit, për numrin total të vizitorëve për turizmin pritës dhe turizmin në dalje, shtetësinë dhe destinacionin.
2. Të dhënat e raportuara nga subjektet e përmendura, sipas pikës 1, të këtij neni, ruhen nga këto subjekte për një afat trevjeçar.

KREU XII
EDUKIMI NË FUSHËN E TURIZMIT

Neni 67
Objektivat e edukimit në fushën e turizmit

- Ministria përgjegjëse për turizmin nxit edukimin në fushën e turizmit me objektivat e mëposhtëm:
- a) nxitja dhe edukimi i të gjitha shtresave të popullsisë për turizmin si industri, njohjen e historisë, kulturës, bukurive natyrore, traditave fetare, artizanatit dhe vënien e tyre në shërbim të turizmit, duke bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse dhe me institucione të tjera publike e private, që veprojnë në fushat përkatëse;
 - b) rritja e ndërgjegjësimit social për turizmin, krijimi i një mjedisi të hapur e miqësor për turistët dhe zhvillimi i traditës së mikpritjes.

Neni 68

Edukimi, trajnimi dhe puna kërkimore

1. Ministria përgjegjëse për turizmin nxit dhe fuqizon kapacitetet njerëzore të sektorit të turizmit, përmes:

a) përfshirjes në fushata për nxitjen e ndërgjegjësimit në popullatën e gjerë për kontributin e sektorit të turizmit në ekonominë vendase, përfitimet e tjera pozitive dhe mundësitë që sektori ofron për punësimin dhe zhvillimin profesional;

b) përfshirjes së çështjeve të turizmit, si sektor i rëndësishëm ekonomik, në të gjitha ciklet e sistemit arsimor;

c) nxitjes së kurseve të trajnimit profesional në shkolla dhe qendra të formimit profesional për sektorin e turizmit;

ç) dhënies së çmimeve kombëtare të suksesit apo të ekselencës, për shërbimet në fushën e turizmit, sipërmarrjeve turistike apo individëve të veçantë.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për turizmin, akrediton kurset e trajnimit profesional për sektorin e turizmit.

KREU XIII

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 69

Përmbajtja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e turizmit

Bashkëpunimi ndërkombëtar nxitet në fushat e mëposhtme:

- a) studimi bazë, mbrojtja, eksplorimi dhe zhvillimi i burimeve turistike;
- b) zhvillimi i produkteve turistike;
- c) marketimi në fushën e turizmit;
- ç) pjesëmarrja në programe të përbashkëta të organizatave rajonale dhe ndërkombëtare turistike;
- d) zhvillimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve në fushën e turizmit;
- dh) kërkimet shkencore e aplikimet e teknologjisë së përparuar dhe zbatimi në fushën e turizmit;
- e) shkëmbimi i ekspertëve, informacionit dhe përvojës për zhvillimin e turizmit;
- ë) mbrojtja e mjedisit dhe vlerave të trashë-gimisë kulturore dhe natyrore në zonat me përpa-rësi zhvillimin e turizmit, destinacionet turistike;
- f) hartimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar Sektorial për zhvillimin e turizmit.

Neni 70

Marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të turizmit

1. Ministria përgjegjëse për turizmin përfaqëson Shqipërinë në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të turizmit.

2. Shoqatat dhe sipërmarrjet turistike shqiptare kanë të drejtën të aderojnë në shoqatat ndërkombëtare të turizmit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar.

KREU XIV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 71

Rastet e kundërvajtjeve administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

- a) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat dhe kriteret e përcaktuara sipas parashikimeve të nenit 44, dënohet me gjobë 200 000 lekë;
 - b) përdorimi i paautorizuar i shenjave dalluese të klasifikimit, sipas nenit 45, dënohet me gjobë 150 000 lekë;
 - c) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 48, dënohet me gjobë 200 000 lekë;
 - ç) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 51, dënohet me gjobë 200 000 lekë;
 - d) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2, të nenit 53, dënohet me gjobë 50 000 lekë;
 - dh) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 54, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
 - e) ushtrimi i veprimtarisë pa certifikatë, sipas pikës 1, të nenit 57, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
 - ë) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 58, dënohet me gjobë 50 000 lekë;
 - f) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 61, dënohet me gjobë 150 000 lekë;
 - g) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 64, dënohet me gjobë 200 000 lekë;
2. Procedurat e konstatimit, vendosjes, ankimit dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet adminis-trative.
3. Subjektet e gjobitura duhet të paguajnë gjobën brenda 10 ditëve nga data kur vendimi i dënimit me gjobë është bërë titull ekzekutiv.

Neni 72

Ankimi

1. Ankimi administrativ, në lidhje me gjobat, do të bëhet në përputhje me përcaktimet në dispozitat e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.
2. Ankimi administrativ, në lidhje me licencat, do të bëhet në përputhje me përcaktimet në dispozitat e ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 73

Të ardhurat nga vendosja e gjobave

Të ardhurat e krijuara nga vendosja e gjobave derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

KREU XV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 74

Dispozita kalimtare

1. Sipërmarrjet turistike, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si struktura akomoduese dhe që e kanë filluar veprimtarinë e tyre para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të aplikojnë për marrjen e certifikatës brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, të cilët kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë së tyre para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet:

a) të aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit për pajisjen me licencë brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) përveç sa është parashikuar në pikën 3, të nenit 48, dhe në pikën 3, të nenit 51, sipërmarrja turistike, që ushtron veprimtarinë si agjenci udhëtimi dhe operator turistik, duhet të plotësojë dhe kriteret e mëposhtme:

i) të mos jetë në proces falimentimi;

ii) të mos jetë në proces likuidimi.

3. Masa dhe mënyra e përdorimit të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 75

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 12; të pikës 3, të nenit 16; të pikave 5, 7 e 8, të nenit 31; të pikës 4, të nenit 35; të pikës 2, të nenit 36; të pikës 2, të nenit 40; të nenit 44; të pikës 5, të nenit 45; të pikës 3, të nenit 48; të pikës 3, të nenit 51; të pikës 2, të nenit 57 dhe të pikës 2, të nenit 64.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për turizmin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 9; pikës 2, të nenit 10; të pikës 2, të nenit 11; të pikës 4, të nenit 17; të pikave 2 e 3, të nenit 18; të pikës 4, të nenit 20; të pikës 2, të nenit 32; të pikës 1, të nenit 53; të pikës 3, të nenit 62 dhe të pikës 2 të nenit 63.

Neni 76

Shfuqizime

Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007, “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 77

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ilir Meta

Miraturar në datën 27.7.2015

KAPITULLI VI
SIGURIA PUBLIKE

LIGJ
Nr.9780, datë 16.7.2007

PËR INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E KUNDËRLIGJSHME³³

(ndryshuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010, nr.10 323, datë 23.9.2010; nr. 23/2013, datë 14.2.2013; nr.183/2014, datë 24.12.2014)

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit e burimeve ujore në të gjithë vendin, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Neni 2

Objekti

(Ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe i përgjegjësisë të tyre.

Neni 3

Organizimi i inspektimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:

- a) inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse.
- b) Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

³³ Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.95, datë 27 korrik 2005.
Ligji nr. 10 240, datë 25.2.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 23 mars 2010.
Ligji nr.10 323, datë 23.9.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.136, datë 13 tetor 2010.
Ligji nr. 23/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.29, datë 11 mars 2013.
Ligji nr.183/2014, datë 24.12.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.214, datë 21 janar 2014.

Neni 4

Përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore

(shtuar një paragraf me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse.

Për përmbushjen e përgjegjësiave të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore.

Neni 5

Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore

(ndryshuar shkronja “e” dhe shtuar shkronja “e” me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010; shtuar një paragraf me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Gjatë ushtrimit të përgjegjësiave të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati;

) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;

f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni.

Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit.

Neni 6

Bashkëpunimi dhe delegimi i përgjegjësive dhe detyrave për inspektimin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës

(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 7

Inspektorati ndërtimor e urbanistik i qarkut

(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 8

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

(Ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion buxhetor, publik, me statusin e personit juridik, i specializuar në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në varësi të ministrisë përgjegjëse për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve.

2. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve.

3. Struktura dhe organika e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit mirtohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve.

4. Punonjësit e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit gëzojnë të drejtën e pajisjes me armë dhe të përdorimit të tyre sipas legjislacionit përkatës.

5. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe shenjat dalluese të veçanta të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8/1

Marrëdhëniet e ministrit me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

(Shtuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Ministri është autoriteti, i cili:

a) informohet për të gjithë veprimtarinë e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, dhe i kërkon kryeinspektorit të raportojë për ushtrimin e përgjegjësive dhe përmbushjen e detyrave të tij e të inspektorëve në varësi të tij, si dhe të inspektorateve vendore, në përgjithësi, nëpërmjet të dhënave statistikore, ose në lidhje me ndonjë çështje të veçantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) kërkon performancë të lartë të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për realizimin e objektivave të përcaktuar;

c) vlerëson dhe merr masat përkatëse brenda fushës së tij të përgjegjësisë, për ankesat e subjekteve të interesuara, ndaj kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Neni 9

Përgjegjësitë e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

(shtuar shkronja "db" me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

a) ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor;

Zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare dhe në territor, në kuptim të këtij ligji, janë zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, pyjet dhe zonat e mbrojtura natyrore, monumentet natyrore, përfshirë zonat me karakteristika unike gjeografike, zonat me rrezik natyror, rrjetet ekologjike, burimet minerare e natyrore dhe rrjetet, komplekset dhe parqet industriale, rrugët kombëtare, linjat hekurudhore dhe infrastruktura ndihmëse, instalimet e infrastrukturës kombëtare, sektori i energjisë dhe komunikimit elektronik, aeroportet, portet e rrugët detare, zhvillimet në zonat ushtarake, vija bregdetare, brigjet dhe burimet ujore, lagunat, lumenjtë, liqenet, digat e dambat, tokat bujqësore, spitalet publike, objektet dhe terrenet sportive, si dhe ato të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit e me akte nënligjore ose ligje të tjera;

b) kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë në nivel të qeverisjes vendore;

c) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe merr masat përkatëse, sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

ç) kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

d) kontrollon përmbushjen e kërkesave ligjore për shfrytëzimin e karrierave të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit dhe merr masat përkatëse sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi;

dh) ushtron përgjegjësitë e parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Neni 9/1

(Shtuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë që:

a) të ushtrojë përgjegjësitë e veta të njësisë vendore, sipas nenit 5, të këtij ligji, për ndërtime/punime të kundërligjshme në territorin e njësisë vendore, që nuk përfshihen në çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor;

b) të ushtrojë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj lejes së ndërtimit, të miratuar në kundërshtim me ligjin dhe/ose dokumentet e planifikimit në fuqi.

2. Përgjegjësia, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, ushtrohet kur:

a) kërkohet nga vetë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore ose nga kryetari përkatës i saj, për shkak të pamundësisë financiare për ushtrimin e kësaj përgjegjësie nga inspektorati vendor;

b) inspektorati vendor nuk e ka inspektuar këtë territor më parë ose nuk është shprehur me vendim për ligjshmërinë ose jo të ndërtimit/punimit, në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore;

c) vendimi i inspektoratit vendor për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar brenda afatit ligjor të caktuar në këtë ligj.

3. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, gjatë ushtrimit të kësaj detyre, për të provuar kundërligjshmërinë e ndërtimit, kryen inspektim në ndërtimin/punimin, objekt inspektimi, sipas nenit 12, të këtij ligji, dhe në rast se në përfundim të inspektimit konstaton se ndërtimi është i kundërligjshëm, vepron sipas nenit 13 të këtij ligji.

4. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për ushtrimin e përgjegjësisë sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, bashkërendon punën me autoritetet përgjegjëse përkatëse të planifikimit të territorit në nivel qendror.

Neni 9/2

(Shtuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka përgjegjësi ekskluzive, në përputhje me këtë ligj, për ndërtimet e kundërligjshme, të përhershme apo të përkohshme, të ngritura mbi sipërfaqen ujore, përkatësisht mbi shtratin e lumenjve, liqeneve dhe deteve, pavarësisht nëse kanë ose jo pikë lidhjeje me bregun e lumit, liqenit ose detit. Në rastet kur inspektorati i mbrojtjes së territorit në nivel vendor konstaton ekzistencën e ndërtimeve të tilla ia përcjell çështjen për kompetencë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

2. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit kryen inspektimin, sipas pikës 1, të këtij neni, në njërën nga format e mëposhtme:

a) periodik, të pakën 1 herë në vit, në çdo mjedis të vënë në dispozicion të të tretëve nga shteti shqiptar, në bazë të marrëveshjeve koncesionare shtetërore;

b) brenda 15 ditëve pune, kur autoriteti kontraktor ose organi shtetëror i autorizuar, sipas rastit, depoziton një kërkesë me shkrim për rikthimin e ligjshmërisë së mjediseve të dhëna me koncesion shtetëror;

c) brenda 15 ditëve pune, kur administrata detare njofton se në mjediset ujore të porteve të shpallura kryhen ndërtime/punime pa lejen përkatëse ose në kundërshtim me parashikimet e bëra në to;

ç) me kërkesë me shkrim të kryetarit të njësisë vendore.

Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, përfshijnë edhe rastet e koncesioneve për ndërtime digash, hidrocentralesh dhe hidrovoresh.

3. Ministritë e linjës depozitojnë në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e marrëveshjes koncesionare, kopje të plota të këtyre marrëveshjeve dhe përcaktime konkrete të mjediseve, në kuptim të pikës 1, të këtij neni, ku parashikohet të operojë koncesionari.

4. Në përfundim të çdo inspektimi, sipas pikës 2, të këtij neni, kopja e plotë e procesverbalit dhe/ose vendimit përkatës i dërgohet, për dijeni, autoritetit kontraktor ose organit shtetëror të autorizuar, sipas rastit, për inspektime, në përputhje me shkronjën “a” dhe çdo kërkuar për inspektime, në përputhje me shkronjat “b”, “c” ose “ç”, të pikës 2, të këtij neni.

Neni 10

Detyrat e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar

(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 10/1

(shtuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010; ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010; shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 10/2

(shtuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010; shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 10/3

(shtuar me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010; shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 11

Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit

(Ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit,

arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

Neni 12

Ushtrimi i kontrollit

(shfuqizuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore.

2. Kryeinspektorët/inspektorët kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet ndërtimi.

3. Kryeinspektori/inspektori duhet të identifikohet me dokument zyrtar.

4. Subjekti që kontrollohet (sipas rastit, investitori, zhvilluesi, ndërtuesi, projektuesi, zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi, kolaudatori, prodhuesi i materialeve të ndërtimit etj.) dhe të gjithë personat e tjerë të përfshirë në procesin e punimit/ndërtimit janë të detyruar të lejojnë kryerjen e kontrollit, të vënë në dispozicion të grupit të kontrollit të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga aktet normative në fuqi, si dhe të ndihmojnë në shqyrtimin e tij.

5. Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës të konstatimit dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

6. Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i jepet një kopje e procesverbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit.

7. Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 5 ditë në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit.

8. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kanë të drejtë:

a) të kërkojnë zbatimin e objektit në terren, sipas lejes së ndërtimit të dhënë nga autoriteti përkatës i planifikimit, si dhe të kontrollojnë dosjen me dokumentacionin teknik e ligjor të objektit;

b) të kryejnë një apo më shumë kontrole në të njëjtin objekt, sipas problematikave teknike e ligjore të objektit, që ndërtohet;

c) të përfshijnë në kontrollin e tij prishjen e një ndërtimi ekzistues, ndërtimin apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe punimet/ndërtimet, që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve.

9. Kryeinspektori/inspektorët e IKMT-së, gjatë ushtrimit të kontrollit të parashikuar, sipas këtij neni, në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësive të parashikuara në këtë ligj, nuk janë të detyruar të kryejnë asnjë lloj njoftimi paraprak pranë inspektoratit përkatës të njësisë vendore dhe/apo organit përkatës të planifikimit.

10. Pavarësisht sa më sipër, kryeinspektori/inspektorët e IKMT-së, gjatë ushtrimit të kontrollit të parashikuar, sipas këtij neni, kanë të drejtë që, krahas verifikimit në vend të situatës ndërtimore, të inspektojnë, të kërkojnë dhe të kryejnë të gjitha verifikimet e nevojshme pranë autoritetit përkatës të planifikimit, të cilët janë të detyruar të krijojnë të gjitha lehtësitë për verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe të japin të gjitha shpjegimet përkatëse dhe

çdo dokume-ntacion të kërkuar. Në rast se në përfundim të inspektimit, sipas kësaj pike, konstatohen shkelje, kryeinspektori/inspektorët e IKMT-së marrin masat përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Neni 13

Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet

(shfuqizuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori.

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim merret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit.

Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë.

Një vendim i tillë merret në rastet kur:

a) subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit, që ka të bëjë, sipas rastit, me projektimin, mbikëqyrjen, zbatimin dhe/ose kolaudimin e punimeve të ndërtimit;

b) mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;

c) plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;

ç) vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim shoqërohet me vendimin për dënim me gjobë, sipas parashikimeve ligjore, si dhe, kur është rasti, me kallëzimin penal apo kërkesën për heqje të licencës subjektit kundërvajtës.

Gjatë periudhës së pezullimit të punimeve në ndërtim, subjekti ndërtues është i detyruar të ndërpresë punimet në objekt dhe inspektorati vendor përkatës është përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi. Në rastet kur vendimi merret nga IKMT-ja, ky i dërgon, brenda 5 ditëve, vendimin e pezullimit inspektoratit vendor, i cili e zbaton atë brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore marrin vendimin për shkeljen e konstatuar brenda afatit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 14

Ankimi gjyqësor

(ndryshuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit.

Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Në rast se, në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar.

Neni 15

Kundërvajtjet administrative të kryeinspektorëve/inspektorëve dhe gjobat

(shtuar pika 7 me ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010; ndryshuar pika 7 dhe shtuar pika 8 ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 323, datë 23.9.2010; ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Veprimet ose mosveprimet e kryeinspektorëve/inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore dhe të inspektorëve të IKMT-së, që janë në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të këtij ligji dhe të legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale ose jo, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Mosushtrimi i funksionit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në masën 300 000 lekë.

2. Shtrembërimi i rezultateve të kontrollit në fushën e ndërtimit, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, të prodhimit dhe hedhjes në treg të produkteve të ndërtimit dhe kontrollit e disiplinimeve të punimeve në ndërtim, në masën 400 000 lekë.

3. Mosrespektimi i afateve për marrjen e vendimeve të parashikuara në këtë ligj, përfshirë dhe ato për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm, në masën 200 000 lekë.

4. Mosrespektimi i afateve të zbatimit të vendimeve të parashikuara në këtë ligj, përfshirë dhe ato për prishje të ndërtimit të kundërligjshëm, në masën 300 000 lekë.

5. Moszbatimi i vendimit të pezullimit të punimeve në ndërtim brenda afatit të parashikuar në këtë ligj, në masën 150 000 lekë.

6. Mosrespektimi i afatit për dhënien e informacionit dhe pengimi në përmbushjen e detyrave, në masën 100 000 lekë.

7. Mosparaqitja e kërkesës për heqje licence të mbikëqyrësit të punimeve, pranë organeve kompetente, në masën 500 000 lekë.

Gjoha vendoset me vendim të kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe përbën titull ekzekutiv.

Neni 16

Unifikimi i praktikave

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Këshilli i Ministrave merr vendim për unifikimin e praktikave të inspektimit të mbrojtjes së territorit nga inspektoratet e mbrojtjes së territorit në ushtrimin e kompetencave të tyre.

Neni 17

Dispozitë kalimtare për Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

1. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar transformohet në Inspektorat Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Struktura e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit miratohet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Deri në daljen e urdhrat për strukturën, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit do të funksionojë sipas strukturës ekzistuese.

4. Praktikë dokumentare administrative, të cilat janë në shqyrtim nga INUK-u, i kalojnë për administrim e ndjekje në vazhdim të tyre nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

Neni 18

Krijimi i inspektorateve ndërtimore e urbanistike të njësive vendore

(shfuqizuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Neni 19

Shfuqizime

Ligji nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, i ndryshuar dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohen.

Neni 20

Shfuqizime

(ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, vendimi nr. 862, datë 5.12.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai vendor”, i ndryshuar, shfuqizohet.

DISPOZITË E PARASHIKUAR ME LIGJIN NR. 10 240, DATË 25.2.2010

1. Autoritetet kontraktore/organi shtetëror i autorizuar, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas rastit, depozitojnë pranë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar kopje të plota të marrëveshjeve koncesionare në fuqi, ku parashikohen të kryhen ose janë kryer ndërtime në mjedise, sipas nenit 10/2 të këtij ligji dhe, kur i disponojnë në dosje, edhe lejet përkatëse, të dhëna për këtë qëllim nga organet përgjegjëse.

2. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bazë të të dhënave që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni e të materialeve arkivore që administron, krijon regjistrin e të dhënave për ndërtimet e kryera ose eventuale në mjedisin e caktuar, sipas nenit 10/2 të këtij ligji, në të cilin do të kryejë përditësime pas çdo inspektimi, si dhe ka detyrim për mirëmbajtjen e tij.

Dispozitë kalimtare

(e parashikuar me ligjin nr. 23/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5423, datë 23.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr.8756, datë 26.3.2001

PËR EMERGJENCAT CIVILE³⁴
(Ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 170 dhe 174 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI :

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Planizimi dhe përballimi i emergjencave civile janë detyra të shtetit shqiptar që synon:

a) parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile;

b) sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile;

c) garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Emergjencë civile” kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

2. “Emergjencë civile kombëtare” kuptohet një situatë kritike urgjente e një natyre të përkohshme, që dëmton seriozisht jetën, shëndetin dhe sigurinë e shtetasve të Republikës së Shqipërisë, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë e natyrë të tillë që kalon mundësinë ose autoritetin e organeve të qeverisjes vendore për ta përballuar atë, ose kërcënon seriozisht mundësinë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të ruajtur sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të vendit.

3. “Fatkeqësi natyrore” kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësitrat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortelet, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.

³⁴ Ligji nr.8756, datë 26.3.2001 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 15, datë 16 prill 2001.

Ligji nr. 10 137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.86, datë 12 qershor 2009.

4. “Fatkeqësi të tjera” kuptohen aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimi njerëzor, nga luftërat ose gjendjet e emergjencës, si dhe format e tjera të dhunës masive.

5. “Fatkeqësi” kuptohet një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera të parashikuara në këtë ligj, të cilat kërcënojnë ose dëmtojnë jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë të tillë, që kërkojnë marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve të veçanta njerëzore e materiale-teknike.

6. “Masa mbrojtëse” kuptohen masat organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, kundër pasojave të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

7. “Operacion ndërhyrjeje” kuptohen veprimet e forcave dhe të mjeteve, për shpëtimin e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale (pronës) në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.

8. “Parandalim” kuptohet një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shamgien ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja.

9. “Parashikim” kuptohen veprimtaritë që kryen për studimin dhe përcaktimin e shkaqeve të emergjencave, për përcaktimin e zonave, të territoreve dhe objekteve nga rreziqet e njëjta.

10. “Planizim e përballim të emergjencave civile” kuptohet përgatitja e autoriteteve publike, e institucioneve dhe organeve të qeverisjes qendrore e vendore, e personave juridikë, publikë ose privatë, e organizatave publike dhe e popullatës për një emergjencë civile, si dhe për rastet e një fatkeqësie natyrore, duke përcaktuar marrjen e masave për parandalimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga veprimi i rrethanave emergjente.

11. “Riaftësim” kuptohen masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme në rajonin (territorin) e prekur nga fatkeqësia.

12. “Rrezik” kuptohet një gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

13. “Shërbim të emergjencave civile” kuptohet shërbimi i bashkërenduar i Policisë së Shtetit dhe të gjitha policive të tjera, shërbimi i shpëtimit dhe i mbrojtjes nga zjarri dhe i urgjencës mjekësore.

14. “Vlerësim rreziku” kuptohet analiza sasiore e cilësore e natyrës dhe e rrethanave të tjera për ndodhinë e pritshme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Organet shtetërore, të përcaktuara në këtë ligj, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësia.

2. Organet shtetërore kanë të drejtë të përdorin çdo mjet publik ose privat, si dhe të bashkëpunojnë me organizata vullnetare që kanë rol të përcaktuar në situatat emergjente, për të shmangur ose për të reduktuar pasojat që shkaktohen nga fatkeqësitë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për aq kohë sa vepron rrethana që i ka shkaktuar ato pasoja.

3. Strukturat e ngritura për planizimin dhe për përballimin e emergjencave civile funksionojnë si të tilla edhe në rastet kur me ligj shpallet gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e luftës ose gjendja e fatkeqësisë natyrore, duke pasur si qëllim kryesor marrjen e masave për parandalimin dhe riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e luftës ose gjendja e fatkeqësisë natyrore.

4. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me mundësitë e tij reale, ka për detyrë të ndihmojë në parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave që shkaktohen nga fatkeqësitë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

5. Asnjë organ, i përcaktuar në këtë ligj, nuk mund të ushtrojë përgjegjësi që nuk janë në sferën e veprimtarisë së tij.

6. Organet që, sipas këtij ligji, ngrihen për situata emergjente, janë fuqiplote, brenda përgjegjësi dhe hierarkisë së tyre dhe veprojnë edhe pas kapërcimit të situatave emergjente, siç përcaktohet në pikat 1 dhe 2 të nenit 174 të Kushtetutës.

7. Organet, që sipas këtij ligji kanë natyrë operative, funksionojnë në mënyrë të përhershme dhe kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë ligj për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes dhe për riaftësimin e pasojave nga fatkeqësitë.

8. Aktet e organeve më të larta janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga organet më të ulta dhe nga çdo person fizik ose juridik. Ato marrin fuqi juridike në çastin e nxjerrjes së tyre. Organet që i nxjerrin këto akte detyrohen t'i vënë ato menjëherë në dispozicion të zbatuesve.

Neni 4

Llojet e strukturave

Për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile krijohen struktura mbi baza të përkohshme dhe të përhershme në nivel qendror dhe vendor.

KREU II

STRUKTURAT E PLANIZIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË NIVEL QENDROR

Neni 5

Këshilli i Ministrave

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij për këtë qëllim, Këshilli i Ministrave kryen këto detyra:

a) Miraton politikën dhe programet për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

b) Miraton programin kombëtar dhe krijon kushte për arsimimin, trajnimin, planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

c) Vendosi për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes ose riaftësimin e pasojave të situatave të emergjencës civile.

ç) Informon Presidentin dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për emergjencën civile, për pasojat që vijnë, si dhe për masat e marra për shmangien e saj.

d) Kërkon pëlqimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.

dh) Vlerëson nivelin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, në bashkëpunim me specialistët e organeve përgjegjëse, si dhe asistencën për riaftësim.

e) Përcakton, në bashkëpunim me donatorët e huaj, procedurat për asistencën ndërkombëtare në rastet e emergjencave civile, në përputhje me konventën përkatëse ndërkombëtare të nënshkruar nga Qeveria Shqiptare.

ë) Planifikon fonde për mjete e pajisje rezervë të shtetit për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Neni 6

Komiteti Ndërmintor i Emergencave Civile

1. Për çdo rast të një emergjence civile kombëtare, sipas qëllimit dhe objektit të këtij ligji, pranë Këshillit të Ministrave krijohet Komiteti Ndërmintor i Emergencave Civile.
2. Këshilli i Ministrave përcakton kryetarin e këtij Komiteti dhe përbërjen e tij.
3. Komiteti Ndërmintor qëndron i mbledhur deri në shuarjen e shkaqeve që kanë çuar në emergjencë.
4. Komiteti Ndërmintor mund të thërrasë specialistë për këshillime në emergjencë.

Neni 7

Detyrat e Komitetit Ndërmintor të Emergencave Civile

Komiteti Ndërmintor i Emergencave Civile kryen këto detyra:

- a) Bashkërendon veprimet e forcave të shërbimit të emergjencave civile.
- b) Bashkërendon menaxhimin e rezervave shtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre.
- c) Përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare në rast emergjence.
- ç) Diskuton dhe vendos paraprakisht për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
- d) Vlerëson rindërtimin dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, si dhe për të parandaluar dëmet e mundshme në të ardhmen dhe në sigurimin e kushteve bazë të jetesës.
- dh) Në rastet e një emergjence civile kombëtare cakton drejtuesin e operacionit për menaxhimin e saj.
- e) Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe detyra të veçanta, të caktuara nga Këshilli i Ministrave për përballimin e emergjencës civile.

Neni 8

Ministria e Pushtetit Vendor

1. Ministria e Pushtetit Vendor është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.
2. Ministria e Pushtetit Vendor kryen këto detyra:
 - a) Zbaton së bashku me institucionet e tjera politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.
 - b) Bashkërendon veprimet e të gjitha palëve në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile për përmbushjen e detyrave që u përkasin atyre dhe bashkërendon punët me organet e qeverisjes vendore për përballimin e emergjencave civile.
 - c) Organizon marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillimin dhe zbatimin e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.
 - ç) Menaxhon sistemin e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.
 - d) Zhvillon strategjitë e programeve të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe i paraqet ato për miratim në Këshillin e Ministrave.
 - dh) Përpunon zbatimin e programeve të arsimit dhe të trajnimit në fushën e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.
 - e) Në bashkëpunim me ministritë, institucionet dhe entet e ndryshme të vendit bën vlerësimin e rrezeve mbi të cilat bazohet plani kombëtar i emergjencave civile dhe e paraqet atë për miratim në Këshillin e Ministrave.

ë) Merr masa për sensibilizimin e opinionit publik dhe për ndërgjegjësimin e tij rreth emergjencave civile dhe planifikon fonde për studime nga institucionet publike për përballimin e emergjencave civile.

f) Lidh marrëveshje me shoqata dhe organizata që ofrojnë asistencën e tyre në realizimin e detyrave në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

g) Njofton në çdo gjashtë muaj Këshillin e Ministrave për gjendjen e përgjithshme të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.

gj) I siguron Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile të gjitha të dhënat e nevojshme për situatat emergjente dhe për rreziqet që ato përfaqësojnë.

h) Ndjek punën për krijimin dhe përdorimin e rezervave shtetërore të vëna në dispozicion nga strukturat e rezervave të shtetit, për situatat e emergjencës civile.

i) Përcakton rregullat e përdorimit të burimeve materiale e financiare në rastet e emergjencës civile.

j) Bashkërendon organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e emergjencës civile.

k) Organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencës civile.

l) Bashkërendon punën për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.

ll) Kontrollon zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese në rastet e emergjencave civile.

m) Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe nga ligje të tjera.

Neni 9

Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile

1. Në Ministrinë e Pushtetit Vendor krijohet dhe funksionon Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.

2. Departamenti ka për detyrë përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile.

3. Departamenti bën inspektim të vazhdueshëm për zbatimin e masave mbrojtëse kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

4. Struktura, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10

Komisioni Teknik Këshillimor i specialistëve

1. Pranë Departamentit Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile krijohet Komisioni Teknik Këshillimor me specialistë nga ministritë, institucionet, entet e ndryshme dhe forcat operationale.

2. Komisioni Këshillimor thirret dhe kryesohet nga Drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile.

3. Komisioni kryen bashkërendimin e veprimeve në fushën e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile ndërmjet autoriteteve të ndryshme dhe organizatave vullnetare.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor, përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni.

5. Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile mban regjistër për specialistët që mund të thërrasë për këshillime.

Neni 11
Ministritë

1. Çdo ministër është përgjegjës për organizimin e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në veprimtarinë që ka në përgjegjësi.

2. Ministritë kryejnë këto detyra:

a) Hartojnë planet për përgatitjen për emergjencë civile sipas llojit të veprimtarisë dhe të përgjegjësisë të tyre dhe i paraqesin këto në Ministrinë e Pushtetit Vendor për bashkërendim.

b) Zbatojnë planet dhe përcaktojnë masat për parandalimin e fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe të pasojave nga fatkeqësi të tilla në fushën e përgjegjësisë së tyre.

c) Organizojnë trajnimin dhe arsimimin në fushën e veprimtarisë së tyre, në bashkërendim dhe këshillim me Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile.

ç) Analizojnë gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në fushën e përgjegjësisë së tyre dhe njoftojnë Departamentin e Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.

Neni 12
Entet e ndryshme publike

1. Entet e ndryshme publike, kur u kërkohet nga Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, kryejnë studime të cilat përfshijnë parashikimin, parandalimin dhe shmangien e pasojave të fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe ia paraqesin këto studime këtij Departamenti.

2. Entet publike paraqesin te ky Departament edhe rezultatet e studimeve që mund të jenë me interes për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në përgjithësi.

3. Mënyra e planifikimit dhe e përballimit të kostos përkatëse përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III
STRUKTURAT E PLANIZIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE
CIVILE NË NIVEL QARKU, BASHKIE DHE KOMUNE

Neni 13
Prefekti

1. Prefekti është përgjegjës për planizimin e emergjencave civile në qarkun përkatës.

2. Prefekti ka për detyrë:

a) të organizojë dhe të bashkërendojë punën për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;

b) të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe komunat për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile;

c) të ndjekë dhe të kërkojë nga organet vartëse skemat e lajmërimit dhe të funksionimit të tyre;

ç) të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare, për sistemimin e popullsisë në raste emergjence nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;

d) të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operationale;

dh) të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;

e) të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyre ose nga fatkeqësitë e tjera;

ë) të analizojë gjendjen e planizimit të emergjencave civile dhe të njoftojë Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile për emergjencat civile që ndodhin në qark;

f) të paraqesë kërkesë për ndihmë në qarqet fqinjë dhe në instancat qendrore nëse është e nevojshme.

g) të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut të tij.

Neni 14

Organizimi në qark

1. Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit, ngrihet një komision i qarkut me detyrë bashkërendimin e veprimtarive të autoriteteve të qarkut dhe të organizatave vullnetare.

2. Ministri i Pushtetit Vendor përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij komisioni.

3. Prefekti mban regjistër për specialistët në qark, me të cilët ai këshillohet kur gjykohet e nevojshme.

Neni 15

Shërbimi i emergjencës civile

1. Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit, funksionon shërbimi i emergjencës civile, si pjesë përbërëse e sistemit të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile, në përputhje me përcaktimin e pikës 13 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Rregullat, mënyra e funksionimit, të drejtat dhe detyrat, si dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencës civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 16

Organizimi në bashki dhe në komunë

1. Kryetari i bashkisë ose kryetari i komunës është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në bashkinë dhe në komunën përkatëse.

2. Kryetari i bashkisë ose kryetari i komunës ka për detyrë:

a) të drejtojë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashkinë dhe në komunën përkatëse dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;

b) të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë dhe komunës për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile;

c) të organizojë sistemin e lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit;

ç) të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme për sistemin e popullatës në raste të emergjencës nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera;

d) të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale;

dh) të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;

e) të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;

ë) të paraqesë kërkesë për ndihmë në bashkitë dhe komunat fqinje e në qark, nëse është e nevojshme;

f) të analizojë gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencës civile në bashki dhe komunë dhe të njoftojë në qark.

g) të zbatojë detyrat e caktuara nga strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror;

gj) të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile në territorin e bashkisë ose të komunës.

Neni 17

Komisioni vendor për emergjencat civile pranë bashkisë ose komunës

1. Në çdo bashki ose komunë, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë ose të komunës, krijohet komisioni vendor për emergjencat civile me detyrë bashkërendimin e veprimeve të autoriteteve të bashkisë ose komunës dhe organizatave vullnetare për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e vet.

2. Ministri i Pushtetit Vendor përcakton kriteret për përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij komisioni.

3. Kryetari i bashkisë ose i komunës mban regjistër për specialistët në territorin e bashkisë ose komunës, me të cilin këshillohet kur është e nevojshme.

KREU IV

FORCAT E NDËRRHYRJES

Neni 18

Strukturat operative të emergjencës civile

Organizimi i planizimit dhe i përballimit të emergjencave civile përfshin Shërbimin e Emergjencave Civile, Bazën e Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, lloje të tjera të policisë së krijuara me ligj në varësi të emergjencës civile dhe organe të tjera të paparashikuara në këtë ligj, por që përfshihen në planet e emergjencave civile.

Neni 19

Baza e Mbrojtjes Civile

Në nivel kombëtar funksionon Baza e Mbrojtjes Civile si strukturë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo përdoret për shpëtimitet e posaçme dhe operacionet e tjera urgjente si përforcim dhe për të siguruar një përgjigje të menjëhershme në emergjencat civile.

Neni 20

Përdorimi i Forcave të Armatosura për emergjencat civile

1. Kur shtrirja e një emergjence civile rritet në mënyrë të menjëhershme në ndihmë të operacioneve të shpëtimit dhe të lehtësimit në zonën e fatkeqësisë, me miratim të Kryeministrit ose të Ministrit të Mbrojtjes, mund të përdoren njësi të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas planeve të hartuara më parë në bashkëveprim me komandantët e tyre.

2. Kur njësitë e Forcave të Armatosura marrin pjesë në operacione, ato drejtohen nga komandantët e tyre sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.

Neni 21

Policia e Shtetit

1. Policia e Shtetit organizohet dhe kryen detyrat e saj në operacionet e shpëtimit dhe të lehtësimit sipas planeve të hartuara më parë.

2. Detyrat e saj përfshijnë mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe të vdekurve, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

3. Kur policia merr pjesë në operacionet e shpëtimit, forcat e saj komandohen nga eprorët e tyre, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.

Neni 22

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi është pjesë përbërëse e forcave operacionale në gatishmëri të përhershme dhe vepron për shuarjen e zjarreve, për kërkimin dhe shpëtimin e njerëzve në zonat e emergjencës civile dhe për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 23

Shërbimi i ambulancës

Shërbimi i ambulancës është pjesë përbërëse e forcave operacionale dhe vepron për dhënien e ndihmës së parë në zonën e emergjencës civile dhe për transportimin e të dëmtuarve për në qendrat spitalore.

Neni 24

Shërbimi vullnetar

1. Për përballimin e emergjencave civile organizohen dhe veprojnë shërbimet vullnetare.
2. Vullnetar mund të jetë çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, që ka kryer arsimin dhe trajnimin bazë në përgjigje të situatave të emergjencës ose pranon të marrë pjesë vullnetarisht për përballimin e emergjencës civile.
3. Për përballimin e emergjencave civile pranohen vullnetarë edhe shtetas të huaj.
4. Personat që vullnetarisht kërkojnë të marrin pjesë në operacionet e shpëtimit kanë këto të drejta:
 - a) Ruhet vendi i punës.
 - b) Marrin pagesën e plotë nga punëdhënësi, qoftë ky edhe subjekt privat.
 - c) Në rast aksidenti ose humbjeje jete gjatë veprimtarisë në emergjencat civile përfitojnë pension invaliditeti, sipas dispozitave në fuqi.

Neni 25

Bashkërendimi i ndihmave

Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile bashkërendon ndihmat nga organizatat ndërkombëtare, nga organizatat joqeveritare dhe nga organizatat private vullnetare vendase dhe të huaja për përballimin e emergjencave civile.

KREU V

SUBJEKTET QË PËRFSHIHEN NË PLANIZIMIN DHE PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Neni 26

Detyrimi i shtetasve

1. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e Kushtetutës, detyrohet të marrë pjesë në përballimin e emergjencave civile sipas një kërkesë të Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, të prefektit, të kryetarit të bashkisë ose të kryetarit të komunës.
2. Detyrimi për të marrë pjesë në përballimin e emergjencave civile fillon në moshën 18 vjeç dhe përfundon në moshën 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë.

Neni 27

Përrjashtim nga detyrimi

Përrjashtohen nga detyrimi për të marrë pjesë në operacionet e ndërhyrjes së emergjencave civile shtetasit:

- a) që për arsye shëndetësore nuk mund të kryejnë detyrat e operacioneve të ndërhyrjes;
- b) gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë me moshë deri në 10 vjeç;
- c) prindër të vetëm me një fëmijë nën 10 vjeç.

Neni 28

Të drejtat e shtetasve

Shtetasit që shërbejnë në përballimin e emergjencave civile, për një kohë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se sa periudha e situatës emergjente, gëzojnë të drejtat e parashikuara në nenin 24.

Neni 29

Personat fizikë dhe juridikë

1. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët në veprimtarinë e tyre përdorin, prodhojnë, transportojnë ose magazinonë substanca të rrezikshme, detyrohen të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën e tyre të veprimtarisë.

2. Personat fizikë dhe juridikë kanë për detyrë:

- a) të hartojnë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojnë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë;
- b) të njoftojnë personelin si dhe autoritetet e bashkisë ose të komunës për një rrezik imediat;
- c) të organizojnë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre, dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjente në zonën e tyre të veprimtarisë;
- ç) të sigurojnë trajnimin për të punësuarit.

3. Këshilli i Ministrave përcakton me akt nënligjor substancat që përbëjnë rrezikshmëri për krijimin e situatave emergjente.

Neni 29/1

(Shtuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e ekspertizës dhe/ose profesionale, parandaluese a ndërhyrëse, në fushën e mbrojtjes civile, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë I.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen sipas ligjit të licencave.

Neni 30

Detyrime të tjera

1. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile, prefektët dhe kryetarët e bashkive e të komunave planifikojnë dhe zbatojnë detyra për ngritjen e kulturës qytetare në përballimin e emergjencave civile.

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton dhe miraton programet përkatëse për edukimin me elementet bazë të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile.

3. Ky program fillon në arsimin 8-vjeçar dhe vazhdon deri në përfundimin e arsimit të lartë.

KREU VI FINANCIMI

Neni 31

Buxheti i shtetit

1. Buxheti i Shtetit është burimi parësor financiar për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.
2. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Pushtetit Vendor, si dhe të çdo ministrie parashikohet, zë më vete, buxheti për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Neni 32

Burime të tjera

Burime të tjera financimi mund të jenë:

- a) Buxheti i Shtetit i planifikuar për Këshillin e Ministrave;
 - b) të ardhurat e pushtetit vendor;
 - c) të ardhurat e krijuara nga shërbimi për të tretët të cilat kalojnë tërësisht në buxhetin e tyre;
 - ç) donatorë të ndryshëm;
- burime të tjera që i lejon ligji;

KREU VII SANKSIONE

Neni 33

Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj

1. Mosrespektimi i detyrimeve që përcakton ky ligj, nga personat juridikë e fizikë, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 500 000 lekë nga strukturat operative të emergjencës civile, të cilat do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Mosrespektimi i detyrimeve që përcakton ky ligj nga ana e individëve, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 25 000 lekë.

Neni 34

E drejta për ankim

Subjekti i gjobitur mund të ankohet dhe të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit që e dënon atë me gjobë, duke respektuar kërkesat Kodit të Procedurave Administrative përsa i përket të drejtës dhe procedurave të ankimit për aktin administrativ.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

Nxjerrja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të tij, në pajtim me parimet e përgjithshme të neneve 5, 6, 9, 14 dhe 26 të këtij ligji.

Neni 36
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dekreti nr.3824, datë 1.12.1964 i Presidiumit të Kuvendit Popullor “Për mbrojtjen civile të Republikës”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2956, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Kuvendi

Përmbledhje legjislacioni për qeverisjen vendore
dhe reformën administrative / RSH. Kuvendi. –
Tiranë : Qendra e Botimeve Zyrtare, 2018
...f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-01-088-9

1.Qeverisja bashkiake 2.Ligje

353(496.5) (094.5)

342.553(496.5) (094.5)